UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK

DISERTACION I DOKTORATURËS

BAZAT JURIDIKE TË TRASHËGIMISË SIPAS TË DREJTËS POZITIVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE TË DREJTËS KOMPARATIVE

NË KËRKIM TË GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

KANDIDATI:
Egzone Osmanaj

MENTORI:
Prof.Dr.Adnan Jashari

Tetovë, 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj më përgjegjësi të plotë se përmbajtja e tezës së doktoratës më titull: "Bazat juridike të trashëgimisë sipas të drejtës pozitive në Republikën e Kosovës dhe të drejtës komparative" është plotësisht autentike e krijuar nga unë në mënyrë të pavarur duke respekuar rregullat akademike dhe të sjelljes etike. Deklaroj gjithashtu se ky punim nuk është prezantuar para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar.

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim arritjen e këtyre objektivave bazë: -të analizohet rregullimi juridik i trashëgimisë ligjore dhe asaj testamentare si dhe procedurës trashëgimore në Kosovë, në një vështrim krahasimor më disa vende në rajon; - të analizohen raste trashëgimore të shqyrtuara nga gjykatat e vendit; - të bëhet evidentimi i problematikës së vërejtur gjatë analizimit të rasteve trashëgimore dhe të bëhen përpjekje në gjetjen e zgjidhjeve lidhur më to. Gjatë punimit janë parashtruar këto pyetje kërkimore: -Së pari, në lidhje më rregullimin ligjor të trashëgimisë është parashtruar pyetja: -Çka e karakterizon rregullimin juridik të trashëgimisë në Kosovë dhe në vendet e përfshira në studim përkatësisht në Maqedoni, Shqipëri, Serbi, Mal të Zi, Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë; -Cilat janë qasjet dhe dallimet kryesore ndërmjet ligjit tonë dhe ligjeve të shteteve të marra në studim? Ndërsa, në lidhje më praktikën gjyqësore vendase janë parashtruar këto pyetje: -Si bëhet inicimi i procedurës trashëgimore në praktikë? -Sa kohë kalon nga vdekja e trashëgimlënësit dhe inicimit të procedurës trashëgimore? -Cilat nga dy bazat juridike të thirrjes në trashëgimi dominon në praktikë? -A u njihet në praktikë të gjithë personave pa dallime, e drejta e barabartë në trashëgimi apo bëhen dallime në baza të ndryshme? -Sa nga trashëgimtarët e përfshirë në aktvdekje (femra dhe meshkuj) e realizojnë të drejtën e trashëgimisë? -Cilat nga format e testamenteve të njohura më ligj, aplikohet më së shumti nga ana e trashëgimlënësve? -Cilat janë shkaqet për të cilat ndërprehet dhe pezullohet procedura trashëgimore më së shpeshti në praktikë? - A kanë ndikim sot normat zakonore në marrëdhëniet e trashëgimisë, e sidomos kur bëhet fjalë për të drejtën trashëgimore të gruas? Në përpjekje për të ofruar një informacion sa më të saktë lidhur më pyetjet e parashtruara gjatë punimit, është realizuar hulumtimi në gjykata dhe anketa (pyetësori) më qytetarët. Hulumtimi në gjykata është orientuar në mbledhjen e të dhënave për rastet trashëgimore të inicuara dhe të zgjidhura në gjykatat e përfshira në studim për gjatë përiudhës 2003-2014, më konkretisht ky hulumtim është fokusuar në identifikimin dhe analizimin e të dhënave në lidhje më: mënyrën e inicimit të procedurës trashëgimore; numrin e trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje dhe cilësia e tyre; numrin e trashëgimtarëve të cilët kanë trashëguar dhe sipas cilës bazë juridike; numrin e trashëgimtarëve të cilët kanë hequr dorë nga trashëgimi dhe në favor të kujt; rastet në të cilat procedura është ndërprerë për shkak të lindjes së kontestit midis palëve; etj. Metodologjia e hulumtimit në gjykata është bazuar në mbledhjen e të dhënave për rastet trashëgimore përmes

metodës së studimit të dokumentacionit dhe përdorimit të formularëve. Rezultatet e hulumtimit tregojnë që mungon bashkëpunimi adekuat ndërmjet organit komunal dhe gjykatës në veprimet që duhet të ndërmirren në rastin e inicimit të procedurës trashëgimore. Si rezultat i kësaj, procedurat trashëgimore asnjëherë nuk inicohen sipas ligjit. Gjykatat nuk i inicojnë procedurat trashëgimore sipas detyrës zyrtare, siç parashihet më ligj, por kjo bëhet vetëm në bazë të kërkesës së palëve. Sa i përkët numrit të trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje, nuk ekziston ndonjë dallim i madh midis numrit të trashëgimtarëve femra dhe meshkuj. Mirëpo, ekzistojnë dallime të rëndësishme sa i përkët numrit të trashëgimtarëve femra dhe meshkuj, të cilët e shfrytëzojnë të drejtën e trashëgimisë. Përqindja e femrave të cilat e shfrytëzojnë të drejtën e trashëgimisë, krahasuar më përqindjen e meshkujve është shumë e ulët. Femrat në shumicën e rasteve heqin dorë vullnetarisht nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve meshkuj të familjes. Pavarësisht se më ligj, përparësi i jepet trashëgimisë testamentare, në praktikë në shumicën e rasteve trashëgimia ndahet në mungesë të testamentit. Mungesa e testamenteve ndikon në numrin e vogël të femrave që trashëgojnë dhe krijon më shumë mundësinë që femrat të heqin dorë nga trashëgimia.

Fjalët kyçe: trashëgimi; trashëgimtarë; trashëgimlënës; testament, ligj.

Abstract

The aim of this paper is to accomplish the following basic objectives: -to analyze the legal regulation of legal inheritance and the testamentary and hereditary procedure in Kosovo, comparing to some countries in the region; -to analyze hereditary cases investigated by the local courts; -to identify the problems encountered upon analyzing hereditary cases and to make efforts to find solutions related to them. During the questioning, the following questions have been raised: -First, regarding the regulation of inheritance legislation, the question is: What characterizes the legal regulation of inheritance in Kosovo and in the countries included in the study, respectively in Macedonia, Albania, Serbia, Montenegro, Slovenia, Croatia and Bosnia and Herzegovina; -What are the main approaches and differences between our law and the laws of the states included in the study? Whereas, regarding the exercising of decision-making, the following questions have been raised: Is the inheritance procedure initiated in practice? –How long does it take from the death of the heirs and the initiation of the hereditary procedure? -Which of the two legal bases of call to inheritance dominate in practice? -Are all the persons recognized in practice without any distinction, the right to inheritance or differences on different grounds? -How many of the heirs are involved in the act of death (female and male) accomplish the right to inheritance? –Which from the forms of the testaments recognized by the law are mostly applied from the heirs? -What are the reasons that the inheritance testament procedure is revoked and suspended most often in practice? -Do customary norms affect inheritance issues today, particularly when it comes to the hereditary right for a woman? In an effort to provide more accurate information on the questions during the procedure, the research was conducted in the courts and the survey with citizens. The research in the Court is oriented to the collection of data on inherited cases initiated and solved in the Courts involved in the study during the period 2003-2014, more specifically, this research focused on identifying and analyzing data related to the method of initiation of hereditary procedure; the number of heirs involved in acts of deaths and their quality; the number of heirs as inheritors and according to which legal basis; the number of heirs who have renounced the inheritance and in whose favor; cases in which the proceedings have been terminated, because of the dispute between the parties; etc. The methodology of research in the court is based on the collection of data on hereditary cases through the method of study documentation and the use of forms. The survey results show that

lack adequate cooperation between the municipal authority and actions of the court to be taken in case of initiation of an inheritance procedure. As a consequence, hereditary procedures have never been initiated according to the law. The courts do not initiate inheritance procedures ex officio, as provided by the law, but this is performëd only upon the claim of the parties. As to the number of heirs involved in the act of death, there is no significant difference between the number of female and male heirs. However, there are significant differences in the number of female and male heirs who use the right to inheritance. The percentage of women who use the right to inheritance compared to the male percentage is very low. Women in most cases voluntarily waive the right to their inheritance in favor of the family of male heirs. Despite the customary law, the priority is given to testamentary inheritance, in practice, in most cases, inheritance is divided in the absence of the testament. The lack of testaments affects the small number of women who inherit and creates more opportunities for women to waive the right to their inheritance.

Keywords: inheritance; heir testator; testament, law.

Апстракт

Овој труд има за цел постигнување на овие основни цели: - да го анализира правното уредување на законското и тестаментарното наследство, како и наследната процедура во Косово, со споредбено осврнување кон некои земји во регионот; - да ги анализира наследните случаи истражени од домашните судови; - да направи евидентирање на запазената проблематика при анализа на наследните случаи и да вложува напори за изнаоѓање решенија. Во текот на пишувањето на трудот, беа поставени следните истражувачки прашања: - Прво, во однос на законското уредување на наследството, се поставувало прашањето: - Што го карактеризира законското уредување на наследството во Косово и земјите вклучени во студијата, односно Македонија, Албанија, Србија, Црна Гора, Словенија, Хрватска и Босна и Херцеговина?; - Кои се главните пристапи и разлики помеѓу нашиот закон и законите на земјите во студијата? А, во однос на домашната судска пракса, се поставени следниве прашања: - Како се започнува постапката за наследство во пракса? - Колку време е потребно за да помине од смртта на оставителот и покренувањето на наследната постапка? - Која од двете правни основи за повикување во наследство доминира во пракса? - Дали во пракса им се признава на сите без разлика, еднаквото право на наследство или се прават разлики по различни основи? - Колку од наследниците вклучени во тестаментот (женски и машки) го остваруваат правото на наследство? - Која од законски признатите форми на тестамент најмногу се применува од страна на оставителите? - Кои се причините за кои постапката за наследување најчесто се прекинува и суспендира во пракса? - Дали обичајните норми влијаат врз наследството денес, особено кога станува збор за наследното право на жените? Во обид да обезбеди најточни информации за прашањата поставени за време на пишувањето на трудот, беше спроведено истражување во судовите и беше направена анкета (прашалник) со граѓаните. Истражувањето во судовите е ориентирано кон собирање на податоци за наследните случаи иницирани и решени во судовите вклучени во студијата во периодот 2003-2014, поточно ова истражување се фокусираше на идентификација и анализа на податоци во врска со: начинот на иницирање на наследната постапка; бројот на наследници вклучени во тестаментот и нивното својство; бројот на наследници кои имаат наследено и врз која правна основа; бројот на наследници кои се откажале од наследството и во чија корист;

случаи во кои постапката е прекината поради раѓање на спор меѓу страните, итн. Методологијата на истражување во судовите се заснова на собирање на податоци за наследни случаи преку методот на проучување на документацијата и употребата на формулари. Резултатите од истражувањето покажуваат дека постои недостаток на соодветна соработка помеѓу општинскиот орган и судот во акциите што треба да се преземат во случај на покренување на наследна постапка. Како резултат на тоа, наследните процедури никогаш не се иницирани според законот. Судовите не поведуваат постапки за наследство по службена должност, како што е предвидено со закон, но ова се прави само по барање на странките. Во однос на бројот на наследници вклучени во тестаментот, не постои значајна разлика помеѓу бројот на наследници жени и мажи. Сепак, постојат значителни разлики во бројот на машки и женски наследници кои го користат правото на наследство. Процентот на жените кои го користат правото на наследство, во споредба со процентот на мажите, е многу мал. Жените во повеќето случаи доброволно се откажуваат од своето наследство во корист на машките семејни наследници. И покрај фактот дека со закон, приоритет му се дава на тестаментарното наследство, во пракса, во повеќето случаи наследството се дели без постоење на тестаментот. Недостатокот на тестаментите влијае на малиот број на жени кои наследуваат и создаваат повеќе можности за жените да се откажат од своето наследство.

Клучни зборови: наследство; наследници; оставител; тестамент, закон.

FALËNDERIME

Realizimi i këtij punimi nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen dhe këshillat e shumë individëve, të cilët gjej rastin t'i falënderoj.

Së pari, falënderoj mentorin e këtij punimi, profesorin e nderuar, Prof.asoc.dr. Adnan Jashari, për inkurajimin dhe mbështetjen e pakursyer gjatë gjithë përiudhës së studimeve të doktoraturës, përmes këshillave dhe sygjerimeve të çmuara profesionale.

Falënderoj gjithashtu subjektët pjesëmarrëse në hulumtim, kryetarët, gjyqtarët dhe zyrtarët e tjerë të gjykatave të përfshira në studim, individët që moren pjesë në plotësimin e pyetësorit, për gatishmërinë e bashkëpunimit, mbështetjen dhe inkurajimin për realizimin e hulumtimit.

Dhe në fund dëshiroj të falënderoj gjithë familjen time, në veçanti prindërit Beqirin dhe Eminën dhe dy vëllezërit e mi Edonin dhe Qendrimin për dashurinë, durimin dhe ndihmën e tyre të pakursyer.

Përmbajtja

1. Hyrje 21
1.1 Problematika e punimit 22
1.2 Qëllimi dhe objektivat e punimit 24
1.3 Përmbledhje e literaturës së punimit 24
1.4 Pyetjet kërkimore 26
1.5 Hipotezat e punimit 26
1.6 Metodologjia e punimit 27
1.7. Kufizimet dhe vështirësitë 28
1.8 Kontributi i punimit 28

KAPITULLI I: ZHVILLIMI HISTORIK I TRASHËGIMISË 30

1. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit.....30
1.1.1. Trashëgimia në shtetet e lindjes së lashtë 31
1.1.2. Trashëgimia në antikitetin grek 33
1.2. Trashëgimia në të drejtën romake 35
1.2.1. Mënyra e thirrjes se trashëgimtarëve në trashëgimi sipas të drejtës romake.....37
1.2.2. Trashëgimia testamentare në të drejtën romake 39
1.3 Trashëgimia në të drejtën osmane (sheriatit) 42
1.4 Rregullimi i trashëgimisë në të drejtën zakonore shqiptare 46
1.4.1 Trashëgimia në Kanunin e Lekë Dukagjinit 47
1.4.2 Trashëgimia në Kanunin e Labërisë 50
1.5. Rregullimi i trashëgimisë në të drejtën borgjeze gjegjësisht në Kodet Civile të fund shek. XIX dhe fillim shek. XX 54
1.5.1 Trashëgimia në Kodin Civil Francez të vitit 1804.....54
1.5.2 Trashëgimia në Kodin Civil Gjerman të vitit 1900.....57
1.5.3 Trashëgimia në Kodin Civil Shqiptar të vitit 1929.....58
1.5.4 Trashëgimia në Kodin Civil Shqiptar të vitit 1982 63
1.6. Rregullimi i trashëgimisë në Kosovë prej përiudhës se sundimit osman e deri më sot ...65
1.6.1 Trashëgimia në Kosovë gjatë sundimit osman e deri në vitin 1912.....65
1.6.2 Trashëgimia në Kosovë në përiudhën 1912-1945.....67
1.6.3 Trashëgimia në Kosovë në përiudhën 1945-1990 70
Përfundimi 74

KAPITULLI II: TRASHËGIMIA LIGJORE NË KOSOVË DHE NË DISA SHTETE NË RAJON- VËSHTRIM KRAHASIMOR 76

2. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit 76
2.1. Parimet e përgjithshme mbi trashëgiminë.....77
2.1.1 Kuptimi i trashëgimisë 77

2.1.2 Koha dhe vendi i çeljes së trashëgimisë 78
2.1.3 Aftësia për të trashëguar 79
2.2. Padenjësia 80
2.2.1 Vlerësimi i shkaqeve të padenjësisë 85
2.2.2 Falja e padenjësisë 86
2.3 Heqja dorë nga trashëgimia 87
2.3.1 Pasojat e heqjes dorë nga trashëgimia 89
2.3.2 Anulimi i deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia.....90
2.4 Rregullimi i trashëgimisë ligjore në Kosovë 92
2.4.1 Rrethi i trashëgimtarëve ligjorë 92
2.4.1.2 Radha e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Kosovë 96
2.4.1.3 Radha e parë e trashëgimisë 97
2.4.1.4 Radha e dytë e trashëgimisë 99
2.4.1.5 Radha e tretë e trashëgimisë 101
2.4.1.6 Shteti (Komuna) si trashëgimtarë ligjorë i radhës së fundit 102
2.5 Trashëgimtarët e domosdoshëm 104
2.5.1 Pjesa e pasurisë trashëgimore që u takon trashëgimtarëve të domosdoshëm.....107
2.5.1.2 Si veprohet në rastin kur cenohet pjesa trashëgimore e domosdoshme 108
2.5.1.3 Si bëhet zvogëlimi i disponimit më testament dhe kthimi i dhurimeve 109
2.5.1.4 Përjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm nga trashëgimia 112
2.5.1.5 Shkaqet e përjashtimit 113
2.5.1.6 Privimi nga pjesa e domosdoshme 114
2.6 Rregullimi i trashëgimisë ligjore në Maqedoni, Shqipëri, Slloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë 115
2.6.1 Rrethi i trashëgimtarëve ligjorë 115
2.6.2 Radha e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë 121
2.6.2.1 Radha e parë e trashëgimisë 123
2.6.2.2 Radha e dytë e trashëgimisë 125
2.6.2.3 Radha e tretë e trashëgimisë 129
2.6.2.4 Radha e katërt e trashëgimisë 130
2.6.2.5 Radha e pestë e trashëgimisë 131
2.7 Trashëgimtarët e domosdoshëm në Maqedoni, Slloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë 132
2.7.1 Pjesa e pasurisë trashëgimore që u takon trashëgimtarëve të domosdoshëm 134
2.7.1.1 Si veprohet në rastin kur cenohet pjesa e domosdoshme 136
2.7.1.2 Përjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm nga trashëgimia 138
2.8 Trashëgimtarët e domosdoshëm në Shqipëri 140
Përfundimi 141
KAPITULLI III: TRASHËGIMIA TESTAMENTARE NË KOSOVË DHE NË DISA SHTETE NË RAJON- VËSHTRIM KRAHASIMOR 143

3. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit 143
3.1 Rregullat e përgjithshme të trashëgimisë testamentare 144
3.1.1 Kuptimi dhe karakteristikat e testamentit 144
3.1.2 Zotësia për të disponuar më testament 146
3.1.3 Zotësia për të trashëguar më testament 147
3.1.4 Pavlefshmëria e testamentit 148
3.2 Përmbajtja e testamentit 149
3.2.1 Caktimi i trashëgimtarëve dhe pasurisë që do u kalojë trashëgimtarëve 149
3.2.2 Caktimi i legut dhe barres 151
3.2.3 Caktimi i ekzekutuesit të testamentit 157
3.3. Llojet e formave të testamentit në Kosovë 159
3.3.1 Testamentet e rregullta 159
3.3.1.1 Testamenti i shkruar nga vetë testatori (ollograf) 159
3.3.1.2 Testamenti i shkruar në praninë e dëshmitarëve (alografik) 161
3.3.1.3 Testamenti gjyqësor 162
3.3.1.4 Procedura e bërjës së testamentit gjyqësor 163
3.3.1.5 Testamenti noterial 165
3.3.2 Testamentet e jashtëzakonshme 167
3.3.2.1 Testamenti më gojë 167
3.4 Format e testamentit në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri 171
3.4.1 Testamentet e rregullta 171
3.4.1.1 Testamenti i shkruar më dorë (ollograf) 172
3.4.1.2 Testamenti më shkrim në prani të dëshmitarëve (alografik) 173
3.4.1.3 Testamenti gjyqësor 174
3.4.1.4 Testamenti noterial 174
3.4.1.5 Testamenti konsular (diplomatik) 176
3.4.1.6 Testamenti ndërkombëtar 176
3.4.2 Format e testamenteve të jashtëzakonshme në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri 179
2.4.2.1 Testamenti gojor 180
2.4.2.2 Testamenti i bërë gjatë gjendjes së luftës (ushtarak) 180
2.4.2.3 Testamenti i bërë në anije 181
2.4.2.4 Testamenti i bërë në aeroplan 182
Përfundimi 183
KAPITULLI IV: PROCEDURA TRASHËGIMORE NË KOSOVË DHE NË DISA SHTETE NË RAJON- VËSHTRIM KRAHASIMOR 185
4. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit 185
4.1 Procedura trashëgimore në Kosovë 186
4.1.1 Kuptimi i procedurës trashëgimore 186

4.1.1.2 Organi i cili është kompetent të zhvillojë procedurën trashëgimore 187
4.1.1.3 Inicimi i procedurës trashëgimore 188
4.2 Përgatitja e procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore 189
4.2.1 Shqyrtimi i pasurisë trashëgimore 194
4.2.1.1 Rrjedha e zhvillimit të procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore 195
4.2.1.2 Ndërprerja e procedurës trashëgimore dhe udhëzimi i palëve në kontest civil 196
4.2.1.3 Aktvendimi për trashëgimi 198
4.2.1.4 Procedura në rastin kur është kompetent organi i shtetit të huaj 201
4.3 Procedura trashëgimore në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri 203
4.3.1 Një trajtim i shkurtër mbi rregullimin e procedurës trashëgimore në Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi 203
4.3.2. Një trajtim i shkurtër mbi rregullimin e procedurës trashëgimore në Shqipëri 209
Përfundimi 212

KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE DHE GJETJEVE TË HULUMTIMIT.....213

5. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit 214
5.1 Qëllimi dhe procedura e hulumtimit 214
5.1.1 Qëllimi i hulumtimit 214
5.1.2 Instrumentët e kërkimit 216
5.2 Zgjedhja e mostrës 217
5.2.1 Zgjedhja e mostrës për gjykata dhe procedura e realizimit të hulumtimit 217
5.2.1.1 Procedura e mbledhjes së të dhënave në Gjykata.....218
5.2.2. Zgjedhja e mostrës për pjesëmarrësit në pyetësorë dhe procedura e realizimit të pyetësorit 220
5.2.2.1 Procedura e realizimit të pyetësorit 222
5.3 Analiza e të dhënave dhe gjetjeve të hulumtimit në gjykata 224
5.3.1 Rastet e trashëgimisë të inicuara dhe të zgjidhura në Gjykatat Komunale tashmë Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014 224
5.3.2. Mënyra e inicimit të procedurës trashëgimore në praktikën e Gjykatave Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014.....228
5.3.2.1. Pasojat juridike nga inicimi më vonesë i procedurës trashëgimore 234
5.3.3. Bazat juridike në bazë të të cilave është ndarë trashëgimia në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014 236
5.3.3.1. Trashëgimtarët të cilët kanë përfituar nga trashëgimia testamentare 239
5.3.3.1 Format e testamenteve të cilat janë kundërshtuar nga trashëgimtarët 245
5.3.4. Numri i trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, 2003-2014 255
5.3.5. Numri i trashëgimtarëve të cilët kanë trashëguar në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, 2003-2014 263

5.3.5.1. Në çfarë roli kanë trashëguar femrat dhe meshkujt në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014 ……..266
5.3.5.2. Trashëgimtarët që kanë hequr dorë nga trashëgimia në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014 ……..268
5.3.6. Rastet për të cilat është pezulluar procedura për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtje të përjetshme ……..273

5.3.7. Numri i rasteve për të cilat është ndërprerë procedura trashëgimore dhe shkaqet e ndërprerjës ……...279

5.4. Analiza e të dhënave të nxjerra nga pyetësorët.....280
Konkluzionet 308
Bibliografia 317
Shtojca 341

LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORI

LTK	Ligji për Trashëgimi i Kosovës
LTMK	Ligji për Trashëgimi i Maqedonisë
LTRS	Ligji për Trashëgimi i Serbisë
LTHR	Ligji për Trashëgimi i Kroacisë
LTME	Ligji për Trashëgimi i Mal të Zi
LTBH	Ligji për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës
LTSI	Ligji për Trashëgimi i Sllovenisë
LPJK	Ligji për Procedurën Jokontestimore i Kosovës
LPJKMK	Ligji për Procedurën Jokontestimore i Maqedonisë
LPJKME	Ligji për Procedurën Jokontestimore i Malit të Zi
LPJKRS	Ligji për Procedurën Jokontestimore i Serbisë
LNRK	Ligji për Noterinë i Republikës së Kosovës
LNRSH	Ligji për Noterinë i Republikës së Shqipërisë
LRPS	Ligji për Regjistrimin e Partneritetit të të Njëjtit Seks në Sllloveni
LFK	Ligji për Familjen i Kosovës
LFMK	Ligji për Familjen i Maqedonisë
LPDTS	Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore i Republikës së Kosovës
LAFM	Ligji mbi Arsimin Fillorë dhe të Mesëm në Kosovë
KLD	Kanuni i Lekë Dukagjinit
KFSH	Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë
KH	Kodi i Hamurabit
KL	Kanuni i Labërisë
KS	Kanuni i Skendërbeut
KCF	Kodi Civil Francez (1804)
KCGJ	Kodi Civil Gjerman (1900)
KCSH	Kodi Civil Shqiptar (1929)
KCA	Kodi Civil Austriak (1811)
KCS	Kodi Civil Serb (1844)
LMD	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
ZGJC	Zyra për Gjendje Civile
KPK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
SKDP	Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë
PDP	Programi për të drejtat pronësore
USAID	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim e Shteteve të Bashkuara
BE	Bashkimi Evropian
OSBE	Organizata për Siguri dhe bashkëpunim Evropian

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Disa nga burimet teorike kryesore të referuara gjatë punimit.....25

Tabela 2: Ndarja e trashëgimtarëve ligjorë sipas të drejtës së sheriatit.....43

Tabela 3: Trashëgimtarët e domosdoshëm sipas legjislacioneve të shteteve të UE-së.....106

Tabela 4: Madhësia e pjesës trashëgimore e trashëgimtarëve të domosdoshëm në Kosovë....108

Tabela 5: Radhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Maqedoni, Shqipëri, Sllloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.....122

Tabela 6: Trashëgimtarët e domosdoshëm në Maqedoni, Sllloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.....133

Tabela 7: Madhësia e pjesës trashëgimore e trashëgimtarëve të domosdoshëm në Maqedoni, Sllloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.....135

Tabela 8: Afati ligjor për kërkimin e legut.....155

Tabela 9: Format e testamenteve të rregullta në shtetet e UE-së.....169

Tabela 10: Format e testamenteve të rregullta në Maqedoni, Serbi, Sllloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri.....171

Tabela 11: Format e testamenteve të jashtëzakonshme në Maqedoni, Serbi, Sllloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri.....179

Tabela 12: Mënyra e inicimit të procedurës dhe organi kompetent për zhvillimin e procedurës trashëgimore në Maqedoni, Serbi, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Sllloveni dhe Mal të Zi 205

Tabela 13: Pyetjet hulumtuese dhe instrumentët e përdorura të kërkimit.....216

Tabela 14: Gjykatat e përfshira në hulumtim dhe kohëzgjatja e hulumtimit.....219

Tabela 15: Përshkrimi i të dhënave demografike të individëve të përfshirë në mostër.....221

Tabela 16: Përqindja e rasteve të trashëgimisë të shqyrtuara brenda vitit të të cilit janë inicuar dhe të kryera në total deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi 225

Tabela 17: Mënyra e inicimit të procedurës trashëgimore shprehur në përqindje.....229

Tabela 18: Përqindja e rasteve (të përfunduara gjate viteve 2003-2014 në gjykatat e përfshira në studim) të ndara sipas viteve të cilat kanë kaluar nga vdekja e trashëgimlënësve dhe inicimit të procedurës.....233

Tabela 19: Format e testamenteve në bazë të të cilave është ndarë trashëgimia në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014.....238

Tabela 20: Numri i rasteve në të cilat trashëgimtarët e kanë kundërshtuar testamentin dhe janë udhëzuar në kontest civil 245

Tabela 21: Numri i trashëgimtarëve të cilët e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014 263

Tabela 22: Në çfarë roli apo cilësie kanë trashëguar femrat në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014……...266

Tabela 23: Në çfarë roli apo cilësie kanë trashëguar meshkujt në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014……...267

Tabela 24: Numi i trashëgimtarëve femra të cilat kanë hequr dorë nga trashëgimia 269

Tabela 25: Në favor të kujt kanë hequr dorë nga trashëgimia trashëgimtarët femra.....269

Tabela 26: Numi i trashëgimtarëve meshkuj të cilët kanë hequr dorë nga trashëgimia.....270

Tabela 27: Në favor të kujt kanë hequr dorë nga trashëgimia trashëgimtarët meshkuj 270

Tabela 28: Numri i rasteve për të cilat është pezulluar procedura trashëgimore për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtje të përjetshme 273

Tabela 29: Numri i rasteve për të cilat është ndërperë procedura trashëgimore dhe shkaqet e ndërprerjës 279

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku Nr/1: Përqindja e Komunave të Kosovës në të cilat janë shpërndarë pyetësorët 220

Grafiku Nr/2: Rastet e trashëgimisë të inicuara dhe të zgjidhura në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014 225

Grafiku Nr/3: Mënyra e inicimit të procedurës trashëgimore për rastet trashëgimore të zgjidhura për gjatë përiudhës 2003-2014 në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 229

Grafiku Nr/4: Bazat juridike në bazë të të cilave është ndarë trashëgimia në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014 236

Grafiku Nr/5: Numri i trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014 256

Grafiqet Nr/6: Si mendoni sipas ligjislacionit kosovar a konsiderohen të barabartë gratë dhe burrat në të drejtat pronësore 280

Grafiqet Nr/7: A duhet të trashëgojnë në mënyrë plotësisht të barabartë gratë dhe burrat.....281

Grafiqet Nr/8: A keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast jashtë familjes ku femra ka trashëgu në mënyrë të barabartë më meshkujt 282

Grafiqet Nr/9: A keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast tjetër jashtë familjes që femrës nuk iu është njohur fare e drejta në trashëgimi familjare 283

Grafiqet Nr/10: A dini për ndonjë rast që femra është detyruar nga anëtarët e tjerë të familjes (zakonisht anëtare meshkuj të familjes) të heqë dorë nga trashëgimia 284

Grafiqet Nr/11: A mendoni se në praktikë ndarja e trashëgimisë është më e madhe për burrat sesa për gratë 285

Grafiqet Nr/12: Në emër të kujt është e regjistruar prona në familjen tuaj 286

Grafiqet Nr/13: A mendoni së përkundër asaj që trashëgimia rregullohet më ligj,në praktikë sidomos kur bëhet fjalë për të drejtën e gruas në trashëgimi vazhdojn të zbatohen rregullat zakonore 287

Grafiqet Nr/14: A duhet të ndryshohet praktika e zbatimit të zakoneve në trashëgimi 288

Grafiqet Nr/15: Kush e ka rolin kryesor në ngritjen e vetëdijes në kontekstin e barazisë në mes femrave dhe meshkujve në trashëgimin e pronës familjare,vlerësoni nga 1 deri 5 289

Grafiqet Nr/16: Motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve 290

Grafiqet Nr/17: Edhe në rastet kur nuk kanë vëllezër motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia 291

Grafiqet Nr/18: Bashkëshortja e trashëgimlënësit kur nuk ka fëmijë nuk mund të trashëgojë pasurinë, atë duhet ta trashëgojnë prindërit apo vëllezërit e trashëgimlënësit 292

Grafiqet Nr/19: Bashkëshortja e trashëgimlënësit edhe kur ka fëmijë duhet të heqë dorë nga trashëgimia në favor të fëmijve/djemve 293

Grafiku Nr/20: Në rast së paradhësi i juaj më testament do t'iu ndante në mënyrë të barabartë pronën familjare më trashëgimtarët meshkuj të familjes a do ta pranonit trashëgiminë 294

Grafiku Nr/21: Duke e ditur që edhe sipas ligjit iu takon e drejta e barabartë më meshkujt në trashëgimi a do kërkonit ju, që trashëgimia të ju ndahet në mënyrë plotësisht të barabartë më trashëgimtarët meshkuj të familjes 294

Grafiku Nr/22: Në rast së pas vdekjes së prindërve motra/rat do kërkonin hise në pronën e babait si do vepronit 295

Grafiku Nr/23: Në rast së do ju mohohej e drejta e trashëgimisë në pronën familjare nga anëtarët meshkuj të familjes si do vepronit 295

Grafiku Nr/24: Në rast së do të kërkonit realizimin e të drejtës së trashëgimisë më padi si mendoni sa do të haseni në përkrahje të familjes, rrethit/shoqërisë dhe institucioneve të drejtësisë.....296

Grafiku Nr/25: Në rastet kur femrës i mohohet e drejta në trashëgimi p.sh, nga vëllezërit sipas mendimit tuaj a duhet ajo të inicojë padi ……...297

Grafiku Nr/26: Në rastet kur femrës i mohohet e drejta në trashëgimi p.sh., nga vëllezërit sipas mendimit tuaj a duhet ajo të inicojë padi 298

Grafiku Nr/27: Në rast së një femër do kërkonte realizimin e të drejtës së trashëgimisë më padi si mendoni sa do të haste ajo në përkrahje 298

Grafiqet Nr/28: A dini për ndonjë rast që femra ka kërku më padi realizimin e të drejtës së trashëgimisë 300

Grafiqet Nr/29: Pse femrat në Kosovë nuk e kërkojnë trashëgiminë vlerësoni nga 1 deri 5 faktorët të cilet ndikojnë në këtë aspekt 301

Grafiqet Nr/30: A keni të hartuar testament 303

Grafiqet Nr/31: Kujt mendoni ju t'ia bartin trashëgiminë 304

Grafiqet Nr/32: A mendoni që në përgjithësi pozita ekonomike-sociale e gruas do të ishte më e mirë sikur të ishte më shumë e përfshirë në trashëgiminë e pronës familjare 305

1. HYRJE

Tema e disertacionit “Bazat juridike të trashëgimisë sipas të drejtës pozitive në Republikën e Kosovës dhe të drejtës komparative” ka në fokus të saj shqyrtimin dhe analizimin e çështjeve më kryesore që ndërlidhen më trashëgiminë ligjore dhe testamentare si dhe më procedurën trashëgimore, si në aspektin e rregullimit legjislativ vendas dhe të huaj ashtu edhe në aspektin e praktikës gjyqësore. Punimi do të trajtohet në këndvështrime të ndryshme. Pjesa e parë e punimit do të përshkruajë zhvillimin historik të institutit të trashëgimisë në përiudha të ndryshme historike, filluar nga zhvillimi i institutit të trashëgimisë në shtetet e lindjes së lashtë, në antikitetin grek, në të drejtën romake dhe në të drejtën osmane apo të drejtën e sheriatit. Më pas, trajtohet rregullimi i institutit të trashëgimisë sipas të drejtës zakonore shqiptare. Një vëmendje e rëndësishme në këtë pjesë, i kushtohet edhe trajtimit të institutit të trashëgimisë sipas të drejtës borgjeze. Përkatësisht, në këtë pjesë trajtohet rregullimi që gjente instituti i trashëgimisë në Kodin Civil Francez të vitit 1804, Kodin Civil Gjerman të vitit 1900 dhe Kodin Civil Shqiptar të vitit 1929. Kjo pjesë mbyllet më trajtimin e historikut të rregullimit të institutit të trashëgimisë në Kosovë nga koha e përfundimit të sundimit osman e deri më sot. Pjesa e dytë e punimit do të paraqesë dhe analizojë rregullimin e trashëgimisë ligjore në Kosovë në një vështrim krahasues më disa vende në rajon. Së pari, në këtë pjesë trajtohen parimet e përgjithshme mbi trashëgiminë si: koha dhe vendi i çeljes së trashëgimisë; aftësia për të trashëguar; paaftësia për të trashëguar për shkak të padenjësisë dhe heqja dorë nga trashëgimia. Më pas,trajtohet rregullimi i trashëgimisë ligjore gjegjësisht mënyrat apo radhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Kosovë, Maqedoni, Serbi, Kroaci, Slloveni, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Shqipëri. Një trajtim i veçantë në këtë pjesë i kushtohet trashëgimisë së domosdoshme konkretisht të drejtave që i takojnë trashëgimtarëve të domosdoshëm, në rastin kur cenohet pjesa trashëgimore e tyre e garantuar më ligj; si dhe shkaqeve për të cilat trashëgimtarit të domosdoshëm i pamundësohet që të trashëgojë për shkak të padenjësisë. Pjesa e tretë e punimit do të trajtojë institutin e trashëgimisë testamentare në Kosovë, Maqedoni, Serbi, Kroaci, Slloveni, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Shqipëri. Kjo pjesë do të analizojë një sërë çështjesh më rëndësi për trashëgiminë testamentare si: zotësia apo aftësia për të disponuar më testament, zotësia për të trashëguar më testament, elementët që duhet t’i përmbajë një disponim më testament si dhe format e testamentit. Këto çështje janë trajtuar duke u referuar në

Ligjin për Trashëgimi i Kosovës dhe njëkohësisht në Ligjet për Trashëgimi të shteteve të përfshira në studim. Pjesa e katërt e punimit analizon procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, duke u fokusuar në trajtimin e çështjeve më më rëndësi në lidhje më procesin e shqyrtimit të trashëgimisë si: inicimi i procedurës trashëgimore; organi kompetent për zhvillimin e procedurës trashëgimore; roli i organit administrativ dhe gjykatës në procesin e trashëgimisë; mbajtja e seancës gjyqësore për shqyrtimin e trashëgimisë; ndërprerja e procedurës trashëgimore dhe udhëzimi i palëve në kontest civil; marrja e aktvendimit për trashëgimi etj. Këto çështje janë trajtuar duke u referuar në legjislacionin pozitiv në Kosovë dhe njëkohësisht në legjislacionin pozitiv të shteteve të përfshira në studim konkretisht legjislacionin pozitiv në Maqedoni, Serbi, Kroaci, Slloveni, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Shqipëri. Pjesa e pestë e punimit merr në shqyrtim dhe analizon të dhënat dhe gjetjet kryesore të hulumtimit të kryer në disa Gjykata Themelore në Kosovë, përkatësisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Prizren dhe Pejë. Në këtë pjesë analizohet gjithashtu edhe rezultati i pyetësorit/anketës të realizuar më qytetar, në lidhje më të drejtën e gruas në trashëgimi. Në fillim të kapitullit, shpjegohet qëllimi, pyetjet hulumtuese, hipotezat, zgjedhja e mostrës dhe procedura e mbledhjes së të dhënave. Më pas, analizohen të dhënat dhe gjetjet kryesore të hulumtimit në gjykata dhe pyetësorit të realizuar më qytetar.

1.1.Problematika e punimit

Instituti i trashëgimisë paraqet mjetin e vetëm përmes të cilit mundësohet bartja e të drejtave dhe detyrimeve pasurore i personit të vdekur tek personat e tjerë. Pra, nëpërmjet trashëgimit bëhet e mundur që të drejtat dhe detyrimet e karakterit pasuror të cilat i ka gëzuar personi i vdekur (trashëgimlënësi), të mos shuhen por të bëhet kalimi i tyre tek personat e tjerë (trashëgimtarët potencial). Duke u nisur nga rëndësia që ka instituti i trashëgimisë, çdo shtet i kushton rëndësi të veçantë këtij instituti përmes rregullimit ligjor të tij. Nëpërmjet rregullimit ligjor të trashëgimisë mundësohet që në baza të rregullta juridike të realizohet bartja e të drejtave dhe detyrave të karakterit pasuror, të trashëgimlënësit tek trashëgimtarët potencial. Edhe vendi ynë i ka kushuar rëndësi të posaçëm rregullimit ligjor të trashëgimisë. Marrëdhëniet e trashëgimisë në Kosovë, rregullohen më Ligjin "Për Trashëgiminë i Kosovës", i cili konsiderohet mjaftë kompatibil më ligjet evropiane dhe konventat ndërkombëtare. Mirëpo, zbatimi në praktikë i LTK, përcjellët më vështirësi në disa raste. Veçanërisht si problem në praktikë shtrohet: -

Mosrespektimi i parimit të barazisë në marrëdhëniet e trashëgimisë. Edhe pse më LTK, u garantohet të gjithë personave, e drejta e barabartë në trashëgimi, pavarësisht gjinisë, races apo kombësisë, në praktikë bëhen dallime në baza gjinore. Vlen të ceket gjithashtu se Kosova ka një legjislacion të avancuar, sa i përkët garantimit dhe mbrotjes së të drejtave të të dy gjinive në mënyrë të barabartë. Përkatësisht, barabarësia ndërmjet burrit dhe gruas mbrohet më një sërë ligje pozitive duke filluar nga Kushtetuta, e cila në nenin 7 par.2 përcakton barazinë gjinore si vlerë themelore ku thuhet: "Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore." Mandej ligje të tjera siç janë Ligji për Familjen, Ligji për Pronësinë, Ligji kundër diskriminimit, Ligji për barazi gjinore etj. Pra, më ligjet pozitive në Kosovë, femrat dhe meshkujt i gëzojnë të drejtat e barabarta në të gjitha sferat e jetës, përfshirë këtu edhe marrëdhëniet e trashëgimisë. Mirëpo, pavarësisht se më ligj në Kosovë, femrës i garantohet e drejta e barabartë më meshkujt në trashëgimi, në praktikë, ajo diskriminohet. Numri i femrave të cilat e shfrytëzojnë të drejtën e trashëgimisë krahasuar më meshkujt është shumë i ulët. Problemi në lidhje më mos trashëgiminë e pronës nga ana e femrave, ndërlidhet më zakonet dhe kulturën e vendit. Rregullat e së drejtës zakonore, të cilat e përjashtojnë gruan nga trashëgimia, vazhdojnë ende të luajnë një rol të rëndësishëm për shoqërinë kosovare. Si problem tjetër në praktikë shtrohet mos inicimi i procedurës trashëgimore konform ligjit. Më ligj konkretisht më LPJK, parashihet se procedura trashëgimore vihet në veprim nga gjykata sipas detyrës zyrtare (ex officio) posa gjykata të informohet se një person ka vdekur ose është shpallur i zhdukur për të vdekur më vendim gjyqësor. Përkundër së parashihet më ligj, në praktikë nuk respektohet asnjëherë kjo procedurë. Në praktikë, procedurat trashëgimore inicohen gjithmonë më kërkesë të palëve gjegjësisht trashëgimtarëve. Mos inicimi i procedurës trashëgimore sipas detyrës zyrtare, shkakton që palët (trashëgimtarët) të inicojnë procedurën trashëgimore shumë vite pas vdekjes së trashëgimlënësit. Inicimi më vonesë i procedurës trashëgimore shkakton një sërë pasoja. Së pari, inicimi më vones i procedurës trashëgimore shkakton që trashëgimlënësi të figurojë si titullarë i pronës së paluajtshme edhe pas vdekjes, e si pasojë e kësaj, trashëgimtarët nuk kanë mundësi që në mënyrë formale ta bartin pronën. Pra, trashëgimtarët potencial pengohen që në mënyrë ligjore të disponojnë më pronën e paluajtshme. Mos inicimi i procedurës trashëgimore konform ligjit, paraqet njërin nga problemet më serioze të cilat i ndeshim në praktikën tonë, problem ky i cili,

pra, mund të tërheq pas veti edhe shumë probleme të tjera. Problematikat e përmendura më sipër si dhe problematikat e tjera të indentifikuara gjate hulumtimit do të elaborohen më hollësisht në kapitullin e pestë të këtij punimi.

1.2.Qëllimi dhe objektivat e punimit

Punimi ka për qëllim arritjen e këtyre tri objektivave bazë:

- Të analizohet rregullimi juridik i trashëgimisë ligjore dhe asaj testamentare si dhe procedurës trashëgimore në një vështrim krahasimor në Kosovë, Maqedoni, Serbi, Shqipëri, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Slloveni;
- të analizohen raste trashëgimore të shqyrtuara nga gjykatat e vendit;
- të bëhet evidentimi i problematikës së vërejtur gjatë analizimit të rasteve trashëgimore dhe të bëhen përpjekje në gjetjen e zgjidhjeve lidhur më to.

Më konkretisht nëpërmjet analizimit të rasteve trashëgimore të zgjidhura nga gjykatat e vendit, synohet të bëhet identifikimi dhe analizimi i të dhënave në lidhje më:

- mënyrën e inicimit të procedurës trashëgimore;
- numrin e trashëgimtarëve të cilet përfshihen në aktvdekje dhe cilësia e tyre;
- numrin e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj të cilët trashëgojnë dhe sipas cilës bazë juridike gjegjësisht më testament apo më ligj;
- format e testamenteve në bazë të të cilave ndahet trashëgimia;
- numrin e trashëgimtarëve të cilët heqin dorë nga trashëgimia dhe në favor të kujt;
- rastet në të cilat procedura ndërprehet për shkak të lindjes së kontestit midis palëve;
- rastet në të cilat procedura pezullohet për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtjen e përjetshme.

1.3. Përmbledhje e literaturës së punimit

Punimi është mbështetur në tri lloje të burimeve: aktet ligjore, praktikën gjyqësore dhe literaturën vendase dhe të huaj. Në aspektin e akteve ligjore punimi është fokusuar kryesisht në Kushtetutën, Ligjin për Trashëgimi, Ligjin për Procedurën Jokontestimore, Ligjin për Noterinë etj. Nga legjislacioni i huaj janë studiuar ligjet për trashëgimi të disa prej shteteve të rajonit konkretisht Ligji për Trashëgimi në Maqedoni, Shqipëri, Serbi, Kroaci, Slloveni, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë. Një tjetër burim parësor është praktika gjyqësore apo vendimet

gjyqësore. Analizës i janë nënshtruar 18,891 vendime gjyqësore gjegjësisht aktvendime mbi trashëgiminë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë. Si burim tjetër është përdorur literatura ekzistuese mbi të drejtën trashëgimore, si librat universitarë, punimet shkencore etj. Në tabelën më poshtë janë përshkruar disa nga burimet teorike bazë të përdorura gjatë punimit.

Tabela 1: Disa nga burimet teorike kryesore të referuara gjatë punimit

- **Hamdi Podvorica** në librin e tij më titull: *"E Drejta Trashëgimore".* (2010)., jep një pasqyrë të rregullimit juridik të institucioneve më kryesore të së drejtës trashëgimore në Kosovë. Ai gjithashtu i shtjellon nga aspekti doktrinar edhe disa institucione të së drejtës trashëgimore të cilat nuk janë të rregulluara me dispozita juridike në Kosovë.
- **Nazmi Biçoku** në librin e tij më titull: ***"****E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë".* (2011)., paraqet dhe analizon në tërësi legjislacionin shqiptar referuar rregullimit të marrëdhënieve të trashëgimisë, që nga koha e shpalljes së pavarësisë (1912) e deri më sot.
- **Juliana Latifi** në librin e saj më titull: *"E Drejta e Trashëgimisë në Kosovë"* (2006)**.,** fokusohet në interpretimin e dispozitave ligjore të përmbajtura në Ligjin për Trashëgimi i Kosovës, në veçanti dispozitave të cilat i referohen institucioneve më kryesore të së drejtës trashëgimore si instituti i trashëgimisë ligjore, instituti i trashëgimisë së domosdoshme, instituti i trashëgimisë testamentare etj.
- **Arben Hakani** në librin e tij më titull: ***"****Trashëgimia Testamentare (Legjislacioni dhe Praktika Gjyqësore)"* (2010)., analizon përmbajtjen e masës legjislative për trashëgiminë testamentare në Shqipëri, duke u ndalur në mënyrë të hollësishme në disa aspekte që kanë të bëjnë me zbatimin në praktikë të aktit testamentar.
- **Kenneth Reid** dhe të tjerë në librin e tyre më titull: "*Comparative Succession Law-Intestate Succession"* (2015)., në mënyrë analitike përshkruajnë zhvillimin e të drejtës trashëgimore në vende të ndryshme dhe në përiudha të ndryshme kohore.
- **Novak M. Krstić** në punimin e tij të doktoratës më titull*: "Violation and Legal Protection of the Right to Compulsory Portion"* apo "ПОВРЕДА И ЗАШТИТА ПРАВА НА НУЖНИ ДЕО". (2015)., analizon institutin e trashëgimisë së domosdoshme në aspektin e kornizës legjislative të një numri të legjislacioneve të huaja dhe legjislacionit serb.
- **George A. Pelletier Jr. & Michael R. Sonnenreich** në artikullin e tyre më titull *"A Comparative Analysis of Civil Law Succession"* (1966)., analizojnë parimet e përgjithshme apo institucionet themelore të së drejtës trashëgimore, duke u referuar kryesisht në të drejtën romake, të drejtën franceze dhe të drejtën gjermane.

1.4. Pyetjet kërkimore

Objektivat e këtij punimi janë bazuar në pyetjet kërkimore si në vijim:

P1. Çka e karakterizon rregullimin juridik të trashëgimisë në Kosovë dhe në vendet e përfshira në studim përkatësisht në Maqedoni, Shqipëri, Serbi, Mal të Zi, Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë?

P1.1. Cilat janë qasjet dhe dallimet kryesore ndërmjet ligjit tonë dhe ligjeve të shteteve të marra në studim?

P2. Si bëhet inicimi i procedurës trashëgimore në praktikë?

P3.1. Sa kohë kalon nga vdekja e trashëgimlënësit dhe inicimit të procedurës trashëgimore respektivisht a ndodhë se procedura trashëgimore të inicohet edhe shumë vite pas vdekjes së trashëgimlënësit dhe cilat janë pasojat juridike?

P3. Cilat nga dy bazat juridike të thirrjes në trashëgimi dominon në praktikë?

P4. Cilat nga format e testamenteve të njohura më ligj, aplikohet më së shumti nga ana e trashëgimlënësve?

P5. A u njihet në praktikë të gjithë personave pa dallime e drejta e barabartë për trashëgimi apo bëhen dallime në baza të ndryshme?

P6. Sa nga trashëgimtarët e përfshirë në aktvdekje (femra dhe meshkuj) e realizojnë të drejtën e trashëgimisë ?

P7. Cilat janë shkaqet për të cilat ndërprehet dhe pezullohet procedura trashëgimore më së shpeshti në praktikë?

P8. Cilët janë faktorët kryesore që ndikojnë në mos përfshirjen e grave në trashëgimi?

P8.1. A kanë ndikim sot normat zakonore në marrëdhëniet e trashëgimisë, e sidomos kur bëhet fjalë për të drejtën trashëgimore të gruas?

1.5. Hipotezat e punimit

Objektivat e hulumtimit të këtij punimi, mbështeten nga parashtrimi i tri hipotezave kryesore:

H1: "Në Kosovë procedura për shqyrtimin e trashëgimisë nuk inicohet konform ligjit."

H1.1 *"Gjykatat në Kosovë nuk inicojn procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë sipas detyrës zyrtare siç parashihet më ligj, por kjo bëhet vetëm më propozim të palëve."*

H1.2 *"Organi komunal i gjendjes civile nuk e kryen detyren ligjorë që në afatin e paraparë më ligj të dërgojë aktvdekjen në gjykatë."*

H2: "Në Kosovë nuk është në praktikë lënia e testamenteve, trashëgimia gati në të gjitha rastet ndahet në mungesë të testamentit."

H3: "Në Kosovë numri i femrave të cilat e realizojnë të drejtën e trashëgimisë në raport më meshkujt, është shumë i ulët."

H3.1 *"Trashëgimtarët femra sidomos kur thirren në trashëgimi në statusin e fëmijës së trashëgimlënësit, ato në shumicën e rasteve heqin dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve."*

1.6. Metodologjia e punimit

Metodologjia e këtij punimi është e bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë siguruar përmes metodës së studimit të dokumentacionit dhe përdorimit të formularëve dhe pyetësorëve. Metoda e studimit të dokumentacionit dhe formularët janë përdorur gjatë procedurës së mbledhjes së të dhënave në gjykata. Nëpërmjet metodës se studimit të dokumentacionit është mundësuar analizimi i dokumenteve të përmbajtura në dosjet e lëndëve trashëgimore, të tilla si: propozimi për inicimin e procedurës trashëgimore; dokumenti i aktvdekjes; proceverbali për mbajtjen e seancës gjyqësore për trashëgimi; testamenti, marrëveshja e palëve për mënyrën e ndarjes së trashëgimisë dhe aktvendimi për trashëgimi. Në mënyrë që të nxirret informacion statistikor, të dhënat e fituara nëpërmjet studimit të dokumentacionit, për çdo lëndë të studiuar janë regjistruar në formular. Pra, metodologjia e hulumtimit në gjykata është bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave për rastet trashëgimore përmes metodës së studimit të dokumentacionit dhe përdorimit të formularëve. Përveç nga hulumtimi në gjykata, një pjesë e të dhënave primare të këtij punimi janë siguruar edhe përmes pyetësorit të realizuar më individë. Në pyetësorë janë përfshirë 792 individë nga vende të ndryshme të Kosovës. Përzgjedhja e individëve të përfshirë në pyetësorë është bërë në mënyrë të rastishëm. Një elaborim më i gjerë për procesin e mbledhjes së të dhënave në gjykata, si edhe për procesin e realizimit të pyetësorit më individë, bëhet në kapitullin e pestë të këtij punimi. Ndërsa, të dhënat sekondare janë siguruar nëpëmjet përdorimit të literaturës bashkëkohore ekzistuese mbi të drejtën trashëgimore. Literatura e përdorur gjatë këtij punimi mbështetet në burime të ndryshme, si akte ligjore, libra universitarë, punime shkencore, monografi dhe burime të tjera.

1.7.Kufizimet dhe vështirësitë

Në Kosovë tematikat mbi trashëgiminë në aspektin komparativ dhe në aspektin praktikë janë shumë pak të trajtuara. Për rrjedhojë, mangësitë e studimeve e kanë bërë të vështirë mbështetjen e punimit në literatura të ndryshme. Andaj, punimi është mbështetur kryesisht në legjislacionin trashëgimor pozitiv në Kosovë dhe në vendet e përfshira në studim, duke u përpjekur të analizohen dhe krahasohen legjislacionet e marra në studim, më qëllim të demonstrimit të qasjeve dhe dallimeve kryesore midis tyre. Përveç legjislacionit, si burim tjetër parësor është përdorur praktika gjyqësore. Përveç limitimit në literaturë, vështirësi tjetër përgjatë studimit të këtij punimi apo sfida më e lartë ishte realizimi i fazës së hulumtimit, më qëllim të nxjerrjes së të dhënave statistikore për çështjet e studiuara në punim. Procesi i hulumtimit ka qenë një proces i gjatë dhe mjaft i vështirë, e veçanërisht hulumtimi në gjykata, i cili ka konsumuar shumë kohë dhe ishte një ndër sfidat më të mëdha gjatë realizimit të këtij punimi. Fillimisht përcaktimi i instrumenteve të kërkimit për nxjerrjen e të dhënave konkretisht përgatitja e formularit, e ka konsumuar një pjesë të konsiderushëm të kohës. Më tej,një pjesë e madhe e kohës është konsumuar në procesin e mbledhjes së të dhënave në gjykata, gjatë të cilit janë shqyrtuar dhe analizuar 18,891 raste trashëgimore.

1.8. Kontributi i punimit

Kontributi shkencor dhe rëndësia e punimit qëndron në analizimin e legjislacionit trashëgimor pozitiv në Kosovë më vështrim krahasimor edhe më legjislacionet trashëgimore pozitive të disa prej vendeve të rajonit. Gjithashtu, kontributi qëndron në trajtimin në disa aspekte që kanë të bëjnë më zbatimin në praktikë të legjislacionit trashëgimor vendas. Duke qenë se studimet mbi vështrimin komparativ dhe në praktikë në lidhje më të drejtën trashëgimore janë shumë të pakta, kontributi i distertacionit më titull “Bazat juridike të trashëgimisë sipas të drejtës pozitive në Republikën e Kosovës dhe të drejtës komparative” është i një rëndësie të veçantë dhe konsiderohet një prurje e re në shkencën kosovare. Ndër rezultatet kryesore që pritet të dalin nga trajtimi i këtij punimi janë:

- Të kuptohen dhe identifikohen qasjet dhe dallimet kryesore ndërmjet ligjit tonë për trashëgimi dhe ligjeve të shteteve të përfshira në studim;

- Të analizohen në aspektin praktikë çështje më rëndësi lidhur më trashëgiminë ligjore dhe testamentare, duke analizuar raste trashëgimore të ndryshme të shqyrtuara nga gjykatat e vendit të përfshira në studim;
- Të nxirren të dhëna statistikore për rastet trashëgimore të analizuara, kryesisht për numrin e trashëgimtarëve të cilet kanë trashëguar dhe mbi cilen bazë juridike gjegjësisht më testament apo më ligj, për format e testamenteve në bazë të të cilave është bërë ndarja e pasurisë trashëgimore, për mënyrën si është inicuar procedura trashëgimore, etj.

KAPITULLI I

ZHVILLIMI HISTORIK I TRASHËGIMISË

1. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit

Në këtë kapitull trajtohet zhvillimi i institutit të trashëgimisë në përiudha të ndryshme historike. Fillimisht trajtohet rregullimi i institutit të trashëgimisë në shtetet e lindjes së lashtë dhe në antikitetin grek. Më pas trajtohet zhvillimi i trashëgimisë në të drejtën romake, ku trajtohet rregullimi i dy formave të trashëgimisë: trashëgimisë ligjore dhe asaj testamentare sipas të drejtës së lashtë, të drejtës klasike dhe të drejtës post-klasike romake. Një trajtim i shkurtër në këtë kapitull, i bëhet institutit të trashëgimisë edhe sipas të drejtës osmane përkatësisht të drejtës së sheriatit, rregullat e së ciles janë zbatuar një kohë të gjatë edhe në Kosovë. Një vëmendje të rëndësishme në këtë kapitull, gjen trajtimi i institutit të trashëgimisë sipas të drejtës zakonore shqiptare, në këtë pjesë rëndësi të veçantë i kushtohet studimit të kanuneve sidomos Kanunit të Lekë Dukagjinit, rregullat e të cilit janë zbatuar për qindra vjet në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare. Vëmendje e rëndësishme në këtë kapitull, gjithashtu i kushtohet edhe trajtimit të institutit të trashëgimisë sipas të drejtës borgjeze. Përkatësisht në këtë pjesë trajtohet rregullimi që gjente instituti i trashëgimisë në Kodin Civil Francez të vitit 1804 dhe Kodin Civil Gjerman të vitit 1900, të cilët konsiderohen ndër kodet civile më të rëndësishme të fund shek.XIX dhe fillim shek XX. Gjithashtu, në këtë pjesë trajtohet edhe rregullimi që gjente instituti i trashëgimisë në Kodin Civil Shqiptar të vitit 1929 dhe vitit 1982. Kapitulli mbyllet më trajtimin e historikut të rregullimit të institutit të trashëgimisë në Kosovë nga koha e përfundimit të sundimit osman e deri më sot. Vëmendje e posaçme në këtë pjesë i është kushtuar studimit të burimeve juridike, të cilat janë zbatuar për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë në përiudhën midis dy luftërave botërore dhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, më ç'rast janë analizuar Kodi Civil Serb i vitit 1844 dhe Ligji për Trashëgimi i vitit 1955.

1.1. Rregullimi i trashëgimisë në shtetet e lindjes së lashtë dhe shtetet antike

1.1.1. Rregullimi i trashëgimisë në shtetet e lindjes së lashtë

Sipas teorisë historike-juridike në shtetet e lindjes së lashtë, si burime juridike kryesore për rregullimin e marrëdhënieve trashëgimore, ashtu sikure edhe për rregullimin e marrëdhënieve të tjera juridike janë aplikuar: e drejta zakonore, aktet ligjore, urdhëresat e organeve administrative të pushtetit qendror dhe lokal si dhe praktika gjyqësore. E drejta zakonore për një kohë të gjatë ka shërbyer si burimi më i rëndësishëm i së drejtës në përgjithësi dhe së drejtës trashëgimore në veçanti. Ndër ligjet e shteteve të lindjes së lashtë dallohej Kodi i Hamurabit *(shek VIII p.e së re)*[1]. Kodi i Hamurabit përbëhej prej 282 neneve,të cilat i referoheshin gjykatave, rregullimit të marrëdhënieve pronësore, familjare, trashëgimore, detyrimore etj. Kodi i Hamurabit (tani e tutje KH), rregullimit të marrëdhënieve trashëgimore iu ka kushtuar nenet nga 162 deri në nenin 184. Në KH,nuk aplikohej parimi i barazisë në trashëgimi. Sipas KH, femrat nuk konsideroheshin trashëgimtarë ligjorë, trashëgimtarë ligjorë konsideroheshin vetëm meshkujt e familjes. Sipas rregullave të KH, pas vdekjes së trashëgimlënësit vajzave të martuara të cilave më parë nuk iu ishte ndarë *"*Shiritka[2]" si dhe vajzave të pamartuara u jepej "Shiritka", bashkëshortës pasjetuese i jepej "Nuduna", kurse pjesa tjetër e mbetur e pasurisë trashëgimore, u ndahej në pjesë të barabarta djemve të familjes.[3] Pra, më marrjen e "Shiritkës" vajzave nuk iu takonte më asnjë e drejtë në pasurinë trashëgimore të mbetur pas marrjes së "Shiritkës", edhe pse vlera e "Shiritkës" rëndomtë ka qenë më e vogël krahasuar më vlerën e pasurisë trashëgimore, e cila iu ndahej djemve në pjesë të barabarta. Sipas KH, shiritkën pas vdekjes së bashkëshortës nuk e trashëgonte bashkëshorti pasjetues, shiritka u jepej fëmijëve të saj[4] dhe po që se gruaja nuk kishte fëmijë, atëherë shiritka i kthehej familjes së babait të saj.[5] Pra, bashkëshorti pasjetues nuk kishte asnjë të drejtë në shiritkë. Sipas KH, as në rastet kur trashëgimlënësi nuk linte djemë, vajzat nuk mund ta trashëgonin, në rastet e tilla trashëgimia u ndahej nipave, nëse mungonin nipat trashëgimia u ndahej vëllezërve e në rast se mungonin edhe vëllezërit trashëgimia u ndahej axhallarëve. KH, lejojnte trashëgimlënësin që njërin prej djemve të cilin e donte më shumë ta

[1] A.Vajs & L.Kandiq (1984) Historia e Përgjithshme e Shtetit dhe e së Drejtës. Botimi i Tretë. Universiteti i Kosovës në Prishtinë. Fq.37-38.
[2] Shiritka ishte si një lloj pajë e ngjajshme më pajën në të drejtën zakonore shqiptare, qe ju jepej vajzave nga familja më rastin e martesës.
[3] H. Ismaili & F. Sejdiu (2000) Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës. Prishtinë. Fq.85.
[4] Kodi i Hamurabit (The Code of Hammurabi. Babylon, Mesopotamia,1700s B.C). Shih nenin 162. (http://www.constitution.org/ime/hammurabi.pdf).
[5] Po aty, shih nenin 163.

favorizonte, duke i dhuruar pasuri për së gjalli.[6] Kjo rezulton nga neni 165 i KH, ku thuhet: "në qoftë së një burrë i dhuron njërit prej djemve të tij që ai preferon një arë,kopsht,apo shtëpi dhe për këtë i lëshon një dokument, atëherë nëse ky burrë vdesë dhe djemtë e tij e ndajnë pasurinë, ata duhet së pari ti japin vëllaut të tyre dhuaratën, që ka ndarë për të babai i tyre dhe më pas të ndajnë në pjesë të barabarta, pjesën e mbetur të pasurisë së bashku më vëllaun të cilit babai i kishtë lënë dhuaratën". Pra, dhurata të cilen trashëgimlënësi i bëntë njërit prej djemve të tij, nuk përfshihej në pasurinë trashëgimore, kurse në pjesën e pasurisë trashëgimore që mbetej pas marrjes së dhuratës, ka trashëgu në mënyrë të barabartë më vëllezërit e tjerë edhe djali i cili pranonte dhuratën.Është më rëndësi të përmendet, që KH, si trashëgimtarë ka njohur edhe fëmijët jashtëmartesor, por më kusht që trashëgimlënësi të pranojë atësinë ndaj tyre për së gjalli. Kjo rrjedh nga neni 170 i KH ku thuhet "Në qoftë se dikujt i ka lindur bashkëshortja fëmijë skllavja (shërbëtorja) e tij i ka lindur fëmijë, kurse i ati sa ka qenë gjallë u ka thënë fëmijëve që i ka lindur skllavja "fëmijët e mi",e pastaj i ka konsideruar si fëmijë të bashkëshortës së vet, kur pastaj i ati vdes, fëmijët e bashkëshortës dhe të skllaves do të ndajnë pasuritë e të atit. Fëmijët e bashkëshortës do të zgjedhin dhe do të marrin". Kurse, në nenin 171 i KH, thuhet: "në qoftë se i ati sa ka qenë gjallë nuk i thotë "fëmijët e mi", fëmijët që i ka lindur skllavja (shërbëtorja), kur vdes i ati fëmijët e skllavës nuk do të ndajnë më fëmijët e bashkëshortës, mirëpo skllavja dhe fëmijët e saj do të jenë të lirë. Fëmijët e bashkëshortës nuk mund të reklamojnë skllavërinë e fëmijëve të skllaves". Pra, fëmijët jashtëmartesor të trashëgimilënësit kanë pasur mundësi të trashëgojnë vetëm në qoftë së trashëgimlënësi i ka pranuar për së gjalli si fëmijë të vetë, në të kundërtën fëmijëve jashtëmartesor nuk iu takonte asnjë e drejtë në trashëgimi, si trashëgimtarë ligjorë njiheshin vetëm fëmijët e lindur në martesë. Mirëpo, edhe në rastin kur fëmijëve jashtëmartesor u njihej atësia për gjalli nga trashëgimlënësi, ata prapë në trashëgimi nuk trajtoheshin në mënyrë të barabartë më fëmijët martesor. Fëmijët jashtëmartesor kanë pasur mundësi të trashëgojnë vetëm pronën e luajtshme, por jo edhe pronën e paluajtshme. E drejta në pronën e paluajtshme, u ka takuar vetëm fëmijëve martesor. Veç kësaj sipas KH, fëmijët martesor kishin të drejtë të zgjedhnin edhe pjesën e pasurisë së luajtshme që dëshironin ta trashëgonin. Është e rëndësishme të përmendet se më rregullat e KH, rregullohej edhe çështja e përjashtimit të trashëgimtarëve ligjorë nga trashëgimia. Lidhur më këtë çështje në nenin 168 i KH, thuhet: "në qoftë së dikush dëshiron për të përzënë djalin e vetë nga shtëpia ai duhet ti

[6] Shih H. Ismaili & F.Sejdiu (2000) Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës. Prishtinë. Fq 85.

deklaroj gjyqtarit "dua të përzë të birin tim jashtë", atëherë gjyqtari i shqyrton shkaqet e tij. Në qoftë se i biri nuk ka bërë ndonjë faj të madh që është i mjaftueshëm për ta pëzënë tërësisht jashtë,i ati nuk mund ta përzëjë". Në qoftë se ai ka bërë faj të rëndë që është i mjaftueshëm për të përzënë,për herë të parë do të falet; nëse ka bërë për herë të dytë faj të rëndë, i ati mund ta përzëjë". Pra, sipas KH, trashëgimlënësi mund të përjashtonte nga trashëgimia djalin e vetë, vetëm në qoftë se ai kryente dy herë ndonjë vepër të keqe kundër tij, në këtë rast trashëgimlënësi ishte i detyruar ta njoftojë gjykatën dhe ti tregontë shkaqet të cilat e arsyetonin veprimin e tij. Në teori, ka mendime së në shtetet e Lindjes së Lashtë, ka qenë e njohur vetëm trashëgimia ligjore, e jo edhe ajo testamentare, për faktin se në KH, nuk përmendet shprehimisht testamenti.[7] Mirëpo, në KH, hasen disa nene respektivisht dispozita të cilat lënë të nënkuptojnë se njihej forma e testamentit gojor, si p.sh., neni 150 ku thuhet:"Në qoftë se dikush ja falë bashkëshortës së vetë arën, kopshtin, shtëpinë dhe për këtë lëshon një dokument,pas vdekjes së bashkëshortit të saj fëmijët e saj nuk mund t'i mohojnë asgjë. Pas vdekjes,ajo mund t'ja lëjë këtë njërit djalë, cilit të dojë dhe nuk është e detyruar t'ja japë ndonjë vëllai tjetër (djemve të saj)". Ose p.sh, neni 179 ku thuhet "Në qoftë se femra e dedikuar ose publike, të cilës i ati i saj i ka dhënë sheriktë dhe për këtë i ka lëshuar dokument,si edhe ka shënuar në të se trashëgiminë e vet mund t'ja lëjë kujt të dojë ajo,e në qoftë se e ka lënë të veprojë sipas dëshirës së vet, kur i ati vdes,ajo mund t'ja lëjë trashëgimin e vet kujt të dojë, kurse vëllezërit e saj nuk mund t'i mohojnë asgjë".

1.1.2. Rregullimi i trashëgimisë në antikitetin grek

Sipas teorisë historike-juridike, në Athinë deri në reformat e Solonit është aplikuar vetëm trashëgimia ligjore, e cila rregullohej më të drejtën zakonore. Sipas të drejtës zakonore greke, trashëgimtarë ligjorë janë konsideruar vetëm meshkujt, femrave nuk u njihej e drejta në trashëgimi. Femrave u takonte e drejta vetëm në pajë, të cilën e merrnin më rastin e martesës. Edhe fëmijëve jashtëmartesor gjithashtu nuk iu është njohur e drejta në trashëgimi.[8] Fëmijëve jashtëmartesor trashëgimlënësi mund t'i linte ndonjë pjesë të pasuirsë trashëgimore vetëm nëpërmjet institutit të legatit. Fëmijët jashtëmartesor barazoheshin më fëmijët martesor në trashëgimi, vetëm nëse më parë ishin adoptuar nga trashëgimlënësi. Në rastet kur trashëgimlënësi nuk kishte fëmijë, pasurinë e tij e trashëgonin farefisi, sipas radhës, në vijën e të atit. Kur

[7] Shih H. Ismaili & F.Sejdiu (2000) Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës. Prishtinë. Fq.86.
[8] A.Vajs & L.Kandiq (1984) Historia e Përgjithshme e Shtetit dhe e së Drejtës. Botimi i Tretë. Universiteti i Kosovës në Prishtinë. Fq. 61.

trashëgonin fëmijët e trashëgimlënësit, nuk ishte e nevojshme të zhvillohej procedurë trashëgimore para organit shtetëror për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Ndërsa, në rastin kur trashëgonin farefisi i trashëgimlënësit, zhvillohej procedurë trashëgimore para organit shtetëror e cila inicohej më padi.[9] Përveç,trashëgimisë ligjore pas reformave të Solonit në Athinë, sikurse u theksua edhe më lartë, është njohur edhe trashëgimia testamentare. Testatori ishte i kufizuar në bërjën e dispozitave të testamentit, për faktin se ai nuk mund ti përjashtonte nga trashëgimia tërësisht trashëgimtarët ligjorë, përveç se mund t'iu zvogëlonte pjesën e pasurisë trashëgimore. Femrave nuk u njihej e drejta për të hartuar testament, sepse nuk kishin zotësi për të vepruar.[10] Veç kësaj, femrave nuk u njihej as e drejta për të trashëguar të atin, madje as në rastin kur ato ishin fëmijët e vetëm të tij. Përkatësisht, në rastin kur trashëgimlënësi kishte vetëm vajza, ai më testament çdo qytetari mund t'ia lëntë pasurinë trashëgimore, më kusht që ky të martohej më të bijën e madhe dhe ndaj të tjerave të bëhej kujdestar, t'i martojë ato dhe nga pasuria trashëgimore t'ua ndajë pajën.[11]Në rastin kur trashëgimlënësi i cili kishte vetëm vajza vdiste pa lënë testament, nëse e bija e tij ishte e martuar, trashëgimtarë i pasurisë trashëgimore bëhej djali i saj. Në rastin kur e bija e trashëgimlënësit nuk ishte e martuar, ajo detyrohej të martohej më kushëririn më të afërt të babait të saj më qëllim për të sjellë në jetë një fëmijë të gjinisë mashkull, si pasardhës i cili do ta trashëgonte pasurinë trashëgimore. Prindërit e fëmijës vetëm mbanin në posedim pasurinë trashëgimore, por nuk kishin të drejtë të dispononin më pasurinë, kjo e drejtë i takonte vetëm fëmijës pasi të bëhet i moshës madhore.[12] Ndërsa, në rastet kur e bija e vetme e trashëgimlënësit (epikleros) ishte e martuar por nuk kishte fëmijë nga martesa, atëherë ajo detyrohej të ndahej nga bashkëshorti i saj dhe të martohej më njërin nga meshkujt më të afërt, kushërinj të babait të saj, në mënyrë që ai të merrej më administrimin e pasurisë trashëgimore. Nëse bija nuk sillte në jetë fëmijë mashkull më kushëririn e saj,atëherë duhej të martohej më kushëririn tjetër, e kështu më radhë. E bija e trashëgimlënësit, përkatësisht,burri i saj, pasurinë trashëgimore e mbanin në përdorim, mirëpo nuk mund të dispononin më të, derisa fëmija mashkull i tyre nuk bëhej i moshës madhore.[13]Pra,e bija e trashëgimlënësit ishte e detyruar të vepronte në këtë mënyrë, më qëllim që pasuria trashëgimore të mbetej brenda familjes.

---

[9] H. Ismaili & F. Sejdiu (2000) Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës. Prishtinë. Fq.122.
[10] Po aty. Fq. 122.
[11] Po aty. Fq. 122.
[12] L.Vorpsi (2015) Trashëgimia në të Drejtën Ndërkombëtare Private *(Distertacion për mbrojtjen e gradës shkencore "*Doktor", Universieteti i Tiranës, Depertamenti i të Drejtës Civile) Tiranë. Fq. 29.
[13] Po aty. Fq. 29. (e cila i referohet L. Gernet, Sur l'épiclérat, in Revue des études grecques, XXIV (1921), fq. 337).

1.2. Rregullimi i trashëgimisë në të drejtën romake

E drejta romake, ka luajtur rol të rëndësishëm jo vetëm në periudhën e feudalizmit,por edhe më tej, edhe sot vazhdon të jetë pikë referimi e rëndësishme në sistemet juridike të shumë shteteve,e sidomos shteteve më sistem juridik kontinental të së drejtës. E drejta romake,i ka kushtuar rëndësi të veçantë rregullimit të institutit të trashëgimisë. Shumë nga rregullat e vendosura në të drejtën romake për trashëgiminë, vazhdojn të vlejnë edhe sot në legjislacionet e shteteve bashkëkohore.Rregullat e të drejtës trashëgimore në të drejtën romake, bënin pjesë në mënyrat për fitimin e pronësisë. Ndryshe,nga mënyrat e tjera të fitimit të pronësisë, të cilat vepronin "inter vivos" për së gjalli të subjektëve, mënyrat trashëgimore-juridike të fitimit të pronësisë vepronin mortis causa,pra,vetëm në rast të vdekjes së subjektit.[14]Në të drejtën romake bëhej dallimi në mes të trashëgimit apo suksedimit universal dhe singular. Trashëgimi universal ekzistonte kur pasuria e personit të vdekur"de-cujusit" kalonte në tërësi tek trashëgimtarët (heredes). Në këtë rast, në trashëgimtarin kalonin të gjitha të drejtat dhe detyrimet të cilat i takonin trashëgimlënësit në momentin e vdekjes.[15] Në të drejtën klasike romake aplikohej vetëm trashëgimi në tërësi i një pasurie. Kurse,në të drejtën postklasike është aplikuar edhe trashëgimi në sende të caktuara apo pasuri të veçanta i quajtur trashëgim apo suksedim singular. Mënyra më e rëndësishme e trashëgimit apo suksedimit singular ishte legu.[16] Për rregullimin me sukses të trashëgimit universal apo singular, kërkohej plotësimi i disa kushteve gjegjësisht duhej të konstatohej: a) cilët persona mund të ishin trashëgimlënës, pra kush mund të trashëgohej; b) çfarë mund të përfshihej në masën e trashëgimit të trashëgimlënësit (hereditas); c) cilët persona mund të ishin trashëgimtarë d) në ç'mënyrë janë thirrur trashëgimtarët që të pranojnë masën e trashëgimit të trashëgimlënësit të caktuar,pra cilat kanë qenë mënyrat e thirrjes në trashëgim.[17] Trashëgimlënës (de cujusi) ishte vetëm personi fizik, i cili për së gjalli mund të ishte titullar i të drejtave dhe detyrimeve të trashëgueshme. Personi fizik i cili ishte i aftë për të qenë trashëgimlënës, e fitonte statusin e trashëgimlënësit në momentin e vdekjes.[18]Në lidhje më këtë ekzistonte edhe rregulla "hereditas viventis non datur", që kishte kuptimin që "askush nuk mund të administrojë më cilësinë e trashëgimisë pasurinë e një të gjalli".[19] Masa e trashëgimit përbëhej

[14] I. Puhan (1980) E Drejta Romake, Universiteti i Prishtinës, Botimi i Pestë.Fq.405
[15] Shih C. Anderson (2009) Roman Law, Dundee University Press.Fq.59
[16] I. Puhan (1980).Vepra e njëjtë.Fq.405
[17] Po aty.Fq.405
[18] Po aty.Fq.406
[19] A. Mandro (2006). E Drejta Romake, Tiranë.Fq.417

nga tërësia e të drejtave dhe detyrimeve pasurore të personit të vdekur dhe është quajtur hereditas.[20]Në masën e trashëgimit përfshihej si aktivi ashtu edhe pasivi i pasurisë së trashëgimlënësit. Pra,masa e trashëgimit përbëhej nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet të cilat i përkisnin trashëgimlënësit në momentin e vdekjes,më përjashtim të të drejtave personale të cilat nuk janë konsideruar si të trashëgueshme dhe si të tilla nuk mund të ishin objekt i masës së trashëgimit.[21] Trashëgimtarë (heredes) nën kushte të caktuara mund të ishte çdo person fizik, madje edhe skllevërit. Që të fitonte statusin e trashëgimtarit,duhej që personi fizik në momentin e hapjes së trashëgimit të ishte gjallë. Përjashtim, nga kjo rregull bëhej për fëmijën e lindur, pas vdekjes së të atit apo për pasardhësit e trashëgimlënësit të lindur pas vdekjes së tij.[22] Sipas Ligjit të XII Tabelave, fëmija që lindte 10 muaj pas vdekjes së të atit, konsiderohej i ligjshëm dhe të njëjtit i njihej e drejta për të trashëguar. Edhe nipit të lindur brenda 10 muajve nga vdekja e trashëgimlënësit, gjithashtu i njihej e drejta për të trashëguar në trashëgiminë e gjyshit.[23]Grave në përiudhën e lashtë, u njihej e drejta për të trashëguar si në trashëgiminë ligjore ashtu dhe në trashëgiminë testamentare, mirëpo kjo e drejtë ishte e kufizuar, më qëllim që pasuria të mos mbetej në tërësi në duart e grave. Vlera e pasurisë që i lihej një gruaje me testament, nuk e kalonte asnjëherë gjysmën e trashëgimisë. Ndërsa, në trashëgiminë ligjore, gratë mund të trashëgonin vetëm prej atyre që ishin në lidhje gjaku siç ishin babai, vëllau apo motra.[24] Skllevërit gëzonin të drejtën për të trashëguar, ende më të kufizuar se sa gratë, skllevërve u nihej e drejta për të trashëguar vetëm në trashëgimi testamentare, në trashëgimi ligjore atyre nuk u takonte asnjë e drejtë. Skllleverët janë njohur si trashëgimtarë (necessarii heredes*)* vetëm në rastet kur janë caktuar më vullnet në testament nga ana e trashëgimlënësit, më ç'rast edhe janë liruar nga skallvëria.Në rastet kur trashëgimlënësi kishte dy ose më tepër skllevër, vetëm njëri prej tyre mund të caktohej si trashëgimtarë, po që se emëroheshin më shumë se një, vetëm ai që emërohej i pari merrej si trashëgimtarë.Skllevëri ishte i detyruar të pranonte trashëgiminë gjegjësisht legatin që i lihej më testament.[25] Personat e thirrur si trashëgimtarë, qoftë në trashëgimi ligjore apo testamentare, krahas zotësisë për të qenë trashëgimtarë që të mund të fitonin trashëgiminë kërkohej të kishin edhe zotësinë për të marrë trashëgiminë.[26] Si persona të cilët kishin zotësinë

[20] A.Billali & B.Bahtiri (2015) E Drejta Romake.Prishtinë Fq.538
[21] Shih George A. Pelletier Jr. & Michael Roy Sonnenreich,A Comparative Analysis of Civil Law Succession, 11 Vill. L. Rev. 323 (1966). Fq.3.Punimi gjendet në linkun më poshtë: http://digitalcommons.laë.villanova.edu/vlr/vol11/iss2/3
[22] I. Puhan (1980) Vepra e njëjtë. Fq.407
[23] E. Olldashi (2015).E Drejta Romake.Botimi i Dytë. Tiranë.Fq.276
[24] Po aty.Fq.275
[25] A. Borkowski & P.D Plessis (2014) E Drejta Romake. Tiranë.Fq.306
[26] E. Olldashi (2015).Vepra e njëjtë.Fq.277

trashëgimore, por jo edhe zotësinë për të marrë trashëgiminë nën disa kushte të caktuara konsideroheshin: a) burrat nga 25 deri 60 vjeç si dhe gratë nga 20 deri në 50 vjeç, të cilëve u dorëzohej trashëgimia vetëm në rast se martoheshin brenda 100 ditëve nga thirrja në trashëgimi; b) latinët, të cilëve u ndahej trashëgimia vetëm nëse brenda 100 ditëve nga thirrja në trashëgimi bëheshin qytetare romakë; c) burrat që nuk kishin fëmijë (orbi) apo burrat që kishin fëmijë (pater solitarius), por nuk kishin gra nuk mund të merrnin më tepër së gjysmën e trashëgimisë.[27] Ndërsa, personat të cilët përjashtoheshin në tërësi nga trashëgimia, qoftë testamentare apo ligjore ishin: a) heretikët; b) personat të cilët kryenin tradhti ndaj shtetit-perandorisë; si dhe c) gratë e veja që ishin martuar pa kaluar një vit nga vdekja e bashkëshortit.[28]

1.2.1. Mënyra e thirrjes se trashëgimtarëve në trashëgimi sipas të drejtës romake

Në Romë ekzistonin dy mënyra në bazë të të cilave trashëgimtarët mund të thirreshin në trashëgim: a) më testament dhe b) në bazë të ligjit (ab intestato). Thirrja më testament në trashëgimi ishte kur trashëgimlënësi më vullnetin e vetë përcaktonte personat, të cilët pas vdekjes së tij do ta trashëgonin pasurinë e tij. Kurse,në rastin kur trashëgimlënësi nuk linte testament ose kur testamenti shpallej i pavlefshëm për ndonjë nga shkaqet e parapara më ligj, trashëgimtarët thirreshin në trashëgimi në bazë të rendit të caktuar më ligj.[29] Në kohën kur forma dominuese e familjes ka qenë consortium, Ligji i XII Tabelave, për rastet kur trashëgimlënësi vdiste pa lënë testament, ka paraparë dy rende ligjorë të trashëgimisë: së pari në trashëgimi është thirrur agnati më i afërt (agnatus proximus) dhe në mungesë të agnatit më të afërt, në trashëgimi janë thirrur gentilët (anëtarët e gjensit të tij). Sipas Ligjit të XII Tabelave,agnatus proximus janë konsideruar personat e gjeneratës së njëjtë (vëllezërit) me të cilën trashëgimlënësi ka jetuar deri në vdekje. Sipas Ligjit të XII Tabelave, kur trashëgimlënësi ka jetuar në konsorcium, agnatus proximus janë konsideruar gjithashtu edhe personat më të cilët ai dikur ka jetuar në konsorcium.[30] Ligji i XII Tabelave, në mesin e trashëgimtarëve ligjorë (intestator) nuk i ka përmendur fëmijët e trashëgimlënësit, ngase për ta ka paraparë testamentin.[31] Në lidhje më këtë në Ligjin e XII Tabelave, përcaktohej rregulla: "uti legassit suae rei ita ius esto", që kishte kuptimin "i ftuari i parë si trashëgimtarë intestator është vëllau (adgnatus proximus), por nëse pater familiasi me

[27] Shih J. Gardner (1991) Women in Roman Law & Society,Indiana University Press.Fq.163 dhe 200
[28] E. Olldashi (2015) vepra e njëjtë.Fq. 277
[29] I.Puhan (1980) vepra e njëjtë.Fq.408
[30] A.Billali & B.Bahtiri (2015) vepra e njëjtë.Fq.541
[31] Po aty, Fq.541

testament dëshiron që fëmijët t'i caktojë për trashëgimtarë, ashtu le të bëhet".[32] Për këtë arsye, edhe është konsideruar fatkeqësi e madhe vdekja pa lënë testament.[33]

Gjatë gjysmës së parë të republikës më humbjen e gjurmëve të konsorciumit, forma dominuese apo e vetme e familjes ishte familja e përbërë nga partnerët martesor dhe pasardhësitë e tyre. Dhe tani më nuk konsiderohej vëllau si më i afërm i trashëgimlënësit, si më i afërm i trashëgimlënësit konsiderohej pasardhësi (fëmija) i cili jetonte më të.[34] Tani në rastet kur trashëgimlënësi nuk linte testament të drejtë në trashëgimi kishin këta persona: sui heredes; agnatët dhe xhentilët, këta trashëgimtarë renditeshin në tre rende.[35] Në rendin e parë, trashëgonin "sui heredes" të cilët ishin personat të cilët jetonin në bashkësi dhe që në momentin e vdekjes së pater familasit bëheshin siu iuris. Këta, ishin personat e shkallës më të afërt të gjinisë agnate, fëmijët e pater familasit si dhe personat e adroguar dhe ata të adoptuar, të cilët ndanin trashëgiminë në mënyrë të barabartë. Në rendin e dytë të trashëgimit, hynin agnatët në kuptim të gjerë, që mund të vërtetoheshin se dikur kishin jetuar nën patria potestas të njëjtë, ku kishte jetuar edhe trashëgimlënësi, apo që rridhnin së bashku më trashëgimlënësin nga i njëjti paraardhës. Kurse, në rastin kur nuk ekzistonin sui heres e as agnatët, trashëgonin xhentilët (gens[36]) të cilët përbënin rendin e tretë të trashëgimit.[37]

Në të drejtën klasike, pretorët e ndryshuan rendin ligjor të trashëgimit, i cili ndryshe është quajtur edhe rendi i trashëgimit të pretorëve.Rendin ligjor praetorian e përbënin katër grupe të trashëgimtarëve: në rendin e parë trashëgonin të gjithë pasardhësit e trashëgimlënësit (fëmijët meshkuj dhe femra), personat e adoptuar,të adroguar si dhe fëmijët e emancipuar më parë; në rendin e dytë trashëgonin të afërmit agnate (vëllezërit dhe motrat), të cilëve kjo e drejtë iu takonte në bazë të Ligjit të XII Tabelave; në rendin e tretë trashëgonin të afërmit cognati deri në shkallë të gjashtë dhe në raste të rralla deri në shkallë të shtatë; si dhe në rendin e katërt trashëgonin bashkëshortët të cilët deri në vdekje kishin jetuar në martesë të rregullt pa manus.[38]

Në të drejtën postklasike, u përmirësua rendi ligjor i trashëgimit në favor të të afërmve agnatë. Justiniani në novelën 118 dhe 127 përcaktoi qartë rendin ligjor të trashëgimit, i cili ishte i përbërë prej pesë grupeve të trashëgimtarëve ligjorë. Në rendin e parë,trashëgonin të gjithë

[32] A.Billali & B.Bahtiri (2015) vepra e njëjtë.Fq.549
[33] Po aty.Fq.542
[34] Po aty, Fq.543
[35] Shih Rudolf Sohm (1892) The Institutes of Roman law.Oxford.Fq.437 (https://books.google.com/books?id=S3sNAwAAQBAJ&printsec=frontcover#v=onepage&q&f=false)
[36] Gens ishin një grup familjesh që rridhnin nga i njëjti pasadhës i përbashkët dhe që ndanin të njëjtin emër.
[37] I. Puhan (1980) vepra e njëjtë. Fq.411
[38] A. Mandro (2006).E Drejta Romake.Tiranë.Fq.433

pasardhësit e trashëgimlënësit, trashëgimia pasardhësve të shkallës më të afërtë u ndahej në pjesë të barabarta, kurse pasardhësve të shkallëve më të largët u ndahej pjesa që u takonte në bazë të së drejtës së përfaqësimit.[39]Në rendin e dytë, trashëgonin paraardhësitë (prindërit) e trashëgimlënësit dhe vëllezërit e motrat e tij, prej nënë dhe prej të atit, paraardhësit më të afërt i përjashtonin nga trashëgimia paraardhësit më të largët, ndërsa kur ishin në konkurrencë motrat dhe vëllezërit, e ndanin masën e trashëgimit në pjesë të barabarta. Në rendin e tretë, trashëgonin vëllezërit dhe motrat që ishin ose prej një nënë ose prej një babe, edhe trashëgimtarëve të këtij rendi, trashëgimia u ndahej në pjesë të barabarta sipas parimit të përfaqësimit. Në rendin e katërt, trashëgonin të gjithë të afërmit anësore të gjakut (kushërinjtë), kushërinjtë më të afërt anësor i përjashtonin kushërinjtë më të largët,kurse midis të afërmëve të shkallës së njëjtë trashëgimia ndahej në pjesë të barabarta sipas rregullave të së drejtës së përfaqësimit.[40] Në rendin e pestë, trashëgonin bashkëshortët. Në të drejtën posklasike, u përmirësua pozita juridike e gruas në trashëgimi. Sipas Justinianit gruaja e ve,pa pajë kishte të drejtë të kërkonte ¼ e masës së trashëgimit të burrit, në konkurrencë më të gjithë të afërmit. Kur gruaja, konkurronte me më shumë së tri fëmijë të trashëgimlënësit, ajo kishte të drejtë të merrte pjesë sa secili prej tyre, ndërsa kur konkurronte më fëmijët e vet, pjesën që i takonte e merrte në uzufrukt.[41]

1.2.2. Rregullimi i trashëgimisë testamentare në të drejtën romake

E drejta romake i ka kushtuar rëndësi të veçantë rregullimit të trashëgimisë testamentare. Në Romë instituti i testamentit njihej prej kohërave më të lashta. Sipas ligjit të XII Tabelave, trashëgimia testamentare gëzonte prioritet ndaj trashëgimisë ligjore. Edhe sipas rregullave religjioze dhe morale ka qenë e detyrueshme praktika, që trashëgimlënësi të hartojë testament.[42] Arsyeja pse testamenti në Romë ka gëzuar prioritet në raport më ligjin, është për shkak se fëmijët e trashëgimlënësit kanë pasur mundësi të trashëgojnë vetëm në bazë të testamentit.Qëllimi i krijimit të testamentit ishte përfshirja e fëmijëve të trashëgimlënësit në trashëgimi.[43]Në të drejtën romake për vlefshmërinë e testamentit kërkohej të plotësoheshin këto kushte: a) testatori duhej të kishte aftësi për të bërë testament (*testamenti factio activa*); b) dëshimtari testamentar duhej të kishte aftësi për të përmbushur detyrën e tij; si dhe c) trashëgimtari apo legatari nevojitej të

[39] I.Puhan (1980) vepra e njëjtë.Fq 414
[40] Po aty.Fq.414
[41] Po aty.Fq.415
[42] A.Billali & B.Bahtiri (2015) vepra e njëjtë.Fq.548
[43] Po aty.Fq.550

kishte aftësinë për të administruar më pasurinë e përfshirë në testament. (*testamenti factio passiva*).Aftësia për të bërë testament, u njihej të gjithë personave madhore të cilet kishin zotësinë e plotë juridike dhe të veprimit. Personat më sëmundje mendore apo personat të cilëve u ishte hequr zotësia për të vepruar nuk mund të bënin testament, e njëjta gjë vlente edhe për personat të cilëve u ishte hequr më ligj e drejta për të administruar pasurinë e tyre.[44] Në fillim femrat nuk kishin të drejtë të bënin testament, më vonë kur testamenti mancipator u bë i zakonshëm, femrave që kishin lindur të lira filloj tu njihej e drejta për të bërë testament, por më kusht që kujdestari i tyre ta miratonte testamentin. Kurse, femrave të çliruara sipas rregullit të përgjithshëm u njihej e drejta për të bërë testament, vetëm më miratimin e mbështetësit të tyre. Aftësia për të dëshmuar në testament, i njihej çdo qytetari mashkull, i cili ishte i aftë për të vepruar.[45] Femrave nuk i njihej e drejta për të dëshmuar në testament. Përveç femrave, nga cilësia e të qenit dëshmitar përjashtoheshin edhe personat të cilët i përkisnin familjes se testatorit. Kurse, personat të cilët nuk i përkisnin familjes se testatorit mund të dëshmonin në testament edhe kur përfitonin nga testamenti, pra i njëjti person ka mundur të jetë edhe trashëgimtarë edhe dëshmitar. Kurse, si të aftë për të administruar një testament konsideroheshin të gjithe personat të cilet kishin zotësinë trashëgimore *(testament factio)* si dhe zotësinë për të marre marrë trashëgiminë *(ius capiendi).*[46]Trashëgimlënësi nuk ishte tërësisht i lirë që të dispononte më testament. Ekzistonin një grup i trashëgimtarëve ligjorë, të cilët trashëgimlënësi nuk mund ti përjashtonte nga masa e trashëgimit të lënë më testament. Kur ekzistonin trashëgimtarët e tillë ligjorë, trashëgimlënësi domosdo duhej ti përfshinte në testament.Mirëpo,për shkaqet e parapara më ligj, trashëgimlënësi mund ti përjashtonte nga trashëgimia edhe trashëgimtarët e domosdoshëm.[47]Në novelën e 115 të Justinianit, si shkaqe për të cilat trashëgimlënësi mund ti përjashtoj nga trashëgimia trashëgimtarët e domosdoshëm përmenden: të rezikuarit e jetës, braktisja gjatë kohës së sëmundjes shpirtërore, ofendimi i rëndë, plagosja trupore, pengimi kur bëhej testamenti etj.Nëse trashëgimlënësi i përjashtonte trashëgimtarët e domosdoshëm pa ekzistuar shkaqet e përmendura më sipër, trashëgimtarët kishin të drejtë të kërkonin pjesën e domosdoshme me padi të quajtur "querela inofficiosi testamenti".[48] E drejta e ngritjes së kësaj

[44] A. Borkowski & P.D Plessis (2014) E Drejta Romake. Tirane. Fq.292
[45] Po aty.Fq.293
[46] Shih A.Borkowski's & P.D Plessis (2015) Roman Law.Fifth Edition, Oxford University Press.Fq 220-221
[47] I.Puhan (1980) vepra e njëjtë Fq.425
[48] Po aty.Fq.425.*Querela inofficiosi testamenti*- Ishte ankesa apo padia e cila ushtrohej ne rastet kur trashegimtaret pretendonin se testatori nuk e kishte përmbushur detyrën morale

padie nuk mund tu kalonte trashëgimtarëve dhe shuhej për shkak të mos përdorimit brenda 2 viteve nga vdekja e trashëgimlënësit.[49]

Format e testamentit-Në të drejtën e lashtë romake njiheshin dy lloje të testamentit a) testamenti comital *(testamentum calatis comitis)* dhe b) Testamenti in procintu *(testamentum in procinctu).*[50] Testamenti comital bëhej në formë të deklaratës publike, para asamblesë gjëgjësisht në mbledhjet e asmablesë të cilat mbaheshin dy herë në vit.[51] Ndërsa, testamenti in procintu bëhej nga ushtarët gjate kohës se luftës. Një formë tjetër e testamentit, e cila është aplikuar në të drejtën e lashtë ishte la mancipatio familaie. Ky lloj testamenti hartohej në praninë e pesë dëshmitarëve, trashëgimlënësit dhe një personi të tretë (familae emptorom). Në fillim kur u aplikua ky lloj testamenti, personi i tretë (familae emptorom) e merrte tërë pasurinë e trashëgimlënësit dhe pas vdekjes së trashëgimlënësit detyrohej që pasurinë e trashëguar, t'ua bartë personave të cilët trashëgimlënësi, i kishte përcaktuar si trashëgimtarë të tij. Më vonë, pozita e familae emptorom ndryshoi plotësisht. Familae emptorom nuk e kishte më pozitën e trashëgimtarit, por fitoi pozitën e ekzekutuesit të testamentit apo administruesit të pasurisë.[52] Në këtë fazë,ky lloj testamenti u bë i fshehtë, trashëgimlënësi në dokumentin që ja dorëzonte familae emporit, i shënonte emrat e trashëgimtarëve të cilët do ta trashëgonin pasurinë e tij. Familae emporit kujdesej që personave të caktuar si trashëgimtarë në testament, tu bartet trashëgimia në mënyrë të rregulltë. Testamenti manicpatio familae vazhdoi të aplikohet edhe në të drejtën klasike, por formalitetet për bërjën e tij u ndryshuan. Tani testamenti manicpatio familae bëhej në praninë e shtatë dëshmitarëve, të cilët kërkohej edhe të nënshkruheshin në testament, ky lloj i testamentit u emërtua testamenti pretorian.[53] Pra,në të drejtën klasike forma e testamentit manicipatio familae u zëvendësua më formën e testamentit pretorian.

Në të drejtën postklasike, bëhej dallimi midis dy llojeve të testamenteve: a) private dhe b) publike. Testamente publike ishin testamentet të cilat hartoheshin më pjesëmarrjen e organit shtetëror, kurse në hartimin e testamenteve private nuk merrte pjesë organi shtetëror. Si lloje të testamenteve private të rregullta janë njohur: testamenti verbal dhe testamenti i shkruar. Testamenti verbal, ishte lloj i testamentit i cili deklarohej gojarisht nga trashëgimlënësi para

[49] A.Billali & B.Bahtiri (2015) vepra e njëjtë.Fq.559
[50] William L. Burdick (2004). The Principles of Roman Law and Their relation to Modern Law.The law book exchange, LTD. Clark New Jersey.Fq.582
[51] Shih G. Mousourakis (2015). Roman Law and the Origins of the Civil Law Tradition. Springer International Publishing Switzerland.Fq.151
[52] I.Puhan (1980) vepra e njëjtë.Fq.417
[53] Po aty.Fq.417

shtatë dëshmitarëve.[54]Kurse, testamenti i shkruar mund të ishte i dy lloje: ollograf ose alograf. Testamenti ollograf ishte lloj i testamentit i cili shkruhej në tërësi nga vetë trashëgimlënësi, kurse testamenti alografik ishte lloj i testamentit të cilin sipas tregimit të trashëgimlënësit e shkruante një person i tretë.[55]

Përveç trashëgimit universal, sikurse u përmend më lartë, në të drejtën klasike romake është aplikuar edhe trashëgimi singular. Mënyra më e rendësishme e trashëgimit singular ishte legu. Legu ishte dhuratë të cilën nga trashëgimia e lënë me testament trashëgimtarët në bazë të urdhërit të trashëgimlënësit, ishin të obliguar ta ndanin për një person të tretë që quhej legatar. Legatari fitonte të drejtë vetëm në pjesë apo sende të caktuara të masës së trashëgimit.[56]Një institucion tjetër më rëndësi në të drejtën romake ishte edhe institucioni i fideikomisit. Fideikomisi ishte një kërkesë që trashëgimlënësi ua drejtonte trashëgimtarëve apo legatarëve, që pas marrjes se trashëgimisë apo legut të kryenin pagesën e një shumë të hollash,apo tu dorëzonin sendin e caktuar ndonjë personi të tretë (fidekomisionari).Qëllimi i institucionit të fideikomisit ishte favorizimi i personave të cilët nuk mund të ishin trashëgimtarë apo legatarë për shkak se nuk kishin të drejtën për të marrë pasuri nga testamenti.[57] Veç kësaj,ky institucion përdorej edhe për qëllime tjera si p.sh, për lirimin e skllavit, bërjën e marrëveshjeve familjare etj.[58]

1.3. Rregullimi i trashëgimisë në të drejtën osmane (sheriatit)

Sipas teorisë juridike në të drejtën osmane, marrëdhëniet e trashëgimisë nuk janë rregulluar nga Kodi Civil, por sipas rregullave të së drejtës se shenjtë myslimane të quajtur sheriat.[59] Burimet kryesore në të cilat mbështetej e drejta e sheriatit ishin: a) Kurani, b) Tradita *(Hadithi-sunneti)*, c) Gjykimet dhe vendimet e katër imaneve të pare (*Ixhma)* si dhe d) Analogjia *(Kijasi).[60]*E drejta e sheriatit ka luajtur rol të rëndësishëm gjate tërë sundimit osman.Ajo ka qenë baza e rregullimit të rendit shoqëror të gjithmbarshëm në tërë perandorinë osmane. Përkitazi më zbatimin e së drejtës së sheriatit në kohën e përandorisë osmane shkruhet *"e drejta e sheriatit është zbatuar ndër të gjithë myslimanët pa dallim shtetësie, kurse më sa kufizime edhe ndër*

[54] I.Puhan (1980) vepra e njëjtë.Fq.418
[55] Po aty.Fq.418
[56] Po aty.Fq.434
[57] E. Olldashi (2015).E Drejta Romake. Botimi i Dytë.Fq 298
[58] Shih A.Borkowski & P.D Plessis (2014) E Drejta Romake.Tiranë.Fq.329
[59] Shih N. Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë. Fq.10.
[60] Grup autorësh (2001) Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Luarasi". Tiranë. Fq. 199.

myslimanë".[61] E drejta e sheriatit ka njohur dhe rregulluar dy forma të trashëgimisë: a) trashëgiminë ligjore dhe b) trashëgiminë testamentare. Për dallim nga e drejta romake, e drejta e sheriatit prioritet i jepte trashëgimisë ligjore, në raport më trashëgiminë testamentare. Trashëgimtarët ligjorë sipas sheriatit ndaheshin në tri grupe: a) trashëgimtarë me pjesë të caktuar *(as-habi feriaz);* b) trashëgimtarë pa pjesë të caktuar *(asaba);* dhe c) trashëgimtarë të tjerë *(zeviul erhan).*[62]

Tabela 2: Ndarja e trashëgimtarëve ligjorë sipas të drejtës së sheriatit [63]

Trashëgimtarët as-habi feriaz ishin:	**Trashëgimtarët asaba ishin**:	**Trashëgimtarëtzeviul erhan ishin:**
1. Babai; 2. Gjyshi prej babait; 3. Vëllezërit dhe motrat prej një nënë; 4. Bashkëshortët; 5. Vajza, vajza e djalit; 6. Motrat gjermene; (quheshin ato që kishin të përbashkët nënën dhe babain). 7. Motrat prej babait; **8.** Nëna dhe gjyshja prej babait dhe prej nënë.	1. Djemtë dhe djemtë e djemve më rradhë; 2. Babai dhe në mungesë të tij gjyshi ose stërgjyshi (këta ishin trashëgimtarë asaba kur mungonin djemtë e djemve); 3. Vëllai gjermen, vëllai prej babe dhe djemtë e tyre; 4. Ungji gjermen, ungji prej babe, djali i ungjit gjermen, djali i ungjit prej babait, djali i ungjit gjermen të gjyshit, djali i ungjit prej babait të gjyshit.	1. Fëmijët meshkuj dhe femra të vajzave; 2. Gjyshja dhe gjyshi nga ana e nënës; 3. Fëmijët femra dhe meshkuj të motrave gjermene; 4. Fëmijët meshkuj dhe femra të motrave prej babait; 5. Fëmijët meshkuj dhe femra të motrave prej një nënë; 6. Hallat gjermene, hallat prej babait, tezet gjermene, motrat e nënës prej babait dhe prej nënë.

Sipas rregullave të sheriatit, kur hapej trashëgimia thirreshin në trashëgimi si trashëgimtarët më pjesë të caktuar ashtu dhe trashëgimtarët pa pjesë të caktuar,e kur këta mungonin atëherë në trashëgimi thirreshin trashëgimtarët e tjerë (zeviul erhan).[64,65]Sipas sheriatit për bartjen e pronësisë më anë të trashëgimit, kërkohej të plotësoheshin këto kushte: a) të konstatohet vdekja e trashëgimlënësit; b) ekzistimi i trashëgimtarëve; c) mosekzistimi i pengesave për të cilat trashëgimtarët mund të shpallen të padenjë për të trashëguar. Sipas sheriatit, trashëgimtari në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit duhet të ishte i gjallë. Përjashtimisht, e drejta për të trashëguar sipas sheriatit i njihej edhe fëmijës, i cili ndodhej në embrion në momentin e vdekjes se trashëgimlënësit nëse lindte i gjallë. Të padenjë për të

[61] E. Statovci (2009) Marrëdhëniet pronësore juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës. Prishtinë. Fq.111.
[62] N. Biçoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tirane. Fq.13.
[63] N. Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë. Fq.11.
[64] Po aty.Fq.11.
[65] Përkitazi mbi ndarjen e trashëgimtarëve ligjore dhe mbi rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë në përgjithësi sipas sheriatit shih Jamal J. Nasir (1990) "The Islamic Law of Personal Status" Second Edition Graham Trotman. London/Dordrecht/Boston Fq 234-245.

trashëguar sipas sheriatit konsideroheshin: a) personat më besim fetar dhe nacionalitet tjetër nga ajo e trashëgimlënësit, b) skllevërit si dhe c) Personi i cili kishte vrarë trashëgimlënësin më ose pa qëllim. Sipas sheriatit,e drejta në trashëgimi i njihej edhe fëmijëve jashtemartesor, por kjo e drejtë ishte e kufizuar. Duhet theksuar se fëmijë jashtëmartesor sipas rregullave të së drejtës te sheriatit konsideroheshin fëmijët e lindur nga prostitucioni përkatësisht fëmijët e lindur si pasojë e amoralitet të cilitdo mashkull më një grua të lirë apo më ndonjë robëreshë.[66]Fëmijë jashtëmartesor llogariteshin gjithashtu edhe fëmijët e lindur pas ndarjes se bashkëshortëve, në rastet kur ndarja bëhej për shkak të dyshimit të burrit se gruaja ka kryer prostitucion. Fëmijët jashtëmartesor mund të trashëgonin vetëm në trashëgiminë e nënës dhe afërmve të saj nga gjinia e gjakut, por jo edhe në trashëgiminë e babait. Pra, krahasuar më të drejtën romake pozita e fëmijëve jashtëmartesor, sipas të drejtës së sheriatit ishte më e favorshme. Ndërsa,fëmija i braktisur sipas sheriatit mund të trashëgonte ose të trashëgohej nga të tjerët vetëm nëse pasi të rritej krijonte pasuri dhe martohej. Kur fëmija i braktisur (trashëgimlënësi) ishte i martuar atë e trashëgonin bashkëshortja dhe fëmijët, gjithashtu edhe ky mund ti trashëgonte ata. Ndërsa,në rast se fëmija i braktisur nuk ishte i martuar, ateherë pasuria e tij i mbetej shtetit.[67]Të drejtë të kufizuar për të trashëguar sipas të drejtës se sheriatit,gëzonin edhe femrat. Sipas sheriatit, femrave u njihej e drejta si në trashëgimi ligjore ashtu edhe në trashëgimi testamentare, por jo në mënyrë të barabartë më trashëgimtarët meshkuj. Sipas rregullave të sheriatit, trashëgimtarit mashkull i ndahej pjesa e trashëgimisë sa për dy trashëgimtarë femra.[68]P.sh.,në rast se trashëgimlënësi linte si trashëgimtarë dy fëmije prej tyre një vajzë dhe një djalë, trashëgimia u ndahej 2/3 djalit dhe 1/3 vajzës.[69]Sipas sheriatit bashkëshortet e trashëgonin reciprokisht njërin-tjetrin.Secila prej grave të trashëgimlënësit trashëgonte "pjesën e gruas", kurse burri trashëgonte "pjesën e burrit" dhe atë nga secila grua që vdiste para tij.[70] Për dallim nga e drejta romake dhe të drejtat e tjera, sipas sheriatit e drejta e përfaqësimit në trashëgimi nuk njihej. Përveç trashëgimisë ligjore, siç u përmend edhe më lartë, e drejta e sheriatit ka njohur edhe trashëgiminë testamentare.Trashëgimlënësi (testatori) sipas sheriatit, nuk ishte i lirë të dispononte në tërësi më

[66] Shih M. Vërbani (2013) E Drejta Trashëgimore në Islam.Kaçanik.Fq 55

[67] Po aty.Fq.57

[68] Kjo rezulton nga En-Nisa ajeti 11 i Kuranit ku thuhet: "Allahu ju urdhëron për trashëgiminë tuaj: mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave; nëse trashëgimtarë janë dy e më tepër femra, atyre u takojnë dy të tretat nga trashëgimia; nëse është një femër – i takon gjysma e pasurisë; e për çdonjërin prind të të vdekurit – u përket një e gjashta nga pasuria e trashëguar, nëse i vdekuri ka lënë fëmijë; e nëse nuk ka fëmijë, e trashëgojnë prindërit dhe nënës i bie një e treta; nëse i vdekuri ka vëllezër, nënës së tij i bie një e gjashta, pas kryerjes së testamentit të lënë dhe larjes së borxhit. Ju nuk e dini se cili është më i afërt për ju nga dobia: prindërit tuaj apo fëmijët tuaj. Ky caktim është nga ana e Allahut. Pa dyshim Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë".

[69] Për më shumë lidhur më të drejtën e femrës në trashëgimi sipas sheriatit shih John L. Esposito & Natana J. DeLong-Bas (2001) "Women in Muslim Family Law" Syracuse University Press, Fq 37-45

[70] Mashkullit sipas të drejtës sheriatit i lejohej lidhja e martesës deri në katër gra në të njëjtën kohë, pra sipas sheriatit lejohet poligamia.

pasurinë e tij më testament kur kishte trashëgimtarë ligjorë përkatësisht në këtë rast personave të tjerëve më testament ai mund ti linte vetëm 1/3 e pasurisë. Ndërsa, kur nuk kishte trashëgimtarë ligjorë trashëgimlënësi më testament mund të dispononte tërë pasurinë. Është interesante të përmendet se më testament burri sipas sheriatit, kishte të drejtë një pjesë të pasurisë të ja linte edhe gruas jomyslimane si dhe personave të tjerë më shtetësi dhe fe tjetër. Për vlefshmërinë e testamentit sipas sheriatit, kërkohej që trashëgimlënësi (testatori) të ishte i moshës madhore (15 vjet), të ishte psiqikisht i shëndoshë, të shprehnte lirisht vullnetin; si dhe trashëgimtarët testamentalë kërkohej të ishin të denjë për të trashëguar.[71] Është më rëndësi të theksohet se trashëgimia mbi tokën në të drejtën osmane rregullohej më ligj të veçantë të quajtur "Ligji mbi tokën" apo *"Erazi Kanuni"* i cili ishte miratuar në v.1274 hixhri (viti 1858 e.r.) dhe ndryshuar në v.1868.[72] Më dispozitat e këtij ligj, bëhej dallimi midis dy llojeve të tokave: a) tokave në pronësi të plotë; dhe b) tokave publike.Tokat në pronësi të plotë mund të tjetërsoheshin dhe të trashëgoheshin, sepse mbi to titullari kishte pronësinë e plotë. Në këtë kategori të tokave hynin: trojet në qytet dhe në fshat; oborri dhe kopshti i shtëpisë si dhe një dynym tokë. Ndërsa, mbi tokat publike do të thotë mbi tokat të cilat ishin në pronësi të shtetit, subjektët e së drejtës kishin vetëm të drejtën e përdorimit, por jo edhe të drejtën e disponimit më to. Të drejtën e përdorimit titullari mund ta barte vetëm me lejen e veçantë të organit shtetëror.Më vonë më ndryshimet e bëra në ligjin mbi tokat, u lejua trashëgimi edhe i tokave publike.[73]

[71] Shih H. Ismaili & F. Sejdiu (2000) Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës. Prishtinë. Fq 285.
[72] N. Biçoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë. Fq. 23.
[73] Po aty.Fq.24.

1.4. Rregullimi i trashëgimisë në të drejtën zakonore shqiptare

Në literaturen juridike-shqiptare, e drejta zakonore përkufizohet si "një e drejtë popullore e pashkruar, e cila është bartur brez pas brezi nga tradita gojore, dhe që ka shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme shoqërore për shekuj më radhë" në Shqipëri dhe në trojet e tjera jashtë territorit të Shqipërisë të banuara më shqiptare.[74] Në pjesët ku vepronin rregullat e së drejtës zakonore thuhet se celulen bazë të shoqërisë,e përbëntë familja patriarkale. Sipas teorisë historike-juridike, familja patriarkale ka dominuar në Shqipëri deri në Luftën e Dytë Botërore. Kurse, në Kosovë dhe trojet të tjera jashtë territorit të Shqipërisë (të banuara më shqiptare) familja patriarkale thuhet së ka vazhduar të dominojë për dekada të tëra edhe pas L.D.B.[75] Burimi i parë dhe kryesor i të drejtës zakonore shqiptare konsiderohet Kanuni i Lekë Dukagjinit. Krahas Kanunit të Lekë Dukagjinit, në të drejtën zakonore shqiptare janë zbatuar edhe kanune të tjerë, si Kanuni i Skendërbeut, Kanuni i Labërisë, Kanuni i Lumës, Kanuni i Dibrës, Kanuni i Malësisë së Gjakovës etj. Këto kanune përbëjnë të drejtën e përgjithshme zakonore shqiptare (apo kanunin popullor mbarëshqiptar), e cila është zbatuar në të gjitha trojet ku kanë banuar e jetuar shqiptarë përkatësisht në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi e Maqedoni.[76] Përkitazi më zbatimin e kanuneve të ndryshme në të drejtën zakonore shqiptare, shkruhet se "midis kanuneve të ndryshme të popullit shqiptar ekzistojnë pika të shumta përkuese, çka dëshmon për një bazë të njëjtë e të përbashkët juridike, kurse dukuria e ekzistimit të emërtimeve të ndryshme të kanuneve, në realitet përfaqëson vetëm variante të kanunit i cili do të mund të emërtohej me një emër të përbashkët e drejtë zakonore shqiptare (kanunore) e popullit shqiptar".[77] Në lidhje më këtë, profesor Statovci shkruan se për dallim prej të drejtës zakonore të popujve të tjerë "e cila kryesisht është shprehje e marrëdhënieve lokale provinciale shoqërore, e drejta zakonore shqiptare e shikuar në thelbin e saj dhe duke u nisur prej parimeve të njëjta kryesore përfaqëson një lloje uniformiteti". Më tej, profesor Statovci shkruan "më siguri në asnjë shtet nuk mund të gjendet një kodeks i këtillë i tërësishëm i së drejtës zakonore, sikundër është e drejta zakonore e shqiptarëve e cila përfaqëson më të vërtetë një "corpus iuris" më të cilin rregullohej jeta e gjithmbarshme shoqërore-ekonomike"[78]. Ndërsa, në lidhje më lashtësinë e së

[74] Grup autorësh (2001) Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Luarasi". Tiranë.Fq.229.
[75] Po aty. Fq 239-240.
[76] Shih Kanuni i Laberisë/kodifikuar e përgatitur për botim nga prof.dr. Ismet Elezi, Tiranë 2006 Fq 21
[77] Zojzi R. Aspekte të Kanunit të Skenderbeut studime historike Nr.4 Tiranë.1967. Fq. 174. (cituar nga E. Statovci. Marrëdhëniet pronësore juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës. Prishtinë. 2009. Fq. 120).
[78] E. Statovci (2009) Marrëdhëniet pronësore juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës. Prishtinë. Fq 120.

drejtës zakonore shqiptare shkruhet se "Asnjë komb i Evropës nuk ka zakone më të vjetra" apo "Ligjet e pashkruara të Maleve janë trashëguar që nga kohët më të lashta dhe janë përmbledhje më e vjetër e ligjeve në Evropë".[79] Përkitazi më këtë profesor Elezi shkruan: "origjina e normave të së drejtës zakonore mbarëshqiptare, përfshirë atë të Labërisë, i përkët lashtësisë, para pushtimit romak, që nga ilirët (shek. IV-I p.e.r)".[80] Në përgjithësi në teorinë juridike vendase dhe atë krahasimore është i pakontestushëm origjinaliteti dhe lashtësia e të drejtës zakonore shqiptare, e cila për shekuj më radhë u zbatua për rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme shoqërore, e në veçanti për marrëdhëniet familjare-trashëgimore. Në këtë punim për arsye të rëndësisë dhe zbatimit më të gjerë si dhe të dhënave më të plota që disponohen do të trajtohet instituti i trashëgimisë sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe Kanunit të Labërisë.

1.4.1. Rregullimi i trashëgimisë në Kanunin e Lekë Dukagjnit

Kanuni i Lekë Dukagjinit (Kanuni i Maleve) mbledhur nga Shtjefën Konstadin Gjeçovi, fillimisht u botua pjesë-pjesë në revistën "Ylli i Dritës" gjate viteve 1913-1929, kurse në vitin 1933 u kodifikua dhe u botua në tërësi nga kleriku franceskanë në Shkodër.[81]Në përgjithësi Kanuni i Lekë Dukagjinit, thuhet se është ruajtur nga ndikimet e të drejtës se sheriatit gjatë përiudhës se okupimit osman, kjo pasi kanuni lindi dhe u zhvillua në pjesën veri-lindore të Shqipërisë ku jetonin kryesisht popullata krishterë. Mirëpo, pasi autoriteti i Lekë Dukagjinit, ishte i padiskutueshëm dhe feja islame e pakonsoliduar, kanuni u zbatua edhe nga popullata myslimane. Për këtë arsye, thuhet se ky kanun ka shërbyer si udhëzim për të drejtat zakonore në pjesën veriore të Shqipërisë, duke përfshirë këtu edhe trevat shqiptare të Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë.[82]Kanuni i Lekë Dukagjinit (tani e tutje KLD), ndahej në 12 pjesë dhe përmbante 159 nene. KLD, rregullimit të institutit të trashëgimisë i ka kushtuar nenet prej 88 deri në 116. KLD, si trashëgimtarë ligjorë ka njohur vetëm meshkujt, ndërsa femrat i ka përjashtuar në tërësi nga trashëgimia, jo vetëm të babait por edhe nga trashëgimia e burrit. Kjo rezulton nga neni 88 i kanunit ku thuhet: "kanunja njef për trashigues djalin e jo vajzën" dhe neni 91 ku thuhet: "as te prindja as te burri grueja s'hin në pjesë të trashëgimit". Pra, sipas KLD, femrat nuk janë thirrur në trashëgimi as në cilësinë e fëmijës së trashëgimlënësit dhe as në cilësinë e

[79] E. Statovci (2009) Të Drejtat, Liritë e Njeriut dhe Skllavërimi, Prishtinë. Fq.183.
[80] I. Elezi (2006). Kanuni i Laberisë.Tiranë. Fq.14.
[81] Po aty. Fq.22.
[82] M.Dragovaja (1996) Studim Krahasues i Kanunit të Shqipërisë dhe Dagestanit. Tiranë. Fq 3. (https://minds.wisconsin.edu/bitstream/handle/1793/69843/KANUNI_s.pdf?sequence=1).

bashkëshortes se trashëgimlënësit, që do të thotë femrave nuk i është njohur fare e drejta e trashëgimit. Sipas KLD, trashëgimlënësi edhe kur nuk kishte djalë nuk ka pasur të drejtë për se gjalli të ju dhuroj vajzave të tij pasuri të paluajtshme (tokë-shtepi), përveç disa sendeve të luajtshme më vlerë më të vogël. Kjo rregull rrjedh nga neni 108 i kanunit ku është përcaktuar: "baba edhe në mos pasët djem, nuk mundet me u lanë bijave as tokë, as plang, as shpi" dhe neni 109 ku thuhet "baba për të gjallë e vet, ka tagër me u falë bijave të holla, rraqe, çakla, përmbas deket të t'et s'ka tagër bija më lypë të falmet e të folmet e të t'et"[83].Pra, sipas KLD, vajzave trashëgimlënësi ka pasur të drejtë të ju dhurojë vetëm pasuri të luajtshme për së gjalli të vet. Ndërsa, në rastet kur trashëgimlënësi për së gjalli e ka përmendur, por nuk ju ka ndarë vajzave pasurinë e luajtshme, atëherë pas vdekjes së trashëgimlënësit vajzat nuk kanë pasur të drejtë të kërkojnë asnjë të drejtë në pasurinë e luajtshme. Sipas rregullave të përmbajtura në KLD, në rastet kur trashëgimlënësi nuk linte djem, trashëgimia u është ndarë kushërinjve më të afërt. Kushërinjët të cilëve u ndahej trashëgimia kanë pasur për detyre të kujdesen për bijat e trashëgimlënësit, e në veçanti për bijat e pamartuara të trashëgimlënësit. Kjo rezulton nga neni 98 i kanunit ku thuhet: "me mbetë plangu[84] në bija, kusherinji ma i ngati, a shkon te ato, ai i merr në shpi të vet, e aty e m'at hov merr sundimin mbi gja, pasuni e prone" dhe nenet 99 deri 102 ku janë përcaktuar detyrat e kushërinjve dhe të drejtat e bijave kësisoj: "më mbajtë në shpi varzat e plangut të shuem, me i a bajtë kujdesin për krah vesha e mbatha. Më martue varzat e vorfna. Më i pritë më të pam e me i përcjellë mbas kanunit. Me u ba drekët bijave, po diqne në shpi të vet para e mbas martese". Në rastet kur nuk ka pasur kusherinjë më të afërt janë kërkuar kushërinjët deri në 100 breza më të largët që të ju kalojë trashëgimia, më qëllim që pasuria të mos mbetet në duart e bijave apo fëmijëve të tyre.[85]Nga e drejta për të trashëguar, sipas KLD, përjashtoheshin edhe nipërit nga ana e bijave, përkitazi më këtë çështje në nenin 90 kanuni shprehet: "nipit të trungut a të gjakut i perket trashëgimi, e jo nipit të tamblit a nipit të bijash" kurse në nenin 92 thuhet: "me dalë fare mashkullimi i njij shpije e njiqind me pasë dalë aso dere s'kanë tager me u perzie në trashëgim të prindës as këto, as bijt e bijat e tyre. Nip bije nuk mund të varet në krrabë t'ungjve." Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu, se e drejta në trashëgim sipas KLD, nuk i është njohur as djalit jashtëmartesor të trashëgimlënësit. Kjo rezulton nga neni 89 i kanunit ku thuhet: "djalin të pakunorë kanunja s'njef për trashëgues". Sipas rregullave të KLD, e drejta për

[83] Shih Shtjefën Gjeçov O.F.M (1999) Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shtepia Botuese "Kuvendi" Tiranë. Fq. 26-28

[84] **Plang-u** quhej shtëpia-banesa.

[85] Lidhur më këtë në nenin 97 kanuni shprehet: "po s'pat kusherinj të ngjatë plangu i shuem, vllaznija a fisi edhe më njiqind breza kojshin, kan tager mbi gja, prone e pasuni të këtij plangu".

të trashëguar u njihej meshkujve mbi moshën 15 vjeçare. Në rastet kur trashëgimlënësi linte si trashëgimtarë të vetëm djalin, i cili nuk kishte mbushur moshën 15 vjeçare, kushërinjët më të afërtë detyroheshin të merrnin në kujdes djalin dhe të ruanin pasurinë e tij. Kushërinjët merrnin në administrim pasurinë e të miturit dhe kujdeseshin se pasuria të mos e humbë vlerën, mirëpo kushërinjve nuk u lejohej të dispononin më pasurinë. Pasi djali arrinte moshën 15 vjeçare, kushërinjët ishin të detyruar të ja dorëzonin pasurinë djalit dhe mund të kërkonin të ju paguhet një shpërblim për punët e kryera gjatë administrimit të pasurisë dhe kujdesit ndaj të miturit. Pra, kushërinjët janë caktuar si kujdestar të të miturit dhe kanë administruar më pasurinë trashëgimore, derisa i mituri ka arritur moshën madhore.[86] KLD, nuk e ka njohur institutin e trashëgimisë testamentare. Përjashtim nga kjo rregull, bëhej në rastet kur trashëgimlënësi nuk kishte djalë dhe kur një pjesë të pasurisë së vetë dëshironte t'ia linte "për shpirt" kishës, mirëpo për këtë kërkohej detyrimisht të merrej pëlqimi i kushërinjve. Kjo rezulton nga neni 115 i kanunit ku thuhet: "po pat djem, i jati nuk mundet më ba testament", kurse në kreun 39 kanuni shprehet: "Kanuni i Lekës nuk njef testamende: e, per në dashtë kush me lanë gja prej pasunish të veta per shpirt, duhet doemos pelqimi i kushrijve." Për lënien e testamentit në dobi të kishës trashëgimlënësi kërkohej domosdoshmërisht t'i plotësonte këto kushte: a) të ishte i shëndoshë mendërisht; b) të shprehte lirisht vullnetin gjegjësisht të mos bënte testamentin nën ndikimin e kanosjes apo kërcenimit; si dhe c) të posedonte të drejtën e disponimit mbi pasurinë e përfshirë në testament. KLD, ka njohur dy lloje të testamenteve apo të lanunash: a) testamente (te lana) më barrë dhe b) testamente (të lanunat) pa barrë. Në rastet kur trashëgimlënësi për pasurinë që i linte kishës i caktonte ndonjë obligim p.sh. me i përgatitë një apo dy mesha në vjet për shpirt të tij, bëhej fjalë për të lanat (testament) më barrë. Ndërsa, në rastet kur trashëgimlënësi për pasurinë që i linte kishës nuk i caktonte asnjë detyrim bëhej fjalë për të lanat (testamente) pa barrë. Për dy llojet e të lanave trashëgimlënësi (lënësi) ishte i detyruar që të mblidhte kushërinjët e vet si dhe pleqtë e fisit më dëshmitar, këta së bashku më trashëgimlënësin kërkohej që të nënshkruheshin përkatësisht të vënin shenjat e gishtit në dokument sipas rregullave të kanunit.[87]

[86] Kjo çështje në kanun rregullohet në nenet 93 deri në 95 përkatësisht në nenin 93 thuhet: "me mentë nji djalë ferishte djepi, i pa nanë, i pa vlla e moter, kusherinja e ngjatë janë në detyrë me e rritë, gjanë e tokën me i a ruejt, porse s'kan tagër as më e shitë e as më ndrrue gjasen" kurse në nenin 94 përcaktohet: "kusherinja edhe pse janë në detyrë më rritë e me mkambë djalin e vorfen, me i a ruejtë gjanë e toket, mundin e djersve të veta kan tagër me e marrë: "puntori do rrogen e vet". Bimët i gëzon, e shtojet e gjas do t'i ndajë mbas kanunit, si të bahet i zoti i vendit djali"si dhe në nenin 95 përcaktohet: "si të bahet 15 vjeç djali, kanunja e njef për burrë e për të zo'n e krahve të vet, atbotë edhe do t'i dorëzohen pronet e pasunit e sundimi i shtepisë se vet." Shih Shtjefën Gjeçov O.F.M (1999) Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shtepia Botuese "Kuvendi" Tiranë. Fq 26-27.

[87] Shih nenin 106 i kanunit ku thuhet: "të lanunat janë dy mëndyrësh: më barrë e pa barrë. a) Të lanunat më barrë (më detyrë) janë ato kur lanësi i cakton kishës nji detutë, b.f me thanë nji a dy Meshë në vjetë per shpirt të tij a të parvet të tij, per at pasuni qi po len. b) të lanunat pa barrë janë ato, kur lanësi len gjasen per kishë pa i caktue kurrfarë detyre, e xehet si i falun. c) lanësi asht në detyrë me mbledhë kushrinin e vet e plqet e fisit me dishmitarë, e, si lanësi si këta, do të vejn gisht në letër si e lypë kanuni".

Dispozita për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë hasim edhe në Kanunin e Skëndërbeut, i cili ka vepruar kryesisht në krahinat Krujë, Mat, Dibër, madje kufijtë e tij në hapësirë thuhet se shtriheshin edhe në jug deri në Elbasan e Librazhd. Kanuni i Skënderbeut, mbledhur dhe kodifikuar nga Dom Frano IlIria gjatë viteve 1936-1966, për herë të parë në gjuhen shqipe është botuar në Itali në v.1993. Kanuni ndahej në 7 pjesë dhe përmbante norma që rregullonin marrëdhëniet të ndryshme shoqërore.[88] Në Kanunin e Skënderbeut hasen edhe disa norma të së drejtës se sheriatit, të cilat janë përhapur pas islamizmit të një pjesë të popullsisë. Kanuni i Skënderbeut nuk dallon nga KLD, sa i përkët rregullimit të institucioneve me themelore, megjithëse ka veçori lokale dhe institucione që nuk gjenden në KLD, dhe as në kanune të tjera.[89] Në rregullimin e institucionit të trashëgimisë Kanuni i Skëndërbeut është i njëjtë më Kanunin e Lekë Dukagjinit. Njëjtë si KLD, edhe Kanuni i Skëndërbeut sanksionon pabarazinë e plotë midis dy gjinive, duke i njohur si trashëgimtarë ligjorë vetëm meshkujt.Pra, as sipas Kanunit të Skëndërbeut, femrat nuk gëzonin të drejtën e trashëgimisë.

1.4.2. Rregullimi i trashëgimisë në Kanunin e Labërisë

Një rregullim më të detajuar dhe më të plotë të institucionit të trashëgimisë (se sa në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe Kanunin e Skëndërbeut) e hasim në Kanunin e Labërisë. Kanuni i Labërisë, kodifikuar nga prof.Ismet Elezi ndahet në 10 pjesë,50 krerë dhe 883 nene. Ky kanun institucionin e trashëgimisë, e trajton në kreun e 34 përkatësisht në nenet 581 deri në 609. Në nenin 581 kanuni jep kuptimin e trashëgimisë kësisoj: "trashëgimia është kalimi pa shpërblim i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe i të drejtave pas vdekjes së trashëgimlënësit të trashëgimtari, brenda barkut duke u bërë zot malli".[90] Në këtë dispozite jepet përkufizimi i trashëgimisë, si marrëdhënie juridike e karakterit pasuror, që krijohet për shkak të vdekjes se subjektit dhe që lidhet më kalimin e pasurisë (së luajtshme apo të paluajtshme) të personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek trashëgimtarët e tij. Sipas Kanunit të Labërisë (tani e tutje KL), përkatësisht sipas dispozitës se nenit 584 të aftë për të trashëguar konsiderohen meshkujt që rrjedhin nga trungu i gjakut të babës. Kurse, të paaftë për të trashëguar konsiderohen fëmijët e gjetur dhe fëmijët nga gjinia e gruas. Sipas rregullave të përmbajtura në KL, në rend të parë trashëgiminë e lënë nga babai, e trashëgojnë djemtë e tij,

[88] Grup autorësh (2001) Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Luarasi" Tiranë. Fq 234.
[89] Po aty. Fq.235.
[90] Shprehja "brenda barkut" nënkuptonte fëmijët që rrjedhnin nga një nënë dhe baba që do të thotë pasuria trashëgimore u kalonte vetëm trashëgimtarëve të cilët kishin të përbashkët nënën dhe babain.

pastaj djemtë e djemve, vëllezërit dhe kushërinjët nga gjaku i babës. Kushërinjët trashëgonin vetëm në mungesë të trashëgimtarëve të tjerë respektivisht kur nuk kishte djem, nipa apo stërnipa në vijë të drejtë.[91] Pra, në radhën e trashëgimtarëve ligjorë hynin vetëm meshkujt, ndërsa femrat parimisht gëzonin të drejtën e trashëgimisë vetëm në pasurinë e luajtshme. Përkitazi më këtë çështje në nenin 587 par.1 KL shprehet: "Gruaja nuk ka të drejtë të trashëgojë pasurinë e paluajtshme të lënë nga babai dhe as nga burri, por trashëgon pasurinë e luajtshme", kurse në al 2 të kësaj dispozite thuhet: "Bija merr trashëgim nga baba, kur dorëbabja është pa bina (mashkull)". Pra, sipas KL, femrave u njihet e drejta e kufizuar për të trashëguar vetëm në pasurinë e luajtshme, përjashtim nga kjo rregull bëhej në rastet kur në familjen e prindërve nuk kishte meshkuj. Sipas KL, gruaja përjashtohet në tërësi nga trashëgimia në këto dy raste: a) kur dyshohet se ka shkelur besnikërinë bashkëshortore (pra për çështje nderi), si dhe b) kur i përket një besimit tjetër fetar nga ajo e trashëgimlënësit. Pra, sipas KL, pozita e femrës në trashëgimi (në cilësinë e vajzës së trashëgimlënësit) ishte më e favorshme, krahasuar më KLD, sipas të cilit femrat përjashtoheshit në tërësi nga trashëgimia, pavarësisht nëse trashëgimlënësi linte djemë ose jo. Sipas KL, femrat gëzonin pozitë jo të favorshme, kur ishin në rolin e bashkëshortës së trashëgimlënësit. KL, nuk e ka njohur të drejtën e trashëgimit reciprok midis bashëshortëve, që do të thotë bashkëshortët nuk e kanë trashëguar njërin-tjetrin. Sipas rregullave të KL, në rastet kur vdes gruaja pasuria trashëgimore u ndahet bijve të saj dhe kur mungojnë këta, trashëgimtarëve të tjerë sipas radhës. Ndërsa, në rastet kur vdes burri po që se gruaja vendos të mos martohet dhe të mos largohet nga shtëpia e burrit, ajo gëzon të drejtën e mbajtjes dhe banimit në shtëpinë e burrit nga familja njëjtë si përpara vdekjes së burrit, por nuk e gëzon te drejtën e trashëgimisë mbi pronën e burrit. Ndërsa, në rast se gruaja e ve vendosë të kthehet më dëshirën e saj në shtëpinë e prindërve të saj, atëherë ajo ka të drejtë të kërkojë nga vëllezërit që ta mbajnë dhe ushqejnë për tërë jetën nëse nuk martohet, por nuk ka të drejtë të kërkojë t'i njihet e drejta e trashëgimisë në pronën e babait.[92] Pra, sipas KL, në rastin e vdekjes se burrit gruaja gëzonte të drejtën e mbajtjes dhe banimit nga familja e burrit ose familja e prindërve të saj, por asaj nuk i njihej e drejta e trashëgimisë në pronën e burrit dhe as të babait. Përjashtimisht, sipas KL gruas së ve, i njihet e drejta e trashëgimisë (miraz) në rastet kur në familjen prindërore, vdisnin të gjithë trashëgimtarët meshkuj që gëzonin të drejtën e trashëgimisë sipas rregullave të kanunit. Vlen të përmendet se KL, përmbante rregulla edhe për

[91] I. Elezi (2006). Kanuni i Laberisë. Tiranë. Fq.193-194.
[92] Po aty.Fq 194-195. (Shih nenet 588 dhe 589).

çështjen e trashëgimisë së vazjës se mitur. Sipas rregullave të KL, në rastet kur trashëgimlënësi lënë vetëm një vajzë të mitur nga familja, vajza vihet në kujdestari të xhaxhait ose të kushëririt të parë nga babai të cilët adminstrojnë më pasurinë e trashëguar. Ndërsa, në rastet kur trashëgimlënësi lënë një vajzë madhore dhe fëmijë të tjerë të mitur, ajo bëhet kujdestare e fëmijëve dhe administron vet më pasurinë e trashëguar. Mirëpo, KL, vazjës nuk i njihnte të drejtën për të disponuar lirisht pasurinë e trashëguar, pa e marrë pëlqimin apo lejen nga xhaxhai ose kushërinjët e parë nga babai.[93] Ndërsa, vajzat që vendosnin për të mos u martuar dhe qëndronin në shtëpinë e prindërve kur nuk kishte asnjë trashëgimtar meshkuj, u njihej e drejta e pakufizuar në trashëgiminë e babait sikur të ishin djemë. Sipas rregullave të KL, vajzat që vendosnin për tu mos u martuar kërkohej që të betoheshin përpara dy ose më tepër dëshmitarëve se nuk do martohen dhe se do të qëndrojnë në shtepinë e prindërve, më këtë rast ato shpalleshin virgjëresha. Pasurinë e vajzës virgjëreshë pas vdekjes së saj, e trashëgonin kushërinjët nga trungu i babës.[94] Është interesante të përmendet që sipas KL, trashëgimlënësit nuk i lejohet që të përjashtojë përgjithmonë nga trashëgimia djalin, pavarësisht nëse djali kryente ndonjë faj të rëndë ndaj tij. Madje, edhe nëse trashëgimlënësi dëshiron ta përjashtojë përgjithmonë djalin nga trashëgimia, sipas KL, nuk duhet ta lejojnin këtë vëllazëria, farefisi dhe as bashkësia, kurse pleqtë të cilët ndanin pasurinë trashëgimore duhej ti jepin pjesën që i takon djalit. Sipas rregullave të KL, meshkujt përjashtoheshin nga trashëgimi vëtem në këto raste: a) kur vrisnin trashëgimlënësin; b) mohonin fenë islame; c) ishin fëmijë të lindur jashtëmartese apo fëmijë të gjetur të lindur nga nëna më burrin tjetër pas vdekjes së burrit të pare.[95] Pra,ashtu si KLD edhe KL, nuk i njeh të drejtën e trashëgimisë, fëmijëve të lindur jashtë martesë. Kurse, fëmijët e birësuar sipas KL, gëzonin të drejtën e barabartë në trashëgimi më fëmijët martesor.[96] Përveç trashëgimisë ligjore,KL ka përmbajtur rregulla edhe për trashëgiminë testamentare. Sipas KL,trashëgimlënësi nuk ishte i lirë të dispononte pasurinë më testament, pa e marrë pëlqimin apo miratimin e vëllezërve e kushërinjëve nga ana e babait. Sipas rregullave të KL, kushërinjët nga babai të trashëgimlënësit kishin të drejtë nëse dëshironin të mbanin për vete 1/3 e pasurisë së lënë trashëgim më testament p.sh shtëpinë, duke ja paguar vlerën e pasurisë personit që i është lënë me testament. Përjashtimisht sipas rregullave të KL, trashëgimlënësi më pëlqimin e vëllezërve apo kushërinjëve nga babai kishte të drejtë t'ia lërë pasurinë me

[93] I. Elezi (2006) Kanuni i Laberisë. Tiranë. Fq.196. (Shih nenin 597).
[94] Po aty. Fq. 195. (Shih nenin 593 dhe 594).
[95] Po aty. Fq. 194. (Shih nenin 590 dhe 591).
[96] Shih nenin 596 ku thuhet: "I birësuari ka të drejtë të trashëgojë pasurinë njësoj sikur fëmija natyral"

testament në trashëgim edhe vajzave apo ndonjë person tjetër[97]. Veç kësaj, trashëgimlënësit sipas KL, i lejohej t'ia linte pasurinë për "shpirt" një institucion fetar p.sh, xhamisë, kishës apo ndonjë institucion kulturor p.sh shkollës, kur nuk kishte trashëgimtarë të radhës, por duke marrë paraprakisht pëlqimin e vëllezërve dhe pasi të ketë shlyer të gjitha borxhet që mund të kishte familja e tij.[98]KL,përmbane rregulla edhe për procedurën e ndarjes se pasurisë trashëgimore. Sipas rregullave të përmbajtura në KL, pasuria trashëgimore ndahej nga vëllau më i madh ose nga një kushëri i afërt i babait ose nga fqinji. Ndërkaq, kur midis vëllezërve kishte mosmarrëveshje mbi mënyrën e ndarjes së pasurisë trashëgimore, për ta ndarë pasurinë thirreshin pleqtë e fshatit. Sipas KL, për ndarjen e pasurisë mund të thirreshin edhe pleqtë nga një fshat tjetër i trashëgimlënësit, të cilët njiheshin për ndërshmërinë dhe paanshmërinë e tyre si dhe për njohjen e zakoneve të vendit. Pleqtë e thirrur fillimisht njoftoheshin më vlerën e pasurisë dhe borxhet që mund t'i kishte trashëgimlënësi, pastaj ndanin pasurinë më hedhjen e shortit ose më marrëveshje në mes të vëllezërve.[99]Sipas rregullit për punët e kryera rreth ndarjes së pasurisë trashëgimore pleqtë mund të merrnin një shpërblim, por jo të caktuar më parë.Pleqve nuk u lejohej të bënin kërkesë dhe as ankesë për masën dhe llojin e shpërblimit. Vendimi i pleqve mbi ndarjen e pasurisë trashëgimore konkretizohej më hedhje shorti ose më arritjen e marrëveshjes midis vëllezërve për mënyrën e ndarjes së pasurisë.Vendimi i marrë nga pleqtë konsiderohej i detyrueshëm dhe kundër tij nuk lejohej të paraqitej ankesa.[100]

[97] I. Elezi (2006) Kanuni i Laberisë. Tiranë.Fq.196
[98] Po aty.Fq.197
[99] Po aty.Fq.199
[100] Po aty. Fq.199

1.5. Rregullimi i trashëgimisë në të drejtën borgjeze gjegjësisht në Kodet Civile të fund shek.XIX dhe fillim shek.XX

Burimet juridike kryesore në të cilat mbështetej e drejta borgjeze ishin kryesisht ligjet. Në këtë faze të zhvillimit të së drejtës, janë nxjerrë një sërë ligje përkatësisht kode për rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme shoqërore dhe ekonomike. Ndër kodet civile më të rëndësishme të kësaj përiudhe përmenden: Kodi Civil Francez i vitit 1804 (Kodi i Napoleonit); Kodi i Përgjithshëm Civil i Austrisë i vitit 1811; Kodi Civil Gjerman miratuar në vitin 1896 dhe hyrë në fuqi në vitin 1900, Kodi Civil Zviceran i vitit 1907 etj.[101] Këto kode kanë pasur influencë të rëndësishme në nxjerrjen e kodeve në shtetet e tjera, e sidmos Kodi Civil Francez, i cili për një kohë të gjatë është përdorur si model referimi në sistemet juridike të shumë shteteve. Kodi Civil Francez, ka pasur ndikim të madh në veçanti në nxjerrjen e Kodit Civil në Holandë (1838), në Itali (1865); në Rumani (1864); në Portugali (1867); Spanje (1889) etj. [102]

1.5.1. Rregullimi i trashëgimisë në Kodin Civil Francez të vitit 1804

Kodi Civil Francez (i njohur ndryshe si Kodi i Napoleonit), përmbante 2281 nene dhe ndahej në tri pjesë, një numër të konsiderueshëm të neneve, kodi i ka kushtuar rregullimit të institutit të trashëgimisë. Instituti i trashëgimisë trajtohej në pjesën e tretë të kodit, ku përfshiheshin rregullat për mënyrat e fitimit të pronësisë (në nenet 819-1100). Në pjesën e dytë, kodi trajtonte materien e së drejtës sendore si pronësinë, servitutet, pengun etj. Ndërsa, në pjesën e pare, kodi përmbantë rregullat lidhur më subjektët e së drejtës, të drejtën martesore, të drejtën prindërore, adoptimin etj. Kodi Civil Francez (tani e tutje KCF) ka njohur dhe rregulluar dy forma të trashëgimit: a) trashëgiminë ligjore dhe b) trashëgiminë testamentare. Sipas KCF (neni 725), të aftë për të trashëguar konsideroheshin të gjithë personat e lindur gjallë si dhe ata që ishin konceptuar (zënë) në kohën e hapjes së trashëgimisë nëse lindin gjallë. Të huajve sipas KCF, nuk i lejohej të trashëgonin pronën e cila ndodhej në territorin e vendit, përveç në rastet dhe në mënyrën në të cilën një francez mund të trashëgonte pronën brenda vendit nga i cili ishte i huaji. Pra,nen kushtet e reciprociteti sipas KCF, edhe të huajve i njihej e drejta e trashëgimit. Ndërsa, të paaftë për të trashëguar për shkak të padenjësisë sipas KCF, (neni 727) konsideroheshin: a)

[101] A. Aliu (2013) E Drejta Civile. Prishtinë. Fq 67.
[102] Shih William Tetley, Mixed Jurisdictions: Common Law v. Civil Law (Codified and Uncodified),60 La. L. Rev. (2000). Fq.688. (Available at: http://digitalcommons.law.lsu.edu/lalrev/vol60/iss3/2).

personat të cilët më qëllim kishin vrarë apo kishin tentuar të vrasin trashëgimlënësin; b) personat të cilët kundër trashëgimlënësit kishin ngritur aktakuzë të rrejshme;[103] c) trashëgimtari i cili ishte në dijeni për vrasësin e trashëgimlënësit dhe nuk e kishte denoncuar atë në organet e drejtësisë. Personi që përjashtohej nga trashëgimi si i padenjë, detyrohej ti kthente të gjitha frutet dhe të ardhurat të cilat i kishte gëzuar pas çeljes së trashëgimisë.[104]Sipas KCF, trashëgimia ligjore njihej deri në brezin e 12-të, e në rast se nuk kishte trashëgimtarë ligjorë deri në këtë brez trashëgimia në tërësi i mbetej bashkëshortit pasjetues,[105]e në mungesë të bashkëshortit pasjetues sipas nenit 768 i KCF, trashëgimia i kalonte shtetit. Sipas rregullave të përmbajtura në kod, bashkëshorti pasjetues apo autoriteti publik pretendent i trashëgimisë kërkohej të parashtronte një kërkesë pranë gjykatës kompetente për kalimin e trashëgimisë. Gjykata pas paraqitjes së kërkesës bëntë shpallje publike, më të cilat kërkohej që të paraqiten trashëgimtarët, nëse pas tre njoftimeve nuk paraqitej asnjë trashëgimtarë ligjorë, trashëgimia i kalonte bashkëshortit pasjetues. Bashkëshorti pasjetues nuk bëhej titullar më të drejta të plota i pasurisë trashëgimore, dersia nuk kalonin tre vjet, përkatësisht nëse ndonjëri prej trashëgimtarëve ligjorë i trashëgimlënësit paraqitej brenda tre vjeteve,bashkëshorti/ja detyrohej të kthente trashëgiminë.[106] Pra,pozita e bashkëshortit pasjetues sipas KCF, ishte e pafavorshme, në mungesë të testamentit bashkëshorti pasjetues thirrej në trashëgimi vetëm kur mungonin trashëgimtarët e tjerë ligjorë. Kjo filloi të ndryshojë nga fundi i shekullit të XIX përkatësisht në vitin 1891 u miratua një ligj më të cilën bashkëshortit pasjetues i garatohej ¼ e trashëgimisë (uzufrukti). Pozite jo të favorshme sipas KCF, gëzonin edhe fëmijët jashtëmartesor.[107]Sipas KCF (neni 756),fëmijëve jashtëmartesor u njihej e drejta për të trashëguar vetëm kur atësia e tyre ishte njohur ligjërisht, në të kundërtën atyre nuk i takonte asnjë e drejtë në pasurinë trashëgimore. Mirëpo,edhe kur fëmijëve jashtëmartesor u ishte njohur atësia, atyre nuk u takonte e drejta e barabartë në trashëgimi më fëmijët e lindur gjatë martesës. Kësisoj, sipas KCF (neni 757),kur fëmijët jashtëmartesor konkurronin në trashëgimi më fëmijët martesor merrnin 1/3 e pasurisë, që kishte m'i taku po të kishin qenë fëmijë të lindur nga martesa. Në rastet kur trashëgimlënësi nuk linte pasardhës (por vetëm prindër apo vëllezër dhe motra) fëmija jashtëmartesor trashëgonte gjysmën

[103] The Code Napoleon: Or the French Civil Code. Literally transated from the original and official edition, Published at Paris, in 1804. By a barrister or the inner temple. London: Printed for Charles hunter, law bookseller, bell-yard, Lincoln's inn.1824. Fq. 198.

[104] Po aty. Fq. 199.

[105] H. Ismaili & F. Sejdiu (2000) Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës. Prishtinë. Fq. 508.

[106] The Code Napoleon: Or the French Civil Code. Literally transated from the original and official edition , Published at Paris, in 1804. By a barrister or the inner temple. London: Printed for Charles hunter, law bookseller, bell-yard, Lincoln's inn.1824. Fq. 212.

[107] Nicolas Boring (2014): Inheritance Laws in the Nineteenth and Twentieth Centuries France.The Law Library of Congress.Fq. 5. (https://www.loc.gov/law/help/inheritance-laws/historical-inheritance-laws.pdf)

e pasurisë që do t'i takonte po të kishte qenë fëmijë martesor, kurse pjesa tjetër e pasurisë u ndahej sipas radhës trashëgimtarëve tjerë ligjorë. Ndërsa, në rastet kur trashëgimlënësi nuk linte pasardhës dhe paradhës e as vëllezër apo motra, fëmijës jashtëmartesor i takonte ¼ e pasurisë.[108] Është më rëndësi të theksohet se fëmijëve të lindur nga martesa, sipas KCF, pasuria u ndahej në pjesë të barabarta dhe nuk bëhej ndonjë dallim midis tyre në baza gjinore. Pra, djemve dhe vajzave të trashëgimilënësit, u ka takuar e drejta e barabartë në trashëgimi. Përveç trashëgimisë ligjore, KCF, i ka kushtuar rëndësi të posaçme edhe rregullimit të trashëgimisë testamentare. Sipas KCF (neni 903), testamentin mund ta bënin të gjithe personat madhore më zotësi veprimi. Përjashtimisht, e drejta për të bërë testament sipas KCF (neni 904), i njihej edhe personit të mitur mbi moshen 16 vjeçare, mirëpo vetëm për një pjesë të pasurisë. Fëmijës se mitur mbi moshën 16 vjeçare, i lejohej të dispononte më testament vetëm më gjysmën e pasurisë, të cilën ligji normalisht i lejonte një person të rritur për të disponuar më testament. Fëmijës së mitur mbi moshën 16 vjeçare, nuk i lejohej për të bërë disponimin e pasurisë më testament në favor të kujdestarit të tij nëse llogaritë përfundimtare të kujdestarisë nuk ishin miratuar më parë.[109] Përjashtim nga kjo rregull, bëhej në rastet kur kujdestar ishte paraardhësi i trashëgimlënësit. Fëmijëve jashtëmartesor nuk u njihej e drejta e barabartë më fëmijët martesor as në trashëgimi testamentare, përkatësisht sipas KCF, fëmijëve jashtëmartesor nuk u lejohej të trashëgonin më testament, më tepër se sa u takonte nga trashëgimia ligjore. Sipas KCF, trashëgimlënësit nuk i lejohej të dispononte në tërësi pasurinë më testament kur kishte trashëgimtarë ligjorë. Kështu: kur trashëgimlënësi kishte një fëmijë mund të linte më testament ½ e pasurisë; 1/3 e pasurisë kur kishte dy fëmijë si dhe ¼ e pasurisë kur kishte më shumë së dy fëmijë.[110]

[108] The Code Napoleon: Or the French Civil Code. Literally transated from the original and official edition, Published at Paris, in 1804. By a barrister or the inner temple. London: Printed for Charles hunter, law bookseller, bell-yard, Lincoln's inn.1824. Fq. 208.
[109] Po aty. Fq. 247.
[110] Joseph Dainow, Forced Heirship in French Law, 2 La. L. Rev. (1940). Faqe. 683.
(Available at: http://digitalcommons.law.lsu.edu/lalrev/vol2/iss4/6)

1.5.2 Rregullimi i trashëgimisë në Kodin Civil Gjerman të vitit 1900

Kodi Civil Gjerman, u miratua më 18 gusht 1896, dhe hyri në fuqi më 1 janar 1900. Kodi Civil Gjerman, u ndërtua duke u mbështetur kryesisht në të drejtën gjermane dhe të drejtën klasike romake.[111] Kodi Civil Gjerman, dallohej për terminologjinë e përpiktë të përdorur, por dhe shumë abstrakte, e cila ishte e vështirë të kuptohet nga njerëzit e zakonshëm të cilët nuk kishin njohuri juridike.[112] Kodi Civil Gjerman, ndahej në pesë libra dhe përmbantë 2385 nene. Në librin e parë, përfshiheshin rregullat për subjektët e së drejtës (personat fizike dhe juridike). Në librin e dytë, trajtohej e drejta e detyrimeve. Në librin e tretë, trajtohej e drejta e pronësisë dhe të drejtat e tjera reale. Në librin e katërt, trajtohej e drejta familjare si dhe në librin e pestë trajtohej e drejta trashëgimore.[113] Kodi Civil Gjerman (tani e tutje KCGJ), ashtu si dhe KCF rregullonte dy forma të trashëgimisë: a) trashëgiminë ligjore dhe b) trashëgiminë testamentare. Sipas KCGJ, në grupin e trashëgimtarëve ligjorë hynin: fëmijët e trashëgimlënësit dhe të pasardhësit e tyre, prindërit e trashëgimlënësit me të pasardhësit e tyre, gjyshërit dhe stërgjyshërit e trashëgimlënësit. Thirrja në trashëgim bëhej sipas parantelave. Në paratelën e parë, thirreshin në trashëgimi pasardhësit e trashëgimlënësit; në parantelën e dytë, thirreshin në trashëgimi prindërit e trashëgimlënësit; në parantelën e tretë, thirreshin në trashëgimi gjyshërit e trashëgimlënësit e kështu më radhë.[114] Trashëgimtarët e parantelës më të afërtë sipas afërsisë së gjinisë së gjakut, i përjashtonin trashëgimtarët e parantelës më të largët. Në KCGJ, zbatohej e drejta e përfaqësimit pa kufizim në të gjitha parantelat e trashëgimisë. P.sh., kur ekzistonin fëmijët e trashëgimlënësit, e gjithë trashëgimia u ndahej në mënyrë të barabartë fëmijëve, në qoftë se njëri prej fëmijëve kishte vdekur para trashëgimlënësit, pjesa e pasurisë së fëmijës se vdekur që do ti takonte po të ishte gjallë në bazë të së drejtës së përfaqësimit i ndahej pasardhësve të tij.[115]Sipas KCGJ, bashkëshortit pasjetues i njihej e drejta absolute për të trashëguar një pjesë të pasurisë nga masa trashëgimore, e cila nuk mund të ishte më e madhe se ¼ e trashëgimit, kur ekzistonin trashëgimtarët e parenteles së pare (pasardhësit e trashëgimlënësit).[116] Në lidhje më trashëgiminë testamentare KCGJ, përcaktonte se testamentin

[111] Edith Palmer (2014): Inheritance Laws in the Nineteenth and Twentieth Centuries Germany. The Law Library of Congress. Fq.7. (Available at: https://www.loc.gov/law/help/inheritance-laws/historical-inheritance-laws.pdf)
[112] Shih M. Fromont (2009). Sistemet e huaja më të mëdha të të drejtës, Papirus. Fq.35.
[113] Shih A. Aliu (2013). E Drejta Civile, Prishtinë. Fq.69.
[114] George A. Pelletier Jr. & Michael R. Sonnenreich, A Comparative Analysis of Civil Law Succession, 11 Vill. L. Rev. 323 (1966). Fq. 336 (Available at: http://digitalcommons.law.villanova.edu/vlr/vol11/iss2/3).
[115] Po aty. Fq. 337.
[116] Po aty. Fq. 338 dhe 369.

mund ta bëjnë të gjithe personat madhore më zotësi veprimi. Sipas KCGJ, trashëgimlënësi ishte i kufizuar në bërjën e dispozitave testamentare, për faktin se trashëgimlënësit nuk i lejohej të dispononte në tërësi pasurinë kur kishte fëmijë dhe bashkëshorte, të cilëve ju takonte pjesa e domosdoshme. Sipas KCGJ, pjesa e domosdoshme e bashkëshortit pasjetues dhe fëmijëve ishte e barabartë më gjysmën e pjesës që merrnin nga trashëgimia ligjore. Në raste të veçanta trashëgimlënësit, i lejohej të përjashtonte nga pjesa e domosdoshëm edhe bashkëshortin dhe fëmijët, p.sh., kur trashëgimtari kishte tentuar të vrasë trashëgimlënësin apo kur bashkëshorti ishte fajtor për ndonjë vepër të kryer për të cilën trashëgimlënësi, do të kishte të drejtë për të kërkuar divorcim.[117]Sipas KCGJ, bashkëshortëve u lejohej të bënin testamentin e përbashkët (reciprok).Në bazë të testamentit të përbashkët bashkëshortët bëheshin reciprokisht trashëgimtarë të njëri-tjetrit, ashtu që në rast të vdekjes bashkëshorti i mbijetuar trashëgonte gjithë pasurinë, kurse fëmijët mund të trashëgonin vetëm pas vdekjes së bashëkshortit të mbijetuar.Testamenti reciprok i detyronte të dy bashkëshortët dhe në rast të vdekjes, bashkëshortit të mbijetuar nuk i lejohej të revokonte dispozitat e testamentit.[118]

1.5.3. Rregullimi i trashëgimisë sipas Kodit Civil Shqiptar të vitit 1929

Kodi Civil i Shqipërisë gjegjësisht Kodi Civil i Mbretërisë Shqipëtare, është miratuar në vitin 1928, dhe ka hyrë në fuqi më 1 prill 1929[119]. Ky kod është hartuar nën ndikimin e Kodit Civil Italian, Francez, Gjerman dhe atij Zviceran.Kodi ndahej në 4 libra dhe përmbante 2047 nene. Në këtë kod, rregullimit të institutit të trashëgimisë, i kushtohet një libër i veçantë përkatësisht instituti i trashëgimisë rregullohet në librin e dytë, në nenet 454-773. Dispozitat për rregullimin e institucionit të trashëgimisë, në këtë kod i referohen kryesisht Kodit Civil Italian.[120] Dispozitat e KCSH të vitit 1929, kanë rregulluar dy forma të trashëgimisë: a) trashëgiminë ligjore; dhe b) trashëgiminë testamentare.Kjo rregull rrjedh nga neni 454 i kodit, ku përcaktohej se:*"Trashëgimi vjen me ligj ose me testament. Trashëgimi legjitim (me ligjë) ka vent vetëm kur e përsa mungon trashëgimi testamentar."* Nga analiza e kësaj dispozitë ligjore, rezulton se trashëgimia testamentare ka gëzuar prioritet ndaj trashëgimisë ligjore. Rrethin e trashëgimtarëve ligjorë sipas KCSH të vitit 1929, e përbënin këta persona: fëmijët e trashëgimlënësit dhe të

[117] George A. Pelletier Jr. & Michael R. Sonnenreich, A Comparative Analysis of Civil Law Succession, 11 Vill. L. Rev. 323 (1966).Fq.351-352
[118] Po aty. Fq. 345.
[119] A. Aliu (2013) E Drejta Civile. Prishtinë.Fq 71
[120] J. Latifi (2009) E Drejta Civile (Pjesa e Përgjithshme).Tiranë.Fq.14-16.

paslindurit e tyre; të paralindurit e trashëgimlënësit (prindërit, gjyshi, gjyshja); bashkëshorti pasjetues si dhe gjinia e tërthortë deri në shkallën e gjashtë.Në mungesë të këtyre trashëgimtarëve, trashëgimia i kalonte shtetit. Bashkëshorti pasjetues hynte në kategorinë e trashëgimtarëve ligjorë, por nuk trajtohej njëjtë si trashëgimtarët e tjerë. Pjesa e pasurisë trashëgimore që merrte bashkëshorti pasjetues, ishte e ndryshme varësisht nga trashëgimtarët ligjorë më të cilët ai konkurronte.[121]Në këtë mënyrë, kur bashkëshorti pasjetues konkurronte në trashëgimi bashkë më fëmijët martesor të trashëgimlënësit, merrte si trashëgim uzufruktin e një pjesë së pasurisë trashëgimore, baras me atë të secilit fëmijë, duke u llogarit edhe vet bashkëshorti në numrin e fëmijëve. Kur konkurronte bashkë më fëmijët martesor dhe jashtëmartesor, bashkëshorti merrte uzufruktin e një pjesë trashëgimore baras më atë që i takonte secilit nga fëmijët martesor. Kjo pjesë e uzufruktit në çdo rast nuk mund të ishte më e madhe se ¼ e trashëgimit. Poashtu, edhe kur konkurronte më fëmijë prej një tjetër martesë të trashëgimlënësit ose më këta dhe fëmijët e tij bashkëshorti pasjetues merrte ¼ e trashëgimit.[122] Në rastet kur konkurronte me të paralindurit e trashëgimlënësit, më fëmijët jashtëmartesor, më vëllezër e motra apo më pasardhësit e tyre bashkëshorti pasjetues merrte 1/3 e trashëgimisë. Ndërsa, në rastet kur konkurronte vetëm më të paralindurit dhe fëmijët jashtëmartesor bashkëshorti pasjetues merrte ¼ e trashëgimisë,[123]si dhe kur konkurronte më gjinite e tjera merrte 2/3 e trashëgimit. Në rastet kur trashëgimlënësi nuk linte asnjë trashëgimtarë tjetër, përveç bashkëshortit e gjithë trashëgimi i takonte bashkëshortit.[124]

KCSH i vitit 1929, përkatësisht neni 477 i kodit, sanksiononte pabarazinë midis fëmijëve martesor dhe fëmijëve jashtëmartesor. Fëmijëve jashtëmartesor kur u ishte pranuar ligjërisht atësia, u njihej e drejta e trashëgimisë, por jo në mënyrë të barabartë më fëmijët martesor. Kur fëmijët jashtëmartesor thirreshin në trashëgim me fëmijët martesor merrnin ½ e trashëgimit, që kishte mi taku po të kishin qenë fëmijë martesor. Ndërkaq, fëmijëve martesor u njihej e drejta e barabartë në trashëgim dhe midis tyre nuk bëhej dallime nëse ishin fëmijë meshkuj apo femra apo nëse i përkisnin martesave të ndryshme të trashëgimlënësit.[125] Është e rëndësishme të përmendet se deri në v.1929, pra deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil, në Shqipëri burrave (të besimit fetar mysliman) u është lejuar lidhja e martesave më disa gra (poligamia) dhe fëmijëve

[121] N.Biçoku (1995) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë.Tiranë.Fq.21
[122] Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare (i vitit 1928), shih nenin 486
[123] Po aty, shih nenin 487
[124] Po aty, shih nenin 488
[125] A. Nuni & L. Hazneziri (2010) E Drejta Civile (Trashëgimia).Tiranë.Fq.335

që mund të kishin lindur nga martesa të ndryshme të trashëgimlënësit, KCSH i vitit 1929, u ka njohur të drejtën e barabartë në trashëgimi. Kjo rregull gjendej e sanksionuar në nenin 460 par.1 i kodit, ku përcaktohej se:*"Atin amën dhe çdo tjetër të paralindun e trashëgojnë fëmijët legjitim, ose të paslindurit e tyne pa dallim seksi edhe sikur të kenë lë nga martesa të ndryshme"*. Më fëmijët martesor janë barazuar edhe fëmijët e adoptuar, por për dallim nga fëmijët martesor fëmijët e adoptuar nuk janë konsideruar trashëgimtarë ekskluzivë të radhës së parë.[126] P.sh., kur nga trashëgimtarët e radhës së parë trashëgimlënësi ka lënë vetëm një fëmijë të adoptuar, fëmija e adoptuar nuk ka trashëguar gjithë trashëgiminë si trashëgimtarë i vetëm i radhës së parë, por ka trashëguar së bashku më trashëgimtarët e radhës pasuese.

KCSH i vitit 1929, ka përmbajtur një sërë dispozita edhe për rregullimin e trashëgimisë testamentare përkatësisht testamenti në kod është trajtuar në nenet 492- 650. Në nenin 492 i kodit, jepej përkufizimi i testamentit në këtë mënyrë: *"Testamenti asht një akt i revokueshëm me të cili ndokush, sipas rregullave të caktume prej ligjës disponon për kohën mas vdekjes të tanë ose një pjesë të pasunisë së vet në favor të një ose më shumë personave".* Të aftë për të bërë testament konsideroheshin të gjithë personat të cilët kishin mbushur moshën 18 vjeç dhe ishin të shëndoshë mendërisht, pra kishin zotësi veprimi. KCSH i vitit 1929, ka paraparë kufizime të caktuara në bërjën e testamentit kur kishte trashëgimtarë ligjorë. Kësisoj: kur trashëgimlënësi kishte një fëmijë (martesor, jashtëmartesor apo të adoptuar) mund të linte më testament ½ e pasurisë. Kur kishte dy ose më shumë fëmijë mund të linte 1/3; kur kishte të paralindur (prindërit apo gjyshërit) mund të linte 2/3 dhe kur kishte trashëgimtarë të tjerë (vëllezër e motra më të paslindur) mund të linte ¾ e pasurisë.[127]

KCSH i vitit 1929, ka shërbyer si burim kryesor për rregullimin e marrëdhënieve juridike-civile deri në vitin 1944, gjegjësisht, deri në vendosjen e pushtetit komunist.Pas vendosjes së pushtetit komunist në Shqipëri në vitin 1944, u vendos që të mos zbatohet më legjislacioni i mëparshëm, përfshirë këtu edhe Kodin Civil. Kështu, në vitin 1945 u nxjerr Ligji.nr 61 dt.17.05.1945, më të cilin u shfuqizua i gjithë legjislacioni i vjetër dhe u vendos të krijohet legjislacioni i ri në pajtim më rendin e ri juridik dhe shoqëror. Mirëpo,për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë nuk është nxjerrë ndonjë akt i veçantë juridik deri në vitin 1954. Për këtë arsye, në shkencën juridike shqiptare shfaqen mendime të ndryshme se cilat burime gjatë përiudhës 1945-1954, janë aplikuar për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë. Sipas

[126] A. Nuni & L. Hazneziri (2010) vepra e njëjtë.Fq.336
[127] N. Biçoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë.Fq.32

autorit N.Biçoku, në këtë përiudhë për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë në tërësi është aplikuar praktika gjyqësore.[128]Mendim tjetër ndajnë autorët A.Nathanali dhe N.Papuli, sipas të cilëve në këtë përiudhë për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë në tërësi janë aplikuar dispozitat e Kodit Civil të v.1929.[129] Ndërsa, sipas autorëve A.Nuni e L.Hasneziri, për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë në këtë përiudhë janë aplikuar pjesërisht si dispozitat e Kodit Civil të v.1929, ashtu dhe praktika gjyqësore përkatësisht vendimet dhe udhëzimet e plenumit të Gjykatës së Lartë. Sipas autorëve në fjalë, më udhëzimet dhe vendimet e nxjerra nga Gjykata e Lartë, janë rregulluar disa çështje në lidhje më trashëgiminë ligjore si të drejtat e bashkëshortit pasjetues, të drejtat e fëmijëve jashtëmartesor etj. Mirëpo, rregullimi i çështjeve më kryesore si zotësia për të trashëguar, zotësia për të bërë testament, përcaktimi i trashëgimtarëve ligjorë dhe rezervës ligjore etj., janë rregullar më dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929.[130] Në teorinë juridike shqiptare, përkrahet më shumë pikëpamja e autorëve në fjalë, pra që në përiudhën 1945-1954, rregullimi i marrëdhënieve të trashëgimisë bëhej pjesërisht nga Kodi Civil i v.1929 dhe nga praktika gjyqësore gjegjësisht nga vendimet dhe udhëzimet e nxjerra nga Gjykata e Lartë. Në bazë të vendimeve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Gjykata e Lartë, u sanksionua barazia midis bashkëshortëve dhe midis fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor.[131] Tani, bashkëshorti pasjetues trashëgonte në mënyrë të barabartë më fëmijët e trashëgimlënësit, por për dallim nga fëmijët kur bashkëshorti ishte trashëgimtarë i vetëm i radhës së parë, ai thirrej në trashëgim bashkë më prindërit e trashëgimlënësit, mirëpo në këtë rast bashkëshorti merrte jo më pak se 1/3 e pasurisë trashëgimore.[132]Ndërsa, në lidhje më trashëgiminë testamentare, më rregullat e reja u përcaktoi se trashëgimlënësi kur nuk ka trashëgimtarë ligjorë, mund ta disponon pasurinë më testament në favor të personave të tjerë, por jo edhe në favor të institucioneve fetare gjegjësisht kishës.[133]

Rregullimi i trashëgimisë sipas "Dekretit mbi Trashëgimi"të vitit 1954 -Në vitin 1954 për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë në Shqipëri, u nxjerr akt i veçantë, përkatësisht Dekreti nr.1892, datë 05.07.1954 "Mbi trashëgiminë".Ky dekret më disa ndryshime që i janë

[128] N. Biçoku (2011). vepra e njëjtë Fq.33
[129] A.Nathanali & N.Papuli (1961) Disa çështje mbi pronësinë dhe trashëgiminë.Tiranë.Fq 109
[130] A. Nuni & L. Hazneziri (2010) E Drejta Civile (Trashëgimia).Tiranë.Fq 397
[131] Shih Aspekte të trashëgimisë ligjore sipas legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar.Distertacion për mbrojtjen e gradës shkencore "Doktor".Kandidati: Nertila Sulçe, udheheqësi shkencor: Eneida Sema (Dervishi).Universiteti i Tiranës.Fakulteti i Drejtësisë.Tiranë.2017.Fq.11
[132] Vendimi Nr.40. datë 4.3.1949 i KC të Gjykatës së Lartë , Drejtësia Populllore , viti 1949,Nr.2, faqe 90 dhe Vendimi Nr.12, datë 22.7.1949 i Plenumit të Gjykatës së Lartë , Drejtësia Populllore , viti 1949,Nr.5 faqe 82 (Cituar nga N. Biçoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë.Fq.35)
[133] Shih A.Nuni & L.Hazneziri (2010) vepra e njëjtë Fq 395-340

bërë në v.1960 dhe v.1973[134], ka shërbyer si burim kryesor për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë deri në vitin 1982 gjegjësisht deri në hyrjen në fuqi të Kodit Civil. Më këtë dekret janë njohur dhe rregulluar si trashëgimia më ligj, ashtu dhe trashëgimia më testament, përkatësisht në nenin 1 i dekretit përcaktohej:*"Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgim) së personit të vdekur (trashëgimlënës) një ose më shumë personave (trashëgimtarë)".* Si trashëgimtarë ligjorë janë njohur: fëmijet, bashkëshorti pasjetues, prindërit, vëllezërit e motrat, gjyshja e gjyshi si dhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit dhe kur mungonin këta trashëgimtarë në trashëgim thirrej shteti. Gjyshja dhe gjyshi janë përfshirë në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë, pas ndryshimeve që i janë bërë Dekretit mbi Trashëgiminë më ligjin nr.3169 dt.26.10.1960.[135] Sipas rregullave të përmbajtura në dekret, trashëgimtarët ligjorë trashëgonin sipas kësaj radhë: -në radhë të parë, trashëgonin fëmijët, bashkëshorti dhe prindërit e paaaftë për punë.[136] Në radhë të dytë, trashëgonin bashkëshorti (kur ishte trashëgimtarë i vetëm i radhës së parë), prindërit e aftë për punë, si dhe personat e paaaftë për punë të cilët kishin jetuar si anëtarë të familjes më trashëgimlënësin 1 vit para vdekjes së tij dhe ishin në ngarkim të tij. Në këtë rast, bashkëshortit i ndahej ½ e pasurisë trashëgimore, ndërsa midis trashëgimtarëve tjerë nuk bëhej dallime, atyre trashëgimia u ndahej në pjesë të barabarta.[137]

Në radhë të tretë, trashëgonin personat e paaftë për punë (kur ishin trashëgimtarë të vetëm të radhës së dytë), vëllezërit dhe motrat si dhe gjyshërit e trashëgimlënësit.[138] Në radhë të katërt, trashëgonte shteti.[139] Për dallim nga legjislacioni trashëgimor i mëparshëm, zotësinë për të bërë testament, dekreti ju ka njohur edhe personave nën moshën 18 vjeçare kur ishin të martuar dhe kishin zotësi veprimi.Gjithashtu, zotësinë për të bërë testament dekreti ju ka njohur edhe të miturve nga mosha 14-18 vjeç, për pasurinë e fituar më punën e tyre të pavarur. Më dekret fillimisht njihej vetëm forma e testamentit noterial, kurse në vendet ku nuk kishte zyrë noteriale njihej edhe testamenti i vërtetuar nga kryetari ose sekretari i këshillit popullor të fshatit ose të qytetit, si dhe testamenti i vërtetuar nga komandanti i repartit ushtarak ose drejtori i spitalit. Kurse, më vonë më ndryshimet e bëra në v.1960, më dekret u rregullua edhe forma e testamentit

[134] N. Biçoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë.Fq.38
[135] Shih A.Nathanali, & A.Papuli (1961)Disa çështje mbi pronësinë dhe trashëgiminë.Tiranë.Fq.96
[136] Dekreti nr.1892, datë 05.07.1954 "Mbi trashëgiminë", shih nenin 21
[137] Po aty, shih nenin 22
[138] Dekreti nr.1892, datë 05.07.1954 "Mbi trashëgiminë",shih nenin 23
[139] Po aty, shih nenin 24

ollograf apo të shkruar nga vetë testatori.[140] Vlen të ceket se dekreti, ka përmbajtur dispozita edhe në lidhje më trashëgiminë ligjorë për ekonomitë bujqësore.Sipas rregullave të përmbajtura në dekret, trashëgimia mbi pasurinë e përbashkët të familjes bujqësore çelej vetëm kur vdiste anëtari i fundit i familjes bujqësore dhe lenia më testament e tokës ishte e ndaluar.[141]

1.5.4. Rregullimi i trashëgimisë sipas Kodit Civil Shqiptar të vitit 1982

Kodi Civil i Shqipërisë i vitit 1982 gjegjësisht Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, është miratuar më 26.6.1981, dhe ka hyrë në fuqi më 1 janar 1982.[142] Karakteristike për Kodin Civil të vitit 1982 është se i njihej fuqia prapavepruese dhe aplikohej edhe për trashëgimitë e hapura para hyrjes në fuqi të tij, më përjashtim të rastit kur trashëgimia ishte ndarë përfundimisht midis trashëgimtarëve.[143] Instituti i trashëgimisë në Kodin Civil të vitit 1982, nuk është trajtuar si institut i veçantë i të drejtës civile, por si institut i të drejtës së pronësisë, përkatësisht institucioni i trashëgimisë është trajtuar në kreun e tretë të kodit ku flitej për mënyrat e fitimit të pronësisë (në nenet 94-119). Është më rëndësi të përmendet se më Kushtetutën e vitit 1976, në Shqipëri e gjithë prona private mbi sendet e paluajtshme kishte kaluar në pronësi shtetërore, kështu që e drejta e individit për të trashëguar pronën ishte kufizuar shumë.[144]Pra,individit i lejohej të linte në trashëgim dhe të trashëgonte vetëm pronën e luajtshme. Për këtë edhe numri i dispozitave referuar rregullimit të institutit të trashëgimisë si dhe instituteve të tjera civile në Kodin Civil të vitit1982, ishte i kufizuar krahasuar më dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929, apo më dispozitat e Dekretit mbi Trashëgiminë. Njëjtë si legjislacioni trashëgimore i mëparshëm edhe Kodi Civil i vitit 1982, ka njohur dy forma të trashëgimisë: trashëgiminë më ligj dhe trashëgiminë më testament. Mirëpo, disa çështje lidhur më trashëgiminë ligjore dhe testamentare që rregulloheshin nga legjislacioni i mëparshëm, Kodi Civil i vitit 1982, nuk i ka trajtuar fare (p.sh institutin e barrës) ose i ka trajtuar në mënyrë të përgjithësuar (p.sh. institutin e padenjësisë).Në lidhje më trashëgiminë ligjore, Kodi Civil i vitit 1982 përcaktonte se mund të thirren në trashëgim trashëgimtarët ligjorë deri në shkallën e tretë. Përkatësisht,sipas nenit 103 të kodit si trashëgimtarë ligjorë janë thirrur: fëmijët dhe fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti pasjetues, prindërit, vëllezërit e motrat si dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të

[140] Shih N.Biçoku (1995) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë.Tiranë.Fq.27
[141] Po aty.Fq.27
[142] Po aty.Fq.28
[143] A. Nuni & L. Hazneziri (2010) E Drejta Civile (Trashëgimia).Tiranë.Fq.352
[144] Shih J. Latifi (2009) E Drejta Civile (Pjesa e Përgjithshme).Tiranë.Fq.20

paravdekur, gjyshi e gjyshja si dhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, e në mungesë të këtyre në shkalllën e katërt në trashëgimi thirrej shteti. Pra,rrethi i trashëgimtarëve ligjorë ishte më i kufizuar se në Kodin Civil të vitit 1929.Thirrja e trashëgimtarëve në trashëgim bëhej sipas kësaj radhë: -në radhë të parë, thirreshin në trashëgim fëmijët, bashkëshorti pasjetues dhe prindërit e paaftë për punë të trashëgimlënësit;[145]-në radhë të dytë, thirreshin në trashëgim bashkëshorti pasjetues (kur nuk kishte trashëgimtarë të tjerë të radhës së parë) dhe prindërit e aftë për punë të trashëgimlënësit, si dhe personat e paaftë për punë të cilët të paktën një vit para vdekjes së trashëgimlënësit, jetonin me të si anëtarë të familjes dhe ishin në ngarkim të tij. Përjashtimisht bashkëshortit që merrte ½ e trashëgimit,të gjithë trashëgimtarëve tjerë trashëgimia u ndahej në pjesë të barabarta.[146]- në radhë të tretë, thirreshin në trashëgim personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit (kur nuk kishte trashëgimtarë të tjerë të radhës së dytë), gjyshi dhe gjyshja, vëllezërit dhe motrat, si edhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave të paravdekur;[147] dhe në radhë të katërt, në mungesë të trashëgimtarëve ligjorë të radhëve paraprake, thirrej në trashëgim shteti.[148]Ndërsa, në rrethin e trashëgimtarëve testamentare,përveç trashëgimtarëve ligjorë hynin edhe ndërmarrjet, institucionet shtetërore, kooperativat bujqësore dhe organizatat shoqërore. Të aftë për të bërë testament konsideroheshin të gjithë personat më zotësi të plotë për të vepruar, pra personat mbi moshën 18 vjeç. Testamenti mund të bëhej në dy forma: më akt notarial ose të shkruhej nga vetë testatori (testamenti ollograf).[149]

[145] Ligj Nr.6340, datë 26.6.1981, Kodi Civil i Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë, shih nenin 104
[146] Neni 105
[147] Po aty, shih nenin 106
[148] Po aty, shih nenet 107-108
[149] Po aty, shih nenin 111, 112 dhe nenin 115

1.6. Rregullimi i trashëgimisë në Kosovë prej përiudhës se sundimit osman e deri më sot

1.6.1. Rregullimi i trashëgimisë në Kosovë gjatë sundimit osman e deri në vitin 1912

Sipas njohurive historike-juridike, sundimi osman në Kosovë është vendosur në vitin 1455 dhe ka zgjatur deri në vitin 1912. Gjate kësaj përiudhe, në Kosovë për rregullimin e marrëdhënieve juridike në përgjithësi dhe marrëdhënieve të trashëgimisë në veçanti, si burim kryesor thuhet se është aplikuar e drejta e sheriatit. Veç të drejtës se sheritatit, thuhet se janë aplikuar edhe ligjet shtetërore dhe rregullat e së drejtës zakonore. Në teorinë juridike, si ligje më të rëndësishme që janë aplikuar gjate sundimit osman në Kosovë përmenden: "Ligji mbi posedimin tokësor dt.7 ramazan 1274/1858; Ligji dt.7 muharrem 1284/1867 që ka të bëjë me trashëgiminë mbi tokën miri, Ligji për bartje dhe lënie të paluajtshmërive të 28 rexhepit 1291/1876; Ligji mbi tapitë i 8 xhamaziut evelit 1275/1859; Ligji për pyje i v.1869 si dhe Kodi Civil Turk (Mixhele) i nxjerrë gjate përiudhës 1867-1877".[150] Në lidhje më të drejtën zakonore, në teorine juridike dominion mendimi se nuk ka asnjë dyshim se gjatë sundimit osman nuk është zbatuar ajo nga popullata kosovare, madje thuhet se për disa marrëdhënie juridike, edhe vetë pushtuesi ka lejuar zbatimin e saj, përkatësisht disa krahinave thuhet se pushtuesi u kishte njohur një lloj autonomie. Kështu, krahinat të cilave u ishte pranuar një lloj autonomie marrëdhëniet e gjithmbarshme juridike (përfshirë edhe marrëdhëniet trashëgimore) i kanë rregulluar nëpërmjet të drejtës zakonore. Disa prej krahinave të tilla thuhet se ishin trevat malore të rajonit të Kosovës përkatësisht viset malore të Llapit, Drenicës, Gjakovës, të Sharrit etj.[151] Përkitazi më zbatimin e të drejtës zakonore gjatë sundimit osman shkruhet "shqiptarët njihnin (pranonin) vetëm të drejtën e tyre zakonore-KLD si një e drejtë fort e lashtë e pashkruar-kanunin" dhe se "shteti osman kurrnjëherë s'ka qenë i aftë të vendosë pushtetin e vet mbi gegët e veriut".[152] Në lidhje më këtë profesor Statovci, shkruan se "në kohën e sundimit osman mund të flitet për një koekzistencë të së drejtës zakonore (KLD) dhe ligjeve shtetërore. Sipas tij, "në qytete e fshatra përreth kanë mbretëror në parim institucionet juridike turke, kurse në vise të brendshme (malore) mbretëronin institucionit e së drejtës zakonore (KLD)".[153] Edhe sipas prof. Elezi, e drejta zakonore e ka

[150] A. Aliu (2013) E Drejta Civile. Prishtinë. Fq. 147.
[151] E. Statovci (2009) Marrëdhëniet pronësore juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës. Prishtinë. Fq.123.
[152] Gibb-Bowen- Islamic Society and the West, vol. I, part.1-2, London 1974. Fq.165. (Cituar nga E. Statovci (2009) vepra e cituar më sipër. Fq.126).
[153] E. Statovci (2009) vepra e njëjtë. Fq.26.

ruajtur karakterin e burimit juridik edhe gjate sundimit osman, përkitazi më këtë çështje prof. Elezi shkruan "e drejta zakonore e Labërisë dhe ajo mbarëshqiptare nuk u asimilua, por në përmbajtje të saj ruajti karakterin origjinal shqiptar e kombëtar dhe vazhdoi të mbijetonte e të zbatohej në praktikë. Në rast se ajo do të ishte asimiluar gjatë pushtimit osman atëherë njerëzit do të detyroheshin të zbatonin vetëm sheriatin dhe të humbisnim edhe gjuhën shqipe, siç kanë humbur rreth 20 mijë gjuhë të ndryshme".[154] Nga kjo qe u parashtrua më lartë, mund të përfundojme se gjatë sundimit osman për rregullimin e marrëdhënieve juridike-civile, përfshirë edhe marrëdhëniet e trashëgimisë janë aplikuar paralelisht rregullat e së drejtës shtetërore turke (sheriati) dhe rregullat e së drejtës zakonore. Sipas profesor Aliut, e drejta e sheriatit dhe ligjet turke janë aplikuar si burime të së drejtës në Kosovë, jo vetëm gjatë përiudhës se sundimit osman, por për disa marrëdhënie juridike-civile (në veçanti për marrëdhëniet e trashëgimisë) janë aplikuar edhe më vonë për një kohë të gjatë, kurse si burim subsidiar kanë shërbyer deri në vitin 1945.[155] Në teorine juridike ka mendime se në krijimin e së drejtës zakonore ka pasur ndikim të rëndësishëm e drejta e sheriatit. Mirëpo, ky ndikim nuk ndihet në institucionin e trashëgimisë përkatësisht midis të drejtës zakonore dhe të drejtës së sheriatit janë të shprehura dallime të rëndësishme sa i përkët rregullimit të institucionit të trashëgimisë. Disa nga dispozitat e të drejtës së sheriatit dhe të drejtës zakonore për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë gjenden në kundërshtim të hapur njëra më tjetrën. Rregullimi i institucionit të trashëgimisë sipas të drejtës së sheriatit dhe të drejtës zakonore shqiptare, është trajtuar më lartë në këtë kapitull, andaj më qëllim që të mos përsëritemi nuk do lëshohemi edhe një herë në shpjegimin e tyre.Por konsiderojm se nuk është e tepërt të përmendim disa nga veçoritë kryesore dalluese. Karakteristikë për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë, sipas të drejtës së sheriatit ishte trajtimi jo i barabartë i fëmijëve meshkuj dhe femra të trashëgimlënësit si dhe i fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor. Sipas të drejtës së sheriatit, djemve të trashëgimlënësit u takonin pjesë më të mëdha të trashëgimisë sesa vajzave përkatësisht një djalë trashëgonte pjesë të pasurisë sa për dy vajza. Ndërsa, fëmijëve jashtëmartesor u njihej e drejta e kufizuar për të trashëguar, për faktin se fëmijët jashtëmartesor mund të trashëgonin vetëm në trashëgiminë e nënës dhe afërmve të saj nga gjinia e gjakut, por jo edhe në trashëgiminë e babait. Veçori tjetër karakteristikë për të drejtën e sheriatit ishte mosnjohja e parimit të përfaqësimit në trashëgimi.

[154] I. Elezi (2006) Kanuni i Laberisë. Tiranë. Fq.14.
[155] A. Aliu (2013) E Drejta Civile. Prishtinë. Fq. 148.

Kurse, rregullimi i marrëdhënieve të trashëgimisë sipas të drejtës zakonore shqiptare (KLD) karakterizohej nga pabarazia e plotë midis burrit dhe gruas, midis fëmijëve martesor meshkuj dhe femra si dhe midis fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor pavarësisht gjinisë. KLD, si trashëgimtarë ligjorë i ka njohur vetëm meshkujt, femrat i ka përjashtuar në tërësi nga trashëgimia, jo vetëm e babait por edhe e burrit. Pra, femrave sipas KLD, nuk i është njohur fare e drejta e trashëgimisë, as në cilësinë e fëmijës së trashëgimlënsit dhe as në cilësinë e bashkëshortës së trashëgimlënësit. Veç femrave, nga e drejta për të trashëguar KLD, i ka përjashtuar edhe djemtë jashtëmartesor të trashëgimlënësit.Pra, krahasuar më të drejtën zakonore, femrat dhe fëmijët jashtëmartesor sipas të drejtës së sheriatit kanë gëzuar pozitë më të favorshme.

1.6.2. Rregullimi i trashëgimisë në Kosovë në përiudhën 1912-1945

Pas përfundimit të sundimit osman në vitin 1912, e deri në vitin 1918, në Kosovë kanë sunduar shtete të ndryshme. Në teorinë juridike shkruhet se më përfundimin e sundimit osman në Kosovë në vitin 1912, një pjesë e Kosovës është vendosur nën sundimin e Mbretërisë Serbe, ndërsa një pjesë tjetër nën sundimin e shtetit malazez.[156]Kurse, në përiudhën 1915-1918 shkruhet se pjesa lindore e Kosovës është vendosur nën sundimin e Bullgarisë, kurse ajo perëndimore nën sundimin e Austrisë.[157] Secili prej sunduesve në Kosovë është përpjekur që të imponojë të drejtën e vet për rregullimin e marrëdhënieve të gjithëmbarshme juridike, përfshirë këtu edhe marrëdhëniet trashëgimore. Pra, gjate përiudhës 1912-1918, në Kosovë kanë vlejtur të drejta të ndryshme të imponuar nga pushtues të huaj. Gjatë kësaj përiudhe, veç akteve ligjore të imponuara nga pushtuesit e huaj, për rregullimin e marrëdhënieve trashëgimore si edhe të marrëdhënieve të tjera juridike-civile, thuhet se janë zbatuar edhe rregullat e së drejtës zakonore.[158] Ndërsa, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore në vitin 1918, Kosova ka rënë nën sundimin e Mbretërisë Serbe, tani rregullimi i marrëdhënieve juridike-civile bëhej sipas të drejtës serbe. Përkatësisht, për rregullimin e marrëdhënieve juridike-civile përfshirë edhe marrëdhëniet trashëgimore është zbatuar Kodi Civil Serb (i vitit 1844) dhe akte të tjera ligjore të mbështetura në kod. Duhet theksuar se Kodi Civil Serb i vitit 1844, në bazë të urdhërit të princit Milosh Obrenoviç është hartuar nga Jovan Haxhiq, duke u bazuar kryesisht në modelin e Kodit

[156] Obradović Milanović. Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1919-1941) Prishtinë, 1981. Fq.22 (Cituar nga A. Abdulla (2013) vepra e njëjtë. Fq. 152).
[157] E.Statovci. Ca çështje mbi burimet e së drejtës civile dhe mbi rregullimin e disa marrëdhënieve civile-juridike në KSA të Kosovës, Revista Përparimi, Nr.3/1976, Prishtinë,1976. Fq.314. (Cituar nga A.Aliu (2013) vepra e njëjtë. Fq. 152).
[158] Shih E. Statovci (2009) Marrëdhëniet pronësore juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës. Prishtinë. Fq.282.

të Përgjithshëm Austriak, të vitit 1811.[159] Nga shumë teoricientë të së drejtës është kritikuar hartuesi i kodit për shkak të mungesës së origjinalitetit, përkatësisht disa teoricientë shprehen se Kodi Civil Serb është vetëm një kopje e shkurtuar e Kodit Civil Austriak. P.sh., prof.Gams shkruan "Kodi Civil për Principatën gjegjësisht Mbretërinë e Serbisë ishte përkthim i shkurtuar i KCA. Ndërkaq ai nuk pati sukses as si përkthim e aq më pak si shkurtim".[160] Mirëpo, ka edhe shumë teoricientë në Serbi, të cilët nuk pajtohen me qëndrimin se KCS, është vetëm një kopje e KCA, teoricientët në fjalë ofrojnë argumente të ndryshme për të shpjeguar se KCS, në mase të madhe është origjinal. Një nga argumentet më të shpeshta që përdoret në mbështetje të qëndrimit se KCS, paraqet një krijim origjinal është fakti se KCA, ka përmbajtur 1502 nene, ndërsa KCS ka përmbajtur vetëm 950 nene.[161] Në përgjithësi në teorinë e së drejtës serbe dominon mendimi se KCS, është i ngjajshëm më KCA, mirëpo që KCS, përmbanë edhe shumë elemente të ndryshme të ndikuara nga e drejta zakonore serbe, e drejta kanonike, e drejta romake, madje thuhet se në kod hasen edhe gjurme të së drejtës së sheriatit.[162] Është më rëndësi të përmendet se hartuesi i KCS, nuk kishte arritur të shtrijë influencën e KCA, në rregullimin e institucionit të trashëgimisë dhe institucionit të familjes. Rregullimi i marrëdhënieve të trashëgimisë dhe marrëdhënieve familjare në KCS, mbështetej kryesisht në të drejtën zakonore serbe dhe të drejtën kishtare. Sipas të drejtës zakonore serbe, pozita e meshkujve në shoqëri ishte më e mirë se ajo e grave. Është më rëndësi të përmendet, se e drejta zakonore serbe, nuk u njihte të drejtën e trashëgimisë fëmijëve femra të trashëgimlënësit.Hadzic ishte përpjekur që të mos i inkorporojë në kod rregullat zakonore për rregullimin e institutit të trashëgimisë dhe familjes, e sidomos ato rregulla të cilat ishin diskriminuese ndaj femrës. Mirëpo, përpjekja e tij nuk u përkrah nga princi Milosh, i cili ishte që të ruhen traditat dhe zakonet serbe, sa i përkët çështjes së të drejtave të femrave. Për këtë arsye, në kod u inkorporuan shume rregulla zakonore të cilat diskriminonin femrën në çështjet e trashëgimisë dhe familjes.[163] Kjo çoi në pakënaqësi të madhe në mesin e intelektualëve serb dhe veçanërisht femrave, sidomos atyre të cilat banonin në vise urbane, të cilat nuk mund të pranonin idenë se vajzat e tyre do të jenë të privuara nga trashëgimia e tyre.

[159] Shih Prof.dr.Sima Avramovic (2014) *Serbian Law Between Roman-Byzantine and Austrian Tradition*s, Journal of International Philosophy. Fq.93.
[160] A. Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Universiteti i Kosovës në Prishtinë. Prishtinë. Fq.21.
[161] Shih Prof.dr Siniša Ognjanović & Darko S. Ognjanović (2011) "*Creation of the New Serbian Civil Code"* 2nd International Conference "Law, Economy and Management in Modern Ambience" Lemima 2011 Proceedings Vol.2 Belgrade, Serbia. Fq.19-20.
[162] Milena Pojac (2014) "Gaius, Hadzic and Occupatio of Wild Animals-Classical Roman Law in the Serbian Civil Code", Fundamina 20 (2) 2014 ISSN: Print 1021-545X, Unisa Press. Fq.739.
[163] Emilija Stanković (2014) "The Serbian Civil Code-The Fourth Codification in Europe" Fundamina 20 (2) 2014 ISSN: Print 1021-545X, Unisa Press. Fq.887.

Inkorporimi në kod i rregullës zakonore, e cila i përjashtonte nga trashëgimia fëmijët femra të trashëgimlënësit ishte kritikuar edhe nga komentuesi i parë i kodit Dimitrije Matic, i cili kishte deklaruar se është bërë një "padrejtësi e qartë" ndaj fëmijëve femra në çështjet e trashëgimisë. Kritikat e shumta serioze ndikuan që dy vjet pas ratifikimit të kodit, të formohej nga Këshilli një komision për rishikimin e ligjit të trashëgimisë. Megjithatë,përpjekjet për të ndryshuar kodin sa i përkët çështjes së trashëgimisë, nuk kishin arritur të sjellin ndonjë rezultat. Diskriminimi ndaj grave në çështjet e trashëgimisë dhe familjes, ka vazhduar për një kohë të gjatë.[164]Kodi Civil është zbatuar në Serbi, deri në vitin 1941.Përveç në cilësinë e vajzës së trashëgimlënësit, sipas KCS, femrave nuk u njihej e drejta e trashëgimisë as në cilësinë e bashkëshortës së trashëgimlënësit. Përkatësisht sipas KCS, bashkëshortës i njihej e drejta në trashëgimi, vetëm po që se trashëgimlënësi nuk linte trashëgimtarë ligjorë deri në shkallën e dhjetë.[165]KCS, përmbante edhe një sërë dispozita të tjera diskriminuese ndaj gruas. Kështu,sipas KCS, gruas nuk i njihej zotësia e plotë për të vepruar, përkatësisht gruaja në aspektin e zotësisë për të vepruar barazohej më një të mitur të rritur dhe për plotëfuqishmërinë e punëve të saj juridike kërkohej pëlqimi i burrit. Gruaja ishte e detyruar ti nënshtrohej burrit.[166]Pozita e gruas sipas KCS, ishte gati e ngjajshme më pozitën që gëzonte gruaja sipas të drejtës zakonore shqiptare. Duhet përmendur se perveç dispozitave të KCS, dhe dispozitave të tjera të mbështetura në të, në Kosovë gjate kohës se sundimit të Mbretërisë Serbe shkruhet se është zbatuar edhe e drejta zakonore.P.sh., prof.Aliu shkruan “e drejta zakonore aktualitetin e vet, si burim i së drejtës civile, jo vetëm që e ruajti edhe pas rënies nën sundimin e Serbisë, por tani popullsia edhe më hapët e kundërshtojë të drejtën shtetërore, sepse ajo nuk ishte në pajtim me marrëdhëniet-ekonomike të popullsisë shumicë të Kosovës”.[167] Ndërsa,prof.Statovci, shkruan se në këtë periudhë zbatimi i të drejtës zakonore në rregullimin e marrëdhënieve juridike-civile, veçanërisht nëpër fshatra kurrnjëherë nuk është vënë në pyetje.[168] Është interesante të përmendet se Kodi Civil Serb, nuk e përjashtonte zbatimin e të drejtës zakonore si burim i së drejtës në rastin kur çështja nuk rregullohej më dispozita ligjore, apo kur më dispozita ligjore udhëzohej që të zbatohej zakoni. Nga kjo rezulton se në kohën e sundimit të Mbretërisë Serbe në Kosovë dhe në vendet e tjera ku vlenin dispozitat e KCS, e

[164] Emilija Stanković (2014) “The Serbian Civil Code-The Fourth Codification in Europe” Fundamina 20 (2) 2014 ISSN: Print 1021-545X, Unisa Press. Fq.888

[165] Владимир Козар & Ирена Радумило (2015) НАСЛЕДНОПРАВНИ ПОЛОЖАЈ ЖЕНЕ СУПРУЖНИКА У СРБИЈИ ОД СРПСКОГ ГРАЂАНСКОГ ЗАКОНИКА ДО ДАНАС, Монографска студија, УДК 316.811/.815:347.65/.58 Култура полиса, год. XII (2015), бр. 27, стр. 367-380. Fq.370.

[166] Po aty. Fq. 370

[167] A. Aliu (2013) E Drejta Civile. Prishtinë. Fq.153.

[168] E. Statovci (2009) Marrëdhëniet pronësore juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës. Prishtinë. Fq. 282.

drejta zakonore është zbatuar si burim subsidiar i së drejtës.[169] Për përiudhën 1941-1945 është vështirë të flitet në mënyrë të saktë për burimet juridike të cilat janë zbatuar në Kosovë për rregullimin e marrëdhënieve juridike në përgjithësi, sepse gjatë kësaj përiudhe në Kosovë kanë sunduar shtete të ndryshme në pjesë të ndryshme të vendit. Gjate kësaj përiudhe, Kosova ishte e ndarë në tri pjesë: një pjesë ishte nën sundimin e Bullgarisë, një pjesë nën sundimin e Gjermanisë dhe pjesa më e madhe ishte nën sundimin e Italisë. Gjatë kësaj përiudhe, në teorinë juridike thuhet se për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë janë zbatuar rregullat e së drejtës zakonore dhe të drejtës së sheriatit. Madje, thuhet se edhe vet pushtuesit në mënyrë të heshtur kishin pranuar që të zbatohet e drejta zakonore.[170] Ndërsa, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945, Kosova ishte vendosur nën sundimin e Jugosllavisë përkatësisht Serbisë.

1.6.3. Rregullimi i trashëgimisë në Kosovë në përiudhën 1945-1990

Përiudha e pas Luftës së Dytë Botërore, në Jugosllavi karakterizohet më nxjerrjen e ligjeve të shumta më qëllim të ndërtimt të rendit të ri juridik. Ndër ligjet më të rëndësishme, që u nxjerr në këtë përiudhe, përmendet ligji mbi shpalljen e pavlefshme të dispozitave ligjore të nxjerra para 6 prillit 1941 dhe gjatë kohës së okupimit armiqësor. Ky ligj u nxjerr më 25 tetor 1946 dhe pati rëndësi të posaçëm sepse shënoj ndërprerjen e kontinuitetit të së drejtës që aplikohej në ish- Mbretërinë Serbe.[171] Përjashtimisht sipas ligjit në fjalë, në mungesë të dispozitave të reja, lejohej edhe zbatimi i dispozitave nga legjsialcioni i mëparshëm (para dates 6 prill 1941) nëse nuk ishin në kundërshtim më rendin e ri juridik.[172] Për rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë në Jugosllavi nuk është nxjerrë ndonjë akt i posaçëm juridik, deri në vitin 1955. Rregullimi i marrëdhënieve juridike-trashëgimore, deri në këtë kohë supozohet që bëhej sipas dispozitave ligjore të legjilacionit të vjetër, të cilat nuk ishin në kundërshtim më rendin e ri juridik. Vlerësimin, se cilat dispozita ligjore ishin në kundërshtim ose jo më rendin e ri juridik, e bënin gjykatat. Në teorinë juridike, ka mendime se lënia e vendosjes gjykatës se cilat dispozita ose jo gjenden në kundërshtim më rendin e ri juridik "ka shërbyer si bazë për marrjen e vendimeve të ndryshme mbi të njëjtën çështje dhe për diskriminim të shqiptarëve". Duke qenë se

[169] E. Statovci (2009) Marrëdhëniet pronësore juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës. Prishtinë. Fq. 129.
[170] A. Aliu (2013).vepra e njëjtë. Fq. 160.
[171] A. Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Universiteti i Kosovës në Prishtinë. Prishtinë. Fq.27.
[172] Shih E. Statovci (2009) vepra e njëjtë. Fq.160.

edhe funksionin e gjyqtarëve e ushtronin kryesisht gjyqtarët serb dhe ata malazezë.[173] Për dallim nga legjislacioni trashëgimor i mëparshëm (sidomos nga KCS), rregullimi i marrëdhënieve trashëgimore sipas "Ligjit për Trashëgimi" (tani e tutje LT) të vitit 1955, bëhej duke u bazuar në parimin e barabarësisë se të gjithë personave pa dallime gjinore. Karakteristikë tjetër për rregullimin e marrëdhënieve trashëgimore, sipas LT, ishte liria e disponimit më testament. Sipas LT, testamenti përbëntë bazën juridike kryesore të thirrjes në trashëgimi, ashtu që trashëgimia më ligj aplikohej vetëm në rast se trashëgimlënësi nuk linte testament apo kur testamenti i lënë nuk vlente. Të aftë për të bërë testament, LT, i konsideronte të gjithe personat të cilët kishin mbushur moshën 16 vjeç dhe të cilët gëzonin aftësinë mendore në momentin e bërjës së testamentit.[174] LT, ka njohur këto lloje të testamentit: a) tetamentin e shkruar më dorë (ollografik) (neni 68 i LT); b) testamentin me shkrim para dëshmitarëve (alografik) (neni 69 i LT); c) testamentin gjyqësor (neni 71-72 i LT); d) testamentin në anije (neni 76 i LT); e) testamentin ushtarak (neni 77 i LT) si dhe g) testamentin gojor (neni 78 i LT).[175] Trashëgimlënësi nuk ishte i lirë tërësisht në bërjen e dispozitave në testament, për arsye se ai nuk mund ti përjashtonte nga disponimi më testament një grup të trashëgimtarëve ligjorë të cilëve u takonte pjesa e domosdoshme.Trashëgimtarët ligjorë të cilëve përherë u takonte pjesa e domosdoshme ishin të afërmit e ngushtë të trashëgimlënësit, si pasardhësit e trashëgimlënësit dhe të adoptuarit e tij, prindërit e trashëgimlënësit si dhe bashkëshorti pasjetues. Ndërsa, trashëgimtarëve të tjerë ligjore, u njihej e drejta në pjesën e domosdoshme vetëm nëse ishin të paaftë për punë dhe nuk kishin mjete të domosdoshme për jetesë.[176]Duhet theksuar që si trashëgimtarë ligjorë njiheshin pasardhësit e trashëgimlënësit, bashkeshorti pasjetues, prindërit e trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre, gjyshërit dhe gjyshet dhe të pasardhësit e tyre. Thirrja e trashëgimtarëve ligjorë në trashëgimi bëhej sipas radhës së përcaktuar më ligj kësisoj: në radhën e parë thirreshin në trashëgimi bashkeshorti pasjetues dhe pasardhësit e trashëgimlënësit; në radhën e dytë thirreshin prindërit e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre si dhe bashkëshorti pasjetues në rastin kur trashëgimlënësi nuk linte pasardhës[177]; si dhe në radhën e tretë thirreshin gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre. Trashëgimtarëve ligjorë të së njëjtës radhë,trashëgimia u ndahej në pjesë të barabarta. Kështu,bashkëshorti pasjetues

[173] H.Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore, Prishtinë.Fq.12.
[174] A. Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Universiteti i Kosovës në Prishtinë. Prishtinë. Fq.370.
[175] Po aty. Fq.372-373.
[176] Po aty. Fq.378.
[177] Po aty. Fq. 376.

trashëgonte në mënyrë të barabartë më të pasardhësit e trashëgimlënësit dhe të adoptuarit e tij. Fëmijëve martesor të trashëgimlënësit,u takonte e drejta e barabartë në trashëgimi pavarësisht nëse ishin fëmijë meshkuj apo femra. Edhe fëmijëve të adoptuar, u njihej e drejta e barabartë në trashëgimi më fëmijët martesor, përveç nëse më marrëveshjen mbi themelimin e adoptimit parashihej ndryshe. Ndërsa, fëmijëve jashtëmartesor, u njihej e drejta e barabartë në trashëgimi më fëmijët martesor, vetëm në rast se ishin bërë fëmijë të martesës më kurorëzimin e prindërve ose kur u ishte pranuar atësia më vendim të gjykatës apo kur babai e kishte pranuar atësinë ndaj tyre para ofiqarit ose e kishte përmendur në testament. Nëse fëmijëve jashtëmartesor nuk u ishte njohur atësia në ndonjërën prej mënyrave të përmendura më sipër, atyre nuk u takonte asnjë e drejtë në trashëgiminë e babait. Fëmijëve jashtëmartesor, u takonte përherë e drejta vetëm në trashëgiminë e nënës dhe të afërmve të saj.[178] Dispozitat e Ligjit për Trashëgimi të vitit 1955, janë zbatuar në Kosovë deri në vitin 1974, kur Kosova për herë të parë nxjerri ligjin e vet për trashëgimi. Duhet theksuar se më kushtetutën e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë të vitit 1946, Kosova nuk ka pasur kompetencë legjislative, që do të thotë Kosova nuk ka pasur të drejtë për të nxjerr ligje. Për këtë arsye rregullimi i marrëdhënieve juridike përshirë edhe marrëdhëniet juridike-civile në Kosovë deri në vitin 1971, bëhej më ligjet e nxjerra nga Republika Serbe pjesë e cilës ishte Kosova. Më nxjerrjen e amandamenteve të kushtetutës së RFPJ në vitin 1963, dhe miratimin e tyre në vitin 1971, nga kuvendi i RFPJ, Kosova për herë të parë fitoi të drejtën për të nxjerr ligje.[179] Kështu, në vitin 1974 Kosova miratoi Kushtetutën më të cilen u vendosen bazat apo parimet themelore në të cilat do të bazohej rendi i ri juridik.[180] Tani rendi juridik mbështetej në ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës.Një ndër ligjet më të rëndësishme, të cilat u nxjerren në këtë kohë për rregullimin e marrëdhënieve juridike-civile konsiderohet edhe Ligji për Trashëgimi i dt.30.12.1974 (Fletorja zyrtare KSAK nr.43/1974), i cili u plotësua dhe ndryshua dy herë përkatësisht më dt.25.10.1978 dhe më dt.11.07.1979.[181]Në mënyrë të njëjtë si më ligjin e mëparshëm për trashëgimi, edhe më këtë ligj garantohej parimi i barabarësisë i të gjithe personave përkatësisht si meshkujve ashtu dhe femrave, u njihej e drejta e barabartë në trashëgimi.Në përgjithësi dispozitat e ligjit në fjalë, nuk dallonin shumë nga dispozitat e ligjit paraprak të trashëgimisë. Ky ligj është zbatuar deri në vitin 2004. Autonomia e Kosovës, e njohur më Kushtetutën e vitit 1971, u rrënua në vitin 1990, më rrugë joligjore nga

[178] A. Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Universiteti i Kosovës në Prishtinë. Prishtinë. Fq. 377.
[179] A.Aliu (2013) E Drejta Civile. Prishtinë. Fq.175.
[180] Po aty.Fq.177.
[181] Po aty.Fq.186.

Serbia, e cila nëpërmjet miratimit të akteve të ndryshme kundërligjore, arriti të vendos kontrollin e plotë mbi të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Kosovë.[182] Kjo gjendje zgjati deri në përfundimin e luftës në vitin 1999, kur Kosova u vendosë nën administrimin e përkohshëm të UNMIKU-ut, dhe okupatori serb u detyrua të largohet nga Kosova. Më miratimin e rregullores së UNMIKU-ut, nr.1999/24 për ligjin e aplikueshëm në Kosovë, u shënua ndërprerja e kontinuitetit juridik të Kosovës më Serbinë. Tani Kosova filloj të ndërtoj sistemin e vet juridik të pavarur, mirëpo për shkak të pamundësisë që për të gjitha fushat përnjëherë të nxirren ligje, më rregulloren e përmendur më sipër u vendosë që përveç rregulloreve të UNMIKU-ut, deri në nxjerrjen e ligjeve të reja nga Kuvendi i Kosovës të zbatohen edhe ligjet jodiskriminuese, të cilat kanë qenë në fuqi deri në vitin 1989. Për këtë arsye, Ligji për Trashëgimi i nxjerrë në vitin 1974, (dhe ndryshuar në vitin 1978 dhe 1979) u zbatua si burim kryesor për rregullimin e trashëgimisë deri në vitin 2004.Në vitin 2004 Kuvendi i Kosovës miratoi "Ligjin për Trashëgimi" (Nr 2004/26) i cili aktualisht është në fuqi. Nxjerrja e këtij ligji shënoi një hap të rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve të trashëgimisë duke u bazuar në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Në këtë ligj gjen zbatim të plotë parimi i barabarësisë se të gjithe personave, duke u garantuar atyre të drejtën e barabartë në trashëgimi pavarësisht gjinisë, races apo kombësisë. Ky parim është i shprehur në nenin 3 par.1 ku thuhet "të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi" dhe në par.2 të nenit të përmendur ku thuhet "Të huajit janë të barabartë në trashëgimi më kosovarët më kusht reciprociteti.Reciprociteti prezumohet".Pra, parimi i barazisë në marrëdhëniet e trashëgimisë respektohet jo vetëm ndaj shtetasve kosovar, por edhe ndaj shtetasve të huaj më kusht të ekzistimit të reciprocitetit.

[182] A.Aliu (2013) E Drejta Civile. Prishtinë.Fq. 196.

Përfundimi

Në këtë pjesë të punimit lidhur më historikun e zhvillimit të institucionit të trashëgimisë kemi arritur në disa përfundime të rëndësishme. Së pari, analizimi i institucionit të trashëgimisë në aspektin historik vënë në dukje faktin e pakontestueshëm se ky institucion përbënë një nga institucionet më të vjetra dhe më zhvilluara të së drejtës. Institucioni i trashëgimisë, gjithashtu, përbënë edhe një nga institucionet më të rëndësishme të së drejtës civile, për faktin se është i vetmi institucion i cili mundëson bartjen e të drejtave dhe detyrimeve të karakterit pasuror të personit të vdekur tek personat e tjerë gjegjësisht tek trashëgimtarët. Nëpërmjet rregullimit juridik të trashëgimisë mundësohet që në baza të rregullta juridike, të realizohet bartja e të drejtave dhe detyrave të karakterit pasuror, të trashëgimlënësit tek trashëgimtarët. Institucioni i trashëgimisë ka gjetur rregullim juridik që në Kodin e Hamurabit. Karakteristikë e rregullimit të marrëdhënieve të trashëgimisë sipas Kodit të Hamurabit, ishte diskriminimi i fëmijëve femra të trashëgimlënësit dhe bashkëshortës si dhe trajtimi jo i barabartë i fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor të trashëgimlënësit.Sipas rregullave të Kodit të Hamurabit , vajzat dhe bashkëshortja e trashëgimlënësit, nuk hynin në radhët e trashëgimtarëve ligjorë. Edhe në antikitetin grek, femrave nuk u njihej e drejta e trashëgimisë. Madje, as në rastet kur nuk ekzistonte asnjë mashkull i familjes, femrat nuk kanë pasur të drejtë të trashëgojnë. Një rregullim i veçantë dhe i rëndësishëm i institutit të trashëgimisë gjendet në të drejtën romake. Shumë rregulla të trashëgimisë, të vendosura nga e dejta romake vlejnë edhe sot në sistemet juridike të shumë shteteve, veçanërisht shteteve më sistem juridik kontinental të së drejtës. Rregullat e institutit të trashëgimisë në të drejtën romake bënin pjesë në mënyrat për fitimin e pronësisë. Veçori e rregullimit të marrëdhënieve të trashëgimisë, sipas të drejtës romake ishte aplikimi i testamentit si mënyrë kryesore e ndarjes së trashëgimisë. Përkatësisht, sipas të drejtës romake testamenti përbëntë bazën juridike kryesore të trashëgimit, në atë mënyrë që trashëgimia ligjore aplikohej vetëm në mungesë të testamentit. Liria e trashëgimlënësit (testatorit) për të disponuar më testament ishte e kufizuar, për faktin se ai nga trashëgimia e lënë më testament nuk mund ti përjashtonte një grup të trashëgimtarëve ligjorë, të cilëve u takonte pjesa trashëgimore e domosdoshme. Një veçori tjetër e rregullimit të trashëgimisë në të drejtën romake, ishte aplikimi i trashëgimisë në sende të caktuara apo pasuri të veçanta i quajtur trashëgim (suksedim) singular. Mënyra më e rëndësishme e trashëgimit apo suksedimit singular ishte legu. E drejta romake luajti një rol të rëndësishëm në sistemet juridike të shumë shteteve, jo vetëm gjatë periudhës feudale, por

dominimi i të drejtës romake vazhdoi edhe më tej në përiudhën e shtetit borxhez. Përiudha e shtetit borxhez karakterizohet më nxjerrjen e ligjeve të shumta gjegjësisht kodeve për rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme shoqërore dhe ekonomike. Një ndër kodet civile më të rëndësishme të kësaj përiudhe konsiderohet Kodi Civil Francez (1804), i cili mbështetej kryesisht në të drejtën romake. Veçori e rregullimit të trashëgimisë, sipas KCF ishte: aplikimi i dy formave të trashëgimisë më ligj dhe më testament; barabarësia e plotë midis fëmijeve martesor të trashëgimilënësit pavarësisht gjinisë; mospërfshirja e bashkëshortit pasjetues në radhët e trashëgimtarëve ligjorë përkatësisht bashkëshortja pasjtuese mund të trashëgonte vetëm në rastin kur trashëgimlënësi nuk linte trashëgimtarë ligjorë deri në brezin e 12-të. Një rregullim i rëndësishëm i institutit të trashëgimisë gjendet edhe ne Kodin Civil Shqiptar të vitit 1929. Në KCSH (të v.1929) instituti i trashëgimisë gjente një rregullim të posaçëm dhe mjaft të detajuar duke filluar nga kuptimi dhe koha e çeljes së trashëgimisë, rrethi i trashëgimtarëve ligjorë, trashëgimia më testament etj. Edhe legjislacioni jugosllav gjegjësisht serb i cili është zbatuar në Kosovë, deri në vitin 1974 i ka kushtuar rëndësi të posaçme rregullimit të trashëgimisë.

KAPITULLI II

TRASHËGIMIA LIGJORE NË KOSOVË DHE NË DISA SHTETE NË RAJON- VËSHTRIM KRAHASIMOR

2. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit

Në këtë kapitull trajtohet trashëgimia ligjore në Kosovë, në një vështrim krahasues më disa vende në rajon. Së pari, në këtë kapitull trajtohen parimet e përgjithshme mbi trashëgiminë si: koha dhe vendi i çeljes së trashëgimisë; aftësia për të trashëguar; paaftësia për të trashëguar për shkak të padenjësisë gjegjësisht shkaqet e padenjësisë; heqja dorë nga trashëgimia, pasojat e heqjes dorë nga trashëgimia dhe anulimi i deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia. Më pas, në mënyrë të detajuar trajtohet rregullimi që gjen trashëgimia ligjore në legjislacionin kosovar, më ç'rast trajtohet rrethi i trashëgimtarëve ligjorë, mënyra e thirrjes në trashëgim e trashëgimtarëve ligjorë, e drejta e përfaqësimit (zëvendësimit) dhe e drejta e shtimit. Një trajtim i veçantë në këtë pjesë i kushtohet trashëgimisë së domosdoshme konkretisht të drejtave që i takojnë trashëgimtarëve të domosdoshëm në rastin kur cenohet pjesa trashëgimore e tyre e garantuar më ligj; si dhe shkaqeve për të cilat trashëgimtarit të domosdoshëm i pamundësohet që të trashëgojë për shkak të padenjësisë. Pas kësaj, trajtohet rregullimi i trashëgimisë ligjore gjegjësisht mënyrat apo radhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Maqedoni, Serbi, Kroaci, Slloveni, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Shqipëri. Edhe në këtë pjesë, gjithashtu, vëmendje e posaçme i kushtohet institutit të trashëgimisë së domosdoshme. Në përfundim të këtij kapitulli, parashtrohen ngjajshmëritë dhe dallimet kryesore të identifikuara në bazë të analizës krahasuese në Kosovë dhe shtetet e përfshira në studim, në lidhje më rregullimin e çështjeve më kryesore që ndërlidhen më trashëgiminë ligjore.

2.1. Parimet e përgjithshme mbi trashëgiminë

2.1.1. Kuptimi i trashëgimisë

Kuptimi i trashëgimisë në të shumtën e rasteve jepet më dispozita ligjore të përmbajtura në ligjet apo kodet civile,më të cilat rregullohet instituti i trashëgimisë gjegjësisht marrëdhëniet e trashëgimisë. Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, e jep kuptimin e trashëgimisë në nenin 1 par.2, sipas të cilit: "Trashëgimia është kalimi me ligj ose në bazë të testamentit i pasurisë (trashëgimit) së personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek një ose më shumë persona (trashëgimtarët ose legatarët), sipas rregullave të caktuara në këtë ligj." Ngjajshëm trashëgimia përkufizohet edhe nga Kodi Civil i Shqipërisë, në nenin 316 ku thuhet: "Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur, një ose më shumë persona (trashëgimtarë), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod". Ndërsa, Ligjet për Trashëgimi të vendeve tjera të përfshira në studim përkatësisht Ligji për Trashëgimi i Maqedonisë (LTMK) [183], Ligji për Trashëgimi i Serbisë (LTRS)[184], Ligji për Trashëgimi i Kroacisë (LTHR)[185],Ligji për Trashëgimi i Mal të Zi (LTME)[186], Ligji për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës (LTBH)[187] dhe Ligji për Trashëgimi i Sllovenisë (LTSI)[188] nuk e përcaktojnë kuptimin e trashëgimisë. Mirëpo, edhe më këto ligje sanksionohet shprehimisht rregulla se trashëgimia mund të fitohet në bazë të ligjit ose testamentit. Nga kjo rezulton që kalimi i pasurisë i personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek personat e tjerë (trashëgimtarët), sipas LTK ashtu sikurse edhe sipas ligjeve të vendeve tjera të përfshira në studim, realizohet në dy mënyra: a) sipas rregullave të parapara më ligj; dhe b) sipas vullnetit të trashëgimlënësit me anë të testamentit. Pra, më LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe më KCSH njihen dhe rregullohen dy forma të trashëgimisë: a) trashëgimia testamentare dhe b) trashëgimia ligjore. Është e rëndësishme të theksohet se LTK (ashtu sikurse edhe ligjet e tjera të analizuara[189]) nuk e përjashton mundësinë e zbatimit paralel të dy llojeve të trashëgimisë. Pra, një person mund të trashëgojë një pjesë të pasurisë sipas bazës ligjorë të trashëgimisë dhe një pjesë sipas bazës së trashëgimisë

[183] Ligji për Trashëgiminë i Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë Nr 47/1997, 18/2001), shih nenin 6.
[184] Ligji për Trashëgiminë i Serbisë (Gazeta Zyrtare e Serbisë Nr 46/1995, 101/2003-18, 6/2015), shih nenin 2.
[185] Ligji për Trashëgiminë i Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Kroacisë 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15), shih nenin 4 par.3.
[186] Ligji për Trashëgiminë i Malit të Zi (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi Nr 74/2008), shih nenin 6.
[187] Ligji për Trashëgiminë i Bosnjës dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjes dhe Hercegovinës Nr 2/98, 39/04 i 73/05), shih nenin 6.
[188] Ligji për Trashëgiminë i Slovenisë (Gazeta Zyrtare e Slovenisë Nr 15/76, 23/78; 17/91, 13/94, 40/94, 117/00, 67/01, 83/01, 31/13 dhe 63/16), shih nenin 7.
[189] J.Đorđević Crnobrnja, Legal Inheritance in the Domain of Ideal and Real. UDC: 347.65:39(497.11)"19" 392.37(497.11)"19. Bulletin of the Institute of Ethnography SASA LVI I (2). Fq.113.

testamentare.[190] Edhe sa i përkët raportit midis dy bazave të thirrjes në trashëgimi, LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH përmbajnë rregullen e njëjtë se trashëgimia testamentare ka përparësi në raport më trashëgiminë ligjore, në atë mënyrë që trashëgimia ligjore zbatohet vetëm në rastin kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, apo kur ka lënë testament vetëm për pjesë të pasurisë së tij ose kur testamenti i lënë sipas ligjit konsiderohet tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.

2.1.2. Koha dhe vendi i çeljes së trashëgimisë

Në teorinë juridike dhe në praktikë më çelje të trashëgimisë nënkuptohet se janë vërtetuar rrethanat gjegjësisht faktet juridike, të cilat përcaktojnë lindjen e të drejtës së trashëgimisë. Vdekja përbënë faktin juridik i cili shërben për çeljen e trashëgimisë.[191] Është parim i njohur dhe i pranuar nga mbarë legjislacionet, se trashëgimia çelet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Këtë rregull LTK, e parashikon shprehimisht në nenin 124 ku thuhet: "Me vdekjen e personit hapet trashëgimi i tij. Të njëjtin efekt e ka edhe shpallja e personit si të vdekur." Ngjajshëm shprehet edhe KCSH, në nenin 318 ku thuhet: "Trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi. Në rastin e shpalljes së personit të vdekur, trashëgimia çelet ditën kur, sipas vendimit gjyqësor, personi konsiderohet i vdekur." Edhe LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, përmbajnë rregullën e njëjtë se trashëgimia çelet më vdekjen e personit ose më shpalljen e tij si të vdekur.[192] Nga kjo rezulton që trashëgimia çelet në kohën kur vërtohet njëri prej këtyre dy fakteve: vdekja e personit ose shpallja e personit të zhdukur për të vdekur. Vdekja e personit vërtetohet më aktvdekje të lëshuar nga ofiqari, ndërsa shpallja e personit të zhdukur për të vdekur vërtetohet më aktvendim të gjykatës.[193]Më kohën e çeljes së trashëgimisë lidhen pasoja të caktuara juridike. -Së pari, në bazë të kohës së çeljes së trashëgimisë përcaktohet rrethi i personave që do të trashëgojnë, pra përcaktohet rrethi i trashëgimtarëve, së bashku më të drejtat pasurore dhe detyrimet që do u kalojnë atyre. Trashëgimtarëve u kalojnë vetëm ato të drejta dhe detyrime të karakterit pasuror, të cilat i kanë takuar trashëgimlënësit në momentin e vdekjes. - Së dyti, më kohën e çeljes së trashëgimisë është e lidhur edhe ecja e afateve të ndryshme siç janë: afati për heqjen dorë nga trashëgimia[194], afati për parashkrimin e së drejtës për kërkimin e pasurisë trashëgimore, afati për paraqitjen e kërkesës për zvogëlimin e disponimit më testament

[190] A.Aliu (2013) E Drejta Civile, Prishtinë. Fq.49.
[191] N.Biqoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Onufri. Tiranë.Fq.37.
[192] Shih LTMK (neni 120); LTRS (neni 206); LTBH (neni 155); LTHR (neni 122); LTSl (neni 123); LTME (neni 124 dhe 125).
[193] H.Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore, Prishtinë. Fq.39.
[194] Shih N.Biqoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.Fq.60.

ose kthimin e dhurimeve etj.Ndërsa, sa i përkët vendit të çeljes së trashëgimisë, LTK, nuk përmbanë ndonjë dispozitë ligjore.Vendi i çeljes së trashëgimisë në Kosovë, rregullohet më dispozitat e Ligjit për Proceduren Jokontesimore. Sipas rregullave të përmbajtura në LPJK, trashëgimia çelet në vendin ku trashëgimlënësi ka patur vendbanimin e tij të fundit ose vendqendrimin. Ndërsa, në rastin kur trashëgimilënësi nuk ka pasur as vendbanim dhe as venqendrim në Kosovë, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa me e madhe e saj.[195] Vendi i çeljes së trashëgimisë përcaktohet në mënyrë të njëjtë edhe nga KCSH, në nenin 318/1 ku thuhet: "Trashëgimia çelet në vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj". Edhe sipas legjislacionit pozitiv në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, trashëgimia çelet në vendin ku trashëgimlënësi ka patur vendbanimin e tij të fundit ose kur vendbanimi i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa me e madhe e saj.[196] Edhe më vendin e çeljes së trashëgimisë, lidhen pasoja të caktuara juridike. Përkatësisht, në bazë të vendit të çeljes së trashëgimisë përcaktohet gjykata e cila do të jetë kompetente që të caktojë masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore. Mandej, në bazë të vendit të çeljes së trashëgimisë përcaktohet edhe kompetenca e organit, para të cilit mund të bëhet heqja dorë nga trashëgimi etj.[197]

2.1.3. Aftësia për të trashëguar

Në teorinë juridike më aftësinë për të trashëguar nënkuptohet ajo kategori juridike, e cila personit i cili thirret si trashëgimtarë (ligjor apo testamentar), i një pasurie trashëgimore i jep mundësinë që ta trashëgojë atë.[198] Në LTK ashtu sikurse edhe në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe në KCSH, në mënyrë pershtatshmërisht të njëjtë është sanksionuar rregulla që të aftë për të trashëguar janë: a) Personat të cilët janë gjallë në momentin e çeljes së trashëgimisë; si dhe b) Personat të cilët janë zënë (konceptuar) para vdekjes së trashëgimlënësit dhe kanë lindur gjallë.[199] Pra, ligji u jep mundësinë për të trashëguar jo vetëm personave të cilët e mbijetojnë trashëgimlënësin, por edhe personave të cilët janë zënë para vdekjes së

[195] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore i Republikës së Kosovës, shih nenin 128
[196] Shih LPJK i Maqedonisë (neni 129); LPJK i Serbisë (neni 88); LPJK i Malit të Zi (neni 95); LTBH (neni 201); LTHR (neni 177); LTSI (neni 177).
[197] N. Biqoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Onufri. Tiranë. Fq.39
[198] J. Latifi (2006) E Drejta e Trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë. Fq.30.
[199] Shih LTK (neni 7); LTMK (neni 122); LTRS (neni 3); LTBH (neni 157); LTHR (neni 124); LTSI (neni 125); LTME (neni 126) dhe KCSH (neni 320).

trashëgimlënësit dhe kanë lindur gjallë. Nga kjo rezulton që aftësia për të trashëguar përcaktohet në bazë të faktit të ekzistimit të personit në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit ose faktit juridik të lindjes gjallë. Është e rëndësishme të ceket se përcaktimi i aftësisë për të trashëguar, mund të paraqitet si problem në rastin kur dy ose më shumë persona të cilët trashëgojnë njëri-tjetrin vdesin në të njëjtën kohë. Përkitazi më këtë rast, parashihen dy zgjidhje të ndryshme varësisht nga ajo nëse mund të përcaktohet ose jo radha e vdekjes së personave. Në rastin, kur mund të përcaktohet se cili prej personave ka vdekur më parë, atëherë personi që ka vdekur më vonë e trashëgon atë që ka vdekur më parë. Kjo për faktin, se trashëgimitë e tyre çelen në kohë të ndryshme.[200] Ndërsa, në rastin kur nuk ekziston asnjë fakt në bazë të të cilit mund të përcaktohet radha e vdekjeve, atëherë konsiderohet se të gjithë personat kanë vdekur në të njëjtën kohë dhe këta nuk e trashëgojnë njëri-tjetrin. Kjo rezulton nga neni 126 par.3 i LTK ku thuhet "Në qoftë se dy ose më shumë persona humbin jetën në të njëjtin aksident, ose kur nuk dihet rendi kronologjik i vdekjes së tyre, konsiderohet se asnjëri prej tyre nuk ka qenë i gjallë në çastin e hapjes së trashëgimisë së tjetrit." Në mënyrë të njëjtë përcaktohet edhe më KCSH në nenin 321 ku thuhet: "Kur dy ose më shumë persona thirren për të trashëguar njëri tjetrin dhe nuk vërtetohet se cili prej tyre ka vdekur më parë, prezumohet se të gjithë kanë vdekur në të njëjtën kohë dhe nuk kalon ndonjë e drejtë nga njëri tek tjetri."[201]

2.2.Padenjësia

Instituti i padenjësisë është institut i veçantë i të drejtës trashëgimore, i cili njihet që nga e drejta romake. Ky institut në teorinë juridike, sot definohet si një lloj sanksioni apo dënimi civil i cili zbatohet ndaj personave të cilet janë sjellur në mënyrë jo të mirë më trashëgimlënësin. Instituti i padenjësisë njihet në të gjitha shtetet, në legjislacionet e të gjitha shteteve janë të përcaktuara shkaqet apo arsyet për të cilat një person mund të përjashtohet nga trashëgimia për shkak të padenjësisë. Parashikimi i shkaqeve të padenjësisë nga ligjvënësi mundëson që gjykata të vendosë mbi baza të justifikueshme për përjashtimin e trashëgimtarëve nga trashëgimia. Parashikimi i shkaqeve të padenjësisë nga ligjvënësi veç gjykatës, në anën tjetër i ndihmon edhe trashëgimtarëve, në kuptimin që të tregohen më të kujdeshëm në sjelljen e tyre ndaj

[200] Shih N.Biqoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Onufri. Tiranë.Fq.47.

[201] Në mënyrë të njëjtë parashihet edhe më LTBH (neni 157 par.4) dhe LTHR (neni 124 par.4). Kurse, ligjet e analizuara të vendeve të tjera të rajonit, gjegjësisht LTSI , LTME dhe LTRS nuk përmbajnë ndonjë rregulle më të cilen rregullohet kjo situatë.

trashëgimlënësit.[202] Pra, trashëgimtarët janë të njoftuar se cilat prej veprimeve të tyre mund të sjell përjashtimin e tyre nga trashëgimia. Ligji për Trashëgimi i Kosovës, në nenin 111, i ka përcaktuar në mënyre taksative shkaqet për të cilat një person i thirrur si trashëgimtarë nuk mund të trashëgojë, këto shkaqe janë:

a) Nëse personi më dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit e tij;
b) Nëse personi ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me heqje lirie;
c) Nëse personi më mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rremë ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve;
d) Nëse personi është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe e ka keqtrajtuar atë;
e) Nëse personi nuk e ka përmbushur detyrimin për të mbajtuar apo ndihmuar trashëgimlënësin.

Në mënyrë të ngjajshme shkaqet e pandenjësisë përcaktohen edhe nga Kodi Civil Shqiptar, në nenin 322 ku thuhet mund të përjashtohet nga trashëgimia si i padenjë:

a) "ai që me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij;
b) ai që ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rreme në një gjykim penal;
c) ai që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rreme ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve;
d) ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë".

Ndërsa, sipas LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, rastet kur një person i thirrur në trashëgim nuk mund të trashëgojë për shkak të padenjësisë janë:[203]

a) Në qoftë se ai më dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin;

[202] Shih N.Biqoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.Fq.80.
[203] Shih LTMK (neni 123); LTRS (4); LTBH (neni 158); LTHR (neni 125); LTSI (neni 126); LTME (127).

b) Në qoftë se ai më anë mashtrimit, kanosjes apo dhunës e ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, revokojë testamentin ose ndonjë dispozitë të tij, apo e ka penguar trashëgimlënësin që ta bëjë testamentin;

c) Në qoftë se ai më qëllim që të pengojë realizimin e vullnetit të fundit të trashëgimlënësit e ka fshehur, agjësuar ose falsifikuar testamentin e trashëgimlënësit;

d) Në qoftë se ai e ka shkelur detyrimin ligjorë për ta mbajtur ose ndihmuar trashëgimlënësin kur ai ka pasur nevojë.

A. Nëse personi më dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit e tij.

Sipas LTK dhe KCSH, i padenjë për të trashëguar konsiderohet jo vetëm personi, i cili e ka vrarë apo ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, por edhe ai i cili ka vrarë apo ka tentuar të vrasë ndonjë familjarë të trashëgimlënësit. Parashikimi i këtij rasti nga ligjvënësi kosovar dhe shqiptar është bërë për arsye morale, sepse nuk do të ishte e drejtë dhe e moralshme që një person i cili i ka shkaktuar vuajtje të mëdha shpirtërore trashëgimlënësit p.sh., duke i vrarë fëmijën të përfitontë nga pasuria e trashëgimlënësit.[204] Ndërsa më LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, nuk parashikohet nëse personi i cili ka vrarë apo ka tentuar të vrasë ndonjë familjarë të trashëgimlënësit është i padenjë për trashëgim. Në këto ligje, specifikohet shprehimisht vetëm se i padenjë për trashëgim është personi i cili më dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin. Në teorinë juridike shqiptare, ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur më vërtetimin e veprës penale të kryer ndaj trashëgimlënësit apo të afërmve të tij. Sipas njërës pikëpamje, për t'u shpallur trashëgimtari i padenjë nga trashëgimia duhet të ekzistojë vendimi i marrë në procedurë penale më të cilin ai është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale kundër trashëgimlënësit apo të afërmve të tij. Ndërsa, sipas një pikëpamjes tjetër, nuk është i nevojshëm ekzistimi i vendimit të marrë në procedurë penale se një person të përjashtohet nga trashëgimia. Sipas autorit të kësaj pikëpamje, nuk ka pengesë që gjykata gjatë zhvillimit të procedurës civile gjegjësisht procedurës trashëgimore të administrojë prova dhe të konstatojë së trashëgimtari ka kryer një vepër penale, e cila e bënë atë të padenjë të trashëgojë.[205] Edhe ne përkrahim mendimin së nuk është e domosdoshme të ekzistojë patjetër vendimi i dhënë në procedurë penale se trashëgimtari të përjashtohet nga trashëgimia, por se përjashtimi i

[204] Shih A. Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë.Tiranë.Fq.19
[205] N.Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Onufri. Tiranë.Fq.56.

trashëgimtarit nga trashëgimia mund të bëhet edhe mbi bazën e vendimit të marrë në procedurë civile. Pra, përjashtimi i trashëgimtarit nga trashëgimia për kryerjen e veprës penale ndaj trashëgimlënësit apo të afërmve të tij, mund të bëhet qoftë në bazë të vendimit të marrë në procedurë penale ose vendimit të marrë në procedurë civile gjegjësisht trashëgimore. Nga kjo që u tha, mund të përfundojmë se për t'u përjashtuar trashëgimtari nga trashëgimi ai duhet të jetë shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale më vendim qoftë të gjykatës së çështjes penale ose çështjes civile dhe vetëm në bazë të këtij vendimi ai mund shpallet i padenjë për të trashëguar.

B. Nëse personi ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me heqje lirie.

Ky shkaq i padenjësisë parashikohet vetëm më LTK dhe KCSH. KCSH, këtë shkaq e lidh më afatin kohor të heqjes së lirisë respektivisht më masën e dënimit që parashikon ligji penal. Kjo rezulton nga neni 322 pika b e KCSH, ku thuhet përjashtohet nga trashëgimia si i padenjë: "personi i cili ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet". Ndërsa, LTK, nuk e specifikon afatin kohor të heqjes së lirisë. Nga kjo rezulton, që kushdo që bën kallëzim ose dëshmi të rreme sipas LTK, konsiderohet i padenjë për të trashëguar pavarësisht nga masa e dënimit që parashikon ligji penal.

C. Nëse personi më mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin.

Këtë shkak e parashikojnë të gjitha ligjet e analizuara. Në këtë rast, kusht i domosdoshëm për tu shpallur personi i padenjë për trashëgim është që ai ta këtë penguar trashëgimlënësin në realizimin e vullnetit të fundit të tij, në çfarëdo mënyrë qoftë duke e mashtruar, kanosur apo edhe duke i ushtruar dhune. Pra, baza e padenjësisë në këtë rast qendron në faktin që vullneti i deklaruar në testament i trashëgimlënësit nuk përputhet më vullnetin e brendshëm të tij. Më LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, parashikohet si rast i veçantë i padenjësisë edhe rasti kur personi e ka vjedhur testamentin dhe e ka fshehur gjegjësisht asgjësuar apo falsifikuar atë më qëllim që të mos realizohet vullneti i fundit i trashëgimlënësit. Në këtë rast, kërkohet që personat që kanë interes juridik ta dëshmojnë se ka ekzistuar testamenti i hartuar sipas kushteve të parapara më ligj dhe se i njëjti është fshehur apo asgjësuar.

D. Nëse personi është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe e ka keqtrajtuar atë.

Këtë shkak të pandenjësisë e parashikojnë vetëm LTK dhe KCSH. Më LTK, dhe KCSH, nuk përcaktohet se çka kuptohet më sjellje poshtëruese dhe keqtrajtim. Kjo do të thotë se gjykata është e lirë që të vlerësojë vetë në pajtim më rregullat e moralit, se kur një person është sjellë ose jo në mënyrë poshtëruese. Në teorinë juridike më sjellje poshtëruese ose keqtrajtim kuptohet mbajtja e një qëndrimi përbuzës dhe jonjerëzor ndaj trashëgimlënësit para vdekjes.[206]Si shembull i sjelljes poshtëruese, përmendet rasti kur trashëgimlënësi braktiset nga fëmija, i cili nuk ka shprehur asnjëherë interesim për trashëgimlënësin, madje as në rastet kur trashëgimlënësi nuk ka pasur mjete për jetesë apo kur trashëgimlënësi ka qenë në gjendje të keqe shëndetësore. Ndërsa, më keqtrajtim kuptohet çdo veprim më të cilin cenohet integriteti fizik apo mendor i trashëgimlënësit. Shembull i keqtrajtimit merren rastet kur trashëgimlënësi është fyer rëndë, kanosur apo edhe është rrahur nga trashëgimtarët.[207]

E. Nëse personi nuk e ka përmbushur detyrimin për të mbajtur apo ndihmuar trashëgimlënësin.

Ky shkak i padenjësisë parashikohet në të gjitha ligjet e analizuara, më përjashtim të KCSH. Është e rëndësishme të theksohet se ky shkak i padenjësisë nuk i godet të gjithë trashëgimtarët ligjorë, por vetëm ata të cilët e kanë për detyrë ligjorë ta mbajnë trashëgimlënësin.[208] Zakonisht në legjislacionet e shteteve, institucioni i mbajtjes rregullohet më dispozitat e ligjeve më të cilat rregullohen marrëdhëniet juridike-familjare. Në vendin tonë marrëdhëniet juridike-familjare rregullohen më ligj të posaçëm më Ligjin për Familje i Kosovës (Nr.2004/32). Përkitazi më personat të cilat janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare, LFK, në nenin 282 par.3 përcakton: "detyrimi për dhënien e mbajtjes financiare për personat në gjini të gjakut caktohet sipas radhës me të cilën mund të thirren në trashëgimi". Sipas kësaj dispozitë ligjore, rezulton që fillimisht bashkëshorti është i detyruar të mbajë trashëgimlënësin, mandej fëmijët (martesore, jashtëmartesor apo të adoptuar) dhe në mungesë të tyre pasardhësit e tyre; prindërit dhe në mungesë të tyre pasardhësit e tyre si dhe gjyshërit. Në mënyrë të njëjtë përcaktohet edhe më Ligjin për Familje i Maqedonisë, në nenin 184 ku thuhet: "Personat të cilët në bazë të ligjit janë të obliguar që në mes veti të japin mbajtjen, e japim mbajtjen në atë rend

[206] N.Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Onufri. Tiranë. Fq.52.
[207] Shih A. Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë.Tiranë.Fq.21
[208] Shih H.Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore, Prishtinë. Fq.79. (i cili i referohet Marković, dr, Slavko , Nasledno parvo, Novinska izdavaćka ustanova Službeni list SFRJ , OOUR "Knjige" Beograd 1981 Fq 90).

sipas të cilit dhënësit e mbajtjes vinë nëpërmjet trashëgimit."[209] Radha e personave të cilët janë të detyruar për të dhënë mbajtjen përcaktohet në mënyrë të ngjajshme edhe nga Kodi i Familjes i Shqipërisë. Përkatësisht sipas KFSH, anëtarët e familjes janë të detyruar për të dhënë mbajtjen sipas kësaj rradhë: "a) bashkëshorti ndaj bashkëshortit tjetër dhe fëmijët ndaj prindërve të tyre; b) prindërit ndaj fëmijëve të tyre; c) të paslindurit ndaj të paralindurve të tyre, që nuk janë prindër, sipas radhës më të afërt; ç) të paralindurit ndaj të paslindurve të tyre, që nuk janë fëmijë të tyre, sipas radhës më të afërt; d) vëllezërit dhe motrat ndaj vëllezërve dhe motrave të tyre, sipas radhës më të afërt."[210] Edhe sipas legjislacionit familjar në Serbi, Slloveni, Kroaci, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, radha e detyrimit të mbajtjes financiare midis anëtarëve të familjes përcaktohet sipas rendit sipas të cilit ata thirren në trashëgimi.

2.2.1. Vlerësimi i shkaqeve të padenjësisë

LTK, dhe ligjet e analizuara të shteteve të përfshira në studim (më përjashtim të Ligjit për Trashëgimi në Serbi[211]) përmbajnë rregullën e njëjtë së për shkaqet e padenjësisë gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare (ex officio). Kjo do të thotë së vlerësimin e rrethanave të padenjësisë,gjykata e bënë vetëm mbi bazën e kërkesës së personave të interesuar (trashëgimtarëve).[212] Përjashtim nga kjo rregull sipas ligjeve të analizuara (më përjashtim të LTRS) përbënë vetëm shkelja e detyrimit të mbajtjes dhe mosdhënies së ndihmës së domosdoshme trashëgimlënësit, për të cilat gjykata është e detyruar të kujdeset zyrtarisht (ex officio). Pra, shkelja e detyrimit të mbajtjes dhe mosdhënia e ndihmës së domosdoshme trashëgimlënësit, përbënë shkakun për të cilin gjykata është e detyruar të kujdeset zyrtarisht, pa marrë parasysh nëse palët kanë paraqitur ose jo kërkesën për përjashtimin e ndonjë trashëgimtari si të padenjë. Ndërkaq, KCSH, nuk e rregullon çështjen se si bëhet vlerësimi i shkaqeve të padenjësisë nga ana e gjykatës. Sipas teorisë juridike shqiptare, gjykata i shqyrton shkaqet e padenjësisë vetëm kur palët pretendonjë se ekzistojnë ato, që do të thotë gjykata nuk e shqyrton çështjen e padenjësisë sipas detyrës zyrtare, por vetëm në bazë të kërkesës së palës. Është e rendësishme të theksohet se padenjësia e pengon që të realizojë të drejtën trashëgimore vetëm

[209] Ligj Nr.1992/80 për Familjen i Maqedonisë, shih nenin 184.
[210] Ligj Nr. 9062 datë 8.5.2003 Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, shih nenin 192.
[211] Shih М. Ковачевић (2016). НЕДОСТОЈНОСТ ЗА НАСЛЕЂИВАЊЕ. UDK: 347.66. ЗБОРНИК РАДОВА ДВАДЕСЕТ ГОДИНА ЗАКОНА О НАСЛЕЂИВАЊУ РЕПУБЛИКЕ СРБИЈЕ. УНИВЕРЗИТЕТ У НИШУ ПРАВНИ ФАКУЛТЕТ. Fq.67.
[212] Shih LTK (neni 112); LTMK (neni 124 par.3); LTRS (neni 4.par.6); LTBH (neni 159 par.3); LTHR (neni 126 par.3); LTSI (neni 127 par.3); LTME (neni 127 par.7).

personin e padenjë, por jo edhe pasardhësit e tij.[213] Pasardhësit e personit të padenjë, trashëgojnë sipas rregullave që vlejnë për trashëgiminë në bazë të së drejtës së përfaqësimit (zëvendësimit). Përkitazi më këtë në nenin 110 par.2 i LTK thuhet: "Padenjësia nuk i pengon pasardhësit e personit të padenjë të trashëgojnë njësoj sikur personi i padenjë të kishte vdekur para trashëgimlënësit". Ngjajshëm përcaktohet edhe më KCSH në nenin 323 ku thuhet: "Padenjësia e prindit ose e të paralindurit, nuk përjashton fëmijët ose të paslindurit e këtij, si kur trashëgojnë vetë, ashtu dhe kur vijnë në trashëgim me zëvendësim". Edhe sipas LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, padenjësia e pengon që të realizojë të drejtën trashëgimore vetëm personin e padenjë, mirëpo jo edhe pasardhësit e tij të cilët trashëgojnë njëjtë sikurse personi i padenjë të ishte i vdekur[214]. Pra, pasardhësit e personit të padenjë trashëgojnë pjesën trashëgimore që do t'i përkiste personit të padenjë në rast se ai nuk do shpallej i padenjë. Për shembull, trashëgimlënësi ka lënë 2 vajza dhe 1 djal, si trashëgimtarë, sipas rregullit trashëgimia në këtë rast u ndahet të tre fëmijëve në pjesë të barabarta (nga 1/3). Mirëpo, nëse djali shpallet i padenjë për trashëgim dhe ka dy vajza, atëherë 1/3 e pasurisë që do t'i përkiste djalit sikur mos të shpallej i padenjë, u ndahet në pjesë të barabarta vajzave të tij.

2.2.2. Falja e padenjësisë

Në teorinë juridike ka mendime se pranimi i institutit të padenjësisë nga ligjvënësi paraqet një kufizim të zotësisë për të trashëguar, sepse shteti ndërhyn duke e kufizuar atë nëpërmjet rrugës ligjore.[215]Mirëpo, ligjvënësi ka paraparë edhe mundësinë e revokimit apo faljes së padenjësisë nga ana e trashëgimlënësit, por më kusht që falja të bëhet në formën e paraparë më ligj. Përkitazi më faljen e padenjësisë LTK, në nenin 113 parashikon:"Trashëgimlënësi ka të drejtë të falë personin e padenjë për ta trashëguar, me kusht që falja të bëhet shprehimisht me testament, ose kur faljen, ndonëse nuk është bërë shprehimisht, trashëgimlënësi ka shënuar në testament se e ka njohur padenjësinë dhe megjithatë e cakton atë si trashëgimtar".Në mënyrë të njëjtë parashikohet edhe më KCSH, në nenin 324 ku thuhet: "Trashëgimlënësi ka të drejtë ta falë personin e padenjë për ta trashëguar, me kusht që falja të bëhet shprehimisht me akt noterial ose me testament, ose kur falja, ndonëse nuk është bërë shprehimisht, trashëgimlënësi ka shënuar në

[213] N. Biçoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Tiranë. Fq. 84.
[214] Shih LTMK (neni 124 par.1); LTRS (neni 6); LTBH (neni 159 par.1); LTHR (neni 126 par.1); LTSI (neni 127 par.1); LTME (neni 127 par.5).
[215] J.Latifi (2006) E Drejta e Trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë Fq 34 (e cila i referohet Edition du Juris-Classeur. Legislation Compare. France 1995 Fq 19).

testament se e ka njohur padenjësinë e megjithatë e cakton atë si trashëgimtar". Pra, në mënyrë që të konsiderohet e plotëfuqishme falja duhet që të bëhet shprehimisht më testament, ose kur falja nuk është bërë shprehimisht, trashëgimlënësi duhet ta theksojë në testament se është në dijeni të padenjësisë së trashëgimtarit të caktuar dhe së pavarësisht kësaj, ai e cakton atë si trashëgimtarë. Edhe sipas LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, trashëgimlënësit i njihet e drejta që të falë personin e padenjë dhe që të konsiderohet e plotëfuqishme falja, kërkohet të bëhet në formën më shkrim sipas rregullave që aplikohen për vlefshmërinë e testamentit.[216]

2.3. Heqja dorë nga trashëgimia

LTK, ashtu sikurse edhe LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, e aplikojnë sistemin e fitimit të trashëgimit, sipas të cilit trashëgimia kalon tek trashëgimtarët në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit. Duke qenë se ligjet në fjalë, kanë pranuar sistemin e fitimit të trashëgimit, njëkohësisht këto ligje kanë pranuar edhe të drejtën e heqjes dorë nga trashëgimia. Pra, trashëgimtarit i garantohet më ligj, e drejta që të heqë dorë nga e drejta trashëgimore. Heqja dorë nga trashëgimia është veprim juridik i njëanshëm, më të cilin trashëgimtari deklaron se heqë dorë vullnetarisht nga trashëgimia, qoftë ajo ligjore apo testamentare. Deklaratën për heqje dorë nga trashëgimia, trashëgimtari ka mundësi ta jap vetëm pasi çelet trashëgimia, përndryshe deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia konsiderohet e pavlefshme. Këtë rregull LTK, e përmbanë në nenin 134 ku thuhet: "Heqja dorë nga trashëgimi që nuk është hapur nuk ka kurrfarë efekti juridik." Edhe LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, përmbajnë rregullën e njëjtë se deklarata për heqjen dorë mund të jepet vetëm pasi të çelet trashëgimia.[217] Përveç kësaj, për plotëfuqishmërinë e deklaratës për heqjen dorë nga trashëgimia kërkohet që ajo të bëhet në gjykatën e vendit ku është çelur trashëgimia dhe në formën më shkrim ose më gojë në seancë, më ç'rast deklarata duhet të regjistrohet në procesverbal.[218] Deklarata për heqje dorë nga trashëgimia nuk mund të jepet në favor të ndonjë trashëgimtari tjetër ligjorë apo testamentar. Përkatësisht, sipas dispozitave LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, heqja dorë nga trashëgimia në favor të ndonjë trashëgimtari nuk konsiderohet

[216] Shih LTMK (neni 124 par.2); LTRS (neni 5); LTBH (neni 159 par.2); LTHR (neni 126 par.2); LTSl (neni 127 par.1); LTME (neni 127 par.6).
[217] Shih LTMK (neni 132); LTRS (neni 218); LTBH (neni 167 par.1); LTHR (neni 134 par.1); LTSl (neni 137 par.1); LTME (neni 135 par.1); dhe KCSH (neni 337).
[218] Shih LTMK (neni 128); LTRS (neni 213); LTBH (neni 163 par.1); LTHR (neni 130 par.1); LTSl (neni 133 par.1); LTME (neni 135 par.3); dhe KCSH (neni 333).

si heqje dorë nga trashëgimia, por si deklaratë mbi cedimin gjegjësisht bartjen e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari i caktuar. Deklarata për heqje dorë nga trashëgimia nuk mund të jepet as duke u kushtëzuar më ndonjë afat apo kusht. Veç kësaj, deklarata për heqje dorë nga trashëgimia nuk mund të jepet edhe vetëm për një pjesë të pasurisë.[219] Pra, trashëgimtarit nuk i lejohet që të heqë dorë vetëm nga një pjesë e pasurisë trashëgimore, por ai mund të heqë dorë vetëm nga e gjithë pjesa trashëgimore që i takon qoftë në bazë të ligjit apo testamentit, pas vdekjes së trashëgimlënësit. Zakonisht më ligj përcaktohet edhe afati kohor brenda të cilit duhet të jepet deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia, në mënyrë që të prodhojë efekte juridike gjegjësisht që të konsiderohet e plotëfuqishme. Afatin për heqjen dorë nga trashëgimia LTK , LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, e rregullojnë në mënyrë të përgjithësuar.[220] Sipas rregullave të përmbajtura në ligjet e cituara më sipër, deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia duhet të jepet më së vonë deri në përfundimin e seancës mbi trashëgiminë. Ndërsa, në KCSH, gjejm një rregullim më të detajuar të afatit për heqjen dorë nga trashëgimia. KCSH, parashikon dy lloje të afateve të cilat dallojnë varësisht nga fakti nëse trashëgimtari ndodhet jashtë shtetit ose jo. Përkatësisht, sipas KCSH, në rastin kur trashëgimtari banon në Shqipëri, heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë. Ndërsa, në rastin kur trashëgimtari nuk banon në Shqipëri sipas KCSH, heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet jo më vonë se 6 muaj nga dita e çeljes së trashëgimisë.[221] Përveç kësaj, KCSH, e rregullon edhe afatin për heqjen dorë nga trashëgimia të fëmijës që ende nuk ka lindur. Sipas KCSH, për trashëgimtarin që në kohën e çeljes së trashëgimisë nuk ka lindur, afati i heqjes dorë nga trashëgimia (3 ose 6 muaj) fillon të rrjedhë nga dita e lindjes.[222] Ndërsa, LTK, LTMK, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, ndonëse fëmijës ende të palindur ja njohin zotësinë për të trashëguar, nuk e rregullojnë çështjen e afatit të heqjes dorë të tij nga trashëgimia.

[219] Shih LTK (neni 133); LTMK (neni 131); LTRS (neni 220); LTBH (neni 166); LTHR (nenet 130-134); LTME (neni 134) ; dhe KCSH (neni 337).
[220] Shih LTK (neni 130 par.1); LTMK (neni 128 par.1); LTRS (neni 213 par.1); LTBH (neni 163 par.1); LTHR (neni 130 par.1); LTSI (neni 133 par.1); LTME (neni 131 par.1).
[221] Shih Kodin Civil Shqiptar, neni 335 par.1.
[222] Po aty, shih nenin 335 par.2.

2.3.1. Pasojat e heqjes dorë nga trashëgimia

Heqja dorë nga trashëgimia shkakton efekte të caktuara juridike. Së pari, trashëgimtari që heqë dorë në emër të vet nga trashëgimia, konsiderohet sikur nuk është thirrur kurrë në trashëgimi dhe pjesa trashëgimore e tij, u kalon pasardhësve të tij.[223] Pasardhësit e personit që heqë dorë nga trashëgimia, trashëgojnë sipas rregullave që aplikohen tek e drejta e përfaqësimit (zëvendësimit). Pra, në këtë rast pasardhësit e personit që heqë dorë nga trashëgimia, trashëgojnë sikur ai të ishte i vdekur. Më LTK, LTMK, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, trashëgimtarit i njihet e drejta që të heqë dorë nga trashëgimia edhe në emër të pasardhësve të vet. Madje, sipas ligjeve në fjalë, nëse trashëgimtari nuk e specifikon shprehimisht se heqë dorë nga trashëgimia vetëm në emër të vet, konsiderohet se ai ka hequr dorë nga trashëgimia edhe në emër të pasardhësve të vet.[224] Pra, që të mund të trashëgojnë pasardhësit e personit që ka hequr dorë nga trashëgimia, duhet patjetër që ai në deklaratën e dhënë për heqje dorë nga trashëgimia të theksojë se heqë dorë nga trashëgimia vetëm në emër të vet, në të kundërtën pasardhësve të tij nuk do i takojë asnjë e drejtë në pasurinë trashëgimore. Pra, efekti i heqjes dorë nga trashëgimia mund të shtrihet edhe ndaj pasardhësve të personit gjegjësisht trashëgimtarit që heqë dorë nga trashëgimia. Ndërsa, sipas Ligjit për Trashëgimi i Serbisë, trashëgimtarit nuk i lejohet që të heqë dorë nga trashëgimia në emër të pasardhësve të vet. Këtë rregull LTRS, e përmbanë në nenin 213 par.2 ku thuhet: "Trashëgimtari mund të heqë dorë nga trashëgimi vetëm në emrin e tij." Ndërsa, KCSH, nuk e rregullon këtë çështje përkatësisht më KCSH, nuk përcaktohet se a ka të drejtë trashëgimtari të heqë dorë nga trashëgimia në emër të pasardhësve të vet ose jo. Kjo mund të kuptohet ndoshta se KCSH, nuk ja njeh të drejten trashëgimtarit që të heqë dorë nga trashëgimia në emër të pasardhësve të vet. Ndërsa, çështjen se si trashëgohet pjesa e pasurisë trashëgimore e personit që heqë dorë nga trashëgimi, e rregullojnë në mënyrë të njëjtë të gjitha ligjet e analizuara. Përkitazi më çështjen në fjalë, në LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH si dhe në KCSH aplikohen këto rregulla: - Në rastin, kur trashëgimtari heqë dorë nga trashëgimia ligjore, pjesa trashëgimore e tij u kalon trashëgimtarëve të tjerë të po njëjtës radhë. Po që se trashëgimtari që heqë dorë nga trashëgimia është i vetmi trashëgimtar i asaj radhë, trashëgimia u kalon trashëgimtarëve të radhës pasuese. Ndërsa,në rastin kur trashëgimtari heqë

[223] Shih LTK (neni 130 par.4); LTMK (neni 128 par.4); LTRS (neni 213 par.3); LTBH (neni 163 par.4); LTHR (neni 130 par.4); LTSI (neni 133 par.4); LTME (neni 131 par.4) dhe KCSH (neni 334).

[224] Shih LTK (neni 130 par.2); LTMK (neni 128 par.2); LTBH (neni 163 par.2); LTHR (neni 130 par.2); LTSI (neni 133 par.2); LTME (neni 131 par.2).

dorë nga trashëgimia testamentare, pjesa trashëgimore e tij u kalon gjithashtu trashëgimtarëve ligjorë, përveç nëse më testament parashihet ndryshe.[225] Pra,sipas kësaj rregulle, trashëgimlënësi mundet në testament të caktojë edhe personin i cili do të trashëgojë në vend të trashëgimtarit të caktuar në testament, po që se trashëgimtari i caktuar në testament, nuk dëshiron ta pranojë trashëgiminë e lënë në testament. Një çështje tjetër më rëndësi, të cilen ligjet e analizuara gjegjësisht LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, e rregullojnë në mënyrë të njëjtë është kalimi i së drejtës së heqjes dorë nga trashëgimi tek personat e tjerë. Përkatësisht, ligjet e analizuara kanë pranuar rregullën se në rastin kur trashëgimtari ka vdekur para se të përfundojë shqyrtimi i pasurisë trashëgimore dhe nuk ka hequr dorë nga trashëgimi, atëherë e drejta për të hequr dorë nga trashëgimia bartet tek trashëgimtarët e tij. E drejta për të hequr dorë nga trashëgimia si një e drejtë e karaterit pasuror nuk lidhet më përsonalitetin e njeriut dhe si e tillë, pra është një e drejtë që mund të bartet tek personat e tjerë gjegjësisht tek trashëgimtarët. Ngjajshëm, ligjet e analizuara përkatësisht LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, e rregullojnë edhe çështjen se kur trashëgimtarit nuk i lejohet që të heqë dorë nga trashëgimia. Sipas rregullave të përmbajtur në ligjet e analizuara, trashëgimtarit nuk i lejohet që të heqë dorë nga trashëgimia, në rastin kur ai e ka disponuar (shitur apo dhuruar) pasurinë trashëgimore në tërësi apo edhe një pjesë të saj.[226]

2.3.2. Anulimi i deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia

Ligjet e marra në analizë gjëgjesisht LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH, dhe KCSH, përmbajnë rregullën e njëjtë që deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia nuk mund të revokohet.[227] Ky qendrim i ligjvënësit është në pajtim më parimin e sigurisë juridike. Pranimi i revokimit të deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia do të shkaktonte pasiguri juridike, sepse personat (trashëgimtarët) të cilët përfitojnë nga trashëgimia, do të ishin gjithmon të rrezikuar së e drejta e tyre mbi trashëgiminë e fituar, papritmas mund të shuhet. Mirëpo, në rastin kur heqja dorë nga trashëgimia nuk ka qenë vullnet i lirë i trashëgimtarit, gjegjësisht kur vullneti i deklaruar përmbanë të meta, trashëgimtarit i lejohet që të kërkojë anulimin e deklaratës. Këtë rregull LTK, e përmbanë në nenin 135 par.2 ku thuhet:

[225] Shih LTK (neni 135 par.5 dhe neni 136); LTMK (neni 128 par.5 dhe neni 134); LTBH (neni 163 par.5 dhe neni169); LTHR (neni 130 par.5 dhe neni 136);); LTSI (neni 133 par.5 dhe neni 139); LTME (neni 131 par.5 dhe neni 137).

[226] Shih LTK (neni 131 dhe 132); LTMK (neni 129 dhe 130); LTRS (neni 215 dhe 217); LTBH (neni 164 dhe 165); LTHR (neni 131 dhe 132); LTSI (neni 134 dhe 135); LTME (neni 132 dhe133); dhe KCSH (neni 340 dhe 338).

[227] Po aty, shih LTK (neni 135 par.1); LTMK (neni 133 par.1); LTRS (neni 214 par.3); LTBH (neni 168 par.1); LTHR (neni 135 par.1); LTSI (neni 138 par.1); LTME (neni 136 par.1); dhe KCSH (neni 339).

“Trashëgimtari që ka dhënë deklaratën mund të kërkojë nulimin e kësaj deklarate, po qe se ajo është dhënë me kanosje, dhunë, për shkak të mashtrimit ose lajthimit.” Ngjajshëm përcaktohet edhe më LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH.[228] Ndërsa, KCSH, nuk e rregullon shprehimisht anulimin e deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia. Mirëpo, është e kuptueshme që edhe KCSH, lejon që të kërkohet anulimi i deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia, përderisa lejon që të shpallet i pavlefshëm çdo veprimi juridik të cilin personi e ka kryer kundër vullnetit të tij.[229] Pra, duke qenë se edhe heqja dorë nga trashëgimia është veprim juridik, kuptohet se është i anulueshëm, po qe se është kryer kundër vullnetit të personit.

[228] Shih LTMK (neni 133 par.2); LTRS (neni 214 par.4); LTBH (neni 168 par.2); LTHR (neni 135 par.2); LTSI (neni 138 par.2); LTME (neni 136 par.2).
[229] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 94 pika ç.

2.4. Rregullimi i trashëgimisë ligjore në Kosovë

2.4.1. Rrethi i trashëgimtarëve ligjorë

Sikurse është theksuar edhe në hyrje të këtij kapitulli, Ligji për Trashëgimi i Kosovës, njeh dy baza juridike të thirrjes në trashëgimi: a) trashëgiminë ligjore dhe b) trashëgiminë testamentare, përkatësisht në nenin 8 LTK, shprehimisht parashikon: "Trashëgimia fitohet më ligj ose me testament". Është e rëndësishme të përmendet se aktualisht është duke u punuar në përgatitjen e Kodit Civil të Kosovës, në draftin fillestar të publikuar nga MD, vërehet se janë paraparë disa ndryshime të ligjit të trashëgimisë. Një ndër ndryshimet më të rëndësishme që parashikohet është lidhur më bazat juridike në bazë të të cilave mund të fitohet, e drejta trashëgimore. Përkatësisht,në projekt-Kodi Civil i Republikës së Kosovës (draftin fillestar), parashihet që fitimi i të drejtës trashëgimore mund të bëhet në bazë të ligjit, testamentit ose kontratës.[230] Pra, më ligjin e ardhshëm në Kosovë, pritet të njihet si bazë juridike e thirrjes në trashëgimi edhe kontrata.Sipas rregullave të përmbajtura në LTK, përparësi i jepet trashëgimisë testamentare ashtu që trashëgimia ligjore zbatohet: a) kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament b) kur trashëgimlënësi ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë si dhe c) kur testamenti është shpallur tërësisht apo pjesërisht i pavlefshëm.[231] Duke qenë se trashëgimia ligjore merret si një vullnet i supozuar i trashëgimlënësit, imponohet nevoja e përcaktimit më dispozita ligjore të rrethit të personave që kanë të drejtë ta trashëgojnë atë. Në legjislacionet e të gjitha shteteve, rrethi i personave që kanë të drejtë në trashëgimi, caktohet nga rrethi i personave me të cilët trashëgimlënësi ka qenë në raporte më të afërta. Këta janë rëndomtë të afërmit e trashëgimlënësit sipas gjinisë se gjakut, pastaj bashkëshorti dhe të afërmit sipas gjinisë civile. Duhet theksuar që në të kaluarën, lidhja e gjakut ka qenë shumë më e fortë se sa sot, andaj edhe rrethi i trashëgimtarëve ligjorë ka qenë më i gjerë. Sot në legjislacionet e shteteve bashkëkohore ekziston tendenca që rrethi i trashëgimtarëve ligjorë të kufizohet. Ligji për Trashëgimi i Kosovës, në nenin 11 par.1 ka përcaktuar në mënyrë shprehimore personat të cilët e përbëjnë rrethin e trashëgimtarëve ligjorë, sipas kësaj dispozitë ligjore trashëgimtarë ligjorë llogariten:

a) Fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre;
b) Bashkëshorti pasjetues;

[230] Projekt-Kodi Civil i Republikës së Kosovës (Dt. 22.02.2017) Shih nenin 8.Gjendet i disponueshëm në linkun më poshtë: https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/5A281B16-34FB-40C3-863B-AF6B4CC3D014.pdf)
[231] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 9.

c) Prindërit e trashëgimlënësit;

d) Vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre;

e) Gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.

Pra, caktimi i personave të cilët thirren në trashëgimi ligjore, sipas ligjit tonë është bërë duke u bazuar në tri fakte të rëndësishme: a) gjinën e gjakut b) gjinën e adoptimit dhe b) martesën.

Fëmijët e trashëgimlënësit.- Sipas LTK, në rrethinë e fëmijëve të trashëgimlënësit përfshihen si fëmijët martesor, ashtu dhe ata jashtëmartesor si dhe fëmijët e adoptuar. Sipas legjislacionit tonë familjar konkretisht LFK, fëmijë martesor konsiderohen fëmijët e lindur gjatë ekzistimit të martesës ose ata që kanë lindur brenda 300 ditëve pas zgjidhjes së martesës. Ndërkaq, fëmijë jashtëmartesor, konsiderohen ata që nuk kanë lindur brenda afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës ose ata që kanë lindur nga një grua e pamartuar.[232] Sipas LTK, fëmijët jashtëmartesor thirren në trashëgimi kur u është pranuar atësia ose amësia nga prindërit ose kur atësia apo amësia e tyre është vërtetuar më vendim të gjykatës. LTK, nuk bënë dallime ndërmjet fëmijve martesor, jashtëmartesor dhe atyre të adoptuar në lidhje më pjesën trashëguese të tyre. Kjo rregull rrjedh nga neni 22 i LTK ku thuhet: "Fëmijët e lindur në martesë, jashtë martese, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent, si dhe ata të adoptuar dhe pasardhësit e tyre kanë të drejta të barabarta në trashëgimi". Pra, fëmijëve martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar të trashëgimlënësit, u takon e drejta e barabartë në trashëgimi. Duhet theksuar se barabarësia ndërmjet fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor, në të gjitha të drejtat përfshirë këtu edhe të drejtën trashëgimore garantohet edhe më Kushtetutë. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 50 par.2 përcakton rregullën: "Fëmijët e lindur jashtë martese, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë". Barabarësia e fëmijëve jashtëmartesor më fëmijët martesor garantohet edhe më legjislacionin familjar. Kështu, Ligji për Familje i Kosovës, në nenin 3 par.4 parashikon: "Fëmijët e prindërve të cilët nuk kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre gëzojnë të drejtat e njëjta dhe kanë detyrime të njëjta sikurse fëmijët e lindur nga prindërit të cilët kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre". Është e rëndësishme të përmendet se barabarësia e fëmijëve jashtëmartesor më fëmijët martesor në trashëgimi garantohet edhe më akte ndërkombëtare. Kështu, Konventa Evropiane për statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martese, në nenin 9 përcakton:"Një

[232] Ligji Nr.2004/32 Për Familje i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/Prishtinë: Viti I/Nr.4/01 Shtator 2006). Shih nenin 101 dhe 102.

fëmijë i lindur jashtë martese ka të njëjtën të drejtë të trashëgimisë në pasurinë e babait dhe nënës së tij dhe të një anëtari të familjes së babait ose nënës të tij, sikur të kishte qenë i lindur në martesë".[233]

Bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit.-Më bashkëshorte sipas ligjit tonë nënkuptohen burri dhe gruaja të cilët kanë të lidhur martesë sipas kushteve të parapara më ligj. Përkatësisht LFK, në nenin 14 e përkufizon martesën kësisoj: "Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes". Pra, sipas ligjit tonë nuk lejohet martesa midis personave të sekseve të njëjta, sikurse lejohet në disa shtete evropiane si p.sh., në Holandë (2001)[234]; Belgjikë (2003); Spanjë (2005); Suedi (2009); Portugali (2010)[235], Danimarkë (2012)[236] etj. Sipas LTK, bashkëshortëve u takon e drejta e barabartë në trashëgimi gjegjësisht si burrit ashtu dhe gruas, u njihet e drejta e barabartë në trashëgimi të njëri-tjerit. E drejta e trashëgimit midis bashkëshortëve mbaron më zgjidhjen e martesës më shkurorëzim ose më anulim. Përkatësisht sipas rregullave të përmbajtura në LTK, bashkëshorti nuk ka të drejtë të trashëgojë në këto raste:

a) "Kur trashëgimlënësi ka paraqitur padi shkurorëzimi, kurse pas vdekjes së trashëgimlënësit është bërë shkurorëzimi me aktgjykim të formës së prerë;
b) Kur martesa e tij me trashëgimlënësin anulohet me aktgjykim të formës së prerë pas vdekjes së trashëgimlënësit për shkaqet që bashkëshorti pasjetues i ka ditur në kohën e lidhjes së martesës;
c) Kur bashkëjetesa e tij me trashëgimlënësin ka pushuar me fajin e bashkëshortit pasjetues ose në bazë të marrëveshjes me shkrim me trashëgimlënësin".[237]

Nga kjo rezulton që të mund ta trashëgojë trashëgimlënësin bashkëshorti pasjetues, domosdo duhet të ekzistojë martesa e vlefshme, në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Pra, trashëgimlënësin nuk mund ta trashëgojë ish-bashkëshorti, qoftë nga martesa e cila ka pushuar më shkurorëzim apo më anulim. Është e rëndësishme të përmendet se më bashkëshortin martesor, në trashëgimi sipas ligjit tonë barazohet edhe bashkëshorti jashtëmartesor, mirëpo në

[233] Konventa Evropiane për statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martese. Strasburg 1975.
[234] Patterson, Nicholas J. (2001) "The Repercussions in the European Union of the Netherlands' Same-Sex Marriage Law," Chicago Journal of International Law: Vol. 2: No. 1, Article 23. Fq.301.
[235] Jens M. Scherpe (2013). The Legal Recognition of Same-Sex Couples in Europe and the Role of the European Court of Human Rights. The Equal Rights Review, Vol. Ten (2013). Fq.84.
[236] Kenneth G.C.Reid & Marius Johannes De Waal & Reinhard Zimmermann (2015). Comparative Succession Law-Intestate Succession.Oxford-University Press.Fq.313
[237] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 27.

këtë rast kërkohet të plotësohen disa kushte të caktuara.[238] Përkatësisht sipas LTK, në mënyrë që të mund të trashëgojnë njërin-tjetrin bashkëshortët jashtëmartesor, kërkohet domosdoshmërisht të plotësohen këto dy kushte:- Se pari, bashkëshortët jashtëmartesor duhet që të kenë jetuar së bashku të paktën 10 vite ose 5 vite nëse nga marrëdhënia e bashkëjetësës kanë lindur fëmijë; dhe -Se dyti, duhet që asnjëri nga bashkëshortët jashtëmartesor në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit mos të kenë patur martesë të lidhur më ndonjë person të tretë ose nëse trashëgimlënësi ka qenë i martuar më personin e tretë, ai duhet të këtë paraqitur padi për shkurorëzimin ose anulimin e martesës dhe pas vdekjes së tij të konstatohet se padia ka qenë më baze.[239] Pra, sipas ligjit në fuqi në Kosovë, bashkëshortëve jashtëmartesore, u pamundësohet që të trashëgojnë nëse nuk kanë bashkëjetuar për 10 vite ose 5 vite kur kanë fëmijë. Duhet theksuar se më qëllim të sigurimit të mbrojtjes më të mirë për bashkëshortin jashtëmartesor, në projekt-Kodi Civil i Republikës së Kosovës (draftin fillestar) është paraparë që bashkëshortëve jashtëmartesore u njihet e drejta e trashëgimit reciprok, nëse kanë bashkëjetuar së paku 5 vite ose së paku 3 vite, në rastet kur nga marrëdhënia e bashkëjetesës ka lindur një fëmijë.[240]

Prindërit e trashëgimlënësit.-Më prindërit nënkuptohen babai dhe nëna e trashëgimlënësit si dhe adoptuesi i tij. Sipas LTK, nëna dhe babai trashëgojnë në pjesë të barabarta. Pra, nuk bëhen dallime midis prindërve sa i përkët pjesës trashëguese të tyre.

Gjyshi dhe gjyshja e trashëgimlënësit.-Më gjyshin dhe gjyshen e trashëgimlënësit nënkuptohen prindërit e nënës dhe të babait si dhe të adoptuesit. LTK, nuk bënë dallime ndërmjet gjyshërve nga ana e babait dhe nënës gjegjësisht në trashëgimi thirren gjyshërit si nga ana e babait ashtu dhe nënës dhe trashëgimia midis tyre ndahet në pjesë të barabarta. Përkatësisht gjysma e pasurisë apo ½ u ndahet në pjesë të barabarta, gjyshit e gjyshës nga ana e nënës dhe gjysma tjetër apo ½ u ndahet gjyshit e gjyshës nga ana e babait.[241]

[238] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 11 par.2
[239] Po aty. Shih nenin 28.
[240] Projekt-Kodi Civil i Republikës së Kosovës (Dt. 22.02.2017) Shih nenin 11 par.3.Gjendet i disponueshëm në linkun më poshtë: https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/5A281B16-34FB-40C3-863B-AF6B4CC3D014.pdf)
[241] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 18 par.2

2.4.1.2 Radha e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Kosovë

Siç dihet thirrja e trashëgimtarëve ligjorë në trashëgimi, bëhet sipas radhës së caktuar më ligj. Rrethi i trashëgimtarëve ligjorë, në Kosovë është i ndërtuar sipas sistemit parantelar-linear. Sipas këtij sistemi, grupimi i trashëgimtarëve ligjorë bëhet në parantela (brez). Parantela (brezi) quhet grupi i të afërmëve sipas gjakut, të cilët kanë pasaardhës të përbashkët. Parantelën (brezin) e parë, e përbëjnë pasardhësit e trashëgimlënësit (fëmijët dhe pasardhësit e tyre). Parantelën (brezin) e dytë, e përbëjnë prindërit e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre. Parantelën (brezin) e tretë, e përbëjnë gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit nga ana e babait dhe nënës dhe pasardhësit e tyre.[242] Parantelat (brezat) me më shumë trashëgimtarë ndahen në të ashtuquajturat trungje, e këto në degë. Për shembull, parantela e dytë ndahet në trung të babait dhe të nënës apo parantela e tretë, ndahet në trungun e gjyshës dhe gjyshit përkah babai dhe gjyshës dhe gjyshit përkah nëna, por secili prej këtyre trungjeve ndahet në nga dy degë (të gjyshit dhe gjyshes) etj.[243] Karakteristikë për sistemin parantelar (i brezave) është se në të aplikohet e drejta e përfaqësimit (zëvendësimit) pa kufizim. E drejta e përfaqësimit (zëvendësimit) mundëson që në rast se të afërmit më të ngushtë në parantelën përkatëse nuk mund të trashëgojnë (për shkak se janë shpallur të padenjë apo kanë hequr dorë nga trashëgimi apo kanë vdekur para trashëgimlënësit) në vendin e tyre të paraqiten pasardhësit të cilët trashëgojnë aq sa do të trashëgonte i afërmi i parë i thirrur, sikur të mos ekzistonte shkaku që ka mundësuar mos realizimin e të drejtës trashëgimore.[244] Për shembull, trashëgimlënësi ka lënë një djalë dhe dy vajza, njëra nga vajzat ka hequr dorë nga trashëgimia në emër të vetin por jo edhe në emër të pasardhësve të saj (dy djemve të saj), atëherë në trashëgim në vend të vajzës paraqiten dy nipat e trashëgimlënësit, në këtë rast trashëgimia ndahet në tri pjesë të barabarta, pjesa e vajzës e cila ka hequr dorë nga trashëgimia (1/3) u ndahet në pjesë të barabarta të dy nipave (pra, se cilit nga 1/6), kurse djali dhe vazja tjetër e trashëgimlënënsit trashëgojnë nga 1/3 e pasurisë trashëgimore.

[242] A.Gams (1986), Hyrje në të Drejtën Civile (Pjesa XII. E Drejta e Trashëgimit), Prishtinë. Fq. 375.
[243] Po aty. Fq.375
[244] Shih J.Latifi (2006) E Drejta e Trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë. Fq. 55.

2.4.1.3. Radha e parë e trashëgimisë

Sipas LTK, në radhën e parë thirren në trashëgimi, fëmijët e trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre dhe bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit, qoftë martesor apo jashtëmartesor. Fëmijët e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti pasjtues, trashëgojnë në pjesë të barabarta.[245] Për shembull, trashëgimlënësi ka lënë gruan, një vajzë dhe një djalë. Sipas rregullit, në këtë rast trashëgimia do t'i ndahet 1/3 gruas, 1/3 djalit dhe 1/3 vajzës. Mirëpo, në qoftë se djali i trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit dhe ka lënë pas veti dy fëmijë, atëherë në bazë të së drejtës se përfaqësimit thirren në trashëgimi fëmijët e tij (nipi dhe mbesa e trashëgimlënësit). Në këtë rast trashëgimia u ndahet 1/3 gruas, 1/3 vajzës dhe 1/3, e cila do ti takonte djalit sikur të ishte gjallë u ndahet dy fëmijëve të tij në pjesë të barabarta, pra secilit nga 1/6 e pasurisë trashëgimore. Duhet theksuar se thirrja e personave në trashëgimi, sipas të drejtës së përfaqësimit lejohet kur personi që duhet thirrur në trashëgimi: a) ka vdekur para trashëgimlënësit; b) ka hequr dorë nga trashëgimia; c) është përjashtuar nga trashëgimia ose është shpallur i padenjë për të trashëguar.[246] Të drejtën e përfaqësimit (zëvendësimit) LTK, e parasheh shprehimisht në nenin 13 par.1 ku thuhet "kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij, e kur edhe të paslindurit për shkaqet e parapara me ligj nuk mund të jenë trashëgimtarë, hyjnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim". Nga kjo rezulton, që e drejta e përfaqësimit sipas ligjit tonë aplikohet vetëm ndaj të paslindurve (pasardhësve) dhe është e pakufizuar në vijë të drejtë. Përkatësisht, sipas ligjit tonë në bazë të drejtës së përfaqësimit mund të thirren në trashëgimi jo vetëm fëmijet e fëmijëve (nipat dhe mbesat) por edhe stërnipërit dhe kështu më radhë deri në trashëgimtarin e fundit. Në rastet kur nuk mund të aplikohet e drejta e përfaqësimit në trashëgimi ligjore, aplikohet e drejta e shtimit gjegjësisht e drejta e shtimit aplikohet në rastet kur brenda të njëjtës radhe të trashëgimtarëve ligjorë nuk mund të këtë trashëgim më përfaqësim[247]. Pra, e drejta e shtimit aplikohet vetëm kur mungojnë trashëgimtarët që mund të trashëgojnë në baze të së drejtës se përfaqësimit. Në shembullin e përmendur më sipër, sikur mos të ekzistonin nipi dhe mbesa e trashëgimlënësit, pra sikur djali i trashëgimlënësit mos të linte pasaardhës pjesa trashëgimore e tij (1/3) në baze të drejtës së shtimit do i ishte shtuar dy trashëgimtarëve tjerë

[245] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 12.
[246] Shih N. Biçoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.Fq.135
[247] Shih H.Podvorica (2011) Legal Inheritance in the Republic of Kosovo. Iliria International Review – 2011/1. Fq.151.

ligjorë përkatësisht gruas dhe vajzës si bashkëtrashëgimtarë të po asaj radhe, pra gruaja dhe vajza e trashëgimlënësit do të trashëgonin nga ½ e pjesës trashëgimore. Është e rëndësishme të përmendet se e drejta e përfaqësimit aplikohet vetëm në rastin e trashëgimisë ligjore, kurse e drejta e shtimit aplikohet si në rastin e trashëgimisë ligjore, ashtu dhe në rastin e trashëgimisë testamentare.[248] Sikurse u theksua më lartë, të gjithë trashëgimtarëve të radhës së parë të trashëgimisë (d.m.th bashkëshortit dhe fëmijëve të trashëgimlënësit) trashëgimia u ndahet në pjesë të barabarta. Mirëpo, ka raste kur bëhen përjashtime nga kjo rregull. Më ligjin tonë është paraparë mundësia e shtimit të pjesës së fëmijës të trashëgimlënësit, kundrejtë bashkëshortit pasjtues, i cili nuk është prind i fëmijës. Përkitazi më këtë në nenin 23 i LTK thuhet: "Kur ekziston fëmija i trashëgimlënësit, prindi tjetër i të cilit nuk është bashkëshort pasjetues, e pasuria e bashkëshortit pasjetues është më e madhe se pjesa që do t'i takonte me rastin e ndarjes së pasurisë trashëgimore në pjesë të barabarta, atëherë secilit fëmijë të trashëgimlënësit i takon pjesa dy herë më e madhe sesa bashkëshortit, nëse gjykata, pasi të marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, nuk vendos ndryshe". Nga kjo rezulton që për tu lejuar shtimi i pjesës trashëgimore të fëmijëve kundrejtë bashkëshortit pasjtues duhet të plotësohen këto dy kushte: -Së pari, prind i fëmijëve të trashëgimlënësit pjesa e të cilëve shtohet nuk duhet të jetë bashkëshorti pasjtues. Pra, duhet të jenë fëmijë nga ndonjë martesë tjetër e trashëgimlënësit apo bashkëjetesë. -Së dyti, pasuria e bashkëshortit pasjtues (pjesa e të cilit zvogëlohet në favor të fëmijëve të trashëgimlënësit) duhet të jetë më e madhe, se sa pjesa që i takon në pasurinë trashëgimore. Zvogëlimi i pjesës trashëgimore i bashkëshortit pasjtues, duket se është paraparë më qëllim të përmirësimit të pozitës së fëmijëve të trashëgimlënësit, mirëpo është e diskutueshme dhe e paqartë sesi gjykata e përcaktonë vlerën e pasurisë se bashkëshortit pasjtues. Vlen të ceket, se ne Projekt-Kodi Civil i Republikës së Kosovës, nuk është parashikuar mundësia për zvogëlimin e pjesës trashëguese të bashkëshortit. Përkatësisht, në projekt-Kodi Civil i Republikës së Kosovës, parashikohet që bashkëshorti pasjetues dhe fëmijët trashëgojnë në pjesë të barabarta, më përjashtim të rastit kur trashëgimlënësi ka më shumë se tre fëmijë, ku bashkëshorti pasjetues trashëgon 1/4 e pasurisë së trashëgimlënësit.[249]

[248] Shih H.Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore, Prishtinë. Fq.55.

[249] Projekt-Kodi Civil i Republikës së Kosovës (Dt. 22.02.2017) Shih nenin 12 par.3.Gjendet i disponueshëm në linkun më poshtë: https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/5A281B16-34FB-40C3-863B-AF6B4CC3D014.pdf

2.4.1.4.Radha e dytë e trashëgimisë

Sipas LTK, në radhën e dytë të trashëgimisë thirren prindërit e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti pasjetues, po që se bashkëshorti është i vetmi trashëgimtar i radhës së parë. Kjo rregull parashihet në nenin 14 par.1 i LTK ku thuhet "Pasurinë e trashigimlënësit që nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij". Pra, në rastin kur bashkëshorti është i vetmi trashëgimtarë ligjorë i radhës se parë, ai nuk trashëgon në radhën e parë, por zbrit në radhën e dytë në trashëgim. Nga kjo rezulton që bashkëshorti pasjetues, sipas ligjit tonë nuk konsiderohet trashëgimtarë ligjorë ekskluzivë i radhës se parë, sikurse fëmijët sepse sikur fëmijët të jenë të vetmit trashëgimtarë të radhës së parë, ata nuk zbresin në radhën e dytë në trashëgim por përfitojnë gjithë trashëgiminë. Mirëpo, edhe pse bashkëshorti zbret në radhën e dytë në trashëgim pozita e tij nuk përkeqësohet, pasi ai trashëgon jo më pak se ½ e pasurisë trashëgimore. Pra, në rastin kur bashkëshorti konkurron në radhën e dytë në trashëgim më prindërit e trashëgimlënësit, ai trashëgon gjysmën e pasurisë trashëgimore dhe gjysmën tjetër të pasurisë e trashëgojnë prindërit në pjesë të barabarta. Këtë rregull LTK, e ka paraparë shpehimisht në nenin 14 par.2 ku thuhet: "Prindërit e trashëgimlënësit trashëgojnë gjysmën e pasurisë në pjesë të barabarta, kurse gjysmën tjetër të pasurisë e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit". Për shembull, trashëgimlënësi ka lënë bashkëshorten dhe dy prindërit. Sipas rregullit, trashëgimia do ti ndahet ½ bashkëshortës dhe ½ prindërve përkatësisht nënës dhe babait u ndahet nga ¼ e pasurisë trashëgimore. Mirëpo, në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit dhe ka lënë si pasardhës dy djemë dhe një vajzë, atëherë në baze të se drejtës se përfaqësimit në vend të prindit të vdekur paraqiten në trashëgim pasaardhësit e tij përkatësisht vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit. Në këtë rast, ½ e pasurisë trashëgimore i ndahet bashkëshortës; ¼ e pasurisë trashëgimore i ndahet prindit, i cili ka përjetuar momentin e vdekjes se trashëgimlënësit; kurse ¼ e pasurisë të cilën do ta trashëgonte prindi i vdekur sikur të ishte gjallë, u ndahet në pjesë të barabarta dy vëllezërve dhe motrës se trashëgimlënësit ku secili merr nga 1/12 e pasurisë trashëgimore. Mirëpo, në qoftë se edhe njëri nga vëllezërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit dhe pas veti ka lënë dy vajza dhe një djalë. Në këtë rast, 1/12 e pasurisë trashëgimore të cilen do ta trashëgonte vëllau i trashëgimlënësit sikur të ishte gjallë u ndahet pasardhësve të tij përkatësisht nipit dhe mbesave të trashëgimlënësit, ku secili trashëgonë nga 1/36 e pasurisë trashëgimore. Nëse edhe njëri nga

nipat e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit dhe pas veti ka lënë një djalë dhe një vajzë, atëherë 1/36 e pasurisë trashëgimore të cilën do ta trashëgonte nipi i vdekur sikur të ishte gjallë u ndahet stërnipit dhe stërmbesës se trashëgimlënësit ku secili trashëgon nga 1/72 e pasurisë trashëgimore. Të drejtën e përfaqësimit në radhën e dytë në trashëgim LTK, e rregullon në nenin 15 gjegjësisht në par.1 i nenit 15 përcaktohet: "Në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), nipat e stërnipat e tij dhe pasardhësit e largët të tij".Kurse në par.2 i nenit 15 i LTK përcaktohet:"Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte secilit prej tyre sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë pasardhësit". Pra, derisa ekziston mundësia e aplikimit të së drejtës së përfaqësimit gjegjësisht derisa ekzistojnë personat, të cilët më përfaqësim në bazë të lidhjeve të gjakut, mund të thirren në trashëgim në vend të paradhësve të tyre të vdekur, nuk mund të vie në shprehje aplikimi i të drejtës se shtimit. Të drejtën e shtimit në radhën e dytë LTK, e rregullon në nenin 16 ku përcaktohet: "Në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, e nuk ka lënë asnjë pasardhës, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgon prindi tjetër, e në qoftë se edhe ky ka vdekur para trashëgimlënësit, pasardhësit e tij trashëgojnë pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'u takonte të dy prindërve". Ndërsa, në rastin kur të dy prindërit kanë vdekur para trashëgimlënësit e pas veti nuk kanë lënë asnjë pasardhës, e gjithë trashëgimia i takon bashkëshortit pasjetues. Këtë rregull LTK, e ka paraparë shprehimisht në nenin 17 ku thuhet: "Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit e nuk kanë lënë asnjë pasardhës, tërë pasurinë trashëgimore e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit." Pra, ndryshe nga radha e parë në trashëgim, në të cilën bashkëshorti mund të trashëgontë si trashëgimtarë ligjorë, vetëm poqëse ekzistonin trashëgimtarët e tjerë ligjorë të radhës se parë (pasardhësit e trashëgimlënësit), në radhën e dytë bashkëshorti paraqitet si trashëgimtarë ligjorë ekskluzivë. Ndërsa, në rastet kur pas vdekjes se trashëgimlënësit mbesin vetëm prindërit, pra, kur trashëgimlënësi nuk lënë bashkëshorte, e gjithë trashëgimia u ndahet në pjesë të barabarta prindërve të trashëgimlënësit gjegjësisht të dy prindërve u ndahet nga ½ e pasurisë trashëgimore. Kjo rezulton nga nenit 14 par.3 i LTK ku thuhet: "Në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka lënë bashkëshort, prindërit e trashëgimlënësit e trashëgojnë tërë pasurinë në pjesë të barabarta."

2.4.1.5. Radha e tretë e trashëgimisë

Sipas LTK, në radhën e tretë në trashëgim thirren gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit si nga ana e babait ashtu dhe nga ana e nënës. Kjo rregull rrjedh nga neni 18 i LTK, përkatësisht në par.1 i nenit 18 përcaktohet "Pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës, bashkëshort, prindër dhe prindërit e tij nuk kanë lënë pasardhës të tjerë, e trashëgojnë gjyshërit dhe gjyshet e tij", kurse në par. 2 i nenit 18 përcaktohet kësisoj: "Gjysmën e pasurisë trashëgimore e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja nga ana e atit, kurse gjysmën tjetër gjyshi dhe gjyshja nga ana e nënës".Nga këto formulime ligjore rezulton që trashëgimtarët e radhës së tretë,thirren në trashëgim vetëm në mungesë të trashëgimtarëve ligjorë të dy radhëve të tjera të trashëgimisë dhe që të gjithë trashëgimtarëve të thirrur në radhën e tretë trashëgimia u ndahet në pjesë të barabarta. Për shembull, trashëgimlënësi ka lënë gjyshin dhe gjyshen si nga trungu i atësisë ashtu dhe nga trungu i amësisë. Në këtë rast, sipas rregullit trashëgimia do ti ndahet ½ gjyshit dhe gjyshës nga trungu i atësisë dhe ½ gjyshit dhe gjyshes nga trungu i amësisë, përkatësisht trashëgimia ndahet në katër pjesë të barabarta, pra secilit prej trashëgimtarëve u ndahet nga ¼ e pasurisë trashëgimore. Pra, midis gjyshit dhe gjyshës së të njëjtit trung nuk bëhen dallime, por trashëgimia midis tyre ndahet në pjesë të barabarta. Këtë rregull LTK, e parasheh shprehimisht në nenin 19 par.1 ku thuhet: "Gjyshi dhe gjyshja të të njëjtit trung trashëgojnë në pjesë të barabarta." Në rastet kur ndonjëri nga gjyshërit apo gjyshet e trashëgimlënësit (qoftë nga trungu i amësisë apo atësisë) kanë vdekur para trashëgimlënësit (apo kur për ndonjë nga shkaqet e parapara më ligj nuk mund të trashëgojnë) atëherë sipas të drejtës së përfaqësimit thirren në trashëgim pasardhësit e tyre. Kjo rregull rrjedh nga neni 19 par.2 i LTK, ku thuhet: "Në qoftë se ndonjë nga parardhësit e të njëjtit trung ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij sipas rregullave që aplikohen për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët e tij". Për shembull, gjyshi nga trungu i atësisë ka vdekur para trashëgimlënësit dhe pas vetes ka lënë një djalë dhe një vajzë, atëherë në baze të se drejtës se përfaqësimit në vend të gjyshit të vdekur, thirren në trashëgim fëmijët e tij përkatësisht daja dhe tezja e trashëgimlënësit të cilët trashëgojnë ¼ e pasurisë trashëgimore, që do ta kishte trashëguar gjyshi sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit. Në këtë rast, gjyshi dhe gjyshja nga trungu i amësisë trashëgojnë nga ¼ e pasurisë trashëgimore; gjyshja nga trungu i atësisë trashëgon poashtu ¼ e pasurisë trashëgimore; kurse daja dhe tezja e trashëgimlënësit në baze të së drejtës së përfaqësimit trashëgojnë nga 1/8

e pasurisë trashëgimore. Në qofte se në rastin e përmendur më sipër, mos të ekzistonte asnjë pasardhës i gjyshit i cili ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesa trashëgimore e cila do ti takonte atij sikur të ishte gjalle i ndahet gjyshës së të njëjtit trung. Mirëpo, në qoftë se gjyshja dhe gjyshi i të njëjtit trung kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë asnjë pasardhës, atëherë e gjitha trashëgimia (1/1) u ndahet gjyshit dhe gjyshit se trungut tjetër në pjesë të barabarta (pra të dytë trashëgojnë nga ½ e pasurisë trashëgimore). Kjo rregull rrjedh nga neni 20 i LTK, ku thuhet: "Në qoftë se gjyshi dhe gjyshja e të njëjtit trung kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë pasardhës, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'u takonte sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja e trungut tjetër në pjesë të barabarta."

2.4.1.6. Shteti (komuna) si trashëgimtarë ligjorë i radhës së fundit

Sipas LTK, në rastin kur trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë ligjorë (bashkëshort, fëmijë, nipa e mbesa, prindër, vëllezër e motra dhe as gjyshër dhe gjyshe) dhe as tesament trashëgimia i takon autoritetit publik, përkatësisht komunës në të cilën trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin apo vendqendrimin e tij të fundit. Këtë situatë LTK, e rregullon në nenin 21 përkatësisht në par.1 i nenit 21 thuhet: "Nëse trashëgimlënësi nuk lënë as trashëgimtarë ligjor dhe as testament, konsiderohet se trashëgimia i takon komunës ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin ose vendqendrimin e tij të fundit", kurse në par.2 e kësaj dispozite përcaktohet: "Nëse ky vendbanim ose vendqendrim ka qënë jashtë Kosovës, atëherë pasuria trashëgimore konsiderohet se i takon Komunës ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanim ose vendqendrim e tij të fundit në Kosovë dhe nëse nuk ka pasur kurrë këtë, pasuria trashëgimore i takon Kosovës". Siç rezulton në mënyrë që komuna gjegjësisht shteti i Kosovës të konsiderohet trashëgimtarë ligjorë duhet: - Së pari, të mungojnë trashëgimtarët ligjorë e tre radhëve të para të trashëgimisë; dhe -Së dyti, duhet të mos ekzistojë testamenti (pra, trashëgimlënësi të mos këtë lënë testament). Për dallim nga trashëgimtarët ligjorë, e tre radhëve të para të trashëgimisë, autoriteti publik (komuna gjegjësisht shteti i Kosovës) kur e fiton pozitën e trashëgimtarit ligjorë nuk mund të heqë dorë nga trashëgimia.[250] Pra, autoriteti publik shpallet trashëgimtarë *"ipso jure"* i trashëgimlënësit. Sipas rregullave të përmbajtura në LTK, në rastin kur nuk dihet nëse trashëgimlënësi ka lënë ose jo trashëgimtarë ligjorë, gjykata me anë të shpalljes ka për detyrë t'i thërrasë personat që pretendojnë se kanë të drejtë për trashëgim që të paraqiten në gjykatë. Nëse

[250] Shih H. Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore, Prishtinë. Fq.61

nga dita kur gjykata ka bërë shpalljen publike kanë kaluar 1 vit dhe nuk është paraqitur asnjë trashëgimtarë, atëherë pasuria trashëgimore i dorëzohet komunës kompetente.[251]Përkatësisht, pasuria e paluajtshme i dorëzohet komunës në territorin e së cilës ndodhet, kurse pasuria e luajtshme i dorëzohet komunës në territorin e së cilës trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin apo vendqëndrimin në Kosovë. Ndërsa, në rastin kur trashëgimlënësi në kohën e vdekjes nuk ka pasur vendbanim apo vendqëndrim në Kosovë, pasuria e luajtshme i dorëzohet komunës në territorin e së cilës ndodhet gjykata trashëgimore.[252] Nëse pasi pasuria trashëgimore (e luajtshme apo e paluajtshme) i është dorëzuar komunës paraqitet ndonjë trashëgimtarë, sipas ligjit ai ka të drejtë që të kërkojë nga komuna që t'i kthejë pasurinë trashëgimore apo pjesën që i takon.[253] Pra, trashëgimtari që paraqitet më vonë (dmth., pas kalimit të 1 viti prej kur gjykata ka bërë shpalljen) nuk e humbë të drejtën që të kërkojë që t'i dorëzohet pasuria trashëgimore ose pjesa që i takon. E drejta e trashëgimtarit për të kërkuar trashëgiminë parashkruhet brenda 20 viteve nga dita e shpalljes së testamentit, ose kur nuk ka testament që nga vdekja e trashëgimlënësit. Kjo rezulton nga neni 128 par. 3 i LTK ku thuhet: "Nëse trashëgimtari nuk e ka kërkuar trashëgiminë brenda 20 viteve nga data e shpalljes së testamentit, ose kur nuk ka testament që nga vdekja e trashëgimlënësit, trashëgimlënësi do të konsiderohet pa trashëgimtarë ligjorë ose testamentarë dhe do të aplikohen dispozitat ligjore në lidhje me të drejtat në trashëgimi të komunave".

[251] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 127.
[252] Po aty, shih nenin 128.
[253] Po aty, shih nenin 127 par.2.

2.5. Trashëgimtarët e domosdoshëm

Trashëgimtarët e domosdoshëm janë një kategori e priviligjuar e trashëgimtarëve ligjorë, të cilëve më ligj u garantohet një pjesë e pasurisë trashëgimore, pavarësisht vullnetit të trashëgimlënësit, madje edhe kundër vullnetit të trashëgimlënësit nëse trashëgimtari i domosdoshëm e kërkon atë. E drejta e trashëgimisë e trashëgimtarit të domosdoshëm rrjedh drejtëpërsëdrejti nga dispozitat imperative.[254]Në literaturën juridike pjesa e pasurisë trashëgimore, e cila më ligj u garantohet trashëgimtarëve të domosdoshëm quhet pjesa e domosdoshme, e cila nuk mund të ndryshohet më testament dhe as më kontratë dhurate.[255] Pjesa trashëgimore e domosdoshme përkufizohet në mënyrë pothuasje të njëjtë edhe më dispozita ligjore. Kështu, LTK në nenin 31 par.1 përcakton: "Trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pasurinë trashëgimore me të cilën trashëgimlënësi nuk mund të disponojë dhe e cila quhet pjesë e domosdoshme". Pra,më parashikimin e pjesës trashëgimore të domosdoshme, testatorit i vihet një kufizim i rëndësishëm për të disponuar lirisht pasurinë e tij. Ky kufizim bëhet më qëllim për të mbrojtur interesat e disa prej trashëgimtarëve ligjorë. Në teorinë juridike dhe në praktikë trashëgimtarët e domosdoshëm ndahen në dy grupe. Grupin e parë, të trashëgimtarëve të domosdoshëm e përbëjnë trashëgimtarët ligjorë, për të cilët ligji nuk kërkon që të plotësohen kushte shtesë që të mund të bëhen trashëgimtarë të domosdoshëm. Këta trashëgimtarë kërkohet që t'i plotësojnë vetëm kriteret objektive që kërkohen për çdo trashëgimtarë ligjorë, pra trashëgimtari duhet të ekzistojë në momentin e çeljes së trashëgimisë (më përjashtim të fëmijës së konceptuar); duhet të jetë i aftë dhe i denjë për të trashëguar. Ndryshe, në teorinë juridike, ky grup i trashëgimtarëve të domosdoshëm quhen trashëgimtarë të domosdoshëm absolutë.[256] Për grupin tjetër të trashëgimtarëve të domosdoshëm, përveç kritereve objektive që të mund të bëhen trashëgimtarë të domosdoshëm kërkohet që t'i plotësojnë edhe kriteret e caktuara subjektive, siç janë a) të jenë plotësisht të paaftë për punë dhe b) të mos kenë mjete për jetesë. Ky grup i trashëgimtarëve të domosdoshëm ndryshe quhen trashëgimtarë të domosdoshëm relativë.[257] Sipas LTK, në kategorinë e trashëgimtarëve të domosdoshëm absolutë hyjnë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe

[254] N.Stojanović (2013). Efectuation and Protection of the Rights to a Forced Portion in Contemporary Serbian Law. Iustinianus Primus Law Review Vol. 4:2. Fq.1. (http://law-reviw.mk/pdf/07/Natasa%20Stojanovic.pdf).
[255] Shih H. Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore, Prishtinë. Fq.64
[256] Новак М.Крстић (2015).ПОВРЕДА И ЗАШТИТА ПРАВА НА НУЖНИ ДЕО (докторска дисертација) УНИВЕРЗИТЕТ У НИШУ ПРАВНИ ФАКУЛТЕТ. Fq.80.
[257] Po aty. Fq.80.

bashkëshorti i tij. Ndërkaq, në kategorinë e trashëgimtarëve të domosdoshëm relativë hyjnë: gjyshërit e trashëgimlënësit, motrat e vëllezërit e trashëgimlënësit.[258]Pra, rrethi i trashëgimtarëve ligjorë të cilëve u takon pjesa e domosdoshme, sipas ligjit tonë është i gjerë. Duhet theksuar se kjo nuk është në përputhje më trendet aktuale të legjislacioneve bashkëkohore.Tendencë e legjislacioneve bashkëkohore është kufizimi i rrethit të të afërmve të trashëgimlënësit, si trashëgimtarë të domosdoshëm. Sikurse mund të shihet edhe nga tabela më poshtë, në asnjërin nga legjislacionet e shteteve të UE-së.(më përjashtim të legjislacionit slloven) nuk përfshihen në kategorinë e trashëgimtarëve të domosdoshëm vëllezërit e motrat apo gjyshërit e trashëgimlënësit. Madje, në legjislacionet e disa shteteve të UE-së, si në Holandë,[259] Finlandë,[260] Sllovaki,[261] Republike Çeke[262] etj., si trashëgimtarë të domosdoshëm konsiderohen vetëm fëmijët e trashëgimlënësit. Parë në këtë konteks, në mënyrë që edhe legjislacioni ynë të jetë në qasje më legjislacionet e shteteve të UE-së, është e nevojshme ,pra, të kufizohet rrethi i trashëgimtarëve të domosdoshëm.Është e rëndësishme të theksohet se trashëgimtarët e domosdoshëm thirren në trashëgim, sipas rendit ligjorë të trashëgimit, në atë mënyrë që trashëgimtarët e një radhë trashëgimore përjashtojnë nga trashëgimi trashëgimtarët e radhëve pasuese.[263] Për shembull, nëse trashëgimlënësi ka lënë bashkëshorten, 2 fëmijë dhe prindërit. Në këtë rast, pjesa trashëgimore e domosdoshme u takon vetëm bashkëshortës dhe fëmijëve të trashëgimlënësit (si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të trashëgimisë) e jo edhe prindërve.

[258] Ligji Nr. 2004 / 26 Për Trashëgimi i Kosovës, shih nenin131 par.1dhe 2.
[259] Dutch Civil Code. (Civil Code of the Netherlands) Section 4.4.3 article 4:64.
[260] Code of Inheritance in Finland (40/1965; amendments up to 1228/2001 included).Chapter 7 section 1
[261] Act No. 40/1964 Coll. the Civil Code of Slovakia, as amended . Article 479.
[262] Law No. 89/2012. Civil Code Czech Republic. (Zákon č. 89/2012 Sb. občanský zákoník České Republiky). Article 1463.
[263] Shih H. Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore, Prishtinë. Fq.67

Tabela 3: Trashëgimtarët e domosdoshëm sipas legjislacioneve të shteteve të UE-së.

Shteti	Trashëgimtarët e domosdoshëm
Holandë, Luksemburg, Suedi, Finlandë, Slovaki dhe Republikë Çeke[264].	Fëmijët e trashëgimlënësit
Francë, Danimarkë, Irlandë , Maltë.[265]	Fëmijët dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit
Gjermani, Belgjikë, Austri , Spanjë, Estoni, Latvi dhe Qipro.[266]	Fëmijët dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit. Në mungesë të fëmijëve dhe pasardhësve të tyre edhe prindërit e trashëgimlënësit.
Itali, Hungari, Portugali dhe Poloni, Bullgari , Rumani dhe Greqi.[267]	Fëmijët, bashkëshorti dhe prindërit e trashëgimlënësit.
Lituani[268]	Fëmijët dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit si dhe prindërit nëse i ka mbajtur trashëgimlënësi.
Kroaci[269]	Fëmijët e trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre dhe bashkëshortja e tij si dhe prindërit e trashëgimlënësit dhe paradhësit e tjerë nëse nuk kanë mjete të domosdoshme për jetesë.
Sllloveni[270]	Fëmijët dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti dhe prindërit e trashëgimlënësit si dhe vëllezërit e motrat dhe gjyshërit e trashëgimlënësit nëse nuk kanë mjete të domosdoshme për jetesë.

[264] Shih Kodin Civil të Holandes (shih Librin 5 seksionin 4.4.3, nenin 4:64); Kodin Civil i Luksemburgut (nenin 913); Ligjin për Trashëgimi i Suedisë (shih kapitullin 7); Kodin e Trashëgimisë i Finlandës (shih kapitulin 7 neni 1); Kodin Civil të Sllovakisë (nenin 479); Kodin Civil të Republikës Çeke (nenin 1463).

[265] Shih Kodin Civil Francez (nenin 912-913); Ligjin per Trashëgimi i Danimarkës (nenet 5-10);); Ligjin per Trashëgimi i Irlandës (nenet 111-117); Kodin Civil të Maltës (nenin 615).

[266] Shih Kodin Civil Gjerman (nenin 2303); Kodin Civil Belg (nenet 913-915); Kodin Civil Austriak (nenin 762-763); Kodin Civil Spanjoll (nenin 807); Ligjin per Trashëgimi i Estonië (shih nenin 104); Kodin Civil të Latvisë (nenin 423); Ligjin për testamentet dhe trashëgimine i Qipros (nenin 4).

[267] Shih Kodin Civil Italian (nenin 536); Kodin Civil të Hungarisë (shih Librin VII nenin 7:75); Kodin Civil të Portugalisë (shih nenin 2157); Kodin Civil të Polonisë (nenin 991); Ligjin per Trashëgimi i Bullgarise (shih nenet 28-29); Kodin Civil të Rumanisë (nenin 1087); Kodin Civil Grek (neni 1825).

[268] Kodi Civil i Lituanisë, shih librin e pestë nenin 5.20 . (Civil Code of the Republic of Lithuania, of July 18, 2000, Law No. VIII-1864 (Last amended on April 12, 2011, No XI-1312)

[269] Ligji për Trashëgimi i Kroacisë, shih nenin 69 par.1 dhe 2.

[270] Ligji për Trashëgimi i Sllovenisë, shih nenin 25 par.1 dhe 2.

2.5.1. Pjesa e pasurisë trashëgimore që u takon trashëgimtarëve të domosdoshëm

Sikurse në çdo legjislacion ku njihet pjesa e domosdoshme edhe në legjislacionin tonë, madhësia e pjesës së domosdoshme përcaktohet si kuotë dhe nuk është e njëjtë për të gjithë trashëgimtarët e domosdoshëm. Përkatësisht sipas LTK, madhësia e pjesës së domosdoshme e bashkëshortit dhe pasardhësve të trashëgimlënësit është ½. Kurse e trashëgimtarëve të tjerë të domosdoshëm është 1/3, e asaj që do t'i përkiste si trashëgimtarë ligjorë sipas rendit ligjor të trashëgimit. Llogaritja e pjesës së domosdoshme përcaktohet në bazë të vlerës së pasurisë trashëgimore. LTK, në nenin 32 përmbanë rregulla të veçanta më të cilat përcaktohen bazat për llogaritjen e pjesës së domosdoshme. Sipas rregullave të përmbajtura në nenin e cituar më sipër, llogaritja e pjesës se domosdoshme bëhet në këtë mënyrë: Së pari, bëhet inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore, në këtë inventarizim llogariten edhe të gjitha të mirat që trashëgimlënësi i ka disponuar me testament si dhe të gjitha borxhet që ia kanë të tjerët, me përjashtim të borxheve për të cilat duket qartë që janë të papagueshme.[271] Pra, së pari përcaktohet vlera totale e pasurisë që ka patur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes gjegjësisht aktivi i pasurisë trashëgimore. Së dyti, pasi përcaktohet vlera e pasurisë trashëgimore, ndahet një pjesë e pasurisë trashëgimore për pagesën e borxheve që ka lënë trashëgimlënësi dhe shpenzimeve që janë bërë më rastin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë trashëgimore si dhe shpenzimeve të varrimit të trashëgimlënësit.[272]Pra, nga vlera e përgjithshme e pasurisë bëhet zbritja e borxheve të cilat i ka lënë trashëgimlënësi. Së treti, pjesës së pasurisë që mbet pas zbritjes së borxheve dhe shpenzimeve i shtohet vlera e të gjitha dhurimeve që trashëgimlënësi i ka bërë ndaj ndonjë trashëgimtari ligjor. Këtu llogariten edhe dhurimet që trashëgimlënësi u ka bërë trashëgimtarëve që heqin dorë nga trashëgimi, madje edhe dhurimet për të cilat vet trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore. Gjithashtu, llogariten edhe dhurimet që trashëgimlënësi u ka bërë personave të tjerë (që nuk janë trashëgimtarë ligjorë) gjatë vitit të fundit të jetës së vet, me përjashtim të dhurimeve të rëndomta.[273]Duhet theksuar se më dhurim në kuptim të dispozitave të LTK nënkuptohet: "çdo heqje dorë nga një e drejtë, falja e borxhit, çdo transferim i pasurisë në interes të një

[271] Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 32 par.2.
[272] Po aty, shih nenin 32 par.3.
[273] Po aty, shih nenin 32 par.4 dhe .5 .

trashëgimtari në emër të pjesës trashëgimore, ose për të themeluar apo për të zgjeruar familjen, ose për të ushtruar mjeshtërinë, si dhe çdo disponim tjetër pa shpërblim".[274]

Tabela 4: Madhësia e pjesës trashëgimore e trashëgimtarëve të domosdoshëm në Kosovë

Trashëgimtarët e domosdoshëm	Madhësia e pjesës së domosdoshme
Fëmijët e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre Bashkëshortit pasjetues i trashëgimlënësit	**1/2**
Prindërit e trashëgimlënësit Vëllezërit e motrat e trashëgimlënësit Gjyshërit e trashëgimlënësit	**1/3**

2.5.1.2. Si veprohet në rastin kur cenohet pjesa trashëgimore e domosdoshme

Sipas LTK, pjesa e domosdoshme konsiderohet se është cenuar, në rastin kur vlera e përgjithshme e disponimit më testament dhe e dhurimeve e tejkalon pjesën disponibile.[275] Në rastin kur pas llogaritjes së pjesës së domosdoshme vërtetohet se për shkak të disponimit të pasurisë që e ka bërë trashëgimlënësi (qoftë më testament apo dhurate) është cënuar pjesa e domosdoshme e ndonjë trashëgimtari ligjorë, atëherë më qëllim të plotësimit të pjesës së domosdoshme bëhet zvogëlimi i disponimit më testament dhe kthehen dhurimet. Kjo rregull rrjedh nga neni 38 par.1 i LTK ku thuhet: "kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimi do të kthehet në masën që nevojitet të plotësohet pjesa e domosdoshme". Sa i përkët radhës së zvogëlimit dhe kthimit të dhurimeve LTK, ka sanksionuar rregullën se fillimisht bëhet zvogëlimi i disponimit më testament, e në rast se edhe pas kësaj, nuk plotësohet pjesa e domosdoshme atëherë kthehen dhurimet.[276] Sipas LTK, zvogëlimin e disponimit më testament dhe kthimin e dhurimeve, më të cilat është cënuar pjesa e domosdoshme mund ta kërkojnë vetëm trashëgimtarët e domosdoshëm.[277]E drejta e trashëgimtarit të domosdoshëm për të kërkuar zvogëlimin e disponimit më testament është e drejtë e kufizuar në pikëpamje kohore, për faktin se më ligj është caktuar afati deri kur mund të

[274] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 33.
[275] Po aty, shih nenin 38 par.2
[276] Po aty, shih neni 39 par.1
[277] Po aty, shih nenin 45 par.1

realizohet kjo e drejtë. Kështu, sipas LTK, trashëgimtari i domosdoshëm mund të kërkojë zvogëlimin e disponimit më testament brenda afatit prej 3 vjetësh nga shpallja e testamentit, ndërsa kthimin e dhuratave brenda afatit prej 3 vjetësh nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marrë formën e prerë vendimi për shpalljen e tij si të vdekur.[278]

2.5.1.3. Si bëhet zvogëlimi i disponimit më testament dhe kthimi i dhurimeve

Sikurse u theksua më lartë, trashëgimtarët e domosdoshëm të cilëve u është cënuar pjesa e domosdoshme më qëllim të plotësimit të pjesës trashëgimore të tyre, së pari kanë të drejtë të kërkojnë zvogëlimin e disponimit më testament, e nëse kjo nuk mjafton atëherë mund të kërkojnë kthimin e dhurimeve. Sipas LTK, zvogëlimi i disponimit më testament bëhet vetëm deri në masën e cila është e mjaftueshme për përmbushjen e pjesës së cënuar të domosdoshme. Në rastet kur trashëgimlënësi më disa testamente ka disponuar pasurinë trashëgimore, zvogëlimi i disponimit më testament bëhet në mënyrë proprocionale pavarësisht nga lloji dhe vëllimi i trashëgimisë, përveç rasteve kur trashëgimlënësi ka caktuar vetë radhën e zvogëlimit të disponimit më testament. Kjo rregull rrjedh nga neni 40 i LTK ku thuhet: "Disponimet me testament zvogëlohen në të njëjtën masë, pa marrë parasysh natyrën e tyre dhe vëllimin e tyre dhe pa marrë parasysh a gjenden në një ose më shumë testamente, po qe se nga testamenti nuk del diçka tjetër". Ndërsa, kthimi i dhurimeve sipas rregullave të përmbajtura në LTK, bëhet duke filluar nga dhurimi i fundit dhe vazhdon në të kundërtën me radhë tek dhurimet e mëparshme, kurse dhurimet e bëra njëkohësisht kthehen në mënyrë proporcionale nga vlera e dhurimit.[279] Është më rëndësi të theksohet se dhuratmarrësi i cili detyrohet të kthejë sendin e dhuruar, konsiderohet si mbajtës me mirëbesim i sendit të dhuruar deri në ditën që ka marrë dijeni për kërkesën që të kthejë dhurimin.[280] Në rastin kur dhurata nuk mund të kthehet si send (in rem), personi që ka pranuar dhuratën duhet të kthejë vlerën e saj të llogaritur sipas rregullave që vlejnë për kthimin në rastin e pasurimit pa bazë.[281] LTK, në mënyrë shprehimore ka sanksionuar rregullën se "çdo trashëgimtari ligjor i llogaritet në pjesën trashëgimore çdo gjë që ka marrë dhurim nga trashëgimlënësi në çfarëdo mënyre" më përjashtim: a) të fryteve dhe përfitimeve të tjera që ka pasur trashëgimtari nga sendi i dhuruar deri në vdekjen e trashëgimlënësit; si dhe b)

[278] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 46.
[279] Po aty, shih nenin 43 par.1 dhe 2.
[280] Po aty, shih nenin 44.
[281] Po aty, shih nenin 39 par.2.

dhurimeve për të cilat trashëgimlënësi ka deklaruar në kohën e dhurimit ose më vonë ose në testament se nuk do ti llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore ose nga rrethanat e tjera mund të vihet në përfundim se ky ka qenë vullneti i trashëgimlënësit.[282] Në rastin kur sipas vullnetit të trashëgimlënësit dhurimi nuk duhet t'i llogaritet trashëgimtarit në pjesën trashëgimore të tij, trashëgimtari i këtillë mban dhurimin dhe merr pjesë me trashëgimtarët e tjerë, në ndarjen e pasurisë trashëgimore sikur të mos kishte marrë fare dhurim. Mirëpo, në rastet kur ka trashëgimtarë të domosdoshëm, bëhen përjashtime nga kjo rregull, ashtu që trashëgimtari mund të mbajë dhurimin vetëm brenda kufijëve të pjesës së domosdoshme.[283] LTK, e rregullon edhe çështjen e shpenzimeve të bëra nga ana e trashëgimlënësit për mbajtjen financiare të trashëgimtarëve të domosdoshëm dhe shkollimin e tyre. Sipas rregullit të përgjithshëm, shpenzimet që i ka bërë trashëgimlënësi për mbajtjen e trashëgimtarit dhe për shkollimin e tij të detyrueshëm nuk llogariten në pjesën trashëgimore të tij.[284] Më LTK, nuk përcaktohet se çka nënkuptohet më mbajtje apo shkollim të detyrueshëm. Institucioni i mbajtjes rregullohet më dispozitat e Ligjit për Familje. Më LFK, përcaktohet se të afërmit në vijë të drejtë janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare reciproke.[285]Mbajtja financiare u siguron personave të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë të drejtën për të kërkuar mbajtje nga të afërmit e tyre, derisa nuk sigurojnë mjete për jetesë, në anën tjetër personat të cilët janë të detyruar të ofrojnë mbajtjen duhet të kenë mundësi për të ofruar atë, pa e rrezikuar ekzistencën e vet.[286] Për shembull, prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje për fëmijët e tyre të mitur, përjashtimisht edhe për fëmijët e moshës madhore deri në moshën 26 vjeçare nëse ata vazhdojnë shkollimin.[287] Pra,shpenzimet të cilat i bënë trashëgimlënësi lidhur më mbajtjen e trashëgimtarëve pa mjete për jetesë nuk llogariten në pjesën e tyre trashëgimore, për arsye se trashëgimlënësi ka patur detyrim ligjorë t'i mbajë ata. Sikurse u theksua edhe më lartë, shpenzimet e bëra nga trashëgimlënësi, lidhur më shkollimin e detyrueshëm të trashëgimtarëve, nuk llogariten në pjesën e tyre trashëgimore. LTK, nuk e përcakton se çka kuptohet më shkollim të detyrueshëm. Sipas LAFM[288]arsimi i detyrueshëm nënkupton përfundimin e arsimit të mesëm të ulët (pas 9 vitesh). Nga kjo rezulton që shpenzimet të cilat i bënë trashëgimlënësi për shkollimin e trashëgimtarit

[282] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 47 par.1, 2,3.
[283] Po aty, shih nenin 50.
[284] Po aty, shih nenin 53 par.1.
[285] Ligji për Familje i Kosovës, shih nenin 278.
[286] Shih A.Aliu & H.Gashi (2007) E Drejta Familjare, Prishtinë. Fq. 300.
[287] Shih H.Podvorica (2010) E Drejta Familjare, Prishtinë Fq. 178 .
[288] Ligji mbi Arsimin Fillorë dhe të Mesëm në Kosovë, shih nenin 7 ku thuhet:" Shkollimi i detyruar mbaron me përfundimin e vitit të nëntë të shkollimit nga data e regjistrimit në arsimin fillor ose në datën kur nxënësi i mbush 15 vjet, varësisht se cila nga këto përputhet".

deri në klasën e nëntë (deri në moshën 15 vjeçare) nuk llogariten në pjesën e tij trashëgimore. Megjithatë, siç është theksuar edhe më sipër sipas rregullave të institucionit të mbajtjes financiare, prindërit janë të detyruar t'i mbajnë fëmijët e tyre deri në arritjen e moshës madhore, e më shumti deri në moshën 26 vjeçare nëse ata vazhdojnë shkollimin. Për këtë shtrohet pyetja, shpenzimet të cilat i bënë trashëgimlënësi për shkollimin e mëtejshëm të trashëgimtarëve, a llogariten në pjesën e tyre trashëgimore ose jo. Përkitazi më këtë çështje LTK, në nenin 53 par.2 shprehet: "Gjykata do të vendosë sipas rrethanave nëse shpenzimet që ka bërë trashëgimlënësi për shkollimin e mëtejshëm të trashëgimtarëve do të llogariten në pjesën trashëgimore të tyre dhe në ç'masë, duke marrë parasysh sidomos vlerën e pasurisë trashëgimore dhe shpenzimet e shkollimit si dhe aftësinë e trashëgimtarëve të tjerë për të mbajtur veten." Pra, gjykata vendosë se trashëgimtarëve në pjesën trashëgimore të tyre t'i llogariten shpenzimet të cilat i ka bërë trashëgimlënësi për shkollimin e tyre duke u bazuar në tri kritere: a) vlerën e pasurisë trashëgimore b) shpenzimet e shkollimit si dhe c) aftësinë e trashëgimtarëve të tjerë për të mbajtur veten. Nga kjo rezulton që gjykata vendosë t'i llogarit në pjesën trashëgimore të trashëgimtarëve edhe shpenzimet që trashëgimlënësi i ka bërë për shkollimin e tyre, kur konstaton se shpenzimet kanë qenë të mëdha ashtu që vlera e pasurisë trashëgimore do të ishte dukshëm më e lartë, sikur të mos ishin bërë ato dhe që trashëgimtarët e tjerë për të cilët trashëgimlënësi nuk ka bërë shpenizme do të përfitonin më tepër nga pasuria trashëgimore. Ky qendrim i ligjvënësit është i aryseshëm dhe i drejtë. Për shembull, do të ishte e padrejtë që nga pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit të përfitonin njëjtë si trashëgimtari A për shkollimin e të cilit trashëgimlënësi ka kryer shpenzime të mëdha, ashtu dhe për trashëgimtarin B për shkollimin e të cilit trashëgimlënësi nuk ka kryer asnjë shpenzim dhe i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për jetesë.

2.5.1.4. Përjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm nga trashëgimia

Edhe pse trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pjesën e domosdoshëm, madje edhe kundër vullnetit të trashëgimlënësit, sipas ligjit lejohet mundësia që trashëgimlënësi më testament të përjashtojë, tërësisht ose pjesërisht nga trashëgimia trashëgimtarin e domosdoshëm, më kusht që të jetë plotësuar ndonjëri nga shkaqet e parapara më ligj.[289] LTK, në nenet 114-118, përmbanë dispozita të veçanta, më të cilat rregullohen shkaqet për të cilat trashëgimlënësi mund ta përjashtojë nga testamenti, trashëgimtarin e domosdoshëm dhe pasojat e përjashtimit. Kushtet që domosdo kërkohen të plotësohen sipas LTK, në mënyrë që përjashtimi i trashëgimtarit të domosdoshëm të jetë i vlefshëm janë: a) trashëgimlënësi duhet ta shprehë në mënyrë të qartë se cilin trashëgimtar e përjashton nga trashëgimia dhe duhet ta tregojë shkakun e këtij përjashtimi;[290] si dhe b) shkaku i përjashtimit (i cili e bënë të padenjë personin të trashëgojë) duhet të ekzistojë në momentin e hartimit të testamentit.[291]Në literaturën juridike shqiptare, paraqitet si e diskutueshme çështja nëse rregullat e institutit të padenjësisë duhet të aplikohen në trashëgiminë më testament ose jo. Sipas një pikëpamje, rregullat e padenjësisë aplikohen në mënyrë strikte edhe në trashëgiminë testamentare, sepse ligji nuk e lidh padenjësinë më llojin e trashëgimisë më ligj apo më testament si dhe për shkakun se më ligj nuk lejohet që trashëgimlënësi ta lë pa efekt ndonjë dispozitë ligjore.[292] Edhe autori i pikëpamjes tjetër, pajtohet më mendimin se rregullat e padenjësisë, e shtrin efektin edhe në trashëgiminë testamentare, mirëpo, sipas tij është e diskutueshme karakteri i këtyre rregullave, nëse ato janë urdhëruese ose autorizuese. Sipas autorit të kësaj pikëpamje, nuk ka dyshim se për trashëgimtarin, normat e padenjësisë kanë karakter urdhërues, mirëpo nuk mund të thuhet së të njëjtin karakter e kanë edhe për trashëgimlënësin, sepse trashëgimlënësi pavarësisht nga qëndrimi që ka mbajtur trashëgimtari ndaj tij, ai më testament mund të vendosë t'ia lë pasurinë atij në trashëgim.[293] Pra, sipas kësaj pikëpamje padenjësia varet nga vullneti i trashëgimlënësit. Nga analizimi i nenit 113, i LTK, në të cilën është sanksionuar rregulla, që trashëgimlënësit i njihet e drejta që ta falë personin e padenjë për ta trashëguar, del se edhe ligjvënësi ynë përkrah qëndrimin e pikëpamjes së dytë. Përkatësisht në nenin 113 i LTK, thuhet: "trashëgimlënësi ka të drejtë që të falë personin

[289] Shih Новак Крстић. КОНЦЕПТУАЛНА МИМОИЛАЖЕЊА У РЕГУЛИСАЊУ НУЖНОГ НАСЛЕЂИВАЊА У РЕПУБЛИЦИ СРБИЈИ И РЕПУБЛИЦИ СРПСКОЈ, UDK: 347.65/.68 (497.11+497.6). ЗБОРНИК РАДОВА ПРАВНОГ ФАКУЛТЕТА, БР. LIX. Fq.244.

[290] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin116 par.1

[291] Po aty, shih nenin 116 par.2.

[292] K. Koci, Padenjësia në të drejtën e trashëgimisë, Drejtësia Popullore, viti 1973 Nr.6, faqe 11-17 (cituar nga Biçoku, N (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë .Tiranë .Fq.54).

[293] N.Biçoku (1997) vepra e njëjtë. Fq. 54.

e padenjë për ta trashëguar, më kusht që falja të bëhet shprehimisht me testament, ose kur faljen, ndonëse nuk është bërë shprehimisht, trashëgimlënësi ka shënuar në testament se e ka njohur padenjësinë dhe megjithatë e cakton atë si trashëgimtar". Pra, sipas LTK, lejohet revokimi i padenjësisë gjegjësisht falja e saj nga ana e trashëgimlënësit, që do të thotë trashëgimlënësi është i lirë të vendosë vetë më rastin e hartimit të testamentit, nëse dëshiron ta përfshijë ose jo në testament trashëgimtarin, i cili ndaj tij ka mbajtur një qëndrim jo të mirë, që e bënë atë të padenjë për të trashëguar.

2.5.1.5. Shkaqet e përjashtimit

LTK, në nenin 114 përmend saktësisht shkaqet për të cilat trashëgimlënësit, i lejohet që të përjashtojë nga testamenti trashëgimtarin e domosdoshëm. Këto shkaqe janë:

A) Nëse personi me shkeljen e ndonjë detyrimi ligjor ose moral ka bërë cenim të rëndë ndaj trashëgimlënësit.[294]

Më ligj nuk janë përcaktuar kriteret në bazë të të cilave cilësohet sjellja e një personit si shkelje e rëndë e detyrimit ligjor apo moral, e cila ka për pasojë përjashtimin e tij nga trashëgimia. Nga kjo rezulton që gjykatës i është lënë për detyrë, të vlerësojë vetë se kur një person është ose jo i padenjë për të trashëguar, për shkak të shkeljes së rëndë të detyrimit ligjor apo moral të tij. Në doktrinën juridike si shkelje e rëndë e ndonjë detyrimi ligjorë apo moral konsiderohet mos pagesa e mbajtjes, mos dhënia e ndihmës në rastin e sëmundjes etj.[295]

B) Nëse personi ka bërë me dashje ndonjë vepër të rëndë penale ndaj trashëgimlënësit, bashkëshortit, fëmijës ose prindit të tij.[296]

Në këtë rast, për tu shpallur personi i padenjë për trashëgim është e nevojshme që të ekzistojë vendimi gjyqësor, më të cilin ai është shpallur fajtor për kryerjen e veprës së rëndë penale, ndaj trashëgimlënësit apo të afërmve të tij. Më dispozitat e LTK, nuk përcaktohet se për kryerjen e cilave veprave të rënda penale një person mund të përjashtohet nga trashëgimia. Lidhur më këtë çështje në doktrinën juridike, janë shfaqur mendime të ndryshme se mbi çfarë kritereve kryerja e një vepre e personit vlerësohet si vepër e rëndë penale, e cila ka për pasojë shpalljen e personit të padenjë për trashëgim. Sipas disa autorëve, përcaktimi i një vepre të personit si vepër e rëndë penale, bëhet duke u bazuar në llojin dhe lartësinë e dënimit që

[294] Ligji Nr. 2004 / 26 Për Trashëgimi i Kosovës, shih nenin 117 pika a.
[295] Shih A.Gams (1986), Hyrje në të Drejtën Civile (Pjesa XII. E Drejta e Trashëgimit), Prishtinë. Fq. 379.
[296] Ligji Nr. 2004 /26 Për Trashëgimi i Kosovës, shih nenin 117 pika b.

parashihet më ligj për atë vepër penale.[297] Siç dihet parashikimi i veprave penale dhe llojet e dënimeve bëhen më ligjet penale. Sipas ligjit penal, lartësia e dënimit përcaktohet duke pasur parasysh rrezikshmërinë dhe pasojën e veprës së kryer penale.

C) Nëse personi është plangprishës, nuk do të punojë ose është dhënë pas jetës së pandershme.[298]

Më LTK, nuk është përcaktuar se çka nënkuptohet më sjellje të pandershme të trashëgimtarit përkatësisht nuk është përcaktuar se cilat sjellje të trashëgimtarit konsiderohen të pandershme të cilat e bëjnë atë plangprishës. Sipas doktrinës juridike, personi konsiderohet se ka sjellje të pandershme dhe është plangprishës kur ai merret më bixhoz, prostitucion në mënyrë të përhershme apo kur ai është alkoolist.[299] Siç dihet pjesa trashëgimore e personit që përjashtohet nga trashëgimi si i padenjë, në këtë rast e personit plangprishës, u kalon pasardhësve të tij.

2.5.1.6. Privimi nga pjesa e domosdoshme

Përveç mundësisë së përjashtimit nga trashëgimia sipas LTK, trashëgimlënësit i lejohet edhe mundësia që të privojë pasardhësin e tij nga pjesa e domosdoshme. Përkatësisht sipas LTK, në rastin kur pasardhësi, i cili ka të drejtë në pjesën e domosdoshme është detyruar së tepërmi (d.m.th është në borxhe) ose është plangprishës (bënë jetë të pandershme), testamentlënësi mund ta privojë plotësisht ose pjesërisht, nga pjesa e tij e domosdoshme në interes të pasardhësve të tij të mitur. Kjo rezulton nga neni 118 i LTK ku thuhet: "kur trashëgimtari i domosdoshëm ka shumë borxhe ose është plangprishës, trashëgimlënësi ka të drejtë që të përjashtojë (privoje) atë në tërësi ose pjesërisht nga pjesa e domosdoshme e tij, në dobi të pasardhësve të tij". Pra, që të lejohet privimi nga pjesa e domosdoshme kërkohet domosdo të plotësohen këto kushte: a) trashëgimtari i domosdoshëm duhet të jetë plangprishës ose të këtë shumë borxhe; b) trashëgimtari i domosdoshëm në momentin e hapjes së trashëgimisë duhet të këtë pasur fëmijë të mitur ose nipër të mitur nga fëmija i vdekur më parë; ose c) duhet të ketë pasur fëmijë madhor ose nipër madhor nga fëmija i vdekur më parë , që janë të paaftë për punë.

[297] Shih H. Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore, Prishtinë. Fq.70.
[298] Ligji Nr. 2004 /26 Për Trashëgimi i Kosovës, shih nenin 117 pika c.
[299] Shih H. Podvorica (2010) vepra e njëjtë. Fq.76.

2.6. Rregullimi i trashëgimisë ligjore në Maqedoni, Shqipëri, Slloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë

2.6.1. Rrethi i trashëgimtarëve ligjorë

Më ligjet e analizuara të shteteve të përfshira në studim, përkatësisht më dispozitat e LTMK[300], LTRS[301], LTSI[302], LTHR[303], LTME [304], LTBH[305] dhe më dispozitat e KCSH[306], sikurse është theksuar edhe më parë, njihen dhe rregullohen dy forma themelore të trashëgimisë: a) trashëgimia ligjore; dhe b) trashëgimia testamentare. Pra, sipas dispozitave të ligjeve të analizuara, kalimi i pasurisë i personit të vdekur tek personat e tjerë, mund të bëhet në bazë të vullnetit të shprehur të trashëgimlënësit gjegjësisht më testament dhe në bazë të rregullave të parapara më ligj. Sipas rregullave të përmbajtura në ligjet e analizuara, rregullat e trashëgimisë ligjorë aplikohen vetëm në mungesë të testamentit, që do të thotë trashëgimia testamentare gëzon prioritet në raport më trashëgiminë ligjorë. Siç dihet në rastin kur aplikohet trashëgimia ligjore, pasuria trashëgimore u kalon personave të cilët më ligj janë të caktuar si trashëgimtarë ligjorë. Sipas dispozitave të LTMK, LTSI, LTRS, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, rrethin e trashëgimtarëve ligjorë e përbëjnë këta persona: a) Fëmijët e trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre; b) Bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit; c) Prindërit e trashëgimlënësit; d) Vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre; e) Gjyshi e gjyshja e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre; d) Stërgjyshërit e trashëgimlënësit. (më përjashtim të LTMK dhe LTSI).[307] Përveç personave të përmendur më sipër, KCSH në rrethinë e trashëgimtarëve ligjorë, i përfshinë edhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit.[308]

Fëmijët e trashëgimlënësit.- Sipas LTMK, LTSI, LTRS, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, në rrethin e fëmijëve përfshihen si ata të lindur nga martesa, ashtu dhe ata të lindur jashtë martesës si dhe fëmijët e adoptuar. Përkatësisht sipas dispozitave të ligjeve në fjalë, fëmijëve martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar, u takon e drejta e barabartë në trashëgimi.[309] Është e

[300] Ligji për Trashëgiminë i Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë Nr 47/1997, 18/2001). Shih nenin 6.
[301] Ligji për Trashëgiminë i Serbisë (Gazeta Zyrtare e Serbisë Nr 46/1995, 101/2003-18, 6/2015). Shih nenin 2.
[302] Ligji për Trashëgiminë i Slovenisë (Gazeta Zyrtare e Slovenisë Nr 15/76, 23/78; 17/91, 13/94, 40/94, 117/00, 67/01, 83/01, 31/13 dhe 63/16). Shih nenin 7.
[303] Ligji për Trashëgiminë i Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Kroacisë 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15). Shih nenin 4 par.3.
[304] Ligji për Trashëgiminë i Malit të Zi (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi Nr 74/2008). Shih nenin 6.
[305] Ligji për Trashëgiminë i Bosnjës dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjës dhe Hercegovinës Nr 2/98, 39/04 i 73/05). Shih nenin 6.
[306] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013).
[307] LTMK (neni 12); LTSI (neni 10); LTHR (neni 8); LTRS (neni 8); LTME (neni 9); dhe LTBH (neni 8).
[308] Kodi Civil Shqiptar. Shih nenin 360.
[309] Shih LTMK (neni 4); LTSI (neni 4 par.2); LTHR (neni 21); LTME (neni 4); dhe LTBH (neni 4 par.2); KCSH (neni 317).

rëndësishme të përmendet se barabarësia midis fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor garantohet edhe më Kushtetutë. Kështu, Kushtetuta e Sllovenisë, në nenin 54 par.2 përcakton rregullën "Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të njëjta të drejta si fëmijët e lindur nga martesa".[310] Ngjajshëm përcaktohet edhe më Kushtetutën e Serbisë, në nenin 64 par.4 ku thuhet: "Një fëmijë i lindur jashtë martesë ka të njëjta të drejta si një fëmijë i lindur në martesë".[311] Edhe Kushtetuta e Malit të Zi, në nenin 72 par.4 sanksionon rregullën e njëjtë ku thuhet: "Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të njëjtat të drejta dhe detyra si fëmijët e lindur nga martesa".[312] Edhe Kushtetuta e Shqipërisë, gjithashtu sanksionon rregullën e njëjtë në nenin 54 par.2 ku thuhet: "Fëmijët e lindur jashtëmartesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa".[313] Pra, parimi i barabarësisë midis fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor është parim kushtetutes, i cili garanton barabarësinë e fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor, në çdo sferë të jetës përfshirë këtu edhe marrëdhëniet e trashëgimisë.

Bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit.-Sipas LTMK, LTSI, LTRS, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, bashkëshortëve u takon e drejta e barabartë në trashëgimi. Kusht i domosdoshëm për tu thirrur bashkëshorti pasjetues, në trashëgimi është që në momentin e çeljes së trashëgimisë të ekzistojë martesa e vlefshme sipas ligjit. Në LTMK, LTSI, LTRS, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, është përcaktuar rregulla e njëjtë, se e drejta e trashëgimit midis bashkëshortëve pushon më shkurorëzimin e martesës ose më anulimin e martesës. Përkatësisht sipas dispozitave të ligjeve të cekura më sipër, bashkëshorti pasjetues nuk mund ta trashëgojë trashëgimlënësin në këto raste: a) Kur trashëgimlënësi ka ngritur padi për shkurorëzimin e martesës, kurse pas vdekjes së trashëgimlënësit vërtetohet se padia ka qenë e bazuar; b) Kur martesa është anuluar pas vdekjes së trashëgimlënësit, për shkaqe për të cilat bashkëshorti pasjetues ka ditur në kohën e lidhjes së martesës; c) Kur bashkëjetesa e bashkëshortit pasjetues më trashëgimlënësin ka pushuar më fajin e bashkëshortit pasjetues ose më marrëveshje më trashëgimlënësin.[314] Nga kjo rezulton se e drejta trashëgimore e bashkëshortit pasjetues është e kushtëzuar më ekzistimin e martesës së ligjshme në momentin e çeljes së trashëgimisë. Pra, nuk mund të thirret në trashëgim ish bashkëshorti i trashëgimlënësit apo bashkëshorti nga martesa, e

[310] The Constitution of the Republic of Slovenia (Official Gazette RS, Nos. 33/91-I, 42/97, 66/2000 and 24/03) Ustava Republike Slovenije (Uradni list RS, št. 33/91-I, 42/97, 66/2000 in 24/03. Shih nenin 54 par.2

[311] Constitution of The Republic of Serbia («Official Gazette of the RS» no. 98/2006) shih nenin 64

[312] The Constitution of Montenegro (Official Gazette of Montenegro 01/07 of 25 October 2007) shih nenin 72

[313] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (ndryshuar më ligjet nr.9675/2007; nr.9904/2008; nr.88/2012 dhe nr.137/2015/RSH. Kuvendi-Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare, 2016). Shih nenin 54 par.2.

[314] LTMK (neni 26); LTSI (neni 22); LTHR (neni 25); LTRS (neni 22) LTME (neni 25); dhe LTBH (neni 25).

cila nuk ka qenë e lidhur sipas kushteve të parapara më ligj gjegjësisht nga martesa e shpallur e pavlefshme.[315] Në ligjet e analizuara, përjashtimisht LTRS dhe KCSH, gjegjësisht në LTMK, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, sanksionohet rregulla që trashëgimlënësin e trashëgon edhe bashkëshorti i tij jashtëmartesorë. Më bashkësi jashtëmartesore në kuptim të dispozitave të ligjeve të analizuara, nënkuptohet bashkëjetesa e një burrri dhe një gruaje, e cila ka zgjatur një kohë të gjate dhe që ka përfunduar më vdekjen e trashëgimlënësit, më kusht të kenë qenë plotësuar kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e martesës.[316] Ndërsa, sipas Ligjit për Trashëgimi i Serbisë, bashkësia jashtëmartesore nuk krijon ndonjë efekt juridik në lidhje më trashëgimi. Pra, sipas LTRS, bashkëshortët jashtëmartesore nuk kanë mundësi të trashëgojnë njëri-tjetrin. Ky qëndrim i ligjvënësit serb në doktrinën juridike serbe, konsiderohet si mangësia më e madhe e Ligjit për Trashëgimi, veçanërisht sa i përkët rregullimit të trashëgimisë ligjore.[317] Në kundërshtim më legjislacionin aktual, doktrina juridike serbe mbanë qëndrimin se rregullat që zbatohen në trashëgimi për bashkëshortët martesor, në mënyrë analoge duhet të zbatohen edhe ndaj bashkëshortëve jashtëmartesor, duke marrë parasysh specifikat e bashkëjetesës.[318] Kushtet të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që bashkësia jashtëmartesore të prodhojë efekte juridike në trashëgimi, sipas doktrinës juridike serbe janë këto:-Bashkësia jashtëmartesore duhet të ekzistojë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit; -Bashkësia jashtëmartesore duhet të zgjasë të paktën 7 vite ose 3 vite nëse nga bashkëjetesa kanë lindur fëmijë;-Bashkëshortët jashtëmartesor nuk duhet të jenë në afërsi gjaku në vije të drejtë pakufi; -As njëri nga bashkëshortët jashtëmartesor gjatë gjithë kohëzgjatjes së bashkëjetesës nuk duhet të ketë qenë ligjërisht i martuar më ndonjë person të tretë.[319] Njëjtë si LTRS edhe KCSH, bashkëshortëve jashtëmartesor nuk u njeh të drejten e trashëgimit të ndërsjellët. Duhet theksuar se legjislacioni shqiptar nuk i kushton vëmendje të posaçme, rregullimit të bashkëjetesës gjegjësisht Kodi i Familjes (si akti kryesor më të cilin rregullohen marrëdhëniet familjare) përmbane vetëm dy dispozita ligjore referuar institutit të bashkëjetesës.KFSH, në nenin 163 përkufizon bashkëjetesën si "një bashkim faktik midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e

[315] Shih A.Nuni & L.Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimsië Tiranë. Fq.24.
[316] Shih LTMK (neni 4); LTSI (neni 4); LTHR (neni 8 par.2); LTME (neni 9 par.2,3); dhe LTBH (neni 9).
[317] Shih Љ.Јанић, (2016). ПРАВО ЗАКОНСКОГ НАСЛЕЂИВАЊА СУПРУЖНИКА, ВАНБРАЧНИХ ПАРТНЕРА И ПАРТНЕРА ИЗ ИСТОПОЛНИХ ЗАЈЕДНИЦА У СРПСКОМ ПРАВУ DE LEGE LATA И DE LEGE FERENDA, UDK: 347.628:347.66 ОКРУГЛИ СТО ДВАДЕСЕТ ГОДИНА ЗАКОНА О НАСЛЕЂИВАЊУ Правни факултет Универзитета у Нишу, 23. септембар 2016. Fq.117.
[318] О.Јовић-Прлаиновић. (2016). БРАК И СРОДСТВО У ДОМЕНУ ЗАКОНСКОГ НАСЛЕЂИВАЊА, UDK:347.626:347.66. ОКРУГЛИ СТО ДВАДЕСЕТ ГОДИНА ЗАКОНА О НАСЛЕЂИВАЊУ Правни факултет Универзитета у Нишу, 23. септембар 2016. Fq.104 .
[319] С.Сворцан (2016). НАСЛЕДНА ПРАВА ВАНБРАЧНОГ ПАРТНЕРА, UDK: 347.627.42:347.66 ОКРУГЛИ СТО ДВАДЕСЕТ ГОДИНА ЗАКОНА О НАСЛЕЂИВАЊУ Правни факултет Универзитета у Нишу, 23.септембар 2016. Fq. 87.

përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie". KFSH nuk parashikon asnjë pasoje juridike në drejtim të personave (çifteve) që jetojnë në bashkësi faktike, përveç që lejon mundësinë që këta persona të parashikojnë më marrëveshje pasojat që lindin lidhur me fëmijët dhe për pasurinë e fituar gjatë bashkëjetesës.[320] Kjo rregull rrjedh nga dispozita e nenit 164 i KFSH, ku thuhet: "Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojn pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës". Pra, sipas legjislacionit shqiptar, bashkëshorti jashtëmartesor i trashëgimlënësit nuk mund të gëzojë ndonjë të drejtë më natyrë trashëgimore në pasurinë trashëgimore, më përjashtim të rastit kur trashëgimlënësi lënë testament. Mirëpo, edhe disponimi më testament ka kufijtë e vet të cilët nuk duhet të prekin pjesën e domosdoshme (e cila është e rezervuar për një kategori të trashëgimtarëve ligjorë).[321] Është e rëndësishme të përmendet se në Slloveni dhe Kroaci lejohet mundësia e trashëgimisë së ndërsjelltë, të personave të të njëjtit seks të cilët e kanë të regjistruar bashkëjetesën. Bashkëjetesa e personave të të njëjtit seks në Slloveni, njihet që nga viti 2006, në bazë të Ligjit për Regjistrimin e Partneritetit të të Njëjtit Seks (LRPS). Ky ligj është miratuar në qershor të vitit 2005, dhe ka hyrë ne fuqi më 23 korrik 2006. Në bazë të këtij ligji, partnerëve të të njëjtit seks u njiheshin një numër i kufizuar i të drejtave[322] si p.sh., e drejta e kufizuar e trashëgimit të ndërsjellët, partneri pasjetues nuk mund të trashëgonte pasurinë e veçantë të partnerit të vdekur (trashëgimlënësit). Në lidhje më këtë në nenin 22 par.4 e LRPS, thuhej se pasuria e veçantë e partnerit të vdekur (trashëgimlënësit) trashëgohet sipas rregullave që aplikohen në Ligjin për Trashëgimi.[323] Mirëpo, në Ligjin për Trashëgimi, nuk përfshihen partnerët e të njëjtit seks në rrethin e trashëgimtarëve, që do të thotë partnerët nuk kishin të drejtë të trashëgonin pronat e veçanta të njëri-tjetrit. Në vitin 2009, Gjykata Kushtetuese në Slloveni, në bazë të kërkesës së Mitje Blažiča, Dobrovo Brežice dhe Viki Kern, shqyrtojë kushtetueshmërinë e nenit 22 e LRPS, më ç'rast gjeti se ky nen është në kundërshtim më nenin 14 të Kushtetutës, më të cilin ndalohet diskriminimi i personave në bazë të orientimit seksual. Gjykata Kushtetuese, kërkoi nga Parlamenti Slloven që brenda gjashtë muajve të korigjojë këtë mospërputhje të LRPS më parimin kushtetues.[324] Është e rëndësishme të përmendet se në vitin

[320] Shih S.Omari (2012) E Drejta Familjare, Tiranë. Fq.42.
[321] Shih A.Mandro (2009) E Drejta Familjare, Tiranë. Fq.280.
[322] M.Forest (2015) Europeanizing and Nationalizing the Regulation of Same-Sex Couples in Central and Eastern Europe,4th ECPG Conference, Uppsala, Sweden, June 10-13th, 2015. (https://ecpr.eu/Filestore/PaperProposal/29e34d59-52b0-4356-976d-20be2dd0e865.pdf dt. 13.04.2017 Fq 12).
[323] Zakon o registraciji istospolne partnerske skupnosti (ZRIPS) uradini list, št. 65/2005 z dne 8.7.2005.
[324] Zakon o registraciji istospolne partnerske skupnosti (ZRIPS) uradini list, št. 55/2009 z dne17.7.2009 (https://www.uradni-list.si/glasilo-uradni-list-rs/vsebina/2009-01-2715?sop=2009-01-2715 dt.13.04.2017).

2015, Parlamenti Slloven ka miratuar projektligjin për legalizimin e martesave midis personave të të njëjtit seks. Mirëpo, kundërshtarët e këtij projektligji përgatiten më sukses një peticion për referendum, më ç'rast referendum u mbajt më 20 dhjetor 2015, dhe ligji u refuzua. Në vitin 2016, Parlamenti Slloven, miratoi Ligjin e ri për Regjistrimin e Partneritetit të të Njëjtit Seks, në bazë të të cilit partnerët e të njëjtit seks, fituan gati të gjitha të drejtat të cilat i takojnë edhe partnerëve të sekseve të kundërta në martesë, përfshirë edhe të drejtën e trashëgimit të ndërsjellët. Sipas rregullave të përmbajtura në LRPS e ri, partneri i mbijetuar e gëzon të drejtën e trashëgimit në mënyrë të barabartë më fëmijët e partnerit të vdekur (trashëgimilënësit). Sipas LRPS e ri, partnerit të mbijetuar nuk i takon e drejta e trashëgimit në këto raste: -kur bashkëjetesa e tij më trashëgimlënësin ka përfunduar më fajin e partnerit të mbijetuar ose më marrëveshje më trashëgimlënësin; kur trashëgimlënësi ka bërë kërkesë për ndërprerjen e bashkëjetesës, ndërsa procedura për ndërprerjen e bashkëjetesës ka përfunduar pas vdekjes së tij;-kur bashkëjetesa apo partneriteti i regjistruar është anuluar për shkaqet për të cilat partneri i mbijetuar ka qenë në dijeni në kohën e regjistrimit apo themelimit të partneritetit më trashëgimlënësin.[325] Nga kjo që u tha më lartë, rezulton se parneriteti i regjistruar i të të njëjtit seks sipas ligjit aktual slloven, krijon efektet e njëjta juridike në trashëgimi sikur martesa. Ndërkaq, Kroacia ka njohur ligjërisht bashkëjetesën e çifteve të të njëjtit seks që nga viti 2003, në bazë të ligjit për partneritet të të njëjtit seks të paregjistruar, gjegjësisht në bazë të këtij ligji bashkëjetesa e personave të të njëjtit seks njihej, por nuk lejohej të regjistrohej.[326] Sipas këtij ligji, partnerët e të njëjtit seks gëzonin të drejta të kufizuara. Më këtë ligj, partnerët e të njëjtit seks nuk kishin mundësi të trashëgonin njëri-tjetrin.[327] Partnerët e të njëjtit seks në Kroaci, e fituan të drejtën e trashëgimit reciprok të njëri-tjetrit në vitin 2014, kur u nxjerrë ligji mbi partneritetin jetësor të të njëjtit seks[328], i cili aktualisht është në fuqi. Sipas këtij ligji, partneri i mbijetuar e trashëgon partnerin e vdekur (trashëgimlënsin) më kusht që partneriteti i tyre të ketë qenë i regjistruar sipas kushteve të parapara më ligj. Partnerit të mbijetuar në bazë të këtij ligji, i takon e drejta e barabartë në trashëgimi më fëmijët e partnerit të vdekur (trashëgimlënësit).[329]

[325] Zakon o registraciji istospolne partnerske skupnosti (Uradni list RS, št. 65/05, 55/09 – odl. US, 18/16 – odl. US, 33/16 – ZPZ in 68/16 – ZPND-A) Shih nenin 22 dhe 23.
[326] Zakon o istospolnim zajednicama (Narodne novine službene list republike hrvatske Broj: 01-081-03-2597/2 Zagreb,16. srp-nja 2003).
[327] D.KLASIČEK, Zakonsko nasljeđivanje istospolnih partnera u Republici Hrvatskoj u Postojećem Zakonoskom Orkviru Zb. Prav. fak. Sveuč. Rij. (1991) v. 34, br. 2, 963-989 (2013) Fq.986.
[328] Shih J. Видић Трнинић (2014) ВАНБРАЧНИ ПАРТНЕР КАО ЗАКОНСКИ НАСЛЕДНИК У САВРЕМЕНИМ ПРАВИМА ЕВРОПЕ, Зборник радова Правног факултета у Нишу | Број 68 | Година LIII | 2014.Fq.410.
[329] Zakon o životnom partnerstvu osoba istog spola (Narodne novine službene list republike hrvatske Broj:92/14) shih nenin 55.

Prindërit e trashëgimlënësit.-Më prindërit e trashëgimlënësit nënkuptohen babai dhe nëna e trashëgimlënësit si dhe adoptuesit e trashëgimlënësit. Sipas dispozitave të LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, prindërve të trashëgimlënësit u takon e drejta e barabartë në trashëgimi. Pra, nëna dhe babai i trashëgimlënësit trashëgojnë në pjesë të barabarta.

Gjyshi e gjyshja e trashëgimlënësit.-Më gjyshin dhe gjyshen e trashëgimlënësit, nënkuptohen vetëm prindërit e nënës dhe babait si dhe të adoptuesve dhe jo të paralindurit e tjerë gjegjësisht stërgjyëshërit të cilët përbëjnë një kategori tjetër të trashëgimtarëve ligjorë.[330] Më dispozitat e LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, nuk bëhen dallime ndërmjet gjyshërve nga ana e babait dhe nënës gjegjësisht në trashëgimi thirren gjyshërit si nga ana e babait ashtu dhe nënës dhe trashëgimia midis tyre ndahet në pjesë të barabarta kështu: gjysma e pasurisë apo ½ u ndahet në pjesë të barabarta gjyshit e gjyshës nga ana e nënës dhe gjysma tjetër apo ½ u ndahet gjyshit e gjyshës nga ana e babait.

Personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit.-Përbëjnë një kategori të veçantë të trashëgimtarëve ligjorë, për faktin se këta persona nuk thirren në trashëgimi për shkak të kriterit të lidhjes së gjinisë më trashëgimlënësin, por për shkak të kriterit të humanizimit.[331] Nga ligjet e analizuara, personat e paaftë për punë përfshihen në rrethinë e trashëgimtarëve ligjorë, vetëm në KCSH. Sipas KCSH, që një person të thirret si trashëgimtarë ligjorë, në cilësinë e të qenit person i paaftë për punë duhet t'i plotësojë këto kushte: a) Të jetë i paaftë për punë në momentin e vdekjes se trashëgimlënësit; b) Të këtë bashkëjetuar si anëtarë i familjes më trashëgimlënësin jo më pak së 1 vit; dhe c) Të këtë qenë në ngarkim të trashëgimlënësit.[332] Kjo rezulton nga dispozita e nenit 363 i KCSH, ku thuhet: "Në radhë te dytë thirren në trashëgim prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë, të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjetonin me atë si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij". Pra, paaftësia për punë është kushti kryesor në mungesë të të cilit është e pamundur , që një person të thirret në trashëgim në cilësinë e personit të paaftë për punë. Sipas KCSH, të paaftë për punë konsiderohen këta persona: a) ata të cilët në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç ose 18 vjeç kur vazhdojnë mësimet; b) burrat që kanë mbushur moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç; si dhe pavarësisht nga mosha, ata që

[330] Shih N. Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Onufri.Fq.74.
[331] A.Nuni & L.Hasneziri (2010) E Drejta Civile III (Trashëgimia) Tirane. Fq.61.
[332] Po aty. Fq.62.

janë invalidë të grupit të parë dhe të grupit të dytë.[333] Pra, ligjvënësi shqiptar ka përcaktuar se kush mund të jetë person i paaftë për punë duke u bazuar në dy kritere: a) moshën e personit dhe b) gjendjen shëndetësore të personit gjegjësisht invaliditetin.

2.6.2. Radha e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë

Është parim i njohur që trashëgimtarët ligjorë, thirren në trashëgim sipas radhës së caktuar më ligj, ashtu që trashëgimtarët ligjorë të radhës më të afërtë i përjashtojnë nga trashëgimi trashëgimtarët e radhës më të largët. Ky parim parashikohet shprehimisht në të gjitha ligjet e analizuara gjegjësisht në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH. Ndërkaq, radha e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në trashëgimi, përkatësisht grupimi i trashëgimtarëve ligjorë në radhë, nuk rregullohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha ligjet e analizuara. Kështu: sipas LTHR, LTRS dhe LTBH si dhe KCSH, grupimi i trashëgimtarëve ligjorë bëhet në pesë radhë,[334] sipas LTSI dhe LTMK trashëgimtarët ligjorë radhiten në tri radhe;[335] ndërkaq sipas LTME trashëgimtarët ligjorë radhitën në katër radhë.[336] Në të gjitha ligjet e analizuara, përcaktohet shprehimisht rregulla sipas të cilës në rastin kur nuk ekzistojnë trashëgimtarë ligjorë, të asnjë radhë, trashëgimia i kalon shtetit. Pra, shteti paraqitet si trashëgimtarë ligjorë i radhës së fundit.

[333] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 371.
[334] Shih Ligjin për Trashëgimi i Kroacisë, nenet 9-20; Ligjin për Trashëgimi i Serbisë, nenet 9-20 dhe Ligjin për Trashëgimi i Bosnjës e Hercegovinës, nenet 9-20.
[335] Shih Ligjin për Trashëgimi i Maqedonisë, nenet 13-22 dhe Ligjin për Trashëgimi i Sllovenisë, nenet 11-20 .
[336] Shih Ligjin për Trashëgimi i Malit të Zi, nenet 11- 20.

Tabela 5: Radhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Maqedoni, Shqipëri, Slloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.

Radhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Kroaci, Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë	
	Thirren në trashëgimi:
Në radhën e parë	Fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues
Në radhën e dytë	Bashkëshorti dhe prindërit e trashëgimlënësit
Në radhën e tretë	Gjyshi dhe gjyshja e trashëgimlënësit
Në radhën e katërtë	Stërgjyshërit e trashëgimlënësit
Në radhën e pestë	Të afërmit e tjerë të trashëgimlënësit.
Radhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Slloveni dhe Maqedoni	
	Thirren në trashëgimi:
Në radhën e parë	Fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues
Në radhën e dytë	Bashkëshorti dhe prindërit e trashëgimlënësit
Në radhën e tretë	Gjyshi dhe gjyshja e trashëgimlënësit.
Radhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Mal të Zi	
	Thirren në trashëgimi:
Në radhën e parë	Fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues
Në radhën e dytë	Bashkëshorti dhe prindërit e trashëgimlënësit
Në radhën e tretë	Gjyshi dhe gjyshja e trashëgimlënësit
Në radhën e katertë	Stërgjyshërit e trashëgimlënësit.
Radhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në Shqipëri	
	Thirren në trashëgimi:
Në radhën e parë	Fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues
Në radhën e dytë	Bashkëshorti, prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë
Në radhën e tretë	Bashkëshorti, personat e paaftë për punë, gjyshi dhe gjyshja, vëllezërit dhe motrat
Në radhën e katërtë	Stërgjyshërit si dhe fëmijet e vëllezërve dhe motrave më të paslindurit e tyre
Në radhën e pestë	Të afërmit e trashëgimlënësit deri në shkallën e gjashtë.

2.6.2.1 Radha e parë e trashëgimisë

Sipas dispozitave të ligjeve të analizuara, përkatësisht sipas LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, në radhën e parë thirren në trashëgim: pasardhësit e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti pasjteues. Pra, në rend të parë trashëgimlënësin, e trashëgojnë pasardhësit gjegjësisht fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues. Më ligjet e analizuara përkatësisht më LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, nuk bëhen dallime midis fëmijëve martesor, jashtëmartesor dhe as atyre të adoptuar, në lidhje më thirrjen në trashëgimi dhe pjesën trashëguese. Sikurse është përmendur edhe më lartë, në ligjet e analizuara (më përjashtim të LTRS dhe KCSH) më bashkëshortin martesor në trashëgimi barazohet edhe bashkëshorti jashtëmartesor. Më bashkësi jashtëmartesore sipas ligjeve të analizuara (më përjashtim të legjislacionit pozitiv në Slloveni dhe Kroaci) nënkuptohet bashkësia e një burri dhe një gruaje të cilet nuk janë ligjërisht të martuar. Ndërkaq, në Slloveni dhe Kroaci, njihet ligjërisht edhe bashkëjetesa midis partnerëve të të njëjtit seks, të cilët gëzojnë të drejtën e trashëgimit të ndërsjellët në mënyrë të njëjtë sikur bashkëshortët. Në të gjitha ligjet e analizuara përkatësisht në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, është përcaktuar njëjtë rregulla, sipas të cilës të gjithë trashëgimtarët e thirrur në radhën e parë të trashëgimisë trashëgojnë në mënyrë të barabartë.[337] Pra, fëmijëve dhe bashkëshortit pasjteues të trashëgimlënësit (në Slloveni dhe Kroaci edhe partnerit të mbijetuar të të njëjtit seks) trashëgimia u ndahet në pjesë të barabarta. Mirëpo, për raste të caktuara parashihen përjashtime nga kjo rregull. Në ligjet e analizuara (më përjashtim të LTHR dhe KCSH) parashikohet mundësia e reduktimit apo zvogëlimit të pjesës trashëgimore të bashkëshortit në favor të fëmijëve. Përkitazi më këtë në nenin 15 e Ligjit për Trashëgimi i Maqedonisë, dhe nenin 9 par.3 e Ligjit për Trashëgimi i Serbisë, parashikohet kësisoj: "në rastin kur trashëgimlënësi ka lënë fëmijë të cilet nuk janë nga martesa më bashkëshortin pasjetues, ndërsa pasuria e këtij bashkëshorti është më e madhe nga pjesa që do t'i kishte takuar më ndarjen e masës trashëgimore në pjesë të barabarta, atëherë secilit fëmijë të trashëgimlënësit i takon pjesë dy herë më e madhe sesa bashkëshortit, nëse gjykata pas vlerësimit të të gjitha rrethanave vlerëson se kjo është e justifikueshme". Ngjajshëm përcaktohet edhe më Ligjin për Trashëgimi i Malit të Zi, në nenin 23 ku thuhet: "Në qoftë se ka fëmijë nga martesat e mëparshme, fëmijë të lindur jashtëmartese apo fëmijë të adoptuar dhe pasuria e bashkëshortit

[337] Shih LTMK (neni 13); LTSI (neni 10); LTHR (neni 9); LTRS (neni 9); LTME (neni 11); dhe LTBH (neni 9) dhe KCSH (neni 361 par.1).

pasjetues është më e madhe se pjesa që do t'i takonte më ndarjen e pasurisë trashëgimore në pjesë të barabarta, atëherë secilit prej fëmijëve martesor, jashtëmartesor apo të adoptuar, do t'i ndahet dy herë pjesë më e madhe sesa bashkëshortit". Pra, sipas LTMK, LTRS dhe LTME, për tu lejuar reduktimi i pjesës së bashkëshortit pasjtues në favor të fëmijëve duhet të plotësohen këto dy kushte: a) Bashkëshorti pasjtues nuk duhet të jetë prind i fëmijëve të trashëgimlënësit; dhe b) Bashkëshorti pasjtues duhet të ketë pasuri të veten të veçantë më të madhe se sa pjesa që i takon në pasurinë trashëgimore. Ndërkaq, Ligji për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe Ligji për Trashëgimi i Sllovenisë, parashikojnë jo vetëm mundësinë e reduktimit të pjesës trashëgimore të bashkëshortit, por edhe reduktimin e pjesës trashëgimore të fëmijëve në favor të bashkëshortit. Përkitazi më reduktimin apo zvogëlimin e pjesës trashëgimore të bashkëshortit në favor të fëmijëve në Ligjin për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe Ligjin për Trashëgimi i Sllovenisë, parashikohet kësisoj: në rastin kur fëmijët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë thirren në trashëgim më trashëgimtarët e tjerë të rendit të parë (do të thotë më bashkëshortin), më kërkesë të fëmijëve gjykata mund të vendosë që fëmijët të trashëgojnë edhe një pjesë nga ajo pjesë e pasurisë trashëgimore që sipas ligjit është dashur të trashëgohet nga trashëgimtarët e tjerë të rendit të parë gjegjësisht nga bashkëshorti. Gjykata mund të vendosë që fëmijët ta trashëgojnë edhe gjithë pasurinë trashëgimore, nëse ajo është e një vlerë aq të vogël që më ndarjen e saj fëmijët do të kishn rënë në varfëri. Më rastin e vendosjes, gjykata do të marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e veçanërisht gjendjen financiare dhe aftësinë për të punuar të fëmijëve dhe bashkëshortit, kohëzgjatjen e martesës si dhe vlerën e pasurisë trashëgimore.[338] Edhe çështjen e reduktimit të pjesës trashëgimore të fëmijëve në favor të bashkëshortit pasjteues, LTBH dhe LTSI, gjithashtu e rregullojnë në mënyrë të njëjtë. Sipas LTBH dhe LTSI, reduktimi i pjesës trashëgimore të fëmijëve përballë bashkëshortit pasjetues, bëhet sipas rregullave të njëjta që apikohen në rastin e reduktimit të pjesës trashëgimore të bashkëshortit. Përkitazi më këtë, në LTBH dhe LTSI,parashikohet kësisoj: në rastin kur bashkëshorti që nuk ka mjete të mjaftueshme për jetesë thirret në trashëgimi më fëmijët e trashëgimlënësit, më kërkesën e bashkëshortit gjykata mund të vendosë që bashkëshortit t'i takojë edhe një pjesë nga pjesa trashëgimore e trashëgimtarëve të tjerë të rendit të pare (d.m.th fëmijëve) ose kur vlera e pasurisë trashëgimore është e vogël mund të vendosë që edhe tërë pasuria trashëgimore t'i takojë bashkëshortit

[338] Shih Ligjin për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, neni 23 dhe Ligjin për Trashëgimi i Sllovenisë, neni 13 par.2,3.

pasjetues.[339] Nga kjo që u tha më lartë rezulton, së në rastin e reduktimit të pjesës trashëgimore të bashkëshortit, ashtu si edhe në rastin e reduktimit të pjesës trashëgimore të fëmijëve sipas LTBH dhe LTSI, kërkohen domosdo të plotësohen këto dy kushte: a)Trashëgimtari (fëmija apo bashkëshorti) në favor të të cilit reduktohet pjesa trashëgimore, e trashëgimtarëve të tjerë të rendit të parë duhet të mos ketë mjete të mjaftueshme për jetesë; dhe b) Trashëgimtari në favor të të cilit reduktohet pjesa trashëgimore (qoftë fëmija apo bashkëshorti) duhet të paraqesë kërkesë në gjykatë për shtimin e pjesës së vet trashëgimore. Lidhur më radhën e parë të trashëgimisë, është e rëndësishme të përmendet edhe fakti që sipas LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME, LTBH dhe KCSH, në radhën e parë të trashëgimisë aplikohen rregullat e së drejtës së përfaqësimit (zëvendësimit) pa kufi.[340] Siç dihet në bazë rregullave të së drejtës së përfaqësimit, mundësohet që në vend të trashëgimtarit ligjor, i cili ka vdekur para trashëgimlënësit apo i cili për ndonjë nga shkaqet e parapara më ligj, nuk mund të trashëgojë në vend të tij të trashëgojnë pasardhësit e tij. Për shembull, trashëgimlënësi ka lënë bashkëshorten dhe dy fëmijë (një vajzë dhe një djalë) si dhe dy nipër të vajzës së paravdekur. Në këtë rast, pasuria trashëgimore do të ndahet në mënyrë të tillë: ¼ bashkëshortës; ¼ vajzës; ¼ djalit; dhe ¼ e pasurisë trashëgimore (të cilën do ta trashëgonte vajza e trashëgimlënësit sikur të ishte gjalle), në bazë të së drejtës së përfaqësimit (zëvendësimit) u ndahet dy nipërve të trashëgimlënësit në pjesë të barabarta. Duhet theksuar që sipas ligjeve të analizuara (më përjashtim të KCSH) e drejta e përfaqësimit aplikohet pa kufizim jo vetëm ndaj pasardhësve të trashëgimlënësit, por edhe ndaj kategorive tjerë të trashëgimtarëve ligjorë. Ndërkaq, sipas KCSH, e drejta e përfaqësimit aplikohet pa kufizim vetëm kur bëhet fjalë për fëmijët e fëmijëve të trashëgimlënësit dhe për fëmijët e vëllezërve e motrave të paravdekur të trashëgimlënësit.[341]

2.6.2.2. Radha e dytë e trashëgimisë

Në ligjet e analizuara (më përjashtim të KCSH) përkatësisht në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH është përcaktuar njëjtë rregulla, sipas të cilës në radhën e dytë thirren në trashëgim bashkëshorti pasjtues i trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës (në Slloveni dhe Kroaci edhe partneri i mbijetuar i të njëjtit seks) dhe prindërit e trashëgimlënësit. Përkatësisht, bashkëshorti pasjtues (dhe partneri i mbijetuar i të njëjtit seks në Slloveni dhe Kroaci)

[339] Shih Ligjin për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës , neni 26 dhe Ligjin për Trashëgimi i Sllovenisë, neni 13 par.1.
[340] Shih LTMK (neni 14); LTSI (neni 12); LTHR (neni 10); LTRS (neni 10); LTME (neni 12); LTBH (neni 11) dhe KCSH (neni 361 par.2).
[341] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 361 par.2.

trashëgojnë së bashku më prindërit e trashëgimlënësit vetëm në rastin kur trashëgimlënësi nuk ka lënë pasardhës. Pra, në rastin kur nuk ka trashëgimtarë te tjerë të rendit të parë pos bashkëshortit pasjetues, bashkëshorti nuk trashëgon në rendin e parë si trashëgimtarë i vetëm, por trashëgon në rendin e dytë së bashku më prindërit e trashëgimlënësit. Ndarja e trashëgimisë midis trashëgimtarëve të radhës së dytë, sipas rregullave të përmbajtura në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, bëhet kësisoj: gjysma (apo ½) e pasurisë trashëgimore u ndahet në pjesë të barabarta prindërve të trashëgimlënësit, d.m.th secili merr nga ¼ e trashëgimit, kurse gjysma tjetër (apo ½) e pasurisë trashëgimore i ndahet bashkëshortit pasjtues.[342] (në Slloveni dhe Kroaci edhe partnerit të mbijetuar të të njëjtit seks). Ndërkaq, sipas KCSH, përveç prindërve të trashëgimlënësit dhe bashkëshortit pasjetues (që nuk ka trashëguar në radhën e parë të trashëgimisë) në radhën e dytë në trashëgim, thirret edhe personi i paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit. Sipas KCSH, bashkëshorti pasjtues trashëgon ½ e pasurisë trashëgimore, kurse ½ tjetër të pasurisë trashëgimore, e trashëgojnë në pjesë të barabarta prindërit dhe personi i paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit. Pra, midis prindërve dhe personit të paaftë për punë nuk bëhen dallime, sa i përkët pjesës trashëguese. Sikurse është theksuar edhe më lartë, sipas KCSH, bashkëshorti jashtëmartesor nuk ka të drejtë në trashëgimi ligjore. Mirëpo, shtrohet pyetja: se a mundet bashkëshorti jashtëmartesor të thirret në trashëgimi ligjore, në cilësinë e personit të paaftë për punë. Përkitazi më këtë çështje në teorinë juridike shqiptare, janë shfaqur mendime të ndryshme. Sipas njërës pikëpamje “kur personat të cilët bashkëjetojnë si burrë e grua nuk janë lidhur me martesë tjetër të rregullt dhe plotësojnë kushtet e personit të paaftë për punë në ngarkim, këta mund të konsiderohen njëri karshi tjetrit trashëgimtarë”.[343] Ndërkaq, sipas një pikëpamje tjetër thuhet se “nuk duhet të trashëgojnë ne as një cilësi bashkëshorti që në fakt nuk ka lidhur martesë të rregulltë, pasi kjo nuk pajtohet si me dispozitat mbi trashëgiminë, ashtu dhe me dispozitat e përgjithshme të legjislacionit civil”.[344] Konsiderojmë se qëndrimi i pikëpamjes së parë është më i drejtë dhe i arsyeshëm. Sikurse u theksua më lartë, bashkëshortit pasjtues dhe prindërve të trashëgimlënësit u ndahet trashëgimia në pjesë të barabarta gjegjësisht bashkëshortit i ndahet ½ e pasurisë trashëgimore dhe ½ tjetër e pasurisë trashëgimore u ndahet prindërve.

[342] Shih Јелена Видић Трнинић (2013) ОДСТУПАЊА ОД РЕДОВНИХ ПРАВИЛА ЗАКОНСКОГ НАСЛЕЂИВАЊА НА ПРОСТОРУ БИВШЕ СФРЈ (Србија, Словенија, Македонија, Црна Гора, Република Српска) Оригинални научни рад 347.65(497.1) doi:10.5937/zrpfns 47-4477. Зборник радова Правног факултета у Новом Саду, 2/2013. Fq.402.

[343] A.Sallabanda, Disa çështje mbi trashëgiminë, Drejtësia Popullore, viti 1956, Nr.3, Faqe 21. (cituar nga N. Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Onufri Fq 71).

[344] A.Lamani, Rreth trashëgimtarëve ligjorë dhe trashëgimtarëve më testament, Drejtësia Popullore, viti 1955, Nr.4, Faqe 52. (cituar nga N. Biçoku (1997) veper e cituar Fq 72).

Mirëpo, ka raste kur bëhen përjashtime nga zbatimi i kësaj rregulle. Sipas ligjeve të analizuara (më përjashtim të Ligjit për Trashëgimi i Kroacisë dhe KCSH) lejohet mundësia e shtimit të pjesës trashëgimore si të bashkëshortit ashtu dhe të prindërve. Përkitazi më shtimin e pjesës trashëgimore të prindërve kundrejt bashkëshortit pasjtues në LTMK, LTRS, LTSI, LTME dhe LTBH parashikohet kësisoj: Në rastin kur prindërit që nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë thirren në trashëgim më bashkëshortin e trashëgimlënësit, më kërkesën e prindërve gjykata mund të vendosë që prindërit të trashëgojnë edhe një pjesë nga ajo e pasurisë trashëgimore, e cila ligjërisht i takon bashkëshortit. Madje, gjykata mund të vendosë që prindërit të trashëgojnë edhe tërë pasurinë trashëgimore nëse ajo është e një vlerë aq të vogël sa që më ndarjen e saj prindërit do të kishin rënë në varfëri të thellë. Ndërsa, në rastin kur bashkëjetesa midis prindërve të trashëgimlënësit është ndërperë për një kohë të gjatë, ndërsa vetëm njëri prind nuk ka mjete të mjaftueshme për jetesë, ai mund të kërkojë t'i rritet pjesa trashëguese si ndaj bashkëshortit të trashëgimlënësit, ashtu edhe ndaj prindit tjetër të trashëgimlënësit. Ndërsa, në rastin kur prindi i trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, prindi pasjteues që nuk ka mjete për jetesë, mund të kërkojë që t'i rritet pjesa trashëguese edhe ndaj trashëgimtarëve të prindit të vdekur të trashëgimlënësit, të cilët në këtë rast trashëgojnë sipas rregullave të së drejtës së përfaqësimit.[345] Gjithashtu, edhe çështja e shtimit të pjesës trashëguese të bashkëshortit pasjtues përballë prindërve rregullohet njëjtë në LTMK, LTRS, LTSI, LTME dhe LTBH. Lidhur më çështjen në fjalë, në ligjet në fjalë parashikohet kësisoj: Në rastin kur bashkëshorti që nuk ka mjete të mjaftueshme për jetesë thirret në trashëgim më prindërit e trashëgimlënësit, atëherë gjykata mundet në bazë të kërkesës së bashkëshortit të vendosë që bashkëshorti të trashëgojë edhe një pjesë nga ajo pjesë e pasurisë trashëgimore që sipas ligjit i takon trashëgimtarëve të tjerë. Veç kësaj, gjykata mund të vendosë që edhe tërë pasuria trashëgimore t'i ndahet bashkëshortit nëse vlera e saj është aq e vogël sa që më ndarjen e saj bashkëshorti do të kishte rënë në varfëri[346]. Sipas rregullave të përmbajtura në ligjet e analizuara si në rastin e shtimit të pjesës trashëgimore të prindërve[347], ashtu dhe në rastin e shtimit të pjesës trashëgimore të bashkëshortit pasjetues[348], gjykata vendosë duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, e në veçanti gjendjen financiare dhe aftësinë për të punuar të prindërve, bashkëshortit pasjtues dhe vlerën e pasurisë trashëgimore. Nga kjo që u tha më lartë rezulton që për shtimin e pjesës trashëgimore, të

[345] LTMK (neni 28 par.1,2,3); LTSI (neni 24 par.1,2,3); LTRS (neni 31 par.1,2,3); LTME (neni 26 par.1,2,3); dhe LTBH (neni 27 par.1,2,3).
[346] Po aty, shih LTMK (neni 27 par.1); LTSI (neni 23 par.1); LTRS (neni 23); LTME (neni 24 par.1); dhe LTBH (neni 26 par.1).
[347] Shih LTMK (nenin 28 par.4); LTSI (nenin 24 par.4); LTRS (nenin 32); LTME (nenin 26 par.4); LTBH (nenin 27 par.4).
[348] Po aty, shih LTMK (nenin 27 par.2); LTSI (nenin 23 par.2); LTRS (nenin 25 par.2); LTME (nenin 24 par.2); dhe LTBH (nenin 26 par.2).

trashëgimtarëve të rendit të dytë të trashëgimisë (qoftë prindërve apo bashkëshortit) në mënyrë komulative kërkohen të plotësohen këto kushte: a) trashëgimtari pjesa trashëguese e të cilit shtohet duhet të mos këtë mjete të mjaftueshme për jetesë; b) trashëgimtari duhet të paraqesë në gjykatë kërkesën për shtimin e pjesës trashëgimore; si dhe c) vlera e pasurisë trashëgimore duhet të jetë e vogël. Në LTMK, LTSI, LTME dhe LTBH, nuk përmendet afati brenda të cilit trashëgimtarët e rendit të dytë kanë të drejtë të kërkojnë shtimin e pjesës së tyre trashëguese. Ndërkaq, në LTRS, përcaktohet së ky afat është 1 vjet nga vdekja e trashëgimlënësit. Sikurse në radhën e parë në trashëgim edhe në radhën e dytë në trashëgim, sipas ligjeve të analizuara, përjashtimisht KCSH, përkatësisht sipas LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, aplikohen rregullat e së drejtës së përfaqësimit. Përkitazi më të drejtën e përfaqësimit në radhën e dytë në trashëgim në ligjet e analizuara (pra, më përjashtim të KCSH) parashikohet kësisoj: Në rastin kur njëri prind i trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore (1/4) që do t'i kishte takuar po ta kishte mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit e motrat e trashëgimlënësit), nipat e stërnipat e tij dhe pasardhësit e tij, e po që se të dy prindërit kanë vdekur para trashëgimlënësit, atëherë pjesa e pasurisë trashëgimore (1/2) që do t'i kishte takuar prindërve i ndahet pasardhësve të tyre, sipas rregullave të njëjta si në rastin e përmendur më sipër.[349] Ndërsa, në rastin kur njëri prind i trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk ka lënë asnjë pasardhës, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i kishte takuar po të ishte gjallë e trashëgon prindi tjetër, e në qoftë se edhe ky ka vdekur para trashëgimlënësit, atëherë pasardhësit e tij i trashëgojnë pjesët trashëgimore të të dy prindërve të vdekur në bazë të rregullave të njëjta që aplikohen në dy rastet e përmendura më sipër.[350] Ndërsa, në rastin kur të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë asnjë pasardhës, atëherë sipas dispozitave të ligjeve të analizuara (më përjashtim të KCSH) tërë pasurinë trashëgimore e trashëgon bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit[351].(në Slloveni dhe Kroaci edhe partneri i mbijetuar i të njëjtit seks). Pra, për dallim nga radha e parë e trashëgimisë, në radhën e dytë në trashëgim bashkëshorti konsiderohet trashëgimtarë ekskluzivë. Ndërkaq sipas KCSH, bashkëshorti pasjtues nuk konsiderohet trashëgimtarë ekskluzivë as në radhën e dytë në trashëgim. Përkatësisht sipas KCSH, në rastin kur bashkëshorti pasjtues mbetet

[349] Shih LTMK (neni 17); LTSI (neni 15); LTHR (neni 12); LTRS (neni 13); LTME (neni 14); dhe LTBH (neni 13).
[350] Po aty, shih LTMK (neni 18); LTSI (neni 16); LTHR (neni 13); LTRS (neni 14); LTME (neni 15); dhe LTBH (neni 14).
[351] Shih LTMK (neni19); LTSI (neni 17); LTHR (neni 11 par.3); LTRS (neni 15); LTME (neni 16).

trashëgimtarë i vetëm i radhës së dytë, ai nuk trashëgon gjithë pasurinë, por zbret në radhën e tretë në trashëgim.[352]

2.6.2.3. Radha e tretë e trashëgimisë

Sipas ligjeve të analizuara (më përjashtim të KCSH) përkatësisht sipas LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, në radhën e tretë thirren në trashëgim: gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit nga ana e babait dhe ana e nënës. Përkitazi më këtë në ligjet e analizuara (më përjashtim ,pra, të KCSH) thuhet kësisoj: "pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës, prindër dhe as këta nuk kanë lënë ndonjë pasardhës dhe as bashkëshort e trashëgojnë gjyshërit dhe gjyshet e tij". Sipas dispozitave të LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, trashëgimtarëve të kësaj radhë trashëgimia, u ndahet në mënyrë të barabartë kësisoj: njëra gjysëm e pasurisë trashëgimore (apo ½) u ndahet gjyshit e gjyshës nga ana e babait, ndërsa gjysma tjetër (½) gjyshit dhe gjyshës nga ana e nënës.[353] Mandej, nuk bëhen dallime as midis gjyshit dhe gjyshes së të njëjtit trung gjegjësisht gjyshit e gjyshës së të njëtit trung trashëgimia (½) u ndahet në pjesë të barabarta, pra të dytë trashëgojnë nga ¼ e pasurisë trashëgimore. Është e rëndësishme të përmendet se edhe në radhën e tretë të trashëgimisë gjejnë zbatim rregullat e së drejtës së përfaqësimit. Përkitazi më të drejtën e përfaqësimit në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH parashikohet kësisoj: "Në rastin kur ndonjëri nga gjyshërit e njërit trung kanë vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i kishte takuar po të kishte mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët e tij, nipat dhe pasardhësit e mëtutjeshëm të tij, sipas rregullave që vlejnë për raste kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët e tij dhe pasardhësit e tjerë."[354] Ndërsa, në rastin kur gjyshi e gjyshja e të njëjtit trung kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë asnjë pasardhës, në këtë rast sipas dispozitave të LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, pjesën e pasurisë trashëgimore të cilën do ta trashëgonin gjyshi e gjyshja e vdekur ose pasardhësit e tyre sikur të ekzistonin, tani e trashëgojnë gjyshi e gjyshja e trungut tjetër, fëmijët e tyre, nipat dhe pasardhësit e tyre të mëtutjeshëm.[355] Pra, në këtë rast aplikohen rregullat e së drejtës së shtimit. Ndërkaq, sipas KCSH, përveç gjyshit e gjyshës në radhën e tretë, thirren në trashëgimi edhe personat e paaftë për punë kur janë trashëgimtarë të vetëm të radhës së dytë, vëllezërit e motrat e trashëgimlënësit si dhe fëmijët e vëllezërve e

[352] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 364.
[353] Shih LTMK (neni 20); LTSI (neni 18); LTHR (neni 14); LTRS (neni 16); LTME (neni 17) dhe LTBH (neni 15).
[354] Po aty, shih LTMK (neni 21); LTSI (neni 19); LTHR (neni 15); LTRS (neni 17); LTME (neni 18) dhe LTBH (neni 16).
[355] Shih LTMK (neni 22); LTSI (neni 20); LTHR (neni 16); LTRS (neni 18); LTME (neni 19) dhe LTBH (neni 17).

motrave të paravdekur[356]. Pra, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, sipas KCSH, nuk konsiderohen trashëgimtarë ekskluzivë të radhës së dytë, por kur ata janë trashëgimtarë të vetëm të radhës së dytë zbresin në radhën e tretë. Sikurse është theksuar edhe më lartë, në radhën e tretë në trashëgimi, sipas KCSH mund të zbres edhe bashkëshorti pasjtues kur është i vetmi trashëgimtarë në dy radhët e para. Pra, në rastin kur bashkëshorti pasjtues konkurron si trashëgimtarë i vetëm në dy radhët e para të trashëgimisë, ai zbret në radhën e tretë në trashëgim, mirëpo edhe në këtë rast bashkëshorti merr jo më pak se ½ e pasurisë trashëgimore. Në rast se bashkëshorti pasjetues është i vetmi trashëgimtarë edhe në radhën e tretë, atëherë e gjithë trashëgimia i mbetet bashkëshortit. Pra, bashkëshorti pasjetues sipas KCSH, bëhet trashëgimtarë ekskluzivë në radhën e tretë të trashëgimisë. Më përjashtim të bashkëshortit i cili trashëgon çdo herë jo pak se ½ e pasurisë trashëgimore, sipas KCSH, trashëgimtarëve të tjerë të përfshirë në radhën e tretë trashëgimia u ndahet në pjesë të barabarta.[357] Për shembull, trashëgimlënësi si trashëgimtarëtë dy radhëve të para të trashëgimisë ka lënë vetëm gruan dhe si trashëgimtarë të radhës së tretë ka lënë gjyshen dhe gjyshin si nga ana e nënës ashtu dhe nga ana e babait. Në këtë rast pasuria trashëgimore do të ndahet në mënyrë të tillë: gruas ½ dhe ½ tjetër e pasurisë trashëgimore, u ndahet në pjesë të barabarta gjyshit dhe gjyshës nga ana e babait dhe nënës. Pra, nuk bëhen dallime ndërmjët gjyshit dhe gjyshës nga ana e babait ose nënës. KCSH, nuk bënë dallime në lidhje më thirrjen në trashëgimi dhe pjesën trashëguese as ndërmjet vëllezërve e motrave të një nënë ose vetëm të një babai.[358] Për shembull, trashëgimlënësi ka lënë dy vëllezër nga babai dhe nëna dhe një vëlla vetëm nga babai, në këtë rast pasuria trashëgimore, u ndahet në mënyrë të barabartë të tre vëllezërve të trashëgimlënësit. Kurse fëmijët e vëllezërve e motrave sipas KCSH, thirren në trashëgimi në radhën e tretë vetëm në bazë të rregullave të së drejtës së përfaqësimit. Përkatësisht në radhën e tretë, sipas KCSH trashëgojnë vetëm fëmijet e vëllezërve e motrave të cilët kanë vdekur para trashëgimlënësit, por jo edhe fëmijët e vëllezërve e motrave të gjallë, pasi këta trashëgojnë në radhën e katërt të trashëgimisë.

2.6.2.4. Radha e katërt e trashëgimisë

Radha e katërt e trashëgimisë parashikohet më shumicën e ligjeve të analizuara, përkatësisht këtë radhë të trashëgimisë nuk e parashikojnë vetëm LTSI dhe LTMK. Sipas

[356] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 364.
[357] Po aty, shih nenin 364.
[358] Shih A.Nuni & L.Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimsië Tiranë. Fq.24-25.

rregullave të përmbajtura në LTRS, LTHR, LTBH dhe LTME, pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës, prindër dhe as këta nuk kanë lënë ndonjë pasardhës dhe nuk ka lënë bashkëshort, e as gjyshër dhe as këta nuk kanë lënë ndonjë pasardhës, e trashëgojnë stërgjyshërit dhe stërgjyshet e tij.[359] Pra, stërgjyshërit e trashëgimlënësit thirren në trashëgim vetëm në mungesë të trashëgimtarëve të tri radhëve të para të trashëgimisë. Sikurse në radhën paraprake të trashëgimisë, edhe në këtë radhë të trashëgimisë nuk bëhen dallime midis trashëgimtarëve të cilët thirren në trashëgim, por atyre trashëgimia u ndahet në pjesë të barabarta. Përkatësisht, gjysma apo ½ e pasurisë trashëgimore u ndahet stërgjyshit (¼) dhe stërgjyshes (¼) nga ana e babait, kurse ½ tjetër e pasurisë trashëgimore u ndahet stërgjyshit (¼) dhe stërgjyshes (¼) nga ana e nënës. Edhe në këtë radhë të trashëgimisë, aplikohen rregullat e së drejtës së përfaqësimit, që do të thotë në mungesë të stërgjyshërve trashëgojnë pasardhësit e tyre.[360] Ndërsa, sipas KCSH, përveç stërgjyshërve dhe stërgjyshëve të trashëgimlënësit, në radhën e katërt thirren në trashëgim edhe fëmijët e vëllezërve e motrave të trashëgimlënësit më të paslindurit e tyre.[361]

2.6.2.5 Radha e pestë e trashëgimisë

Prej ligjeve te analizuara, këtë radhë të trashëgimisë e rregullojnë LTRS, LTBH, LTHR dhe KCSH. Sipas dispozitave të ligjeve në fjalë, trashëgimlënësin i cili nuk ka lënë stërgjyshër dhe as këta nuk kanë lënë ndonjë pasardhës, e trashëgojnë paraadhësit e tij të mëtutjeshëm, sipas rregullave sipas të cilave trashëgonin stërgjyshërit në radhën paraprake të trashëgimisë.[362] Më dispozitat e ligjeve të përmendura më sipër (më përjashtim të KCSH) nuk është përcaktuar se deri në cilen shkallë thirren në trashëgim paraadhësit e mëtutjeshëm të trashëgimlënësit. Pra, nuk dihet se kush mund të jenë paraadhësit e tjerë të trashëgimilënësit apo mënyra gjegjësisht radha e thirrjes së tyre në trashëgim. Kurse, në KCSH është përcaktuar shprehimisht rregulla se në radhën e pestë në trashëgim thirren të afërmit e trashëgimlënësit deri në shkallën e gjashtë (këtu përfshihen kushërinjtë konkretisht hallat, tezet, dajet si dhe fëmijët e tyre).[363]

[359] Shih LTHR (neni 17); LTRS (neni 19); LTME (neni 20) dhe LTBH (neni 18).
[360] Po aty, shih LTHR (neni 18); LTRS (neni 19); LTME (neni 20) dhe LTBH (neni19).
[361] Shih A. Nuni & L. Hasneziri (2010) E Drejta Civile III (Trashëgimia).Tiranë.Fq.70
[362] Shih LTHR (neni 19); LTRS (neni 20) dhe LTBH (neni 20).
[363] Shih A. Nuni & L. Hasneziri (2010) E Drejta Civile III (Trashëgimia).Tiranë.Fq.70

2.7. Trashëgimtarët e domosdoshëm në Maqedoni, Slloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë

Sikurse është theksuar edhe më lartë (në pjesën ku është trajtuar instituti i trashëgimisë së domosdoshëm në Kosovë) trashëgimtarët e domosdoshëm quhen trashëgimtarët ligjorë të cilëve më ligj, u takon e drejta mbi një pjesë të pasurisë trashëgimore, të cilën trashëgimlënësi nuk guxon ta disponojë më testament apo dhuratë në favor të personave të tjerë. Në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME, ashtu sikurse edhe në teorinë juridike, trashëgimtarët e domosdoshëm ndahen në dy grupe: a) Trashëgimtarët e domosdoshëm absolutë; dhe b) Trashëgimtarët e domosdoshëm relativë.[364] Trashëgimtarët e domosdoshëm absolutë,janë ata për të cilët ligjvënësi konsideron së janë në lidhje veçanërisht të ngushtë më trashëgimlënësin dhe si të tillë për ta ligjvënësi, nuk kërkon që të plotësohen kushte shtesë, që të mund të bëhen trashëgimtarë të domosdoshëm. Trashëgimtarët e domosdoshëm absolutë, kërkohet që t'i plotësojnë vetëm kriteret objektive sikurse për çdo trashëgimtarë ligjorë, pra trashëgimtari duhet të ekzistojë në momentin e çeljes së trashëgimisë (më përjashtim të fëmijës së konceptuar); duhet të jetë i aftë dhe i denjë për të trashëguar.[365] Ndërkaq, për trashëgimtarët e domosdoshëm relativë, veç kritereve objektive që të mund të bëhen trashëgimtarë të domosdoshëm kërkohet që t'i plotësojnë edhe kriteret e caktuara subjektive, siç janë: paaftësia e përhershme për punë dhe mungesa e mjeteve të domosdoshme për jetesë.[366] Termat paaftësia e përhershme për punë dhe mungesa e mjeteve të domosdoshme për jetesë pra, janë kritere ligjorë përmbajtja e të cilave vlerësohet sipas rrethanave të rastit konkret nga gjykata që zhvillon proceduren trashëgimore. Ekzistenca e paaftësisë për punë vërtetohet zakonisht më çertifikatë mjekësore të lëshuar nga komisoni i mjekëve. Ndërsa, mungesa e mjeteve të domosdoshme për jetesë vlerësohet në bazë të gjendjes financiare të trashëgimtarit të domosdoshëm, pavarësisht nëse ai ka një fëmijë apo bashkëshortë që mund ta sigurojë atë.[367] Kriteret subjektive duhet të plotësohen në momentin e çeljes së trashëgimisë.

[364] Mónika Csöndes –Dubravka Klasiček: The legal nature of the forced share of inheritance under the Croatian and Hungarian law. working paper, SUNICOP 11/2012, http://sunicop.eunicop.eu/publications.html Fq.4. (i referohen N. Gavella, V. Belaj, Nasljedno pravo [Inheritance Law], 3. edition, Zagreb, Narodne novine, 2008, str. 220).

[365] Novak M. Krstić (2015) Violation and Legal Protection of the Right to Compulsory Portion, Doctoral Dissertation, University of Niš, Fakulty of Law. Fq.80.

[366] Новак Крстић. КОНЦЕПТУАЛНА МИМОИЛАЖЕЊА У РЕГУЛИСАЊУ НУЖНОГ НАСЛЕЂИВАЊА У РЕПУБЛИЦИ СРБИЈИ И РЕПУБЛИЦИ СРПСКОЈ, UDK: 347.65/.68 (497.11+497.6). ЗБОРНИК РАДОВА ПРАВНОГ ФАКУЛТЕТА, БР. LIX. Fq.236.

[367] N.Stojanović (2013). Efectuation and Protection of the Rights to a Forced Portion in Contemporary Serbian Law. Iustinianus Primus Law Review Vol. 4:2. Fq 3 (http://law-reviw.mk/pdf/07/Natasa%20Stojanovic.pdf).

Tabela 6: Trashëgimtarët e domosdoshëm në Maqedoni, Slloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.

Ndarja e trashëgimtarëve të domosdoshëm në:	Trashëgimtarët e domosdoshëm absolutë	Trashëgimtarët e domosdoshëm relativë
Slloveni[368], Serbi dhe Mal të Zi	Fëmijët e trashëgimlënësit, fëmijët e tij të adoptuar dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti pasjtues dhe prindërit e tij	Vëllezërit e motrat dhe gjyshërit e trashëgimlënësit
Maqedoni	Fëmijët e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti pasjtues	Prindërit e trashëgimlënësit dhe vëllezërit dhe motrat e tij
Kroaci	Fëmijët e trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre dhe bashkëshorti pasjtues	Prindërit e trashëgimlënësit dhe paradhësit e tjerë
Bosnjë dhe Hercegovinë	Fëmijët e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti pasjtues	Pasardhësit e tjerë të trashëgimlënësit, prindërit e tij dhe vëllezërit e motrat e tij

Sikurse mund të shihet edhe nga tabela më lartë, ekzistojnë dallime jo pak të rëndësishme midis ligjeve të analizuara, sa i përkët kategorizimit të trashëgimtarëve të domosdoshëm. Kështu, sipas LTSI,[369] LTRS [370] dhe LTME[371] në kategorinë e trashëgimtarëve të domosdoshëm absolutë hyjnë: fëmijët e trashëgimlënësit, fëmijët e tij të adoptuar dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti pasjtues dhe prindërit e trashëgimlënësit. Dhe si trashëgimtarë të domosdoshëm relativë konsiderohen vëllezërit e motrat dhe gjyshërit e trashëgimlënësit. Ndërsa, sipas LTHR në kategorinë e trashëgimtarëve të domosdoshëm absolutë hyjnë: fëmijët e trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre dhe bashkëshortja e tij (gjithashtu dhe partneri i mbijetuar i të njëjtit seks) kurse si trashëgimtarë të domosdoshëm relativë numërohen: prindërit e trashëgimlënësit dhe paraardhësit e tjerë.[372]Ndërsa, në Ligjin për Trashëgimi i Maqedonisë, dhe Ligjin për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, vërehet një numër më i kufizuar i trashëgimtarëve të domosdoshëm. Kështu, sipas Ligjit për Trashëgimi i Maqedonisë (LTMK), trashëgimtarë të domosdoshëm absolutë konsiderohen vetëm fëmijët, të adoptuarit dhe bashkëshortja e trashëgimlënësit, kurse

[368] Shih M. Anderson and E. Arroyo i Amayuelas (2011). The Law of Succession: Testamentary Freedom:European Perspectives. European Studies in Private Law (5). Europa Law Publishing. Fq.261.
[369] Ligji për Trashëgimi i Sllovenisë, shih nenin 25 par.1 dhe 2.
[370] Ligji për Trashëgimi i Serbisë, shih nenin 39 par.1 dhe 2.
[371] Ligji për Trashëgimi i Malit të Zi, shih nenin 27 par.1 dhe 2.
[372] Ligji për Trashëgimi i Kroacisë, shih nenin 69 par.1 dhe 2.

prindërit dhe vëllezërit e motrat e trashëgimlënësit konsiderohen trashëgimtarë të domosdoshëm relativë. LTMK, parashikon edhe një zgidhje tjetër për pasardhësit e fëmijeve të trashëgimlënësit dhe të adoptuarve të tij, që nuk është karakteristikë për ligjet e tjera të analizuara. Sipas LTMK, pasardhësit e fëmijeve të trashëgimlënësit dhe të të adoptuarit e tij, mund të bëhen trashëgimtarë të domosdoshëm vetëm nëse në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit kanë jetuar në bashkësi më të ose nëse ai i ka mbajtur ose nëse janë plotësisht të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë.[373] Pra, nga kjo rezulton se pasardhësit e fëmijve (d.m.th. nipat dhe mbesat) të trashëgimlënësit sipas ligjit maqedon konsiderohen si trashëgimtarë të domosdoshëm relativë. Një kategorizim të ngjajshëm të trashëgimtarëve të domosdoshëm si në LTMK, e hasim edhe në Ligjin për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës (LTBH). Sipas LTBH, trashëgimtarë të domosdoshëm absolutë konsiderohen vetëm fëmijët e trashëgimlënësit dhe bashkëshortja e tij, kurse trashëgimtarë të domosdoshëm relativë konsiderohen pasardhësit e tjerë të trashëgimlënësit (d.m.th nipat dhe mbesat) prindërit e trashëgimlënësit dhe vëllezërit e motrat e tij.[374]

2.7.1. Pjesa e pasurisë trashëgimore që u takon trashëgimtarëve të domosdoshëm

Çështja e pjesës së domosdoshëm, gjegjësisht madhësia e pjesës trashëgimore të trashëgimtarëve të domosdoshëm, rregullohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha ligjet e analizuara (më përjashtim të Ligjit për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës). Kështu, sipas dispozitave të LTMK, LTRS, LTSI, LTHR dhe LTME, pjesa e domosdoshme e fëmijëve të trashëgimlënësit dhe pasardhësve të tyre, të adoptuarve të tyre dhe bashkëshortit pasjetues (në Slloveni dhe Kroaci edhe partnerit të mbijetuar të të njëjtit seks) është 1/2, ndërsa pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të tjerë është 1/3 nga ajo pjesë që do t' i takonte secilit trashëgimtar sipas rendit ligjor të trashëgimisë.[375] Nga kjo rezulton që trashëgimtarëve ligjorë të rendit të parë të trashëgimisë (bashkëshortit pasjtues dhe pasardhësve të trashëgimlënësit) u ndahet në mënyrë të barabartë pjesa e domosdoshme. Duhet theksuar së pjesa e domosdoshme e bashkëshortit pasjtues është çdo herë ½ edhe atëherë kur konkurron në trashëgim më trashëgimtarët e rendit të dytë të trashëgimisë.[376] Ndërkaq, sipas LTBH pjesa e domosdoshme e fëmijëve të trashëgimlënësit dhe bashkëshortit pasjetues është ½, kurse e trashëgimtarëve të tjerë të

[373] Ligji për Trashëgimi i Maqedonisë, shih nenin 30 par.1,2 dhe 3.
[374] Ligji për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, shih nenin 28 par.1 dhe 2.
[375] Shih LTMK (neni 31 par.2); LTSI (neni 26 par.2); LTHR (neni 70 par.3); LTRS (neni 40 par.2); LTME (neni 28 par.2) dhe LTBH (neni 29 par.2).
[376] Shih N.Stojanović (2013). Efectuation and Protection of the Rights to a Forced Portion in Contemporary Serbian Law. Iustinianus Primus Law Review Vol. 4:2. Fq.4. (http://law-reviw.mk/pdf/07/Natasa%20Stojanovic.pdf).

domosdoshëm, përfshirë këtu edhe pasardhësit e tjerë të trashëgimlënësit (nipat dhe mbesat e trashëgimlënësit) është 1/3.[377] Pra, ndryshe nga ligjet e tjera të analizuara, sipas LTBH, madhësia e pjesës së domosdoshme të pasardhësve të fëmijëve të trashëgimlënsit është më e vogël.

Tabela 7: Madhësia e pjesës trashëgimore e trashëgimtarëve të domosdoshëm në Maqedoni, Slloveni, Kroaci, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.

Shtetet	Madhësia e pjesës trashëgimore e trashëgimtarëve të domosdoshëm e garantuar më ligj
Slloveni, Serbi dhe Mal të Zi	Fëmijëve të trashëgimlënësit, pasardhësve të tyre dhe bashkëshortit pasjetues u takon **1/2** Prindërve, vëllezërve e motrave dhe gjyshërve të trashëgimlënësit u takon **1/3**
Maqedoni	Fëmijëve të trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre dhe bashkëshortit pasjetues u takon **1/2** Prindërvë të trashëgimlënësit dhe vëllezërve e motrave të tij **1/3**
Kroaci	Fëmijëve të trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre dhe bashkëshortit pasjetues u takon **½** Prindërve të trashëgimlënësit dhe paradhësve të tjerë u takon **1/3**
Bosnjë dhe Hercegovinë	Fëmijëve të trashëgimlënësit dhe bashkëshortit pasjetues u takon **1/2** Pasardhësve të tjerë të trashëgimlënësit, prindërve të tij dhe vëllezërve e motrave të tij u takon **1/3**

Llogaritja e pjesës së domosdoshme bëhet në bazë të vlerës së pasurisë trashëgimore. Sipas rregullave të përmbajtura në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, përcaktimi i vlerës së pasurisë trashëgimore bëhet në këtë mënyrë: -Së pari, bëhet regjistrimi dhe vlerësimi i të mirave që i ka pasur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes. Në këtë vlerësim llogaritet edhe tërë ajo të cilën trashëgimlënësi e ka disponuar me testament. Veç kësaj, llogariten edhe të gjitha kërkesat të cilat i ka pasur trashëgimlënësi ndaj personave të tjerë, madje edhe ato që i ka ndaj ndonjë trashëgimtari, më përjashtim të kërkesave që duket qartë se janë të papagueshme. -Së dyti, pasi të përcaktohet vlera e të mirave që i ka pasur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes, hiqet tërësia e borxheve që i ka lënë trashëgimlënësi, këtu përfshihen edhe shpenzimet e bëra rreth vlerësimit dhe regjistrimit të pasurisë trashëgimore si dhe shpenzimet e varrimit të trashëgimlënësit. - Së treti, pjesës së pasurisë trashëgimore, që mbet pas zbritjes së borxheve

[377] Ligji për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, shih nenin 29 par.2.

sipas dispozitave të ligjeve të analizuara (më përjashtim të Ligjit për Trashëgimi i Maqedonisë) i shtohet vlera e dhurimeve që i ka bërë trashëgimlënësi në çfarëdo mënyrë ndonjë trashëgimtari ligjorë, madje edhe dhurimet që i janë bërë trashëgimtarëve që heqin dorë nga trashëgimia si dhe dhurimet për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar mos t'i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëguese. Veç kësaj, llogariten edhe dhuratat të cilat i ka bërë trashëgimlënësi gjatë vitit të fundit të jetës së tij ndonjë personi të tretë që nuk është trashëgimtarë ligjorë.[378] Edhe sipas Ligjit për Trashëgimi i Maqedonisë, gjithashtu llogariten dhuratat, por për dallim nga ligjet e tjera të analizuara gjegjësisht nga LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, më LTMK nuk specifikohet nëse bëhet fjalë për dhuratat të cilat trashëgimlënësi, ju ka bërë trashëgimtarëve ligjorë apo trashëgimtarëve që heqin dorë nga trashëgimia apo personave të tjerë që nuk janë trashëgimtarë ligjorë. Përkatësisht, sipas LTMK, pjesës së pasurisë që mbet pas zbritjes së të gjitha borxheve, i shtohet vlera e të gjitha dhuratave që i ka bërë trashëgimlënësi në cilëndo mënyrë në 90 ditët e fundit të jetës së tij, edhe të atyre dhuratave për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar mos t'i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëguese.[379] Duhet theksuar se si dhuratë në kuptim të dispozitave të LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH "çdo heqje dorë nga të drejtat, falja e borxhit, ajo që trashëgimlënësi ia ka dhënë trashëgimtarit gjatë kohës së jetës së tij në emër të pjesës trashëgimore ose për shkak të themelimit dhe zgjerimit të familjes ose për shkak të kryerjes së profesionit si dhe çdo disponim tjetër pa kompensim".[380]

2.7.1.1 Si veprohet në rastin kur cenohet pjesa e domosdoshme

Në ligjet e analizuara (më përjashtim të Ligjit për Trashëgimi i Bosnjës e Hercegovinës) është sanksionuar rregulla e njëjtë, se në rastin kur vërtetohet se është cënuar pjesa e domosdoshme bëhet zvogëlimi i disponimit më testament dhe kthehen dhuratat.[381]Ndërsa, sipas Ligjit për Trashëgimi i Bosnjës e Hercegovinës, kur cënohet pjesa e domosdoshme bëhet si zvogëlimi i disponimit më testament dhe kthimi i dhurimeve, ashtu edhe zvogëlimi i disponimit më kontratë të trashëgimisë. Kjo pasi LTBH, lejon që të lidhet edhe kontrata e trashëgimisë, por vetëm midis bashkëshortëve (qoftë martesor ose jashtëmartesor). Sipas LTBH, në rastin kur cënohet pjesa e domosdoshme, së pari bëhet zvogëlimi i disponimit më testament dhe kontratës së trashëgimisë, e nëse kjo nuk mjafton që të plotësohet pjesa e domosdoshme atëherë kthehen

[378] Shih LTSI (neni 28); LTHR (neni 71); LTRS (neni 48); LTME (neni 30) dhe LTBH (neni 31).
[379] Ligji për Trashëgimi i Maqedonisë, shih nenin 33.
[380] Shih LTMK (neni 34); LTSl (neni 29); LTHR (neni 72); LTRS (neni 50); LTME (neni 31) dhe LTBH (neni 32).
[381] Shih LTMK (neni 38 par.1); LTSl (neni 34 par.1); LTHR (neni 78); LTRS (neni 53) dhe LTME (neni 36).

dhurimet.[382] Edhe në ligjet e tjera të analizuara, përkatësisht në LTMK, LTRS, LTHR, LTSI dhe LTME , parashikohet që se pari duhet të bëhet zvogëlimi i disponimit më testament, e nëse edhe pas zvogëlimit të disponimit më testament, nuk plotësohet pjesa e domosdoshme e cënuar, atëherë kthehen dhuratat.[383] Pra, në LTMK, LTRS, LTHR, LTSI, LTME dhe LTBH, rendi i zvogëlimit të dispozitave testamentare dhe kthimit të dhurimeve rregullohet në mënyrë të njëjtë. Në Ligjin për Trashëgimi i Maqedonisë, përcaktohet shprehimisht që duhet të kthehen dhuratat e bëra në 3 muajt e fundit të jetës së trashëgimlënësit, kurse në ligjet e tjera të analizuara nuk bëhet ky specifikim. Pra, më përjashtim të LTMK, kthimi i dhuratave bëhet pavarësisht kohës kur janë bërë. Sa i përkët mënyrës së zvogëlimit të disponimeve testamentare dhe mënyrës së kthimit të dhuratave, ligjet e analizuara gjegjësisht LTMK, LTRS, LTHR, LTSI, LTME dhe LTBH, i përmbajnë rregullat e njëjta. Kështu, sa i përkët zvogëlimit të disponimeve testamentare në ligjet e analizuara, parashikohet se disponimet në testament zvogëlohen në proprocion të njëjtë pa marrë parasysh natyrën dhe madhësinë e tyre, dhe pa marrë parasysh nëse gjenden në një ose më shumë testamente, përveç nëse më testament nuk parashihet ndryshe. Në rastin kur trashëgimlënësi ka lënë më shumë legate dhe ka urdhëruar që ndonjë legat të paguhet para të tjerave, ai legat do të zvogëlohet vetëm nëse vlera e legatave të tjera nuk mjafton që të plotësohet pjesa e domosdoshme e cënuar. Ndërkaq, kthimi i dhuratave bëhet duke filluar nga dhurata e fundit dhe shkon nga ana e kundërt nga rendi sipas të cilit janë dhënë dhuratat. E në rast se dhuratat janë dhënë njëkohësisht atëherë kthimi i tyre bëhet në mënyrë proprocionale.[384] Gjithashtu, më LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, rregullohet në mënyrë pothuajse të njëjtë edhe çështja se kush mund të kërkojë zvogëlimin e disponimit më testament dhe brenda cilit afat. Kështu, sipas dispozitave të LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, e drejta për të kërkuar zvogëlimin e disponimit më testament ose kthimin e dhurimeve, u takon vetëm trashëgimtarëve të domosdoshëm dhe në parim nuk është e drejtë e trashëgueshme. Përkatësisht, zvogëlimi i disponimit më testament mund të kërkohet në afat prej 3 vjetëve nga shpallja e testamentit, ndërsa kthimi i dhuratave në afat prej 3 vjetëve nga vdekja e trashëgimlënësit gjegjësisht nga dita kur vendimi për shpalljen e tij për të vdekur është bërë i plotëfuqishëm.[385] Pra, zvogëlimi i dispozitave testamentare dhe kthimi i dhuratave, bëhet vetëm në bazë të kërkesës së trashëgimtarit të domosdoshëm, që do të thotë gjykata kurrë nuk do t'i japë

[382] Ligji për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, shih nenin 38 dhe 126.
[383] Shih LTMK (neni 39); LTSl (neni 35); LTHR (neni 78 par.2); LTRS (neni 53); LTME (neni 37).
[384] Shih LTMK (nenet 40-42); LTSl (nenet 36-38); LTHR (nenet 79-81); LTRS (nenet 54-56); LTME (nenet 38-40); dhe LTBH (neni 39-41).
[385] Shih LTMK (nenet 44-45); LTSl (nenet 40-41); LTHR (nenet 83-84); LTRS (nenet 58-60); LTME (nenet 42-43); dhe LTBH (nenet 43-44).

trashëgimtarit të domosdoshëm pjesën e tij të domosdoshëm pa e kërkuar atë.[386] Ndërsa, sa i përkët çështjes së trashëgimit të kësaj të drejtë në ligjet e analizuara, parashikohen zgjidhje të ndryshme. Kështu, sipas Ligjit për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe Ligjit për Trashëgimi i Kroacisë, kjo e drejtë është e trashëgueshme vetëm nëse pasardhësi i domosdoshëm, para se të vdiste e ka paraqitur kërkesën për pjesën e domosdoshme.[387] Kurse, sipas Ligjit për Trashëgimi i Serbisë, në rast se pasardhësi apo i adoptuari i cili nuk e ka kërkuar pjesën e domosdoshme vdes para skadimit të afatit për paraqitjen e kërkesës, kjo e drejtë i takon trashëgimtarëve të tij, brenda gjashtë muajve të vdekjes së tij.[388] Kurse, sipas Ligjit për Trashëgimi i Maqedonisë, në rastin kur vdes trashëgimtari i domosdoshëm, i cili nuk e ka kërkuar pjesën e domosdoshëm deri në përfundimin e procedurës trashëgimore, e drejta për të kërkuar pjesën e domosdoshme nuk kalon në trashëgimtarët e tij Mirëpo, pasardhësi i trashëgimtarit të domosdoshëm, i cili edhe vetë do të kishte qenë trashëgimtarë sikur paradhësi i tij të kishte vdekur para trashëgimlënësit, mund ta realizojë për vete të drejtën në një pjesë të domosdoshme që në këtë rast do t'i kishte takuar.[389] Kurse më Ligjin për Trashëgimi i Sllovenisë dhe Ligjin për Trashëgimi i Malit të Zi, nuk parashikohet asnjë mundësi e bartjes së të drejtës për pjesën e domosdoshme tek trashëgimtarët, që do të thotë kjo e drejtë nuk lejohet në asnjë mënyrë të trashëgohet.

2.7.1.2. Përjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm nga trashëgimia

Edhe pse trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pjesën e domosdoshëm pavarësisht vullnetit të trashëgimlënësit, lejohet mundësia që trashëgimlënësi më testament të përjashtojë tërësisht ose pjesërisht nga trashëgimia trashëgimtarin e domosdoshëm, më kusht që të jetë plotësuar njëri nga shkaqet e parapara më ligj.[390] Shkaqet për të cilat trashëgimlënësit, i lejohet që të përjashtojë nga trashëgimia trashëgimtarin e domosdoshëm dhe pasojat e përjashtimit rregullohen në mënyrë pothuajse të njëjtë, në të gjitha ligjet e analizuara. Përkatësisht sipas dispozitave të LTMK, LTSI, LTRS, LTHR, LTBH dhe LTME,

---

386 P. Klarić, M. Vedriš, Građansko parvo [Civil Law], 9. edition, Narodne novine, Zagreb, 2006, p.752 (Cituar nga Mónika Csöndes – Dubravka Klasiček: The legal nature of the forced share of inheritance under the Croatian and Hungarian laë. Ëorking paper, SUNICOP 11/2012. Fq.10).

387 Shih LTBH, nenin 43 par.2 dhe LTHR, nenin 83 par.2.

388 Shih И.Евтимов (2016). МОГУЋНОСТ НУЖНИХ НАСЛЕДНИКА ДА ЗАХТЕВАЈУ ПРЕОБРАЖАЈ ЗАКОНСКЕ ПРЕТПОСТАВКЕ ОБЛИГАЦИОНОПРАВНЕ ПРИРОДЕ ПРАВА НА НУЖНИ ДЕО. UDK: 347.65. Двадесет година Закона о наслеђивању Републике Србије. Fq.132.

389 Shih LTMK, neni 44 par.2.

390 Shih Новак Крстић. КОНЦЕПТУАЛНА МИМОИЛАЖЕЊА У РЕГУЛИСАЊУ НУЖНОГ НАСЛЕЂИВАЊА У РЕПУБЛИЦИ СРБИЈИ И РЕПУБЛИЦИ СРПСКОЈ, UDK: 347.65/.68 (497.11+497.6). ЗБОРНИК РАДОВА ПРАВНОГ ФАКУЛТЕТА, БР. LIX Fq.244.

trashëgimlënësit i lejohet që të përjashtojë nga trashëgimia trashëgimtarin, që ka të drejtë në pjesën e domosdoshme për këto shkaqe: a) Në qofë se ai ka shkelur ndonjë detyrim ligjorë ose moral të rëndë ndaj trashëgimlënësit; b) Në qoftë se ai më dashje ka kryer ndonjë vepër penale të rëndë kundër trashëgimlënësit ose bashkëshortit të tij, fëmijës ose prindit të tij; c) Në qoftë se ai është dhënë pas jetës së pandershme dhe është plangprishës.[391]Përveç shkaqeve të përmendura më sipër, sipas Ligjit për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe Ligjit për Trashëgimi i Kroacisë, trashëgimlënësit i lejohet që të përjashtojë trashëgimtarin e domosdoshëm nga trashëgimia edhe atëherë kur ai ka kryer një krim kundër integritetit të shtetit boshnjak gjegjësisht kroat ose kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare.[392] Në mënyrë që përjashtimi nga trashëgimia të konsiderohet i plotëfuqishëm në LTMK, LTSI, LTRS, LTHR, LTBH dhe LTME është përcaktuar se duhet domosdo të plotësohen këto dy kushte: a) Trashëgimlënësi i cili dëshiron të përjashtojë ndonjë trashëgimtarë duhet ta shpreh këtë në testament në mënyrë të qartë dhe të padyshmtë dhe është në interes të theksojë edhe shkakun e përjashtimit; si dhe b) Shkaku për përjashtim duhet të ekzistojë në kohën e përpilimit të testamentit.[393](më përjashtim të Ligjit për Trashëgimi i Serbisë, sipas të cilit shkaku i përjashtimit duhet të ekzistojë në kohën e çeljes së trashëgimisë). Përveç mundësisë së përjashtimit nga trashëgimia, më të gjitha ligjet e analizuara trashëgimlënësit i lejohet edhe mundësia që të privojë pasardhësin e tij nga pjesa e domosdoshme më qëllim të mbrojtjes së interesit të pasardhësve të tij. Përkatësisht sipas dispozitave të LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTME dhe LTBH, në rastin kur pasardhësi i cili ka të drejtë në pjesën e domosdoshme është detyruar së tepërmi (d.m.th është në borxhe) ose është plangprishës, testamentlënësi mund ta privojë plotësisht ose pjesërisht nga pjesa e tij e domosdoshme në interes të pasardhësve të tij. Privimi nga pjesa e domosdoshme, konsiderohet i plotëfuqishëm vetëm nëse në momentin e çeljes së trashëgimisë i privuari ka fëmijë të mitur ose nip të mitur nga fëmija i vdekur më parë, ose ka fëmijë madhor ose nip madhor nga fëmija i vdekur të cilët janë të paaftë për punë.[394] Pra, ndryshe nga instituti i përjashtimit në bazë të të cilit trashëgimtari përjashtohet nga pjesa e domosdoshme për shkak të sjelljes jo të mirë ndaj trashëgimlënësit, privimi nga trashëgimia e trashëgimtarit të domosdoshëm, bëhet më qëllim të mbrojtjes së interesave të pasardhësve të tij, të cilat janë të mitur apo edhe madhor por që janë të paaftë për punë.

[391] Shih LTMK (neni 46); LTSI (neni 42); LTRS (nen 61); LTME (neni 44).
[392] Shih LTBH (neni 45) dhe LTHR (neni 85).
[393] LTMK (neni 47); LTSl (nen 43); LTHR (neni 86); LTRS (neni 62); LTME (neni 45); LTBH (neni 46).
[394] Shih LTMK (neni 49); LTSl (nen 45); LTHR (neni 88); LTRS (neni 64 dhe 65); LTME (neni 47); LTBH (neni 48).

2.8. Trashëgimtarët e domosdoshëm në Shqipëri

Në legjislacionin shqiptar, trashëgimtarëve të domosdoshëm i është dhënë kuptim i ndryshëm nga ai që i është dhënë në LTMK, LTSI, LTRS, LTHR, LTBH dhe LTME. Sipas legjislacionit shqiptar, pjesa e pasurisë të cilën testatori nuk mund ta disponojë më testament apo në çfarë do mënyrë tjetër quhet rezerva ligjore (apo pjesa e domosdoshme siç emërtohet në ligjet e tjera të analizuara) ndërsa trashëgimtarët ligjorë të cilëve u garantohet domosdo, e drejta e tyre në rezervën ligjore quhen rezervatarë ligjorë. Sipas KCSH rezervatarë ligjorë konsiderohen: a) Fëmijët e mitur të trashëgimlënësit dhe fëmijët e fëmijëve të mitur të trashëgimlënësit; si dhe b) Personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit.[395] Sipas KCSH, rezervatarët ligjorë trashëgimlënësi nuk ka të drejtë t'i përjashtojë nga trashëgimia ligjore dhe as t'ia cënojë pjesën e tyre trashëgimore më testament apo në ndonjë mënyrë tjetër, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar.[396] Pra, ndryshe nga ligjet e tjera të analizuara, KCSH, i vënë kufizime trashëgimlënësit, për të përjashtuar nga trashëgimi vetëm dy kategori të trashëgimtarëve ligjorë.

[395] Shih A.Hakani (2010) Trashëgimia Testamentare (Legjislacioni dhe Praktika Gjyqësore) Botimet "Dudaj" Tiranë. Fq.185.
[396] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 379.

Përfundimi

Në përfundim të analizës krahasuese të institutit të trashëgimisë ligjore në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Serbi, Mal të Zi, Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, do të ndalemi në gjetjet kryesore të këtij studimi, që do të fokusohen në ngjajshmëritë dhe dallimet në lidhje më çështjet kryesore të institutit të trashëgimisë ligjore. Shumë çështje që lidhen më trashëgiminë ligjore në Kosovë dhe në shtetet e përfshira në studim, rregullohen në mënyrë të njëjtë. Një karakteristikë e përbashkët, e ligjeve të shteteve të marra në studim është trajtimi i barabartë i fëmijëve martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar të trashëgimlënësit si dhe trajtimi i barabartë i bashkëshortëve. Përkatësisht, në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Serbi, Mal të Zi, Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, nuk bëhen dallime midis fëmijëve martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar të trashëgimlënësit, në lidhje më thirrjen në trashëgimi dhe pjesën trashëguese. Gjithashtu, nuk bëhen dallime në trashëgimi as midis burrit dhe gruas gjegjësisht bashkëshortëve, u takon e drejta e barabartë në trashëgimi. Një dallim ekziston se në Kosovë, Maqedoni, Kroaci, Mal të Zi, Slloveni dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, më bashkëshortin martesor në trashëgimi barazohet edhe bashkëshorti jashtëmartesor. Kurse, në Shqipëri dhe Serbi bashkëshortëve jashtëmartesor, nuk u njihet e drejta e trashëgimit reciprok. Ndërkaq, në Slloveni dhe Kroaci ndryshe nga shtetet e tjera të përfshira në studim, e drejta e trashëgimit reciprok u njihet edhe partnerëve të të njëjtit seks, në mënyrë të njëjtë sikurse bashkëshortëve martesor. Një karakteristikë tjetër e përbashkët e ligjeve të shteteve të marra në analizë është aplikimi i rregullës, sipas të cilës në rend të parë trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues.Përkatësisht sipas ligjeve të analizuara, fëmijëve dhe bashkëshortit pasjtues trashëgimia u ndahet në pjesë të barabarta. Mirëpo, në ligjet e analizuara të disa shteteve ka raste kur bëhen përjashtime nga zbatimi i kësaj rregulle. Kështu, në Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi, më qëllim të përmirësimit të pozitës së fëmijëve lejohet që të zvogëlohet pjesa trashëgimore e bashkëshortit pasjtues në favor të fëmijëve. Ndërkaq, në Slloveni dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, lejohet jo vetëm zvogëlimi i pjesës trashëguese të bashkëshortit në favor të fëmijëve, por edhe zvogëlimi i pjesës trashëguese të fëmijëve në favor të bashkëshortit pasjtues. Kurse, në Kroaci dhe Shqipëri nuk lejohet zvogëlimi i pjesës trashëguese as të fëmijëve dhe as të bashkëshortit pasjtues. Karakteristikë tjetër e përbashkët e ligjeve të analizuara është aplikimi i rregullës sipas të cilës bashkëshorti pasjtues nuk konsiderohet trashëgimtarë ekskluzivë i rendit të parë të trashëgimisë, sikurse konsiderohen fëmijët. Në rastin kur bashkëshorti pasjtues konkurron i vetëm në rendin e

parë të trashëgimisë, ai nuk e trashëgon gjithë pasurinë, por zbrit në rendin e dytë në trashëgim. Në Kosovë dhe në shtetet e ish-Jugosllavisë gjegjësisht në Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, në rendin e dytë, trashëgimlënësin e trashëgojnë prindërit dhe bashkëshorti, po që se bashkëshorti nuk ka trashëguar në rendin e parë. Prindërve u ndahet ½ e trashëgimit dhe ½ i ndahet bashkëshortit. Një dallim ekziston se në Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, lejohet mundësia e shtimit të pjesës trashëgimore si e bashkëshortit ashtu dhe e prindërve, në rastin kur bashkëshorti apo prindërit nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë. Ndërsa, në Kosovë, Kroaci, Slloveni dhe Shqipëri, nuk lejohet shtimi i pjesës trashëgimore e bashkëshortit dhe as e prindërve. Në Shqipëri në rendin e dytë, veç prindërve dhe bashkëshortit pasjtues trashëgojnë edhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit. Përfshirja e personave të paaftë për punë, në rrethinë e trashëgimtarëve ligjorë është karakteristikë vetëm e legjislacionit shqiptar. Një karakteristikë tjetër e veçantë e legjislacionit shqiptar është që bashkëshorti pasjtues konsiderohet trashëgimtarë ekskluzivë vetëm në rendin e tretë në trashëgim. Ndërsa, në Kosovë dhe në shtetet e ish-Jugosllavisë, bashkëshorti konsiderohet trashëgimtarë ekskluzivë në radhën e dytë në trashëgim. Një dallim tjetër mjaft i rëndësishëm është që në Kosovë dhe në shtetet e ish-Jugosllavisë aplikohet e drejta e përfaqësimit pa kufizim, jo vetëm ndaj pasardhësve të trashëgimlënësit, por edhe ndaj kategorive tjerë të trashëgimtarëve ligjorë, në cilendo radhë të trashëgimisë. Ndërsa, në Shqipëri e drejta e përfaqësimit aplikohet pa kufizim vetëm kur bëhet fjalë për fëmijët e fëmijëve të trashëgimlënësit dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të paravdekur të trashëgimlënësit. Dallimi tjetër është që në Shqipëri, në rend të tretë trashëgimlënësin e trashëgojnë gjyshërit, vëllezërit e motrat si dhe bashkëshorti dhe personat e paaftë për punë, po që se nuk kanë trashëguar në radhën paraprake të trashëgimisë. Ndërsa, në Kosovë dhe shtetet e ish-Jugosllavisë në rendin e tretë, thirren në trashëgim gjyshërit e trashëgimlënësit. Dallime të rëndësishme ekzistojnë edhe sa u përkët trashëgimtarëve të domosdoshëm. Në Kosovë dhe në shtetet e ish-Jugosllavisë, si trashëgimtarë të domosdoshëm konsiderohen: fëmijët e trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre; bashkëshorti pasjtues; prindërit; vëllezërit e motrat dhe gjyshërit e trashëgimlënësit. Ndërkaq, në Shqipëri rrethi i trashëgimtarëve ligjorë të domosdoshëm është shumë më i ngushtë gjegjësisht në Shqipëri trashëgimtarë të domosdoshëm apo siç emërtohen ndryshe rezervatarë ligjorë konsiderohen: fëmijet e mitur dhe fëmijët e fëmijëve të mitur të trashëgimlënësit si dhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit.

KAPITULLI III

TRASHËGIMIA TESTAMENTARE NË KOSOVË DHE NË DISA SHTETE NË RAJON-VËSHTRIM KRAHASIMOR

"Është fatekeqësi të vdesësh, pa lënë testament"

3. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit

Në këtë kapitull trajtohet trashëgimia testamentare në Kosovë dhe në disa shtete në rajon përkatësisht në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri. Ky kapitull është i ndarë në tri pjesë. Pjesa e parë, e këtij kapitulli analizon një sërë çështjesh më rëndësi për trashëgiminë testamentare. Së pari, trajtohet kuptimi dhe karakteristikat e testamentit, më tej trajtohet zotësia apo aftësia për të disponuar më testament dhe zotësia për të trashëguar më testament. Një rëndësi e posaçëm në këtë pjesë i kushtohet përmbajtjës së testamentit, duke i analizuar më kujdes elementët që duhet t'i përmbajë një disponim më testament, si caktimi i trashëgimtarëve dhe pasurisë që u lihet më testament trashëgimtarëve, caktimi i legut dhe barrës si dhe caktimi i ekzekutuesit të testamentit. Këto çështje janë trajtuar duke u referuar në Ligjin për Trashëgimi i Kosovës dhe njëkohësisht në Ligjet për Trashëgimi të shteteve të përfshira në studim, duke u përpjekur në këtë mënyrë të sqarojmë qasjet dhe dallimet kryesore ndërmjet ligjit tonë dhe ligjeve të shteteve të marra në studim. Pjesa e dytë, e këtij kapitulli merr në analizë llojet e formave të testamenteve, të cilat aplikohen në Kosovë, më ç'rast trajtohen testamenti i shkruar nga vetë testatori (ollograf); testamenti i shkruar në praninë e dëshmitarëve (alografik), testamenti gjyqësor, testamenti noterial dhe testamenti më gojë. Ndërsa, format e testamenteve të cilat aplikohen në shtetet e marra në studim gjegjësisht në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri, trajtohen në pjesën e tretë të këtij kapitulli.

3.1. Rregullat e përgjithshme të trashëgimisë testamentare

3.1.1. Kuptimi dhe karakteristikat e testamentit

Në rastin e trashëgimisë testamentare, ndarja e pasurisë trashëgimore bëhet sipas vullnetit të trashëgimlënësit të shprehur në testament. Në trashëgiminë testamentare, bazë juridike për kalimin e pasurisë trashëgimore tek trashëgimtarët është testamenti.[397]Testamenti është shprehje e njëanshme e vullnetit e dhënë në formën e paraparë më ligj, nëpërmjet të cilit mundësohet që të ndryshohet rendi i trashëgimisë ligjore. Sikurse në të gjitha legjislacionet bashkëkohore, ashtu dhe në legjislacionet e marra në analizë, testamenti konsiderohet si baza juridike kryesore e thirrjes në trashëgimi, në atë konteks që trashëgimia ligjore zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament ose kur ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm. Pra, baza juridike e trashëgimisë testamentare gëzon prioritet në raport më bazën juridike të trashëgimisë ligjore. Termi testament për herë të parë është përdorur në të drejtën romake si testamentum. Fillimisht testamentum është hasur në Romën e lashtë dhe nënkuptonte "deklarimin për kalimin e pasurisë nga një person në favor të një apo më shumë trashëgimtarëve, duke dëshmuar që deklarimi përmbante vullnetin e fundit dhe për këtë kërkonte miratimin nga të pranishmit që paraqiteshit si dëshmitarë prej thirrjes që ju drejtohej".[398] Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, testamenti përkufizohet si "dokument zyrtar që bën trashëgimlënësi, më anën e të cilit ai, më vullnetin e tij, i lë pas vdekjes pasurinë a sendet vetjake dikujt tjetër".[399]Kuptimi i testamentit jepet edhe më dispozita ligjorë.Ligji për Trashëgimi i Kosovës, e përkufizon testamentin në këtë mënyrë: "Testament do të thotë shprehje e vullnetit të fundit e dhënë në formën e paraparë me ligj, me të cilin trashëgimlënësi (testatori) urdhëron si të veprohet me pasurinë e tij pas vdekjes së tij".[400]Ngjajshëm testamenti përkufizohet edhe në KCSH sipas të cilit "testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me ane të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes".[401] Për dallim nga LTK dhe KCSH, Ligji për Trashëgimi i Serbisë në përkufizimin e testamentit e përfshinë edhe veçorinë që testamenti është veprim juridik i revokushëm. Përkatësisht Ligji për Trashëgimi

[397] Shih N. Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë. Fq.144.
[398] A. Hakani (2010) Trashëgimia Testamentare, Legjislacioni dhe Praktika Gjyqësore. Tiranë. Fq. 27.
[399] Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, botim i Akademisë së Skencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë 1980.Fq.1989. (Cituar nga A. Hakani (2010) vepra e njëjtë. Fq. 27.
[400] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 69 par.1.
[401] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013). Shih nenin 372 par.1.

i Serbisë, e përkufizon testamentin kësisoj: "Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm, personal dhe gjithmonë i revokuar, i personit të aftë i cili disponon pasurinë e tij në rastin e vdekjes në formën e caktuar më ligj."[402] Ndërkaq, më ligjet e tjera të marra në analizë gjegjësisht më LTMK, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME, nuk jepet kuptimi i testamentit.

Nga përkufizimi që i është dhënë testamentit, sipas LTK, KCSH dhe LTRS, mund të nxjerrim disa veçori karakteristikë për testamentin, të cilat janë: a) Testamenti është veprim juridik i njëanshëm; b) Testamenti është veprim juridik mortis causa; c) Testamenti është veprim juridik formal; d) Testamenti është veprim juridik personal; e) Testamenti është veprim juridik pa shpërblim (bamirës) dhe g) Testamenti është veprim juridik i revokueshëm.

Testamenti është veprim juridik i njëanshëm, sepse lind dhe krijon efekte juridike vetëm me deklarimin e vullnetit të një personi gjegjësisht testatorit. Deklarimi i vullnetit në testament duhet të jetë vullnet i lirë. Deklarimi i vullnetit konsiderohet se është i lirë nëse nuk është dhënë nën ndikimin e dhunës, mashtrimit, lajthimit apo kanosjes. Testamenti është veprim juridik mortis causa, për faktin se efektet juridike gjegjësisht të drejtat dhe detyrat që dalin nga testamenti realizohen vetëm pas vdekjes së testatorit. Pra, testamenti është veprim juridik që ndërmirret për së gjalli të subjektit, por që efektet e tij shkaktohen pas vdekjes së subjektit (testatorit). Testamenti konsiderohet veprim juridik formal, sepse për vlefshmërinë e tij kërkohet formë e veçantë e paraparë më ligj. Mos respektimi i formës së paraparë më ligj, ka për pasojë shpalljen e pavlefshme të testamentit. Pra, vullneti i testatorit për ndarjen e pasurisë së tij për kohën pas vdekjes kërkohet të shfaqet në formën e caktuar. Testamenti është veprim juridik personal (intuita personae) për faktin se testamenti mund të bëhet vetëm më deklarimin e drejtëpërdrejtë të vullnetit nga vetë testatori. Pra, testamenti nuk mund të bëhet përmes përfaqësuesit. Testamenti është veprim juridik pa shpërblim sepse personat të cilet përfitojnë nga testamenti nuk japin ndonjë shpërblim për pasurinë e fituar. Testamenti konsiderohet veprim juridik i revokueshëm sepse testatori mund ta ndryshojë testamentin në çdo kohë, duke i ndryshuar dispozitat e testamentit të mëparshëm ose duke hartuar një testament të ri, i cili lë pa fuqi testamentin e mëparshëm.

[402] Ligji për Trashëgiminë i Serbisë (Gazeta Zyrtare e Serbisë Nr 46/1995, 101/2003-18, 6/2015). Shih nenin 78.

3.1.2. Zotësia për të disponuar më testament

Në doktrinën juridike më zotësinë për të disponuar më testament nënkuptohet zotësia e personit fizik që në mënyrë vullnetare dhe në pajtim më ligjin të disponojë tërë ose një pjesë të pasurisë pas vdekjes në favor të një ose disa personave të tjerë.[403] Zotësinë apo të drejtën për të disponuar më testament e kanë vetëm personat fizik. Zotësia për të disponuar më testament përcaktohet duke u mbështetur në dy kritere, moshën dhe aftësinë mendore të personit. Kriteri i moshës zakonisht lidhet më arritjen e moshës madhore të personit gjegjësisht më fitimin e zotësisë së veprimit. Ndërsa, aftësia mendore ka të bëjë më aftësinë e personit që të kuptojë rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tij. Sipas Ligjit për Trashëgimi i Kosovës. zotësinë për të disponuar më testament e ka çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç. Përjashtimisht, zotësia për të disponuar më testament sipas LTK, i njihet edhe personit mbi moshën 16 vjeç kur është i martuar. Pra, në Kosovë të drejtë për të hartuar testament kanë personat të cilët kanë arritur moshën madhore 18 vjeç dhe nën këtë moshë, në moshën 16 vjeç vetëm kur janë të martuar. Në Shqipëri të drejtën për të hartuar testament, e kanë personat që kanë mbushur moshën 18 vjeç, kurse nën këtë moshë e drejta për të hartuar testament i lejohet vetëm gruas kur është e martuar. Kjo rezulton nga neni 373 par.1 i KCSH ku thuhet: "Testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, si dhe gruaja nën këtë moshë kur është e martuar." Pra, ndryshe nga LTK, sipas KCSH më lidhjen e martesës zotësinë për të vepruar gjegjësisht të drejtën për të bërë testament e fiton vetëm gruaja. Një dallim tjetër është që sipas KCSH, e drejta për të hartuar testament i njihet edhe personit mbi moshën 14 vjeç për pasurinë që e ka fituar më punën e vet të pavarur.[404] Ndonëse, në Kosovë të miturve mbi moshën 15 vjeç, u lejohet që të hyjnë në marrëdhënie kontraktuese të punës[405], LTK nuk parashikon nëse këta persona kanë të drejtë ose jo për të disponuar më testament pasurinë e fituar më punën e tyre. Në Kroaci të drejtën për të hartuar testament e ka çdo person që ka mbushur moshën 16 vjeç.[406] Ndërsa, në Maqedoni[407], Serbi[408], Sllloveni,[409] Bosnjë dhe Hercegovinë[410] dhe Mal të Zi[411]e drejta për të hartuar testament

[403] A. Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë, Tiranë. Fq. 54.
[404] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013). Shih nenin 373 par.2.
[405] Ligji Nr.03/L-212 i Punës i Republikës së Kosovës. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010). Shih nenin 7 par.2.
[406] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Kroacisë 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15). Neni 26 par.1.
[407] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë Nr 47/1997, 18/2001). Neni 62 par.2.
[408] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Serbisë (Gazeta Zyrtare e Serbisë Nr 46/1995, 101/2003-18, 6/2015). Neni 79.
[409] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Slovenisë (Gazeta Zyrtare e Slovenisë Nr 15/76, 23/78; 17/91, 13/94, 40/94, 117/00, 67/01, 83/01, 31/13 dhe 63/16). Neni 59 par.1.
[410] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Bosnjës dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjes dhe Hercegovinës Nr 2/98, 39/04 i 73/05). Neni 62.1.
[411] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Malit të Zi (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi Nr 74/2008). Neni 61.1.

i njihet çdo personi që ka mbushur moshën 15 vjeç. Krahas kriterit të moshës për të fituar zotësinë apo të drejtën për të hartuar testament, në çdo legjislacion kërkohet që të plotësohet edhe kushti tjetër, e që është aftësia mendore. Aftësia mendore nënkupton aftësinë e personit që të kuptojë rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tij. Mund të ndodhë se personi edhe përkundër moshës, për shkak të ndonjë sëmundje psikikë apo ngecjes në zhvillimin mendor, mos të jetë në gjendje të kuptojë rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tij. Pra, testatori duhet të jetë i shëndoshë mendërisht dhe të kuptojë rëndësinë e të bërit testament dhe pasojat që dalin nga një akt i tillë, në të kundërtën testamenti konsiderohet i pavlefshëm. Nga kjo që u tha më lartë, mund të nxjerrim përfundim se zotësia për të disponuar më testament është zotësia e personit, i cili e ka arritur moshën ligjore dhe i cili është i aftë për kuptuar rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tij, që të disponojë tek personat e tjerë pasurinë e tij në rast të vdekjes. Zotësia për të disponuar më testament duhet të ekzistojë në momentin e hartimit të testamentit. Humbja e aftësisë se testatorit për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tij, pas hartimit të testamentit nuk ndikon në vlefshmërinë e testamentit.Është më rëndësi të theksohet se rregullat për zotësinë për të disponuar më testament vlejnë vetëm për personat vendas,pasi për personat e huaj (jo shtetas të vendit) në lidhje më zotësinë për të disponuar më testament aplikohen rregullat e ligjit të shtetit të cilit i përkasin.[412]

3.1.3. Zotësia për të trashëguar më testament

Sipas rregullit zotësia për të trashëguar më testament, i njihet çdo personi që ka zotësi për të trashëguar. Sipas ligjeve të marra në analizë përkatësisht sipas LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH, LTME dhe KCSH, zotësi për të trashëguar ka personi i cili në momentin e çeljes së trashëgimisë është gjallë ose është zënë (konceptuar) para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë.[413]KCSH,bënë një përjashtim nga kjo rregull në rastin e trashëgimisë testamentare. Përkitazi më këtë çështje KCSH, në nenin 374 parashikon: "Janë të pazotë për të fituar me testament ata që janë të pazotë për të trashëguar me ligj me përjashtim të fëmijëve të pandërmjetshëm të një personi të caktuar dhe të gjallë në kohën e vdekjes së testatorit edhe sikur ata fëmijë të mos jenë zënë ende."Sipas teorise juridike shqiptare,më fëmijë të pandërmjetshëm kuptohet personi i cili nuk rrjedh direkt nga testatori.[414] Pra,sipas KCSH të aftë për të trashëguar

[412] Shih A.Bilalli & H.Kuçi (2012) E Drejta Ndërkombëtare Private. Prishtinë. Fq.216.
[413] Shih Ligjin për Trashëgimi i Kosovës (neni 7); LT i Maqedonisë (neni 122); LT i Serbisë (neni 3); LT i Bosnjës dhe Hercegovinës (neni 157); LT i Kroacisë (neni 124); LT i Slovenisë (neni 125); LT i Malit të Zi (neni 126) dhe Kodin Civil Shqiptar (neni 320).
[414] Shih A. Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë, Tiranë. Fq.60.

më testament konsiderohen edhe fëmijët që ende nuk janë zënë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit (testatorit), pavarësisht se këta nuk mund të trashëgojnë sipas trashëgimisë me ligj.Për shembull, trashëgimlënësi mund të lërë pasurinë e tij në favor të djalit të vajzës (nipit) edhe pse nipi nuk është zënë ende në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit, më kusht që vajza të jetë e gjallë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.[415]Mirëpo, nëse vajza e testatorit në këtë rast vdes dhe nuk lind fëmijën, shtrohet pyetja së çfarë ndodhë më fatin e pasurisë. Më KCSH, nuk parashikohet ky rast. Pra, është e paqartë së çfarë ndodhë më fatin e pasurisë në rast së fëmija i pandërmjetëm nuk lind dhe testatori nuk e ka parashikuar në testament se kush mund ta zëvendësojë atë. Është e paqartë gjithashtu dhe raporti juridik që krijohet ndërmjet personit të caktuar me pasurinë trashëgimore, nga moment i çeljes së trashëgimisë deri në lindjen e fëmijës së pandermjetëm.[416]Sipas autorit A.Hakani, në rastin kur më testament nuk parashikohet ndryshe, kur lindja e fëmijës së pandërmjetëm nuk ndodhë dhe personi i caktuar vdes, pasuria nuk u shpërndahet trashëgimtarëve ligjorë të personit të caktuar. Në shembullin e përmendur më sipër, pasuria nuk u ndahet trashëgimtarëve ligjorë të vajzës së trashëgimlënësit. Mirëpo, nëse lejojnë kushtet aplikohen rregullat e së drejtës së shtimit ndaj trashëgimtarëve testamentarë. Në të kundërtën, pasuria u ndahet trashëgimtarëve ligjorë të testatorit. Pra,në këtë rast veprohet sikurse testamenti të ishte i pavlefshëm apo inekzistent.[417]

3.1.4. Pavlefshmëria e testamentit

Sipas dispozitave të LTK, ashtu sikurse edhe sipas dispozitave të LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH, LTME dhe KCSH, testamenti konsiderohet i pavlefshëm në këto raste:

a) Kur testamenti është bërë nga një person që nuk ka pasur zotësi për të bërë testament;
b) Kur testamenti është bërë më mashtrim, kanosje ose dhune, ose kur ekziston lajthimi mbi shkaqet që kanë shtyrë trashëgimlënësin të bëjë testamentin;
c) Kur testamenti nuk është bërë në formën e paraparë më ligj.
d) Kur disponimi në testament është bërë në favor të personave që nuk mund të trashëgojnë.[418]

[415] Shih A. Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë, Tiranë. Fq.60.
[416] A. Hakani (2010) Trashëgimia Testamentare, Legjislacioni dhe Praktika Gjyqësore. Tiranë. Fq. 148.
[417] Po aty. Fq.148.
[418] Shih LTK (nenin 71); LTMK (nenin 63); LTRS (nenin 169); LTBH (nenin 63); LTHR (nenin 27); LTSI (nenin 60); LTME (nenin 62) dhe KCSH (nenet prej 403 deri 410).

Anulimin e testamentit për shkak të ndonjërit prej këtyre shkaqeve, sipas ligjeve të analizuara (përjashtimisht KCSH) mund ta kërkojë vetëm personi që ka interes juridik, brenda afatit prej 1 viti nga dita kur ka marrë dijeni se ekzistojnë shkaqet e pavlefshmërisë, e më së largu 10 vjet nga shpallja e testamentit. Afati prej një viti fillon të rrjedhë më shpalljen e testamentit. Kurse, anulimi i testamentit ndaj personit me keqbesim, mund të kërkohet edhe 20 vjet pas shpalljes së testamentit.[419] Ndërkaq, sipas KCSH shpallja e pavlefshme e testamentit, mund të kërkohet nga trashëgimtarët apo personat e tjerë që kanë interes juridik, brenda afatit prej 3 vjetëve nga çelja e trashëgimisë.[420]

3.2. Përmbajtja e testamentit

Sikurse çdo veprim tjetër juridik edhe testamenti kërkohet të hartohet në bazë të elementëve të caktuara. Elementët të cilat duhet t'i përmbajë një testament janë:

1. Caktimi i trashëgimtarëve;
2. Caktimi i pasurisë që do u kalojë trashëgimtarëve;
3. Caktimi i legut dhe barrës; si dhe
4. Caktimi i ekzekutuesit të testamentit.[421]

Dy elementët e para janë elemente të domosdoshme pa të cilat testamenti nuk mund të ekzistojë,kurse dy elementët e fundit janë elemente jo të domosdoshme të cilat varen nga vullneti i testatorit.

3.2.1. Caktimi i trashëgimtarëve dhe pasurisë që do u kalojë trashëgimtarëve

Caktimi i personave gjegjësisht trashëgimtarëve që do u lihet pasuria më testament është element bazik i domosdoshëm i testamentit. Trashëgimlënësi mund të caktojë me testament një ose më shumë trashëgimtarë. Pra,caktimi i trashëgimtarëve varet nga vullneti i trashëgimlënësit. Testatori ka të drejtë që të caktojë në testament edhe personin që do ta zëvendësojë trashëgimtarin e caktuar në testament. Për shembull, trashëgimlënësi e ka disponuar më testament pasurinë e tij në favor të dy fëmijëve të tij (vajzës dhe djalit) dhe nëse djali nuk dëshiron (ka hequr dorë nga trashëgimi) ose nuk ka mundësi të trashëgojë (ka vdekur para trashëgimlënësit apo është shpallur i padenjë për trashëgim) trashëgimlënësi mund ta zëvendësojë atë më një trashëgimtarë tjetër. Gjithashtu, në vullnetin e trashëgimlënësit lihet edhe

[419] Shih LTK (nenin 72); LTMK (nenin 64); LTRS (nenin 170); LTBH (nenin 64); LTHR (nenin 28); LTSI (nenin 61); LTME (nenin 63)
[420] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 411.
[421] Shih N. Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë. Fq. 91.

caktimi i pasurisë që do u lihet trashëgimtarëve. Përkatësisht trashëgimlënësi mund të vendosë që trashëgimtarët të trashëgojnë gjithë pasurinë ose një pjesë të saj p.sh.1/3 ose sende apo të drejta të caktuara.[422] Pra, trashëgimlënësi është i lirë të disponojë pasurinë e tij më testament, mirëpo duke pasur kujdes që të mos preket pjesa e pasurisë që u garantohet më ligj një kategorie të caktuar personash,të cilët njihen si trashëgimtarë të domosdoshëm.Sikurse është përmendur edhe në kapitullin paraprak, ekzistojnë dallime jo pak të rëndësishme midis ligjeve të analizuara, sa u përkët çështjes së trashëgimtarëve të domosdoshëm. Kështu, sipas LTK, LTRS, LTSI, LTME, personave të cilëve më ligj u garantohet pjesa e pasurisë dhe të cilën trashëgimlënësi nuk guxon ta disponojë më testament janë: Fëmijët e trashëgimlënësit më të pasardhësit e tyre, bashkëshorti pasjtues, prindërit e trashëgimlënësit, vëllezërit e motrat e trashëgimlënësit dhe gjyshërit e trashëgimlënësit.[423]Duhet theksuar së vëllezërit e motrat dhe gjyshërit e trashëgimlënësit konsiderohen trashëgimtarë të domosdoshëm vetëm nëse nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë. Sipas LTMK, personave të cilëve perherë u takon pjesa e pasurisë së domosdoshme janë: Fëmijet e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti pasjtues. Ndërsa, prindërit dhe vëllezërit e motrat e trashëgimlënësit konsiderohen trashëgimtarë të domosdoshëm vetëm nëse nuk kanë mjete për jetesë.[424]Gjithashtu, edhe sipas LTRH, personave të cilëve perherë u takon pjesa e domosdoshme janë: Fëmijet e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti pasjtues, ndërsa prindërve të trashëgimlënësit dhe paradhësve të tjerë të trashëgimlënësit, u takon pjesa e domosdoshme vetëm nëse nuk kanë mjete përjetesë.[425]Sipas LTBH, fëmijve të trashëgimlënësit dhe bashkëshortit pasjtues u takon përherë pjesa e domosdoshme, ndërsa pasardhësve të tjerë të trashëgimlënësit, prindërve dhe vëllezërve e motrave të trashëgimlënësit, u takon pjesa e domosdoshme vetëm nëse nuk kanë mjete për jetesë.[426] Ndërkaq,në Shqipëri rrethi i trashëgimtarëve të domosdoshëm (apo rezervatarëve ligjorë siç emërtohen në ligjin shqiptar) është më i ngushtë. Sipas KCSH, trashëgimtarë të domosdoshëm gjegjësisht rezervatarë ligjorë konsiderohen fëmijet e mitur dhe fëmijët e fëmijëve të mitur të trashëgimlënësit si dhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit.[427] Mirëpo, KCSH, përmbanë edhe një dispozitë të veçantë, e cila i referohet drejtpërdrejtë rrethit të trashëgimtarëve testamentarë. Fjala është për dispozitën e nenit 377 ku

[422] Shih LTK (neni 87); LTMK (neni 96-97); LTRS (neni 114); LTBH (neni 99-100); LTHR (neni 43-44); LTSI (neni 78-79); LTME (neni 93-94) dhe KCSH (neni 381).
[423] Shih LTK (neni 30 par.1,2); LTRS (neni39 par.1,2); LTSI (neni 25 par.1,2); LTME (neni 27 par.1,2).
[424] Ligji për Trashëgimi i Maqedonisë, shih nenin 30 par.1,2 dhe 3.
[425] Ligji për Trashëgimi i Kroacisë, shih nenin 69 par.1 dhe 2.
[426] Ligji për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, shih nenin 28 par.1 dhe 2.
[427] Shih A. Hakani (2010) Trashëgimia Testamentare (Legjislacioni dhe Praktika Gjyqësore) Tiranë. Fq.185.

thuhet: “Trashëgimlënësi që nuk ka të paslindur ose të paralindur ose vëllezër e motra, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vet, në çdo person fizik apo juridik”. Nga kjo rezulton se testatorit i vihet kufizim në caktimin e trashëgimtarëve në testament gjegjësisht testatori nuk mund të disponojë më testament jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë të cekur në dispozitën e cituar më lartë, të cilët i takojnë tre radhëve të para të trashëgimisë. Pra, sipas KCSH, testatorit i ndalohet që të disponojë më testament pasurinë në favor të personave të tjerë, derisa ekzistojnë trashëgimtarët ligjorë, që u takojnë tri radhëve të para të trashëgimisë.[428]

3.2.2. Caktimi i legut dhe barrës

Caktimi i legut përbënë një element tjetër më rëndësi të testamentit, i cili varet nga vullneti i trashëgimlënësit. Institucioni i legut është njohur që nga e drejta romake.Në të drejtën romake legu ishte një nga format e suksedimit singular dhe nënkuptonte urdhërimin e bërë prej testatorit në testatment ose në një kodicil bashkangjitur testamentit, me anën e të cilit një personi të caktuar pa i dhënë statusin e trashëgimtarit, i jepej një dhuratë e cila përfshihej në masën trashëgimore dhe mund të përbëhej nga një send i vetëm caktuar trashëgimtarit, ose një personi të tretë. Në terminologjinë romake legatari quhej onorato (i nderuar), kurse personi i detyruar të përmbushte legun quhej onerato. Personi i ngarkuar (onerato) më legun mund të ishte vetëm trashëgimtari, i cili përfitonte nga aktvi i pasurisë trashëgimore.[429] Trashëgimtari (onerato) e përmbushte legun më aktivin e pasurisë trashëgimore, e jo më aktivin e pasurisë së vetë të veçantë. Në rastin kur objekt i legut ishte ndonjë send që i përkiste dikujt tjetër, trashëgimtari i ngarkuar më legun kishte për detyrë ta blinte atë më aktivin e pasurisë trashëgimore. Ndërsa, përfitues të legut gjegjësisht legatar (onorato) mund të ishin vetëm ata të cilët kishin zotësi për të trashëguar më testament.[430]Shumë nga rregullat e përgjithshme për legun, që kanë vlejtur në të drejtën romake aplikohen edhe sot, kjo vërehet në vetë kuptimin apo definicionin që i jepet legut. Përkatësisht, kuptimi që i jepet sot legut më dispozita ligjore, nuk dallon nga kuptimi që i është dhënë legut në të drejtën romake. Kështu, në nenin 93 i LTK legut i jepet ky kuptim: “Testatori mund të lërë me testament një ose më shumë sende të caktuara ose ndonjë të drejtë personit të caktuar, të urdhërojë trashëgimtarin ose ndonjë person tjetër, të cilit i lë diçka që nga ajo që i është lënë të japë ndonjë send një personi të caktuar, t’i paguajë një shumë të hollash, ta lirojë

[428] Shih A. Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë, Tiranë. Fq.64.
[429] E. Olldashi (2015) E Drejta Romake. Botimi i Dytë. Tiranë. Fq.290.
[430] Po aty. Fq. 291.

nga ndonjë borxh e ta mbajë ose në përgjithësi të bëjë diçka, të përmbahet nga ndonjë veprim ose të fitojë diçka në dobi të tij. Kjo mënyrë e të trashëguarit quhet leg, kurse personi të cilit i është destinuar legu quhet legatar." Ngjajshëm legu përkufizohet edhe nga LTMK, në nenin 103 ku thuhet: "Testamentlënësi mundet që më anë të testamnetit ti lë personi të caktuar një ose më tepër sende të caktuara apo të ndonjë të drejtë, ose të urdhërojë trashëgimatrin ose ndonjë personi tjetër që i lënë diçka, që ti ndajë ndonjë send nga ajo që i është lënë personit të caktuar apo të paguajë shumë të caktuar parash, ta lirojë nga ndonjë borxh, ta mbajë, të bëjë diçka në interes të tijë apo të përmbahet ose durojë diçka.Më testamentin e këtillë parimisht nuk përcaktohen trashëgimtar.Testamenti i këtillë quhet legë, ndërsa personit të cilit i dedikohet quhet legator." Ngjajshëm kuptimi i legut jepet edhe më ligjet e tjera të analizuara.[431]Nga kuptimi që ligji i ka dhënë legut mund të nxjerrim disa karakteristika për mënyrën e trashëgimit më anë të legut. Së pari,legu mund të lihet vetëm më testament. Pra,për themelimin e legut domosdo kërkohet që trashëgimlënësi ta disponojë pasurinë më testament. Së dyti, personi që përfiton nga legu gjegjësisht legatari nuk konsiderohet trashëgimtarë. Kjo pasi legatari pasurinë nuk e fiton më testament, por e fiton nga trashëgimtari i caktuar, të cilit trashëgimlënësi i ka lënë detyrim përmbushjen e legut. Nga kjo mund të nxjerrim përfundim se legu është detyrim i caktuar në testament i trashëgimtarit ndaj legatarit, në lidhje më pjesën e pasurisë që trashëgimtari ka fituar nga trashëgimlënësi. Pra, në disponimin më leg, trashëgimtari i ngarkuar paraqitet si debitor, kurse përfituesi i legut gjegjësisht legatari paraqitet në rolin e kreditorit të tij.[432] Në ligjet e analizuara (më përjashtim të KCSH) nuk përcaktohet shprehimisht se cilët persona kanë zotësi për të fituar pasurinë më anë të legut. Sipas KCSH, zotësia për të fituar pasurinë më anë të legut përcaktohet sipas rregullave të njëjta më të cilat përcaktohet zotësia për të trashëguar.[433]Pra, e drejta për të fituar pasurinë më anë të legut, i njihet çdo personi që ka zotësi për të trashëguar. Nga kjo rezulton se si legatarë të pasurisë së tij, testatori mund të përcaktojë çdo person që ka zotësi për të trashëguar. Nga ky rregull i përgjithshëm KCSH, bënë përjashtim. Më KCSH, liria e testatorit për të përcaktuar legatarin në testament është e kufizuar, kur ai ka trashëgimtarë ligjorë të tre radhëve të para. Përkatësisht, sipas KCSH, kur testatori ka trashëgimtarë ligjore të tre radhëve të para, ai nuk mund që të disponojë legun në favor të personave të tjerë.[434] Pra, KCSH

[431] Shih LTSI (neni 85); LTRS (neni 141); LTBH (neni 106); LTHR (neni 45); LTME (neni 100).
[432] A. Hakani (2010) Trashëgimia Testamentare, Legjislacioni dhe Praktika Gjyqësore. Tiranë. Fq. 240.
[433] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013). Shih nenin 384 par.3.
[434] Shih A. Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë, Tiranë. Fq.96 dhe 98.

caktimin e personave që mund të përfitojnë nga legu, e bënë sipas rregullës së njëjtë më atë për caktimin e trashëgimtarëve testamentarë. Ndërkaq, më ligjet e tjera të analizuara përkatësisht më LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME, testatorit nuk i vihet ndonjë kufizim në caktimin e legatarit. Pra, testatorit i lejohet që të disponojë legun edhe në favor të personave që nuk i përkasin trashëgimtarëve ligjorë, mirëpo pa e cënuar më këtë rast pjesën e domosdoshme, e cila u garantohet një kategorie të caktuar të trashëgimtarëve ligjorë. Në rastin, kur testatori ka cënuar pjesën e domosdoshme, sipas rregullit bëhet zvogëlimi i disponimit më testament. Sipas LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME, trashëgimtarit testamentar pjesa trashëgimore e të cilit duhet të zvogëlohet për t'u plotësuar pjesa e domosdoshme, i njihet e drejta që të kërkojë zvogëlimin proporcional të legëve që ai duhet t'i paguajë, po qe se më testament nuk parashihet ndryshe.[435] Pra, legu nuk mund të zbatohet në rast se testatori ka cënuar pjesën e domosdoshme. Testatori mund t'i ngarkojë më përmbushjen e legut, të gjithë trashëgimtarët, disa ose vetëm njërin prej tyre. Në bazë të testamentit, legatarit i takon e drejta që të kërkojë përmbushjen e legut nga personi që është ngarkuar me testament që të permbushë legun. Nëse për përmbushjen e legut janë ngarkuar disa persona, secili përgjigjet në përpjestim me pjesën e pasurisë trashëgimore që merr, përveç nëse më testament parashihet ndryshe. Mund të ndodhë se testatori ta caktojë legun, por mos ta parashohë në testament se cili prej trashëgimtarëve do të merret më ekzekutimin e tij. Në këtë rast, sipas zgjidhjes së parashihet në ligjet e analizuara, secili prej trashëgimtarëve të përfshirë në testament, detyrohet që të kontribuojë në përmbushjen e legut, sipas pjesës që i takon në pasurinë trashëgimore.[436] Një situatë tjetër që gjen rregullim në ligjet e analizuara është rasti kur trashëgimtari i ngarkuar me legun, ka vdekur para testatorit ose kur për ndonjë nga shkaqet e parapara më ligj nuk mundet të trashëgojë. Në lidhje më këtë rast, në ligjet e analizuara gjegjësisht në LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH, LTME dhe KCSH, parashihen dy zgjidhje. Sipas zgjidhjes së parë, detyrimi për të përmbushur legun bie mbi trashëgimtarët e tjerë të përfshirë në testament ose mbi trashëgimtarët ligjorë, të cilëve në bazë të së drejtës së shtimit u kalon pjesa e trashëgimtarit, i cili për ndonjë nga shkaqet e parapara më ligj nuk mund të trashëgojë. Ndërsa, në rastin kur përmbushja e detyrimeve në lidhje me legun është e lidhur ngushtë me personin që për shkaqet e parapara më ligj nuk mund të trashëgojë, atëherë legu mbetet pa u përmbushur. Në këtë rast legu

[435] Shih LTK (neni 42); LTMK (neni 41); LTRS (neni 55); LTBH (neni 40); LTHR (neni80); LTSI (neni 37); LTME (neni 39).
[436] Shih LTK (neni 94 dhe 97); LTMK (neni 104); LTRS (neni 145); LTBH (neni 107); LTHR (neni 51); LTSI (neni 86); LTME (neni 102) dhe KCSH (neni 388).

shpallet i pavlefshëm.[437] Përveç trashëgimtarit që është i ngarkuar më testament, mund të ndodhë që edhe legatari të vdesë para testatorit ose pasi çelet trashëgimia. Shtrohet pyetja se çfarë ndodhë më legun në këtë rast. Ky rast parashikohet në të gjitha ligjet e analizuara. Sipas dispozitave të ligjeve të analizuara gjegjësisht sipas LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH, LTME dhe KCSH, kur legatari vdes para trashëgimlënësit ose kur për ndonjë nga shkaqet e parapara më ligj nuk mund të fitojë pasurinë më leg, legu nuk u kalon trashëgimtarëve ligjorë të legatarit, por i mbetet trashëgimtarit që ka qenë i detyruar ta përmbushë atë, po qe se nga vetë testamenti nuk rezulton ndryshe.[438] Sipas një pikëpamje që është shfaqur në doktrinën juridike shqiptare, në rast se legatari ka vdekur para çeljes së trashëgimisë, legu nuk u kalon trashëgimtarëve të legatarit[439], që do të thotë legu mbetet pa u përmbushur. Pra, në këtë rast e drejta e legatarit merret si e drejtë personale, e cila kuptohet që nuk mund të kalojë në trashëgimtarë. Ndërsa, në rastin e kundërt kur legatari vdesë pas çeljes së trashëgimisë, sipas autorit të pikëpamjes në fjalë, legu do të përmbushet në favor të trashëgimtarëve ligjorë të legatarit të vdekur. Pra,në këtë rast e drejta e legatarit, konsiderohet si e drejtë pasurore.[440] Përndryshe, sipas rregullit të sanksionuar në LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH, LTME dhe KCSH, legu shuhet në këto dy raste a) kur legatari vdesë para trashëgimlënësit, heq dorë nga legu ose bëhet i padenjë; dhe b) kur testatori ka shpenzuar objektin e legut apo kur objekti i legut vetëvetiu ka pushuar së ekzistuari derisa ka qenë gjallë testatori, ose rastësisht është asgjësuar pas vdekjes së tij.[441]Është e rëndësishme të theksohet se e drejta e legatarit për të kërkuar përmbushjen e legut është e drejtë e kufizuar në pikëpamje kohore.Afati kohor brenda të cilit legatari ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e legut nuk rregullohet në mënyre të njëjtë në ligjet e analizuara. Kështu, më LTK parashihet që legatari ka të drejtë të kërkojë dorëzimin e legut brenda 1 viti nga dita kur ai ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe ka qenë i autorizuar të kërkojë dorëzimin e legut, e më se voni prej 3 vjetëve nga dita kur ka pasur mundësi të kërkojë dorëzimin e legut.[442] Pra,sipas LTK, afati subjektiv për dorëzimin e legut është 1 vit dhe ai objektiv 3 vite. Ndërsa, sipas LTBH[443] dhe LTHR,[444] afati subjektiv për dorëzimin e legut është

[437] Shih LTK (neni 96); LTMK (neni 107); LTRS (neni146); LTBH (neni110); LTHR (neni 54); LTSI (neni 89); LTME (neni 105) dhe KCSH (neni387).
[438] Shih LTK (neni 99); LTMK (neni 108); LTRS (neni 148); LTBH (neni 111); LTHR (neni 55); LTSI (neni 90); LTME (neni 106) dhe KCSH (neni 390).
[439] Shih J. Latifi (2006) E Drejta e Trashëgimisë në Kosovë. Prishtinë. Fq. 95.
[440] N. Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë. Fq.104.
[441] Shih LTK (neni 100); LTMK (neni 108-109); LTRS (neni 148-149); LTBH (neni 111-112); LTHR (neni 55-56); LTSI (neni 90-91) dhe LTME (neni 106-107).
[442] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 101.
[443] Ligji për Trashëgiminë i Bosnjës dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjes dhe Hercegovinës Nr 2/98, 39/04 i 73/05). Shih nenin 115.

1 vit, kurse ai objektiv 5 vite. Ndryshe nga ligjet e cituara më sipër, LTRS,[445] LTSI[446] dhe LMTE[447]parashohin vetëm një afat për dorëzimin e legut, atë prej 1 viti. Kurse LTMK, parashikon që legatari mund të ushtrojë të drejtën për të kërkuar dorëzimin e legut brenda 1 viti, pasi ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe ka qenë i autorizuar të kërkojë dorëzimin e legut, por jo më vone se 10 vjetë pas vendimit për trashëgimi ose brenda 20 viteve të vdekjes trashëgimlënësit.[448]Ndërkaq, KCSH nuk e rregullon afatin e kërkimit të legut.Në teorinë juridike shqiptare është shfaqur mendimi se caktimi i afatit për kërkimin e legut duhet të bëhet sipas llojit të së mirës materiale respektivisht sipas natyrës së sendit, ashtu që kërkimi i legut përcaktohet sipas afateve të përgjithshme dhe të posaçme të kërkimit të sendit apo të drejtës që rrjedh nga marrëdhënia e detyrimeve.[449] Kështu, p.sh., nëse pasuria leg ka të bëjë më një send, afati është i ndryshëm për sendet e luajtshme dhe të paluajtshme. Apo nëse pasuria leg ka të bëjë më një të drejtë, përsëri afati është i ndryshëm, ai i përgjithshëm dhe i posaçëm, varësisht prej natyrës së pasurisë së lënë më leg.[450]

Tabela 8: Afati ligjor për kërkimin e legut

Shteti	Afati për kërkimin e legut
Kosovë	**1-3 vite**
Maqedoni	**1-10 vite ose deri 20 vite**
Serbi, Slloveni dhe Mal të Zi	**1 vit**
Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë	**1-5 vite**

Përveç më leg, testatori ka të drejtë që t'i ngarkojë trashëgimtarët e tij edhe më detyrimin që një pjesë e pasurisë trashëgimore ose tërë pasuria trashëgimore të përdoret për realizimin e ndonjë interesi në dobi të shoqërisë dhe jo të individëve. Ky veprim i testatorit njihet më emrin barrë.Instituti i barrës gjen rregullim në të gjitha ligjet e analizuara. Sipas KCSH dhe LTK, testatori mund t'i ngarkojë më barrë, jo vetëm trashëgimtarët testamentarë, por edhe shtetin. Përkitazi më çështjen në fjalë, në KCSH parashikohet kësisoj:

---

444 Ligji për Trashëgiminë i Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Kroacisë 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15). Shih nenin 59.
445 Ligji për Trashëgiminë i Serbisë (Gazeta Zyrtare e Serbisë Nr 46/1995, 101/2003-18, 6/2015). Shih nenin 154.
446 Ligji për Trashëgiminë i Slovenisë (Gazeta Zyrtare e Slovenisë Nr 15/76, 23/78; 17/91, 13/94, 40/94, 117/00, 67/01, 83/01, 31/13 dhe 63/16). Shih nenin 94.
447 Ligji për Trashëgiminë i Malit të Zi (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi Nr 74/2008). Shih nenin 112.
448 Ligji për Trashëgiminë i Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë Nr 47/1997, 18/2001). Shih nenin 112.
449 A. Hakani (2010) Trashëgimia Testamentare, Legjislacioni dhe Praktika Gjyqësore. Tiranë. Fq.269.
450 Po aty. Fq. 269.

"Trashëgimlënësi mund të ngarkojë trashëgimtarin ose trashëgimtarët e caktuar në testament që të kryejnë ndonjë veprim të dobishëm për shoqërinë ose ndonjë veprim tjetër, pa i dhënë të drejtë një personi të caktuar mbi këtë veprim (barrë)"

"Kur trashëgimlënësi i lë me testament pasurinë shtetit, organeve të tij, ose enteve të ndryshëm, ka të drejtë të caktojë qëllimin për të cilin duhet të përdoret pasuria"[451]

Ndërsa në LTK parashikohet kësisoj:

"Testatori mund të urdhërojë me testament që një send ose e drejtë ose një pjesë e pasurisë trashëgimore ose tërë pasuria trashëgimore të përdoret për të arritur një qëllim të lejuar."[452] "Kur testatori ia lë me testament pasurinë organeve publike, ose institucioneve të tjera, ai mund të caktojë në testament qëllimin për të cilin duhet të përdoret pasuria".[453]Më LTK, nuk përcaktohet kuptimi i shprehjes qëllim i lejuar, mirëpo duke u nisur nga përmbajtja dhe qëllimi i institutit të barrës, mendojmë se shprehja qëllim i lejuar e ka kuptimin e realizimit të qëllimit që pasuria trashëgimore të përdoret në interes të shoqërisë. P.sh., për ndërtimin e një spitali, ndërtimin e një institucioni shkollor apo bibliotekës etj. I njëjti qëllim dëshirohet të arrihet edhe në rastin kur barra i lihet shtetit. Pra, edhe në rastin kur më barrë ngarkohet shteti, qëllimi është që pasuria trashëgimore të përdoret në interes të shoqërisë. P.sh.,trashëgimlënësi mund t'i lë pasurinë komunës më detyrimin që pasuria e lënë në trashëgim të përdoret për ndërtimin e një rrugë, e cila lidhe disa fshatra apo për ndërtimin e një qendre të kulturës apo për financimin e ndonjë organizate që merret më mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa përkujdes prindëror etj. Për dallim nga LTK dhe KCSH, në ligjet e tjera të marra në analizë gjegjësisht në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME, nuk gjen rregullim përmbushja e detyrimit të barrës nga ana e shtetit. Përkatësisht më dispozitat e ligjeve të cituara më sipër, parashikohet që testatori ka të drejtë që të ngarkojë më barrë trashëgimtarët testamentarë, por nuk parashikohet nëse testatori ka të drejtë ose jo që të ngarkojë më barrë edhe shtetin. Përkitazi më detyrimin e trashëgimtarëve që të përmbushin barrën në ligjet e cituara më sipër përcaktohet kësisoj: "Testatori mundet që më anë të testamentit të urdhërojë që ndonjë send apo e drejtë apo pjesë nga pasuria trashëgimore apo gjithë pasuria trashëgimore të përdoret për arritjen e ndonjë qëllimi të lejuar."[454] Edhe në këtë rast, kuptohet që shprehja qëllimi i lejuar e ka kuptimin që pasuria trashëgimore duhet të

[451] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013). Shih nenin 386.
[452] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 88 par.1
[453] Po aty, shih nenin 88.3.
[454] Shih LTMK (neni 99); LTRS (neni 118); LTBH (neni 102); LTHR (neni 46); LTSI (neni 81); LTME (neni 96).

përdoret në interes të shoqërisë, e jo të individëve. Duhet theksuar që testatori ka të drejtë që të disponojë më testament pasurinë edhe për krijimin e një fondacioni. Në ligjet e analizuara (më përjashtim të LTSI dhe KCSH) parashihet mundësia e disponimit të pasurisë për krijimin e fondacionit, mirëpo në asnjërin nga ligjet e marra në analizë nuk gjenden dispozita për natyrën dhe përmbajtjen e një disponimi të tillë.[455]Për këtë arsye, në teorinë juridike paraqitet e diskutueshme nëse disponimi më testament i pasurisë për krijimin e një fondacioni duhet të konsiderohet si një mënyrë e veçantë disponimi apo vetëm si një pjesë e disponimit më barrë i pasurisë trashëgimore.[456] Është e rëndësishme gjithashtu të theksohet që testatorit i lejohet që të vendosë edhe kushte dhe afate në lidhje më ekzekutimin e testamentit.[457]

3.2.3. Caktimi i ekzekutuesit të testamentit

Përmbajtja e testamentit, veç caktimit të trashëgimtarëve, caktimit të pasurisë që do u kalojë trashëgimtarëve, caktimit të legut dhe barrës si dhe disponimit të pasurisë për krijimin e fondacionit dhe më kusht, mund të përfshijë edhe personin që do merret më ekzekutimin e testamentit. Ligjet e marra në analizë (më përjashtim të KCSH) gjegjësisht LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME, çështjen e ekzekutimit të testamentit e rregullojnë sipas parimeve të njëjta. Sipas rregullit të sanksionuar në ligjet e cituara më sipër, testatori ka të drejë që të caktojë në testament një ose më shumë persona për të ekzekutuar testamentin.[458] Pra, detyrën e ekzekutimit të testamentit mund ta kryejnë një ose më tepër persona. Sipas KCSH, personi i cili caktohet si ekzekutes i testamentit duhet ta shpreh pëlqimin për pranimin e detyrës, në testament ose në një deklaratë të veçantë që i bashkëkohet testamentit.[459] Në rast se ekzekutuesi i testamentit nuk e pranon detyrën në ndonjërën prej këtyre dy mënyrave, atëherë caktimi i ekzekutuesit në testament konsiderohet i pavlefshëm. Ky rregull nuk gjendet në ligjet e tjera të analizuara. Më ligjet e tjera të analizuara (përkatësisht më LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME) personi i cili caktohet si ekzekutues në testament nuk kërkohet që paraprakisht të pranojë detyrën, në mënyrë që caktimi i ekzekutuesit të konsiderohet i vlefshëm. Mirëpo,në këto ligje sanksionohet shprehimisht rregulla sipas të cilës ekzekutuesi i testamentit

[455] Shih LTK (neni 88.2); LTMK (neni 99.2); LTRS (neni 118.2); LTBH (neni 102.2); LTHR (neni 46.2); LTME (neni 96).
[456] A. Hakani (2010) Trashëgimia Testamentare, Legjislacioni dhe Praktika Gjyqësore. Tiranë. Fq.282.
[457] Shih LTK (neni 89); LTMK (neni 100); LTRS (neni 119-120); LTBH (neni 103); LTHR (neni 47); LTSI (neni 82); LTME (neni 97).
[458] Shih LTK (neni 102.1); LTMK (neni 113.1); LTRS (neni172.1); LTBH (neni 116.1); LTHR (neni 60.1); LTME (neni 113.2) dhe KCSH (neni 414.1).
[459] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013). Shih nenin 414 par.2.

nuk është i detyruar që të pranojë detyrën.[460] Pra, personit të ngarkuar më ekzekutimin e testamentit i njihet e drejta që të heqë dorë nga detyra. Dallimi tjetër është që sipas KCSH, ekzekutuesi i testamentit, përveç administrimit dhe ruajtjes së pasurisë, ka për detyrë të bëjë edhe inventarizimin e pasurisë trashëgimore. Sipas KCSH, inventarizimi i pasurisë trashëgimore nga ekzekutuesi i testamentit bëhet në prani të trashëgimtarëve dhe personave të tjerë që përfitojnë nga testamenti.[461] Ndërsa, në LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME, si detyrime të ekzektuesit të testamentit përmenden: a) Ruajtja dhe administrimi i pasurisë trashëgimore; b) Pagesa e borxheve dhe legeve; dhe në përgjithësi kujdesi që testamenti të ekzekutohet ashtu si ka urdhëruar testatori.[462] Një dallim tjetër është që KCSH, parashikon rregullën që detyra e ekzekutuesit të testamentit nuk mund të bartet tek trashëgimtarët e tij.[463] Ndërsa, më ligjet e tjera të analizuara nuk bëhet ky parashikim. Dallimi tjetër është që më KCSH,nuk parashikohet e drejta e ekzekutesit të testamentit për të kërkuar shpërblim për punën e kryer, në lidhje më ekzekutimin e testamentit. Kurse, në ligjet e tjera të analizuara parashikohet shprehimisht që ekzekutuesit të testamentit i takon e drejta për të kërkuar shpërblim për punën e kryer, në lidhje më ekzekutimin e testamentit dhe për shpenzimet e bëra. Kjo pagesë kryhet në ngarkim të pjesës disponible të pasurisë trashëgimore dhe kuptohet në bazë të vendimit të gjykatës.[464] Ndërsa, në lidhje më shkarkimin e ekzekutuesit të tesamentit, në të gjitha ligjet e analizuara është sanksionuar rregulla e njëjtë, sipas të cilës gjykata mund të shkarkojë nga detyra ekzekutuesin e testamentit, kur ai nuk e përmbushe detyrën sipas ligjit apo kur nuk vepron sipas urdhërit të testatorit, ose kur nuk është i aftë për të administruar më pasurinë trashëgimore. Mirëpo, edhe këtu ekziston një dallim sa i përkët inicimit të procedurës. Kështu, sipas KCSH, procedura për shkarkimin e ekzekutuesit, mund të inicohet në bazë të propozimit të trashëgimtarëve ose personave tjerë që kanë interes.[465] Ndërsa, sipas ligjeve të tjera të analizura (përkatësisht sipas LTK, LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME) procedurën për shkarkimin e ekzekutuesit mund ta inicojë edhe gjykata sipas detyrës zyrtare.[466]

[460] Shih LTK (neni 102.3); LTMK (neni113.3); LTRS (neni 95.2); LTBH (neni 116.2); LTHR (neni 60.3); LTME (neni 113.3).
[461] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 415.
[462] Shih LTK (neni 106); LTMK (neni 114); LTRS (neni 173); LTSI (neni 96); LTBH (neni 117.1); LTHR (neni 61.1); LTME (neni 114.1).
[463] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 417.
[464] Shih LTK (neni 104.2); LTMK (neni 115); LTRS (neni 174); LTSI (neni 97.2); LTBH (neni 118.2); LTHR (neni 62.2); LTME (neni 115.2).
[465] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013). Shih nenin 416.
[466] Shih LTK (neni 105.1); LTMK (neni 116); LTRS (neni 175); LTSI (neni 98); LTBH (neni 119); LTHR (neni 63); LTME (neni 116).

3.3. Llojet e formave të testamentit në Kosovë

3.3.1 Testamentet e rregullta

Në literaturën juridike dhe në legjislacion ndarja e testamenteve sipas formës bëhet në dy grupe: a) Të rregullta dhe b) Të jashtëzakonshme. Testamente të rregullta konsiderohen ato testamente që mund të bëhen në çdo rast. Ndërsa, të jashtëzakonshme quhen ato testamente, që mund të bëhen vetëm në raste të jashtëzakonshme, të cilat ligji i parasheh në mënyrë të veçantë. Forma e testamenteve të jashtëzakonshme është e thjeshtësuar dhe vlejnë vetëm për një kohë të caktuar, gjersa të vazhdojë rrethana e jashtëzakonshme.[467]Ligji për Trashëgimi i Kosovës, i rregullon këto forma të testamenteve të rregullta:

a) Testamentin e shkruar nga vetë testatori (ollograf);
b) Testamentin e shkruar në praninë e dëshmitarëve (alografik); dhe
c) Testamentin gjyqësor.[468]

Është e rëndësishme të theksohet se më Ligjin për Noteri i Republikës së Kosovës, njihet edhe forma e testamentit noterial.[469] Kjo formë e testamentit nuk është aplikuar në Kosovë, deri në vitin 2012, sepse deri në këtë kohë në Kosovë nuk ka qenë i funksionalizuar shërbimi noterial.[470]

3.3.1.1. Testamenti i shkruar nga vetë testatori (ollograf)

Testamentin ollograf LTK, e rregullon në nenin 74, në të cilin parashikohet kësisoj: *"*Testamenti është i vlefshëm në qoftë se testatori e ka shkruar atë, datuar dhe nënshkruar me dorën e vet ose ka vënë gishtin e vet.Data e testamentit duhet të tregojë ditën, muajin dhe vitin. Nënshkrimi duhet të përmbajë mbiemrin e testatorit si dhe të paktën njërin prej emrave të tij dhe duhet vënë në fund të testamentit". Pra, për vlefshmërinë e testatmentit ollograf LTK, kërkon detyrimisht të plotësohen këto kushte: a) të shkruhet në tërësi prej fillimit e deri në mbarim nga trashëgimlënësi (testatori); b) të shënohet data e hartimit të testamentit; dhe c) të nënshkruhet personalisht nga trashëgimlënësi (testatori). LTK, lejon gjithashtu mundësinë që testamenti

[467] A. Gams (1986), Hyrje në të Drejtën Civile (Pjesa XII. E Drejta e Trashëgimit), Prishtinë. Fq.372.
[468] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 74 ,75 dhe76.
[469] Ligji Nr.03/L-010 për Noterinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III/ Nr.42/25 Nëntor 2008). Shih 40 par.1.pika 1.1.
[470] E.Osmanaj (2017) Regulation of testament presence of witnesses and noterial testament according to the law of Kosovo comparing whith the law of EU countries.International Journal of Scientific & Engineering Research.Volume 8 Issue 1, January-2017.Issn 2229-5518 Fq.511.

ollograf të konsiderohet i vlefshëm edhe nëse testatori nuk e ka nënshkruar atë, por vetëm e ka vënë gishtin në të. Për vlefshmërinë e testamentit nuk është më rëndësi gjuha në të cilin testatori e ka shkruar testamentin.Testatori mund ta hartojë testamentin në cilindo gjuhe të cilen e kupton, nuk është më rëndësi nëse testamenti shkruhet në gjuhen amtare apo në ndonjë gjuhe tjetër të huaj.[471]Pra,e rëndësishme është që testatori ta këtë kuptuar gjuhen në të cilen e ka shkruar testamentin.Gjithashtu,për vlefshmërinë e testamentit nuk është më rëndësi as lloji i mjetit më të cilin testatori e shkruan testamentin gjegjësisht testamenti mund të shkruhet më laps, ngjyrë apo më ndonjë mjet tjetër të ngjajshme.[472]Sipas rregullit të sanksionuar në LTK, nënshkrimi në testament duhet të vihet në fund të testamentit dhe duhet të përmbajë mbiemrin e testatorit si dhe të paktën njërin prej emrave të tij. Ndërsa, në jurispodencën evropiane ekziston mendimi se për vlefshmërinë e testamentit, nuk është e domosdoshme që nënshkrimi të vendoset në fund të testamentit. Por, më rëndësi është që nënshkrimi t'i përkasë testatorit, pavarësisht se ku është vendosur.[473]Përveç,se për vlefshmërine e testamentit ollograf kërkohet domosdo që ai të shkruhet në tërësi nga testatori dhe të nënshkruhet nga testatori, për vlefshmërinë e tij kërkohet të respektohet detyrimisht edhe rregulla e vendosjes së datës. Në legjislacionet e disa shteteve për vlefshmërinë e testamentit ollograf nuk kërkohet domosdoshmërisht të respektohet kushti i vënies së datës në testament, si p.sh., në Austri[474], Gjermani[475], Poloni,[476]Lituani[477] etj. Vënia e datës në testament konsiderohet të jetë e rëndësishme për shumë arsye. Fillimisht, vënia e datës mundëson që të vërtetohet nëse testatori në kohën e hartimit të testamentit ka qenë i aftë në aspektin mendor, sepse mund të ndodhë që testatori në kohën kur e ka hartuar testamentin ka qenë i shëndoshë mendërisht, por më vonë është sëmurë ose e kundërta. Mandej, në rastet kur testatori ka hartuar më shumë së një testament, data e vendosur në testament ndihmon të vërtetohet se cili testament është vullneti i fundit i testatorit.[478]Më LTK, nuk parashikohet, por dihet se formën e testamentit ollograf mund ta bëjnë vetëm personat që dine të lexojnë dhe shkruajnë. Për shembull, KCSH në nenin 394 shprehimisht parasheh se testatori duhet të dijë të shkruajë dhe të lexojë. Sipas LTK, testamenti ollograf mund të dorëzohet për ruajtje në

[471] H. Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore. Prishtinë. Fq. 131-132.
[472] Po aty. Fq. 132.
[473] Shih A.Jashari & E.Osmanaj (2016). Type of Testaments in Albania and France, Europian Journal of Humanities and Social Sciences No2, *East West, Association for Advanced Studies and Higher Education GmbH*, Vienna.Fq.72 (Cituar J. Latifi & R. Ruçi Llojshmëria e testamenteve në legjislacionet botërore, Revista "Avokatia"12, Nëntor 2014).
[474] Kodi i Përgjithshëm Civil i Austrisë, shih nenin 578.
[475] Kodi Civil i Gjermanisë, shih nenin 2247 par.5.
[476] Kodi Civil i Polonisë, shih nenin 949 par.2.
[477] Kodi Civil i Lituanisë, shih nenin 5.30.
[478] H. Podvorica (2010). Vepra e cituar më sipër. Fq.132.

gjykatë.Në rastin e pranimit të testamentit për ruajtje, gjykata ka për detyrë të mbajë një procesverbal, kurse testamentin e pranuar për ruajtje duhet ta vendosë në një zarf të veçantë të vulosur.[479]

3.3.1.2. Testamenti i shkruar në praninë e dëshmitarëve (alografik)

Ky lloj testamenti ka qenë i njohur që në të drejtën romake si testamentum allographum. LTK, e rregullon këtë formë të testamentit në nenin 75, ku përcaktohet: "Testatori që di të shkruajë e të lexojë mund të bëjë testamentin duke nënshkruar me dorë dokumentin pa marrë parasysh kush e ka përpiluar, në praninë e dy dëshmitarëve që e kuptojnë gjuhën e testamentit, duke deklaruar para tyre se testamenti është i tij. Dëshmitarët nënshkruhen në vetë testamentin dhe është e dobishme të shënohet cilësia e tyre si dëshmitarë." Nga ky formulim ligjore rezulton se për vlefshmërinë e testamentit alografik, kërkohet domosdo të plotësohen tri kushte. Kushti i parë, kërkon që testatori të dijë të lexojë dhe të shkruajë. Kushti i dytë, kërkon që testatori ta nënshkruajë më dorën e vetë testamentin. Dhe sipas kushtit të tretë, kërkohet që testatori të deklarojë së testamenti është i tij në praninë e dy dëshmitarëve, të cilët e kuptojnë gjuhen e testamentit.[480].Pra,të kjo formë e testamentit, prania e dëshimtarëve është e detyrueshme, për arsye se ata në mënyrë të drejtpërdrejtë vërtetojnë se testatori e ka nënshkruar testamentin gjegjësisht që e ka pranuar përmbajtjen e testamentit.[481] Në legjislacionet e të gjitha shteteve të UE-së, në të cilat njihet forma e testamentit alografik,si p.sh., në Danimark[482], Suedi[483], Qipro[484], Republikën Çeke[485], Slovaki[486], Slloveni[487], Kroaci[488] etj.,parashihet që kjo formë e testamentit duhet të bëhet në praninë e dy dëshmitarëve, të cilët duhet edhe të nënshkruhen në testament. Më përjashtim të legjislacionit austriak, i cili parasheh së forma e testamentit alografik duhet të bëhet në praninë e tre dëshmitarëve, si dhe legjislacionit skocez, sipas të cilit testamenti alografik bëhet në praninë e vetëm një dëshmitari. Në të drejtën romake testamenti alografik kërkohej të bëhet në praninë e shtatë dëshmitarëve.[489] Sipas LTK, personat të cilët dëshmojnë në testament

[479] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 78.
[480] Shih E.Osmanaj (2017) Regulation of testament presence of witnesses and noterial testament according to the law of Kosovo comparing whith the law of EU countries.International Journal of Scientific & Engineering Research.Volume 8 Issue 1, January-2017.Issn 2229-5518 Fq.512.
[481] O. Tmava (2006). Dëshmitarët e Testamentit. Buletini i Instituit Gjyqësor të Kosovës (IGJK). Fq. 3.
[482] Ligji për Trashëgimi i Danimarkës, shih nenin 64.
[483] Kodi i Trashëgimisë i Suedisë (*Inheritance Code* in Sëedish). Shih nenin 1 dhe 2, kapitulli 10.
[484] Ligji për testamentet dhe trashëgimine i Qipros, shih nenin 23.
[485] Kodi Civil i Republikës Çeke, shih nenin 1534 par.2.
[486] Kodi Civil i Sllovakisë, shih nenin 476 b.
[487] Ligji për Trashëgiminë i Slovenisë, shih nenin 64.
[488] Ligji për Trashëgiminë i Kroacisë, shih nenin 31.
[489] A. Mandro. (2006). E Drejta Romake. Tirane. Fq. 436.

duhet t'i posedojnë disa cilësi të caktuara.Së pari, duhet që personat që dëshmojnë të jenë të moshës madhore (mbi 18 vjeç). Së dyti,duhet që këta persona të kenë zotësi për të vepruar dhe duhet të dinë të shkruajnë dhe të lexojnë. LTK, nga cilësia e të qenit dëshmitar të hartimit të testamentit i përjashton këta persona: "pasardhësit e testatorit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, parardhësit e tij, prindërit e tij adoptues, personat e tij në gjini në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt dhe bashkëshortët e të gjithë këtyre personave si dhe bashkëshorti i testatorit."[490]Duhet theksuar që edhe testamenti alografik, mund të dorëzohet për ruajtje në gjykatë. Procedura për dorëzimin e testamentit alografik për ruajtje në gjykatë, zhvillohet sipas rregullave të njëjta, si në rastin e dorëzimit të testamentit ollograf.[491]

3.3.1.3. Testamenti gjyqësor

Testamenti gjyqësor është lloj i testamentit publik, i cili hartohet nga gjyqtari sipas tregimit të vullnetit të fundit të trashëgimlënësit. Ky testament për herë të parë është paraqit në Romë në kohën e prinicipatave, ndërsa më vonë u aplikua pothuajse në të gjitha shtetet evropiane.[492] Sot kjo formë e testamentit njihet në një numër të vogël të shteteve, prej shteteve të UE-së, këtë formë të testamentit e njohin vetëm Kroacia[493], Sllovenia[494] dhe Latvia.[495]Në shumicën e legjislacioneve evropiane, sot forma e testamentit gjyqësor është zëvendësuar më formën e testamentit noterial. LTK, rregullon dy forma të testamentit gjyqësor:

a) Testamentin gjyqësor të cilin testatori është në gjendje ta lexojë; dhe

b) Testamentin gjyqësor të cilin testatori nuk është në gjendje ta lexojë.

Dallimi midis këtyre dy formave të testamenteve, qëndron në atë se në rastin e hartimit të testamentit të cilin testatori nuk është në gjendje ta lexojë, hartimi i testamentit bëhet në praninë e dy dëshmitarëve, të cilët duhet edhe të nënshkruhen në testament. Ndërsa, në rastin e hartimit të testamentit gjyqësor të cilin testatori është në gjendje ta lexojë, nuk është e nevojshme prania e dëshmitarëve.[496] Pra, prania e dëshmitarëve në rastin e hartimit të testamentit gjyqësor kushtëzohet më faktin nëse testatori din ose jo që të lexojë.

[490] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 79.
[491] Po aty, shih nenin 78.
[492] H. Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore. Prishtinë. Fq. 134.
[493] Ligji për Trashëgiminë i Kroacisë, shih nenin 32.
[494] Ligji për Trashëgiminë i Slovenisë, shih nenin 65.
[495] Kodi Civil i Latvisë, shih nenin 434.
[496] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 77 dhe 76.

3.3.1.4. Procedura e bërjës së testamentit gjyqësor

Procedura për bërjen e testamentit gjyqësor rregullohet nga LTK,dhe Ligji për Procedurën Jokontestimore (tani e tutje LPJK). Për hartimin e testamentit gjyqësor kompetente në pikëpamje territoriale konsiderohet Gjykata Themelore më kompetencë lëndore, në territorin e të cilës testatori ka vendbanimin.[497] Sipas rregullit të sanksionuar në LPJK, testamenti gjyqësor hartohet në gjykatë ose jashtë ndërtesës së gjykatës, kur testatori nuk është në gjendje të shkoje në gjykatë apo kur për këtë ekzistojnë shkaqe të justifikueshme.[498] Përkatësisht testamenti gjyqësor lejohet që të hartohet jashtë gjykatës,në rastin kur testatori nuk është në gjendje të shkoj në gjykatë për shkaqe shëndetësore p.sh., ndodhet në spital. Në rastin e bërjes së testamentit gjyqësor,më ligj kërkohet detyrimisht të kryhen disa veprime paraprake nga gjyqtari, para që ai të fillojë hartimin e testamentit. Së pari,gjyqtari duhet të vërtetojë identitetin e testatorit. Së dyti, kërkohet që gjyqtari të vërtetojë nëse testatori ka zotësi për të hartuar testament dhe nëse hartimi i testamentit është vullnet i lirë i tij. Dhe së treti, gjyqtari ka për detyrë ta njoftojë testatorin për rëndësinë e veprimit të tij dhe pasojat juridike qe dalin nga kryerja e një veprimi të tillë. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, vazhdimi i mëtejmë i procedurës varet nga ajo nëse testatori dinë të lexojë testamentin e hartuar nga gjyqtari ose jo. Në rastin kur testatori dinë të lexojë testamentin, ai deklaratën për përmbajtjen e testamentit e jep vetëm para gjyqtarit, që do të thotë nuk është e nevojshme prania e dëshmitarëve. Në këtë rast gjyqtari nuk është i obliguar që t'ia lexojë testamentin testatorit. Përkatësisht në këtë rast, gjyqtari pasi ta formulojë përmbajtjen e testamentit, kërkon nga testatori që ai vetë ta lexojë dhe ta nënshkruajë testamentin. Gjyqtari duhet domosdo ta theksojë në vetë testamentin, se testatori e ka lexuar dhe e ka nënshkruar atë në praninë e tij.[499] Ndërsa, në rastin kur testatori nuk është në gjendje të lexojë testamentin që ia ka hartuar gjyqtari, gjyqtari është i detyruar që t'ia lexojë testamentin testatorit në praninë e dy dëshmitarëve. Kurse, testatori është i detyruar që në praninë e po këtyre dëshmitarëve të nënshkruajë testamentin ose të vë në të shenjën e gishtit të vet, pasi të deklarojë se ky është testamenti i tij. Dëshmitarët, gjithashtu,duhet të nënshkruhen në testament.[500] Çeshtjen se kush mund të jetë dëshmitar në rastin e hartimit të testamentit gjyqësor, e rregullojnë si LTK ashtu dhe LPJK. Sipas LPJK nga cilësia e të qenit dëshmitar në rastin e hartimit të testamentit gjyqësor

[497] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 224.
[498] Po aty, shih nenin 225.
[499] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 76.
[500] Po aty, shih nenin 77.

përjashtohen: "pasardhësit e testatorit; të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, paraardhësit e tij, duke i përfshire gjyshin dhe gjyshen e tij dhe pasardhësit e tyre të shkallës së pare, kushërinjtë e tyre në vijë të tërthortë deri në shkallë të tretë, bashkëshortët e të gjithë këtyre personave si dhe bashkëshorti i testatorit".[501]Ngjajshëm përcaktohet edhe më LTK, përveç asaj që LTK përjashton edhe gjyqtarin si dëshmitar, që mund të kuptohet si harresë e LPJK, si dhe LTK përjashton mundësinë që të jenë dëshmitar personat në gjini në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt.[502] Gjatë hartimit të testamentit gjyqësor, gjyqtari ka për detyrë të mbajë procesverbal, në të cilin duhet të shënohen të gjitha veprimet e kryera. Përkatësisht, në procesverbal gjyqtari ka për detyrë të shënojë çdo rrethanë që është më rëndësi për vlefshmërinë e testamentit. Deklaratën e testatorit për përmbajtjen e testamentit, gjyqtari ka për detyrë që ta shënojë në mënyrë sa më besnikë në procesverbal, duke pasur kujdes që vullneti i testatorit të shprehet në mënyrë sa më të qartë.[503]Procesverbali duhet të nënshkruhet nga testatori,dëshmitarët dhe gjyqtari.[504]Në rastin kur procesverbali përbëhet prej disa faqeve, faqet duhet të përshkohen me pe dhe të dy skajet e perit duhet të vulosen me vulën e gjykatës. Secilën faqe të procesverbalit, testatori duhet ta nënshkruajë veç e veç ose do të ve shenjën e gishtit. Në fund të procesverbalit duhet të theksohet se prej sa faqeve përbëhet testamenti.[505]Më ligj rregullohet edhe situata se si veprohet kur testamenti, hartohet nga gjykata që nuk ka qenë kompente për një gjë të tillë gjegjësisht nga gjykata në territorin e të cilës nuk ndodhet vendbanimi i testatorit. Në këtë rast, sipas zgjidhjes që parashihet në LPJK, gjykata e cila nuk ka qenë kompetente që të hartojë testamentin, ka për detyrë ta njoftojë menjëherë për këtë gjykatën kompetente gjegjësisht gjykatën në territorin e të cilës ndodhet vendbanimi i testatorit.[506]

[501] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 233.
[502] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 79.
[503] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 234.
[504] Po aty, shih nenin 232.
[505] Po aty, shih nenin 237.
[506] Po aty, shih nenin 238.

3.3.1.5. Testamenti noterial

LTK, nuk e rregullon formën e testamentit noterial, mundësinë e bërjës së testamentit noterial, e parasheh Ligji për Noterinë i Republikës së Kosovës (tujtje si LNK). Në LNK, nuk gjenden rregulla konkrete për testamentin noterial, më përjashtim të nenit 40 par.1 pika 1.1 në të cilin shprehimisht sanksionohet rregulla, sipas të cilës gjatë përgatitjes së testamentit noterial detyrimisht duhet të marrin pjesë dy dëshmitarë. Sipas LNK, dëshmitarët duhet të jenë të pranishëm, të paktën në kohën e leximit të testamentit nga noteri dhe më rastin e nënshkrimit të testamentit.Dëshmitarët gjithashtu duhet të nënshkruhen në testament.[507] Duke ju referuar LNK, konkretisht dispozitës ku flitet për elementët të cilat duhet t'i përmbajë një akt noterial, por dhe në analogji më legjislacionet e tjera, rezulton që testamenti noterial duhet të përmbajë:

1. vitin, muajin, ditën, vendin dhe nëse kërkohet me ligj apo nga testatori kohën kur është hartuar akti, dhe të gjitha këto duhet të përmenden me shkronja;
2. emrin dhe mbiemrin si dhe selinë e Noterit që ka hartuar testamentin;
3. emrin, mbiemrin, vendin dhe datën e lindjes, adresën e vendbanimit të përhershëm apo të përkohshëm si dhe profesionin e testatorit, dëshmitarët dhe përkthyesit që kanë marrë pjesë në përgatitjen e testamentit;
4. deklaratën nga Noteri lidhur me bindjen e tij apo saj rreth identitetit të testatorit;
5. përshkrimin e hollësishëm të disponimeve testamentare;
6. kur lëndë e disponimeve testamentare është prona e paluajtshme, vendi ku gjendet prona e tillë, referimi në planin kadastral dhe numrin kadastral, si dhe definimi i kufijve të pronës së tillë;
7. përshkrimi i dokumenteve që i janë bashkëngjitur testamentit;
8. deklaratën mbi faktin që testamenti dhe dokumentet e përfshira me të janë lexuar në prani të testatorit, apo që procedurat e përshkuara më ligj për sa u përket pjesëmarrësve të shurdhër apo analfabetë, apo pjesëmarrësve që nuk flasin apo kuptojnë gjuhën zyrtare, janë respektuar.[508]
9. Nenshkrimin e testatorit, nënshkrimin e dëshmitarëve dhe nënshkrimin dhe vulen e noterit.

[507] Ligji Nr.03/L-010 për Noterinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III/ Nr.42/25 Nëntor 2008). Shih nenin 40 par.5.
[508] Po aty, shih nenin 33.

Duke ju referuar LNK, gjegjësisht rregullave për veprimet e noterizuara në përgjithësi, procedura e hartimit të testamentit noterial shkon kësisoj: Së pari, noteri duhet të vërtetojë nëse testatori është i aftë për të bërë testament dhe nëse ekziston vullneti i vërtetë i tij për bërjën e testamentit. Më pas,noteri duhet ta njoftojë testatorin për rëndësinë dhe pasojat juridike të veprimit të tij dhe për ligjin e zbatueshëm. Së dyti, pasi noteri ta vërtetojë së testatori është i aftë të bëjë testament,se ekziston vullneti i lirë i tij dhe se disponimi më testament është i lejueshëm sipas ligjit, ai fillon përgatitjen e testamentit sipas tregimit të testatorit. Deklaratën e testatorit për përmbajtjen e testamentit, noteri duhet ta formulojë në mënyrë sa më të qartë dhe të kuptueshme.[509] Gjatë tërë procesit të përgatitjes së testamentit, noteri duhet të konstatojë se nuk ka konfuzion apo dyshime tek testatori rreth hartimit të testamentit dhe efekteve të tij juridike. Pasi ta hartojë testamentin, noteri duhet t'ia lexojë atë testatorit dhe duhet ta pyes nëse përmbajtja e testamentit është në pajtim në çdo aspekt më qëllimet e tij gjegjësisht më vullnetin e tij.[510] Dhe në fund, pasi të jetë hartuar testamenti origjinal dhe pasi të jetë lexuar dhe aprovuar përmbajtja e tij, testamenti nënshkruhet nga testatori, noteri dhe dëshmitarët e pranishëm, duke dëshmuar në këtë mënyrë që janë respektuar të gjitha kriteret për vlefshmërinë e testamentit.[511] Nga kjo që u tha më lartë rezulton se për vlefshmërinë e testamentit noterial kërkohet të plotësohen detyrimisht këto kushte: a) të hartohet nga noteri; b) testatori të vë nënshkrimin dhe c) prania e dy dëshmitarëve. Pra, testamenti noterial quhet testamenti i cili hartohet nga noteri dhe nënshkruhet nga testatori në praninë e dy dëshmitarëve. Duhet theksuar që në shumicën e legjislacioneve të shteteve të UE-së si p.sh., në Belgjikë, Poloni, R. Çeke, Maltë, Luksemburg, Bullgari, Latvi, Itali etj[512]., parashihet që testamenti noterial duhet të bëhet në praninë e një noteri dhe dy dëshmitarëve. Legjislacioni francez dhe austriak për vlefshmërinë e testamentit noterial, kërkojnë që ai të bëhet në praninë e dy notërve ose një noteri dhe dy dëshmitarëve[513]. Megjithatë, ka edhe legjislacione të cilat për vlefshmërinë e testamentit noterial nuk e shohin të nevojshme praninë e dëshmitarëve në rastin e bërjës së tij, siç p.sh., Kodi Civil Gjerman, Kodi Civil i Hungarisë, Ligji për Trashëgimi i Danimarkës etj.[514]

[509] Ligji Nr.03/L-010 për Noterinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III/ Nr.42/25 Nëntor 2008). Shih nenin 36 par.1.
[510] Po aty, shih nenin 36 par.2 dhe 3.
[511] Po aty, shih nenin 36 par.5.
[512] Shih Kodi Civil i Belgjikës (neni 971); Kodi Civil i Republikës Çeke (neni 1534); Ligji për Trashëgimi i Bullgarisë (neni 24); Kodi Civil i Latvisë (neni 434); Kodi Civil i Luksemburgut (neni 969); Kodi Civil i Italisë (neni 603); Kodi Civil i Maltës (neni 655); Kodi Civil i Polonisë (neni 950).
[513] Shih Kodi i Përgjithshëm Civil i Austrisë (neni 583) dhe Kodi Civil i Francës (neni 971).
[514] Kodi Civil i Gjermanisë (neni 2232); Kodi Civil i Hungarisë (neni 7:14); Ligji për Trashëgimi i Danimarkës (neni 63).

3.3.2. Testamentet e jashtëzakonshme

Më LTK,si lloj i testamentit të jashtëzakonshëm njihet vetëm forma e testamentit më gojë.

3.3.2.1 Testamenti më gojë

Sipas LTK, testatorit i lejohet që të deklarojë vullnetin e tij të fundit me gojë në prani të dy dëshmitarëve, vetëm në qoftë se nga shkaku i rrethanave të jashtëzakonshme nuk është në gjendje të bëjë testamentin në formën me shkrim.[515] Pra, për vlefshmërinë e testamentit më gojë kërkohet detyrimisht të plotësohen dy kushte: a) ekzistimi i rrethanës së jashtëzakonshme dhe b) prania e dy dëshmitarëve. Më LTK, nuk përcaktohet se çka nënkuptohet më rrethana të jashtëzakonshme. Pra,më ligj nuk specifikohen së cilat ngjarje konsiderohen rrethana të jashtëzakonshme, në ekzistimin e të cilave testatorit i lejohet të bëjë testamentin më gojë. Në teorinë juridike më rrethana të jashtëzakonshme nënkuptohen rrethanat e përgjithshme të cilat nuk janë të varura nga njeriu, në paraqitjen e të cilave nuk mund të këtë ndikim njeriu. Rrethana të tilla konsiderohen: tërmeti, vërshima, epidemia, aksidentat e rënda në komunikacion etj. Rrethana e jashtëzakonshme gjithashtu merret së ekziston edhe në rastin kur testatori sëmuret rëndë dhe gjendja e tij shëndetësore nuk pritet të përmirësohet.[516] Sipas rregullit të sanksionuar në LTK, dëshmitarë në rastin e bërjës së testamentit më gojë mund të jenë vetëm ata persona që mund të jenë dëshmitarë kur bëhet testamenti gjyqësor,por për dallim nga testamenti gjyqësor, dëshmitarët tek testamenti më gojë nuk kërkohet domosdo të dinë të shkruajnë e të lexojnë.[517] Pra,dëshmitarë në rastin e bërjës së testamentit më gojë mund të jenë personat madhorë, të cilëve nuk u është hequr zotësia për të vepruar dhe që e kuptojnë gjuhën e testamentit. Ndërkaq, nga cilësia e të qenit dëshmitarë të testamentit gojor, sikurse të format e rregullta të testamentit, edhe tek testamenti gojor përjashtohen personat me cilësinë e gjyqtarit, pasardhësit e testatorit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, parardhësit e tij, prindërit e tij adoptues, personat e tij në gjini ne vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, bashkëshortët e të gjithë këtyre personave dhe bashkëshorti i testatorit.[518] Në qoftë se nga testamenti i bërë më gojë u lihet diçka dëshmitarëve që kanë marrë pjesë në e hartimin e tij, bashkëshortëve të tyre, pasardhësve të tyre,personave në

[515] Ligji Nr.2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 81.
[516] H. Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore. Prishtinë. Fq. 139.
[517] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 82.
[518] Po aty. Shih nenin 79 par.2.

gjini gjaku të tyre në vijë të tërthortë, gjer në shkallën e katërt dhe të bashkëshortëve të të gjithë këtyre personave, testamenti do të konsiderohet i pavlefshëm.[519] Sipas LTK, dëshmitarët pjesëmarrës të testamentit më gojë, deklaratën e testatorit për përmbajtjen e testamentit kanë për detyrë ta përpilojnë më shkrim dhe ta dorëzojnë atë sa më parë në gjykatë, ose ta përsërisin me gojë para gjykatës, duke treguar kohën, vendin dhe rrethanat në të cilat testatori e ka deklaruar vullnetin e tij të fundit. Përkatësisht, sipas LTK, testamenti me gojë bëhet i pavlefshëm nëse nuk deklarohet në gjykatë nga dëshmitarët 30 ditë pas pushimit të rrethanave të jashtëzakonshme në të cilat ai është bërë.[520] Pra,efektet juridike të testamentit më gojë mbarojnë më pushimin e rrethanës së jashtëzakonshme. Në legjislacione të ndryshme afati i vlefshmërisë së testamentit të jashtëzakoshëm varion zakonisht nga 3 deri në 6 muaj. P.sh., në Gjermani, Austri, Suedi, Finlande, Danimark dhe Latvi, testamenti më gojë vlenë deri në tre (3) muaj, në Poloni testamenti më gojë vlen deri në 6 muaj.[521]

[519] Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006). Shih nenin 84.
[520] Po aty, shih nenin 83.
[521] Shih Kodi Civil Gjerman (neni 2252); Kodi i Përgjithshëm Civil i Austrisë (neni 584); Kodi i Trashëgimisë i Suedisë (neni 3 kapitulli 10); Kodi i Trashëgimise i Finlandes (seksioni 3 kapitulli 10); Ligji për Trashëgimi i Danimarkës (neni 65); Kodi Civil i Latvisë (neni 461); Kodi Civil i Polonisë (neni 952 par.2).

Tabela 9: Format e testamenteve të rregullta në shtetet e UE-së

Format e testamenteve të rregullta	
Austri	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf. Testamenti alografik.[522]
Belgjikë	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf. Testamenti ndërkombëtar.[523]
Bullgari	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf.[524]
Danimarkë	Testamenti publik (noterial). Testamenti alografik.[525]
Estoni	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf. Testamenti alografik.[526]
Francë	Testamenti publik (noterial). Testamenti sekret. Testamenti ollograf.[527]
Finlandë	Testamenti ollograf. Testamenti alografikik.[528]
Greqi	Testamenti ollograf. Testamenti publik (noterial). Testamenti sekret.[529]
Gjermani	Testamenti publik (noterial).Testamenti ollograf.Testamenti kontrate (reciprok).[530]
Holandë	Testamenti alografikik. Testamenti ollograf.[531]
Hungari	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf. Testamenti alografik. Testamenti kontrate (reciprok).[532]
Irlandë	Testamenti alografik.[533]
Itali	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf. Testamenti sekret.[534]
Kroaci	Testamenti ollograf.Testamenti alografikik.Testamenti publik (noterial ose gjyqësor).[535]
Latvi	Testamenti publik (noteria, gjyqësor apo diplomatik). Testamenti ollograf. Testamenti alografik.[536]
Lituani	Testamenti publik (noterial, diplomatik). Testamenti ollograf.[537]
Luksemburg	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf. Testamenti sekret.[538]
Maltë	Testamenti publik (noterial). Testamenti sekret.[539]
Poloni	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf.[540]
Portugali	Testamenti publik (noterial). Testamenti sekret. Testamenti ndërkombëtar.[541]

[522] Kodi i Përgjithshëm Civil i Austrisë, shih nenet 578, 579 dhe 583.
[523] Kodi Civil i Belgjikës, shih nenin 969.
[524] Ligji për Trashëgimi i Bullgarisë (Nr.47/23 qershor 2009). Shih nenet 24-25.
[525] Ligji për Trashëgimi i Danimarkës, shih nenin 63 dhe 64.
[526] Ligji për Trashëgimi i Estonisë, shih nenet prej 20 deri 24.
[527] Kodi Civil i Francës, shih nenin 669.
[528] Kodi i Trashëgimise i Finlandes, shih nenin kapitullin X seksioni 1.
[529] Kodi Civil i Greqisë, shih nenet 1721, 1724 dhe 1738.
[530] Kodi Civil i Gjermanisë, shih nenin 2231.
[531] Kodi Civil i Holandës, shih seksionin 4.4.4 nenin 4:94.
[532] Kodi Civil i Hungarisë, shih seksionin 07:13, 07:17 (1) (a), 07:17 (1) (b) dhe 07:23.
[533] Ligji për Trashëgimi i Irelandës. (Succession Act, 1965. Number 27 of 1965). Shih nenin 79.
[534] Kodi Civil i Italisë, shih nenet 601, 602 dhe 603.
[535] Ligji për Trashëgiminë i Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Kroacisë 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15), shih nenin 31, 32 dhe 33.
[536] Kodi Civil i Latvisë, shih nenet 433, 434, 445, 446 dhe 451.
[537] Kodi Civil i Lituanisë, shih nenet 5.28 dhe 5.30.
[538] Kodi Civil i Luksemburgut, shih nenin 969
[539] Kodi Civil i Maltës, shih nenet 654, 655 dhe 656.
[540] Kodi Civil i Polonisë, shih nenet 949 dhe 950.
[541] Kodi Civil i Portugalisë, shih nenet 2204 dhe 2223.

Qipro	Testamenti alografik.[542]
R. Çeke	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf. Testamenti alografik. Testamenti sekret. [543]
Rumani	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf.[544]
Slovaki	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf. Testamenti alografik.[545]
Slloveni	Testamenti gjyqësor.Testamenti diplomatik. Testamenti ollograf. Testamenti alografik. Testamenti ndërkombëtar.[546]
Spanjë	Testamenti publik (noterial). Testamenti ollograf. Testamenti sekret. [547]
Suedi	Testamenti alografik.[548]

[542] Ligji për testamentet dhe trashëgimine i Qipros, shih nenin 23.
[543] Kodi Civil i Republikës Çeke, shih nenet 1533 deri 1341.
[544] Kodi Civil i Rumanisë, shih nenin 1040.
[545] Kodi Civil i Sllovakisë, shih nenin 476 a., 476 b., dhe 476 d.
[546] Ligji për Trashëgiminë i Slovenisë (Gazeta Zyrtare e Slovenisë Nr 15/76, 23/78; 17/91, 13/94, 40/94, 117/00, 67/01, 83/01, 31/13 dhe 63/16). Shih nenet 63, 64, 65, 69 dhe 71.a.
[547] Kodi Civil i Spanjës, shih nenet 688, 694, 706.
[548] Kodi i Trashëgimisë i Suedisë (Inheritance Code in Swedish). Shih nenin 1 dhe 2, kapitulli 10.

3.4. Format e testamentit në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri

3.4.1. Testamentet e rregullta

Më LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe KCSH,rregullohen forma të ndryshme të testamenteve të rregullta, të cilat janë paraqitur në formën tabelare si më poshtë.

Tabela 10: Format e testamenteve të rregullta në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri

Shteti	Testamentet e rregullta
Maqedoni	1. Testamenti i shkruar më dorë (ollograf). 2. Testamenti gjyqësor. 3. Testamenti noterial. 4. Testamenti ndërkombëtar. 5. Testamenti konsular-diplomatik.
Serbi	1. Testamenti i shkruar më dorë (ollograf). 2. Testamenti në praninë e dëshmitarëve (alografik). 3. Testamentin gjyqësor. 4. Testamenti noterial. 5. Testamentin ndërkombëtar. 6. Testamentin konsular-diplomatik.
Shqipëri	1. Testamenti i shkruar më dorë (ollograf). 2. Testamenti noterial.
Slloveni	1. Testamenti i shkruar më dorë (ollograf). 2. Testamenti në praninë e dëshmitarëve (alografik). 3. Testamenti gjyqësor. 4. Testamenti noterial. 5. Testamenti ndërkombëtar. 6. Testamentin konsular-diplomatik.
Kroaci	1. Testamenti i shkruar më dorë (ollograf). 2. Testamenti në praninë e dëshmitarëve (alografik). 3. Testamenti gjyqësor. 4. Testamenti noterial. 5. Testamenti konsular-diplomatik.
Bosnjë dhe Hercegovinë	1. Testamenti i shkruar më dorë (ollograf). 2. Testamenti në praninë e dëshmitarëve (alografik). 3. Testamenti gjyqësor.

	4. Testamenti noterial. 5. Testamenti konsular-diplomatik. 6. Testamenti ndërkombëtar.
Mal të Zi	1. Testamenti i shkruar më dorë (ollograf). 2. Testamenti në praninë e dëshmitarëve (alografik). 3. Testamenti gjyqësor. 4. Testamenti noterial. 5. Testamenti konsular-diplomatik. 6. Testamenti ndërkombëtar.

3.4.1.1. Testamenti i shkruar më dorë (ollograf)

Në ligjet e shteteve të marra në analize (më përjashtim të KCSH) përkatësisht në LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH, LTME, testamenti ollograf përkufizohet në këtë mënyrë: "Testamenti është i plotëfuqishëm në qoftë se testatori e ka shkruar atë më dorën e vet dhe e ka nënshkruar. Për plotëfuqishmërinë e testamentit të shkruar më dorë nuk është e domosdoshme, por është në interes të shënohet data e përpilimit të testamentit."[549] Nga ky formulim ligjor, rezulton që për vlefshmërinë e testamentit ollograf, duhet të përmbushen dy kushte: a) të jetë shkruar nga vetë testatori dhe b) të jetë nënshkruar nga testatori. Ndërkaq, në KCSH testamenti ollograf përkufizohet kësisoj: "Testamenti ollograf shkruhet tërësisht me dorën e testatorit duke vënë datën dhe nënshkrimin e vet.Data e testamentit duhet të tregojë ditën, muajin dhe vitin. Nënshkrimi vihet në fund të disponimeve."[550] Pra, ndryshe nga ligjet e cituara më sipër, sipas KCSH, për vlefshmërinë e tesatmentit ollograf, testatori është i obliguar të vë datën e hartimit të testamentit. Megjithatë, në doktrinën juridike shqiptare, ekziston pikëpamja sipas të cilës jo në çdo rast, mungesa e datës në testament, e bënë të pavlefshëm testamentin ollograf. Përkatësisht sipas kësaj pikëpamje, rastet kur testamenti ollograf konsiderohet i vlefshëm edhe kur i mungon data janë: a) kur testamenti ollograf është vërtetuar apo regjistruar në ndonjë institucion shtetëror, në këtë rast dita e vërtetimit gjegjësisht regjistrimit do të konsiderohet si datë e hartimit të testamentit; b) kur personi që ka hartuar testamentin ollograf gjegjësisht testatori ka vdekur, dita e vdekjes se tij do të konsiderohet si datë e hartimit të testamentit; c) kur testatori që ka hartuar testamentin ollograf, nuk është me në gjendje për të shkruar, si datë e hartimit të testamentit merret dita në të cilen testatorit i është pamundësuar që të shkruaj;[551] d) kur

[549] Shih LTMK (neni 66); LTRS (neni 84); LTSI (neni 63); LTHR (neni 30); LTBH (neni 66); LTME (neni 66).
[550] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013). Shih nenin 393.
[551] A. Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë, Tiranë. Fq. 75.

përmbajtja e testamentit është përsëritur në një akt tjetër zyrtar, data e këtij akti zyrtar do të konsiderohet si datë e hartimit të testamentit; si dhe e) kur është vërtetuar një fakt tjetër i cili provon se testamenti është bërë në një datë të mëparshme, dita e vërtetimit të këtij fakti do të konsiderohet si datë e hartimit të testamentit.[552]Pra, sipas rregullës së kësaj pikëpamje,testamenti ollograf konsiderohet i vlefshëm edhe në qoftë nuk e përmbanë datën e hartimit, po që se data e hartimit të testamentit, mund të provohet në mënyrë të saktë nga ndonjë fakt i mëvonshëm.

3.4.1.2. Testamenti më shkrim në prani të dëshmitarëve (alografik)

Kjo formë e testamentit nuk gjen rregullim në LTMK dhe KCSH.Përcaktimi që jepet për testamentin alografik në LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME është: "Trashëgimlënësi që të di të lexojë dhe të shkruajë mund të hartojë testamentin, duke nënshkruar me dorë dokumentin pa marrë parasysh kush e ka përpiluar atë, në praninë e dy dëshmitarëve, duke deklaruar para tyre se testamenti është i tij."[553] Pra, për vlefshmërinë e kësaj formë të testamentit, ligjet e cituara më sipër, parashikojnë që duhet të përmbushen tre kushte: a) testatori të dijë të lexojë dhe të shkruajë; b) të jetë nënshkruar testamenti nga testatori; dhe c) prania e dy dëshmitarëve. Nga kjo rezulton, pra, se testamenti alografik është lloj i testamentit të cilin në favor të testatorit, e harton një person i tretë, kurse testatori është i obliguar që në prani të dy dëshmitarëve ta nënshkruajë atë. Më LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME, parashikohet që dëshmitarët në rastin e bërjës së testamentit duhet t'i plotësojë këto kushte: të jenë të moshës madhore dhe të kenë zotësi për të vepruar, të dinë të lexojnë dhe shkruajnë, të kuptojnë gjuhën në të cilën hartohet testamenti si dhe të mos jenë në lidhje gjaku apo familjare më testatorin. Përkatësisht,sipas ligjeve të cituara më sipër (më përjashtim të LTSI) nga cilësia e të qenit dëshmitarë të testamentit përjashtohen personat në afërsi gjaku më testatorin deri në shkallën e katërt, ndërkaq sipas LTSI personat në afërsi gjaku më testatorin deri në shkallën e tretë.[554]

[552] A. Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë, Tiranë. Fq. 76.
[553] Shih LTRS (neni 85); LTSI (neni 64); LTHR (neni 31); LTBH (neni 67) dhe LTME (neni 67).
[554] Po aty, shih LTRS (neni 113); LTSI (neni 67); LTHR (neni 35); LTBH (neni 72) dhe LTME (neni 68).

3.4.1.3. Testamenti gjyqësor

Kjo formë e testamentit (më përjashtim të KCSH) gjen rregullim në të gjitha ligjet e analizuara.Më ligjet e analizuara gjegjësisht më LTMK, LTRS, LTSI, LTHR, LTBH dhe LTME, kjo formë e testamentit parashikohet që mund të bëhet në dy raste, si kur testatori di të lexojë, ashtu dhe në rastin kur testatori nuk di të lexojë. Pra, më këto ligje rregullohen dy forma të testamentit gjyqësor: a) testamenti gjyqësor të cilin testatori di ta lexojë dhe b) testamenti gjyqësor të cilin testatori nuk di ta lexojë. Procedurën e bërjës së testamentit gjyqësor, si kur testatori di të lexojë ashtu dhe në rastin kur testatori nuk di të lexojë, ligjet e analizuara, e rregullojnë në mënyrë plotësisht të njëjtë. Kësisoj, sipas dispozitave të ligjeve të analizuara, në rastin kur testatori di të lexojë, testatori testamentin e hartuar nga gjyqtari e nënshkruan pasi ta këtë lexuar vetë testamentin dhe gjyqtari e shënon në vetë testamentin se testatori e ka lexuar dhe e ka nënshkruar atë në praninë e tij. Kurse, në rastin kur testatori nuk di të lexojë, gjyqtari i cili harton testamentin ia lexon atë testatorit në praninë e dy dëshmitarëve. Testatori pastaj në praninë e po këtyre dëshmitarëve e nënshkruan testamentin, ose e vë në të shenjën e gishtit të vet, pasi të deklarojë se ky është testamenti i tij.Dëshmitarët gjithashtu duhet ta nënshkruajnë testamentin.[555] Pra, në rastin e hartimit të testamentit gjyqësor të cilin testatori është në gjendje ta lexojë nuk kërkohet prania e dëshmitarëve, kurse në rastin e hartimit të testamentit gjyqësor të cilin testatori nuk është në gjendje ta lexojë kërkohet prania e dy dëshmitarëve, të cilët duhet edhe të nënshkruhen në testament. Dëshmitarët të kjo formë e testamentit duhet që t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme, si edhe dëshmitarët e testamentit alografik, pra duhet të jenë persona madhorë më zotësi veprimi, duhet ta kuptojnë gjuhën në të cilën hartohet testamenti, duhet të dinë të lexojnë dhe shkruajnë si dhe të mos jenë në lidhje gjaku më testatorin.

3.4.1.4. Testamenti noterial

Mundësia e bërjës së testamentit noterial, më përjashtim të LTMK dhe LTSI, parashihet në të gjitha ligjet e analizuara. Kështu,në LTHR[556] dhe LTME[557] parashikohet që testamentin noterial e harton noteri publik, sipas rregullave që aplikohen në rastin e hartimit të testamentit

[555] Shih LTMK (nenet 67-68); LTRS (nenet 87-88); LTSI (nenet 65-66); LTHR (nenet 32-33); LTBH (nenet 68-69) dhe LTME (neni 69). Duhet theksuar se LTME e rregullon në mënyrë të përgjithësuar testamentin gjyqësor, kjo forme e testamentit në Mal të Zi rregullohet në mënyrë më të detajuar nga Ligji për Procedurën Jokontestimore. LPJK i Mal të Zi e trajton në nenet 190-209. Rregullat e përmbajtura në LPJK për hartimin e testamentit gjyqësor në Mali të Zi nuk dallojnë nga rregullat e LTMK, LTRS, LTSI dhe LTBH.

[556] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Kroacisë 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15). Neni 32 dhe 33.

[557] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Malit të Zi (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi Nr 74/2008). Neni 69.

gjyqësor. Pra, testamenti noterial ashtu si dhe testamenti gjyqësor mund të bëhet në dy forma: testamenti noterial të cilin testatori nuk di ta lexojë dhe testamentin noterial të cilin testatori di ta lexojë. Testamenti noterial të cilin testatori nuk është në gjendje ta lexojë, e harton noteri sipas tregimit të testatorit dhe e nënshkruan testatori, në praninë e dy dëshmitarëve. Dëshmitarët gjithashtu nënshkruhen në testament. Ndërsa, në rastin kur testatori është në gjendje të lexojë, testamenti hartohet nga noteri dhe nënshkruhet nga testatori, pa praninë e dëshmitarëve. Pra, sipas LTHR dhe LTME, prania e dëshmitarëve, në rastin e bërjës së testamentit noterial është e kushtëzuar më faktin nëse testatori është ose nuk është në gjendje të lexojë. Ndërkaq, në LTRS dhe LTBH parashihet që hartimi i testamentit noterial bëhet sipas rregullave të parapara në Ligjin për Noteri. Në Ligjin për Noterinë i Serbisë,[558]dhe Ligjin për Noterinë i Bosnjës dhe Hercegovinës,[559]gjithashtu parashikohet që prania e dëshmitarëve në rastin e hartimit të testamentit noterial, është e nevojshme vetëm në rastin kur testatori nuk di apo nuk është në gjendje të lexojë. Sikurse u theksua edhe më lartë, në Ligjin për Trashëgimi i Maqedonisë dhe Ligjin për Trashëgimi i Sllovenisë, nuk parashikohet mundësia e bërjës së testamentit noterial. Megjithatë, edhe në Maqedoni dhe Sllloveni njihet forma e testamentit noterial.Testamenti noterial në Maqedoni dhe Sllloveni rregullohet më Ligjin për Noteri. Sipas Ligjit për Noteri i Maqedonisë[560]dhe Ligjit për Noteri i Sllovenisë[561], testamentin noterial e harton noteri dhe e nënshkruan testatori, përherë në praninë e dy dëshmitarëve, pavarësisht nëse testatori di ose nuk di të lexojë. Pra,sipas ligjeve në fjalë, për vlefshmërinë e testamentit noterial është e nevojshme prania e dëshmitarëve. Ndryshe nga ligjet e cekura më sipër, sipas KCSH për vlefshmërinë e testamentit noterial nuk është e nevojshme prania e dëshmitarëve.[562]Përkitazi më testamentin noterial në KCSH, parashikohet kësisoj: "Testamenti me akt noterial redaktohet nga noteri dhe nënshkruhet nga trashëgimlënësi në prani të noterit."[563]

[558] Zakon o javnom beležništvu ("Sl.glasnik RS", br. 31/2011, 85/2012, 19/2013, 55/2014 - dr. zakon, 93/2014 - dr. zakon, 121/2014, 6/2015 i 106/2015). Ligji për Noterët i Republikës së Serbisë. Shih nenin 68.

[559] Law on Notaries Bosnia and Hercegovina.Sarajevo, August 2002. (Ligji për Noterinë i Bosnjës dhe Hercegovinës). Shih nenin 83.

[560] Notary Public Law ("Official Gazette of the Republic of Macedonia" No.50/969). Shih nenin 46.

[561] Zakon o notariatu (Uradni list RS, št. 2/07 – uradno prečiščeno besedilo, 33/07 – ZSReg-B, 45/08 in 91/13). Shih nenin 51.

[562] Shih A.Jashari & E.Osmanaj (2016). Type of Testaments in Albania and France, Europian Journal of Humanities and Social Sciences No2, *East West, Association for Advanced Studies and Higher Education GmbH*, Vienna. Fq.73.

[563] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013). Shih nenin 397.

3.4.1.5. Testamenti konsular (diplomatik)

Testamenti konsular gjegjësisht diplomatik, rregullohet më dispozitat e të gjitha ligjeve të analizuara, përjashtimisht KCSH. Në literaturën juridike, testamenti konsular (diplomatik) përkufizohet si një "dokument publik të cilin testatorit, sipas tregimit të tij, ia përpilon përfaqësuesi i përfaqësisë konsulare diplomatike, i ngarkuar me punë konsulare diplomatike në botën e jashtme në mënyrën e paraparë më ligj".[564]Testamenti konsular përkufizohet edhe më dispozita ligjore. Kështu, në LTMK për testamentin konsular jepet ky kuptim: "Është i plotëfuqishëm testamenti i përgatitur nga shtetasi i Republikës së Maqedonisë, jashtë vendit sipas dispozitave që vlejnë për përgatitjen e testamentit gjyqësor, nga ana e përfaqësuesit konsular ose përfaqësuesit diplomatik të Republikës së Maqedonisë, i cili i kryen punët konsulare".[565] Një përkufizim i ngjajshëm për testamentin konsular jepet edhe në LTBH, ku thuhet: "Shtetasit të Bosnjës dhe Hercegovinës jashtë vendit, sipas dispozitave që aplikohen për përgatitjen e testamentit gjyqësor, mund t'ia përgadisë testamentin një agjent konsular ose përfaqësues diplomatik i Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili kryen punët konsulare".[566] Ngjajshëm ,gjithashtu, kuptimi i testamentit konsular jepet edhe në LTSI[567], LTRS[568], LTME[569] dhe LTHR.[570] Nga këto përkufizme mund të nxjerrim përfundimin se testamenti konsular (diplomatik) është lloj i shkruar i testamentit, të cilin sipas rregullave të njëjta si për testamentin gjyqësor, e harton përfaqësuesi konsular apo diplomatik në bazë të tregimit të testatorit. Për vlefshmërinë e kësaj formë të testamentit,kërkohet të përmbushen kushtet e njëjta si edhe për vlefshmërinë e testamentit gjyqësor.

3.4.1.6. Testamenti ndërkombëtar

Testamenti ndërkombëtar (përjashtimisht KCSH) njihet në të gjitha ligjet e analizuara. Duhet theksuar që testamenti ndërkombëtar njihet si formë e testamentit nga viti 1973, kur është nënshkruar Konventa e Uashingtonit, nga një numër i konsiderushëm i shteteve. Së pari, këtë konventë më 26 tetor 1973 në Uashington, e kanë nënshkruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës,

564 H. Podvorica (2010) fq 143-144 (i cili i referohet Mile Hxhi Vasilev-Vardarski, Fq 218)
565 Ligji për Trashëgiminë i Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë Nr 47/1997, 18/2001). Shih nenin
566 Ligji për Trashëgiminë i Bosnjes dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjes dhe Hercegovinës Nr 2/98, 39/04 i 73/05). Shih nenin 74.
567 Ligji për Trashëgiminë i Slovenisë (Gazeta Zyrtare e Slovenisë Nr 15/76, 23/78; 17/91, 13/94, 40/94, 117/00, 67/01, 83/01, 31/13 dhe 63/16). Shih nenin 69.
568 Ligji për Trashëgiminë i Serbisë (Gazeta Zyrtare e Serbisë Nr 46/1995, 101/2003-18, 6/2015). Shih nenin 91.
569 Ligji për Trashëgiminë i Malit të Zi (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi Nr 74/2008). Shih nenin 71.
570 Ligji për Trashëgiminë i Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Kroacisë 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15). Shih nenin 32.

Irani, Laos, Sierra Leone dhe Holy See. Konventa ka qenë e hapur për nënshkrim nga 26 tetor 1973 deri 31 dhjetor 1974, gjate kësaj përiudhe konventën e kanë nënshkruar edhe Belgjika, Britania e Madhe, Federata Ruse, Çekosllavakia, Ekuadori dhe Franca. Më vonë, palë kontraktuese në këtë konventë janë bërë edhe disa shtete të tjera si: Portugalia (1975), Jugosllavia (1977), Italia (1991), Sllovenia (1992), Bosnja dhe Hercegovina (1994) etj.[571] Kjo konventë ndryshe njihet si konventa për sigurimin e ligjit uniform për formën e testamentit ndërkombëtar, sepse në të parashikohen rregulla uniformë për bërjën e testamentit ndërkombëtar. Testamenti i hartuar në formë të testamentit ndërkombëtar është i vlefshëm në aspektin e formës, pavarësisht nga vendi ku është hartuar, vendndodhjes së pasurisë dhe shtetësisë, vendndodhjes apo vendbanimit të testatorit.[572]Testamenti ndërkombëtar gjithmonë duhet të bëhet në formë të shkruar dhe mund të bëhet edhe nga ndonjë person tjetër në çfarëdo gjuhe, më dorë ose më ndonjë mjet tjetër.[573] Sipas rregullave të përmbajtura në Konventën e Uashingtonit, procedura e bërjës së testamentit ndërkombëtar është kësisoj: Testatori duhet te deklarojë në prani të dy dëshmitarëve dhe të një personi të autorizuar për të vepruar (noterit apo gjyqtarit) në lidhje më testamentin ndërkombëtar, se dokumenti i shkruar është vullneti i tij dhe se ai e njeh përmbajtjen e tij.Testatori nuk është i detyruar që më përmbajtjen e testamentit t'i njoftojë personin e autorizuar dhe dëshmitarët. Testatori në praninë e personit të autorizuar dhe dëshmitarëve duhet ta nënshkruajë testamentin ose në qoftë se e ka nënshkruar atë më parë, duhet ta njohë nënshkrimin si të vetin. Nëse testatori nuk është në gjendje të nënshkruajë testamentin e tij, ai duhet t'i tregojë arsyen e mos nënshkrimit personit të autorizuar, i cili do ta shënoje këtë fakt në testament. Veç kësaj, testatori sipas ligjit që është caktuar personi i autorizuar të veprojë, mund të kërkojë nga personi i autorizuar që një person tjetër, në emër të tij, të nënshkruajë testamentin. Personi i autorizuar dhe dëshmitarët në praninë e testatorit,e nënshkurjnë testamentin.[574] Nënshkrimet duhet të vihen në fund të testamentit. Nëse testamenti përbëhet nga disa faqe, çdo faqe duhet të nënshkruhet nga testatori ose, nëse ai nuk është në gjendje të nënshkruajë, nga personi që nënshkruan në emër të tij, ose, nëse nuk ka një person të tillë, nga vetë personi i autorizuar. Çdo faqe duhet patjetër të shënohet më numër.Data e testamentit konsiderohet data e nënshkrimit të tij nga personi i autorizuar dhe shënohet në fund të testamentit.[575] Në mungesë të

[571] http://www.state.gov/documents/organization/209142.pdf (Vizituar më dt.30.07.2017 ora 16:11).
[572] Convention Providing a Uniform Law on the Form of an International Will done at Washington D.C. on 26 October 1973. Shih Ankes, neni 1.
[573] Po aty, shih nenin 3.
[574] Po aty shih nenin 4 dhe 5
[575] Po aty shih nenin 5 dhe 6

ndonjë rregulle të detyrueshme në lidhje më ruajtjen e testamentit, personi i autorizuar, e pyet testatorin nëse ai dëshiron të japë deklaratë në lidhje me ruajtjen e testamentit të tij. Nëse është kështu dhe me kërkesën e shprehur të testatorit, vendi ku testatori synon ta ruajë testamentin, duhet të shënohet në një certifikatë të veçantë, e cila i bashkangjitet testamentit për të përcaktuar nëse janë përmbushur detyrimet ligjore për hartimin e tij.[576]Çertifikata hartohet në tri kopje, një kopje i bashkangjitet testamentit, një kopje e mbanë personi i autorizuar dhe kopja tjetër i dorëzohet testatorit.Mosekzistimi gjegjësisht parregullësia e çertifikatës nuk ndikon në plotëfuqishmërinë formale të testamentit ndërkombëtar të hartuar në pajtim më rregullat ligjore.[577](Forma e çertifikatës gjendet e bashkangjitur në shtojcen nr.3 të punimit)

[576] Convention Providing a Uniform Law on the Form of an International Will done at Washington D.C. on 26 October 1973. Shih nenin 8 dhe 9.

[577] Po aty shih nenin 11 dhe 12.

3.4.2. Format e testamenteve të jashtëzakonshme në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri

Në ligjet e marra në analizë, rregullohen forma të ndryshme të testamenteve të jashtëzakonshme. Kësisoj, në LTRS, LTSI dhe LTME, si forma të testamenteve të jashtëzakonshme rregullohen: a) testamenti i bërë në anije: b) testamenti gojor; dhe c) testamenti i bërë gjatë kohës së luftës.[578] Në LTBH, veç formave të testamenteve të përmendura më sipër, rregullohet edhe testamenti i bërë në aeroplan.[579]Edhe në KCSH, gjithashtu rregullohet testamenti i bërë në kohë luftë dhe testamenti i bërë në anije, por ndryshe nga ligjet e cituara më sipër, KCSH nuk e njeh testamentin gojor. Dhe një dallim tjetër, është që më KCSH rregullohet edhe një formë tjetër e posaçëm e testamentit të jashtëzakonshëm, ai i bërë në vendet ku nuk ka noterë, i cili vërtetohet nga kryetari ose sekretari i bashkësisë ose i komunës.[580] Në LTMK si forma të testamenteve të jashtëzakonshme, rregullohen testamenti gojor dhe testamenti i bërë në kohë të luftës.[581] Ndërsa,në LTHR si formë e testamentit të jashtëzakonshëm rregullohet vetëm testamenti më gojë.[582]

Tabela 11: Format e testamenteve të jashtëzakonshme

Shteti	Testamentet e jashtëzakonshme
Serbi, Slloveni, dhe Mal të Zi	1. Testamenti i bërë në anije. 2. Testamenti i bërë gjatë gjendjes së luftës. 3. Testamenti gojor.
Maqedoni	1. Testamenti i bërë gjatë gjendjes së luftës. 2. Testamenti gojor.
Shqipëri	1. Testamenti në anije. **2.** Testamenti ushtarak**.** **3.** Testamenti i bërë në vendet ku nuk ka noterë.
Bosnjë dhe Hercegovinë	1. Testamenti i bërë në anije dhe aeroplan. 2. Testamenti i bërë gjatë gjendjes së luftës. 3. Testamenti gojor.
Kroaci	1. Testamenti gojor.

[578] Shih LTRS (nenet prej 108 deri 110); LTSI (nenet prej 69 deri 72); LTME (nenet prej 72 deri 88).
[579] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Bosnjës dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjes dhe Hercegovinës Nr 2/98, 39/04 i 73/05). nenet prej 75 deri 80.
[580] Kodi Civil Shqiptar, shih nenet prej 398 deri 400.
[581] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë Nr 47/1997, 18/2001). Nenet 73 dhe 90.
[582] Shih Ligjin për Trashëgiminë i Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Kroacisë 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15). Nenin 37.

3.4.2.1. Testamenti gojor

Testamenti gojor në LTMK, LTRS, LTSI, LTBH dhe LTME, rregullohet në mënyrë të njëjtë. Sipas dispozitave të ligjeve në fjalë, testatori mund ta bëjë testamentin më gojë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, që pengojnë bërjen e një testamentit më shkrim.[583]Në rastin e testamentit gojor, dëshmitarë mund të jenë vetëm personat të cilët mund të jenë dëshmitarë edhe në rastin e testamentit gjyqësor, por që dëshmitarët tek kjo formë e testamentit nuk është e nevojshme të dinë shkrim dhe lexim. Dëshmitarët para të cilëve testatori ka deklaruar vullnetin e tij të fundit më gojë, janë të detyruar që këtë vullnet, ta deklarojnë pa vonesë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur përparë një autoriteti publik gjegjësisht gjykatës ose noterit. Në të gjitha ligjet e analizuara, parashikohet që kjo formë e testamentit është e vlefshme 1 muaj nga mbarimi i gjendjes së jashtëzakonshme, në të cilën është përgatitur.

3.4.2.2. Testamenti i bërë gjatë gjendjes së luftës (ushtarak)

Në LTMK, LTRS, LTSI, LTBH dhe LTME, për testamentin e bërë në kohë luftë apo ushtarak jepet ky përcaktim: "Është i plotëfuqishëm testamenti i përgaditur në kohë të gjendjes së luftës sipas dispozitave që vlejnë për testamentin gjyqësor të personave në shërbim ushtarak nga ana e komandantit të çetës ose të ndonjë eprori tjetër të rangut të tij ose të ndonjë rangu më të lartë, ose të ndonjë personi tjetër në prani të ndonjërit nga këta eprorë, si dhe nga secili epror tjetër të njësitit të caktuar"[584]. Nga ky formulim ligjor rezulton se testamentin e bërë gjatë kohës së luftës gjegjësisht testamentin ushtarak mund ta bëjnë vetëm ushtarët, sipas rregullave të cilat vlejnë për testamentin gjyqësor. Në këtë rast, eprori ushtarak ose një zyrtar tjetër, e kryen detyrën e njëjtë sikurse gjyqtari tek testamenti gjyqësor, që do të thotë ai e harton testamentin në bazë të tregimit të vullnetit të testatorit dhe testatori e nënshkruan testamentin.Forma e testamentit ushtarak rregullohet edhe në KCSH. Në KCSH, për testamentin ushtarak jepet ky përkufizim: "Testamenti i një personi që ndodhet në shërbim ushtarak, mund të vërtetohet nga komandanti i njësisë ushtarake në të cilën ai bën pjesë dhe kur është shtruar në spital për mjekim nga drejtori i spitalit."[585] Pra,sipas KCSH, testamentin ushtarak mund ta bëjnë ushtarët gjatë ushtrimit të detyrës ose kur ndodhen të shtruar në spital. Ndryshe nga ligjet e cituara më sipër, sipas KCSH,

[583] Shih LTMK (nenet 90-93); LTRS (nenet 110 dhe 111); LTSI (nenet prej 72 deri 75); LTHR (nenet prej 37 deri 39); LTBH (nenet prej 77 deri 80) dhe LTME (nenet prej 88 deri 90).
[584] Shih LTMK (neni 73 par.1); LTRS (neni 109 par.1); LTSI (neni 71 par.1); LTBH (neni 76 par.1); dhe LTME (neni 73 par.1).
[585] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 399.

komandati i njësisë gjegjësisht drejtori i spitalit nuk e harton testamentin, por vetëm e vërteton përmbajtjen e testamentit dhe nënshkrimin e testatorit. Në KCSH, nuk gjendet ndonjë rregulle më të cilen tregohet se kush mund ta hartojë testamentin ushtarak, pra nuk dihet nëse testamentin ushtarak e harton testatori ose jo. Në KCSH, nuk gjendet ndonjë rregull as në lidhje më afatin e vlefshmërisë së testamentit ushtarak. Ndërsa, në LTMK, LTRS, LTSI, LTBH dhe LTME, parashikohet shprehimisht që testamenti i bërë në kohë luftë gjegjësisht testamenti ushtarak pushon të vlejë pas kalimit të 60 ditëve pas përfundimit të gjendjes së luftës, e nëse testatori para ose më pas është demobilizuar, pas kalimit të 30 ditëve nga demobilizimi.[586]

3.4.2.3. Testamenti i bërë në anije

Sipas LTRS, LTSI, LTBH dhe LTME,testamentin në anije në bazë të tregimit të testatorit e harton kapiteni i anijës, sipas rregullave të aplikueshme për testamentin gjyqësor.[587] Pra, kapiteni i anijes si dhe eprori ushtarak tek testamenti ushtarak, e kryen detyrën e njëjtë si gjyqari në rastin e hartimit të testamentit gjyqësor. Testamenti i bërë në anije njihet edhe në KCSH. Në lidhje më testamentin e bërë në anije në KCSH, parashikohet kësisoj: "Testamenti i një personi që ndodhet në një anijë shqiptare në lundrim ose që ka qëndruar në një liman të huaj, mund të vërtetohet nga kapiteni i anijes". Edhe për këtë formë të testamentit në KCSH nuk gjenden rregulla, për mënyrën se si hartohet testamenti dhe as për afatin e vlefshmërisë së testamentit.[588]Kurse, në LTRS, LTSI, LTBH dhe LTME, parashikohet që kjo formë e testamentit vlen deri në 30 ditë pas kthimit të testatorit në vendin, ku ka pasur mundësi të bëjë një testament në format e zakonshme.[589] Pra,efektet juridike të testamentit në anije, ashtu sikurse edhe të formave të testamenteve tjera të jashtëzakonshme, janë të kufizuara në pikëpamje kohore.Në legjislacione të ndryshme testamenti i bërë në anije, ashtu si dhe testamenti ushtarak, zakonisht vlenë 3 deri në 6 muaj nga pushimi i shkakut që ka penguar testatorin të përdorë format e zakonshme të testamentit. P.sh. në Kodin Civil Italian, parashikohet që testamenti i bërë në anije e humbë efektin, tre muaj pasi testatori ka arritur në një vend ku mund ta bëjë një testament në format e zakonshme.[590] Kështu, parashikohet edhe në Kodin Civil Belg,[591]Kodin Civil

[586] Shih LTMK (neni 73 par.2); LTRS (neni 109 par.2); LTSI (neni 71 par.2); LTBH (neni 76 par.2); dhe LTME (neni 73 par.2).
[587] Shih LTRS (neni 108 par.1); LTSI (neni 70 par.1); LTBH (neni 75 par.1); dhe LTME (neni 72 par.1).
[588] Kodi Civil Shqiptar, shih nenin 400.
[589] Shih LTRS (neni 108 par.2); LTSI (neni 70 par.2); LTBH (neni 75 par.2); dhe LTME (neni 72 par.2).
[590] Kodi Civil i Italisë, shih nenin 618.
[591] Kodi Civil i Belgjikës, shih nenin 996.

Gjerman[592], Kodin Civil i R. Çeke etj.[593]Kurse, në Kodin Civil Francez, parashikohet që testamenti i bërë në gjendje të luftës dhe testamenti i bërë në anije, bëhet i pavlefshëm gjashtë muaj, pasi testatori ka ardhur në një vend ku ai është i lirë, të përdorë format e zakonshme të testamentit, përveç nëse përpara skadimit të kësaj periudhe, ai është vendosur sërish në njërën prej situatave të veçanta të cilat pamundësojnë bërjën e një testamenti të zakonshëm.[594]

3.4.2.4. Testamenti i bërë në aeroplan

Kjo formë e testamentit prej ligjeve të marra në analizë rregullohet vetëm më LTBH. Sipas LTBH, testamenti i bërë në aeroplan ashtu si dhe testamenti i bërë në anije, bëhet sipas rregullave të cilat aplikohen për testamentin gjyqësore. Pra,forma e testamentit të bërë në aeroplan dhe në anijë është e njëjtë më formën e testamentit gjyqësor. Afati i vlefshmërisë së testamentit të bërë në aeroplan sipas LTBH, është i njëjtë më atë të testamentit të bërë në anije.[595] Pra, kjo formë e testamentit pushon të vlejë 30 ditë, pasi testatori është vendosur në një vend ku ka pasur mundësi të bëjë një testament në format e zakonshme.

[592] Kodi Civil i Gjermanisë, shih nenin 2251
[593] Kodi Civil i Republikës Çeke, shih nenin 1549.
[594] Kodi Civil i Francës, shih nenin 984.
[595] Ligji për Trashëgiminë i Bosnjës dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjes dhe Hercegovinës Nr 2/98, 39/04 i 73/05). Shih nenin 75.

Përfundimi

Gjatë këtij kapitulli është analizuar rregullimi ligjor i trashëgimisë testamentare në Kosovë, Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri. Pra, në këtë kapitull është bërë krahasimi i dispozitave të ligjit të brendshëm dhe ligjeve të shteteve të përfshira në studim, në lidhje më rregullimin e trashëgimisë testamentare. Për këtë arsye, në përfundim të këtij kapitulli, do të ndalemi në dallimet kryesore ndërmjet ligjit tonë dhe ligjeve të shteteve të marra në studim, në aspektin e rregullimit të çështjeve më kryesore në lidhje më trashëgiminë testamentare. Kësisoj, do të ndalemi fillimisht tek aftësia e testatorit për të disponuar pasurinë më testament. Aftësia për të disponuar më testament përcaktohet duke u bazuar në dy kritere. Kriteri i parë kërkon që personi të jetë i një moshë të caktuar. Kurse, sipas kriterit të dytë, personi i cili ka arritur moshën e caktuar më ligj, duhet të jetë i aftë të kuptojë rëndësinë dhe pasojat e veprimit të tij. Kriteri i moshës i parashikuar më ligj, ndryshon në shtetet e përfshira në studim, duke shkuar nga mosha 15 vjeç deri në moshën 18 vjeç. Kështu, në Kosovë testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën madhore (18 vjeç). Përjashtimisht edhe nën këtë moshë, në moshën 16 vjeçare nëse është i martuar. Në Shqipëri të drejtën për të bërë testament e kanë personat që kanë mbushur moshën 18 vjeç, kurse nën këtë moshë, e drejta për të bërë testament i lejohet vetëm gruas kur është e martuar. Gjiteashtu, në Shqipëri e drejta për të bërë testament i njihet edhe personit mbi moshën 14 vjeç, për pasurinë që e ka fituar më punën e vet të pavarur. Në Kroaci të drejtën për të bërë testament, e ka çdo person që ka mbushur moshën 16 vjeç. Ndërsa, në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, e drejta për të bërë testament i njihet personave mbi moshën 15 vjeçare. Ndryshe, nga aftësia për të disponuar më testament, aftësia për të trashëguar më testament rregullohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha ligjet e marra në analizë, përjashtimisht ligjit shqiptar. Në ligjin tonë ashtu si dhe në ligjet e marra në analizë, aftësi për të trashëguar konsiderohet që ka personi i cili në momentin e çeljes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë (konceptuar) para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë. Ligji shqiptar bënë një përjashtim nga kjo rregull, kur bëhet fjalë për fëmijët e pandermjetshëm apo fëmijët të cilët nuk rrjedhin direkt nga testatori. Përkatësisht sipas ligjit shqiptar, të aftë për të trashëguar më testament konsiderohen edhe fëmijët e pandermjetshëm, që ende nuk janë zënë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit (testatorit). Dallime të tjera më rëndësi ekzistojnë në lidhje më llojet e formave të testamenteve që aplikohen. Kështu, në Kosovë si testamente të rregullta aplikohen: testamenti ollograf, testamenti alografik, testamenti

gjyqësor dhe testamenti noterial. Në Shqipëri aplikohen vetëm dy lloje të testamenteve të rregullta, testamenti ollograf dhe testamenti noterial. Ndërsa, në Serbi, Slloveni, Kroaci, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, si testamente të rregullta aplikohen testamenti ollograf, testamenti alografik, testamenti gjyqësor, testamenti noterial, testamenti ndërkombëtar dhe testamenti diplomatik (konsular). Këto forma të testamenteve aplikohen gjithashtu edhe në Maqedoni, përjashtimisht testamentit alografik. Dallime ekzistojnë edhe në lidhje më kushtet ligjore që kërkohen të plotësohen për vlefshmërinë e testamentit. Për shembull, në Kosovë dhe Shqipëri për vlefshmërinë e testamentit ollograf kërkohet domosdo të vihet edhe data e hartimit të testamentit. Ndërsa, në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë për vlefshmërinë e testamentit ollograf nuk kërkohet domosdo të vihet data në testament. Ose për shembull, për vlefshmërinë e testamentit noterial në Kosovë, Maqedoni dhe Slloveni kërkohet që testamenti të bëhet gjithmonë në praninë e dy dëshmitarëve. Ndërsa, në Serbi, Kroaci, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë për vlefshmërinë e testamentit noterial kërkohet prania e dy dëshmitarëve, vetëm në rastin kur testatori nuk është në gjendje të lexojë dhe shkruajë. Ndërsa, në Shqipëri për vlefshmërinë e testamentit noterial nuk është e nevojshme prania e dëshmitarëve në asnjë rast. Dallime gjithashtu ekzistojnë edhe në lidhje më format e testamenteve të jashtëzakonshme. Kështu, në Serbi, Slloveni dhe Mal të Zi, si forma të testamenteve të jashtëzakonshme njihen: testamenti i bërë në anije; testamenti gojor dhe testamenti ushtarak. Në Bosnjë dhe Hercegovinë veç formave të testamenteve të përmendura më sipër, njihet edhe testamenti i bërë në aeroplan. Edhe në Shqipëri gjithashtu njihet testamenti ushtarak dhe testamenti i bërë në anijë, por jo edhe testamenti gojor. Në Shqipëri njihet edhe një formë tjetër e testamentit të jashtëzakonshëm, ai i bërë në vendet ku nuk ka noterë, i cili vërtetohet nga kryetari ose sekretari i bashkësisë ose i komunës. Në Maqedoni si testamente të jashtëzakonshme, njihen testamenti gojor dhe testamenti ushtarak. Ndërsa, në Kosovë dhe Kroaci si formë e testamentit të jashtëzakonshëm njihet vetëm testamenti gojor.

KAPITULLI IV

PROCEDURA TRASHËGIMORE NË KOSOVË DHE NË DISA SHTETE NË RAJON-VËSHTRIM KRAHASIMOR

4. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit

Në këtë kapitull trajtohet procedura trashëgimore në Kosovë dhe në disa shtete në rajon respektivisht në Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Shqipëri dhe Mal të Zi. Kapitulli është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë, trajtohet procedura trashëgimore sipas legjislacionit vendas, duke u fokusuar në trajtimin e çështjeve më më rëndësi në lidhje më procesin e shqyrtimit të trashëgimisë si:

- inicimi i procedurës trashëgimore;
- organi kompetent për zhvillimin e procedurës trashëgimore;
- roli i organit administrativ dhe gjykatës në procesin e trashëgimisë;
- mbajtja e seancës gjyqësore për shqyrtimin e trashëgimisë;
- ndërprerja e procedurës trashëgimore dhe udhëzimi i palëve në kontest civil;
- marrja e aktvendimit për trashëgimi; etj.

Këto çështje në vija më të përgjithshme janë trajtuar gjithashtu edhe në pjesën e dytë të këtij kapitulli, ku është trajtuar procedura trashëgimore në Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi. Dhe në një pjesë të veçantë të këtij kapitulli (për shkak të dallimeve të mëdha nga shtetet e tjera të përshira në studim) është trajtuar procedura trashëgimore në Shqipëri.

4.1. Procedura trashëgimore në Kosovë

4.1.1. Kuptimi i procedurës trashëgimore

Sikurse është theksuar edhe më parë,instituti i trashëgimisë paraqet mjetin e vetëm përmes të cilit mundësohet bartja e të drejtave dhe detyrimeve pasurore, i personit të vdekur tek personat e tjerë.Pra,nëpërmjet trashëgimit bëhet e mundur që të drejtat dhe detyrimet e karakterit pasuror të cilat i ka gëzuar personi i vdekur, të mos shuhen por të bëhet kalimi i tyre tek personat e tjerë (trashëgimtarët potencial).Bartja e të drejtave dhe detyrimeve pasurore i personit të vdekur tek personat e tjerë bëhet në momentin e hapjes së trashëgimisë. Çdo kalim i të drejtave dhe detyrimeve pasurore i personit të vdekur, para që të hapet trashëgimia konsiderohet i pavlefshëm.Këtë rregull LTK, e ka paraparë shprehimisht në nenin 5 par.3 ku është përcaktuar: "E drejta në trashëgimi fitohet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit" dhe në nenin 6 ku thuhet: "Është e pavlefshme çdo marrëveshje mes trashëgimtarëve të ardhshëm, ose mes trashëgimtarëve të ardhshëm dhe personave të tretë, lidhur me një trashëgimi ende të pahapur." Nga kjo rrjedh që të mund të lind e drejta e trashëgimisë duhet të plotësohen dy kushte: të vërtetohet vdekja e personit dhe të hapet trashëgimia. Pra, momenti i vdekjes mundëson që të hapet procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, në të cilën personat e thirrur në trashëgim qoftë si trashëgimtarë testamentar apo ligjor, mund ti realizojnë të drejtat e tyre që ju takojnë në pasurinë trashëgimore. LTK, nuk përmbanë dispozita sipas të cilave rregullohet procedura trashëgimore, përveç dispozitës se nenit 145 ku thuhet: "Rregullat e procedurës sipas të cilave, gjykata, organet e tjera dhe personat e autorizuar veprojnë në çështjet e trashëgimisë përcaktohen me dispozitat për procedurën jashtëkontestimore".Pra,sipas kësaj dispozitë ligjore, aktviteti i gjykatës dhe organeve të tjera si dhe personave të autorizuar në procedurën trashëgimore, rregullohet më dispozitat më të cilat rregullohet procedura jokokontestimore. Procedura jokontestimore rregullohet më Ligjin për Procedurën Jokontestimore i Republikës së Kosovës.(tutje si LPJK).Në LPJK, për procedurën trashëgimore jepet ky përcaktim: "Në procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore gjykata konstaton se kush janë trashëgimtarët e personit të vdekur, ose të personit vdekja e të cilit është shpallur me vendim gjyqësor, cila pasuri përbën pasurinë trashëgimore të tij, dhe cilat të drejta nga pasuria trashëgimore u takojnë

trashëgimtarëve, legatarëve dhe personave të tjerë." [596]Në këtë dispozitë ligjore, ligjvënësi ka përcaktuar faktet kryesore të cilat gjykata duhet ti vërtetojë në procedurën trashëgimore, më qëllim të vendosjes meritore lidhur mbi objektin e trashëgimit dhe të drejtave që ju takojnë mbi të, trashëgimtarëve apo legatarëve.Pra, pasi gjykata të vërtetojë se cilt persona janë trashëgimtarë dhe cilat sende e përbëjnë pasurinë trashëgimore dhe në përgjithësi pasi ti shqyrtojë të gjitha çështjet e tjera më rëndësi që kanë të bëjnë më pasurinë e trashëgimlënësit, gjykata e përfundon procedurën trashëgimore më nxjerren e aktvendimit për trashëgimi.[597]

4.1.1.2. Organi i cili është kompetent të zhvillojë procedurën trashëgimore

Sipas rregullave të përmbajtura në LPJK,kompetente në pikëpamje territoriale për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, konsiderohet gjykata në territorin e të cilës trashëgimlënësi në momentin e vdekjes ka pasur vendbanimin apo vendqendrimin, kurse në rastet kur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes nuk ka pasur as vendbanim e as vendqëndrim në Kosovë, kompetente në pikëpamje territoriale konsiderohet gjykata në territorin e të cilës gjendet pasuria trashëgimore e tij ose pjesa më e madhe e saj.[598]Ndërsa,kompetente në pikëpamje lëndore për zhvillimin e procedures trashëgimore konsiderohet Gjykata Themelore. Është e rëndësishme të theksohet se në Kosovë, në bazë të Ligjit për Noteri, rastet e trashëgimisë jokontestimore, kanë filluar ti shqyrtojnë edhe noterët. Në Ligjin për Noteri i Kosovës, një ndër funksionet noteriale përmendet edhe trajtimi i të gjitha procedurave jokontestimore trashëgimore.[599] Mirëpo, në këtë ligj nuk gjendet ndonjë dispozitë tjetër më të cilën rregullohet zhvillimi i procedurës trashëgimore p.sh.,se si bëhet inicimi i procedurës trashëgimore apo si sigurohet aktvdekja etj., çështje këto të cilat rregullohen nga LPJK. Kurse, më LPJK, nuk parashikohet që shqyrtimi i rasteve të trashëgimisë hynë edhe në kompetencë të noterëve. Këto zbrazëtira ligjore kanë bërë që në praktikë të krijohet konfuzion në lidhje me juridiksionin e noterëve mbi rastet e trashëgimisë.

[596] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 125.
[597] Shih A.Jashari & E.Osmanaj (2016). Initiation of inheritance procedure according to positive legislation in Kosovo and problems in practice. International Journals of Multidisciplinary Research Academy (IJMRA). ISSN 2249-2496.Volume 6, Issue 8 (August 2016). Fq.95.
[598] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009).Shih nenin 128.
[599] Ligji Nr.03/L-010 për Noterinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III/ Nr.42/25 Nëntor 2008). Shih nenin 29 par.1 pika 4.

4.1.1.3. Inicimi i procedurës trashëgimore

Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, inicohet nga gjykata sipas detyrës zyrtare "ex officio", kjo rregull është sanksionuar në nenin 127 i LPJK, ku është përcaktuar: "Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore vihet në veprim nga gjykata sipas detyrës zyrtare posa gjykata të informohet se një person ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjyqësor". Sipas LPJK, për vdekjen e personit apo për shpalljen e personit të vdekur më vendim gjyqësor, gjykata informohet nga organi komunal gjegjësisht nga nënpunësi i gjendjes civile, i cili është kompetent të regjistrojë vdekjen në librin amzë të të vdekurve. Nënpunësi i gjendjes civile brenda aftatit prej 15 ditësh, nga dita në të cilën e ka regjistruar vdekjen ka për detyrë t'ia dërgojë akvdekjen gjykatës trashëgimore.[600] Pra, sipas ligjit gjykata është e detyruar që të fillojë zyrtarisht procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Përjashtim, nga kjo rregull bëhet në rastet kur vërtetohet se pasurinë e trashëgimlënësit, e përbëjnë vetëm sende të luajtshme, në raste të tilla, gjykata është e detyruar që të shqyrtojë pasurinë trashëgimore, vetëm po që se trashëgimtarët kërkojnë që të shqyrtohet ajo. Këtë rregull LPJK, e ka paraparë shprehimisht në nenin 157 par.1 ku është thuhet: "Në qoftë se nga të dhënat e aktvdekjes shihet se trashëgimlënësi nuk ka lënë pasuri, apo se ka lënë vetëm pasuri të luajtshme, e asnjëri nga trashëgimtarët nuk kërkon që të shqyrtohet çështja, atëherë gjykata me aktvendim do të vendos që mos të shqyrtohet pasuria trashëgimore". Pra, gjykata është e detyruar sipas detyrës zyrtare të inicojë procedurën dhe të shqyrtojë trashëgiminë, vetëm në rastet kur trashëgimlënësi ka lënë pasuri të paluajtshme, kurse në rastet kur pasuria e trashëgimlënësit përbëhet prej sendeve të luatjshme, trashëgimia shqyrtohet vetëm në qoftë se këtë e kërkojnë personat e interesuar gjegjësisht trashëgimtarët potencial. Këtë zgjidhje ligjvënësi, e ka paraparë duke u nisur nga botëkuptimi tradicional, se sendet e paluajtshme përbëjnë vlerë më të madhe se sa sendet e luatjshme, mirëpo botëkuptimi i tillë në kushtet e sotme shoqërore dhe ekonomike mund të mos konsiderohet i arsyeshëm, pasi pasuritë e luajtshme mund të përbjëjnë vlerë më të madhe se sa ato të paluajtshme. Edhe në rastin kur gjykata vendosë të mos shqyrtojë trashëgiminë (për shkak se trashëgimlënësi nuk ka lënë pasuri të paluajtshme), e drejta e trashëgimisë nuk humbet

[600] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 133 par.1.

asnjëherë, por trashëgimtarët e ruajnë të drejtën që më vonë ta inicojnë procedurën trashëgimore.[601]

4.2. Përgatitja e procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore

Zhvillimit të procesit trashëgimor gjegjësisht seancës gjyqësore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, i paraprijnë disa veprime paraprake. Veprimet paraprake të cilat ndërmirren në procedurën trashëgimore janë:

a. Përpilimi i aktvdekjes;
b. Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë së trashëgimlënësit;
c. Caktimi i masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore dhe emërimi i kujdestarit të përkohshëm;[602]

Në rast se ekziston testamenti, në veprimet paraprake hyjnë edhe veprimet të cilat ndërmirren lidhur më testamentin.

a). Përpilimi i aktvdekjes. -Sikurse u theksua edhe më lartë, sipas LPJK, kur një person vdes ose shpallet i vdekur më vendim gjyqësor, organi komunal gjegjësisht nënpunësi i gjendjes civile kompetent për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve, ka për detyrë që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita në të cilën e ka regjistruar vdekjen, t'ia dërgojë aktvdekjen gjykatës trashëgimore. Sipas LPJK, organi komunal gjegjësisht nënpunësi i gjendjes civile, të dhënat për hartimin e aktvdekjes, i siguron nga personat më të cilët trashëgimlënësi ka bashkëjetuar, nga kushërinjët e trashëgimlënësit, si dhe nga personat e tjerë të cilët mund të japin dhënat e nevojshme për hartimin e aktvdekjes.[603] Po që se, nënpunësi i gjendjes civile, nuk arrinë t'i sigurojë të dhënat e nevojshme për hartimin e aktvdekjes, ai e dërgonë aktvdekjen në gjykatë vetëm me ato të dhëna që disponon dhe duhet t'i tregojë shkaqet për të cilat nuk ka mundur ta përpilojë aktvdekjen e plotë dhe duhet t'i paraqesë të dhënat që mund t'i shërbejnë gjykatës për të gjetur trashëgimtarët dhe pasurinë e trashëgimlënësit.[604] Sipas nenit 136 par.1 i LPJK, aktvdekja duhet të përmbajë:

a. emrin dhe mbiemrin e trashëgimlënësit dhe emrat e prindërve të tij, profesionin, datat e lindjes dhe shtetësinë e trashëgimlënësit, kurse për trashëgimlënësin që ka qenë i martuar edhe mbiemrin të cilin e ka pasur para se të martohet;
b. ditën, muajin dhe vitin, vendin dhe sipas mundësisë, orën e vdekjes;

[601] Shih F. Brestovci (2006). E Drejta Procedurale Civile II. Prishtinë.Fq.227.
[602] Shih F. Brestovci (2006). E Drejta Procedurale Civile II. Prishtinë. Fq. 273.
[603] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 133 par. 2.
[604] Po aty, shih nenin 134.

c. vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin që e ka pasur trashëgimlënësi;
d. emrin e mbiemrin, datën e lindjes, profesionin, vendbanimin gjegjësisht vendqëndrimin e bashkëshortit të trashëgimlënësit dhe i fëmijëve të lindur nga martesa, jashtë martesës dhe i fëmijëve të adoptuar;
e. emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, vendbanimin ose vendqëndrimin e kushërinjve të tjerë që mund të thirren në trashëgim në bazë të ligjit, si dhe të personave që kanë të drejtë trashëgimi në bazë të testamentit;
f. vlerën e përafërt e pasurisë së paluajtshme dhe veçanërisht vlera e përafërt e pasurisë së luajtshme të trashëgimlënësit.

Përveç të dhënave të cekura më sipër, sipas LPJK, në dokumentin e aktvdekjes sipas mundësisë është në interes të shënohen edhe disa të dhëna tjera, si:

a. vendi ku ndodhet pasuria e lënë në trashëgim;
b. a ka lënë trashëgimlënësi pasuri për mbajtjen, ruajtjen, ose paraqitjen e së cilës ekzistojnë rregulla të posaçme ose a ka lënë trashëgimlënësi të holla të gatshme, letra me vlerë, gjëra të çmueshme, libreza të kursimit ose dokumente të tjera me rëndësi;
c. a ka lënë trashëgimlënësi borxhe dhe sa;
d. a ka lënë trashëgimlënësi testament të shkruar ose kontratë për mbajtje të përjetshëm, ose marrëveshje për pjesëtimin e pasurisë për të gjallë dhe ku gjenden ato;
e. nëse trashëgimlënësi ka lënë testament gojor, atëherë edhe emri e mbiemri, profesioni dhe vendbanimi i dëshmitarëve para të cilëve është bërë testamenti gojor;
f. nëse pritet lindja e fëmijës së trashëgimlënësit;
g. Nësë para trashëgimlënësit ka vdekur bashkëshorti i tij ose ndonjë nga fëmijët e tij, ose ndonjë person tjetër që mund të trashëgojë trashëgimlënësin, në aktvdekje duhet të shënohet edhe data dhe vendi i vdekjes së tyre;[605] dhe
h. në aktvdekje është në interes të shënohen edhe emrat e mbiemrat dhe adresat e anëtarëve të moshës madhore të bashkësisë familjare të trashëgimlënësit si dhe të gjitha pasuritë e bashkësisë familjare.[606]

b). Inventarizimi (regjistrimi) dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore. -Sipas rregullit të përgjithshëm, inventarizimi gjegjësisht regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore, bëhet

[605] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 136 par.2, 3 dhe 4.
[606] Po aty, shih nenin 137.

në bazë të vendimit të gjykatës, në raste të caktuara të parashikuara më ligj. Rastet në të cilat është e nevojshme të bëhet inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore,LPJK, i rregullon në nenin 138. Sipas kësaj dispozitë ligjore, inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore, bëhet në këto raste: a) kur nuk dihen trashëgimtarët apo vendbanimi i tyre; b) kur trashëgimtarë janë personat që për shkak të moshës së mitur, sëmundjes mendore ose rrethanave të tjera nuk janë fare të aftë, ose nuk janë plotësisht të aftë, që të kujdesen vetë për punët e veta; c) kur pasuria trashëgimore duhet t'i dorëzohet komunës ose personit juridik tjetër; si dhe c) kur kanë kërkuar vetë trashëgimtarët, legatarët ose kreditorët e trashëgimlënësit. Është e rëndësishme të theksohet se inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore, lejohet të bëhet edhe pa vendim të gjykatës, kur këtë e kërkojnë trashëgimtarët apo legatarët, që më rastin e përpilimit të aktvdekjes.[607] Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore, mund të bëhet nga ana e zyrtarit të organit komunal kompetent dhe nga ana e zyrtarit të gjykatës që e cakton gjykatësi. Gjatë inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë trashëgimore, duhet domosdo të jenë të pranishëm dy persona madhore në cilësinë e dëshmitarit dhe sipas nevojës edhe eksperti përkatës. Përndryshe, gjatë inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë trashëgimore lejohet që të jetë i pranishëm secili person i interesuar.[608]Në inventarizimin apo regjistrimin e pasurisë duhet të përfshihet tërë pasuria, sikurse ajo e luajtshme, ashtu edhe ajo e paluajtshme, të cilen trashëgimlënësi e ka pasur në posedim në momentin e vdekjes. Në inventarizim përfshihet edhe pasuria që i ka takuar trashëgimlënësit, por që ndodhet të ndonjë person tjetër. Në këtë rast, duhet treguar të kush ndodhet pasuria e këtillë dhe mbi cilën bazë juridike. Në inventarizim përfshihet gjithashtu edhe pasuria të cilën e ka pasur në posedim trashëgimlënësi në momentin e vdekjes, e për të cilën pretendohet se nuk është pronësi e tij. Si dhe në inventarizim përfshihen gjithashtu edhe kreditë dhe detyrimet e trashëgimlënësit, e në veçanti tatimi i papaguar dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit.[609]

c).Caktimi i masave për sigurimin e pasurisë trashëgimore dhe emërimi i kujdestarit të përkohshëm. -Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore, mund të shqiptohen nga ana e organit komunal administrativ, që më rastin e përplimit të aktvdekjes dhe nga ana e gjykatës gjatë gjithë zhvillimit të procesit trashëgimor. Sipas nenit 145 i LPJK, organi komunal administrativ është i detyruar që të ndërmarrë masa për sigurimin e pasurisë

[607] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 138 par.3
[608] Po aty, shih nenin 141.
[609] Po aty, shih nenin 139.

trashëgimore, në këto raste: a) kur asnjëri nga trashëgimtarët e paraqitur nuk janë të aftë që të administrojnë më pasurinë trashëgimore, kurse përfaqësuesi ligjor mungon; b) kur trashëgimtarët janë të panjohur apo mungojnë. Kur ekzistojnë rrethanat e tilla, në raste të ngutshme, organi komunal administrativ do t'ia dorëzojë pasurinë, ose vetëm një pjesë të saj, për ruajtje një personi të sigurt. Për masën e ndërmarrë, organi komunal administrativ ka për detyrë ta njoftojë menjëherë gjykatën, në territorin e të cilës gjendet pasuria. Masën e shqiptuar nga organi komunal administrativ, gjykata mund ta ndryshojë ose ta abrogojë. Ndërsa, të hollat e gatshme, letrat me vlerë, sendet e çmueshme, librezat e kursimit dhe dokumentet tjera të rëndësishme duhet t'i dorëzohen për ruajtje gjykatës në territorin e së cilës gjendet pasuria. Kjo gjykatë është e obliguar ta njoftojë gjykatën trashëgimore për të gjitha masat e ndërmarra për sigurimin e pasurisë trashëgimore. Ndërsa, emërimin e kujdestarit të përkoheshëm të pasurisë trashëgimore, në rastet kur sipas ligjit është e nevojshme, e bënë gjykata gjykata trashëgimore.Sipas mundësive, gjykata para se ta caktoj kujdestarin e përkohshëm, për personalitetin e kujdestarit duhet ta kërkojë mendimin nga personat që paraqiten si trashëgimtar.[610]

d). Veprimet të cilat ndermirren lidhur më testamentin. –Sikurse është theksuar edhe më lartë, në veprimet paraprake të procedurës trashëgimore, hyjnë edhe veprimet të cilat ndërmirren në lidhje më testamentin.Organi komunal administrativ, i cili e përpilon aktvdekjen është i obliguar sipas ligjit, të vërtetojë nëse trashëgimlënësi ka lënë testament ose nëse ekziston dokumenti mbi testamentin gojor. Nëse po, testamenti i dërgohet gjykatës trashëgimore bashkë më aktvdekjen.[611] Hapjen dhe leximin e testamentit, gjykata e bënë në praninë e dy dëshimtarëve të moshës madhore, këta dëshmitarë mund të jenë edhe nga rradha e trashëgimtarëve potencial. Më rastin e shpalljes së testamentit mund të jenë të pranishëm gjithashtu edhe trashëgimtarët, legatarët dhe personat e tjerë të interesuar, të cilët mund të kërkojnë edhe nga një kopje të testamentit. Është e rëndësishme të theksohet, që gjykata tek e cila ndodhet testamenti për ruajtje, apo tek e cila është dorëzuar testamenti nga organi komunal administrativ, e bënë hapjen dhe shpalljen e testamentit edhe kur për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është kompetente gjykata tjetër ose organi i shtetit të huaj.[612] Për shpalljen e testamentit, gjykata mbanë procesverbal. Sipas LPJK, procesverbali duhet të përmbajë këto të dhëna: a) sa testamente janë gjetur, cilën datë e mbajnë dhe ku janë gjetur; b) kush ia ka dorëzuar gjykatës testamentin apo

[610] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 146.
[611] Po aty, shih nenin 148.
[612] Po aty, shih nenin 149.

organit administrativ komunal gjegjësisht përpiluesit të aktvdekjes; c) a është dorëzuar testamenti i hapur apo i mbyllur, dhe çfarë vule ka mbajtur; d) cilët dëshmitar kanë qenë të pranishëm kur është hapur dhe shpallur testamenti. Sipas LPJK, në procesverbal duhet të shënohet gjithashtu edhe nëse me rastin e hapjes së testamentit është vërejtur ndonjë gjë e dyshimtë, si p.sh., nëse vula në testament ka qenë e dëmtuar apo se në testament është fshirë, vijëzuar apo ndrequr diçka. Në procesverbal, duhet të nënshkruhen gjykatësi, dëshmitarët dhe procesmbajtësi.[613] Edhe shpallja e testamentit gojor për të cilin ekziston dokumenti, të cilin dëshmitarët e kanë nënshkruar më dorën e vet, bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse testamenti i shkruar, nga trashëgimlënësi. Pra, përmbajtja e dokumentit të testamentit gojor, shpallet nga gjykata sipas rregullave të cilat vlejnë për shpalljen e testamentit të shkruar nga trashëgimlënësi. Kurse, në rastin kur mungon dokumenti në të cilin është shkruar përmbajtja e testamentit gojor, veprohet në këtë mënyrë: së pari dëshmitarët përpara të cilëve është bërë testamenti gojor dëgjohen veç e veç, për përmbajtjen e testamentit, e sidomos lidhur me rrethanat nga të cilat varet vlefshmëria e tij. Më pas, procesverbali i përpiluar me deklaratat e tilla, shpallet sipas rregullave që vlejnë për shpalljen e testamentit të shkruar nga trashëgimlënësi. Duhet theksuar se marrja në pyetje e dëshmitarëve të testamentit gojor, mund të bëhet edhe më betim, në rastin kur një gjë të tillë e ka kërkuar ndonjë nga pjesëmarrësit në procedurë ose kur vetë gjykata vij në përfundim se është i nevojshëm dëgjimi i këtillë i dëshmitarëve. Në një rast të tillë, gjykata duhet të caktojë seancën për dëgjimin e dëshmitarëve, në të cilën thirret pjesëmarrësi i cili e ka bërë propozimin, kurse pjesëmarrësit e tjerë thirren vetëm nëse një gjë e tillë nuk e zvarritë procedurën e mëtejme.[614] Sipas rregullave të përmendura më sipër, bëhet edhe shpallja e testamentit të hartuar nga trashëgimlënësi, i cili është humbur apo agjësuar pa vullnetin e tij. Përkatësisht, në këtë rast nëse midis personave të interesuar nuk ka kontest, për ekzistimin e testamentit të tillë (respektivisht për formën në të cilën është hartuar, për mënyrën e humbjes si dhe për përmbajtjen e testamentit), gjykata trashëgimore lidhur me ekzistimin e testamentit, i dëgjon të gjithë të interesuarit dhe sipas propozimeve të tyre merr prova. Pas kësaj, gjykata procesverbalin e përpiluar, e shpallë sipas rregullave që vlejnë për shpalljen e testamentit gojor. Ndërsa, në rastin kur pasuria trashëgimore në mungesë të testamentit, do të bëhej pronë shtetërore, marrëveshja e personave të interesuar për ekzistimin e mëhershëm të testamentit,

[613] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 150.
[614] Po aty, shih nenin 151.

konsiderohet e vlefshme vetëm nëse paraprakisht merret pëlqimi i përfaqësuesit të autorizuar të komunës. E kur midis personave të interesuar ka të atillë që u mungon aftësia për të vepruar, për vlefshmërinë e marrëveshjës së arritur, midis personave të interesuar për ekzistimin e testamentit, kërkohet të merret pëlqimi i organit të kujdestarisë.[615] Në rastin kur gjykata, e cila e ka shpallur tesamentin (e shkruar nga trashëgimlënësi, gojor apo testamentin e humbur apo agjësuar pa vullnetin e trashëgimlënësit), nuk është kompetente që të shqyrtojë pasurinë trashëgimore, ajo është e obliguar që bashkë më procesverbalin t'ia dërgojë testamentin gjykatës trashëgimore, kurse vetë e mbanë kopjen e testamentit të shpallur.[616]

4.2.1. Shqyrtimi i pasurisë trashëgimore

Në LPJK, shprehimisht është sanksionuar rregulla se "shqyrtimi i pasurisë trashëgimore bëhet në seancë gjyqësore".[617]Para që të caktojë seancën gjyqësore, gjegjësisht që në momentin kur i dorëzohet aktvdekja, gjykata ka për detyrë të verifikojë nëse është kompetente që të shqyrtojë pasurinë trashëgimore. Kështu, nëse gjykata konstaton se nuk është kompetente, ajo dosjen e lëndës ia dërgon gjykatës, për të cilen mendon se është kompetente. Ndërsa, në rastin kur gjykata konstaton që për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është kompetent organi i shtetit të huaj, atëherë ajo më aktvendim shpallet jokompetente dhe procedura trashëgimore pezullohet.[618] Përveç, verifikimit të kompetencës, gjykata para që të fillojë shqyrtimin e pasurisë trashëgimore i ndërmerre edhe disa veprime të tjera, p.sh., në rast se trashëgimlënësi e ka caktuar personin, i cili do të merret më ekzekutimin e testamentit, gjykata e njofton ekzekutuesin e testamentit dhe e thërret që në afatin e caktuar të deklarojë se a e pranon detyrën me të cilën është ngarkuar. Ose p.sh., nëse pritet lindja e fëmijës që do të kishte të drejtë trashëgimi, gjykata trashëgimore e njofton për këtë organin e kujdestarisë.[619] Mund të ndodhë se gjykata, të përfundojë procedurën trashëgimore, më aktvendim edhe pa u lëshuar në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Rastet kur gjykatës i lejohet që të mos e shqyrtojë pasurinë trashëgimore janë: a) kur nga të dhënat e aktvdekjes, rezulton se trashëgimlënësi nuk ka lënë pasuri; ose b) trashëgimlënësi ka lënë vetëm pasuri të luajtshme, e asnjëri nga trashëgimtarët potencial nuk kërkon që të shqyrtohet ajo. Në raste të tilla, po që se midis trashëgimtarëve ka të atillë që nuk

[615] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 152.
[616] Po aty, shih nenin 153.
[617] Po aty, shih nenin 159.
[618] Po aty, shih nenin 154.
[619] Po aty, shih nenin 155 dhe 156.

kanë aftësi për të vepruar dhe ju mungon përfaqësuesi ligjor, gjykata është e obliguar për një gjë të tillë, ta lajmërojë organin e kujdestarisë.[620]

4.2.1.1. Rrjedha e zhvillimit të procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore

Pasi gjykata të konstatoj se është kompetente për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe se janë plotësuar edhe kushtet e tjera për fillimin e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore, ajo e cakton seancën. Në seancën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykata është e obliguar t'i therrasë më kohë personat e interesuar, më anë të letërthirrjes dhe t'i njoftojë më veprimet të cilat duhet të ndërmirren nga ana e tyre dhe më pasojat eventuale të cilat mund të shkaktohen nga moskryerja e veprimeve të tilla. Në rastin kur trashëgimlënësi ka lënë testament, për fillimin e procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykata ka për detyrë t'i njoftojë dhe t'i thërrasë në seancë edhe ata persona të cilët në bazë të vet ligjit mund të kishin të drejtë në trashëgimi.[621] Në rastet kur gjykata nuk e dinë se a ka lënë trashëgimlënësi trashëgimtarë, ajo me anë të shpalljes publike ka për detyrë t'i thërrasë personat që kanë të drejtë për trashëgim, që të paraqiten në gjykatë brenda afatit prej 6 muajsh, nga dita e publikimit të shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Kosovës". Shpallja ngjitet gjithashtu edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës, e në rast nevoje ajo publikohet edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Në këtë mënyrë, gjykata vepron edhe kur trashëgimtarit i është emëruar përfaqësuesi i përkohshëm nga shkaku se atij nuk i dihet vendbanimi, apo nga shkaku se trashëgimtari ose përfaqësuesi ligjor i tij, që i mungon përfaqësuesi me prokurë, ndodhet në botën e jashtme, kurse dërgimi i shkresave nuk ka mundur t'u bëhet sipas rregullave që aplikohen në Ligjin për Procedurën Kontestimore. Pas skadimit të afatit prej 6 muajve, gjykata e zhvillon seancën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, në bazë të deklaratës së kujdestarit të emëruar si dhe të dhënave të cilat i ka në disponim gjykata.[622]Sipas LPJK, në seancën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykata i shqyrtonë të gjitha çështjet më rëndësi që kanë të bëjnë me pasurinë e trashëgimlënësit, e në veçanti atë që i përket të drejtës së trashëgimit, madhësisë së pjesës trashëgimore dhe të drejtës së legatarit. Për këto të drejta, në parim gjykata vendosë, pasi t'i ketë marrë deklaratat e nevojshme nga personat e interesuar. Mirëpo,në rast se personat e interesuar nuk ardhur në seancë, përkundrejt thirrjes së rregullt të tyre, për të drejtat e tyre, gjykata vendosë në bazë të të dhënave që i posedon. Duhet theksuar se

[620] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 157.
[621] Po aty, shih nenin 159 dhe 160.
[622] Po aty, shih nenin 161.

gjykata, deklaratat e arritura më shkrim të personave që mungojnë në seancë, i merr parasysh deri në momentin e nxjerrjes së aktvendimit mbi trashëgiminë.[623] Është e rëndësishme të theksohet, gjithashtu, se më ligj personat e interesuar apo trashëgimtarët janë të autorizuar (dmth, kanë të drejtë), por jo edhe të detyruar që të deklarohen në lidhje më trashëgiminë. Kur trashëgimtari nuk e jep deklaratën për pranimin ose heqjen dorë nga trashëgimi, sipas ligjit ai konsiderohet se dëshiron të bëhet trashëgimtarë. Deklaratën e dhënë në mënyrë të vlefshme për pranimin e trashëgimisë, trashëgimtari nuk ka të drejtë që më vonë ta revokojë atë. Trashëgimtari deklaratën për pranimin ose heqjen dorë nga trashëgimi, duhet ta nënshkruajë ose të ve shenjën e gishtit tregues, ai vetë ose përfaqësuesi ligjor i tij. Kur trashëgimtari ose përfaqësuesi i tij, nuk është në gjendje të nënshkruajë deklaratën trashëgimore, mjafton që personit të autorizuar para të cilit e jep deklaratën, t'ia tregojë shkaqet për një gjë të tillë, kurse ai shkaqet e tilla duhet t'i theksoj në procesverbal. Nënshkrimi në dokumentin që e përmban deklaratën trashëgimore, ashtu si dhe nënshkrimi në prokurën (autorizimin) për dhënien e deklaratës trashëgimore, duhet të jenë të vërtetuar nga organi kompetent. Në deklaratën trashëgimore trashëgimtari duhet cekur se a e pranon, apo heqë dorë nga pjesa që i takon në bazë të ligjit apo në bazë të testamentit, ose se ajo ka të bëjë me pjesën e domosdoshme. Nëse mungon ky specifikim, konsiderohet se deklarata i përket të gjitha bazave për trashëgim.[624] Deklaratën gojore për heqjen dorë nga trashëgimi, trashëgimtari mund ta japë në gjykatën trashëgimore ose në ndonjë gjykatë tjetër kompetente. Me rastin e dhënies së deklaratës për heqjen dorë nga trashëgimi, gjykata ka për detyrë ta njoftojë trashëgimtarin me mundësinë që të heqë dorë vetëm në emër të vet ose edhe në emër të pasardhësve të tij.[625]

4.2.1.2. Ndërprerja e procedurës trashëgimore dhe udhëzimi i palëve në kontest civil

Në teorinë juridike vendase ashtu si dhe në atë krahasimore, ekziston pikëpamja sipas të cilës gjykata trashëgimore nuk është e autorizuar për t'i vërtetuar faktet kontestuese prej të cilave varet ekzistimi i të drejtës trashëgimore, i të drejtës se legut apo për ekzistimin e ndonjë të drejtë tjetër nga pasuria trashëgimore.[626] Përkatësisht, sipas teorisë juridike, kur çështja që e përbënë objektin e kontestit midis pjesëmarrësve është e natyrës faktike, gjykata trashëgimore e ndërpret

[623] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 162 par.1,2 dhe 3.
[624] Po aty, shih nenin 164 par.1,2,3,4,5,6 dhe 7.
[625] Po aty, shih nenin 165.
[626] Shih H. Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore. Prishtinë. Fq. 170.

procedurën dhe udhëzon që më padi të inicohet procedura kontestimore. Ndërsa, në rastin kur çështja është e natyrës juridike, gjykata trashëgimore e zgjidh vetë kontestin më anë të aktvendimit mbi trashëgiminë.[627] Ky qendrim i teorisë juridike përkrahet edhe nga ligjvënësi. Kështu, më LPJK është paraparë shprehimisht se "gjykata trashëgimore e ndërpretë procedurën dhe i udhëzon trashëgimtarët që të fillojnë procedurën kontestimore në gjykatë ose procedurën në organin administrativ po qe se ndërmjet tyre janë kontestuese faktet nga të cilat varet ndonjë e drejtë e tyre lidhur me trashëgimin."[628] Në këtë mënyrë, sipas nenit 166 par.2 i LPJK, gjykata do të veprojë sidomos kur janë kontestuese:

a) "faktet nga të cilat varet e drejta për trashëgim, e sidomos vlefshmëria ose përmbajtja e testamentit ose marrëdhënia e trashëgimtarit dhe e trashëgimlënësit në bazë të së cilës bëhet trashëgimi sipas ligjit;
b) faktet nga të cilat varet themelësia e kërkesës së bashkëshortit pas jetues dhe pasardhësve të trashëgimlënësit, që kanë bashkëjetuar me trashëgimlënësin në të njëjtën familje, që nga pasuria trashëgimore t'u veçohen sendet e ekonomisë shtëpiake që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përditshme;
c) faktet nga të cilat varet madhësia e pjesës trashëgimore, vlera e pjesës së detyrueshme (domosdoshme) e sidomos e pjesës që përfshihet (llogaritet) me pjesën trashëgimore;
d) faktet nga të cilat varet thëmelësia ligjore e përjashtimit të trashëgimtarëve nga trashëgimi, apo ekzistimi i shkaqeve për padenjësi për të trashëguar pasurinë e trashëgimlënësit;
e) faktet lidhur me rrethanën se a ka hequr dorë ndonjë trashëgimtar nga e drejta e trashëgimit."

Sipas LPJK, po qe se në rastet e përmendura më sipër, nuk ekziston kontesti rreth fakteve, por ndërmjet palëve ka konteste lidhur me zbatimin e normave juridike, gjykata trashëgimore nuk e ndërpretë procedurën, por vetë i shqyrton çështjet e natyrës juridike në procedurën trashëgimore.[629] Ky qendrim i ligjvënësit është në pajtim më atë të teorisë juridike të përmendur më lartë. Në rastin kur gjykata e ndërpret procedurën trashëgimore, ajo e cakton edhe një afat, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë, brenda të cilit duhet të inicohet procedura kontestimore. Pjesëmarrësi në procedurën trashëgimore që është udhëzuar për inicimin e

[627] Shih F. Brestovci (2006). E Drejta Procedurale Civile II. Prishtinë. Fq. 278.
[628] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 166 par.1.
[629] Po aty. Shih nenin 166 par.3.

procedurës kontestimore, ka për detyrë që ta njoftojë gjykatën se a ka vepruar sipas udhëzimit të këtillë brenda afatit të caktuar. Kur pala vepron sipas vendimit të gjykatës dhe e inicon brenda afatit të caktuar procedurën kontestimore, ndërprerja e procedurës trashëgimore zgjatë deri sa mos të përfundoj procedura kontestimore. Ndërsa, në rastin kur pala brenda afatit të caktuar nuk vepron sipas vendimit të gjykatës, procedura e ndërprerë vazhdohet dhe përfundon pa u marrë parasysh kërkesa lidhur me të cilën pala është udhëzuar të inicoj procedurën kontestimore. Mirëpo, në këtë rast aktvendimi i formës së prerë i gjykatës trashëgimore, nuk përbënë pengesë që pala më vonë të inicoj procedurën kontestimore. Në mënyrë të njëjtë veprohet edhe në rastin kur gjykata trashëgimore, pasurinë trashëgimore e ka shqyrtuar përkundrejt faktit se është dashur ta udhëzojë palën, që të inicoj procedurën kontestimore. Pra, edhe në këtë rast pala mundet pasi të përfundojë proceudra më aktvendim të formës së prerë të inicoj procedurën kontestimore.[630]

4.2.1.3. Aktvendimi për trashëgimi

Procedura trashëgimore përfundon më anë të aktvendimit përkatësisht kur gjykata në procedurën trashëgimore konstaton se cilëve persona u takon e drejta për trashëgim, ajo i shpallë këta persona trashëgimtarë me anë të aktvendimit.[631] Sipas nenit 171 par.2 i LPJK, aktvendimi për trashëgimi duhet t'i përmbajë këto të dhëna:

a) "emrin dhe mbiemrin e të vdekurit dhe emrin e njërit nga prindërit e tij, datën e lindjes dhe shtetësinë e trashëgimlënësit, e sipas mundësisë edhe numrin personal, kurse për trashëgimlënësin në martesë edhe mbiemrin që e kanë pasur para lidhjes së martesës;
b) paluajtshmërinë me të dhënat nga librat publike të nevojshme për regjistrim, si dhe sendet e luajtshme dhe të drejtat të tjera për të cilat gjykata ka konstatuar se bëjnë pjesë në pasurinë trashëgimore;
c) emrin dhe mbiemrin e trashëgimtarit, vendbanimin e tij, marrëdhënien e trashëgimtarit ndaj trashëgimlënësit, a e trashëgon trashëgimlënësin në bazë të ligjit apo të testamentit, e po qe se janë më tepër trashëgimtarë edhe pjesën trashëgimore të secilit, nga ta të shprehur me vijë thyese, e sipas mundësisë numrin personal unik të trashëgimtarit;
d) a është kushtëzuar, afatizuar, kufizuar apo ngarkuar, dhe në dobi të kujt, e drejta e trashëgimtarit;

[630] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 170 par.1,2,3,4 dhe 5.
[631] Po aty, shih nenin 171 par.1.

e) emrin e mbiemrin, vendbanimin e personave të cilëve u ka takuar në pasurinë trashëgimore e drejta e legatit apo ndonjë e drejtë tjetër nga trashëgimia me shënimin e saktë të kësaj të drejte, dhe sipas mundësisë numrin personal të tyre".

Është e rëndësishme të theksohet se gjykata në aktvendimin për trashëgimi nuk e përcakton mënyrën e ndarjes së pasurisë trashëgimore gjegjësisht gjykata nuk e përcakton se cilëve trashëgimtarëve u takojnë sendet e caktuara nga pasuria trashëgimore. Mirëpo, ekziston mundësia që vetë trashëgimtarët ta bëjnë një gjë të tillë, duke arritur marrëveshje mbi mënyrën e ndarjes së sendeve të caktuara nga pasuria trashëgimore.[632] Kështu, nëse trashëgimtarët gjatë procedurës trashëgimore arrijnë marrëveshje mbi mënyrën e ndarjes së pasurisë trashëgimore, gjykata marrëveshjen e arritur e inkorporon në aktvendimin për trashëgimin. Këtë rregull LPJK, e përmbanë në nenin 172 ku thuhet: "Në qoftë se në procedurën trashëgimore të gjithë trashëgimtarët dhe legatarët me marrëveshje i propozojnë gjykatës ndarjen dhe mënyrën e ndarjes, gjykata marrëveshjen e këtillë e inkorporon në aktvendimin për trashëgimin." Aktvendimin për trashëgimi gjykata trashëgimore ka për detyrë që t'ua dërgojë të gjithë trashëgimtarëve dhe legatarëve, si dhe personave që gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore kanë paraqitur ndonjë kërkesë lidhur më pasurinë trashëgimore. Ndërsa, kur aktvendimi për trashëgimi bëhet i formës së prerë, gjykata ka për detyrë që t'ia dërgojë atë edhe organit kompetent për tatime dhe mbajtje të librave publike.[633] Duhet theksuar se më LPJK, parashikohet edhe mundësia e dhënies së aktvendimit të pjesërishëm për trashëgimin. Këtë mundësi ligjvënësi, e ka paraparë për rastet kur përbërja e pasurisë trashëgimore vetëm pjesërisht është jokontestuese. Në një rast të këtillë, sipas LPJK, gjykata trashëgimore pasi të konstatojë kush janë trashëgimtarët apo legatarët, e jep aktvendimin e pjesërishëm për trashëgimin, me të cilin i cakton trashëgimtarët dhe legatarët dhe pjesën e pasurisë jokontestuese që hynë në pasurinë trashëgimore.[634] Sipas LPJK, me anë të aktvendimit për trashëgimin që ka marrë formë të prerë konsiderohet se janë vërtetuar këto fakte: a) se çka hynë në pasurinë trashëgimore; b) se kush është trashëgimtar i të vdekurit; c) sa është e madhe pjesa e pasurisë që i takon; d) se a i është kufizuar apo ngarkuar e drejta e trashëgimit dhe në cilën mënyrë; si dhe e) se a ekzistojnë dhe cilat të drejta të legatit ekzistojnë. E njëjta vlen edhe për aktvendimin e pjesërishëm për trashëgim në pikëpamje të asaj që është konstatuar me anë të tij. Faktet e konstatuara më

[632] Shih F. Brestovci (2006). Vepra e njëjtë. Fq.281.
[633] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 173.
[634] Po aty. Shih nenin 177.

aktvendim të formës së prerë për trashëgimin mund të kontestohen vetëm nga ana e personit që nuk është i lidhur me aktvendimin e këtillë.[635]Është e rëndësishme të theksohet se më aktvendimin e formës së prerë, konsiderohen të lidhur vetëm personat që si palë kanë marrë pjesë në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, apo që kanë qenë të ftuar për pjesëmarrje në te personalisht dhe rregullisht. Kjo rregull, sipas LPJK nuk vlen në rastet kur kemi të bëjmë me: "a) të drejtat të cilat për ta dalin nga testamenti i gjetur pas përfundimit të procedurës trashëgimore; b) të drejtën konstatimi i të cilës ka qenë i varur nga mënyra e zgjidhjes së ndonjë fakti kontestues në procedurën kontestimore ose administrative për inicimin e të cilës ka ekzistuar udhëzimi i gjykatës, apo është dashur të ekzistojë, po qe se kontesti nuk është zgjidhur para se të marrë formë të prerë aktvendimi për trashëgimin; c) në qoftë se janë plotësuar kushtet nën të cilat në procedurën kontestimore do të mund të propozohej përsëritja e procedurës e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë".[636]Mund të ndodhë që pasi aktvendimi për trashëgimin të marrë formë te prerë, të zbulohet pasuri e re, e cila nuk është shqyrtuar gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore. Në një rast të këtillë, gjykata nuk e shqyrtonë përsëri pasurinë trashëgimore, pra nuk inicohet procedurë e re trashëgimore. Mirëpo, pasurinë e re të gjetur, gjykata më aktvendim të ri e pjesëton në mbështetje të aktvendimit të mëparshëm për trashëgimin. Në rastin kur në procedurën trashëgimore të inicuar më pare, nuk është shqyrtuar pasuria trashëgimore, gjykata e shqyrtonë pasurinë e gjetur vetëm po qe se pasuria e tillë, përbëhet nga sendet e paluajtshme apo nga të drejtat që barazohen me sendet e këtilla. Ndërsa, kur pasuria e gjetur përbëhet nga sendet e luajtshme apo nga të drejtat që barazohen me sendet e tilla, gjykata e fillon procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore vetëm me kërkesën e personave të interesuar.[637] Mund të ndodhë se pasi të marrë formë të prerë aktvendimi për trashëgimi të gjendet edhe testamenti i trashëgimlënësit. Në këtë rast, sipas LPJK gjykata duhet ta shpallë testamentin dhe procesverbalin për shpalljen dhe kopjen e testamentit duhet t' ia dërgojë gjykatës trashëgimore, kurse origjinalin duhet ta mbajë për vete. Edhe në këtë rast, ashtu sikurse në rastin e gjetjes së pasurisë, gjykata trashëgimore nuk e shqyrtonë përsëri pasurinë trashëgimore, por ajo i njoftonë personat e interesuar për testamentin e shpallur dhe ia tërheqë

[635] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 178.
[636] Po aty, shih nenin 180.
[637] Po aty, shih nenin 182 par.1,2 dhe 3.

vërejtjen se të drejtat e veta në bazë të testamentit mund t'i realizojnë në procedurën kontestimore.[638]

4.2.1.4. Procedura në rastin kur është kompetent organi i shtetit të huaj

LPJK,përmbanë dispozita të veçanta edhe për rastin kur për zhvillimin e procedurës trashëgimore është kompetent organi i shtetit të huaj. Në një rast të këtillë, sipas LPJK, gjykata në territorin e të cilës ka vdekur trashëgimlënësi, pasi t'i arrijë aktvdekja, ka për detyrë të publikoj shpallje me të cilën i thërret të gjithë shtetasit e vendit të cilët pretendojnë se janë trashëgimtarë apo legatar apo edhe kreditor të trashëgimlënësit, që brenda afatit të caktuar në shpallje, t'i paraqesin në gjykatë kërkesat e veta. Afati i caktuar në shpallje nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë, e as më i gjatë se 6 muaj. Ky afat fillon të ecë nga dita e publikimit të shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Kosovës".[639] Përveç se në "Gazetën Zyrtare të Kosovës" shpallja bëhet edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës, e në rast nevoje edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Një ekzemplar i shpalljes duhet t'i dërgohet përfaqësuesit diplomatik apo konsullor të shtetit përkatës në vendin tonë. Gjykata nuk e bënë shpalljen publike, po qe se pasuria trashëgimore e cila ndodhet në vendin tonë është e vlerës së vogël.[640] Në rastin kur gjykata nuk e publikon shpalljen, pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit i dorëzohet organit kompetent të huaj, ose personit të cilin e autorizon organi i tillë, vetëm pasi të kalojnë 3 muaj, nga dita e vdekjes së shtetasit të huaj.[641]Po qe se ndonjë person që e konsideron veten trashëgimtarë apo legatar të trashëgimlënësit paraqet kërkesë në gjykatë, gjykata e mbanë pasurinë trashëgimore gjegjësisht një pjesë të saj, që është e nevojshme për mbulimin e kërkesës së tillë, deri sa mos të bëhet i formës së prerë vendimi i organit të huaj lidhur me kërkesën e tillë. Vendimin e formës së prerë të organit të huaj lidhur me kërkesën e paraqitur gjykata e shtetit tonë e ekzekuton mbi pasurinë trashëgimore ose pjesën e saj të mbajtur, e në rast se tepron diçka nga pasuria e mbajtur pas përmbushjes së kërkesës, atë gjykata ja dërgon organit të shtetit të huaj.[642]Në mënyrë të njëjtë,sipas LPJK, veprohet edhe në rastin kur ndonjë kreditor i trashëgimlënësit e paraqet në gjykatë kërkesën e tij që e ka ndaj trashëgimlënësit. Përkatësisht, në këtë rast gjykata i mbanë aq sende të luajtshme nga pasuria trashëgimore sa mjaftojnë për

[638] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009), Shih nenin 183 par.1 dhe 2.
[639] Po aty, shih nenin 186 par.1.
[640] Po aty, shih nenin 186 par.2 dhe 3.
[641] Po aty, shih nenin 186 par.4.
[642] Po aty, shih nenin 187 par.1 dhe 2.

mbulimin e kërkesës së këtillë. Sendet e këtilla mbahen deri sa mos të realizohet apo sigurohet në mënyrë të mjaftushëm kërkesa e kreditorit.[643]Duhet theksuar që LPJK, lejon mundësinë që shqyrtimi i pasurisë trashëgimore që përbëhet nga sendet e luajtshme, e shtetasit të huaj për të cilen është kompetent organi i huaj, të bëhet nga gjykata e shtetit tonë, po që se të gjithë trashëgimtarët që ndodhen në Kosovë, propozojnë që shqyrtimi i saj të bëhet në gjykatën e vendit tonë. Në këtë rast, sipas LPJK, gjykata e vendit tonë paraprakisht ka për të detyrë që t'i thërras trashëgimtarët dhe legatarët jashtë vendit tonë që brenda afatit 6 mujor, nga dita e dorëzimit të letërthirrjes, të paraqesin prapësimin e in kompetencës së gjykatës tonë, me kërcënim se shqyrtimin e pasurisë trashëgimore do ta bëjë gjykata e jonë.[644] Kur trashëgimtarët janë të njohur, mirëpo nuk i dihet vendbanimi atyre thirrja u dërgohet më anë të shpalljes që publikohet në "Gazetën Zyrtare të Kosovës", po ashtu në tabelën e shpalljeve të gjykatës, e në rast nevoje edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Një ekzemplar i shpalljes duhet t'i dërgohet përfaqësuesit diplomatik apo konsullor të shtetit përkatës që ndodhet në shtetin tone.[645]Nëse asnjëri nga trashëgimtarët ose legatarët jashtë shtetit tonë nuk parashtron prapësimin e inkompetencës së gjykatës tonë, brenda afatit 6 mujor, gjykata e jonë pas skadimit të këtij afati e bënë shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të shtetasit të huaj.[646]

[643] Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009). Shih nenin 188.
[644] Po aty, shih nenin 189 par.2.
[645] Po aty, shih nenin 189 par.3.
[646] Po aty, shih nenin 189 par.2.

4.3. Procedura trashëgimore në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri.

4.3.1. Një trajtim i shkurtër mbi rregullimin e procedurës trashëgimore në Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi.

Kompetenca e organit për zhvillimin e procedurës trashëgimore dhe mënyra e inicimit të procedurës. -Në Maqedoni procedura trashëgimore rregullohet më Ligjin për Procedurën Jokontestimore i Maqedonisë (tani e tutje LPJKMK). Sipas LPJKMK, për zhvillimin e procedurës trashëgimore kompetente është gjykata ose noteri si përfaqësues i gjykatës. Këtë rregull LPJKMK, e përmbanë në nenin 126 ku thuhet: "Për shqyrtimin e trashëgimisë qytetarit të Republikës së Maqedonisë lidhur me pronën e tij, e cila gjendet në Republikën e Maqedonisë ekskluzivisht është kompetent gjyqi i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht noteri si përfaqësues i gjykatës". Pra,në Maqedoni shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është kompetente ta bëjë gjykata respektivisht noteri si i autorizuar i gjykatës. Në procedurën trashëgimore, noterët veprojnë në bazë të autorizimit të dhënë nga gjykata trashëgimore. Sipas LPJKMK, kryetari i gjykatës trashëgimore, pasi të vërfikohet kompetenca e gjykatës, ka të drejtë që në pajtim me dispozitat e procedurës jokontestimore lëndën e trashëgimisë me të gjitha shkresat në afat prej 8 ditësh, nga dita kur lënda është pranuar në gjykatë, t'ia besojë për zgjidhje noterit me seli në rajonin e gjykatës trashëgimore.[647] Gjykata trashëgimore veprimin në lëndët trashëgimore apo zbatimin e procedurave trashëgimore ia besonë noterëve në bazë të rajoneve zyrtare të noterëve të përcaktuara me Ligjin për Noterinë. Kur në rajonin e gjykatës trashëgimore ka më tepër noterë, lëndët u ndahen në mënyrë të barabartë sipas renditjes alfabetike të mbiemrave që mbajnë noterët.[648] Noterët punët e besuara në procedurën trashëgimore janë të obliguar t'i kryejnë në pajtim më dispozitat e Ligjit për Procedurën Jokontesimore, të cilat aplikohen edhe nga gjykata.[649] Pra, për noterët vlejnë rregullat e njëjta si për gjykatat.Ndërsa, në pikëpamje territoriale kompetente për zhvillimin e procedurës trashëgimore, sipas LPJKMK, është gjykata në rajonin e të cilës trashëgimlënësi në momentin e vdekjes ka pasur vendbanim të përhershëm ose vendqëndrim. E në rast se trashëgimlënësi në momentin e vdekjes nuk ka pasur vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë, për zhvillimin e procedurës trashëgimore e

[647] Ligji për Procedurën Jokontestimore i Maqedonisë, shih nenin 126 par.2 dhe nenin 131 par.1.
[648] Po aty, shih nenin 135.
[649] Po aty, shih nenin 133 dhe 136.

kompetencës territoriale konsiderohet gjykata në rajonin e të cilës ndodhet trashëgimia. Ndërsa, në rastin kur asnjë pjesë e pasurisë trashëgimore nuk ndodhet në Republikën e Maqedonisë, gjykatën kompetente për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, e përcakton Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë.[650] Ndërsa, në lidhje më inicimin e procedurës trashëgimore, në LPJKMK, shprehimisht parashikohet rregulla, sipas të cilës procedura trashëgimore inicohet sipas detyrës zyrtare nga gjykata, posa gjykata të njoftohet së një person ka vdekur ose është shpallur i vdekur më vendim gjyqësor.[651] Duhet theksuar se për vdekjen e personit apo për shpalljen e personit të vdekur më vendim gjyqësor, gjykata trashëgimore njoftohet nga ofiqari i cili është kompetent të regjistrojë vdekjen në librin amzë të të vdekurve. Përkatësisht, sipas LPJKMK, ofiqari është i detyruar që në afat prej 30 ditësh, nga dita në të cilën e ka regjistruar vdekjen t'ia dërgojë akvdekjen gjykatës trashëgimore.[652] Në mënyrë të njëjtë si në Maqedoni, kompetenca e organit për zhvillimin e procedurës trashëgimore rregullohet edhe në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi. Duhet theksuar se procedura trashëgimore në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, rregullohet më Ligjin për Trashëgimi. Kurse, në Mal të Zi, procedura trashëgimore rregullohet më dispozitat e Ligjit për Procedurën Jokontestimore. Përkitazi më organin i cili është kompetent të zhvillojë procedurën trashëgimore në nenin 176 i Ligjit për Trashëgimi i Kroacisë (LTHR) jepet ky përcaktim: "procedurat për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore në shkallë të parë zhvillohen nga një gjyqtar i vetëm i gjykatës komunale ose nga një noter publik si përfaqësues i gjykatës." Ngjajshëm përcaktohet edhe më Ligjin për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës (LTBH), në nenin 200 par.1, ku thuhet: "procedura trashëgimore në shkallë të parë kryhet në një gjykatë komunale ose para një noteri si përfaqësues i gjykatës" Njëjtë parashikohet gjithashtu edhe më Ligjin për Procedurën Jokontestimore i Malit të Zi[653] (LPJKME). Pra, ashtu sikurse në Maqedoni edhe në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është gjykata ose noteri publik si përfaqësues i gjykatës. Ndërsa, në Slloveni dhe Serbi procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore zhvillohet nga gjykata, por jo edhe nga noterët. Pra, në Slloveni dhe Serbi noterët nuk janë të autorizuar që t'i shqyrtojnë rastet e trashëgimisë. Procedura trashëgimore në Slloveni, rregullohet nëpërmjet Ligjit për Trashëgimi i Sllovenisë (LTSI). Kurse, në Serbi procedura trashëgimore rregullohet më Ligjin për Procedurën Jokontestimore i Serbisë (LPJKRS). Ndërsa,

[650] Ligji për Procedurën Jokontestimore i Maqedonisë, shih nenin 129.
[651] Po aty, shih nenin 121.
[652] Po aty, shih nenin 142.
[653] Ligji për Procedurën Jokontestimore i Malit të Zi, shih nenin 94 par.1

në lidhje më kompetencën territoriale ashtu si në LPJKMK, edhe në LTHR, LTBH, LPJME, e gjithashtu edhe në LTSI dhe LPJKRS, saksionohet rregulla e njëjtë, sipas të cilës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore kompetencë territoriale ka gjykata, në territorin e të cilës trashëgimlënësi në momentin e vdekjes ka pasur vendbanimin e përhershëm ose vendqëndrimin. E nëse trashëgimlënësi, nuk ka pasur vendbanim e as vendqendrim në shtetin e vendit, e kompetencës territoriale konsiderohet gjykata në territorin e të cilës trashëgimlënësi ka lënë pjesën më të madhe të pasurisë.[654] LTHR,[655]LTBH,[656] LPJME,[657] LTSI[658] dhe LPJKRS,[659] nuk dallojnë nga LPJKMK,[660] as në lidhje më mënyrën e inicimit të procedurës trashëgimore. Sipas dispozitave të ligjeve në fjalë, gjykata është e obliguar të inicojë zyrtarisht procedurën trashëgimore, posa ajo e pranon aktvdekjen nga organi kompetent gjegjësisht nga ofiqari, i cili bënë regjistrimin e vdekjeve në librin amzë të të vdekurve.

Tabela 12: Mënyra e inicimit të procedurës dhe organi kompetent për zhvillimin e procedurës trashëgimore në Maqedoni, Serbi, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Slloveni dhe Mal të Zi.

Shteti	Mënyra e inicimit të procedurës	Organi kompetent për zhvillimin e procedurës
Maqedoni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Mal të Zi	Zyrtarisht nga gjykata.	Gjykata ose noteri publik.
Shqipëri	Më kërkesën e palëve.	Noteri publik.
Slloveni, Serbi.	Zyrtarisht nga gjykata.	Gjykata.

Veprimet e gjykatës pas inicimit të procedurës trashëgimore-Veprimet të cilat ndërmirren nga gjykata dhe pjesëmarrësit e tjerë pas inicimit gjegjësisht fillimit të procedurës, e deri në përfundimin e procedurës më aktvendim, janë në rregulluara në mënyrë të njëjtë në LPJKMK, LTHR, LTBH, LPJKME, LTSI dhe LPJKRS. Më poshtë, duke ju referuar dispozitave të ligjeve në fjalë, do ndalemi në trajtimin e disa prej veprimeve më të rëndësishme procedurale, të cilat

654 Shih LTHR (neni 177); LTBH (neni 201); LPJKME (neni 95); LPJKRS (neni 88); dhe LTSI (neni 177).
655 Ligjin për Trashëgiminë i Kroacisë (Gazeta Zyrtare e Kroacisë 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15). Shih nenin 164.
656 Ligji për Trashëgiminë i Bosnjes dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjes dhe Hercegovinës Nr 2/98, 39/04 i 73/05). Shih nenin 227.
657 Ligji për Procedurën Jokontestimore i Malit të Zi, shih nenin 97.
658 Ligji për Trashëgiminë i Slovenisë (Gazeta Zyrtare e Slovenisë Nr 15/76, 23/78; 17/91, 13/94, 40/94, 117/00, 67/01, 83/01, 31/13 dhe 63/16). Shih nenin 164.
659 Ligji për Procedurën Jokontestimore i Serbisë, shih nenin 89 par.1.
660 Ligji për Procedurën Jokontestimore i Maqedonisë, shih nenin 121.

mundësojnë marrjen e aktvendimit për trashëgimi. Siç dihet për kryerjen e veprimeve procedurale gjykata (ose noteri) cakton seanca gjyqësore. Në seancën për trashëgimi gjykata (noteri) më ftesë i thërret të gjithë personat e interesuar. (trashëgimtarët potencial). Sipas LPJKMK, LTSI, LTHR, LTBH, LPJKRS dhe LPJKME, në thirrjen për në seancë, gjykata (noteri) ka për detyrë t'i njoftojë personat e interesuar për fillimin e procedurës trashëgimore dhe mbi ekzistencën e mundshme të testamentit, dhe njëkohësisht t'i thërret personat e interesuar që të dorëzojnë testamentin më shkrim, gjegjësisht dokumentin për testamentin gojor nëse ndodhet tek ata, ose që të tregojnë për dëshmitarët e testamentit gojor. Në letërthirrje gjykata (noteri) gjithashtu ka për detyrë t'i paralajmërojë personat e interesuar se deri në përfundimin e procedurës, mund të japin deklaratë për pranimin ose heqjen dorë nga trashëgimia, dhe se nëse nuk vijnë në seancë ose nuk japin deklaratë, për të drejtën e tyre do të vendosë në bazë të të dhënave me të cilat disponon. Në rastin kur trashëgimlënësi ka lënë testament, gjykata (noteri) ka për detyrë që t'i thërrasë në seancë edhe ata persona të cilët në bazë të ligjit do të mund të kenë të drejtën e trashëgimisë.[661] Ndërsa, në rastin kur gjykata (noteri) nuk ka njohuri nëse trashëgimlënës ka lënë trashëgimtarë, sipas LPJKMK, LTSI, LTHR, LTBH, LPJKRS dhe LPJKME, gjykata (noteri) ka për detyrë që më anë të shpalljes publike t'i thërret personat, të cilët pretendojnë që ju takon e drejta e trashëgimisë, që të lajmërohen në afat prej 1 viti, (respektivisht 6 muajve sipas LPJKME) nga dita e publikimit të shpalljes. Shpallja publikohet në gazetën zyrtare të shtetit si dhe vendoset në tabelën për shpallje të gjykatës. Pas skadimit të afatit prej 1 viti (respektivisht 6 muajve sipas LPJKME) gjykata e shqyrtonë trashëgiminë në bazë të deklaratës së kujdestarit dhe të dhënave më të cilat disponon.[662] Në seancën për shqyrtimin e trashëgimisë gjykata (noteri) diskuton për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë, e veçanërisht për të drejtën e trashëgimisë, për madhësinë e pjesës trashëgimore të çdo trashëgimtari etj. Për këto çështje gjykata (noteri) vendos, sipas rregullit, pasi trashëgimtarët t'i japin deklaratat për pranimin apo heqjen dorë nga trashëgimi. Për të drejtën e personave të cilët nuk kanë ardhur në seancë, ndërsa në mënyrë të rregullt janë thirrur, gjykata (noteri) vendosë në bazë të të dhënave me të cilat disponon, duke marrë parasysh deklaratat e tyre me shkrim që do të arrijnë deri në marrjen e aktvendimit. [663]

[661] Shih LPJKMK (neni 167); LTBH (neni 234); LTSI (neni 205); LTHR (neni 217); LPJKME (neni 125); LPJKRS (neni 115).
[662] Shih LPJKMK (neni 168); LTBH (neni 235); LTSI (neni 206); LTHR (neni 218); LPJKME (neni 126); LPJKRS (neni 116).
[663] Shih LPJKMK (neni 171); LTBH (neni 236); LTSI (neni 207); LTHR (neni 219); LPJKME (neni 127); LPJKRS (neni 117).

Ndërprerja e procedurës trashëgimore dhe udhëzimi i palëve në kontest civil- Sipas LPJKMK, LTSI, LTHR, LTBH, LPJKRS dhe LPJKME, nëse ndërmjet trashëgimtarëve lind kontesti për faktet ose për zbatimin e të drejtës, gjykata (noteri) e ndërprenë procedurën trashëgimore dhe i udhëzon pjesëmarrësit që të inicojnë procedurën kontestimore ose administrative.[664] Në këtë mënyrë, sipas ligjeve të cituara më sipër, gjykata është e autorizuar që të veprojë sidomos kur kontestuese janë këto fakte:

a) faktet nga të cilat varet e drejta e trashëgimisë, plotfuqishmëria ose përmbajtja e testamentit ose raporti i trashëgimtarëve dhe trashëgimlënësit mbi bazën e të cilave trashëgohet sipas ligjit;
b) faktet nga të cilat varet baza e kërkesës së bashkëshortit të mbijetuar dhe personave më të cilët trashëgimlënësi ka jetuar në bashkësi të përhershme, që nga trashëgimia t'u ndahen sendet e amvisërisë që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përditshme;
c) faktet nga të cilat varet madhësia e pjesës trashëgimore, dhe veçanërisht përllogaritja e pjesës trashëgimore;
d) faktet nga të cilat varet baza e përjashtimit të trashëgimtarëve të domosdoshëm ose baza e shkaqeve për padenjësi;
e) faktet lidhur me rrethanën se a ka hequr dorë ndonjë trashëgimtar nga trashëgimia.[665]

Në qoftë se në këto raste, ndërmjet pjesëmarrësve nuk ekziston kontesti rreth fakteve, por rreth zbatimit të së drejtës, gjykata (noteri) nuk e ndërprenë procedurën trashëgimore, por çështjet juridike i shqyrtonë vetë.[666] Gjykata (noteri) kur e ndërprenë procedurën e cakton një afat (zakonisht 30 ditë), brenda të cilit duhet të inicohet procedura kontestimore ose administrative. Në qoftë së pjesëmarrësi nuk veprojnë në afat të caktuar më aktvendim të gjykatës (noterit), shqyrtimin e trashëgimisë gjykata (noteri), do ta vazhdojë pa marrë parasysh kërkesat për shkak të të cilave pjesëmarrësi ka qenë i udhëzuar të inicojë procedurën kontestimore përkatësisht administrative. Ndërsa, kur pjesëmarrësi vepron në bazë të aktvendimit të gjykatës (noterit), ndërprerja e procedurës do të zgjasë përderisa zgjat procedura kontestimore përkatësisht administrative. Në rastet kur gjykata (noteri) nuk e ka udhëzuar palën që të inicojë procedurën kontestimore apo administrative, kurse një gjë të tillë është dashur ta bëjë, apo kur

[664] Shih LPJKMK (neni 173 par.1); LTBH (neni 239 par.1); LTSI (neni 210 par.1); LTHR (neni 222 par.1); LPJKME (neni 129 par.1); LPJKRS (neni 119 par.1).
[665] Po aty, shih LPJKMK (neni 173 par.2); LTBH (neni 239 par.2); LTSI (neni 210 par.2); LTHR (neni 222 par.2); LPJKME (neni 129 par.2); LPJKRS (neni 119 par.2).
[666] Po aty, shih LPJKMK (neni 173 par.3); LTBH (neni 239 par.3); LTSI (neni 210 par.3); LTHR (neni 222 par.3); LPJKME (neni 129 par.3); LPJKRS (neni 119 par.2).

pjesëmarrësi nuk ka vepruar sipas udhëzimit të gjykatës (noterit), dhe gjykata (noteri) e ka shqyrtuar trashëgiminë, në këtë rast plotëfuqishmëria e aktvendimit për trashëgimi nuk është pengesë që pala më vonë të inicojë procedurën kontestimore.Pra, lejohet që pala të inicojë procedurën kontestimore për realizimin e kërkesës së vetë edhe pasi të përfundojë procedura trashëgimore më aktvendim të plotëfuqishëm.[667]

Aktvendimi për trashëgimin -Sipas LPJKMK, LTSI, LTHR, LTBH, LPJKRS dhe LPJKME, kur gjykata (noteri) konstaton se cilëve persona u takon e drejta në trashëgimi, ajo me aktvendim i shpallë këta persona trashëgimtarë.[668] Sipas dispozitave të ligjeve të cituara më sipër, aktvendimi për trashëgimi duhet t'i përmbajë këto të dhëna:

a) emrin dhe mbiemrin e trashëgimlënësit dhe emrin e njërit nga prindërit e tij, datën e lindjes dhe shtetësinë e trashëgimlënësit, e nëse është e mundur edhe numrin personal, kurse për trashëgimlënësin në martesë edhe mbiemrin që e kanë pasur para lidhjes së martesës;
b) sendet e paluajtshme me të dhënat nga librat publike të nevojshme për regjistrim, si dhe sendet e luajtshme dhe të drejtat të tjera për të cilat gjykata ka konstatuar se bëjnë pjesë në pasurinë trashëgimore;
c) emrin dhe mbiemrin, profesionin, vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin e trashëgimtarit, marrëdhënien e tij ndaj trashëgimlënësit, a trashëgon si trashëgimtar ligjor ose testamentar, ndërsa nëse ka më tepër trashëgimtarë edhe pjesën trashëgimore të secilit, nga ta të shprehur me vijë thyese, e sipas mundësisë numrin personal unik të trashëgimtarit.
d) a është e kushtëzuar e drejta e trashëgimtarit apo është e afatizuar, kufizuar apo ngarkuar, dhe në dobi të kujt;
e) emrin dhe mbiemrin, profesonin dhe vendbanimin ose vendqëndrimin e personave të cilëve u ka takuar në trashëgimi e drejta e legatit, apo ndonjë e drejtë tjetër nga trashëgimia me shënimin e saktë të kësaj të drejtë dhe sipas mundësisë numrin personal të tyre.[669]

[667] LPJKMK (neni 176); LTBH (neni 242); LTSI (neni 213); LTHR (neni 225); LPJKME (neni 132).
[668] Shih LPJKMK (neni177 par.1); LTBH (neni 243 par.1); LTSI (neni 214 par.1); LTHR (neni 226 par.1); LPJKME (neni 133 par.1); LPJKRS (neni 122 par.1).
[669] LPJKMK (neni 177 par.2); LTBH (neni 243 par.2); LTSI (neni 214 par.2); LTHR (neni 226 par.2); LPJKME (neni 133 par.2); LPJKRS (neni 122 par.2).

Aktvendimi për trashëgimi gjykata (noteri) duhet që t'ia dërgojë të gjithë trashëgimtarëve dhe legatarëve, si dhe personave që gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore kanë paraqitur ndonjë kërkesë në lidhje më trashëgiminë. Kur aktvendimi për trashëgimi bëhet i formës së prerë, gjykata (noteri) ka për detyrë që atë t'ia dërgojë edhe organit administrativ kompetent për mbajtjen e librave publik. Aktvendimi i formës së prerë krijon efekte juridike ndaj personave që kanë marrë pjesë në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë, ndërsa kur atyre nuk u është pranuar e drejta, kërkesën e vet mund ta realizojnë në procedurën kontestimore.[670]

4.3.2. Një trajtim i shkurtër mbi rregullimin e procedurës trashëgimore në Shqipëri

Kompetenca e organit për zhvillimin e procedurës trashëgimore dhe mënyra e inicimit të procedurës.-Në Shqipëri rregullimi juridik i procesit të trashgimisë dallon nga rregullimi juridik në Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi. Sipas legjilacionit shqiptar, procedura për shqyrtimin e trashëgimisë nuk inicohet sipas detyrës zyrtare nga gjykata. Shqyrtimi i rasteve të trashëgimisë, sipas legjislacionit shqiptar konkretisht KCSH, nuk hynë në kompetencë të gjykatave, por gjykimi i rasteve të trashëgimisë konsiderohet kompetencë ekskluzivë e notërve.Sipas KCSH, kompetent për gjykimin e rasteve të trashëgimisë konsiderohet noteri i njësisë vendore në territorin e të cilës trashëgimlënësi në momentin e vdekjes ka pasur vendbanimin ose noteri i njësisë vendore në territorin e të cilës ndodhet pasuria e trashëgimlënësit.[671]

Procedura e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore.-Sipas rregullave të përmbajtura në Ligjin për Noterinë e Republikës së Shqipërisë (tani e tutje LNRSH), procesi i shqyrtimit të trashëgimisë zhvillohet kësisoj: së pari, noteri pasi të pranojë kërkesën për shqyrtimin e trashëgimisë nga personat e interesuar (trashëgimtarët potencial), e verifikon kompetencën vendore të tij. Më pas, noteri e dërgon një kërkesë pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, të cilës ja bashkangjitë një kopje të kërkesës së personit të interesuar (trashëgimtarit) dhe një kopje të certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit.[672] Pas marrjes së kërkesës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 3 ditëve, kontrollon në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë, se a ka lënë trashëgimlënësi testament dhe mos është

[670] LPJKMK (neni 183 dhe 184); LTBH (neni 244-249); LTSI (neni 215 dhe220); LTHR (neni 227 dhe 232); LPJKME (neni 134); LPJKRS (neni 123).
[671] Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013). Shih nenin 348.
[672] Ligj Nr.7829, datë 1.6.1994 Për Noterinë. (Ndryshuar për herë të fundit më ligjin nr. 131/2013, datë 29.4.2013). Shih nenin 53/1 pika a dhe b.

shqyrtuar pasuria trashëgimore dhe është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore apo testamentare nga ndonjë noter tjetër.[673] Brenda 3 ditëve pas marrjes së përgjigjes nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, noteri në rastin kur ekziston dëshmia e trashëgimisë ose kur ekziston testamenti i shkruar, e drejton personin e interesuar (trashëgimtarin) tek noteri i cili e ka lëshuar dëshminë, apo të noteri tek i cili ndodhet testamenti. Ndërsa, në rastin kur nuk ekziston dëshmia e trashëgimisë gjegjësisht kur trashëgimia nuk është trajtuar, noteri procedon me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore apo testamentare, në përputhje më rregullat e parapara në Kodin Civil dhe e regjistron dëshminë e trashëgimisë në Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë.[674] Në rastin kur lëshon dëshminë e trashëgimisë testamentare, noteri ka për detyrë të kontrollojë nëse disponimet me testament të testatorit janë të vlefshme, sipas rregullave të parapara në Kodin Civil. Kur disponimi me testament është i pavlefshëm, noteri, me vendim të arsyetuar, e shpalle të pavlefshëm testamentin dhe vazhdon me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore. Në rast se deklarohen të pavlefshme vetëm disa nga disponimet e testamentit, dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet vetëm për atë pjesë të disponimeve të testamentit që deklarohen të pavlefshme.[675] Sipas nenit 53 par.1 i LNRSH, dëshmia e trashëgimsië duhet t'i përmbajë këto të dhëna:

a) "bazën ligjore dhe elementet, mbi të cilat noteri konsiderohet që ka kompetencë territoriale për të lëshuar dëshminë;
b) të dhënat e kërkuesit: emri, mbiemri, gjinia, data dhe vendi i lindjes, gjendja civile, shtetësia, numri i identitetit, adresa dhe marrëdhënia me trashëgimlënësin;
c) të dhënat e trashëgimlënësit: emri, mbiemri, gjinia, data dhe vendi i lindjes, gjendja civile, shtetësia, numri i identitetit, adresa në datën e vdekjes, data dhe vendi i vdekjes;
d) të dhënat e trashëgimtarëve: emri, mbiemri, gjinia, data dhe vendi i lindjes, gjendja civile, shtetësia, numri i identitetit, adresa;
e) të dhëna mbi regjimin pasuror martesor të trashëgimlënësit;
f) të dhëna mbi padenjësinë ose heqjen dorë nga trashëgimia, nëse ka;
g) të dhëna mbi legun dhe barrën, nëse ka;
h) pjesët takuese të secilit prej trashëgimtarëve;
i) çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga legjislacioni në fuqi".

673 Ligj Nr.7829, datë 1.6.1994 Për Noterinë. (Ndryshuar për herë të fundit më ligjin nr. 131/2013, datë 29.4.2013). Shih nenin 53/1.
674 Po aty, shih nenin 53/1.
675 Po aty, shih nenin 53.

Sipas LNRSH, noteri duhet ta mbajë origjinalin e dëshmisë së trashëgimisë, kurse kërkuesit ose çdo personi, që ka një interes të ligjshëm, i lëshohen një ose disa kopje të dëshmisë së trashëgimisë, të njësuara me origjinalin. Noteri duhet t'i shënojë në një regjistër të posaçëm të dhënat e çdo personi, të cilit i ka lëshuar një kopje të dëshmisë së trashëgimisë.[676] Gabimet e bëra në shkrim në dëshminë e trashëgimisë p.sh., në lidhje më caktimin e pjesëve takuese, mund të përmirësohen në çdo kohë nga noteri kryesisht ose me kërkesën e çdo personi, që ka një interes të ligjshëm. Për çdo ndreqje të gabimeve në dëshminë e trashëgimisë, noteri ka për detyrë t'i njoftojë të gjithë personat, të cilëve u ka lëshuar një kopje të njësuar të dëshmisë së trashëgimisë.[677] Sipas LNRSH, në rastin kur më vendim gjyqësor të formës së prerë është pranuar padia për pavlefshmërinë e testamentit, për pjesëtimin e trashëgimisë apo për atë që rrjedh nga trashëgimia dhe ky vendim ka sjell efekte mbi përmbajtjen e dëshmisë së trashëgimisë, noteri është i obligurar që brenda 3 ditëve nga marrja dijeni, ta revokojë më vendim dëshminë fillestare të trashëgimisë dhe të lëshojë një dëshmi të re. Pas lëshimit të dëshmisë së re të trashëgimisë, noteri ka për detyrë ta regjistroj atë në Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë, së bashku me vendimin për revokimin e dëshmisë fillestare të trashëgimisë. Përveç padive që rrjedhin nga trashëgimia, padive për pavlefshmërinë e testamentit, padive për pjesëtimin e trashëgimit,[678]ndaj çdo veprimi ose vendimi të noterit, lejohet të bëhet edhe ankim i posaçëm në gjykatë, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.[679]

[676] Ligj Nr.7829, datë 1.6.1994 Për Noterinë. (Ndryshuar për herë të fundit më ligjin nr. 131/2013, datë 29.4.2013). shih nenin 53/1.
[677] Po aty, shih nenin 53/2.
[678] Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë (Miratuar më ligjin nr 8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar më ligjet nr. 8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë 27.5. 1999; nr. 8335, datë 18.10. 1999; nr. 8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008). Shih nenin 46.
[679] Ligj Nr.7829, datë 1.6.1994 Për Noterinë. (Ndryshuar për herë të fundit më ligjin nr. 131/2013, datë 29.4.2013). Shih nenin 53/4.

Përfundimi

Në përfundim të këtij kapitulli do të ndalemi në dallimet kryesore në lidhje më rregullimin e procedurës trashëgimore në Kosovë, Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Shqipëri dhe Mal të Zi. Dallimet kryesore rezultojnë në rregullimin e kompetencës së organit për zhvillimin e procedurës trashëgimore dhe në mënyrën e inicimit të procedurës trashëgimore. Kështu, sipas Ligjit për Procedurën Jokontestimore i Kosovës (më të cilin rregullohet procedura trashëgimore), kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është gjykata. Mirëpo, në praktikë duke u bazuar në Ligjin për Noterinë i Kosovës, shqyrtimi i pasurisë trashëgimore bëhet edhe nga noterët. Sipas Ligjit për Noterinë i Kosovës, noterët janë të autorizuar që t'i zhvillojnë edhe procedurat trashëgimore jokontestimore. Këto zbrazëtira ligjore, kanë bërë që në praktikë të krijohet konfuzion, lidhur më juridiksionin e noterëve në çështjet e trashëgimisë. Pra,në mënyrë që të përcaktohet roli i noterëve në çështjet e trashëgimisë është e nevojshme që të ndryshohet LPJK. Ndërsa më ligjet pozitive më të cilat rregullohet procedura trashëgimore në Maqedoni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, parashikohet në mënyrë të qartë se shqyrtimi i pasurisë trashëgimore, përveç nga gjykata mund të bëhet edhe nga noterët e autorizuar nga gjykata trashëgimore.Kurse, në Serbi dhe Slloveni, kompetente për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore konsiderohet vetëm gjykata. Në Shqipëri kompetenca e organit për zhvillimin e procedurës trashëgimore dhe inicimi i procedurës si dhe në përgjithësi rregullimi në tërësi i procesit të trashgimisë dallon nga rregullimi juridik në Kosovë, Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi. Sipas legjilacionit shqiptar, procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore nuk inicohet sipas detyrës zyrtare nga gjykata. Përkatësisht, shqyrtimi i rasteve të trashëgimisë sipas legjislacionit shqiptar nuk hynë në kompetencë të gjykatave, por gjykimi i rasteve të trashëgimisë konsiderohet kompetencë ekskluzivë e notërve.

KAPITULLI V

ANALIZA E TË DHËNAVE DHE GJETJEVE TË HULUMTIMIT

5. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit

Në kapitujt e mëparshëm është analizuar rregullimi ligjor i trashëgimisë ligjore dhe asaj testamentare, si dhe procedurës trashëgimore në një vështrim krahasimor në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Kroaci, Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi.Ndërsa,në këtë kapitull trajtohen çështje të rëndësishme në lidhje më trashëgiminë ligjore dhe testamentare si dhe më procesin e trashëgimisë, në aspektin e praktikës gjyqësore kosovare. Në këtë kapitull bëhet analizimi i të dhënave dhe gjetjeve të hulumtimit të kryer në disa Gjykata Themelore në Kosovë, përkatësisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Prizren dhe Pejë. Ky hulumtim është orientuar në mbledhjen e të dhënave për rastet trashëgimore të inicuara dhe të zgjidhura në gjykatat e përfshira në studim për gjatë përiudhës 2003-2014, kryesisht ky hulumtim është fokusuar në identifikimin dhe analizimin e të dhënave në lidhje më: mënyrën e inicimit të procedurës trashëgimore; numrin e trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje dhe cilësia e tyre; numrin e trashëgimtarëve të cilët kanë trashëguar dhe sipas cilës bazë juridike gjegjësisht më testament apo më ligj; numrin e trashëgimtarëve të cilët kanë hequr dorë nga trashëgimia dhe në favor të kujt; rastet në të cilat procedura është ndërprerë për shkak të lindjes së kontestit midis palëve; rastet trashëgimore për të cilat procedura është pezulluar për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtjen e përjetshme, etj.Në këtë kapitull analizohet gjithashtu edhe rezultati i pyetësorit/anketës të realizuar më qytetar, në lidhje më të drejtën e gruas në trashëgimi. Ky pyetësor është realizuar më qëllim identifikimi dhe analizimi të faktorëve, që ndikojnë në mos përfshirjen e mjaftueshme të grave në trashëgimi. Në fillim të kapitullit, shpjegohet qëllimi, pyetjet hulumtuese, hipotezat, zgjedhja e mostrës dhe procedura e mbledhjes së të dhënave. Më pas, analizohen të dhënat dhe gjetjet kryesore të hulumtimit në gjykata dhe pyetësorit të realizuar më qytetarë.

5.1 Qëllimi dhe procedura e hulumtimit

5.1.1. Qëllimi i hulumtimit

Hulumtimi është realizuar më qëllim të vlerësimit (testimit) të hipotezave të ngritura në këtë punim. Rikujtojmë se hipotezat e ngritura në këtë punim janë:

H1: "Në Kosovë procedura për shqyrtimin e trashëgimisë nuk inicohet konform ligjit."

H1.1 *"Gjykatat në Kosovë nuk inicojn procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë sipas detyrës zyrtare siç parashihet më ligj, por kjo bëhet vetëm më propozim të palëve."*

H1.2 *"Organi komunal i gjendjes civile nuk e kryen detyren ligjore që në afatin e paraparë më ligj të dërgojë aktvdekjen në gjykatë."*

H2: "Në Kosovë nuk është në praktikë lënia e testamenteve, trashëgimia gati në të gjitha rastet ndahet në mungesë të testamentit."

H3: "Në Kosovë numri i femrave të cilat e realizojnë të drejtën e trashëgimisë në raport më meshkujt, është shumë i ulët."

H3.1 *"Trashëgimtarët femra sidomos kur thirren në trashëgimi në statusin e fëmijës së trashëgimlënësit, ato në shumicën e rasteve heqin dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve."*

Ndërsa, pyetjet hulumtuese të cilat parashtrohen në këtë punim janë:

P1. Si bëhet inicimi i procedurës trashëgimore në praktikë?

P1.1. A ekziston bashkëpunimi adekuat ndërmjet organit komunal dhe gjykatës në veprimet që duhet të ndërmirren më rastin e inicimit të procedurës trashëgimore?

P1.2. Sa kohë kalon nga vdekja e trashëgimlënësit dhe inicimit të procedurës trashëgimore, respektivisht a ndodhë se procedura trashëgimore të inicohet edhe shumë vite pas vdekjes së trashëgimlënësit dhe cilat janë pasojat juridike?

P2. Cilat nga dy bazat juridike të thirrjes në trashëgimi dominon në praktikë?

P3. Sa shënon përqindja e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj të cilët e realizojnë të drejtën e trashëgimisë?

P4. Cilat nga format e testamenteve të njohura më ligj,aplikohet më së shumti nga ana e trashëgimlënësve?

P5. Cilat janë shkaqet për të cilat ndërprehet dhe pezullohet procedura trashëgimore më së shpeshti në praktikë?

P6. Cilët janë faktorët kryesore që ndikojnë në mos përfshirjen e grave në trashëgimi ?

- P6.1. A kanë ndikim sot normat zakonore në marrëdhëniet e trashëgimisë, e sidomos kur bëhet fjalë për të drejtën trashëgimore të gruas?
- P7. Kush e ka rolin kryesor në ngritjen e vetëdijes në kontekstin e barazisë në mes femrave dhe meshkujve në trashëgimi?

Në përpjekje për të ofruar një informacion sa më të saktë lidhur më çështjet e ngritura në këtë punim, është realizuar hulumtimi në gjykata dhe anketa (pyetësori) më qytetarët. Hulumtimi në gjykata është orientuar në mbledhjen e të dhënave për rastet trashëgimore, të inicuara dhe të zgjidhura për gjatë periudhës 2003-2014, në gjykatat e përfshira në studim.Pra,objekt i hulumtimit në gjykata janë lëndët trashëgimore të inicuara dhe zgjidhura për gjatë periudhës 2003-2014, më qëllim identifikimi dhe analizimi të të dhënave në lidhje më:

- mënyrën e inicimit të procedurës trashëgimore;
- numrin e trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje dhe cilësia e tyre;
- numrin e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj të cilët kanë trashëguar dhe sipas cilës bazë juridike gjegjësisht më testament apo më ligj;
- format e testamenteve në bazë të të cilave është ndarë trashëgimia;
- numrin e trashëgimtarëve të cilët kanë hequr dorë nga trashëgimia dhe në favor të kujt;
- rastet në të cilat procedura është ndërprerë për shkak të lindjes së kontestit midis palëve;
- rastet trashëgimore për të cilat procedura është pezulluar për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtjen e përjetshme.

Ndërsa, hulumtimi më qytetarë (anketa) është fokusuar në mbledhjen e të dhënave në lidhje më identifikimin e faktorëve kryesore, që ndikojnë në mos realizimin e të drejtës së gruas në trashëgimi.

5.1.2 Instrumentët e kërkimit

Për mbledhjen e të dhënave për pyetjet hulumtuese janë përdorur këto instrumente të kërkimit: a) studimi i dokumentacionit; b) formularët; c) vrojtimi dhe d) pyetësorët.

Tabela: 13. Pyetjet hulumtuese dhe instrumentët e përdorura të kërkimit

Pyetja hulumtuese	Instrumenti i kërkimit
1. Si bëhet inicimi i procedurës trashëgimore në praktikë?	Studimi i dokumentacionit, formulari.
2. Sa kohë kalon nga vdekja e trashëgimlënësit dhe inicimit të procedurës trashëgimore?	Studimi i dokumentacionit, formulari.
3. Cilat nga dy bazat juridike të thirrjes në trashëgimi dominon në praktikë?	Studimi i dokumentacionit, formulari.
4. Cilat nga format e testamenteve të njohura më ligj, aplikohet më së shumti nga ana e trashëgimlënësve?	Studimi i dokumentacionit, formulari.
5. A u njihet në praktikë të gjithe personave pa dallime e drejta e barabartë për trashëgimi apo bëhen dallime në baza të ndryshme?	Studimi i dokumentacionit. Pyetësorët.
6. Sa nga trashëgimtarët e përfshirë në aktvdekje (femra dhe meshkuj) e realizojnë të drejtën e trashëgimisë ?	Studimi i dokumentacionit, formulari.
7. Cilat janë shkaqet për të cilat ndërprehet dhe pezullohet procedura trashëgimore më së shpeshti në praktikë?	Studimi i dokumentacionit, formulari.
8. A kanë ndikim sot normat zakonore në marrëdhëniet e trashëgimisë?	Anketa/pyetësorët.
9. Cilët janë faktorët kryesore që ndikojnë në mos përfshirjen e grave në trashëgimi ?	Anketa/pyetësorët.
10. Kush e ka rolin kryesor në ngritjen e vetëdijes në kontekstin e barazisë në mes femrave dhe meshkujve në trashëgimi ?	Anketa/pyetësorët.

5.2. Zgjedhja e mostrës

5.2.1. Zgjedhja e mostrës për gjykata dhe procedura e realizimit të hulumtimit

Siç e kemi përmendur në kapitullin paraprak, sipas LPJK, kompetente për zhvillimin e procedurës trashëgimore në shkallë të parë janë Gjykatat Themelore. Vlen të ceket se në Kosovë veprojnë 7 Gjykata Themelore:

1. Gjykata Themelore e Prishtinës me seli në Prishtinë, e cila vepron për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Gllogovcit dhe të Graçanicës;
2. Gjykata Themelore e Gjilanit me seli në Gjilan, e cila vepron për territorin e Komunës së Gjilanit, Kamenices, Novobërdës, Ranillugut. Parteshit, Vitisë, Kllokotit dhe Vërbocit;
3. Gjykata Themelore e Prizrenit me seli në Prizren, e cila vepron për territorin e Komunës së Prizrenit, Dragashit, Suharekës dhe Mamushës;
4. Gjykata Themelore në Gjakovë me seli në Gjakovë, e cila vepron për territorin e Komunës së Gjakovës, Malishevës, dhe Rahovecit;
5. Gjykata Themelore e Pejës me seli në Pejë, e cila vepron për territorin e Komunës së Pejës, Deçanit, Junikut, Istogut dhe Klinës;
6. Gjykata Themelore e Ferizajit me seli në Ferizaj, e cila vepron për territorin e Komunës së Ferizajit, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpcës dhe Hanit të Elezit;
7. Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë**,** e cila vepron për territorin e Komunë së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrrisë[680].

Përveç selisë kryesore, secila Gjykatë Themelore ka edhe degët e veta, të shpërndara në vende të ndryshme.[681]

Në këtë hulumtim më përjashtim të Gjykatës Themelore në Gjakovë, janë përfshirë të gjitha Gjykatat Themelore. Pra, hulumtimi është zhvilluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjykatën Themelore në Ferizaj, Gjykatën Themelore në Gjilan, Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Gjykatën Themelore në Pejë si dhe në Gjykatën Themelore në Prizren. Në hulumtim nuk është përfshirë Gjykata Themelore në Gjakovë, për arsye se deri në organizimin e ri të

[680] Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Prishtinë: Viti V/Nr.79/24 Gusht 2010). Shih nenin 9 par.2 pikat 1-7).
[681] Po aty, shih nenin 10.

gjykatave në Kosovë gjegjësisht deri në vitin 2013, për territorin e komunës së Gjakovës kompetente ka qenë Gjykata e Pejës. Dhe duke qenë se objekt i këtij hulumtimi janë lëndët trashëgimore të inicuara dhe të zgjidhura për gjatë përiudhës 2003-2014, është vendosur që hulumtimi të mos zhvillohet në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

5.2.1.1 Procedura e mbledhjes së të dhënave në Gjykata

Procesi i mbledhjes së të dhënave në gjykata ka zgjatë një përiudhë 9 mujore, gjatë vitit 2015 dhe vitit 2016. Së pari, në secilen gjykatë të përfshirë në studim, është paraqitur kërkesë më shkrim për lejimin e realizimit të hulumtimit konkretisht qasjes në dosjet e lëndëve trashëgimore. Më pas, më secilin prej kryetarëve të gjykatave të përfshira në studim, është zhvilluar takim për t'i informuar më qëllimin e hulumtimit dhe mënyrën e mbledhjes së të dhënave. Kryetarët e të gjitha gjykatave të përfshira në studim, ishin të vetëdijshëm për rëndësinë e hulumtimit që nuk konsiston vetëm në interes të hulumtuesit, dhe pa ndonjë hezitim kanë miratuar kërkesën për lejimin e realizimit të hulumtimit. Përkatësisht, në secilen gjykate më qëllim të nxjerrjes së të dhënave të nevojshme lidhur më çështjet e ngritura në këtë punim, është lejuar qasja e drejtëpërdrejtë në dokumentet e përmbajtura në dosjet e lëndëve trashëgimore, më ç'rast për nevojat e këtij hulumtimi janë analizuar 18,891 raste trashëgimore. Identifikimi dhe analizimi i të dhënave për rastet trashëgimore të studiuara është realizuar nëpërmjet studimit të dokumentacionit.Nëpërmjet studimit të dokumentacionit është mundësuar analizimi i dokumenteve të përmbajtura në dosjet e lëndëve trashëgimore, të tilla si: propozimi për inicimin e procedurës trashëgimore; dokumenti i aktvdekjes; proceverbali për mbajtjen e seancës gjyqësore për trashëgimi; deklaratat e palëve për pranimin apo heqjen dorë nga trashëgimi; testamenti, marrëveshja e palëve për mënyrën e ndarjes së trashëgimisë dhe aktvendimi për trashëgimi. Në mënyrë që të nxirret informacion statistikor, të dhënat e fituara nëpërmjet studimit të dokumentacionit, për çdo lëndë të studiuar janë regjistruar në një formular. Formulari është përgatitë në përputhje më rrjedhën e zhvillimit të procedurës trashëgimore dhe objektivat e hulumtimit. Formulari përbëhet nga grup pyetjesh që synojnë të japin përgjigje për pyetjet e shtruara kërkimore dhe të vërtetojnë ose jo hipotezat e parashtruara gjatë punimit.(Forma e formularit gjendet e bashkangjitur në shtojcën nr.1 të punimit). Gjatë procedurës së mbledhjes së të dhënave janë plotësuar 18,891 formularë, pra gjatë studimit të çdo rasti trashëgimor është përdorur formulari, në mënyrë që të dhënat e identifikuara për çdo rast trashëgimor të studiuar të

paraqiten edhe në formë numerike (statistikore). Vlen të ceket se gjatë procedurës së mbledhjes së të dhënave gjegjësisht studimit të rasteve trashëgimore, është bërë edhe sigurimi në kopje fizike i mbi 700 aktvendimeve për trashëgimi. Njëkohësisht më procedurën e mbledhjes së të dhënave është realizuar edhe procedura e përpunimit të të dhënave. Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave në secilen gjykatë përkatëse ka filluar përpunimi i të dhënave. Fillimisht është bërë përpunimi i të dhënave për secilen gjykatë veç e veç, e më pas, pasi ka përfunduar në tërësi procesi i mbledhjes së të dhënave është bërë përpunimi i të dhënave për të gjitha gjykatat dhe është nxjerrë rezultati i përgjithshëm.Në mënyrë që të bëhet analiza e të dhënave, paraprakisht janë futur informatat e secilit formular në programin Microsoft Office Exel, pastaj ka filluar procedura e analizës së të dhënave.Procedura e përpunimit dhe analizës së të dhënave ka zgjatë gati 1 vit.

Tabela 14: Gjykatat e përfshira në hulumtim dhe kohëzgjatja e hulumtimit

Nr.	Gjykatat e përfshira në studim	Nr. i lëndëve të studiuara	Kohëzgjatja e hulumtimit
1.	Gjykata Themelore në Pejë	2,576	07.05.2015 deri 29.06.2015
2.	Gjykata Themelore në Prishtinë	5,893	01.07.2015 deri 24.08.2015
3.	Gjykata Themelore në Mitrovicë	806	26.08.2015 deri 18.09.2015
4.	Gjykata Themelore në Ferizaj	2,900	22.09.2015 deri 29.10.2015
5.	Gjykata Themelore në Gjilan	2,683	01.11.2015 deri 05.12.2015
6.	Gjykata Themelore në Prizren	4,033	11.07.2016 deri 19.08.2016
	Gjithsej	**18,891**	**9 muaj**

5.2.2. Zgjedhja e mostrës për pjesëmarrësit në pyetësorë dhe procedura e realizimit të pyetësorit

Përzgjedhja e pjesëmarrësve të përfshirë në studim është bërë në mënyrë të rastishëm . Në studim janë përfshirë 792 pjesëmarrës. Nga këta 138 ose (18%) janë nga Prishtina, 127 ose (16%) janë nga Peja, 94 ose (12%) janë nga Prizreni, 97 ose (12%) janë nga Istogu, 70 ose (9%) janë nga Ferizaji, 66 ose (8%) janë nga Gjilani, 39 ose (5%) janë nga Klina, 36 ose (5%) janë nga Deçani, 48 ose (6%) janë nga Mitrovica, 42 ose (5%) janë nga Gjakova dhe 35 ose (4%) janë nga Skenderaji.

Grafiku 1: Përqindja e komunave të Kosovës në të cilat janë shpërndarë pyetësorët



Në tabelën e mëposhtme janë përshkruar të dhënat demografike të pjesëmarrësve të përfshirë në studim. Nga gjithsej 792 pjesëmarrës të përfshirë në studim, 397 apo 50.1% i përkasin gjinisë mashkullore dhe 395 apo 49.8% i përkasin gjinisë femërore. Pjesëmarrësit u përkasin grupmoshave të ndryshme nga 18 vjeç e deri mbi 60 vjeç. Kështu, 30.4% janë që i përkasin moshës 18-30 vjeç, 24.2% të moshës 31-40 vjeç, 25.5% të moshës 41-50 vjeç, 16.2% të moshës 51-60 vjeç dhe 8% e pjesëmarrësve i përkasin moshës mbi 60 vjeç. Pjesëmarrësit vijnë nga zonat urbane dhe rurale të ndryshme të Kosovës, përkatësisht 53% e pjesëmarrësve vijnë nga zonat urbane dhe 47% vijnë nga zonat rurale. Sa u përket gjendjes civile, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë të martuar 60.4%, beqar janë 32.5%, të divorcuar janë 1.2% dhe të ve janë 5.6%. Sa u përket arsimimit, 10% e pjesëmarrësve kanë të përfunduar arsimimin fillor, 36.1%

arsimimin e mesëm, 39.6% arsimimin universitar dhe 14% e kanë të përfunduar arsimimin pasuniversitar. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve, i përkasin nacionalitetit shqiptar, përkatësisht 96% janë shqiptarë, 2% janë boshnjak dhe 1.5% janë turq. Pjesëmarrësit u përkasin dy besimeve fetare, besimit fetar islam 89.6% dhe 10.4 % i përkasin besimit fetar katolik.

Tabela 15: Përshkrimi i të dhënave demografike të individëve të përfshirë në mostër

Gjinia	**Numri**	**Përqindja**
Femra	395	49.8%
Meshkuj	397	50.1%
Mosha	**Numri**	**Përqindja**
18-30 vjeç	241	30.4%
31 – 40 vjeç	192	24.2%
41 – 50 vjeç	163	20.5%
51-60 vjeç	129	16.2%
Mbi 60 vjeç	67	8%
Shkalla e arsimimit	**Numri**	**Përqindja**
Fillor	80	10%
I mesëm	286	36.1%
Universitar	314	39.6%
Pasuniversitar	112	14%
Vendbanimi	**Numri**	**Përqindja**
Fshat	373	47%
Qytet	419	53%
Gjendja civile	**Numri**	**Përqindja**
Beqar/e	258	32.5%
i/e martuar	479	60.4%
i/ e devorcuar	10	1.2%
i/e ve	45	5.6%
Përkatësia etnike	**Numri**	**Përqindja**
Shqiptar	763	96.3%
Serb	/	/
Boshnjak	17	2.1 %
Rome/Ashkali/Egjyptas/	/	/
Turq	12	1.5%
Përkatësia fetare	**Numri**	**Përqindja**
Islame	706	89.1%
Katolike	86	10.9%
Ortodokse	/	/

5.2.2.1. Procedura e realizimit të pyetësorit

Në hulumtim janë përdorur dy pyetësorë, pyetësori për gratë dhe pyetësori për burrat. Të dy format e pyetësorit, i përmbajnë pyetjet gati të njëjta, kjo për të nxjerrë informacion për të njëjtat çështje që lidhen më të drejtën e gruas në trashëgimi, por nga dy këndvështrime, pra si nga këndvështrimi i grave, ashtu edhe nga këndvështrimi i burrave.Pyetjet e pyetësorëve janë formuluar duke u mbështetur kryesisht në hulumtimin e QKSGJ (2011).[682] Pyetësorët përbëhen nga dy pjesë. Pjesa e parë, synon të mbledhë informacione të përgjithshme rreth të anketuarve si: mosha e tyre, shkalla e arsimimit dhe gjendja civile e tyre, po ashtu vendbanimi i tyre si dhe përkatësia etnike e tyre. Ndërsa, pjesa e dytë përmbanë pyetje për qëndrimet apo vlerësimet e të anketuarve për çështje të ndryshme që lidhen më të drejtën e gruas në trashëgimi. Më konkretisht pjesa e dytë synon të mbledhë informacion për përceptimet e grave dhe burrave në lidhje më këto çështje apo pyetje: -nëse në praktikë sidomos kur bëhet fjalë për të drejtën e gruas në trashëgimi vazhdojn të zbatohen rregullat zakonore dhe nëse po a duhet ndryshuar kjo praktikë; - nëse duhet të trashëgojnë në mënyrë të barabartë si meshkujt ashtu edhe femrat; - Cili është roli i familjes, rrethit shoqëror, shkollës, mediave dhe institucioneve shtetërore në ngritjen e vetëdijes në kontekstin e barazisë në mes të femrave dhe meshkujve në trashëgiminë e pronës famijlare; - nëse femrave ju mohohet e drejta e trashëgimisë në pronën familjare a duhet të inicojnë padi në gjykatë apo duhet të heshtin; -nëse femrat e kërkojnë më padi realizimin e të drejtës së trashëgimisë sa mund të hasin në përkrahje të familjes, rrethit shoqëror dhe institucioneve të drejtësisë/gjykatës; - Cilët janë faktorët kryesor që ndikojnë në mos realizimin e të drejtës së gruas në trashëgimi; etj. Pyetësoret përbëhen nga 20 pyetje të parashtruara në mënyra të ndryshme si: pyetjet më nga një përgjigje po/jo, pyetjet më rangim të formuluara sipas shkallës Likert, si dhe pyetjet ku të anketuarve u kërkohet ta vendosin përgjigjen e tyre në një shkallë nga 1 në 5. (Format e të dy pyetësoreve gjenden të bashkangjitura në shtojcën nr.2 të punimit). Ndërtimi i pyetësorëve ka zgjatë një përiudhë gati 2 mujore gjatë vitit 2015. Ndërsa, shpërndarja e pyetësorëve ka zgjatë më shumë së 1 vit përkatësisht shpërndarja e pyetësorëve ka filluar në maj të vitit 2015 dhe ka vazhduar deri në shtator të vitit 2016. Procedura e shpërndarjës së pyetësorëve, u realizua njëkohësisht më procedurën e mbledhjes së të dhënave nëpër gjykata. Vlen të ceket se për të dy format e pyetësorëve, së pari u realizua testimi paraprak (pilot), për të

[682] Qendra Kosovare për Studime Gjinore.(Mar 2011). E Drejta e Trashëgimisë Pronësore të Grave në Kosovë. Prishtinë. Shih Fq. 53-60. http://www.womensnetwork.org/documents/20130530153942831.pdf

parë nëse pyetjet janë formuluar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Testimi paraprak është realizuar gjatë muajit prill. Në testimin paraprak janë përfshirë 30 gra dhe 30 burra nga rajoni i Pejës dhe Istogut. Pas realizimit të testimit paraprak, u bë shpërndarja në kopje të fortë e 1000 pyetësorëve. Pyetësorët janë shpërndarë në vendet më të frekuentuara të komunave të përfshira në mostër dhe në institucione të ndryshme si komuna, gjykata, universitete etj. Duhet theksuar se një pjesë e madhe e pyetësorëve është shpërndarë në gjykatat ku është realizuar hulumtimi, punëtorët e gjykatave kanë shprehur gatishmëri që pyetësorin ta ndajnë edhe më familjarë dhe miqtë e tyre. Prej 1000 pyetësorëve të shpërndarë u kthyen të plotësuar 833, prej tyre 41 ishin jo të vlefshme për shkak të mungesës së korrektësisë dhe seriozitetit të të anketuarve, për këtë aryse në rezultatin final janë përfshirë 792 pyetësorë. Përpunimi i të dhënave të nxjerra nga pyetësorët është bërë në programin Microsoft Office Exel.

Analiza e të dhënave të nxjerra nga hulumtimi në gjykata

5.3.1. Rastet e trashëgimisë të inicuara dhe të zgjidhura në Gjykatat Komunale tashmë Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, 2003-2014.

Në Gjykatat Komunale tashmë Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, për gjatë përiudhës 2003-2014, janë inicuar 19,698 raste të trashëgimisë. Kështu:

- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Prishtinë, gjatë përiudhës 2003-2014, janë inicuar 6,061 raste të trashëgimisë, prej tyre deri në gusht të vitit 2015 janë shqyrtuar 5,893 apo 97.2%;
- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Ferizaj, gjatë përiudhës 2003-2014, janë inicuar 3,309 raste të trashëgimisë, prej tyre deri në nëntor të vitit 2015 janë shqyrtuar 2,900 apo 87.6%;
- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Gjilan, gjatë përiudhës 2003-2014, janë inicuar 2,756 raste të trashëgimisë, prej tyre deri në dhjetor të vitit 2015 janë shqyrtuar 2,683 apo 97.3%;
- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Prizren, gjatë përiudhës 2003-2014, janë inicuar 4,115 raste të trashëgimisë, prej tyre deri në gusht të vitit 2016 janë shqyrtuar 4,033 apo 98%;
- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Pejë, gjatë përiudhës 2003-2013, janë inicuar 2,638 raste të trashëgimisë, prej tyre deri në qershor të vitit 2015 janë shqyrtuar 2,576 apo 97.6%;
- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Mitrovicë më seli në Vushtrri, gjatë përiudhës 2008-2014, janë inicuar 819 raste të trashëgimisë, prej tyre deri në shtator të vitit 2015 janë shqyrtuar 806 apo 98.4%. Duhet theksuar se në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, nuk janë përfshirë në studim lëndët trashëgimore të viteve 2003-2008, për aryse se këto lëndë gjenden në arkiven e Gjykatës Themelore në pjesën veriore të Mitrovicës, e cila që nga viti 2008 administrohet nga serbët.

Në grafikun më poshtë, janë paraqitur të dhënat lidhur më numrin e tërësishëm të rasteve trashëgimore të inicuara për së cilin vit veç e veç, së bashku më numrin e rasteve të cilat kanë

arritur të kryhen brenda vitit, si dhe numrin e rasteve të kryera në total deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi.

Grafiku 2: Rastet e trashëgimisë të inicuara dhe të zgjidhura në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014



	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Të inicuara	1549	1494	1826	1845	1876	1768	2252	2426	2460	1875	231	96
Të përfunduara brenda vitit	1002	951	1022	967	1215	1159	1495	1415	1397	1146	138	61
Të përfunduara në total deri në përiudhën kur është kryer hulumtimi	1535	1475	1758	1756	1808	1732	2177	2322	2353	1720	188	67

Tabela 16: Përqindja e rasteve të trashëgimisë të kryera brenda vitit të të cilit janë inicuar dhe të kryera në total deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
% e lëndëve të kryera brenda vitit:	65 %	64 %	56 %	52 %	64 %	65 %	66 %	58 %	56 %	61%	59 %	63 %
% e lëndëve të kryera në total	99%	98 %	96 %	95 %	96%	97%	96%	95%	95 %	91 %	81 %	69%

Duhet theksuar se numri i vogël i rasteve të kryera brenda vitit të të cilit janë inicuar në disa gjykata, nuk ndërlidhet më mosefikasitetin e punës së tyre, por kjo është pasojë e vëllimit të lartë të lëndëve civile dhe numrit të vogël të gjyqtarëve në anën tjetër, të cilet merren më trajtimin e këtyre lëndëve. Ndoshta edhe si rezultat i kësaj, në shumë raste jokontestimore të trashëgimisë, në disa gjykata kemi vërejtur se procedurat e trashëgimisë zhvillohen në tërësi nga bashkëpunorët profesional, e jo nga gjyqtarët, edhe pse LTK, nuk e parasheh këtë mundësi.

Nga 19,698 raste sa janë inicuar gjatë përiudhës 2003-2014, në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Prizren, Pejë dhe Mitrovicë, brenda vitit të të cilit janë inicuar janë zgjidhur 11,968 (apo 60.7%), kurse deri në periudhën kur është realizuar hulumtimi janë zgjidhur gjithsej 18,891 apo 95.9%. Kësisoj:

- Në vitin 2003, janë inicuar 1,549 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 1,002 (apo 65%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 1,535 (99%);
- Në vitin 2004, janë inicuar 1,494 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 951 (apo 64%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 1,475 (98%);
- Në vitin 2005, janë inicuar 1,826 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 1,022 (apo 56%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 1,758 (apo 96%);
- Në vitin 2006, janë inicuar 1,845 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 967 (apo 52.4%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 1,756 (apo 95%);
- Në vitin 2007, janë inicuar 1,876 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 1,215 (apo 64.7%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 1,808 (apo 96%);
- Në vitin 2008, janë inicuar 1,768 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 1,159 (apo 65.5%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 1,732 (apo 97%);
- Në vitin 2009, janë inicuar 2,252 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 1,495 (apo 66.3%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 2,177 (apo 96%);
- Në vitin 2010, janë inicuar 2,426 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 1,415 (58.3%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 2,322 (apo 95%);
- Në vitin 2011, janë inicuar 2,460 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 1,397 (apo 56.7%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 2,353 (apo 95%);
- Në vitin 2012 janë inicuar 1,875 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 1,146 (apo 61.1%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 1,720 (apo 91%);

- Në vitin 2013, janë inicuar 231 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 138 (apo 59.7%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 188 (apo 81%);
- Në vitin 2014, janë inicuar 96 raste prej tyre brenda vitit janë shqyrtuar 61 (apo 63.5%), kurse deri në përiudhën kur është realizuar hulumtimi janë shqyrtuar 67 (apo 69.7%).

Gjatë viteve 2013-2014, është zvogëluar numri i rasteve trashëgimore të inicuara në gjykata, për arsye se rastet jokontestimore të trashëgimisë nga viti 2012, kanë filluar të shqyrtohen edhe nga noterët, edhe pse më LTK dhe LPJK, noterëve nuk u njihet kjo kompetencë. Kompetenca e noterëve që të veprojnë në çështjet e trashëgimisë parashikohet më Ligjin për Noterinë.Përkatësisht,në Ligjin për Noterinë, parashikohet që noterët janë të autorizuar t'i zhvillojnë të gjitha procedurat trashëgimore jokontestimore. Ky kolezion i ligjeve ka bërë që në praktikë të krijohet konfuzion jo vetëm tek palët, por edhe tek gjykatat dhe noterët, në lidhje me juridiksionin e tyre mbi rastet e trashëgimisë. Kështu disa gjykata gjatë viteve 2013-2014, nuk kanë pranuar raste jokontestimore të trashëgimisë për shqyrtim, duke konsideruar se nuk janë më kompetente të merren më çështjet e trashëgimisë. Pra, më qëllim që të përcaktohen dhe të ndahen qartë kompetencat e noterëve dhe gjykatave,sa i përkët zhvillimit të procedurave të trashëgimisë, duhet të ndryshohet LTK dhe LPJK. Mendojmë se zhvillimi i procedurave të trashëgimisë duhet t'u lihet në kompetencë noterëve, por si të autorizuar nga gjykata. Pra,ashtu si në Maqedoni, ku shqyrtimi i rasteve të trashëgimisë bëhet nga gjykata dhe noterët si përfaqësues të gjykatës. Përkatësisht në Maqedoni, gjykata e fillon zyrtarisht procedurën trashëgimore, e më pas kryetari i gjykatës në pajtim me dispozitat e procedurës jokontestimore, ia besonë noterit me seli në rajonin e gjykatës kompetente themelore zbatimin e procedurës së trashëgimisë. Mendojmë së një praktikë e tillë,duhet të zbatohet edhe në Kosovë.

5.3.2. Mënyra e inicimit të procedurës trashëgimore në praktikën e Gjykatave Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë

Në grafikun dhe tabelën më poshtë, janë paraqitur të dhënat lidhur më mënyrën e inicimit të procedurës trashëgimore për rastet trashëgimore të përfunduara për gjatë përiudhës 2003-2014, në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë. Sikurse është theksuar edhe në kapitullin e IV, sipas ligjit konkretisht sipas LPJK, gjykata është e detyruar që të fillojë zyrtarisht procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Kjo rregull është sanksionuar në nenin 127 i LPJK, ku thuhet: "Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore vihet në veprim nga gjykata sipas detyrës zyrtare posa gjykata të informohet se një person ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjyqësor". Sipas LPJK, për vdekjen e personit apo për shpalljen e personit të vdekur më vendim gjyqësor, gjykata informohet nga organi komunal përkatësisht nga nënpunësi i gjendjes civile, i cili është kompetent të regjistrojë vdekjen në librin amzë të të vdekurve. Nënpunësi i gjendjes civile brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita në të cilën e ka regjistruar vdekjen, ka për detyrë ligjore t'ia dërgojë akvdekjen gjykatës trashëgimore. Pavarësisht se parashikohet më ligj, në praktikë kjo procedurë nuk respektohet pothuajse asnjëherë. Gjatë fazës së hulumtimit nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore në Gjykatat Komunale gjegjësisht Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, vetëm për 167 raste në Gjykatën Komunale në Ferizaj, kemi vërejtur se organi komunal e ka dërguar aktvdekjen në gjykatën trashëgimore dhe procedura është inicuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata. Ndërsa,për 18,724 rastet e tjera të analizuara procedura është inicuar më kërkesën e palëve (trashëgimtarëve). Përkatësisht për asnjërin nga këto raste nuk kemi vërejtur se organi komunal ka dorëzuar aktvdekjen në gjykatë, por në të gjitha rastet palët e kanë siguruar vetë aktvdekjen, si nevoje e plotësimit të dokumentacionit që kërkohet në rastin e parashtrimit të propozimit për fillimin e procedurës trashëgimore.Propozimet për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore për një numër të konsiderueshëm të rasteve të analizuara, janë ushtruar nga trashëgimtarët meshkuj. Përkatësisht në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, përqindja mesatare e propozimeve të ushtruara për gjatë përiudhës 2003-2014 nga trashëgimtarët meshkuj është 67.9%; nga trashëgimtarët femra është 19.8%; bashkërisht nga trashëgimtarët F/M është 11.2% si dhe 0.88% të rasteve janë inicuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata.

Grafiku 3: Mënyra e inicimit të procedurës trashëgimore për rastet trashëgimore të zgjidhura për gjatë përiudhës 2003-2014, në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë.



	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Sipas detyrës zyrtare	0	1	81	68	8	2	4	3	0	0	0	0
Më kërkesën e përbashkët të trashëgimtarëve F/M	179	192	235	231	240	199	224	248	216	142	21	3
Më kërkesën e trashëgimtarëve femra	337	264	363	344	329	326	400	451	519	366	36	16
Më kërkesën e trashëgimtarëve meshkuj	1019	1018	1079	1113	1231	1205	1549	1620	1618	1212	131	48

Tabela Nr.17: Mënyra e inicimit të procedurës trashëgimore shprehur në përqindje.

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
% e rasteve të inicuara sipas detyrës zyrtare	0%	0.6%	4.6%	3.8%	0.4%	0.1%	0.1%	0.1%	0%	0%	0%	0%
% e rasteve të inicuara më kërkesën e trashëgimtarëve meshkuj	66%	69%	61%	63%	68%	69%	71%	70%	69%	71%	70%	72%
% e rasteve të inicuara më kërkesën e trashëgimtarëve femra	22%	17%	20%	19%	18%	19%	18%	19%	22%	21%	19%	24%
% e rasteve të inicuara më kërkesën e përbashkët të trashëgimtarëve M-F.	12%	13%	13%	13%	13%	11%	10%	10%	9%	8%	11%	4%

Mos inicimi i procedurës trashëgimore sipas detyrës zyrtare nga gjykata ashtu siç parashihet më ligj, shkakton që palët të inicojnë procedurat trashëgimore shumë vite pas vdekjes së trashëgimlënësit.Nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore në Gjykatat Komunale gjegjësisht Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, kemi vërejtur së vetëm për

1,735 raste, procedura është inicuar brenda vitit të të cilit ka vdekur trashëgimlënësi si dhe për 6,023 raste procedura është inicuar brenda 10 viteve nga vdekja e trashëgimlënësit. Ndërsa, në të gjitha rastet e tjera, procedurat janë inicuar pasi kanë kaluar mbi 10 vite e më shumë, nga vdekja e trashëgimlënësit.Madje, ka raste në të cilat inicimi i procedurës është bërë edhe pasi kanë kaluar mbi 90 vite nga vdekja e trashëgimlënësit. Në tabelën Nr/16, është bërë ndarja e rasteve të analizuara në secilen gjykatë të përfshirë në studim, në bazë të kohës që ka kaluar nga vdekja e trashëgimlënësit dhe inicimit të procedurës trashëgimore. Ndërsa, më poshtë do jepen shembuj nga analizimi i vetëm disa prej rasteve trashëgimore, të cilat janë inicuar deri në shumë vite pas vdekjes së trashëgimlënësit. Kështu:

- Në Gjykatën Komunale në Pejë, në vitin 2005, është inicuar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1909, pra, nga koha e vdekjes së trashëgimlënësit dhe inicimit të procedurës kanë kaluar 96 vite. Trashëgimlënësi ka lënë pasuri të paluajtshme në vlerë prej 150.000 euro. Kurse, si trashëgimtarë janë paraqitur dy nipat e trashëgimlënësit nga djali i ndjerë i trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1972. Më 27.01.2005 gjykata ka marre vendim që në bazë të drejtës së përfaqësimit për trashëgimtarë të shpallen dy nipat e trashëgimlënësit.[683]
- Në Gjykatën Komunale poashtu në Pejë, në vitin 2006, është paraqitur nga palët propozimi për shqyrtimin e pasurisë së trashëgimlënësit,i cili ka vdekur në vitin 1913. Trashëgimlënësi ka lënë pasuri të paluajtshme në vlerë prej 100.000 euro. Kurse, si trashëgimtarë ka lënë dy nipat nga djali i tij i ndjerë dhe nipin nga vëllau i ndjerë gjegjësisht djalin e vëllaut. Nipat nga djali i ndjerë i trashëgimlënësit kanë hequr dorë nga trashëgimia në dobi të djalit të axhit gjegjësisht djalit të vëllaut të trashëgimlënësit. Më 05.02.2007, gjykata ka marre vendim më të cilin e ka shpallë trashëgimtarë, në tërë pasurinë trashëgimore djalin e vëllaut të trashëgimlënësit. Pra, në bazë të së drejtës së përfaqësimit, ka trashëguar gjithë pasurinë trashëgimore, djali i vëllaut të trashëgimlënësit si trashëgimtarë i radhës së dytë.[684] Në një rast tjetër në Gjykatën Komunale në Pejë, në vitin 2010, është parashtruar propozimi për inicimin e procedurës për shqyrtimin e pasurisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1966. Pra, nga vdekja e trashëgimlënësit kanë kaluar mbi 40 vite. Si trashëgimtarë ligjorë janë paraqitur: tri mbesat dhe tre nipat nga djali i ndjerë i trashëgimlënësit, i cili ka vdekur

[683] Vendimi: T.Nr.05/05 datë 27.01.2005. Gjykata Komunale në Pejë
[684] Vendimi: T.Nr.26/06 datë 05.02.2007. Gjykata Komunale në Pejë

në vitin 1996; dhëndrri nga mbesa e ndjerë e trashëgimlënësit, e cila ka vdekur në vitin 1997 dhe dy nipat nga djali tjetër i ndjerë i trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1997. Prej tyre e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë tre nipat dhe mbesa e trashëgimlënësit, deri sa trashëgimtarët e tjerë gjegjësisht dy nipat e tjerë, dhëndrri, dhe dy mbesat e tjera të trashëgimlënësit, kanë hequr dorë nga trashëgimia. Procedura ka përfunduar në vitin 2013, përkatësisht më datë 19.04.2013, gjykata më aktvendim sipas të drejtës së përfaqësimit, i ka shpallur trashëgimtarë ligjorë tre nipat dhe mbesën e trashëgimlënësit në tërë pasurinë trashëgimore.[685]

- Në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në vitin 2010, më kërkesën e trashëgimtarëve është inicuar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1918. Pra, kanë kaluar 92 vite nga vdekja e trashëgimlënësit. Si trashëgimtar i vetëm është paraqitur nipi nga djali i ndjerë i trashëgimlënësit, i cili edhe e ka pranuar trashëgiminë gjegjësisht gjykata më datë 17.06.2010, e ka marrë vendimin më të cilin është shpallë trashëgimtarë nipi i trashëgimlënësit në tërë pasurinë trashëgimore.[686]
- Në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në vitin 2011, është parashtruar nga pala propozimi për shqyrtimin e pasurisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1926. Pra, nga vdekja e trashëgimlënësit kanë kaluar 85 vite. Në bazë të së drejtës së përfaqësimit, si trashëgimtarë e vetme është paraqitur stërmbesa e trashëgimlënësit, nga nipi i ndjerë i trashëgimlënësit. Më datë 23.02.2011, gjykata ka marrë vendim më të cilin është shpallë trashëgimtarë në tërë pasurinë trashëgimore stërmbesa e trashëgimlënësit si trashëgimtarë e vetme ligjore.[687]
- Në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, në vitin 2012, më kërkesën e palës (trashëgimtarit) është inicuar procedura për shqyrtimin e pasurisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1920 apo para 92 viteve më parë. Trashëgimtarë i vetëm ligjor është paraqitur nipi nga djali i ndjerë i trashëgimlënësit. Më datë 26.07.2012, gjykata ka marre vendim më të cilin e ka shpallë trashëgimtarë nipin e trashëgimlënësit, në tërë masën e pasurisë trashëgimore.[688]

  Në një rast tjetër në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, në vitin 2009, është inicuar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1944.

[685] Vendimi: T.Nr.226/10 datë 19.04.2013. Gjykata Themelore në Pejë
[686] Vendimi: T.Nr.78/10 datë 17.06.2010. Gjykata Komunale në Prishtinë
[687] Vendimi: T.Nr.65/11 datë 23.02.2011. Gjykata Komunale në Prishtinë
[688] Vendimi: T.Nr.90/12 datë 26.07.2012. Gjykata Komunale në Mitrovicë

Si trashëgimtarë ligjor të rendit të parë, në bazë të së drejtës së përfaqësimit janë lajmëruar dy stërnipat nga djali i ndjerë i trashëgimlënësit, të cilët gjykata më 08.09.2009, i ka shpallur trashëgimtarë në tërë pasurinë trashëgimore.[689]

- Në Gjykatën Komunale në Prizren, në vitin 2010, është parashtruar propozimi për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1953. Pra, nga vdekja e trashëgimlënësit kanë kaluar 57 vite. Si trashëgimtarë ligjorë janë lajmëruar katër sternipa nga dy nipat e ndjerë të trashëgimlënësit, një mbesë dhe dy stërmbesa poashtu nga dy nipat e ndjerë të trashëgimlënësit. Mbesa dhe stërmbesat e trashëgimlënësit, sipas të drejtës së përfaqësimit nga baballarët e tyre të ndjerë, kanë hequr dorë nga trashëgimia. Deri sa katër stërnipat e trashëgimlënësit sipas të drejtës së përfaqësimit nga baballarët e tyre të ndjerë, e kanë pranuar trashëgiminë dhe gjykata më 18.06.2012, i ka shpallur trashëgimtarë në tërë pasurinë trashëgimore.[690] Në një rast tjetër në Gjykatën Komunale në Prizren, poashtu në vitin 2010, është inicuar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1948, apo para 62 viteve më pare.Si trashëgimtarë ligjorë janë lajmëruar mbesa, dy stërmbesat dhe dy stërnipat e trashëgimlënësit sipas të drejtës së përfaqësimit nga baballarët e tyre respektivisht nëna e tyre e ndjerë përndryshe nipi dhe mbesa e trashëgimlënësit në këtë rast. Të gjithë trashëgimtarët e thirrur në trashëgimi e kanë pranuar trashëgiminë, më ç'rast më 24.02.2011, gjykata e ka marrë vendimin më të cilin i ka shpallur të gjithë trashëgimtarët e lajmëruar trashëgimtarë ligjor të pasurisë trashëgimore.[691]
- Në Gjykatën Komunale në Gjilan, në vitin 2004, është paraqitur propozimi për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1944. Trashëgimtarë ligjorë i vetëm është lajmëruar nipi nga djali i ndjerë i trashëgimlënësit. Gjykata më 10.02.2004, e ka marrë vendimin më të cilin e ka shpallë trashëgimtarë sipas të drejtës së përfaqësimit nipin e trashëgimlënësit në tërë pasurinë trashëgimore.[692]

[689] Vendimi: T.Nr.153/09 datë 08.10.2009. Gjykata Komunale në Mitrovicë
[690] Vendimi: T.Nr.28/10 datë 18.06.2012. Gjykata Komunale në Prizren
[691] Vendimi: T.Nr.385/10 datë 24.02.2011. Gjykata Komunale në Prizren
[692] Vendimi: T.Nr.14/04 datë 10.02.2004. Gjykata Komunale në Gjilan

Tabela Nr.18: Përqindja e rasteve (të përfunduara gjate viteve 2003-2014) të ndara sipas viteve të cilat kanë kaluar nga vdekja e trashëgimlënësit dhe inicimit të procedurës

Numri dhe % e rasteve në të cilat procedurat janë inicuar:	Në Gjykatën Themelore në Prishtinë	Në Gjykatën Themelore në Ferizaj	Në Gjykatën Themelore në Gjilan	Në Gjykatën Themelore në Mitrovicë	Në Gjykatën Themelore në Pejë	Në Gjykatën Themelore në Prizren
Brenda vitit të të cilit kanë vdekur trashëgimlënësit	535 (9%)	383 (13.2%)	286 (10.6%)	94 (12%)	163 (6.3%)	274 (6.7%)
Brenda 10 viteve nga vdekja e trashëgimlënësit	1,991 (33.7%)	882 (30.4%)	851(31.7%)	299 (37%)	680 (26.3%)	1320 (32.7%)
Pasi kanë kaluar mbi 10 vite nga vdekja e trashëgimlënësit	1,317.(22.3%)	669 (23%)	605 (22.5%)	69 (8.5%)	560 (21.7%)	919 (22.7%)
Pasi kanë kaluar mbi 20 vite nga vdekja e trashëgimlënësit	1,160.(19.6%)	538 (18.5%)	574 (21.3%)	177 (21.9%)	631 (24.4%)	796 (19.7%)
Pasi kanë kaluar mbi 30 vite nga vdekja e trashëgimlënësit	529 (8.09%)	270 (9.3%)	243 (9%)	93 (11.5%)	296 (11.4%)	442 (10.9%)
Pasi kanë kaluar mbi 40 vite nga vdekja e trashëgimlënësit	234 (3.9%)	102 (3.5%)	91 (3.3%)	48 (5.9%)	161 (6.2%)	202 (5%)
Pasi kanë kaluar mbi 50 vite nga vdekja e trashëgimlënësit	72 (1.2 %)	34 (1.1%)	24 (0.8%)	14 (1.7%)	59 (2.3%)	61 (1.5%)
Pasi kanë kaluar mbi 60 vite nga vdekja e trashëgimlënësit	21 (0.35%)	14 (0.48%)	8 (0.29%)	10 (1.2%)	16 (0.6%)	11 (0.27%)
Pasi kanë kaluar mbi 70 vite nga vdekja e trashëgimlënësit	17.(0.28%)	5 (0.17)%	1 (0.03%)	0%	4 (0.15%)	6 (0.14%)
Pasi kanë kaluar mbi 80 vite nga vdekja e trashëgimlënësit	9 (0.015%)	3 (0.10%)	0%	0%	1 (0.03%)	2 (0.04%)
Pasi kanë kaluar mbi 90 vite nga vdekja e trashëgimlënësit	8 (0.13%)	0%	0%	2 (0.2%)	5 (0.19%)	0

5.3.2.1. Pasojat juridike nga inicimi më vonesë i procedurës trashëgimore

Inicimi më vonesë i procedurës trashëgimore shkakton një sërë pasoja negative .

Se pari, kur shqyrtimi i trashëgimisë bëhet më vonesë mund të ndodhë se ndonjë nga trashëgimtarët potencial të vdesë në ndërkohë, pa e realizuar të drejtën e trashëgimisë, ashtu siç e pamë në disa nga shembujt e parashtruar më lartë, ku trashëgimtarët e dy gjeneratave kanë vdekur pa e realizuar të drejtën e trashëgimisë. Mandej,kur shqyrtimi i trashëgimisë bëhet shumë më vonesë, rritet edhe numri i trashëgimtarëve që thirren në trashëgimi dhe pjesëmarrja e tyre në procedurë në disa raste është e vështirë të sigurohet. Barra e përgatitjes se gjithë dokumentacionit që kërkohet në rastin e inicimit të procedurës, ashtu sikurse edhe sigurimi i pjesëmarrjes se trashëgimtarëve në procedurë, bie mbi trashëgimtarët të cilët e inicojnë procedurën trashëgimore. Në praktikë, procedura trashëgimore inicohet rëndomtë nga trashëgimtarët të cilët e kanë në posedim pasurinë trashëgimore. Procesi i përgatitjes së materialit të nevojshëm për inicimin e procedurës, e veçanërisht sigurimi i pjesëmarrjes se trashëgimtarëve në procedurë, mund të jetë i vështirë dhe të marrë kohë, kur numri i trashëgimtarëve është i madh, e sidomos kur ka trashëgimtarë të cilët jetojnë jashtë Kosovës. Mjaft shpesh,trashëgimtarët të cilët jetojnë jashtë Kosovës, nuk tregojnë interes apo refuzojnë të marrin pjesë në procedurë. Këta trashëgimtarë ndodhë edhe se nuk përfshihen në aktvdekje.Përkatësisht, në këto raste, ekziston rreziku se trashëgimtarët potencial të cilët e kanë në posedim pasurinë trashëgimore,më qëllim të formalizimit të të drejtave pronësore të tyre, kur e bëjnë inicimin e procedurës, nuk i deklarojnë të gjithë trashëgimtarët.[693]

Se dyti, inicimi i procedurave trashëgimore më vonesë shkakton që personat e vdekur të mbesin titulllarë të paluajtshmërive për përiudha të gjata kohore, ndodhë se trashëgimlënësit sikurse në disa nga shembujtë e parashtruar më sipër, mbesin titullarë të pronave edhe deri në 90 vite pas vdekjes. Shkruhet se të dhënat nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), tregojnë se deri në 50% e pronave në Kosovë, janë të regjistruara në emrin e personave të vdekur.[694] Kjo situate krijon mundësin e realizimit të transkasioneve pronësore joformale dhe pengon trashëgimtarët potencial që në mënyrë ligjore të disponojnë më pronën e paluatjshme.[695] Për

[693] Shih Tetra Tech.Raporti i programit të USAID-it për të drejtat pronësore (PDP) "Informaliteti në sektorin e tokave: Çështja e trashëgimisë së vonuar në Kosovë".Prishtinë.Prill 2016.Fq.VI

[694] Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë.Publikuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.Ministria e Drejtësisë Prishtinë.Dhjetor 2016.Fq.44

[695] Shih OSBE (2010) Çështjet lidhur më rolin e bashkëpuntorëve profesional dhe inicimin e procedurave në rastet e trashëgimisë Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete.Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik.Edicioni 9. Prishtinë.Fq.3

shkak të mos zhvillimit të procesit të trashëgimisë, trashëgimtarët nuk kanë mundësi të regjistrojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën e trashëguar të cilën e posedojnë. Kështu, shkruhet se të dhënat nga regjistrimet sistematike të AKK, tregojnë se afër 30% e të gjithë parashtruesve të kërkesave për legalizim dhe regjistrim të të drejtave të tyre pronësore, nuk arrijnë ta bëjë këtë për shkak se të drejtat mbi pronat të cilën ata e posedojnë janë të regjistruara në emrin e personit të vdekur, sepse trashëgimtarët nuk e kanë filluar procedurën e trashëgimisë. Veç kësaj, shkruhet që sipas disa informatave jo zyrtare, rezulton se 50% apo më shumë parashtrues të kërkesave për legalizimin e të drejtave të tyre në mbi 350,000 objekte pa leje, përmes programit të Qeverisë së Kosovës (QK) për legalizim, nuk kanë arritur të dëshmojnë të drejtat e tyre mbi tokën mbi të cilën i kanë ndërtuar objektet, për shkak se ato janë të regjistruara në emrin e personave të vdekur si titullar të pronave".[696] Pra,mos fillimi i procedurës trashëgimore i privon trashëgimtarët potencial nga mundësia për ti gëzuar autorizimet e të qenit pronar i një paluajtshmërie. P.sh, trashëgimtarët të cilët nuk e kanë filluar procedurën e trashëgimisë, nuk mund të shfrytëzojnë pronën e trashëguar, si kolateral për marrjen e huasë (kredisë) për investime. Nga mos fillimi i procedurave trashëgimore, trashëgimtarët potencial po humbasin, pra, mundësinë e gëzimit të së drejtës së pronësisë si një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila është e garantuar nga neni 47 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nga LPDTS i RK[697] dhe nga aktet të tjera ligjore apo nënligjore si dhe nga neni 1 i protokollit shtesë nr.1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

[696] Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë.Publikuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.Ministria e Drejtësisë Prishtinë.Shtator 2016.Fq.25

[697] Ligji Nr. 03/L-154 Për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti IV/Nr.57/04 Gusht 2009). Neni 2

5.2.3.3. Bazat juridike në bazë të të cilave është ndarë trashëgimia në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014

Në grafikun më poshtë janë paraqitur të dhënat lidhur më bazat juridike në bazë të të cilave është ndarë trashëgimia për rastet trashëgimore të zgjidhura për gjatë përiudhës 2003-2014, në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë. Sikurse e kemi theksuar edhe më parë, LTK njeh dy baza juridike të thirrjes në trashëgimi: trashëgiminë ligjore dhe atë testamentare. Sipas rregullave të përmbajtura në LTK,përparësi i jepet trashëgimisë testamentare ashtu që trashëgimia ligjore zbatohet vetëm në rastet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament ose kur trashëgimlënësi ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë ose kur testamenti është shpallur tërërsisht apo pjesërisht i pavlefshëm.[698] Pra, sipas ligjit trashëgimia testamentare gëzon prioritet në raport më trashëgiminë ligjorë.

Grafiku 4: Bazat juridike në bazë të të cilave është ndarë trashëgimia në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014.



	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Në bazë të testamentit	5	3	5	7	8	5	7	9	5	3	3	2
Në bazë të ligjit	1530	1472	1753	1749	1800	1727	2170	2313	2348	1717	185	65

Pavarësisht se më ligj prioritet i jepet trashëgimisë testamentare, në praktikë testamenti aplikohet në raste jashtëzakonisht të rralla. Në praktikë, gati në të gjitha rastet trashëgimia ndahet në mungesë të testamentit përkatësisht përqindja e rasteve për të cilat trashëgimia ndahet në bazë të testamentit nuk arrin as 1%. Kështu,gjatë hulumtimit nga analizimi i 18,891 rasteve

[698] Ligji Nr. 2004/26 Për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006).Shih nenin 9

trashëgimore të viteve 2003-2014 në gjykatat e përfshira në studim, vetëm për 62 raste (0.32%) kemi vërejtur se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit, ndërsa në të gjitha rastet e tjera (18,829 apo 99.6%) trashëgimia është ndarë në bazë të ligjit, konkretisht:

- Në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga analizimi i 5,893 rasteve të viteve 2003-2014, vetëm për 16 raste kemi vërejtur se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit;
- Në Gjykatën Themelore në Gjilan nga analizimi i 2,683 rasteve të viteve 2003-2014, vetëm për 4 raste kemi vërejtur se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit;
- Në Gjykatën Themelore në Ferizaj nga analizimi i 2,900 rasteve të viteve 2003-2014, vetëm për 3 raste kemi vërejtur se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit;
- Në Gjykatën Themelore në Prizren nga analizimi i 4,033 rasteve të viteve 2003-2014, për 29 raste kemi vërejtur se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit.
- Në Gjykatën Themelore në Mitrovicë nga analizimi i 806 rasteve të viteve 2008-2014, vetëm për 1 rast kemi vërejtur se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit; si dhe
- Në Gjykatën Themelore në Pejë nga analizimi i 2,576 rasteve të viteve 2003-2013, vetëm për 9 raste kemi vërejtur se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit.

Pra, numri më i lartë i rasteve për të cilat trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit ka shënuar në Gjykatën Komunale tash Themelore në Prizren. Përkatësisht, prej gjithsej 62 rasteve për të cilat trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit në të gjitha gjykatat e përfshira në studim, 29 raste apo 46.7% të rasteve i përbëjnë rastet trashëgimore të shqyrtuara nga Gjykata Komunale gjegjësisht Themelore në Prizren.Pra, testamenti aplikohet më se shumti në rajonin e Prizrenit.

Është e rëndësishme të theksohet se mungesa e testamenteve nuk është karakteristikë vetëm për vendin tonë, në shumë shtete hartimi i testamenteve nuk është çështje e zakonshme. P.sh., në vitin 2014, përqindja e njerëzve të cilët kishin të hartuar testament në Itali ishte 8%; në Spanjë 7%, në Francë me pak se 5%, në Belgjikë 25%, ne vendet Skandinave 20%, në Holandë 32%.[699] Një përqindje më e lartë e njerëzve të cilët kanë të hartuar testament vërehet në Mbretërinë e Bashkuar 42%,[700]dhe Shtetet e Bashkuara 45%.[701]

[699] Giornata Internazionale del Lascito Solidale (13 Settembre 2014), Lasciti solidali e testamenti: Italia, al primo posto per tutela degli eredi, ma ancora in ritardo per diffusione rispetto all'Europa, pg.1. Available at: www.testamentosolidale.org

[700] https://www.unbiased.co.uk/write-and-register-a-will (e vizituar me 03.07.2016)

[701] http://info.legalzoom.com/statistics-last-wills-testaments-3947.html (e vizituar me 03.07.2016)

Tabela 19: Format e testamenteve në bazë të të cilave është ndarë trashëgimia në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014.

Viti	Në bazë të ligjit	Në bazë të testamentit	Testamentit Gjyqësor	Testamentit Alograf	Testamentit Ollograf	Testamentit Gojor
2003	1,530	5	2	3	/	/
2004	1,472	3	3	/	/	/
2005	1,753	5	3	2	/	/
2006	1,749	7	4	1	2	/
2007	1,800	8	5	2	/	1
2008	1,727	5	4	1	/	/
2009	2,170	7	3	3	1	/
2010	2,313	9	5	1	3	/
2011	2,348	5	1	3	1	/
2012	1,717	3	1	1	1	/
2013	185	3	2	/	1	/
2014	65	2	2	/	/	/
Total	**18,829**	**62**	**35**	**17**	**9**	**1**

Në tabelën më lartë, është paraqitur numri i rasteve trashëgimore për të cilat trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit dhe format e testamenteve të cilat janë aplikuar. Ashtu, sikurse mund të shihet edhe nga tabela, prej 62 rasteve për të cilat trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit në Gjykatat Komunale gjegjësisht Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë:

- për 35 (56%) raste trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit gjyqësor;
- për 17 (27.4%) raste trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit në praninë e dëshmitarëve;
- për 9 (14.5%) raste trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit ollograf apo të shkruar nga vetë testatori**;** dhe
- për 1 (1.6%) rast trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit gojor**.**

Pra, krahasuar më numrin e përgjithshëm të rasteve për të cilat trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit, testamenti gjyqësor paraqet formën më të aplikuar të testamentit në praktikë.Mendojmë se kjo fomë e testamentit aplikohet më së shumti nga ana e trashëgimlënësve, sepse paraqet më tepër siguri juridike, për vet faktin se testamentin e harton gjykatësi. Kjo formë e testamentit përjashton mundësinë e disponimeve që bien në kundërshtim më ligjin, të cilat do ta bënin të pavlefshëm testamentin, sepse testatori nëpërmjet gjyqtarit njihet më dispozitat juridike më të cilat rregullohet trashëgimia testamentare

gjegjësisht gjyqtari është i detyruar që personin që do të bëjë testamentin ta njohë me të gjitha kërkesat ligjore për vlefshmërinë e testamentit.

2.3.3.1. Trashëgimtarët të cilët kanë përfituar nga trashëgimia testamentare

Siç dihet testatori nuk është i lirë të disponojë gjithë pasurinë e tij më testament. Përkatësisht, më testament testatori nuk mund të cënojë pjesën e personave që kanë të drejtë në pjesën e domosdoshme. Sipas LTK, testatori nuk mund t'i përjashtojë nga trashëgimi dhe as të cënojë pjesën (1/2) që u takon fëmijëve të tij dhe pasardhësve të tyre, bashkëshortit pasjteues dhe prindërve të tij. Gjithashtu, sipas LTK, testatori nuk mund të cënojë as pjesën (1/3) e gjyshërve dhe motrave e vëllezërve të tij, në qoftë se ata nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë. Personat e përmendur më sipër, e përbëjnë rrethin e trashëgimtarëve të domosdoshëm.Në rastin kur testatori më testament, e cënon pjesën e domosdoshme, më qëllim të përmbushjes së pjesës së domosdoshme bëhet zvogëlimi i disponimit më testament. Zvogëlimi i dispozitave testamentare, bëhet vetëm në bazë të kërkesës së trashëgimtarit të domosdoshëm, që do të thotë gjykata nuk i ndan trashëgimtarit të domosdoshëm pjesën e tij trashëgimore pa e kërkuar atë. Në praktikë, jo rrallë herë ndodhë që të cënohet më testament pjesa e domosdoshme, e sidomos pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve femra. Gjatë analizimit të rasteve trashëgimore konkretisht rasteve për të cilat trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit, kemi vërejtur shumë raste ku trashëgimlënësi e ka cënuar pjesën e domosodoshme.Mirëpo,trashëgimtarët pjesa trashëgimore e të cilëve është cënuar, gati asnjëherë nuk e kanë kontestuar vlefshmërinë e testamentit dhe nuk kanë kërkuar që t'i përmbushet pjesa e domosdoshme. Më poshtë,do përmendëm disa nga rastet e tilla. Kështu:

- Gjykata Komunale në Prishtinë, në vitin 2006, në një rast ka shqyrtuar trashëgiminë e trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 2005 dhe i cili për pasurinë e luajtshme ka lënë testament të hartuar në praninë e dëshmitarëve (alografik). Më testament pasurinë e luajtshme të përbërë prej 42 kg ari të punuar prej 14 dhe 18 karatëve, trashëgimlënësi e ka disponuar në favor të djemve gjegjësisht të dy djemve ju ka ndarë nga 22 kg ari. Gjatë procedurës gjykata ka vërtetuar që prej trashëgimtarëve ligjorë trashëgimlënësi, veç djemve ka lënë edhe bashkëshortën dhe vajzën dhe se përveç pasurisë së luajtshme të përfshirë ne testament, ka lënë edhe pasuri të paluajtshme. Në seancën për shqyrtimin e trashëgimisë, bashkëshortja dhe vazja e trashëgimlënësit kanë deklaruar se nuk e

kundërshtojnë përmbajtjen e testamentit dhe se heqin dorë edhe nga trashëgimia mbi sendet e paluajtshme që ju takon sipas ligjit. Kurse, djemtë janë deklaruar se e pranojnë edhe pjesën trashëgimore që ju takon sipas ligjit dhe i kanë propozuar gjykatës edhe marrëveshjen për mënyrën e ndarjes së trashëgimisë midis tyre. Kështu, duke qenë se bashkëshortja dhe vajza e trashëgimlënësit nuk e kanë kontestuar testamentin dhe nuk e kanë pranuar as pjesën e pasurisë që ju takon sipas ligjit, më të drejtë gjykata ka marrë vendim më të cilin në bazë të testamentit për pasurinë e luajtshme i ka shpallë trashëgimtarë djemtë. Gjithashtu edhe për pasurinë e paluajtshme, sipas bazës ligjore dhe marrëveshjes së trashëgimtarëve, trashëgimtarë janë shpallur trashëgimtarët testamentarë gjegjësisht djemtë e trashëgimlënësit.[702]

- Gjykata Komunale në Pejë, në vitin 2008, në një rast ka bërë shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 2006 duke lënë testament gjyqësor. Prej trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë ka lënë bashkëshortën dhe katër djemë. Më testamentin nr. 836/04 të dt.16.12.2004, i cili është hapur më dt.08.02.2008, trashëgimlënësi pasurinë e tij të paluajtshme në vlerë mbi 50.000 €, e ka disponuar në favor të tre djemve të tij, secilit nga 1/3 e pjesës ideale. Lidhur më përmbajtjen e testamentit janë deklaruar para gjykatës të gjithë trashëgimtarët kësisoj: Bashkëshortja ka deklaruar se nuk e konteston testamentin e bashkëshortit dhe nuk e kërkon pjesën e domosdoshme, e cila i takon në bazë të ligjit. Djali i cili nuk është përfshirë në testament gjithashtu është deklaruar se nuk e konteston testamentin, sepse është kompensuar nga babai sa ishte gjallë për pjesën që kishte më i taku në bazë të ligjit. Ndërsa, dy nga trashëgimtarët e përfshirë në testament kanë deklaruar se e pranojnë pjesën e lënë më testament dhe të njëjtën ja cedojnë vëllaut të tyre të përfshirë në testament. Në këtë rast gjykata më të drejtë ka marrë vendim që për trashëgimtarë testamentarë në tërë pasurinë e paluajtshme të shpallë djalin e trashëgimlënësit.[703]
- Gjykata Komunale në Pejë, në një rast në vitin 2009, e ka shqyrtuar trashëgiminë e trashëgimlënësit, i cili për pasurinë e paluajtshme ka lënë testament të shkruar më dorën e vetë (ollograf). Prej trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë ka lënë bashkëshortën dhe tre djemë. Në testament janë përfshirë vetëm djemtë, bashkëshortja është përjashtuar nga

[702] Vendimi: T.nr.273/06 datë 27.04.2006. Gjykata Komunale në Prishtinë
[703] Vendimi: T.nr. 17/08 datë 08.02.2008. Gjykata Komunale në Pejë

trashëgimia e pronës së paluajtshme të përfshirë në testament. Bashkëshortja ka deklaruar se nuk e konteston testamentin dhe nuk e kërkon pjesën e domosdoshme mbi paluajtshmëritë e lëna më testament. Ndërsa, sa i përkët pasurisë së luajtshme ka deklaruar se e pranon pjesën trashëgimore, e cila i takon në bazë të ligjit si trashëgimtarë e radhës së parë. Kurse, djemtë kanë deklaruar se e pranojnë pjesën trashëgimore, e cila u takon në bazë të testamentit, ndërsa për pasurinë e luajtshme kanë deklaruar se e pranojnë pjesën, e cila ju takon në bazë të ligjit dhe të njëjtën ja cedojnë nënës së tyre. Nga arsyet e përmendura më sipër, gjykata më të drejtë ka vendosur që në bazë të testamentit për trashëgimtarë të pasurisë së paluajtshme t'i shpallë djemtë e trashëgimlënësit, kurse sipas bazës ligjore për trashëgimtarë të pasurisë së luajtshme është shpallur bashkëshortja e trashëgimlënësit.[704] Gjykata Komunale në Pejë, në një rast tjetër në vitin 2009, ka shqyrtuar trashëgiminë e trashëgimlënësit, i cili ka lënë testament të shkruar në praninë e dëshmitarëve (alografik). Si trashëgimtarë ka lënë fëmijët gjegjësisht katër djemë dhe tri vajza. Më testament një pjesë të pasurisë së tij të paluajtshme, e ka disponuar në favor të tre djemve të tij. Pra, në testament nuk janë përfshirë vajzat dhe djali i trashëgimlënësit. Vajzat janë deklaruar para gjykatës se nuk e kontestojnë testamentin dhe se heqin dorë edhe nga pjesa e pasurisë që ju takon sipas ligjit. Gjithashtu edhe djali tjetër i trashëgimlënësit, i cili nuk është përfshirë në testament është deklaruar se nuk e kundërshton testamentin dhe se heqë dorë edhe nga pjesa e pasurisë që i takon sipas ligjit. Kurse, trashëgimtarët testamentare kanë deklaruar se e pranojnë trashëgiminë e lënë më testament. Në këtë rast gjykata më të drejtë ka marrë vendim që edhe për pjesën e trashëgimisë që nuk është përfshirë në testament, trashëgimtarë të shpallen trashëgimtarët testamentarë, pasi trashëgimtarët e tjerë kanë hequr dorë nga trashëgimi.[705]

- Gjykata Komunale në Prizren, në vitin 2008, në një rast ka shqyrtuar trashëgiminë e trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 1989, duke lënë testament të hartuar para gjykatës dhe prej trashëgimtarëve ligjorë ka lënë tre djemë dhe një vajzë. Më testamentin gjyqësor nr. 908/85 dt. 30.09.1985, trashëgimlënësi tërë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme e ka disponuar në dobi të djemve, vajzën nuk e ka përfshirë në trashëgimi. Vajza ka deklaruar para gjykatës se nuk e konteston vlefshmërinë e testamentit dhe nuk e kërkon pjesën e domosdoshme që i takon në bazë të ligjit. Kurse, trashëgimtarët

[704] Vendimi: T.nr. 167/09 datë 22.10.2009. Gjykata Komunale në Pejë
[705] Vendimi: T.nr. 150/09 datë 11.09.2009. Gjykata Komunale në Pejë

testamentare kanë deklaruar se e pranojnë trashëgiminë e lënë më testament. Për këtë, gjykata më të drejtë ka marrë vendim që për trashëgimtarë në tërë pasurinë të shpallen trashëgimtarët testamentarë.[706]

- Gjykata Komunale në Prizren, në vitin 2005, në një rast ka shqyrtuar trashëgiminë e trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 2002, duke lënë testament gjyqësor. Prej trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë ka lënë vajzën dhe sipas të drejtës së përfaqësimit nga djali i ndjerë, ka lënë renë dhe dy nipa. Më testamentin nr. 19/96 të dt.30.01.1996, trashëgimlënësi tërë pasurinë e tij, e ka disponuar në favor të resë dhe dy nipave. Pra, vajza nuk është përfshirë në testament. Para gjykatës, lidhur më përmbajtjen e testamentit vajza është deklaruar se nuk e kundërshton testamentin dhe nuk e kërkon pjesën e domosdoshme,e cila i takon në bazë të ligjit. Ndërsa, trashëgimtarët testamentarë kanë deklaruar se e pranojnë trashëgiminë e lënë më testament. Për këtë, gjykata më të drejtë ka marrë vendim që në tërë pasurinë trashëgimore në bazë të testamentit si trashëgimtarë të shpallen trashëgimtarët testamentarë.[707]
- Gjykata Komunale në Prizren, në vitin 2009, në një rast ka shqyrtuar trashëgiminë e trashëgimlënësit, i cili poashtu ka lënë testament të hartuar para gjykatës, kurse si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë ka lënë bashkëshortën, vajzën dhe dy djemë. Më testamentin nr. 286/07 të dt.31.05.2007, trashëgimlënësi tërë pasurinë e ka disponuar në favor të fëmijëve, bashkëshortën nuk e ka përfshirë në trashëgimi. Bashkëshortja ka deklaruar para gjykatës se nuk e konteston vlefshmërinë e testamentit dhe nuk e kërkon as pjesën e domosdoshme, e cila i takon sipas ligjit. Kurse, trashëgimtarët testamentarë kanë deklaruar se e pranojnë trashëgiminë e lënë më testament. Në këtë rast, gjykata më të drejtë ka marrë vendim që në bazë të testamentit në tërë masën trashëgimore trashëgimtarë të shpallen trashëgimtarët testamentarë.[708]
- Gjykata Komunale në Pejë, në vitin 2007, në një rast ka bërë shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në vitin 2006, duke lënë testament gjyqësor. Kurse, prej trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë ka lënë bashkëshortën, dy vajza dhe katër djemë. Më testamentin nr.13/2000 të dt.16.06.2000, i cili është hapur më dt.19.09.2006, trashëgimlënësi pasurinë e tij të paluajtshme në vlerë mbi 500.000 €, e ka disponuar në

[706] Vendimi: T.nr.160/08 datë 01.07.2008. Gjykata Komunale në Prizren
[707] Vendimi: T.nr.94/05 datë 25.04.2005. Gjykata Komunale në Prizren
[708] Vendimi: T.nr.183/08 datë 21.08.2009. Gjykata Komunale në Prizren

favor të katër djemve, të cilëve ju ka lënë detyrim të përmbushin në dobi të motrave të tyre legun konkretisht dy prej trashëgimtarëve testamentare ju ka lënë detyrim të paguajnë shumën prej 50.000 DM (të konvertuara në euro) dhe dy trashëgimtarëve tjerë shumën prej 25.000 DM (të konvertuara në euro) në dobi të motrave të tyre në këtë rast vajzave të trashëgimlënësit. Trashëgimtarët testamentare kanë deklaruar para gjykatës se e pranojnë trashëgiminë e lënë më testament e gjithashtu edhe detyrimin e legut. Vajzat kanë deklaruar se nuk e kundërshtojnë testamentin dhe se pranojnë që të ju paguhet legu i lënë më testament. Kurse, bashkëshortja e trashëgimlënësit e cila nuk ka përfituar asgjë nga testamenti, është deklaruar se nuk i intereson pjesa e domosdoshme që i takon sipas ligjit dhe se pajtohet më përmbajtjen e testamentit. Në këtë rast, gjykata më të drejtë ka marrë vendim që në bazë të testamentit trashëgimtarë nen detyrimin e pagimit të legut të shpallen djemtë e trashëgimlënësit.[709]

- Gjykata Komunale në Prizren në vitin 2004, ka shqyrtuar në një rast trashëgiminë e trashëgimlënësit që ka vdek në 2004, duke lënë testament gjyqësor, kurse prej trashëgimtarëve ligjore ka lënë dy djemë dhe dy vajza. Më testamentin nr.13/2001 i dt. 19.01.2001, trashëgimlënësi tërë pasurinë e ka disponuar në favor të djemve, duke i përjashtuar në këtë mënyrë vajzat nga trashëgimia.Vajzat kanë deklaruar se nuk e kundërshtojnë përmbajtjen e testamentit dhe se heqin dorë edhe nga pjesa e pasurisë që ju takon sipas ligjit. Kurse, trashëgimtarët testamentarë kanë deklaruar se e pranojnë trashëgiminë e lënë më testament. Në bazë të kësaj, gjykata ka nxjerrë vendim që në bazë të testamentit për trashëgimtarë në tërë pasurinë trashëgimore të shpallen djemtë e trashëgimlënësit.[710] Në një rast tjetër në vitin 2004, Gjykata Komunale në Prizren, ka shqyrtuar trashëgiminë e trashëgimlënësit, i cili poashtu ka lënë testament gjyqësor dhe në testament nuk i ka përfshirë vajzat. Përkatësisht prej trashëgimtarëve ligjorë ka lënë 4 djemë dhe 3 vajza. Kurse, më testamentin nr.539/93 i dt.31.08.1993 dhe nr.147/95 dt. 25.12.1995, tërë pasurinë e ka disponuar në dobi të djemve. Vajzat nuk e kanë kontestuar testamentin dhe nuk e kanë kërkuar pjesën e domosdoshme. Ndërsa, trashëgimtarët testamentarë e kanë pranuar trashëgiminë e lënë më testament[711].

[709] Vendimi: T.nr.118/06 datë 11.12.2007. Gjykata Komunale në Pejë
[710] Vendimi: T.nr.194/04 datë 05.10.2004. Gjykata Komunale në Prizren
[711] Vendimi: T.nr.91/04 datë 12.05.2004. Gjykata Komunale në Prizren

- Gjykata Komunale në Pejë, në vitin 2005, në një rast ka bërë shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënsës, e cila ka vdekur në vitin 1989, duke lënë testament gjyqësor. Prej trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë ka lënë djalin. Më testamentin nr. 636/83 të dt.28.07.1983, trashëgimlënësja tërë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme e ka disponuar në favor të vëllaut të saj. Trashëgimtari ligjor nuk e ka kundërshtuar testamentin dhe nuk e ka kërkuar pjesën e domosdoshme. Në këtë rast, gjykata më të drejtë ka marrë vendim që në bazë të testamentin të shpallet trashëgimtarë vëllau i trashëgimlënsës.[712]

Nga shembujt e parashtruar më lartë,mund të nxjerrim përfundim se trashëgimtarët ligjorë, të cilëve më shpeshti u cënohet pjesa e domosdoshme në praktikë, janë trashëgimtarët femra.Kurse, trashëgimtarët të cilët përfitojnë më së shpeshti nga trashëgimia testamentare janë trashëgimtarët meshkuj gjegjësisht djemtë e trashëgimlënësit. Është e rëndësishme të përmendet se në rastet kur femrave më testament u ndahet trashëgimia, ato rrallë herë ndodhë të heqin dorë nga trashëgimia. Megjithatë, edhe në rastet kur trashëgimtarët femra përfshihen në testament, në shumicën e rasteve atyre nuk u ndahet trashëgimia, në pjesë të barabarta më trashëgimtarët meshkuj, zakonisht trashëgimtarëve meshkuj u ndahet pjesë më e madhe e trashëgimit.

[712] Vendimi: T.nr.101/05 datë 08.08.2005. Gjykata Komunale në Pejë

2.3.3.1. Format e testamenteve të cilat janë kundërshtuar nga trashëgimtarët

Nga analizimi i 18,891 rasteve të trashëgimisë, për 11 raste kemi vërejtur se është ndërprerë procedura trashëgimore për shkak së trashëgimtarët e kanë kundërshtuar përmbajtjen apo vlefshmërinë e testamentit. Kështu: -në 6 raste është kundërshtuar forma e testamentit ollograf; -në 3 raste është kundërshtuar forma e testamentit alograf; si dhe në 2 raste tjera është kundërshtuar forma e testamentit gjyqësor.

Tabela 20: Numri i rasteve në të cilat trashëgimtarët e kanë kundërshtuar testamentin dhe janë udhëzuar në kontest civil

Viti	Nr. i rasteve në të cilat palët e kanë kundërshtuar testamentin	Testamenti Gjyqësor	Testamenti Alograf	Testamenti Ollograf	Testamenti Gojor
2003	/	/	/	/	/
2004	3	1	1	1	/
2005	1	/	/	1	/
2006	1	/	/	1	/
2007	1	1	/	/	/
2008	1	/	/	1	/
2009	1	/	/	1	/
2010	1	/	/	1	/
2011	/	/	/	/	/
2012	1	/	1	/	/
2013	/	/	/	/	/
2014	1	/	1	/	/
Total	11	2	3	6	0

Në këto raste, testamenti është kundërshtuar nga ana e trashëgimtarëve për shkak të mospajtimit lidhur më mënyrën e ndarjes së trashëgimisë në testament,duke hedhur dyshime mbi aftësinë mendore të testatorit. Më poshtë do përmendim disa nga rastet e tilla. Kështu:

- Në Gjykatën Komunale në Prizren, në vitin 2004, është inicuar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënsës, e cila ka vdekur në v.1998, duke lënë testament gjyqësor.[713] Kurse, prej trashëgimtarëve ligjorë ka lënë katër vajza dhe një djalë. Në testament janë përfshirë të gjithë trashëgimtarët ligjorë. Vajzat e trashëgimlënsës, kanë deklaruar se e pranojnë si të vlefshëm testamentin dhe së i pranojnë pjesët e tyre të lëna më testament, duke ia mohuar të drejtën në trashëgimi vëllaut të tyre. Ndërsa, djali i trashëgimlënsës ka deklaruar

[713] Testamenti gjyqësor Ndr.Nr. 26/97 të datë 24.02.1997 Gjykata Komunale në Prizren

se në tërësi e konteston testamentin gjyqësor, për shkakun se i njëjti testament është hartuar në kohën kur trashëgimlënsja nuk ka qenë në vetëdijë të plotë dhe se testamenti nuk përfaqëson vullnetin e lirë të trashëgimlënsës, sepse i njëjti është bërë nën presionin e trashëgimtarëve tjerë ligjorë, në këtë rast vajzave të trashëgimlënësës. Duke u bazuar në deklaratat e palëve, gjykata ka marrë vendim në bazë të të cilit është ndërprerë procedura e shqyrtimit të trashëgimisë dhe trashëgimtari ligjor gjegjësisht djali i trashëgimlënsës është udhëzuar të inicoj kontestin civil për vërtetimin e pavlefshmërisë së testamentit gjyqësor, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur aktvendimi për ndërprerjen e procedurës trashëgimore bëhet i plotëfuqishëm.[714]

- Gjykata Themelore në Mitrovicë, në një rast në vitin 2014, e ka ndërprerë procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka lënë testament të shkruar para dy dëshmitarëve (alograf), nga shkaku se trashëgimtarët e kanë kontestuar testamentin. Prej trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë ka lënë dy djemë dhe dy vajza. Kurse më testament trashëgimlënësi tërë pasurinë e ka disponuar në favor të nipit gjegjësisht djalit të vajzës. Vajza e trashëgimlënësit ka dhënë deklaratën trashëgimore se e pranon të vlefshëm testamentin dhe se nuk e konteston të drejtën në trashëgimi të djalit të saj, që i njëjti të shpallet trashëgimtarë në tërë pasurinë e paluajtshme të përfshirë në testament. Ndërsa, trashëgimtarët e tjerë ligjorë (vajza dhe dy djemtë e trashëgimlënësit) kanë deklaruar se e pranojnë trashëgiminë që ju takon në bazë të ligjit, kurse testamentin nuk e pranojnë si të vlefshëm,sepse në kohën kur është hartuar testamenti,gjendja shëndetësore e trashëgimlënësit ishte e atillë, sa nuk ka mund të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve të tij, sepse ai vuante nga sëmundja e diabetit, hipetensionit dhe ka qenë i traumatizuar nga lufta e fundit në Kosovë dhe se testamentin e ka bërë nën presionin e vajzës dhe nipit. Kurse, trashëgimtari testamentarë në këtë rast nipi i trashëgimlënësit ka deklaruar se nuk e konteston testamentin dhe se e pranon trashëgiminë e lënë më testament. Në këtë rast, duke qenë se në mes të trashëgimtarëve kanë ekzistuar fakte kontestuese nga të cilat varet e drejta në trashëgimi gjegjësisht vlefshmëria e testamentit, gjykata ka marrë vendim për ndërprerjen e procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe trashëgimtarët janë udhëzuar të inicojnë kontestin

[714] Vendimi: T.nr. 306/04 datë 27.12.2004 Gjykata Komunale në Prizren

civil brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur akvendimi për ndërprerjen e procedurës trashëgimore bëhet i plotëfuqishëm.[715]

- Gjykata Komunale në Prishtinë, në një rast, në vitin 2008, e ka ndërprerë procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili për pasurinë e luajtshme ka lënë testament të shkruar më dorën e vet (ollograf) dhe për pasurinë e paluajtshme (banesën) ka lënë kontratë për mbajtje të përjetshme. Kurse, prej trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë ka lënë: bashkëshortën,dy djemë, dy vajza dhe tre nipa. Në testament janë përfshirë të gjithë trashëgimtarët ligjorë. Bashkëshortja e trashëgimlënësit ka dhënë deklaratën trashëgimore se e pranon pasurinë trashëgimore, e cila i takon sipas ligjit pas vdekjes së bashkëshortit të saj, e njëherit ka shtuar se e konteston testamentin, duke theksuar se i njëjti është i falsifikuar. Ndërsa, sa i përkët paluajtshmërisë (banesës), bashkëshortja e trashëgimlënësit ka deklaruar se më dt.23.09.1994, trashëgimlënësi ka lidhur kontratë për mbajtje të përjetshme më të birin e tij, e cila kontratë është vërtetuar në gjykatë dhe se lidhur më të, është duke u zhvilluar aktualisht kontest i veçantë në gjykatë. Djemtë dhe njëra vajza e trashëgimlënësit kanë deklaruar se e pranojnë trashëgiminë se u takon sipas ligjit pas vdekjes së babait të tyre. Kurse, vajza tjetër e trashëgimlënësit ka deklaruar gjithashtu se e pranon trashëgiminë se i takon sipas ligjit, duke shtuar së në masën trashëgimore të trashëgimlënësit, nuk është përfshirë pasuria e paluajtshme (banesa) si dhe pasuria e luajtshme (mjetet) sipas librezës së kursimit të cekura në testament. Ndërsa, sipas të drejtës së përfaqësimit pas vdekjes së babait të tyre, nipat e trashëgimlënësit kanë deklaruar se e pranojnë trashëgiminë e cila u takon sipas ligjit pas vdekjes së gjyshit të tyre. Në këtë rast,duke qenë se mes trashëgimtarëve ka qenë kontestuese faktet nga të cilat varet madhësia e pjesës trashëgimore gjegjësisht se a është përfshirë e gjithë pasuria e trashëgimlënësit në masën trashëgimore si dhe vërtetësia e testamentit dhe kontratës për mbajtje të përjetshme, gjykata ka marrë vendim që të ndërprehet procedura e trashëgimisë dhe trashëgimtarët ligjorë (bashkëshortja dhe vajza e trashëgimlënësit) janë udhëzuar që të inicojnë konestin civil brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur aktvendimi për ndërprerjen e procedurës trashëgimore bëhet i plotëfuqishëm.[716]

Në të tri rastet e parashtruara më sipër, gjykatat gjegjësisht Gjykata Komunale në Prizren, Gjykata Komunale në Prishtinë si dhe Gjykata Themelore në Mitrovicë, kanë vepruar drejtë kur

[715] Vendimi: CT.Nr. 34/2014 datë 17.11.2014 Gjykata Themelore në Mitrovicë
[716] Vendimi: T. Nr. 73/07 Datë 01.12.2008 Gjykata Komunale në Prishtinë

e kanë bërë ndërprerjen e procedurës dhe udhëzimin e palëve në kontest civil, sepse në rastet konkrete janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara më ligj që të bëhet ndërprerja e procedurës. Përkitazi më ndërprerjën e procedurës trashëgimore dhe udhëzimin e palëve në kontest civil, në nenin 166 par.1 i LPJK, parashikohet kësisoj:

"*Gjykata trashëgimore e ndërpretë procedurën dhe i udhëzon trashëgimtarët që të fillojnë procedure kontestimore në gjykatë ose procedurën në organin administrativ po qe se ndërmjet tyre janë kontestuese faktet nga të cilat varet ndonjë e drejtë e tyre lidhur me trashëgimin."*

Kurse, në par.2 i nenit të cituar më sipër, përmendën faktet kontestuese për të cilat, gjykata është e obliguar domosdo të ndërprerjë procedurën trashëgimore, ndër to në pikën a dhe c, përmenden edhe këto dy fakte:

"a) faktet nga të cilat varet e drejta për trashëgim, e sidomos vlefshmëria ose përmbajtja e testamentit ose marrëdhënia e trashëgimtarit dhe e trashëgimlënësit në bazë të së cilës bëhet trashëgimi sipas ligjit;

"c) faktet nga të cilat varet madhësia e pjesës trashëgimore, vlera e pjesës së detyrueshme (domosdoshme) e sidomos e pjesës që përfshihet (llogaritet) me pjesën trashëgimore."

Kurse në nenin 169 par.1 i LPJK parashikohet kësisoj: "Gjykata do të ndërpresë procedurën trashëgimore dhe do t'i udhëzojë palët që të inicojnë procedurën kontestimore ose atë administrative në qoftë se ndërmjet tyre janë kontestuese faktet: a) nga të cilat varet përbërja e pasurisë trashëgimore." Si dhe në nenin 170 par.1 dhe 2 i LPJK parashikohet kësisoj: "Gjykata do të udhëzoj për inicimin e procedurës kontestimore ose atë administrative palën të drejtën e së cilës e konsideron më pak të besueshme. Në qoftë se gjykata e ndërpret procedurën trashëgimore, atëherë ajo e cakton një afat, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë, brenda të cilit duhet të inicohet procedura kontestimore përkatësisht procedura administrative në organin kompetent." Nga kjo rezulton se në rastet e parashtruara më lartë, gjykatat kanë vepruar drejtë kur e kanë bërë ndërprerjen e procedurës dhe udhëzimin e palëve në kontest civil, duke u mbështetur plotësisht në rregullat e parapara më ligj.

Është më rëndësi të përmendet, se në disa prej rasteve për të cilat është ndërprerë procedura për shkak të lindjes se kontestit për vlefshmërinë e testamentit, trashëgimtarët nuk kanë vepruar konformë udhëzimit të gjykatës gjegjësisht nuk e kanë inicuar procedurën kontestimore për vërtetimin e vlefshmërisë së testamentit. Për këtë,gjykata ka vazhduar shqyrtimin e trashëgimisë në procedurë jokontestimore, pavarësisht udhëzimit të dhënë. Kështu:

- Në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në vitin 2004, është inicuar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësës, e cila ka lënë testament të shkruar më dorën e vet (ollograf), kurse prej trashëgimtarëve ligjorë ka lënë tre djemë dhe një vajzë, ndërsa më testament tërë pasurinë e ka disponuar në favor të njërit djalë. Njëri prej trashëgimtarëve ligjor gjegjësisht djali e ka kontestuar testamentin nga shkaku se testatorja në kohën kur e ka hartuar testamentin ka qenë e sëmurë dhe e paaftë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të saja. Kurse, trashëgimtarët e tjerë ligjorë nuk e kanë kontestuar testamentin. Meqenëse, gjykata në këtë rast ka konsideruar se mes pjesëmarrësve në procedurë janë kontestuese faktet të cilat kanë të bëjnë më vlefshmërinë e testamentit, më 26.06.07 ka nxjerrë aktvendimin më të cilin është ndërprerë procedura dhe trashëgimtari, i cili e ka kontestuar testamentin është udhëzuar që të inicoj procedurën kontestimore brenda 30 ditëve, për ti vërtetuar faktet të cilat janë kontestuese midis tyre.[717] Pasi trashëgimtari nuk e ka filluar procedurën kontestimore, në vitin 2008 gjykata më propozimin e trashëgimtarit testamentarë, ka vazhduar shqyrtimin e trashëgimisë në procedurë jokontestimore pavarësisht udhëzimit të dhënë. Më ç'rast më dt.10.07.2008, gjykata ka marrë vendim që për trashëgimtarë në bazë të testamentit në tërë pasurinë të shpallet trashëgimtari testamentarë.[718]
- Në Gjykatën Komunale në Prizren, në vitin 1998 është inicuar procedura trashëgimore për trashëgimlënësin, i cili ka lënë testament gjyqësor[719], kurse prej trashëgimtarëve ligjorë ka lënë: djalin, nipin, mbesën dhe gjashtë vajza. Më testament, trashëgimlënësi tërë pasurinë e ka disponuar në favor të vajzës. Djali i trashëgimlënësit, e ka kundërshtuar në tërësi përmbajtjen e testamentit. Për këtë aryse, më aktvendimin nr. 26/1998 dt.24.03.1998, gjykata e ka ndërprerë procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë dhe e ka udhëzuar trashëgimtarin ligjorë që e ka kundërshtuar testamentin të filloj procedurën kontestimore.[720] Në vitin 2011, trashëgimtarja testamentarë ka paraqitur propozimin për vazhdimin e procedurës trashëgimore, më arsyetimin se trashëgimtari që e ka kontestuar testamentin nuk ka ndërmarrë veprime procedurale për të filluar procedurën kontestimore. Gjykata e ka aprovuar propozimin, më ç'rast ka filluar procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë dhe më

[717] Vendimi: T. Nr. 266/04 Datë 26.06.2007 Gjykata Komunale në Prishtinë
[718] Vendimi: T. Nr. 266/04 Datë 10.07.2008 Gjykata Komunale në Prishtinë
[719] Testamenti gjyqësor nr.39/91 të dt.15.01.1991.Gjykata Komunale në Prizren
[720] Vendimi: T. Nr. 26/1998 Datë 24.03.1998 Gjykata Komunale në Prizren

dt.13.07.2011, ka marre vendim që për trashëgimtarë në tërë pasurinë trashëgimore të shpallet trashëgimtarja testamentarë.[721]

Në të dy rastet e përmendura më sipër, gjykatat gjegjësisht Gjykata Komunale në Prishtinë dhe Gjykata Komunale në Prizren, kanë vepruar drejtë kur e kanë vazhduar shqyrtimin e trashëgimisë në procedurë jokontestimore. Kjo situatë rregullohet në nenin 170 par.4 i LPJK ku thuhet: "*Në qoftë se pala brenda afatit të caktuar nuk vepron sipas vendimit të gjykatës, procedura e ndërprerë do të vazhdohet dhe përfundoj pa u marrë parasysh kërkesa lidhur me të cilën pala është udhëzuar të inicoj procedurën kontestimore ose administrative*".

Ndryshe nga rastet e parashtruara më lartë, në dy raste kemi vërejtur që gjykata ka vepruar jo drejtë, në një rast kur e ka ndërprerë procedurën trashëgimore si dhe në një rast tjetër kur e ka zhvilluar procedurën trashëgimore në procedurë jokontestimore edhe pse midis pjesëmarrësve ka ekzistuar kontesti lidhur më vlefshmërinë e testamentit. Kështu:

- Gjykata Komunale në Gjilan, në vitin 2007 në një rast, e ka ndërprerë procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, i cili ka vdekur në v.2002, dukë lënë testament gjyqësor.[722] Kurse, prej trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë ka lënë vetëm djalin e adoptuar. Në testament trashëgimlënësi ka shprehur dëshirën që gjithë pasurinë e tij të luajtshme dhe të paluajtshme (shtëpinë) ta trashëgojë djali i tij i adoptuar dhe i ka lutur nipat (fëmijët e vëllezërve) dhe anëtarët e tjerë më të largët të famijes, t'ia respektojnë dëshirën e fundit. Gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore përkatësisht në seancën e dt.16.06.2007, gjykata e ka rekomanduar trashëgimtarin testamentarë që në afat prej 15 ditësh ta prezantojë aktvendimin mbi themelimin e adoptimit. Në seancën e mbajtur më dt.16.07.2007, trashëgimtari testamentarë ka deklaruar se nuk ka arritur të siguroje aktvendimin mbi themelimin e adoptimit, ngase ka kaluar kohë e gjatë. Për këtë gjykata pa të drejtë ka marrë aktvendim që të ndërprejë procedurën trashëgimore dhe e ka udhëzuar trashëgimtarin testamentarë që në afatin prej 30 ditësh të inicojë kontestin civil.[723] Kundër këtij aktvendimi, trashëgimtari testametarë ka ushtruar më kohë ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, më të cilën në tërësi e ka kontestuar aktvendimin si të pabazuar për shkak: të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës jokontestimore; aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktvendimi i

[721] Vendimi: T. Nr. 26/1998 Datë 13.07.2011 Gjykata Komunale në Prizren
[722] Testamenti gjyqësor N.nr.125/98 i datës 03.12.1998.Gjykata Komunale në Gjilan
[723] Vendimi: T.nr. 126/07 datë 16.07.2007 Gjykata Komunale në Gjilan

atakuar të prishet dhe lënda të kthehet për rivendosje në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e Qarkut, e ka shqyrtuar aktvendimin e atakuar dhe ka gjetur se i njëjti është marrë më shkelje esenciale të dispozitave të procedurës jokontestimore dhe dispozitave të së drejtës materiale. Për këtë në seancën e mbajtur më dt.06.08.2007, më të drejtë Gjykata e Qarkut ka marrë aktvendim në bazë të të cilit është aprovuar ankesa e propozuesit dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.[724]Aktvendimi i atakuar është marrë më shkelje të dispozitave të procedurës jokontestimore, për aryse se asnjëri nga faktet e parapara më LPJK, për të cilat ndërprehet procedura trashëgimore dhe inicohet kontesti civil, nuk kanë ekzistuar në rastin konkret. Përkatësisht, nuk ka ekzistuar kontesti lidhur më vlefshmërinë e testamentit dhe as lidhur më të drejtën e trashëgimit apo masën e trashëgimit të përfshirë në testament. Në rastin konkret, meqenëse ka ekzistuar testamenti gjyqësor, i hartuar sipas kushteve të parapara më ligj dhe trashëgimtarë tjerë ligjorë, përveç trashëgimtarit testamentarë nuk ka pasur, gjykata e shkallës së pare është dashur ta shpallë trashëgimtarë trashëgimtarin testamentarë, pavarësisht prej faktit nëse trashëgimtari testamentarë është ose jo djali i adoptuar i trashëgimilënësit.

- Në Gjykatën Komunale në Ferizaj në vitin 2007, më kërkesën e trashëgimtarëve është inicuar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënsës, e cila ka vdekur në v.2004, kurse prej trashëgimtarëve ligjorë ka lënë djalin dhe vajzën. Në seancën e mbajtur pranë kësaj gjykate, vajza e trashëgimlënsës ka deklaruar se nëna e saj ka lënë testament më gojë para dëshmitarëve dhe së lidhur më këtë sipas lëndës 117/07, i njëjti është shpallur sipas procesverbalit në seancën e mbajtur më 17.05.2007. Sipas këtij testamenti e tërë pasuria e paluajtshme i është lënë asaj. Ndërsa, trashëgimtari tjetër djali i trashëgimlënsës, ka deklaruar se nuk e ka të njohur këtë fakt. Duke u nisur nga këto rrethana gjykata i ka siguruar shkresat e lëndës 117/07 dhe kuptoi se sipas kësaj lëndë është shpallur testamenti në seancën e mbajtur më 17.05.2007. Përkatësisht, në seancën e mbajtur më 17.05.2007 është bërë shpallja e testamentit gojor në bazë të dëgjimit të tre dëshmitarëve, të cilët kanë pasur lidhje familjare më trashëgimlënsën. Kështu, njëri dëshmitar ka qenë nipi i trashëgimlënsës, dëshmitari tjetër ka qenë mbesa e trashëgimlënsës si dhe dëshmitari tjetër ka qenë dhëndërr i familjes së trashëgimlënsës. Para gjykatës dëshmitarët kanë deklaruar se trashëgimlënësja në formë të amanetit, në pamundësi për të lënë testament më shkrim, ju ka përmendur se duke qenë që

[724] Vendimi: AC.nr. 300/07 datë 06.08.07 Gjykata e Qarkut në Gjilan

djalit për së gjalli i ka dhuruar një pjesë të pasurisë së paluajtshme, pronën tjetër të paluajtshme (shtëpine) dëshiron të ja lë në trashëgim vajzës.[725] Duke u nisur nga kjo gjendje, në seancën e mbajtur më 28.06.2007, gjykata ka marrë aktvendim që në bazë të testamentit gojor për trashëgimtarë të shpallë vajzën e trashëgimlënsës. Duhet theksuar se dispozitivi dhe arsyetimi i aktvendimit në fjalë, janë kontradiktor mes veti, kështu në pjesën e parë të dispozitivit të aktvendimit thuhet:

"Shpallet trashëgimtarë: e bija e të ndjerës R.B në tërë pasurinë ne emër të ndjerës, ***në bazë të testamentit gojor*** *të shpallur sipas procesverbalit Nd.nr. 117/07 nga 17.05.2007. Nuk shpallet trashëgimtarë: i biri i të ndjerës N.K nga Ferizaji"*

Kurse, në pjesën e parë arsyetuese të aktvendimit thuhet:

"*Propozuesit pranë kësaj gjykate kanë ushtruar propozim për shqyrtimin e masës trashëgimore të lënë pas vdekjes së trashëgimlënsës E.K. ish nga Ferizaj,* ***e cila ka vdekur pa e shprehur vullnetin e saj të fundit*** *më 17.02.2004*"[726]

Kundër aktvendimit në fjalë, trashëgimtari ligjor gjegjësisht djali i trashëgimlënsës në afatin e lejuar ligjor ka ushtuar ankesë për të gjitha shkaqet ankimore të parapara më ligj, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke propozuar që aktvendimi ankimor të prishet dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë. Në ankesë ndër të tjera ankuesi ka theksuar së aktvendimi është marrë më shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, dhe se testamentin e ka kundërshtuar menjëherë kur është mbajtur seanca, dhe gjykata nuk e ka shënuar këtë fakt në procesverbal për këtë arsye ankuesi thotë se edhe ka refuzuar ta nënshkruajë procesverbalin. Ankuesi ka theksuar se e ka kundërshtuar testamentin nga shkaku se i njëjti testament nuk është deklaruar nga trashëgimlënësja.Trashëgimtarja është përgjigjur në ankesë duke theksuar se konstatimet e ankuesit janë të pabazuara dhe se ankesa duhet të refuzohet nga Gjykata e Qarkut, nga shkaku se vendimi është i drejtë dhe se në të njëjtin janë konstatuar të gjitha faktet vendimtare dhe provat lidhur më masën e trashëgimisë dhe se trashëgimlënësja për së gjalli i ka dhuruar djalit të adoptuar në këtë rast ankuesit një pjesë të pasurisë të paluajtshme dhe për pjesën tjetër të pasurisë ka lënë testament gojor në dobi të saj, i cili testament është vërtetuar në gjykatë. Kolegji i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, pas shqyrtimit të aktvendimit të atakuar dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa është e bazuar, për çka në seancën e mbajtur

[725] Procesverbal mbi shpalljen e testamentit gojor.Ndr.nr.117/07 i datës 17.05.2007.Gjykata Komunale në Ferizaj.
[726] Vendimi: T.nr.139/07 datë: 28.06.2007.Gjykata Komunale në Ferizaj.

më 27.05.2010, më të drejtë ka marrë aktvendim që të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Në pjesën e parë të arsyetimit të aktvendimit të Gjykatës së Qarkut thuhet kësisoj:

"Nga shkresat e lëndës rrjedhë se: gjatë procedurës së shqyrtimit të trashëgimisë, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje qenësore nga dispozitat e nenit 354 al.2 pika 14 e LPK-së, për të cilat kolegji është i detyruar të kujdeset kryesisht. Këto shprehje qenësore shprehen në faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit ankimor nuk ka paraqit arsye për faktet të cilat janë vendimtare për të gjykuar lidhur më këtë çështje jokontestimore, ndërsa aryset e paraqitura nuk janë në pajtueshmëri më përmbajtjen e deklaratës së trashëgimtarit N.K, e paraqitur në seancën e shqyrtimit të dt.28.06.2007,i cili e ka kontestuar faktin se trashëgimlënësja ia ka dhuruar trashëgiminë motrës së tij përkatësisht trashëgimtarës. Meqenëse aktvendimi i atakuar i përmbanë shkeljet qenësore të theskuara në paragrafin e mësipërm, për këto shkaqe dhe aryse të paraqitura ky aktvendim është prishë dhe çështja është kthyer në rigjykim."

Kurse, në pjesën e fundit të arsyetimit të aktvendimit të cituar më sipër thuhet kësisoj:

"Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta bëjë eliminimin e shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore në pajtim më vërejtjet e paraqitura dhe nëse trashëgimtari N.K e konteston të drejtën në trashëgimi të trashëgimtarës R.B si dhe testamentin gojor të trashëgimlënsës, atëherë gjykata do ta bëjë ndërprerjën e procedurës së shqyrtimit të trashëgimisë dhe trashëgimtarin do ta udhëzojë që këtë çështje kontestuese ta zgjidhë në procedurë kontestimore."[727]

Pra, Gjykata e Qarkut nuk është lëshuar në shqyrtimin e vlefshmërisë së testamentit gojor gjegjësisht në aktvendimin e Gjykatës se Qarkut nuk përmendet fakti se testamenti në bazë të të cilit ka vepruar gjykata e shkallës së pare nuk ka qenë i hartuar sipas kushteve të parapara më ligj për vlefshmërinë e testamentit gojor. Përkitazi më testamentin gojor, në nenin 81 i LTK thuhet: *"Testatori mund të deklarojë vullnetin e tij të fundit me gojë para dy dëshmitarëve, vetëm në qoftë se për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme nuk është në gjendje të bëjë testamentin me shkrim"* Më LTK, nuk specifikohet së cilat ngjarje konsiderohen rrethana të jashtëzakonshme në ekzistimin e të cilave testatorit i lejohet të bëjë testamentin më gojë. Sikurse, e kemi theksuar edhe më parë, në teorinë juridike më rrethana të jashtëzakonshme nënkuptohen rrethanat e

[727] Vendimi: Ac. Nr.111/2008 i dt.27.05.2010.Gjykata e Qarkut në Prishtinë

përgjithshme të cilat nuk janë të varura nga njeriu, si p.sh.,tërmeti, vërshima, aksidentat e rënda në komunikacion etj. Rrethana e jashtëzakonshme gjithashtu merret së ekziston edhe në rastin kur testatori sëmuret rëndë dhe gjendja e tij shëndetësore nuk pritet të përmirësohet. Në rastin konkret, nga procesverbali nr.117/07 i shpalljes së testamentit gojor gjegjësisht nga aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, rezulton se trashëgimlënësja nuk është gjendur në asnjërën nga këto rrethana. Pra,testamenti nuk është hartuar në rrethanat e jashtëzakonshme. Nga aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet gjithashtu se edhe deklarimi gjegjësisht shpallja e testamentit gojor është bërë jashtë afatit ligjor, kështu trashëgimlënësja ka vdekur më dt.17.02.2004,ndërkaq testamenti është shpallur si thuhet në arsyetimin e aktvendimit më 17.05.2007 sipas procesverbalit nr.117/07. Pra, deklarimi i testamentit është bërë 3 vite, pas vdekjes së trashëgimlënsës, kurse sipas ligjit dëshmitarët e testamentit më gojë kanë qenë të obliguar që në afat prej 30 ditësh ta deklarojnë testamentin në gjykatë. Lidhur më këtë në nenin 83 par.2 i LTK përcaktohet: "*Testamenti me gojë bëhet i pavlefshëm nëse nuk deklarohet në gjykatë nga dëshmitarët 30 ditë pas pushimit të rrethanave të jashtëzakonshme në të cilat ai është bërë"* Pra, gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas testamentit pa të drejtë e ka përfunduar procedurën trashëgimore, për arsye se testamenti ka pasur mangësi esenciale që e bëjnë të pavlefshëm. Veç kësaj, mes pjesëmarrësve ka ekzistuar kontesti lidhur më vlefshmërinë e testametit e gjithashtu edhe lidhur më të drejtën e trashëgimit, e siç dihet në këtë rast gjykata sipas ligjit, ka qenë e detyruar të ndërperjë procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë dhe palët t'i udhëzojë në kontest civil. Andaj, gjykata e shkallës së dytë më të drejtë ka marrë vendim,që të prishet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe çështja të kthehet në rigjykim. Seanca e shqyrtimit kryesor lidhur më çështjen e kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së pare, gjegjësisht në Gjykatën Komunale në Ferziaj është mbajtur më 24.10.2012 Vajza e trashëgimlënsës ka prezantuar personalisht në seancë,e cila ka deklaruar se heqë dorë plotësisht nga testamenti dhe pasuria e lënë në testament në llogari të vëllaut. Ndërsa, në emër të djalit të trashëgimlënsës në seancë ka prezantuar e autorizuara e tij gjegjësisht vajza e tij, e cila ka deklaruar së në emër të babait të saj e pranon tërë trashëgiminë, e cila i takon më ligj. Për këtë më 24.10.2012, gjykata ka marrë aktvendim që për trashëgimtarë në tërë pasurinë trashëgimore të shpallet djali i tashëgimlënsës.[728]

[728] Vendimi: T.nr.137/10 datë: 24.10.2012.Gjykata Komunale në Ferizaj.

5.3.4. Numri i trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, 2003-2014.

Në grafikun më poshtë, është paraqitur numri i trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekjet, e rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë.

Grafiku 4: Numri i trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014



	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Nr i trashëgimtarëve meshkuj të përfshire në aktvdekje	2625	2594	2827	2913	3331	3453	4,054	4132	3923	2626	260	105
Nr i trashëgimtarëve femra të përfshira në aktvdekje	2450	2273	2592	2568	2946	3019	3466	3737	3446	2260	219	92

Duke u nisur nga disa hulumtime të kryera në Kosovë, lidhur më të drejtën e femrës në trashëgimi, sipas të cilave del se përqindja e femrave të cilat trashëgojnë është shumë e ulët dhe se femrat në shumë raste nuk marrin pjesë në procedurë,[729] ne gjate analizimit të rasteve trashëgimore i kemi kushtuar kujdes të veçantë kësaj çështje, më ç'rast në se cilen gjykate në të cilen është kryer hulumtimi kemi nxjerrë të dhënat për se cilin vit të përfshirë në studim lidhur më atë se sa ka qenë numri i trashëgimtarëve femra dhe meshkuj të përfshirë në aktvdekje dhe sa nga trashëgimtarët e përfshirë në aktvdekje kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë. Kështu,

[729] Kështu, p.sh, sipas një hulumtimi të publikuar nga NORMA në vitin 2011, del se në shumë raste femrat nuk informohen fare për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësve të tyre dhe se numri më i madh i aktvdekjeve përmbajnë vetëm emrat e trashëgimtarëve meshkuj. Shih NORMA (2011) Fq 24

gjatë fazës së hulumtimit nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore (të viteve 2003-2014) në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, kemi vërtetuar se:

- Sa i përkët numrit të trashëgimtarëve femra dhe meshkuj të përfshirë në aktvdekje, nuk ekzistojnë dallime shumë të rëndësishme, sidomos nëse këtë e krahasojm edhe më numrin e përgjithshëm të popullsisë sipas gjinisë. Kështu, në aktvdekjet e 18,891 lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, numri i trashëgimtarëve të përfshirë është 61,911 prej tyre 32,843 (53%) meshkuj dhe 29,068 (47%) femra. Sipas raportit të fundit të publikuar nga ASK, në vitin 2011, numri total i popullsisë në Kosovë është 1,739,825 prej tyre janë: 863,925 femra (apo 49.6%) dhe 875,900 (50.4%) meshkuj.[730] Pra, përbërja e popullsisë sipas gjinisë është gati e njëjtë gjegjësisht për 0.40%, Kosova ka më shumë meshkuj se femra.
- Në disa gjykata sidomos në Gjykatën Komunale tash Themelore në Mitrovicë, kemi vërejtur se numri i trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje gjegjësisht të lajmëruar në gjykatë është i vogël. Në këtë gjykatë, në shumicën e rasteve të analizuara , kemi vërejtur që trashëgimlënësit nuk kanë lënë më tepër se dy trashëgimtarë. Në shumë raste kemi vërejtur se në aktvdekje është shënuar vetëm një trashëgimtarë zakonisht djali i trashëgimlënësit ose bashkëshortja. Përkatësisht, në Gjykatën Komunale tash Themelore në Mitrovicë, në aktvdekjet e 806 rasteve të trashëgimisë (të viteve 2008-2014) kanë qenë të përfshirë 1,559 trashëgimtarë, prej tyre 614 (39.4%) femra dhe 945 (60.6%) meshkuj, pra në bazë të kësaj i bie që trashëgimlënësit kanë lënë deri në dy trashëgimtarë më së shumti. Ndërsa, në gjykatat e tjera, rezulton që trashëgimlënësit kanë lënë nga tre deri në katër trashëgimtarë. Kështu:
- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Pejë, në aktvdekjet e 2,576 lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2013, numri i trashëgimtarëve të përfshirë është 10,151, prej tyre 4,936 (49%) femra dhe 5,215 (51%) meshkuj.
- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Gjilan, në aktvdekjet e 2,683 lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, numri i trashëgimtarëve të përfshirë është 9,564, prej tyre 4,423 (46%) femra dhe 5,141 (54%) meshkuj.

[730] Agjencia e Statistikave të Kosovës (prill 2013).Regjistrimi i Popullsisë Eknomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011 Rezultatet përfundimtare.Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe venbanimit.Prishtinë.Fq.11

- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Ferizaj, në aktvdekjet e 2,900 lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, numri i trashëgimtarëve të përfshirë është 11,287 prej tyre 5,220 (46.3%) femra dhe 6,067 (53.7%) meshkuj.
- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Prishtinë, në aktvdekjet e 5,893 lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, numri i trashëgimtarëve të përfshirë është 16,478, prej tyre 7,392 (45%) femra dhe 9,086 (55%) meshkuj.
- Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Prizren, në aktvdekjet e 4,033 lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, numri i trashëgimtarëve të përfshirë është 12,872, prej tyre 6,483 (50.3%) femra dhe 6,389 (49.7%) meshkuj.

Duke e pasur parasysh se numri mesatar i anëtarëve të familjes në Kosovë llogaritet të jetë deri në 6 anëtarë,[731] nga ajo që u tha më lartë mund të nxirret përfundimi se në aktvdekje, nuk shënohen të gjithë trashëgimtarët ligjorë, pra, ka fshehje të trashëgimtarëve.Fshehja e trashëgimtarëve gjegjësisht deklaratat e rremë në procedurë cilesohen si vepra penale dhe janë të dënueshme më burgim deri në tre vjet. Kjo rregull rezulton nga neni 391 i KPK[732] ku thuhet: *"Kushdo që pasi të ketë dhënë betimin pranë organit kompetent për të administruar dëshmitë e dhëna nën betim ose betimet dhe pastaj nënshkruan dëshminë nën betim ose deklaron diç që nuk beson se është e vërtetë ose me dijeni fsheh ose shmang nga deklarimi ndonjë çështje relevante për procedurën, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet"*. Kurse, ne nenin 392 i KPK thuhet: "*Pala, dëshmitari, eksperti në cilësi të dëshmitarit, përkthyesi apo interpreti i cili në procedurën gjyqësore, ne procedurën për kundërvajtje, ne procedurën administrative, ne procedurën para noterit publik ose ne procedurën disiplinore jep deklarate te rreme dënohet me gjobe dhe me burgim deri në një (1) vit. Nëse deklarata e rreme merret si bazë për vendimin përfundimtar në procedurë, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tri (3) vjet."*[733] Fshehja e trashëgimtarëve veçanërisht e trashëgimtarëve meshkuj, mendojmë se nuk bëhet gjithmonë më qëllim për t'i përjashtuar nga trashëgimia. Por, kjo bëhet më shumë për shkak të ikjes së procedurës së gjatë, sidomos në rastet kur kemi trashëgimtarë të cilët jetojnë jashtë Kosovës, ku marrja e deklaratave trashëgimore të të cilëve, mund të zgjasë më tepër se zakonisht përfundimin e procedurës. Këta trashëgimtarë edhe pse nuk shënohen në aktvdekje dhe nuk shpallen trashëgimtarë më vendim të gjykatës, ata e shfrytëzojnë pasurinë trashëgimore, kjo vlen

[731] Shih Agjencia e Statistikave të Kosovës (shkurt 2013). Vlerësim,Popullsia e Kosovës 2011,Prishtinë Fq.16
[732] Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.04/L-082 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.19/13Korrik 2012, Prishtinë) Shih nenin 391 par.1
[733] Po aty, shih nenin 392 par.1 dhe 2

për trashëgimtarët meshkuj. Në këto raste zakonisht trashëgimia ndahet më marrëveshje nga trashëgimtarët meshkuj, ndërsa i drejtohen vetëm formalisht gjykatës, ku më qëllim të përfundimit sa më të shpejtë të procedurës, trashëgimtarët merren vesh që vetëm disa prej tyre të deklarohen në gjykatë. P.sh.,në Gjykatën Themelore në Pejë, kemi hasur shumë raste në të cilat i kemi njohur personalisht palët, ku si trashëgimtarë janë lajmëruar në gjykatë vetëm një ose dy fëmijë ose vetëm bashkëshortja e trashëgimlënësit, të cilët edhe janë shpallur trashëgimtarë në tërë pasurinë trashëgimore, e në fakt ka pasur edhe trashëgimtarë të tjerë, të cilët paluajtshmërinë (tokën), e cila ka qenë e përfshirë në masën trashëgimore, e kanë në posedim, madje i kanë të ndërtuara objektet (shtepitë) në paluajtshmërinë e përfshirë në masën trashëgimore.

Gjatë fazës së hulumtimit gjegjësisht gjatë analizimit të rasteve trashëgimore, në gjykatat e përfshira në studim, nuk kemi vërejtur ndonjë rast për të cilin gjykata ka vërtetuar që janë fshehur trashëgimtarët ligjorë gjegjësisht nuk kemi vërejtur ndonjë rast për të cilin gjykata e ka inicuar procedurën në prokurori për dëshmi të rremë të trashëgimtarëve. Lidhur më çështjen në fjalë, kemi zhvilluar intervista edhe më disa nga gjyqtarët e gjykatave të përfshira në studim, edhe gjyqtarët janë shprehur se nuk kanë pasur raste të deklarimit të rremë në procedurë trashëgimore. Megjithatë, thojnë se e kanë të vështirë ti identifikojnë rastet e tilla, pasi nuk kanë ndonjë mekanizëm që të mund t'i verifikojnë deklaratat e trashëgimtarëve ligjorë lidhur më saktësinë e të dhënave të përmbajtura në aktvdekje. Si mekanizëm për verifikimin e rasteve të tilla, disa gjyqtarë e shohin krijimin e një çertifikatë familjare nga zyra për gjendje civile (ZGJC), e cila do të përmbantë të dhëna të sakta dhe të vërtetuara lidhur më anëtarët e familjes se personit të vdekur. Aktualisht, thuhet se mungesa e kapaciteteve teknike të menaxhimit të të dhënave në sistemin e regjistrimit civil, pengon ZGJC, që të krijojë këtë cerifikatë apo një listë të saktë të anëtarëve të familjes të një individi, duke i lidhur ata me individin nëpërmjet numrit personal të tij/saj[734]. Përveç krijimit të kësaj çertifikatë, raporti i programit të USAID-it, për të drejtat pronësore "Informaliteti në sektorin e tokave: Çështja e trashëgimisë së vonuar në Kosovë", në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja në procedurë e të gjithë trashëgimtarëve, gjen se duhet të shpërndahen sa më shumë informata lidhur më fillimin e procedurës trashëgimore. Raporti rekomandon që Qeveria e Kosovës, duhet të shqyrtojë mundësinë që të kërkojë nga gjykatat dhe noterët që për fillimin e shqyrtimit të çdo rasti jokontestimor të trashëgimisë, të

[734] Shih Tetra Tech. Raporti i programit të USAID-it për të drejtat pronësore (PDP) "Informaliteti në sektorin e tokave: Çështja e trashëgimisë së vonuar në Kosovë".Prishtinë.Prill 2016.Fq.22

bëjnë një njoftim zyrtar në internet.Njoftimet për fillimin e procedurës trashëgimore, rekomandohet të publikohen në faqen e internetit të Republikës së Kosovës, dhe të shoqërisë civile si dhe në mediat sociale, ndërsa për të informuar trashëgimtarët të cilët jetojnë jashtë Kosovës, parashikohet mundësia e njoftimit përmes ambasadave të Kosovës jashtë vendit.[735] Vlen të ceket, se një praktikë e tillë, e publikimit zyrtar në internet për fillimin e procedurës trashëgimore, aplikohet në Estoni dhe në disa shtete tjera evropiane, dhe është dëshmuar si masë mjaftë efektive për mbrojtjen e të drejtave të palëve në procedurë dhe njëkohësisht është në pajtueshmëri me standardet për të drejtat e njeriut për një proces të rregullt gjyqësor.[736]Duke qenë se një pjesë e madhe e popullatës në Kosovë, kanë qasje në internet, konsiderohet se publikimi zyrtar në internet për fillimin e procedurës trashëgimore, mund të tregohet si mase efektive për mbrojtjen e të drejtave të trashëgimtarëve. Përkatësisht, rezulatet e anketës së përdorimit të teknologjisë informative dhe komunikimit, tregojnë se në vitin 2017, 88,8% të ekonomive familjare në Kosovë, kanë pasur qasje në internet në shtëpi, nga çfarëdo lloj pajisje.[737]Raporti i USAD-it, i cituar më lartë, rekomandon edhe aplikimin e një mase tjetër në funksion të mbrojtjes se të drejtave të trashëgimtarëve dhe garantimit të pjesëmarrjes se të gjithë trashëgimtarëve në procedurë. Përkatësisht,raporti rekomandon që nga trashëgimtarët të cilët e inicojnë procedurën trashëgimore qoftë para noterit apo gjyqtarit, duhet të kërkohet në një seancë të veçantë gjyqësore të japin betim nën kërcënimin e dënimit se nuk janë duke e fshehur ndonjë trashëgimtarë potencial. Në mënyrë të njëjtë rekomandohet të veprohet edhe në rastin kur trashëgimtarët heqin dorë nga trashëgimia respektivisht trashëgimtarët të cilët dëshirojnë të heqin dorë nga trashëgimia, është rekomanduar që në një seancë të veçantë gjyqësore të deklarojnë nën betim,se vullnetarisht janë duke hequr dorë nga trashëgimia.[738] Është më rëndësi të theksohet se këto masa janë përfshirë edhe në rekomandimet e SKDP.[739]Këto masa procedurale mbrojtëse janë më rëndësi esenciale që të zbatohen në drejtim të parandalimit të fshehjes dhe përjashtimit të trashëgimtarëve nga trashëgimia si dhe heqjes dorë të detyruar nga trashëgimia.Veçanërisht, mendojmë se është më rëndësi dhe nevoje e domosdoshme që më LTK, të parashikohet detyrimi

[735] Shih Tetra Tech.Raporti i programit të USAID-it për të drejtat pronësore (PDP) "Informaliteti në sektorin e tokave: Çështja e trashëgimisë së vonuar në Kosovë".Prishtinë.Prill 2016.Fq.23

[736] Po aty Fq.23

[737] Agjencia e Statistikave të Kosovës. Seria 4: Statistikat Sociale. Rezulatet e anketës së përdorimit të teknologjisë informative dhe komunikimit 2017. Prishtinë. Fq.4

[738] Shih Tetra Tech.Raporti i programit të USAID-it për të drejtat pronësore (PDP) "Informaliteti në sektorin e tokave: Çështja e trashëgimisë së vonuar në Kosovë".Prishtinë.Prill 2016.Fq.33

[739] Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë.Publikuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.Ministria e Drejtësisë Prishtinë.Shtator 2016.Shih Fq.45 dhe 52

i trashëgimtarëve që për pranimin apo heqjen dorë nga trashëgimia, të deklarohen në seancë të veçantë gjyqësore të zhvilluar qoftë para gjykatës apo noterit. Kështu, gjykatësit dhe noterët do të jenë të detyruar që për çdo pranim apo heqje dorë nga trashëgimia të mbajnë seancë gjyqësore dhe t'i njoftojnë trashëgimtarët më pasojat juridike që dalin nga veprimi juridik i heqjes dorë nga trashëgimia. Në këtë mënyrë, pra, trashëgimtarët do të kenë mundësi të marrin më tepër njohuri për të drejtat e tyre dhe për pasojat juridike që dalin nga akti i heqjes dorë nga trashëgimia. Gjatë fazës së hulumimit gjegjësisht gjatë analizimit të rasteve trashëgimore, kemi vërjetur se në shumicën e rasteve trashëgimtarët si pranimin ashtu edhe heqjen dorë nga trashëgimia, e bëjnë më një deklaratë të shkruar të vërtetuar të noteri, e mjaft shpeshë edhe nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Kjo pasi më LTK,u lejohet kjo mundësi.

Nëse edhe pas aplikimit të masave mbrojtëse të përmendura më sipër, pjesëmarrja e femrave në trashëgimi vazhdon të jetë e vogël, ashtu siç aktualisht është në praktikë, atëherë si masë tjetër alternative, më qëllim të parandalimit të heqjes dorë të detyruar nga trashëgimia të trashëgimtarëve femra, mendojmë se duhet të shqyrtohet edhe mundësia që më LTK, të mos parashikohet e drejta e heqjes dorë nga trashëgimia. Duhet theksuar se këtë propozim e ka bërë prof.A.Aliu, në rastin e hartimit të LTK. Sipas prof.A.Aliu, parimi se çdo kush ka të drejtë të vendosë se a do të trashëgojë apo jo nuk përputhet me përmbajtjen e tij kur është rasti i Kosovës, sepse heqja dorë nga trashëgimia nuk është thjeshtë çeshtje e vullnetit të lirë, por është çështje e kushtëzuar nga rrethanat shoqërore në Kosovë. Prof.Aliu, propozon që instituti i heqjes dorë nga trashëgimia të zëvendësohet më kontratën e dhurimit, sipas tij do të ishte më mirë që një përiudhë 6 mujore deri në 1 vit të jetë çdo trashëgimtarë titullarë i pasurisë së trashëguar dhe pastaj trashëgimtarët mund të lidhin edhe kontratën e dhurimit, përparësi e kontratës mbi dhurimin është se ajo në rastet e caktuara mund të revokohet.[740] Kështu, sipas ligjit konkretisht LMD,kontrata e dhurimit mund të revokohet në rastin kur pas lidhjes së kontratës dhuratëmarrësi sillet me dhuratëdhënësin apo me ndonjë person të afërt të tij, në atë mënyrë që sipas rregullave të moralit do të ishte e padrejtë për dhuratëmarrësin të mbante atë që ka marrë me dhuratë.[741] Rasti tjetër, kur lejohet revokimi i kontratës për dhurimin sipas ligjit, është rasti kur dhuratëdhënësi pas realizimit të kontratës së dhurimit, varfërohet dhe i rrezikohet

[740] A.Aliu (2013).E Drejta Civile.Prishtinë.Fq.51

[741] Ligji Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.16/19 Qershor 2012, Prishtinë) Shih nenin 543

mbijetesa.[742]Dhe një rast tjetër, kur mund të revokohet kontrata e dhurimit, sipas ligjit, është rasti kur pasi që është lidhur kontrata e dhurimit, dhuratëdhënësi bëhet me fëmijë dhe i cili më parë nuk ka pasur asnjë fëmijë.[743]Në praktikë,rasti më i shpeshtë i revokimit të dhuratës është për shkak të mosmirënjohjes.[744]

Më lartë e theksuam, se gjatë analizimit të rasteve trashëgimore nuk kemi vërejtur raste për të cilat gjykata trashëgimore, ka vërtetuar që janë fshehur trashëgimtarët, megjithatë kemi vërejtur disa raste për të cilat palët (trashëgimtarët), kanë ushtruar ankesë kundër aktvendimit të gjykatës trashëgimore, më pretendimin se gjykata ka bërë shkelje të ligjit duke mos e vërtetuar faktin se ka fshehje të trashëgimtarëve. Në këto raste, ankesa është aprovuar nga gjykata e shkallës së dytë dhe çështja është kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Kështu:

Gjykata Komunale në Gjilan, në një rast në vitin 2003, ka nxjerrë aktvendim në bazë të të cilit sipas bazës ligjore për trashëgimtarë në tërë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit janë shpallur tre djemtë e tij në pjesë të barabarta.[745] Procedura në këtë rast, është inicuar më kërkesën e përfaqësuesit të trashëgimtarëve, i cili ka deklaruar se trashëgimlënësi ka vdekur në v.1986 dhe prej trashëgimtarëve ligjorë të radhës së pare, i ka lënë tre djemë. Njëri prej djemve të trashëgimlënësit nuk është paraqitur në gjykatë, mirëpo gjykata ka vendosur që të konstatojë se edhe ai është trashëgimtarë dhe më aktvendimin nr.248/02, e ka shpallur trashëgimtarë së bashku më dy trashëgimtarët e tjerë. Kundër këtij aktvendimi, trashëgimtari ligjorë i cili nuk është paraqitur në gjykatë, brenda afatit të lejuar ligjor ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, më pretendimin se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, nga shkaku se përveç trashëgimtarëve ligjorë të shënuar në aktvdekje,ka edhe trashëgimtarë të tjerë ligjorë, përkatësisht trashëgimlënësi i ka lënë edhe 5 vajza.Pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, Gjykata e Qarkut në Gjilan, ka vërtetuar së ankesa është e bazuar dhe më të drejtë ka marrë vendim që të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.[746] Në arsyetimin e aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan thuhet kësisoj: "*Kjo gjykatë duke vlerësuar këtë aktvendim të gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është marrë më shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 al.2 pika 13 të LPC dhe si i tillë i njëjti nuk mundë të shqyrtohet dhe është dashtë*

[742] Ligji Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.16/19 Qershor 2012, Prishtinë) Shih nenin 542
[743] Po aty, shih nenin 544
[744] Për më shumë, shih N.Dauti (2012) Kontratat.Prishtinë.Fq.166
[745] Vendimi: T.nr. 248/02 datë 16.05.2003 Gjykata Komunale në Gjilan
[746] Vendimi: AC.nr. 276/03 datë 17.12.03 Gjykata e Qarkut në Gjilan.Fq.1

patjetër të prishet. Në të vërtetë gjykata e shkallës së parë në bazë të propozimit të ushtruar është dashtë të shiqoj se përveç trashëgimtarëve të cilët janë paraqitur a ka edhe trashëgimtarë të tjerë, pastaj që patundshmëria e treguar si pasuri e të ndjerit a është rregulluar në ndonjë mënyrë tjetër dhe nëse ka trashëgimtarë të tjerë atëherë të bëjë shqyrtimin e saj.''[747]

Gjykata Komunale në Prizren, në një rast në vitin 2001, duke vepruar sipas propozimit të trashëgimtarit ligjorë ka filluar procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë, më ç'rast pasi mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor dhe marrjes së deklaratës trashëgimore të trashëgimtarit,ka marrë aktvendim që për trashëgimtarë të shpallet djali i trashëgimlënësit si trashëgimtarë i vetëm ligjorë.[748]Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë nipi i trashëgimlënësit,i cili nuk është shënuar në aktvdekje, duke e kundërshtuar aktvendimin për shkak të të gjithave shkaqeve ligjore për të cilat mund të ushtrohet ankesa. Lidhur më ankesën e ushtruar, Gjykata e Qarkut në Prizren,në seancën e mbajtur më 19.02.2008, më të drejtë ka marrë aktvendim që të prishet aktvendimi i atakuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Përkatësisht në arsyetimin e aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren thuhet: "*Kolegji i gjykatës së Qarkut në Prizren, pasi i shqyrtojë të gjitha shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësoi prendimet ankimore ka gjetur se: ankesa është e bazuar. Nga ankesa e paraqitur del se trashëgimtari i shpallur A.M nuk është trashëgimtarë i vetëm i dekujusit J.M, por se trashëgimtarë paraqitet edhe ankuesi.Prandaj, në procedurën e sërishme gjykata në bazë të provave të cilat duhet t'i administrojë të vërtetojë se kush janë trashëgimtarë të rendit të parë të dekujusit J.M, dhe pastaj të merr një aktvendim të drejtë në këtë çështje.''*[749]

[747] Vendimi: AC.nr. 276/03 datë 17.12.03 Gjykata e Qarkut në Gjilan.Fq.2
[748] Vendimi: T.nr. 129/01 datë 12.09.2001 Gjykata Komunale në Prizren
[749] Vendimi: AC.nr.339/07 datë 19.02.2008 Gjykata e Qarkut në Prizren.Fq.1

5.3.5. Numri i trashëgimtarëve të cilët kanë trashëguar në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, 2003-2014.

Në tabelën më poshtë, është paraqitur numri i trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekjet e lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, së bashku më numrin e trashëgimtarëve të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë,në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë.

Tabela 21: Numri i trashëgimtarëve të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014

Viti	Nr. total i trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje	Meshkuj	Femra	Nr. total i trashëgimtarëve të cilet kanë trashëguar	Meshkuj	Femra
2003	5,075	2,625 (52%)	2,450 (48%)	2,375	1,733 (66%)	642 (26.2%)
2004	4,867	2,594 (53%)	2,273 (47%)	2,309	1,680 (64.7%)	629 (27.6%)
2005	5,419	2,827 (52%)	2,592 (48%)	2,642	1,899 (67.1%)	743 (28.6%)
2006	5,481	2,913 (53%)	2,568 (47%)	2,648	1,922 (65.9%)	726 (28.2%)
2007	6.277	3,331 (53%)	2,946 (47%)	2,993	2,217 (66.5%)	776 (26.3%)
2008	6,472	3,453 (53%)	3,019 (47%)	3,281	2,411 (69.8%)	870 (28.8%)
2009	7,520	4,054 (54%)	3,466 (46%)	3,657	2,697 (66.5%)	960 (27.6%)
2010	7,869	4,132 (53%)	3,737 (47%)	3,698	2,713 (65.6%)	985 (26.3%)
2011	7,369	3,923 (53%)	3,446 (47%)	3,532	2,577 (65.6%)	955 (27.7%)
2012	4,886	2,626 (54%)	2,260 (46%)	2,344	1,723 (65.6%)	621 (27.4%)
2013	479	260 (55%)	219 (45%)	222	165 (63.4%)	57 (26%)
2014	197	105 (54%)	92 (46%)	100	75 (71.4%)	25 (27.1%)
Total	**61,911**	**32,843 (53%)**	**29,068 (47%)**	**29, 801**	**21,812 (66.4%)**	**7.989 (27.4%)**

Nga 29,068 trashëgimtarë femra sa kanë qenë të përfshira në aktvdekjet e lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014,e kanë shfrytëzuar të drejtën trashëgimore 7,989 apo 27.4%, ndërsa, nga 32,843 meshkuj sa kanë qenë të përfshirë në aktvdekje, e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë 21,812 apo 66.4%. Kështu:

- *Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Prizren*, nga 6,483 femra sa kanë qenë të përfshira në aktvdekjet e lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014,e kanë shfrytëzuar të

drejtën e trashëgimisë 2,120 apo 32.7%, ndërsa nga 6,389 meshkuj të përfshirë në aktvdekje, e kanë shfrytëzuar të drejtën trashëgimore 4,250 apo 66.5%.

- *Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Prishtinë,* nga 7,392 femra të përfshira në aktvdekjet e lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë 2,329 apo 31.5%, ndërsa nga 9,086 meshkuj të përfshirë në aktvdekje,e kanë shfrytëzuar të drejtën trashëgimore 6,342 apo 69.7%.
- *Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Gjilan*, nga 4,423 femra të përfshira në aktvdekjet e lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë 938 prej tyre apo 21.2%, ndërsa nga 5,141 meshkuj të përfshirë në aktvdekje, e kanë shfrytëzuar të drejtën trashëgimore 3,269 apo 63.5%.
- *Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Pejë*, nga 4,936 femra të përfshira në aktvdekjet e lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë 1,309 apo 26.5%, ndërsa nga 5,215 meshkuj të përfshirë në aktvdekje, e kanë shfrytëzuar të drejtën trashëgimore 3,312 apo 63.5%.
- *Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Ferizaj,* nga 5,220 femra të përfshira në aktvdekjet e lëndëve trashëgimore të viteve 2003-2014, e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë 993 apo 19.2%, ndërsa nga 6,067 meshkuj të përfshirë në aktvdekje, e kanë shfrytëzuar të drejtën trashëgimore 3,894 apo 64.1%.
- *Në Gjykatën Komunale tash Themelore në Mitrovicë,* nga 614 femra të përfshira në aktvdekjet e lëndëve trashëgimore të viteve 2008-2014,e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë 300 apo 49%, ndërsa nga 945 meshkuj të përfshirë në aktvdekje, e kanë shfrytëzuar të drejtën trashëgimore 745 apo 78.7%.

Është e rëndësishme të përmendet se shumica e femrave të cilat kanë trashëguar në Gjykatën Komunale gjegjësisht Themelore në Mitrovicë,kanë trashëguar në cilësinë e bashkëshortës së trashëgimlënësit. Përkatësisht nga gjithsej 300 femra sa kanë trashëguar, 184 apo 61% kanë trashëguar në cilësinë e bashkëshortës së trashëgimlënësit. Sikurse e kemi theksuar edhe më lartë, në këtë gjykatë numri i trashëgimtarëve të lajmëruar në gjykatë gjegjësisht të shënuar në aktvdekje është i vogël. Gjatë analizimit të rasteve trashëgimore, në mjafte raste kemi vërejtur se trashëgimlënësi si trashëgimtarë të vetëm ligjorë ka lënë bashkëshortën. Është e rëndësishme të përmendet se gjatë realizimit të pyetësorit gjegjësisht intervistës, shumë gra dhe burra të rajonit të Mitrovicës, kanë deklaruar se prona në familjen

e tyre, formalisht është e regjistruar në emër të trashëgimtarëve femra përkatësisht bashkëshortës së trashëgimlënësit. Kjo pasi, më qëllim të përfundimit sa më të shpejtë të procedurës trashëgimore, në gjykatë nuk lajmërohen të gjithë trashëgimtarët, mjaft shpesh kur trashëgimlënësi lënë bashkëshortën, si trashëgimtarë e vetme lajmërohet ajo, e në të vërtetë pasuria trashëgimore shfrytëzohet nga trashëgimarët meshkuj përkatësisht nga djemtë e trashëgimlënësit.

Pavarësisht se më ligjet pozitive[750]në Kosovë femrës i garantohet e drejta e barabartë më meshkujt në trashëgimi, pra, në praktikë numri i femrave të cilat e shfrytëzojnë të drejtën trashëgimore është i ulët.Në shumicën e rasteve të ndikuara nga zakonet dhe traditat, femrat heqin dorë vullnetarisht nga trashëgimia. Sipas Edward Tawil, problemi në lidhje më trashëgiminë e pronës nga femrat në Kosovë, përveç kulturës dhe traditës ndërlidhet edhe me realitetet e tjera siç janë abuzimet në familje, pasi Kosova e ka një ndër nivelet më të larta të abuzimit familjar të femrave në rajon.[751] Një tregues i rendësishëm i mospërfshirjes se grave në trashëgimi është edhe regjistrimi i pronave të paluajtshme. Vlen të përmendet se Kosova, ka përqindjen më të ulët të pronave të paluajtshme të regjistruara në emër të femrave, në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor përkatësisht në Kosovë femrat zotërojnë 15% të totalit të pasurisë së paluajtshme (shtëpive dhe tokës); në Shqipëri 29%, në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinë 25%, në Bosnjë dhe Hercegovinë Republika Srpska 30%; në Serbi 39%; Mal të Zi 26%; dhe Maqedoni 17%.[752] Është interesante të përmendet se në zonën me shumicë shqiptare të Serbisë,Luginën e Preshevës përqindja e pronës në emër të femrave është e ulët 13%.[753]

[750] Për dallim nga e drejta zakonore (e njohur ndryshe me emrin ‘’Kanuni i Lekë Dukagjinit”), e cila diskriminonte gruan në aspektin e së drejtës së trashëgimisë (shih nenin 91 i KLD ku thuhet:*”As të prindja as të burri grueja s’hyn në pjesë të trashëgimit”),* legjislacioni pozitiv në Kosovë njeh barazinë e plotë të gruas në trashëgimi. LTK në nenin 3.1 garanton barazinë e plotë të trashëgimtarëve eventual të dy gjinive, barazia ndërmjet burrit dhe gruas garantohet edhe nga LFK (shih nenin 3al.1) dhe nga një sërë ligje të tjera më të cilat femrave dhe meshkujve u garantohen të drejtat e njëjta në çdo sferë të jetës. Barazia ndërmjet gruas dhe burrit mbrohet edhe më konventa të ndryshme ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (shih nenin 1); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih nenin 14); Konventa për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (shih nenin 15 al.1 Pjesa IV) etj.

[751] E.Tawil (2009) “Property Rights in Kosovo”: A Haunting Legacy of a Society in Transition.International Center for Transitional Justice. Fq.23

[752] R.Tonchovska & K.Kelm & R.Giovarelli (2014) “Ict in support of evidence based policy making: Land and gender in the ëestern ballkans.Annual Ëorld Bank Conference on Land and Poverty Ëashington DC. 14-27 March, 2014. Fq.4

[753] S.F.Joireman (2015)."Resigning Their Rights? Impediments to Women's Property Ownership in Kosovo". Political Science Faculty Publications. Paper 44. Fq. 6

5.3.5.1. Në çfarë roli kanë trashëguar femrat dhe meshkujt në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, 2003-2014.

Në tabelën më poshtë, janë paraqitur të dhënat lidhur më numrin e trashëgimtarëve femra, të cilat kanë trashëguar dhe në çfarë cilësie apo roli gjegjësisht si bashkëshortë, vajzë, mbesë apo stërmbesë e trashëgimlënësit, etj.

Tabela 22: Në çfarë roli apo cilësie kanë trashëguar femrat në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014.

Viti	Nr. i femrave të cilat kanë trashëguar	Bashkëshortja	Vajza	Mbesa	Stërmbesa	Nëna	Motra	Reja	Tjetër
2003	642	320 (49.8%)	222 (34.5%)	50 (7.7%)	5 (0.77%)	3 (0.46%)	9 (1.4%)	30 (4.6%)	3
2004	629	340 (54.0%)	187 (29.7%)	33 (5.2%)	10 (1.5%)	4 (0.63%)	15 (2.3%)	39 (6.2%)	1
2005	743	369 (49.6%)	270 (36.3%)	53 (7.1%)	4 (0.53%)	2 (0.29%)	12 (1.6%)	30 (4.3%)	3
2006	726	366 (50.4%)	275 (37.8%)	44 (6.0%)	5 (0.64%)	3 (0.38%)	8 (1.0%)	24 (3.0%)	1
2007	776	382 (49.2%)	293 (37.7%)	51 (6.5%)	2 (0.30%)	1 (0.15%)	16 (2.4%)	31 (4.7%)	0
2008	870	392 (45.0%)	329 (37.8%)	88 (10.1%)	8 (0.91%)	3 (0.34%)	5 (0.56%)	43 (4.9%)	2
2009	960	441 (45.9%)	396 (41.2%)	74 (7.7%)	3 (0.31%)	2 (0.20%)	14 (1.4%)	27 (2.8%)	3
2010	985	525 (53.2%)	343 (34.8%)	57 (5.7%)	6 (0.60%)	4 (0.40%)	9 (0.91%)	37 (3.7%)	4
2011	955	512 (53.6%)	324 (33.9%)	67 (7.0%)	3 (0.31%)	4 (0.41%)	16 (1.6%)	26 (2.7%)	3
2012	621	341 (54.9%)	200 (32.2%)	28 (4.5%)	5 (0.80%)	3 (0.48%)	14 (2.2%)	28 (4.5%)	2
2013	57	23 (40.3%)	29 (50.8%)	1 (1.7%)	0	0	2 (3.5%)	2 (3.5%)	0
2014	25	13 (52%)	11 (44%)	0	0	0	0	0	1
Total	**7,989**	**4,024 (50.3%)**	**2,879 (36.0%)**	**546 (6.8%)**	**51 (0.63%)**	**29 (0.36%)**	**120 (1.50%)**	**317 (3.9%)**	**23 (0.2)**

Sikurse është theksuar edhe më lartë, nga 29,068 trashëgimtarë femra sa kanë qenë të përfshira në aktvdekjet e rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, në gjykatat e përfshira në studim, e kanë shfrytëzuar të drejtën trashëgimore 7,989 prej tyre. Kësisoj:

- 4,024 apo 50.3%, kanë trashëguar në cilësinë e bashkëshortës së trashëgimlënësit;
- 2,879 apo 36.0%, kanë trashëguar në cilësinë apo rolin e vajzës së trashëgimlënësit;
- 546 apo 6.8%, kanë trashëguar në cilësinë e mbesës së trashëgimlënësit;
- 51 apo 0.63%, kanë trashëguar në cilësinë e stërmbesës së trashëgimlënësit;
- 29 apo 0.36%, kanë trashëguar në cilësinë e nënës së trashëgimlënësit;
- 120 apo 1.50%, kanë trashëguar në cilësinë e motrës së trashëgimlënësit;

- 317 apo 3.9%, kanë trashëguar në cilësinë e resë së trashëgimlënësit; si dhe
- 23 apo 0.22%, kanë trashëguar në cilësi tjera si p.sh kunatë, ortakë etj.

Tabela 23: Në çfarë roli apo cilësie kanë trashëguar meshkujt në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë 2003-2014.

Viti	Nr. i meshkujve të cilet kanë trashëguar	Bashkeshorti	Djali	Nipi	Sternipi	Babai	Vëllau	Gjyshi	Tjetër
2003	1,733	9 (0.55%)	1,298(74.8%)	376 (21.6%)	19 (1.02%)	1 (0.06%)	24 (1.3%)	0 (0%)	6
2004	1,680	6 (0.38%)	1,350 (80.3%)	274 (16.3%)	36 (2.1%)	0 (0%)	13 (0.7%)	0 (0%)	1
2005	1,899	11 (0.57%)	1,501 (79.0%)	349 (18.3%)	14 (0.73%)	2 (0.10%)	17 (0.8%)	0 (0%)	5
2006	1,922	17 (0.88%)	1,490 (77.5%)	363 (18.8%)	20 (1.04%)	3 (0.15%)	25 (1.3%)	0 (0%)	4
2007	2,217	14 (0.63%)	1,770 (79.8%)	388 (17.5%)	17 (0.76%)	0 (0%)	21 (0.9%)	1 (0.04%)	6
2008	2,411	20 (0.82%)	1,878 (77.8%)	429 (17.7%)	35 (1.45%)	5 (0.20%)	36 (1.4%)	0 (0%)	8
2009	2,697	26 (0.96%)	2,107 (78.1%)	484 (17.9%)	29 (1.07%)	7 (0.25%)	31 (1.1%)	0 (0%)	13
2010	2,713	24 (0.88%)	2,119 (78.1%)	498 (18.3%)	27 (0.99%)	9 (0.33%)	29 (1.0%)	0 (0%)	7
2011	2,577	21 (0.88%)	2,030 (78.1%)	477(18.5%)	23(0.89%)	6 (0.23%)	18 (0.6%)	0 (0%)	2
2012	1,723	12 (0.74%)	1,373 (79.6%)	296 (17.7%)	15 (0.58%)	5 (0.29%)	13 (0.7%)	0 (0%)	9
2013	165	0 (0%)	134 (81.2%)	24 (14.5%)	2 (1.21%)	0	2 (2.21%)	0 (0%)	3
2014	75	1 (2%)	59 (78.6%)	12(16%)	0	0	3 (4%)	0	0
Total	**21,812**	**161 (0.73%)**	**17,109 (78.4%)**	**3,970 (18.2%)**	**237 (1.09%)**	**38 (0.17%)**	**232 (1.06%)**	**1 (0.004%)**	**64 (0.2)**

Ndërsa,nga 32,843 meshkuj sa kanë qenë të përfshirë në aktvdekjet e rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, në gjykatat e përfshira në studim, e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë 21,812 apo 66.4%. Kështu:

- 161 apo 0.73%, kanë trashëguar në cilësinë e bashkëshortit të trashëgimlënësit;
- 17, 109 apo 78.4%, kanë trashëguar në cilësinë e djalit të trashëgimlënësit;
- 3, 970 apo 18.2%, kanë trashëguar në cilësinë e nipit të trashëgimlënësit;
- 237 apo 1.09%, kanë trashëguar në cilësinë e stërnipit të trashëgimlënësit;
- 38 apo 0.17 %, kanë trashëguar në cilësinë e babait të trashëgimlënësit;
- 232 apo 1.06%, kanë trashëguar në cilësinë e vëllaut të trashëgimlënësit;
- 1 apo 0.004%, ka trashëguar në cilësinë e gjyshit të trashëgimlënësit; si dhe
- 64 apo 0.29%, kanë trashëguar në cilësi apo role tjera, si p.sh, dhëndërr, tezak, etj.

5.3.5.2. Trashëgimtarët që kanë hequr dorë nga trashëgimia në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, 2003-2014.

Pranimi i trashëgimisë është çështje e vullnetit të lirë gjegjësisht trashëgimtari nuk mund të detyrohet të pranojë trashëgiminë ligjorë apo atë testamentare kundër vullnetit të tij. Për këtë arsye, më ligj, është paraparë edhe mundësia respektivisht e drejta e trashëgimtarit, që të heqë dorë nga trashëgimia, pra të mos bëhet trashëgimtarë kundër vullnetit apo dëshirës së tij. Heqja dorë nga trashëgimia, bëhet më deklaratë të shkruar, e cila regjistrohet në gjykatën trashëgimore, ose gojarisht në seancë dhe shënohet në procesverbal gjyqësor. Në aspektin e efekteve juridike, heqja dorë nga trashëgimia barazohet më mosthirrjen në trashëgimi, gjegjësisht trashëgimtari i cili heqë dorë nga trashëgimia konsiderohet sikur nuk është thirrur asnjëherë në trashëgimi. Kjo rregull është shprehur në nenin 130 par.4 i LTK, ku thuhet: "Trashëgimtari, i cili ka hequr dorë në emër të vet konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar". Trashëgimtari se heqë dorë nga trashëgimia, mund ta bëjë këtë më qëllim që pjesa e tij t'i shtohet trashëgimtarit të caktuar që thirret në trashëgim. Mirëpo, në këtë rast, heqja dorë nga trashëgimia nuk konsiderohet si heqje dorë nga trashëgimia, por si deklaratë për cedimin e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari i caktuar. Kjo rregull gjendet e sanksionuar në nenin 133 par.2 i LTK, ku thuhet:"Heqja dorë në dobi të trashëgimtarit të caktuar nuk konsiderohet si heqje dorë nga trashëgimi, por si deklaratë për cedimin e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari i caktuar." Trashëgimtari mund të deklarojë se heqë dorë fare nga pjesa e vet trashëgimore dhe se nuk i intereson se kujt i kalon pjesa trashëgimore e tij, ose mund të deklarojë së pjesën trashëgimore nga e cila heqë dorë, e cedonë tek një trashëgimtar i caktuar ose tek disa prej trashëgimtarëve që thirren në trashëgimi. Në praktikë, heqjen dorë nga trashëgimia, e bëjnë kryesisht trashëgimtarët femra dhe këtë e bëjnë më qëllim që pjesa e tyre t'i shtohet trashëgimtarëve meshkuj zakonisht vëllezërve. Kështu, sikurse e kemi cekur edhe më lartë, në gjykatat e përfshira në studim, nga 29,068 femra të përfshira në aktvdekjet e rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, kanë hequr dorë nga trashëgimia 21,079 apo 72.6%, përkatësisht 7,993 kanë deklaruar se heqin dorë fare nga trashëgimia dhe se nuk i intereson kujt i kalon pjesa trashëgimore e tyre, kurse 13,086 kanë deklaruar se heqin dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve tjerë, kësisoj:

- 8, 126 kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të vëllaut/vëllezërve;
- 400 në favor të motrës/ motrave;
- 1,708 në favor të djalit/djemve;

- 101 në favor të vajzës;
- 2,299 në favor të nënës;
- 75 në favor të babait;
- 41 në favor të fëmijëve (F/M);
- 336 në favor të trashëgimtarëve tjerë.

Tabela 24: Numi i trashëgimtarëve femra të cilat kanë hequr dorë nga trashëgimia

Viti	Nr. i trashëgimtarëve femra të përfshira në aktvdekje	Kanë trashëguar	Kanë hequr dorë nga trashëgimia	Kanë hequr dorë fare nga trashëgimia	Kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve tjerë
2003	2,450	642	1,808	820	988
2004	2,273	629	1,644	644	1000
2005	2,592	743	1,849	696	1,153
2006	2,568	726	1,842	732	1,110
2007	2,946	776	2,170	770	1400
2008	3,019	870	2,149	799	1350
2009	3,466	960	2,506	938	1,568
2010	3,737	985	2,752	1,184	1,568
2011	3,446	955	2,491	796	1,695
2012	2,260	621	1,639	542	1,097
2013	219	57	162	53	109
2014	92	25	67	19	48
Total	**29,068**	**7.989**	**21,079**	**7,993**	**13,086**

Tabela 25: Në favor të kujt kanë hequr dorë nga trashëgimia trashëgimtarët femra

Viti	Në favor të vëllezërve	Në favor të motrës	Në favor të babait	Në favor të nënës	Në favor të djalit	Në favor të vajzës	Në favor të fëmijëve	Tjerë
2003	616	28	6	192	103	18	2	23
2004	590	35	3	224	125	8	1	14
2005	699	61	7	222	131	8	7	18
2006	679	21	10	203	145	4	4	44
2007	887	36	14	242	170	10	5	36
2008	850	46	2	210	178	12	7	45
2009	982	53	8	248	214	13	2	48
2010	1,018	41	2	250	212	9	8	28
2011	1,028	49	11	304	241	6	4	52
2012	673	23	12	189	164	8	1	27
2013	69	2	0	14	18	5	0	1
2014	35	5	0	1	7	0	0	0
Total	**8, 126**	**400**	**75**	**2,299**	**1,708**	**101**	**41**	**336**

Tabela 26: Numi i trashëgimtarëve meshkuj të cilët kanë hequr dorë nga trashëgimia

Viti	Nr. i trashëgimtarëve meshkuj të përfshirë në aktvdekje	Kanë trashëguar	Kanë hequr dorë nga trashëgimia	Kanë hequr dorë fare nga trashëgimia	Kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve të tjerë
2003	2,625	1,733	892	438	454
2004	2,594	1,680	914	442	472
2005	2,827	1,899	928	387	541
2006	2,913	1,922	991	425	566
2007	3,331	2,217	1,114	493	621
2008	3,453	2,411	1,042	434	608
2009	4,054	2,697	1,357	572	785
2010	4,132	2,713	1,419	720	699
2011	3,923	2,577	1,346	515	831
2012	2,626	1,723	903	329	574
2013	260	165	95	44	51
2014	105	75	30	10	20
Total	**32,843**	**21,812**	**11, 031**	**4, 809**	**6, 222**

Tabela 27: Në favor të kujt kanë hequr dorë nga trashëgimia trashëgimtarët meshkuj

Viti	Në favor të vëllaut/vëllezërve	Në favor të motrës	Në favor të babait	Në favor të nënës	Në favor të djalit	Në favor të vajzës	Në favor të fëmijëve	Tjerë
2003	220	18	12	186	1	0	1	16
2004	182	15	7	249	1	0	0	18
2005	246	35	9	224	4	2	10	11
2006	241	19	20	248	5	0	1	32
2007	287	26	4	252	1	0	3	48
2008	306	23	0	255	3	0	1	20
2009	409	48	6	271	5	3	2	41
2010	358	35	6	274	3	1	0	22
2011	446	53	18	285	9	1	2	17
2012	283	21	12	238	0	1	0	19
2013	22	10	0	11	0	1	0	7
2014	9	2	0	8	0	0	0	1
Total	**3, 009**	**305**	**94**	**2,501**	**32**	**9**	**20**	**252**

Ndërsa, nga 32,843 meshkuj sa kanë qenë të përfshirë në aktvdekjet e rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, kanë hequr dorë nga trashëgimia 11,031 prej tyre 4,809 apo 43% kanë hequr dorë fare nga trashëgimia, duke deklaruar së nuk i intereson se kujt i kalon pjesa trashëgimore e tyre, kurse 6,222 kanë deklaruar se heqin dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve tjerë, kësisoj:

- 3,009 kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të vëllaut/vëllezërve;

- 305 në favor të motrës/ motrave;
- 2,501 në favor të nënës;
- 94 në favor të babait;
- 32 në favor të djalit/djemve;
- 9 në favor të vajzës;
- 20 në favor të fëmijëve (F/M);
- 252 në favor të trashëgimtarëve tjerë.

Pra, krahasuar më numrin e femrave, numri i trashëgimtarëve meshkuj të cilët kanë hequr dorë nga trashëgimia është dukshëm më i vogël.

Është më rëndësi të theksohet se trashëgimtarët (si femrat ashtu edhe meshkujt) të cilet heqin dorë nga e drejta e trashëgimit, njëkohësisht heqin dorë edhe nga e drejta e trashëgimit për pasardhësit (fëmijët) e tyre të mitur. Kjo pasi më LTK, trashëgimtarëve i lejohet mundësia që heqjen dorë nga trashëgimia ta bëjnë edhe në emër të pasardhësve të tyre të mitur dhe për këtë veprim nuk kërkohet të merret pëlqimi i organit të kujdestarisë. Kjo rregull rrjedh nga neni 130 par.2 i LTK ku thuhet:*"Heqja dorë vlen edhe për pasardhësit e atij që ka hequr dorë, përveç nëse shprehimisht ka deklaruar se heq dorë vetëm në emër të vet"* si dhe nga par.3 i nenit të cituar më sipër, ku thuhet:*"Në qoftë se pasardhësit janë të mitur për këtë heqje dorë nuk nevojitet leja e organit të kujdestarisë".* Kjo dispozitë ligjore nuk është në pajtim me standartet evropiane për të drejtat e fëmijës. Pra, më qëllim të mbrojtes se interesave të fëmjës, është e nevojshme që të ndryshohet kjo dispozitë, ashtu që gjykata të kërkojë pëlqimin e organit të kujdestarisë, sa herë që trashëgimtarët heqin dorë nga e drejta e trashëgimit edhe në emër të pasardhësve të tyre të mitur.Ndryshimi i kësaj dipozitë është rekomanduar edhe në SKDP[754].

Në shumicën e rasteve, si trashëgimtarët femra ashtu edhe trashëgimtarët meshkuj, heqjen dorë nga trashëgimia,e bëjnë në favor të trashëgimtarëve meshkuj gjegjësisht vëllezërve. Kështu, sikur e pamë më lartë, nga 13,086 femra sa kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve tjerë, 9,909 apo 75.7% kanë hequr dorë në favor të trashëgimtarëve meshkuj. Ndërsa, nga 6,222 meshkuj sa kanë hequr nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve tjerë, 3,135 apo 50.3% kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve meshkuj. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i trashëgimtarëve meshkuj, vërehet se kanë hequr dorë

[754] Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë.Publikuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.Ministria e Drejtësisë Prishtinë.Shtator 2016.Fq.11

nga trashëgimia edhe në favor të nënës. Gjatë analizimit të rasteve trashëgimore, kemi vërejtur se djemtë zakonisht heqin dorë nga trashëgimia në favor të nënës, në rastet kur trashëgimlënësi vdes në një moshë pak më te re. Për këtë, edhe rastet më të shpeshta kur femrat e shfrytëzojnë të drejtën trashëgimore,janë rastet kur ato thirrën në trashëgimi në rolin e bashkëshortës së trashëgimlënësit. Kështu, sikurse e kemi përmendur në pikën 3.3.5.1, nga 7,989 femra sa kanë trashëguar, 4,024 prej tyre apo 50.3%, kanë trashëguar në cilësinë e bashkëshortës së trashëgimlënësit. Ndërsa, rastet më të shpeshta kur femrat heqin dorë nga trashëgimia,janë rastet kur ato thirren në trashëgimi në cilësinë e vajzës apo mbesës së trashëgimlënësit.

Mendojmë se vështirësitë dhe pengesat e shumta më të cilat ballafaqohen femrat në rastin e realizimit të së drejtës trashëgimore, i detyrojnë ato në mënyrë indirekte të heqin dorë nga trashëgimia.Pengesat më të mëdhaja në realizimin e së drejtës trashëgimore të femrave konsiderohen zakonet, traditat e gjithashtu edhe kushtet ekonomike. Pra, heqja dorë nga trashëgimia e trashëgimtarëve femra, në shumicën e rasteve nuk përfaqëson vullnetin e tyre të lirë, por heqja dorë nga trashëgimia e trashëgimtarëve femra është më tepër një çështje që ndërlidhet më traditat dhe zakonet e vendit. Është më rëndësi të theksohet, se aktualisht Ministria e Drejtësisë, PDP dhe Projekti për Kodin Civil dhe të Drejtat Pronësore i financuar nga BE, janë duke punuar së bashku për të zhvilluar masa mbrojtëse procedurale kundër heqjes dorë të detyruar nga trashëgimia. Si masë mbrojtëse e mundshme, është duke u shqyrtua mundësia që të zbatohet kërkesa që trashëgimtarët të cilët dëshirojnë të heqin dorë nga trashëgimia në një seancë të veçantë gjyqësore jashtë procedurës jokontestimore, të deklarojnë nën betim, se vendimi për të hequr dorë nga trashëgimia është i bazuar në vullnetin e tyre të lirë.[755]

[755] Shih Tetra Tech. Raporti i programit të USAID-it për të drejtat pronësore (PDP) "Informaliteti në sektorin e tokave: Çështja e trashëgimisë së vonuar në Kosovë".Prishtinë.Prill 2016.Fq.19

5.3.6. Rastet për të cilat është pezulluar procedura për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtje të përjetshme

Në tabelën më poshtë, është paraqitur numri i rasteve trashëgimore për të cilat është pezulluar procedura për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtje të përjetshme, në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë.

Tabela 28: Numri i rasteve për të cilat është pezulluar procedura trashëgimore për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtje të përjetshme

Viti	Nr. i rasteve trashëgimore të përfunduara deri në përiudhën kur është kryer hulumtimi	Nr.i rasteve për të cilat është pezulluar procedura për shkak të kontratës për mbajtje të përjetshme
2003	1,535	11
2004	1,475	9
2005	1,758	16
2006	1,756	29
2007	1,808	25
2008	1,732	14
2009	2,177	12
2010	2,322	10
2011	2,353	9
2012	1,720	4
2013	188	3
2014	67	4
Total	**18,891**	**146 (0.76%)**

Kontrata për mbajtjen e përjetshme rregullohet më dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve[756], pasi kjo kontratë në thelb është kontratë e detyrimeve por që përmbanë edhe disa elemente të së drejtës trashëgimore.[757] Kjo kontratë lidhet ndërmjet dhënësit dhe marrësit të mbajtjës, në bazë të se cilës dhënësi i mbajtjës detyrohet të kujdeset për marrësin e mbajtjës deri në fund të jetës së tij, psh., kujdeset për shëndetin, veshmbathjen, dhënien e ushqimit, për administrimin dhe ruajtjen e pasurisë si dhe pas vdekjes se mbajtësit kujdeset që varrimi i mbajtësit të bëhet sipas dokeve dhe zakoneve të vendit. Ndërsa, marrësi i mbajtjës detyrohet që dhënësit t'ia bartë një pjesë të pasurisë apo tërë pasurinë. Detyrimi i marrësit të mbajtjës përmbushet pas vdekjes se tij.[758] Pra, dhënësi i mbatjës e fiton shpërblimin (një pjesë të pasurisë

[756] Shih LMD, nenet 561-566.
[757] Shih N.Dauti (2012) Kontratat.Prishtinë.Fq.278
[758] Shih T.Beka (2013)Vështrim i përgjithshëm i kontratës mbi mbajtjen e përjetshme.Reviste Shkencore Juridica Viti II nr 2/2012 – 3/2013.Prishtinë.Fq.28

ose tërë pasurinë) pas vdekjes së marrësit të mbajtjës. Lëndë e kësaj kontratë, pra, mund të jetë një pjesë e pasurisë ose tërë pasuria e marrësit të mbajtjës.Pas vdekjes së marrësit të mbajtjës në masën trashëgimore të tij, nuk përfshihet pjesa e pasurisë që përbënë lëndën e kësaj kontratë, kjo pjesë e pasurisë i kalon dhënësit të mbajtësit si shpërblim për përmbushjen e kontratës. Në rastin kur marrësi i mbajtjës nuk lënë pasuri tjetër të luajtshme apo të paluajtshme në trashëgim, përveç pasurisë së përfshirë në kontratë, atëherë pezullohet procedura për shqyrtimin e masës trashëgimore.

Gjatë fazës se hulumtimit gjegjësisht gjatë analizimit të rasteve trashëgimore, kemi vërejtur disa raste për të cilat gjykata trashëgimore ka pezulluar procedurën trashëgimore për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtje të përjetshme. Përkatësisht, nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, për 145 raste kemi vërjetur se trashëgimlënësit kanë lënë kontratë për mbajtje të përjetshme dhe procedura për shqyrtimin e trashëgimisë, në këto raste është pezulluar. Duhet theksuar se nga gjykatat e përfshira në studim, kontrata për mbajtje të përjetshme për gjatë përiudhës 2003-2014, më se shumti është aplikuar në Gjykatën Komunale tash Themelore në Pejë. Përkatësisht, nga gjithsej 145 raste për të cilat është pezulluar procedura për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtje të përjetshme, në të gjitha gjykatat e përfshira në studim, 97 raste i përbëjnë rastet trashëgimore të shqyrtuara nga Gjykata Komunale gjegjësisht Themelore në Pejë.[759] Mendohet se ligjvënësi ka paraparë mundësinë e lidhjes se kontratës për mbajtje të përjetshme më qëllim të sigurimit të kujdesit dhe mbajtjes se personit, i cili për shkak të moshës apo sëmundjes nuk mund të kujdeset për veti dhe i cili nuk ka fëmijë apo anëtarë të tjerë të familjes të cilet do të mund të kujdeseshin dhe do ta mbanin atë.[760] Mirëpo, në praktikë kjo kontratë rezulton se lidhet më tepër më qëllim të shmangies se ligjit për trashëgimin lidhur

[759] Shih Vendimi: T.nr.62/2010 dt.13.04.2010 Gjykata Komunale në Pejë ; Vendimi: T.nr.83/2010 dt.10.11.2010 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 109/2010 dt.24.06.2010 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 177/2010 dt.20.07.2010 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 234/2010 dt.30.12.2010 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 105/2011 dt.26.05.2011 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 71/2011 dt.19.04.2011 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 10/2012 dt.15.03.2012 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 131/2012 dt.25.10.2012 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 56/2005 dt.10.11.2005 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 76/2005 dt.06.03.2006 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr. 72/2006 dt.11.05.2006 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.150/2006 dt.20.09.2006 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.07/06 dt.23.01.2006 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.27/06 dt.01.03.2006 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.33/06 dt.10.03.2006 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.224/07 dt.22.11.2007 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.23/07 dt.07.02.2007 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.37/07 dt.02.03.2007 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.51/07 dt.10.05.2007 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.142/07 dt.03.08.2007 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.3/2013 dt.16.01.2013 Gjykata Themelore në Pejë; Vendimi: T.nr.145/2006 dt.26.09.2006 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.25/2006 dt.16.03.2006 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.32/2006 dt.03.04.2007 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.40/2007 dt.13.03.2007 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.124/2008 dt.07.07.2008 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.146/2008 dt.14.05.2009 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.33/2008 dt.03.03.2008 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.230/2009 dt.16.12.2009 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.230/2009 dt.16.12.2009 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.206/2009 dt.08.12.2009 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: T.nr.84/2003 dt.29.04.2003 Gjykata Komunale në Pejë; Vendimi: Ac.nr.43/2010 dt.16.03.2010 Gjykata e Qarkut në Pejë.

[760] Shih N.Dauti (2012) Kontratat.Prishtinë.Fq.279

me trashëgimtarët ligjorë. Kjo pasi në praktikë, kjo kontratë në shumicën e rasteve lidhet nga personat të cilët kanë fëmijë dhe anëtarë të tjerë të familjes. Kështu, në afër 50% të rasteve të analizuara për të cilat trashëgimlënësit kanë lënë kontratë për mbajtje të përjetshme, në gjykatat e përfshira në studim, kemi vërejtur se trashëgimlënësit e kanë lidhur kontratën për mbajtjen e përjetshme më pasardhësit apo fëmijët e tyre zakonisht më fëmijët e gjinisë mashkull.[761]Mirëpo, shumë pak raste kemi vërejtur se trashëgimtarët e kanë kundërshtuar kontratën për mbajtje të përjetshme apo që kanë ushtruar ankesë kundër aktvendimit për pezullimin e procedurës trashëgimore për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtje të përjetshme. Më poshtë, do përmendim një rast më specifik kur trashëgimtarët kanë ushtruar ankesë kundër aktvendimit për pezullimin e procedurës trashëgimore. Kështu:

Gjykata Komunale në Pejë, në një rast në vitin 2009, më aktvendimin nr.230/09 dt.16.12.2009, e ka pezulluar procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë së trashëgimlënësit, për shkak të ekzistimit të kontratës për mbajtje të përjetshme. Përkatësisht në paragrafin 1,2 të dispozitivit të aktvendimit të cituar më sipër thuhet kësisoj:

"*Pezullohet procedura për shqyrtimin e masës trashëgimore, pas vdekjes së të ndjerit XH (H) M, i lindur më 15.06.1931 në Pejë, i cili ka vdekur me 27.11.2009 Pejë, për shkak të ekzistimit të kontratës mbi mbajtje të përjetshme.*

Dhënësi i ushqimisë, E (XH)M, të drejtën e vetë nga kjo kontratë konform nenit 106 të LTK-së, mund ta regjistrojë në librin publik."

Kurse nën paragrafin 3,4,5,6 të arsyetimit të aktvendimit përcaktohet kësisoj:

[761] Shih Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.103/06 dt. 31.12.1996.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.121/05 dt.15.03.2005.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.328/94 dt.07.09.1994.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.304/06 dt.13.11.2006.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.10/97 dt.19.02.1997.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr12/00 dt.15.08.2000.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.13/03 dt. 21.02.2003.Gjykata Komunale në Pejë ; Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.776/04 dt.24.11.2004.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.210/09 dt.12.01.2010.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.152/01 dt.10.10.2001.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.06/98 dt.02.02.1998.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.107/01 dt.11.07.2001.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.62/97 dt.24.09.1997.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.42/95 dt.27.11.1995.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.916/82 dt.15.04.1982.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.57/96 dt.04.09.1996. Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.11/98 dt.13.02.1998.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.316/93 dt.21.06.1993.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.644/92 dt.25.12.1992.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.584/93 dt.17.12.1993.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.358/05 dt.01.07.2005.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.136/03 dt.31.03.2003.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.129/04 dt.01.06.2006.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.77/95 dt.03.11.1995.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.476/94 dt.19.06.1995.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.386/87 dt.14.05.1987.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.529/74 dt.25.12.1974.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.10/98 dt.06.02.1998.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.340/05 dt.20.06.2005.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.50/09 dt.22.04.2009.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.50/09 dt.22.04.2009.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.64/95 dt.25.08.1995.Gjykata Komunale në Pejë**;** Kontrata për mbajtjen e përjetshme dt.23.09.1997.Gjykata Komunale në Pejë.

"*Më dt.15.12.2009 pranë kësaj gjykate është paraqitur biri i të ndjerit, E (XH)M, i cili i ka prezantuar gjykatës kontratën mbi mbajtje të përjetshme Nr.50/09 dt.22.04.2009 e lidhur mes të ndjerit, XH (H) M, si marrës i ushqimisë dhe birit të tij E (XH) M, si dhënës i ushqimisë , e cila kontratë është vërtetuar nga ana e kësaj gjykate. Gjykata bërë shiqimin në kontratën mbi mbajtje të përjetshme Nr.50/09 dt.22.04.2009 të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë, dhe konstatoj se më kotratën mbi mbajtje të përjetshme, tani i ndjeri XH (H) M, ja ka lënë pasurinë e cekur më lartë dhënësit të ushqimisë E (XH) M. Meqënse i ndjeri XH (H) M, nuk ka pasuri tjetër e cila kishte me qenë lëndë e shqyrtimit, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Dhënësi i ushqimisë, E (XH) M, të drejtën e vetë nga kjo kontratë në kuptim të dispozitave të nenit 106, i LTK-së mund ta regjistrojë në librin publik."*

Pra, gjykata duke u mbështetur në nenin 106 i LTK-së, e udhëzon palën që të drejtën nga kontrata ta regjistrojë në librin publik. Mirëpo, neni 106 i LTK-së dhe as ndonjë dispozitë tjetër e LTK-së, mundësinë e regjistrimit të kontratës për mbajtje të përjetshme nuk e parasheh dhe as nuk e rregullon. Përkatësisht, në nenin 106 i LTK-së thuhet kësisoj: "*Testatori mund t'i kërkojë Gjykatës Trashëgimore të emërojë një ekzekutues, ose të emërojë një të tillë nëse ekzekutuesi i caktuar nga testatori refuzon të marrë detyrën ose është shkarkuar nga Gjykata Trashëgimore*."

Kundër aktvendimit në fjalë, më kohë kanë paraqitur ankesë vajzat e trashëgimlënësit, për të gjitha shkaqet për të cilat sipas ligjit lejohet të ushtrohet ankesa, më propozimin që të prishet aktvendimi dhe çështja të kthehet në rigjykim. Ndër të tjera në ankesë theksohet se ankueset janë njoftuar rastësisht për fillimin e procedurës dhe më parashtresën e dt.14.12.2009, janë paraqitur si trashëgimtarë duke e njoftuar gjykatën se një pjesë të pasurisë se përfshirë në kontratën mbi mbajtje të përjetshme, i ndjeri e ka disponuar paraprakisht më kontratën mbi faljen, e cila kontratë edhe është vërtetuar në gjykatë. Mirëpo, pavarësisht lajmërimit, gjykata ka vazhduar procedurën duke u mbështetur në deklarimin e të birit të të ndjerit.

Në shkresat e lëndës gjendet kontrata mbi mbajtjen e përjetshme e lidhur në Pejë, më dt.15.04.2009[762] në mes të XH.M, si ushqimmarrës në njërën anë me të birin E (XH) M, në anën tjetër si ushqimdhënës, në bazë të të cilës gjykata edhe ka vepruar. Gjithashtu, nga shkresat e

[762] Në nenin 2 të kësaj kontratë përcaktohet: "se kontraktuesit janë marrë vesh që të jetojnë bashkërisht në një bashkësi famijare në shtepinë e tyrë gjatë tërë jetës, ndërsa ushqimdhënësi është obliguar që ushqimmarrësit t'ia mundësoi një jetë të qetë e të rehatshme , që të ushqej, ta pajisë me veshmbathje të kujdeset për higjienën dhe shëndetin e tij në rast të sëmundjes të kujdeset për shërimin e tij dhe pas vdekjes ta varros sipas zakoneve vendore, ti kryej të gjitha ceromonit fetare dhe t'ia rregullon varrezën , ndërsa ushqimmarrësi si kompensim për të gjitha këto , ushqimdhënësit ia lenë në trashëgim dhe pronësi patundshmërinë e regjistrar me numër të njësisë P-71610710-00664-1 në sipërfaqe prej 178 m3 nga certifikata e pronësisë nr.UL-7161071-04915 ZK-Pejë".

lëndës rezulton se i ndjeri XH.M, e ka disponuar një pjesë të pasurisë gjegjësisht ngastrën kadastrale 664/1 në bazë të kontratës mbi falje, në favor të dy vajzave të tij, dhe e njëjta kontratë rezulton se është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë, nën Vr.4823/02 dt.17.06.2002, dhe se një ekzemplar i është dorëzuar drejtorisë për kadastër, gjeodezi dhe pronësi në Pejë, me 25.09.2002. Mirëpo, në aktvendimin e atakuar gjegjësisht në pjesën arsyetuese të tij nuk përmendet ky fakt, për çka konsiderojmë se gjykata ka vepruar jo drejtë. Duke qenë se nga provat e prezantuara nga palët është vërtetuar se i ndjeri, ka disponuar më paluajtshmërinë e vet gjatë jetës në bazë të kontratës mbi faljen dhe kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, në një rast të këtillë mendojmë se gjykata është dashur vetëm të pezullojë procedurën trashëgimore për shkak se i ndjeri konsiderohet se nuk ka lënë pasuri, por jo të veprojë në bazë të kontratës mbi mbajtje të përjetshme. Kurse,pretendimet e palëve përkitazi më ekzistimin e kontratës mbi falje dhe kontratës mbi mbajtje të përjetshme, është dashur të shqyrtohen dhe vlerësohen në procedurë kontestimore. Është interesante se Gjykata e Qarkut në Pejë, ka marrë vendim që të refuzohen si të pabazuara ankesat dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet. Kështu, në dispozitivin e aktvendimit të Gjykatës së Qarkut përcaktohet kësisoj:

"*Refuzohen si të pabazuara ankesat e N.K e lindur M. dhe V.L e lindur M, që të dyja nga Peja, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komunale në Pejë, T.nr.230/2009 të dt.16.12.2009 VËRTETOHET*."

Arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, është jo i qartë dhe kontradiktor. Në pjesën e parë të arsyetimit, theksohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur e ka pezulluar procedurën trashëgimore për shkak të ekzistimit të kontratës mbi mbajtje të përjetshme dhe e ka udhëzuar palën që të drejtën ta regjistrojë në librat publik. Kurse, në pjesën e fundit të arsyetimit theksohet se duke qenë se trashëgimlënësi për së gjalli e ka disponuar pasurinë nëpërmjet kontratës mbi falje dhe kontratës mbi mbajtje të përjetshme, gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur e ka pezulluar procedurën trashëgimore.

Përkatësisht, në pjesën arsyetuese të aktvendimit pëcaktohet kësisoj:

"Gjykata e shkallës së parë në bazë të aktvendimit të atakuar nën paragrafin1 të dispozitivit e ka pezulluar procedurën për shqyrtimin e masës trashëgimore pas vdekjes së të ndjerit Xh. (H) M , i vdekur më 27.11.2009 në Pejë për shkak ekzistimit të kontratës mbi mbajtje të përjetshme. Nën paragrafin 2 të dispozitivit konstaton se dhënësi i ushqimisë E (XH) M, të drejtën e vet nga kjo kontratë konform nenit 106 i LTK, mund ta regjistron në librin publik.

Gjykata e Qarkut ka shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të gjithë anshëm të tyre në bazë të nenit 194 të LPK, gjeti se: ankesat janë të pabazuara.[763] *Vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj e aprovon edhe Gjykata e Qarkut, për arsye, se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikë b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe së drejtë e ka zbatuar gjykata e shkallës së parë të drejtën materiale e të cilat shkaqet ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LTK." Nga shkresat e lëndës rrjedhë se i ndjeri i ndjeri XH.M, ka disponuar më ngastrën 664/1 në bazë të kontratës mbi faljen e pasurisë së patundshme të theksuar më lartë, mirëpo, përkundër këtij fakti me këtë ngastër ka disponuar edhe në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme e lidhur më vonë se kontrata mbi faljen*.[764]*Duke u bazuar në faktin se i ndjeri XH.M,ka disponuar më patundshmërinë e vet në bazë të kontratës mbi falje dhe kontratës mbi mbajtjen e përjetshme në këtë rast gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se i ndjeri nuk ka lënë pasuri dhe më të drejtë e ka pezulluar procedurën trashëgimore, respektivisht drejtë ka vendosur që mos shqyrtohet pasuria trashëgimore për shkak se i ndjeri konsiderohet se nuk ka lënë pasuri trashëgimore".*[765]

Duke qenë se në bazë të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë e ka pezulluar procedurën trashëgimore duke e theksuar si shkak vetëm ekzistimin e kontratës mbi mbajtje të përjetshme, dhe njëkohësisht pa bazë ligjore e ka udhëzuar palën që të drejtën nga kontrata ta regjistrojë në librat publik, konsiderojmë se vendimi i Gjykatës se Qarkut është jo i drejtë. Përkatësisht mendojmë se Gjykata e Qarkut konformë nenit 195 pika e) dhe nenit 201 i LPK, është dashur ta ndryshojë aktvendimin e atakuar,duke theksuar se procedura trashëgimore pezullohet për shkak që trashëgimlënësi nuk ka lënë pasuri gjegjësisht se trashëgimlënësi e ka disponuar pasurinë për se gjalli në bazë të kontratës mbi faljen dhe kontratës mbi mbajtjen e përjetshme dhe duke theksuar se palët lidhur më vërtetimin e pretendimeve të tyre mund të inicojnë procedurën kontestimore.

[763] Vendimi: Ac.nr.43/2010 dt.16.03.2010.Gjykata e Qarkut në Pejë.Fq.1
[764] Po aty,Fq.2
[765] Po aty,Fq.3

5.3.7. Numri i rasteve për të cilat është ndërprerë procedura trashëgimore dhe shkaqet e ndërprerjës

Në tabelën më poshtë, është paraqitur numri i përgjithshëm i rasteve për të cilat është ndërprerë procedura dhe shkaqet e ndërprerjës, në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë.

Tabela 29: Numri i rasteve për të cilat është ndërperë procedura trashëgimore dhe shkaqet e ndërprerjës 2003-2014

Viti	Nr. i rasteve të përfunduara deri në përiudhën kur është kryer hulumtimi	Nr. total i rasteve për të cilat është ndërpreprë procedrua	Nr i rasteve për të cilat procedura është ndërprerë për shkak të kontestit	Nr i rasteve për të cilat procedura është ndërprerë për shkak të inkompetences se gjykatës	Nr i rasteve për të cilat procedura është ndërprerë për shkak të mosinteresimit të palëve
2003	1,535	67	17	11	39
2004	1,475	57	21	14	22
2005	1,758	93	14	9	70
2006	1,756	73	19	15	39
2007	1,808	109	23	12	74
2008	1,732	114	16	20	78
2009	2,177	206	20	17	169
2010	2,322	193	24	11	158
2011	2,353	220	27	16	177
2012	1,720	227	16	19	192
2013	188	49	7	11	31
2014	67	21	3	3	15
Total	18,891	1,429	207	158	1,064

Nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014,në gjykatat e përfshira në studim, gjegjësisht në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë, për 1,429 raste kemi vërejtur se është ndërprerë procedura përkatësisht:

- Për 207 raste procedura është ndërprerë për shkak të ekzistimit të kontestit midis palëve;
- Për 158 raste procedura është ndërprerë për shkak të inkompetencës se gjykatës; dhe
- Për 1, 064 raste procedura është ndërprerë për shkak të mosinteresimit të palëve.

5.4. Analiza e të dhënave të nxjerra nga pyetësorët

Në bazë të analizës së rezultateve nga 792 pyetësorë, të shpërndarë tek individët e ndryshëm në Kosovë, janë gjeneruar disa të dhëna mbi pikëpamjet e grave dhe burrave për çështje të ndryshme që ndërlidhen më të drejtën e trashëgimisë së gruas, më qëllim të identifikimit të faktorëve kryesore që ndikojnë në mos përfshirjen e mjaftueshme të grave në trashëgimi.

Grafiqet Nr/6: Si mendoni sipas legjislacionit kosovar a konsiderohen të barabartë gratë dhe burrat në të drejtat pronësore:

Grafiku 6.1 Opinioni i grave



Grafiku 6.2 Opinioni i burrave



Sikurse e kemi theksuar edhe më parë, më legjislacionin pozitiv në Kosovë, duke filluar nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore më të cilat rregullohen marrëdhëniet pronësore në Kosovë, gratë dhe burrat konsiderohen plotësisht të barabartë në të drejtat pronësore dhe trashëgimore. Përkatësisht, Kushtetuta, LPDTS, LTK, LTF dhe LBGJ, sigurojnë qasjen e grave në pronë në mënyrë të barabartë më burrat. Mirëpo, shumë gra dhe burra në Kosovë, nuk e dinë se më ligj u garatohen të drejta të barabarta në pronë dhe trashëgimi. Kështu, në anketë sikurse mund të shihet edhe nga grafiqet më lartë, 45% e grave dhe 39% e burrave janë përgjigjur që gratë dhe burrat nuk konsiderohen të barabartë në të drejtat pronësore-trashëgimore sipas ligjit në Kosovë.Pra, shumë gra dhe burra në Kosovë kanë mungesë të njohurive në lidhje më të drejtat pronësore që ju takojnë në bazë të ligjit.

Grafiqet Nr/7: A duhet të trashëgojnë në mënyrë plotësisht të barabartë gratë dhe burrat:

Grafiku 7.1 Opinioni i grave



Grafiku 7.2 Opinioni i burrave



Në pyetjen se a duhet të trashëgojnë në mënyrë plotësisht të barabartë femrat dhe meshkujt, 61% e femrave dhe 52% e meshkujve janë shprehur po, ndërsa se nuk duhet të trashëgojnë në mënyrë të barabartë janë shprehur 29% e femrave dhe 40% e meshkujve si dhe 10% e femrave dhe 8% e meshkujve janë shprehur se nuk e dinë nëse femrat dhe meshkujt duhet të trashëgojnë në mënyrë të barabartë. Është më rëndësi të ceket, se shumë prej të anketuarve të cilët janë shprehur se meshkujt dhe femrat nuk duhet të trashëgojnë në mënyrë të barabartë, kanë dhënë mendimin se trashëgimia duhet të ndahet sipas rregullave të kuranit. Ndërsa, në pyetjen se a keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast jashtë familjes ku femra ka trashëgu në mënyrë të barabartë më meshkujt, vetëm 23% e femrave dhe 27% e meshkujve janë deklaruar se kanë pasur një rast të tillë në familje dhe apo se dinë për ndonjë rast jashtë familjes ku femrat kanë trashëguar në mënyrë të barabartë më meshkujt.

Grafiqet Nr/8: A keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast jashtë familjes ku femra ka trashëgu në mënyrë të barabartë më meshkujt:

Grafiku 8.1 Opinioni i grave



Grafiku 8.2 Opinioni i burrave



Grafiqet Nr/9: A keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast tjetër jashtë familjes që femrës nuk iu është njohur fare e drejta në trashëgimi familjare:

Grafiku 9.1 Opinioni i grave



Grafiku 9.2 Opinioni i burrave



Sikurse mund të shihet edhe nga të dhënat e paraqitura në grafiqet më lartë, 69% e femrave dhe 67% e meshkujve kanë deklaruar që kanë pasur rast në familjen e tyre, apo që dinë për ndonjë rast tjetër jashtë familjes, ku femrës nuk iu është njohur fare e drejta në trashëgimi familjare. Shumë prej të anketuarve femra janë shprehur se edhe vet atyre nuk u është njohur e drejta në trashëgimi në familjen e babait.

Ndërsa, në pyetjen se a keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast jashtë familjes ku femra është detyruar nga anëtarët e tjerë të familjes respektivisht nga anëtaret

meshkuj të familjes të heqë dorë nga trashëgimia, 46% e femrave dhe 40% e meshkujve janë përgjigjur po.

Grafiqet Nr/10: A dini për ndonjë rast që femra është detyruar nga anëtarët e tjerë të familjes (zakonisht anëtare meshkuj të familjes) të heqë dorë nga trashëgimia:

Grafiku 10.1 Opinioni i grave



Grafiku 10.2 Opinioni i burrave



Grafiqet Nr/11: A mendoni se në praktikë ndarja e trashëgimisë është më e madhe për burrat sesa për gratë:

Grafiku 11.1 Opinioni i grave



Grafiku 11.2 Opinioni i burrave



Sikurse mund të shihet edhe nga grafiqet më lartë, në pyetjen a mendoni se në praktikë ndarja e trashëgimisë është më e madhe për burrat sesa për gratë, 79% e femrave dhe 70% e meshkujve janë përgjigjur po, 11% e femrave dhe 17% e meshkujve janë përgjigjur jo, si dhe 11% e femrave dhe 13% e meshkujve janë përgjigjur se nuk e dinë nëse qendron një pohim i tillë , pra, se në praktikë gratë trashëgojnë më pak se burrat.

Një tregues i rëndësishëm i faktit se gratë trashëgojnë më pak sesa burrat në praktikë, është numri i vogël i pronave të paluajtshme të regjistruara në emër të grave. Kështu, vetëm 14% e femrave dhe 12% e meshkujve janë përgjigjur që prona në familjen e tyre është e regjistruar në

emër të gruas, kurse 78% e femrave dhe 79% e meshkujve janë përgjigjur që prona në familjen e tyre është e regjistruar në emër të burrit,si dhe 8% e femrave dhe 9% e meshkujve janë përgjigjur që prona në familjen e tyre është e regjistruar në emër të përbashkët të të dy bashkëshortëve.

Grafiqet Nr/12: Në emër të kujt është e regjistruar prona në familjen tuaj:

Grafiku 12.1 Opinioni i grave



Grafiku 12.1 Opinioni i burrave



Grafiqet Nr/13: A mendoni së përkundër asaj që trashëgimia rregullohet më ligj,në praktikë sidomos kur bëhet fjalë për të drejtën e gruas në trashëgimi vazhdojn të zbatohen rregullat zakonore:

Grafiku 13.1 Opinioni i grave



Grafiku 13.2 Opinioni i burrave



Siç mund të shihet edhe nga të dhënat e paraqitura në grafiqet më lartë, 72% e femrave dhe 67% e meshkujve të anketuar besojnë së përkundër asaj që trashëgimia rregullohet më ligj, në praktikë veçanërisht kur bëhet fjalë për të drejtën e gruas në trashëgimi vazhdojn të zbatohen rregullat zakonore. Ndërsa, në pyetjen se a duhet të ruhet kjo praktikë, 29% e femrave dhe 42% e meshkujve janë përgjigjur jo. Pra, një pjesë e madhe e burrave ende konsiderojnë se është e drejtë të ruhet praktika e zbatimit të zakoneve në trashëgimi.

Grafiqet Nr/14: A duhet të ndryshohet praktika e zbatimit të zakoneve në trashëgimi:

Grafiku 14.1 Opinioni i grave



Grafiku 14.2 Opinioni i burrave



Në pyetjen, kush e ka rolin kryesor në ngritjen e vetëdijes në kontekstin e barazisë në mes femrave dhe meshkujve në trashëgimin e pronës familjare, siç mund të shihet edhe nga grafiku nr.14.1 dhe nr.14.2, pjesa më e madhe e të anketuarve konsiderojnë se faktori kryesor dhe më i rëndësishmi është familja përkatësisht 34% e femrave dhe 32% e meshkujve janë shprehur që familja është faktor shumë i rëndësishëm. Ndërsa, për shkollën si faktor shumë i rëndësishëm janë përgjigjur 24% e femrave dhe 23% e meshkujve, për institucionet shtetërorë janë përgjigjur 19% e femrave dhe 19% e meshkujve, për rrethinë/shoqërinë janë përgjigjur 15% e femrave dhe 11% e meshkujve si dhe për mediat si faktor shumë i rëndësishëm janë përgjigjur 8% e femrave dhe 15% e meshkujve. Pra, sipas vlerësimit të të anketuarve, për nga rëndësia në

ngritjen e vetëdijës në kontekstin e barazisë në mes femrave dhe meshkujve në trashëgimin e pronës familjare, familja renditet e para, shkolla renditet e dyta, institucionet shtetërore renditen të tretat, shoqëria renditet e katërta dhe mediat renditen të pestat.

Grafiqet Nr/15: Kush e ka rolin kryesor në ngritjen e vetëdijës në kontekstin e barazisë në mes femrave dhe meshkujve në trashëgimin e pronës familjare,vlerësoni nga 1 deri 5:

Grafiku 15.1 Opinioni i grave



Grafiku 15.2 Opinioni i burrave



Grafiqet Nr/16: Motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve:

Grafiku 16.2 Opinioni i grave



Grafiku 16.2 Opinioni i burrave



Sikurse mund të shihet edhe nga të dhënat e paraqitura në grafiqet më lartë, 44% e femrave dhe 52% e meshkujve të anketuar janë shprehur së pajtohen më pohimin që motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve, ndërsa së nuk pajtohen më një pohim të tillë janë shprehur 46% e femrave dhe 39% e meshkujve si dhe 10% e femrave dhe 9% e meshkujve janë shprehur neutral.

Ndërsa, lidhur më pohimin që motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia edhe në rastet kur nuk kanë vëllezër, janë pajtuar vetëm 4% e femrave dhe 6% e meshkujve, kurse 92% e

femrave dhe 88% e meshkujve janë shprehur se nuk pajtohen më një pohim të tillë, si dhe neutral janë shprehur 4% e femrave dhe 6% e meshkujve.

Grafiqet Nr/17: Edhe në rastet kur nuk kanë vëllezër motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia:

Grafiku 17.1 Opinioni i grave



Grafiku 17.2 Opinioni i burrave



Grafiqet Nr/18: Bashkëshortja e trashëgimlënësit kur nuk ka fëmijë nuk mund të trashëgojë pasurinë, atë duhet ta trashëgojnë prindërit apo vëllezërit e trashëgimlënësit:

Grafiku 18.1 Opinioni i grave



Grafiku 18.2 Opinioni i burrave



Siç mund të shihet edhe nga grafiqet më lartë, 30% e femrave dhe 46% e meshkujve janë pajtuar më pohimin që bashkëshortja e trashëgimlënësit kur nuk ka fëmijë nuk mund të trashëgojë pasurinë, atë duhet ta trashëgojnë prindërit apo vëllezërit e trashëgimlënësit, ndërsa 47% e femrave dhe 43% e meshkujve janë shprehur së nuk pajtohen më një pohim të tillë , kurse neutral janë shprehur 13% e femrave dhe 11% e meshkujve. Ndërsa, lidhur më pohimin që bashkëshortja e trashëgimlënësit edhe kur ka fëmijë nuk duhet të trashëgojë, por duhet të heqë

dorë nga trashëgimia në favor të fëmijve gjegjësisht djemve, janë pajtuar 35% e femrave dhe 40% e meshkujve, ndërsa nuk janë pajtuar 52% e femrave dhe 45% e meshkujve, si dhe neutral janë shprehur 13% e femrave dhe 15% e meshkujve.

Grafiqet Nr/19: Bashkëshortja e trashëgimlënësit edhe kur ka fëmijë duhet të heqë dorë nga trashëgimia në favor të fëmijve/djemve

Grafiku 19.1 Opinioni i grave



Grafiku 19.2 Opinioni i burrave



Grafiku Nr/20: Në rast së paradhësi i juaj më testament do t'iu ndante në mënyrë të barabartë pronën familjare më trashëgimtarët meshkuj të familjes a do ta pranonit trashëgiminë



Grafiku Nr/21: Duke e ditur që edhe sipas ligjit iu takon e drejta e barabartë më meshkujt në trashëgimi a do kërkonit ju që trashëgimia të ju ndahet në mënyrë plotësisht të barabartë më trashëgimtarët meshkuj të familjes:



Në pyetjen në rast së paraardhësi i juaj më testament do t'iu ndante në mënyrë të barabartë pronën familjare më trashëgimtarët meshkuj të familjes, a do ta pranonit trashëgiminë , 63% e femrave të anketuar janë përgjigjur po, 24% janë përgjigjur jo, si dhe 13% janë përgjigjur se nuk e dinë se si do të vepronin në këtë rast. Ndërsa, në pyetjen duke e ditur që edhe sipas ligjit iu takon e drejta në trashëgimi njëjtë si meshkujve, a do kërkonit ju që trashëgimia të ju ndahet në mënyrë të barabartë më trashëgimtarët meshkuj të familjes, siç mund të shihet edhe nga të dhënat e paraqitura në grafikun nr.20, vetëm 27% e femrave janë përgjigjur po.

Grafiku Nr/22: Në rast së paraardhësi i juaj më testament do t'iu ndante në mënyrë të barabartë pronën familjare më trashëgimtarët femra të familjes si do vepronit:



Grafiku Nr/23: Në rast së pas vdekjes së prindërve motra/rat do kërkonin hise në pronën e babait si do vepronit



Në pyetjen poqëse paraardhësi i juaj më testament do t'iu ndante në mënyrë të barabartë pronën familjare më trashëgimtarët femra të familjes gjegjësisht më motrat si do vepronit, 48% e meshkujve janë përgjigjur që do e pranonin testamentin, 23% janë përgjgjur që do e kundërshtonin testamentin, 5% janë përgjigjur që do kërkonin nga trashëgimtarët femra të heqin dorë nga trashëgimia, 2% janë përgjigjur që nuk e do pranonin kurrsesi këtë fakt si dhe 22% janë

përgjigjur që nuk e dinë se si do të vepronin në këtë rast. Ndërsa, në pyetjen poqëse pas vdekjes së prindërve motra/rat do kërkonin hise në pronën e babait si do vepronit, 37% e burrave të anketuar janë përgjigjur që do i përkrahnin motrat në realizimin e të drejtës së tyre, 30% janë përgjigjur që nuk do i përkrahnin, 7% janë përgjigjur që do kërkonin nga motrat të heqin dorë nga trashëgimia, 2% janë përgjigjur që kurrsesi nuk do i përkrahnin, 5% janë shprehur neutral si dhe 19% janë përgjgjur që nuk e dinë se si do të vepronin në këtë rast.

Grafiku Nr/24: Në rast së do ju mohohej e drejta e trashëgimisë në pronën familjare nga anëtarët meshkuj të familjes si do vepronit:



Në pyetjen poqëse do ju mohohej e drejta e trashëgimisë në pronën familjare nga anëtarët meshkuj të familjes respektivisht nga vëllezërit si do vepronit, siç mund të shihet edhe nga grafiku më lartë, vetëm 15% e femrave janë përgjigjur që do iniconin padi në Gjykatë, 19% janë përgjigjur që asnjëherë nuk do iniconin padi, 49% janë përgjigjur që do heshtnin, si dhe 17% janë përgjigjur që nuk e dinë se si do vepronin në një rast të tillë.

Pjesa më e madhe e të anketuarve femra mendojnë se nuk do të hasnin në përkrahje sidomos të familjes dhe shoqërisë, poqëse do të kërkonin realizimin e të drejtës së trashëgimisë më padi. Kështu, vetëm 13% e femrave besojnë se do ishin përkrahur mjaftueshëm nga familja, 14% besojnë se do ishin përkrahur pak nga familja, 20% besojnë se do ishin përkrahur shumë pak, 28% besojnë se nuk do ishin përkrahur aspak si dhe 25% nuk e dinë nëse do ta kishin ose jo përkrahjen e familjes në një rast të tillë. Pra, mbi 60% e femrave besojnë se do ishin përkrahur

pak, shumë pak ose aspak nga familja. Edhe në shoqëri femrat mendojnë se nuk do të gjenin mbështetje poqëse do kërkonin më padi realizimin e të drejtës së trashëgimisë, kështu në këtë rast vetëm 10% e femrave besojnë se do gjenin mbështetje të mjaftueshme tek shoqëria, 72% besojnë se do ishin përkrahur pak (10%), shumë pak (23%) ose aspak (39%) si dhe 18% nuk e dinë nëse do ta kishin përkrahjen e shoqërisë. Sa i përkët institucioneve të drejtësisë, pjesa më e madhe e femrave gjegjësisht 42% janë shprehur se nuk e dinë nëse do ishin përkrahur nga institucionet e drejtësisë/gjykata, ndërsa 18% janë shprehur se do ishin përkrahur pak, 9% janë shprehur se do ishin përkrahur shumë pak, 7% janë shprehur se nuk do ishin përkrahur aspak si dhe 23% janë shprehur se do ishin përkrahur mjaftueshëm nga institucionet e drejtësisë respektivisht nga gjykata.

Grafiku Nr/25: Në rast së do të kërkonit realizimin e të drejtës së trashëgimisë më padi si mendoni sa do të haseni në përkrahje të:



	Pak	Shumë pak	Mjafueshëm	Aspak	Nuk e di
Familjes	55	79	52	111	98
Rrethit/Shoqërisë	41	90	41	154	69
Institucioneve të drejtësisë/Gjykatës	71	36	91	29	168

Grafiku Nr/26: Në rastet kur femrës i mohohet e drejta në trashëgimi p.sh., nga vëllezërit sipas mendimit tuaj a duhet ajo të inicojë padi

Grafiku 26.1 Opinioni i burrave



Në pyetjen poqëse femrës i mohohet e drejta në trashëgimi p.sh., nga vëllezërit sipas mendimit tuaj a duhet ajo të inicojë padi, siç mund të shihet edhe nga grafiku më lartë, vetëm 34% e burrave janë përgjigjur po.

Grafiku Nr/27: Në rast së një femër do kërkonte realizimin e të drejtës së trashëgimisë më padi si mendoni sa do të haste ajo në përkrahje të:

Grafiku 27.1 Opinioni i burrave



	Pak	Shumë pak	Mjafueshëm	Aspak	Nuk e di
Familjes	125	106	38	82	46
Rrethit/Shoqërisë	77	96	56	143	25
Institucioneve të drejtësisë/Gjykatës	70	41	177	18	91

Edhe të anketuarit meshkuj mendojnë se femrat nuk do të hasnin në përkrahje veçanërisht të familjes dhe shoqërisë poqëse do kërkonin më padi të drejtën e trashëgimisë. Kështu, sikurse mund të shihet edhe nga grafiku nr/25, në pyetjen poqëse një femër do kërkonte më padi të drejtën e trashëgimisë sa do mbështetej ajo nga familja, 31% e meshkujve janë përgjigjur pak, 27% janë përgjigjur shumë pak, 21% janë përgjigjur aspak, 9% janë përgjigjur mjaftueshëm si dhe 12% janë përgjigjur se nuk e dinë nëse një femër do përkrahej ose jo nga familja poqëse do kërkonte më padi të drejtën e trashëgimisë. Gjithashtu, as në shoqëri meshkujt mendojnë se femrat nuk do të gjenin përkrahje të mjaftueshme poqëse do kërkonin më padi të drejtën e trashëgimisë, përkatësisht në një rast të tillë përkrahja nga shoqëria 20% e meshkujve besojnë se do të ishte pak, 24% shumë pak, 36% aspak, 14% mjaftushëm si dhe 6% nuk e dinë nëse femrat do të ishin përkrahur ose jo nga shoqëria. Ndryshe nga të anketuarit femra, pjesa më e madhe e të anketuarve meshkuj, gjegjësisht 45% mendojnë se femrat do ishin përkahur mjaftueshëm nga instutucionet e drejtësisë respektivisht gjykata, poqëse më padi do kërkonin të drejtën e trashëgimisë.

Grafiqet Nr/28: A dini për ndonjë rast që femra ka kërku më padi realizimin e të drejtës së trashëgimisë:

Grafiku 28.1 Opinioni i grave



Grafiku 28.2 Opinioni i burrave



Në pyetjen a dini për ndonjë rast që femra ka kërku më padi realizimin e të drejtës së trashëgimisë, siç mund të shihet edhe nga të dhënat e paraqitura në grafiqet më lartë, 42% e femrave dhe 48% e meshkujve janë përgjigjur po. Shumica e të anketuarve si femra ashtu edhe meshkuj janë shprehur që nga mjetet e informimit publik gjegjësisht nga televizioni kanë mësuar për raste të tilla, por që në rrethinë ku ata jetojnë nuk dinë ndonjë rast ku femra më padi ka kërkuar pjesën e vet të trashëgimisë. Në këtë pyetje, shumë prej të anketuarve kanë përmendur rastin e znj.Shyhrete Berisha.

Grafiqet Nr/29: Pse femrat në Kosovë nuk e kërkojnë trashëgiminë vlerësoni nga 1 deri 5 faktorët të cilet ndikojnë në këtë aspekt:

Grafiku 29.1 Opinioni i grave



Grafiku 29.2 Opinioni i burrave



Siç mund të shihet edhe nga grafiku nr.28.1 dhe nr.28.2, pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se zakonet janë faktori kryesor pse femrat në Kosovë, nuk e shfrytëzojnë të

drejtën e trashëgimisë, përkatësisht 78% e femrave dhe 74.5% e meshkujve të anketuar janë shprehur që zakonet janë faktor shumë i rëndësishëm.

Për varësinë e parashikuar tek prindërit pas martesës, si faktorë shumë i rëndësishëm janë përgjigjur 68% e femrave dhe 67% e meshkujve.

Për nivelin arsimor gjegjësisht mosvetëdijesimin e duhur, si faktorë shumë i rëndësishëm janë përgjigjur 45% e femrave dhe 42% e meshkujve.

Për mosbezdisjen e prindërve gjegjësisht vëllezërve si faktor shumë i rëndësishëm janë përgjigjur 59.4% e femrave dhe 48% e meshkujve; si dhe

Për mosbesimin në institucionet e drejtësisë si faktor shumë i rëndësishëm janë përgjigjur 37% e femrave dhe 41% e meshkujve.

Pra, sipas vlerësimit të të anketuarve, për nga rëndësia faktorët të cilet ndikojnë që femrat të mos trashëgojnë në Kosovë,renditen kësisoj: faktori i parë dhe më i rëndësishëm konsiderohen zakonet, faktori i dytë më rëndësi konsiderohet varësia e parashikuar tek prindërit pas martesës, faktori i tretë konsiderohet mosbezdisja e prindërve gjegjësisht vëllezërve, faktori i katërtë konsiderohet niveli arsimor si dhe faktori i pestë më rëndësi pse femrat nuk e kërkojnë të drejtën e trashëgimisë konsiderohet mosbesimi në institucionet e drejtësisë.

Grafiqet Nr/30: A keni të hartuar testament:

Grafiku 30.1 Opinioni i grave



Grafiku 30.2 Opinioni i burrave



Sikurse e kemi theksuar edhe në pikën 5.2.3.3, të këtij kapitulli, gjatë hulumtimit në gjykata nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, në gjykatat e përfshira në studim, vetëm për 62 raste (0.32%) kemi vërejtur se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit. Pra,numri i trashëgimlënësve të cilët lënë testament është jashtëzakonisht i vogël. Kështu, edhe në anketë nga 395 femra të anketuara vetëm 4 apo 1% kanë deklaruar që kanë të hartuar testament,ndërsa nga 397 meshkuj të anketuar vetëm 7 apo 1.76% kanë deklaruar që kanë

të hartuar testament. Pra,nga gjithsej 792 individë të anketuar vetëm 11 apo 1.38% kanë deklaruar që kanë të hartuar testament.

Grafiqet Nr/31: Kujt mendoni ju t'ia bartin trashëgiminë

Grafiku 31.1 Opinioni i grave



Grafiku 31.2 Opinioni i burrave



Sikurse mund të shihet edhe nga grafiqet më lartë, në pyetjen se kujt mendoni t'ia bartin trashëgiminë 45% e femrave dhe 31% e meshkujve kanë deklaruar se trashëgiminë do ja ndajnë si vajzave ashtu edhe djemve, pra, në mënyrë të barabartë; 40% e femrave dhe 44% e meshkujve

kanë deklaruar se një pjesë të pasurisë do ja ndajnë edhe vajzave, por gjithsesi që djemtë do i favorizojnë; 8% e femrave dhe 15% e meshkujve kanë deklaruar që trashëgiminë do ja ndajnë vetëm djemve; 1% e femrave ashtu si edhe 1% e meshkujve kanë deklaruar së trashëgiminë do ja ndajnë vetëm vajzave; 2% e femrave dhe 6% e meshkujve kanë deklaruar se vetëm në rast se nuk do kishin djalë do ja ndanin trashëgiminë vazjave si dhe 4% e femrave dhe 3% e meshkujve kanë deklaruar se nuk e dinë se kujt do ja ndajnë trashëgiminë.

Grafiqet Nr/32: A mendoni që në përgjithësi pozita ekonomike-sociale e gruas do të ishte më e mirë sikur të ishte më shumë e përfshirë në trashëgiminë e pronës familjare:

Grafiku 32.1 Opinioni i grave



Grafiku 32.2 Opinioni i burrave



Në pyetjen a mendoni që në përgjithësi pozita ekonomike-sociale e gruas do të ishte më e mirë sikur të ishte më shumë e përfshirë në trashëgiminë e pronës familjare, 77% e femrave dhe 67% e meshkujve janë përgjigjur po, 7% e femrave dhe 9% e meshkujve janë përgjigjur jo si dhe 16% e femrave dhe 24% e meshkujve janë përgjigjur se nuk e dinë nëse pjesëmarrja më e madhe e femrave në trashëgimi do të përmirësonte poziten e tyre ekonomike-sociale.

Përfundimi

Nga analizimi i të dhënave të gjeneruara nga faza e hulumtimit gjegjësisht nga hulumtimi në gjykata dhe anketa (pyetësori) më qytetarë mund të nxjerrën konkluzionet si në vijim:

- Në praktikë procedurat trashëgimore nuk inicohen sipas detyrës zyrtare ashtu siç parashihet më ligj. Kjo pasi organi komunal i gjendjes civile nuk e kryen detyren që në afatin e paraparë më ligj të dërgojë aktvdekjen në gjykatë. Nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, në gjykatat e përfshira në studim, vetëm për 167 raste u vërtetua se procedura është inicuar sipas detyrës zyrtare. Mos inicimi i procedurës trashëgimore sipas detyrës zyrtare nga gjykata, shkakton që palët gjegjësisht trashëgimtarët potencial të inicojnë procedurën trashëgimore shumë vite pas vdekjes së trashëgimlënësit.
- Edhe pse më ligj përparësi i jepet trashëgimisë testamentare në raport më trashëgiminë ligjore, në praktikë në shumicën e rasteve trashëgimia ndahet në mungesë të testamentit. Kështu, nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, në gjykatat e përfshira në studim, vetëm për 62 (0.32%) raste u vërtetua se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit. Edhe në anketë një numër shumë i vogël i të anketuarve, kanë deklaruar që kanë të hartuar testament përkatësisht nga 395 femra të anketuara vetëm 4 apo 1% kanë deklaruar që kanë të hartuar testament, ndërsa nga 397 meshkuj të anketuar vetëm 7 apo 1.76% kanë deklaruar që kanë të hartuar testament.
- Një pjesë e madhe e burrave dhe grave në Kosovë, përkatësisht nga rezultati i anketës (pyetësorit) del se 45% e grave dhe 39% e burrave, nuk e dinë që sipas ligjit në Kosovë, gratë dhe burrat konsiderohen të barabartë në të drejtat pronësore-trashëgimore. Mirëpo, edhe pse më ligj gruas i garantohet e drejta e barabartë më burrat në trashëgimi, në praktikë, numri i grave të cilat e shfrytëzojnë të drejtën e trashëgimisë është shumë i ulët. Gratë në shumicën e rasteve heqin dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve meshkuj respektivisht vëllezërve. Kështu, nga hulumtimi në gjykatat e përfshira në studim, u vërtetua se nga 29,068 femra të përfshira në aktvdekjet e rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, kanë hequr dorë nga trashëgimia 21,079 apo 72%. Arsyeja kryesore pse gratë heqin dorë nga trashëgimia ndërlidhet kryesisht më zakonet dhe traditat e vendit. Shoqëria kosovare ende vazhdon t'iu jap një rëndësi të konsiderueshme respektimit të zakoneve dhe traditave.

Konkluzionet

Nga informacionet e trajtuara përmes analizës së Ligjeve për Trashëgimi të shteteve të përfshira në studim, lidhur më specifikat dalluese të rregullimit të çështjeve më kryesore që ndërlidhen më trashëgiminë ligjore dhe testamentare si dhe më procedurën trashëgimore, mund të nxjerrën konkluzionet si në vijim:

- Shumë çështje që lidhen më trashëgiminë ligjorë në Kosovë dhe në shtetet e përfshira në studim përkatësisht në Maqedoni, Shqipëri, Serbi, Mal të Zi, Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, rregullohen në mënyrë të njëjtë, megjithatë ekzistojnë edhe dallime të rëndësishme. Një dallim ekziston se në Kosovë, Maqedoni, Kroaci, Mal të Zi, Slloveni dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, më bashkëshortin martesor në trashëgimi barazohet edhe bashkëshorti jashtëmartesor. Kurse, në Shqipëri dhe Serbi bashkëshortëve jashtëmartesor, nuk u njihet e drejta e trashëgimit reciprok. Ndërkaq, në Slloveni dhe Kroaci ndryshe nga shtetet e tjera të përfshira në studim, e drejta e trashëgimit reciprok u njihet edhe partnerëve të të njëjtit seks, në mënyrë të njëjtë sikurse bashkëshortëve martesor.
- Në Shqipëri bashkëshorti pasjetues konsiderohet trashëgimtarë eskluzivë vetëm në rendin e tretë në trashëgim. Ndërsa, në Kosovë, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, bashkëshorti pasjtues konsiderohet trashëgimtarë eskluzivë në radhën e dytë në trashëgim. Një dallim tjetër mjaft i rëndësishëm është që në Kosovë, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, aplikohet e drejta e përfaqësimit pa kufizim, jo vetëm ndaj pasardhësve të trashëgimlënësit, por edhe ndaj kategorive tjerë të trashëgimtarëve ligjorë, në cilendo radhë të trashëgimisë. Ndërsa, në Shqipëri, e drejta e përfaqësimit aplikohet pa kufizim vetëm kur bëhet fjalë për fëmijët e fëmijëve të trashëgimlënësit dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të paravdekur të trashëgimlënësit.
- Edhe në lidhje më rregullimin e trashëgimisë testamentare, në Kosovë dhe vendet e rajonit të përfshira në studim, ekzistojnë dallime jo pak të rëndësishme, duke filluar nga aftësia e testatorit për të bërë testament. Kështu, në Kosovë aftësia për të bërë testament, i njihet çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, përjashtimisht edhe nën këtë moshë, në moshën 16 vjeçare, kur është i martuar. Në Shqipëri të drejtën për të bërë testament, e kanë personat që kanë mbushur moshën 18 vjeç, kurse nën këtë moshë, e drejta për të bërë

testament i lejohet vetëm gruas kur është e martuar. Gjithashtu, në Shqipëri e drejta për të bërë testament i njihet edhe personit mbi moshën 14 vjeç, për pasurinë që e ka fituar më punën e vet të pavarur. Në Kroaci të drejtën për të bërë testament, e ka çdo person që ka mbushur moshën 16 vjeç. Ndërsa, në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, e drejta për të bërë testament i njihet personave mbi moshën 15 vjeçare.

- Dallime të tjera më rëndësi ekzistojnë në lidhje më llojet e formave të testamenteve që aplikohen. Kështu, në Kosovë si testamente të rregullta aplikohen: testamenti ollograf, testamenti alografik, testamenti gjyqësor dhe testamenti noterial. Në Shqipëri aplikohen vetëm dy lloje të testamenteve të rregullta, testamenti ollograf dhe testamenti noterial. Ndërsa, në Serbi, Slloveni, Kroaci, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, si testamente të rregullta aplikohen testamenti ollograf, testamenti alografik, testamenti gjyqësor, testamenti noterial, testamenti ndërkombëtar dhe testamenti diplomatik (konsular). Këto forma të testamenteve aplikohen gjithashtu edhe në Maqedoni, përjashtimisht testamentit alografik.
- Dallime ekzistojnë edhe në lidhje më kushtet ligjore që kërkohen të plotësohen për vlefshmërinë e testamentit. Për shembull, në Kosovë dhe Shqipëri për vlefshmërinë e testamentit ollograf kërkohet domosdo të vihet edhe data e hartimit të testamentit. Ndërsa, në Maqedoni, Serbi, Slloveni, Kroaci, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, për vlefshmërinë e testamentit ollograf nuk kërkohet domosdo të vihet data në testament. Në Kosovë, Maqedoni dhe Slloveni për vlefshmërinë e testamentit noterial kërkohet që testamenti të bëhet gjithmonë në praninë e dy dëshmitarëve. Ndërsa, në Serbi, Kroaci, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë për vlefshmërinë e testamentit noterial kërkohet prania e dy dëshmitarëve, vetëm në rastin kur testatori nuk është në gjendje të lexojë dhe shkruajë. Ndërsa, në Shqipëri për vlefshmërinë e testamentit noterial nuk është e nevojshme prania e dëshmitarëve në asnjë rast.
- Dallime gjithashtu ekzistojnë edhe në lidhje më format e testamenteve të jashtëzakonshme. Kështu, në Serbi, Slloveni dhe Mal të Zi, si forma të testamenteve të jashtëzakonshme njihen: testamenti i bërë në anije; testamenti gojor dhe testamenti ushtarak. Në Bosnjë dhe Hercegovinë veç formave të testamenteve të përmendura më sipër, njihet edhe testamenti i bërë në aeroplan. Edhe në Shqipëri gjithashtu njihet testamenti ushtarak dhe testamenti i bërë në anijë, por jo edhe testamenti gojor. Në

Shqipëri njihet edhe një formë tjetër e testamentit të jashtëzakonshëm, ai i bërë në vendet ku nuk ka noterë, i cili vërtetohet nga kryetari ose sekretari i bashkësisë ose i komunës. Në Maqedoni si testamente të jashtëzakonshme, njihen testamenti gojor dhe testamenti ushtarak. Ndërsa, në Kosovë dhe Kroaci si formë e testamentit të jashtëzakonshëm njihet vetëm testamenti gojor.

- Në Kosovë kompetenca e organit kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore nuk është e përcaktuar në mënyrë të qartë. Kështu, sipas LPJK kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është gjykata, ndërsa më LNK parashikohet që shqyrtimi i pasurisë trashëgimore bëhet edhe nga noterët. Në Maqedoni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, parashikohet në mënyrë të qartë se shqyrtimi i pasurisë trashëgimore, përveç nga gjykata mund të bëhet edhe nga noterët e autorizuar nga gjykata trashëgimore. Kurse, në Serbi dhe Slloveni, kompetente për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore konsiderohet vetëm gjykata. Ndërsa, në Shqipëri shqyrtimi i rasteve të trashëgimisë konsiderohet kompetencë ekskluzivë e notërve. Dhe në Shqipëri ndryshe nga shtetet e tjera të përfshira në studim, procedura trashëgimore inicohet vetëm më kërkesën e palëve.

Ndërsa, nga informacionet e trajtuara përmes analizës së të dhënave primare nga faza e hulumtimit në gjykata (gjegjësisht nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, në Gjykatat Komunale tash Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren) dhe nga pyetësori më individë (792 gjithsej të zgjedhur për mostër), mund të nxjerrën këto konkluzione:

- Në praktikë procedura trashëgimore nuk inicohet sipas detyrës zyrtare ashtu siç parashihet më ligj. Kjo pasi organi komunal i gjendjes civile nuk e kryen detyren që në afatin e paraparë më ligj të dërgojë aktvdekjen në gjykatë. Kështu, gjatë fazës së hulumtimit nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, në gjykatat e përfshira në studim, vetëm për 167 raste u vërtetua se organi komunal e ka dërguar aktvdekjen në gjykatën trashëgimore dhe procedura është inicuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata.
- Për shumicën e rasteve të analizuara inicimi i procedurës trashëgimore është bërë më kërkesën e trashëgimtarëve meshkuj përkatësisht 12,843 raste apo 67.9% janë inicuar më kërkesën e trashëgimtarëve meshkuj; 3,751 raste apo 19.8% janë inicuar më kërkesën e trashëgimtarëve femra; 2,130 raste apo 11.2% janë inicuar më kërkesën e përbashkët të

trashëgimtarëve F/M, si dhe vetëm 167 raste apo 0.88% janë inicuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata.

- Mos inicimi i procedurës trashëgimore sipas detyrës zyrtare nga gjykata, shkakton që palët gjegjësisht trashëgimtarët potencial të inicojnë procedurën trashëgimore shumë vite pas vdekjes së trashëgimlënësit. Kështu, nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore u vërtetua së vetëm për 1,735 raste apo 9.1% procedura është inicuar brenda vitit të të cilit ka vdekur trashëgimlënësi si dhe për 6,023 raste apo 31.8% procedura është inicuar brenda 10 viteve nga vdekja e trashëgimlënësit. Ndërsa,në të gjitha rastet e tjera, procedurat janë inicuar pasi kanë kaluar mbi 10 vite e më shumë, nga vdekja e trashëgimlënësit. Madje, ka raste në të cilat inicimi i procedurës është bërë edhe pasi kanë kaluar mbi 90 vite nga vdekja e trashëgimlënësit. Pra, inicimi më vonesë i procedurës trashëgimore shkakton që personat e vdekur të mbesin titulllarë të paluajtshmërive për përiudha të gjata kohore.
- Në lidhje më numrin e trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje, nuk ekziston ndonjë dallim i madh midis numrit të trashëgimtarëve femra dhe meshkuj. Kështu, në aktvdekjet e 18,891 rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, në gjykatat e përfshira në studim, kanë qenë të përfshirë gjithsej 61,911 trashëgimtarë prej tyre 32,843 (53%) meshkuj dhe 29,068 (47%) femra.Mirëpo,ekzistojnë dallime të rëndësishme sa i përkët numrit të trashëgimtarëve femra dhe meshkuj, të cilët e shfrytëzojnë të drejtën e trashëgimisë. Kështu, nga 29,843 trashëgimtarë femra sa kanë qenë të përfshira në aktvdekjet e rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, e kanë shfrytëzuar të drejtën trashëgimore 7,989 apo 27%, ndërsa, nga 32,843 meshkuj sa kanë qenë të përfshirë në aktvdekje, e kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimisë 21,812 apo 66.4%.
- Rastet më të shpeshta kur femrat e shfrytëzojnë të drejtën trashëgimore, janë rastet kur ato thirrën në trashëgimi në rolin e bashkëshortës së trashëgimlënësit. Kështu, nga 7,989 femra sa kanë trashëguar, 4,024 prej tyre apo 50.3%, kanë trashëguar në cilësinë e bashkëshortës së trashëgimlënësit, 2,879 apo 36%, kanë trashëguar në cilësinë apo rolin e vajzës së trashëgimlënësit, 546 apo 6.8%, kanë trashëguar në cilësinë e mbesës së trashëgimlënësit si dhe 540 kanë trashëguar në cilësi tjera si p.sh në cilësinë e stërmbesës, motrës, nënës etj. Ndërsa,rastet më të shpeshta kur femrat heqin dorë nga trashëgimia, janë rastet kur ato thirren në trashëgimi në cilësinë e vajzës së trashëgimlënësit.

- Në shumicën e rasteve, si trashëgimtarët femra ashtu edhe trashëgimtarët meshkuj, heqjen dorë nga trashëgimia, e bëjnë në favor të trashëgimtarëve meshkuj gjegjësisht vëllezërve. Kështu, nga 13,086 femra sa kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve tjerë, 9,909 kanë hequr dorë në favor të trashëgimtarëve meshkuj. Ndërsa, nga 6,222 meshkuj sa kanë hequr nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve tjerë, 3,135 kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarëve meshkuj.
- Një pjesë e madhe e femrave dhe meshkujve në Kosovë, përkatësisht nga rezultati i anketës (pyetësorit) del se 45% e femrave dhe 39% e meshkujve, nuk e dinë që sipas ligjit në Kosovë, femrat dhe meshkujt konsiderohen të barabartë në të drejtat pronësore-trashëgimore. Gjithashtu, një pjesë e madhe e femrave dhe meshkujve të anketuar gjegjësisht 72% e femrave dhe 67% e meshkujve besojnë së përkundër asaj që trashëgimia rregullohet më ligj, në praktikë veçanërisht kur bëhet fjalë për të drejtën e gruas në trashëgimi vazhdojn të zbatohen rregullat zakonore. Se a duhet të ruhet praktika e zbatimit të zakoneve në trashëgimi, 29% e femrave dhe 58% e meshkujve janë përgjigjur po. Pra, një pjesë e madhe e burrave ende konsiderojnë se është e drejtë të ruhet praktika e zbatimit të zakoneve dhe se motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve. Kështu, edhe në pyetjen se a pajtoheni se motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve, 52% e meshkujve dhe 44% e femrave janë shprehur po.
- Heqja dorë nga trashëgimia e trashëgimtarëve femra, në shumicën e rasteve nuk përfaqëson vullnetin e tyre të lirë, por heqja dorë nga trashëgimia e trashëgimtarëve femra është më tepër një çështje që ndërlidhet më traditat dhe zakonet e vendit. Kështu, nga rezultati i anketës del se 78% e femrave dhe 74.5% e meshkujve konsiderojnë se zakonet janë faktori kryesor pse femrat në Kosovë nuk e kërkojnë pjesën e trashëgimisë.
- Një pjesë e madhe e pjesëmarrësve në anketë gjegjësisht 69% e femrave dhe 67% e meshkujve kanë deklaruar që kanë pasur rast në familjen e tyre apo që dinë për ndonjë rast tjetër jashtë familjes, ku femrës nuk iu është njohur fare e drejta në trashëgimi familjare. Shumë prej të anketuarve femra janë shprehur se edhe vet atyre nuk u është njohur e drejta në trashëgimi në familjen e babait. Ndërsa, në pyetjen poqëse do ju mohohej e drejta e trashëgimisë në pronën familjare nga anëtarët meshkuj të familjes respektivisht nga vëllezërit si do vepronit, vetëm 15% e femrave janë përgjigjur që do iniconin padi në Gjykatë.

- Pavarësisht se më ligj përparësi i jepet trashëgimisë testamentare në raport më trashëgiminë ligjore, në praktikë në shumicën e rasteve trashëgimia ndahet në mungesë të testamentit. Kështu, nga analizimi i 18,891 rasteve trashëgimore të viteve 2003-2014, vetëm për 62 raste apo 0.32% u vërtetua se trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit, ndërsa në të gjitha rastet e tjera (18,829 apo 99.6%) trashëgimia është ndarë në bazë të ligjit. Edhe në anketë një numër shumë i vogël i të anketuarve, kanë deklaruar që kanë të hartuar testament përkatësisht nga 395 femra të anketuara vetëm 4 apo 1% kanë deklaruar që kanë të hartuar testament, ndërsa nga 397 meshkuj të anketuar vetëm 7 apo 1.76% kanë deklaruar që kanë të hartuar testament. Pra, nga gjithsej 792 individë të anketuar vetëm 11 apo 1.38% kanë deklaruar që kanë të hartuar testament.
- Testamenti gjyqësor paraqet formën më të aplikuar të testamentit në praktikë. Kështu, prej gjithsej 62 rasteve për të cilat trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit: për 35 raste apo 56% trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit gjyqësor; për 17 raste apo 27.4% trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit në praninë e dëshmitarëve; për 9 raste apo 14.5% trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit ollograf apo të shkruar nga vetë testatori si dhe për 1 rast apo 1.6% trashëgimia është ndarë në bazë të testamentit gojor. Ndërsa, forma më e kundërshtuar e testamentit rezulton të jetë forma e testamentit ollograf apo të shkruar nga vetë testatori. Kështu, nga gjithsej 11 raste për të cilat është ndërprerë procedura për shkak së trashëgimtarët e kanë kundërshtuar vlefshmërinë e testamentit, në 6 raste (apo 54.4%) është kundërshtuar forma e testamentit ollograf; -në 3 raste (apo 27.2%) është kundërshtuar forma e testamentit alograf; si dhe në 2 raste (apo 18.1%) është kundërshtuar forma e testamentit gjyqësor.
- Mungesa e testamenteve ndikon në numrin e vogël të femrave që trashëgojnë dhe krijon më shumë mundësinë që femrat të heqin dorë nga trashëgimia. Gjatë hulumtimit në gjykatat në të cilat i kemi nxjerr të dhënat, kemi vërejtur se në rastet kur femrave më testament, u ndahet trashëgimia ato rrallë herë ndodhë të heqin dorë nga trashëgimia. Se numri i femrave të cilat heqin dorë nga trashëgimia, dukshëm do ishtë më i vogël nëse do aplikohej testamenti e tregojnë edhe rezultatet e anketës gjegjësisht pyetësorit. Kështu, në pyetjen në rast së paraardhësi i juaj më testament do t'iu ndante në mënyrë të barabartë pronën familjare më trashëgimtarët meshkuj të familjes, a do ta pranonit trashëgiminë, 63% e femrave të anketuara janë përgjigjur po. Ndërsa, në pyetjen duke e ditur që edhe

sipas ligjit iu takon e drejta në trashëgimi njëjtë si meshkujve, a do kërkonit ju që trashëgimia të ju ndahet në mënyrë të barabartë më meshkujt e familjes, vetëm 27% e femrave janë përgjigjur po. Gjithashtu, edhe një pjesë e madhe e të anketuave meshkuj gjegjësisht 48% janë shprehur se poqëse paraardhësi i tyre më testament do t'iu ndante në mënyrë të barabartë pronën familjare më motrat, do e pranonin testamentin. Ndërsa, në pyetjen poqëse pas vdekjes së prindërve motra/rat do kërkonin hise në pronën e babait si do vepronit, vetëm 37% e burrave të anketuar janë përgjigjur që do i përkrahnin motrat në realizimin e të drejtës së tyre.

Rekomandimet

- Rekomandohet që të ndryshohet LTK dhe LPJK, në mënyrë që të përcaktohet qartë roli i gjykatës dhe notëreve në çështjet e trashëgimit, përkatësisht rekomandohet që shqyrtimi i rasteve të trashëgimisë të bëhet nga noterët, por si të autorizuar nga gjykata.
- Rekomandohet që organi komunal i gjendjes civile të zbatojë detyrimin ligjor që në afatin brenda 15 ditësh nga regjistrimi i vdekjes të dërgojë aktvdekjen në gjykatën trashëgimore dhe gjykata zyrtarisht të inicojë procedurën trashëgimore.
- Rekomandohet që të ndryshohet neni 130.3 i LTK, i cili thotë: "Nëse pasardhësit janë të mitur, për këtë heqje dorë nuk kërkohet leja e organit të kujdestarisë" të parashikohet që gjykata ta kërkojë domosdo pëlqimin e organit të kujdestarisë, sa herë që trashëgimtarët heqin dorë nga e drejta e trashëgimit edhe në emër të fëmijëve të mitur.
- Rekomandohet që të ndryshohet neni 70 par.1 dhe 2 i LTK, i cili thotë: "Testament mund të bëjë çdo person që ka zotësi për të vepruar dhe i cili i ka mbushur 18 vjet. Testament mund të bëjë edhe personi që ka zotësi për të vepruar e i ka mbushur 16 vjet dhe është i martuar" të parashikohet që e drejta për të bërë testament ti njihet edhe personit mbi moshën 15 vjeç për pasurinë që e ka fituar më punën e vet të pavarur.
- Rekomandohet që të ndryshohet neni 80 i LTK, i cili thotë: "Testatori mund të deklarojë vullnetin e tij të fundit me gojë para dy dëshmitarëve, vetëm në qoftë se për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme nuk është në gjendje të bëjë testamentin me shkrim" të përcaktohen disa kritere që duhet të merren parasysh për të vlerësuar një situatë të caktuar si të jashtëzakonshme.

- Rekomandohet që të ndryshohet neni 130 par.1 i LTK, i cili thotë: “Trashëgimtari mund të heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë gjykatës gjersa të përfundojë seanca mbi trashëgimin” të përcaktohet afati për heqjen dorë nga trashëgimia dhe gjithashtu të përcaktohet që trashëgimtarët deklaratën për heqje dorë nga trashëgimia duhet ta japin personalisht në një seancë të veçantë gjyqësore, qoftë para gjykatësit apo noterit.
- Rekomandohet që të hiqet neni 133 par.2 i LTK, i cili thotë: “Heqja dorë në dobi të trashëgimtarit të caktuar nuk konsiderohet si heqje dorë nga trashëgimi, por si deklaratë për cedimin e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari i caktuar”, duke pasur parasysh faktin se në shumicën e rasteve, trashëgimtarët e sidomos trashëgimtarët femra heqjen dorë nga trashëgimia e bëjnë në favor të vëllezërve, rekomandohet që më rastin e heqjes dorë nga trashëgimia, trashëgimtarëve mos tu lejohet që pjesën e tyre trashëgimore ta cedojnë në favor të trashëgimtarëve tjerë ligjorë.
- Rekomandohet që të ndryshohet neni 30 par.1 dhe 2 i LTK, i cili thotë: “Trashëgimtarë të domosdoshëm janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij. Gjyshërit e trashëgimlënësit, motrat dhe vëllezërit e trashëgimlënësit janë trashëgimtarë të domosdoshëm vetëm në qoftë se janë plotësisht të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete për jetesë”, parë në konteksin e të drejtës krahasuese dhe në mënyrë që edhe legjislacioni ynë të jetë në qasje më legjislacionet e shteteve të UE-së, duhet që të kufizohet rrethi i trashëgimtarëve të domosdoshëm.
- Duke pasur parasysh problemet e paraqitura në praktikë, rekomandohet që të parashikohen më ligj, masa procedurale mbrojtëse për rastet e përjashtimeve nga trashëgimia si: krijimi i një certifikate familjare përmes të cilës gjykatat dhe noterët do të mund të verifikonin identitenin e anëtarëve të familjes së trashëgimlënësit; detyrimi i trashëgimtarëve që me rastin e inicimit të procedurës trashëgimore para gjykatësit apo noterit, të betohen, nën kërcënimin e dënimit se nuk janë duke e fshehur ndonjë trashëgimtarë të njohur ligjorë; publikimi në internet i njoftimit për fillimin dhe mbarimin e procedurës trashëgimore.
- Rekomandohet që të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve nëpërmjet zhvillimit të fushatave publike për rëndësinë e ndjekjes së procesit të trashëgimisë dhe bartjes se pronës në mënyrë formale pas vdekjes së pronarit.

- Rekomandohet që shoqëria civile në bashkëpunim më mekanizmat institucional të kontribuojnë më shumë në ngritjen e vetëdijes së femrave lidhur me të drejtat që i përkasin në bazë të LTK, më qëllim të tejkalimit të ndikimit të fuqishëm të zakoneve dhe traditave.

Bibliografia

A. Literaturë shkencore

- A.Billali & B.Bahtiri (2015) E Drejta Romake.Prishtinë.
- A.Aliu (2014). E Drejta Sendore.Prishtinë.
- A.Aliu (2013) E Drejta Civile. Prishtinë.
- A.Bilalli & H.Kuçi (2012) E Drejta Ndërkombëtare Private.Prishtinë.
- A.Aliu & H.Gashi (2007) E Drejta Familjare, Prishtinë.
- A. Borkowski's & P.D Plessis (2015) Roman Law.Fifth Edition, Oxford University Press.
- A.Borkowski & P.D Plessis (2014) E Drejta Romake. Tiranë.
- A.Hakani (2010) Trashëgimia Testamentare, Legjislacioni dhe Praktika Gjyqësore. Tiranë.
- A.Nuni & L. Hazneziri (2010) E Drejta Civile (Trashëgimia).Tiranë.
- A.Mandro (2009) E Drejta Familjare.Tiranë.
- A.Nuni & L. Hasneziri (2007) Leksione të së Drejtës së Trashëgimisë. Tiranë.
- A.Mandro (2006). E Drejta Romake, Tiranë.
- A.Gams (1986) Hyrje në të Drejtën Civile, Universiteti i Kosovës në Prishtinë. Prishtinë
- A.Jashari & E.Osmanaj (2016). Type of Testaments in Albania and France, Europian Journal of Humanities and Social Sciences No2, *East West, Association for Advanced Studies and Higher Education GmbH*, Vienna.

- A.Jashari & E.Osmanaj (2016). Initiation of inheritance procedure according to positive legislation in Kosovo and problems in practice. International Journals of Multidisciplinary Research Academy (IJMRA). ISSN 2249-2496.Volume 6, Issue 8 (August 2016). Page 94-117

- A.Vajs & L.Kandiq (1984) Historia e Përgjithshme e Shtetit dhe e së Drejtës. Botimi i Tretë. Universiteti i Kosovës në Prishtinë.

- A.Sallabanda, (1956) Disa çështje mbi trashëgiminë, Drejtësia Popullore, viti 1956, Nr.3.

- A.Lamani, (1955). Rreth trashëgimtarëve ligjorë dhe trashëgimtarëve më testament, Drejtësia Popullore, viti 1955, Nr.4.

- A.Nathanali & N.Papuli (1961) Disa çështje mbi pronësinë dhe trashëgiminë.Tiranë.

- Aspekte të trashëgimisë ligjore sipas legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar. Distertacion për mbrojtjen e gradës shkencore "Doktor". Kandidati: Nertila Sulçe, udheheqësi shkencor: Eneida Sema (Dervishi).Universiteti i Tiranës.Fakulteti i Drejtësisë. Tiranë.2017.

- Владимир Козар & Ирена Радумило (2015) НАСЛЕДНОПРАВНИ ПОЛОЖАЈ ЖЕНЕ СУПРУЖНИКА У СРБИЈИ ОД СРПСКОГ ГРАЂАНСКОГ ЗАКОНИКА ДО ДАНАС, Монографска студија, УДК 316.811/.815:347.65/.58 Култура полиса, год. XII (2015), бр. 27, стр. 367-380.

- С.Сворцан (2016). НАСЛЕДНА ПРАВА ВАНБРАЧНОГ ПАРТНЕРА, UDK: 347.627.42:347.66 ОКРУГЛИ СТО ДВАДЕСЕТ ГОДИНА ЗАКОНА О НАСЛЕЂИВАЊУ Правни факултет Универзитета у Нишу, 23. септембар 2016.

- C.Anderson (2009) Roman Law.Dundee University Press.

- D.KLASIČEK, Zakonsko nasljeđivanje istospolnih partnera u Republici Hrvatskoj u Postojećem Zakonoskom Orkviru Zb. Prav. fak. Sveuč. Rij. (1991) v. 34, br. 2, 963-989 (2013).

- E. Olldashi (2015). E Drejta Romake. Botimi i Dytë. Tiranë.

- E.Osmanaj (2017) Regulation of testament presence of witnesses and noterial testament according to the law of Kosovo comparing whith the law of EU countries.International Journal of Scientific & Engineering Research.Volume 8 Issue 1, January-2017.Issn 2229-5518

- E.Tawil (2009).Të drejtat pronësore të grave në Kosovë: Një trashëgimi e vështirë e shoqërisë në tranzicion.Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale.Prishtinë.

- Emilija Stanković (2014) "The Serbian Civil Code-The Fourth Codification in Europe" Fundamina 20 (2) 2014 ISSN: Print 1021-545X, Unisa Press.

- Edith Palmer (2014): Inheritance Laws in the Nineteenth and Twentieth Centuries Germany. The Law Library of Congress.

- E. Statovci (2009) Marrëdhëniet pronësore juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës. Prishtinë.

- E. Statovci (2009) Të Drejtat, Liritë e Njeriut dhe Skllavërimi, Prishtinë.

- E. Statovci. (1976) Ca çështje mbi burimet e së drejtës civile dhe mbi rregullimin e disa marrëdhënieve civile-juridike në KSA të Kosovës, Revista Përparimi, Nr.3/1976, Prishtinë.

- Edition du Juris-Classeur. Legislation Compare. France 1995.

- F. Brestovci (2006). E Drejta Procedurale Civile II. Prishtinë.

- Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, botim i Akademisë së Skencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë 1980.

- G. Mousourakis (2015).Roman Law and the Origins of the Civil Law Tradition. Springer International Publishing Switzerland.

- Grup autorësh (2001) Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, Shtëpia Botuese "Luarasi". Tiranë.

- Gavella, V. Belaj, Nasljedno pravo [Inheritance Law], 3.edition, Zagreb, Narodne novine, 2008.

- George A. Pelletier Jr. & Michael Roy Sonnenreich. A Comparative Analysis of Civil Law Succession, 11 Vill. L. Rev. 323 (1966).

- Gibb-Bowen- Islamic Society and the West, vol. I, part.1-2, London 1974.

- Новак М.Крстић (2015). ПОВРЕДА И ЗАШТИТА ПРАВА НА НУЖНИ ДЕО (докторска дисертација) УНИВЕРЗИТЕТ У НИШУ ПРАВНИ ФАКУЛТЕТ.

- H.Podvorica (2011) Legal Inheritance in the Republic of Kosovo. Iliria International Review – 2011/1.

- H.Podvorica (2010) E Drejta Trashëgimore, Prishtinë.

- H. Ismaili & F. Sejdiu (2000) Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës. Prishtinë.

- Новак Крстић. КОНЦЕПТУАЛНА МИМОИЛАЖЕЊА У РЕГУЛИСАЊУ НУЖНОГ НАСЛЕЂИВАЊА У РЕПУБЛИЦИ СРБИЈИ И РЕПУБЛИЦИ СРПСКОЈ, UDK: 347.65/.68 (497.11+497.6). ЗБОРНИК РАДОВА ПРАВНОГ ФАКУЛТЕТА, БР. LIX.

- I.Elezi (2006). Kanuni i Laberisë. Tiranë.

- I.Puhan (1980) E Drejta Romake, Universiteti i Prishtinës, Botimi i Pestë.

- Љ.Јанић, (2016). ПРАВО ЗАКОНСКОГ НАСЛЕЂИВАЊА СУПРУЖНИКА, ВАНБРАЧНИХ ПАРТНЕРА И ПАРТНЕРА ИЗ ИСТОПОЛНИХ ЗАЈЕДНИЦА У СРПСКОМ ПРАВУ DE LEGE LATA И DE LEGE FERENDA, UDK: 347.628:347.66.

- Ј. Видић Трнинић (2014) ВАНБРАЧНИ ПАРТНЕР КАО ЗАКОНСКИ НАСЛЕДНИК У САВРЕМЕНИМ ПРАВИМА ЕВРОПЕ, Зборник радова Правног факултета у Нишу | Број 68 | Година LIII | 2014.

- J.Latifi & R.Ruçi. Llojshmëria e testamenteve në legjislacionet botërore, Revista “Avokatia”12, Nëntor 2014.

- Јелена Видић Трнинић (2013) ОДСТУПАЊА ОД РЕДОВНИХ ПРАВИЛА ЗАКОНСКОГ НАСЛЕЂИВАЊА НА ПРОСТОРУ БИВШЕ СФРЈ (Србија, Словенија, Македонија, Црна Гора, Република Српска) Оригинални научни рад

347.65(497.1) doi: 10.5937/zrpfns 47-4477. Зборник радова Правног факултета у Новом Саду, 2/2013.

- Jens M. Scherpe (2013). The Legal Recognition of Same-Sex Couples in Europe and the Role of the European Court of Human Rights. The Equal Rights Review, Vol. Ten (2013).

- L.Garb & J.Wood (2010) International Succession, Third Edition, Oxford University Press

- J.Latifi (2009) E Drejta Civile (Pjesa e Përgjithshme). Tiranë.

- J.Latifi (2006) E Drejta e Trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë.

- John L. Esposito & Natana J. DeLong-Bas (2001) "Women in Muslim Family Law" Syracuse University Press.

- J. Gardner (1991) Women in Roman Law & Society, Indiana University Press

- Jamal J. Nasir (1990) "The Islamic Law of Personal Status" Second Edition Graham Trotman. London/Dordrecht/Boston.

- Joseph Dainow, Forced Heirship in French Law, 2 La. L. Rev. (1940).

- J.Đorđević Crnobrnja, Legal Inheritance in the Domain of Ideal and Real. UDC: 347.65:39(497.11)"19" 392.37(497.11)"19. Bulletin of the Institute of Ethnography SASA LVI I (2).

- Kenneth G.C.Reid & Marius Johannes De Waal & Reinhard Zimmermann (2015). Comparative Succession Law- Intestate Succession. Oxford-University Press.

- Koci, Padenjësia në të drejtën e trashëgimisë, Drejtësia Poppulore, viti 1973 Nr.6.

- L.Vorpsi (2015) Trashëgimia në të Drejtën Ndërkombëtare Private *(Distertacion për mbrojtjen e gradës shkencore "*Doktor", Universieteti i Tiranës, Depertamenti i të Drejtës Civile) Tiranë.

- М. Ковачевић (2016). НЕДОСТОЈНОСТ ЗА НАСЛЕЂИВАЊЕ. UDK: 347.66. ЗБОРНИК РАДОВА ДВАДЕСЕТ ГОДИНА ЗАКОНА О НАСЛЕЂИВАЊУ РЕПУБЛИКЕ СРБИЈЕ. УНИВЕРЗИТЕТ У НИШУ ПРАВНИ ФАКУЛТЕТ.

- M.Forest (2015) Europeanizing and Nationalizing the Regulation of Same-Sex Couples in Central and Eastern Europe,4th ECPG Conference, Uppsala, Sweden, June 10-13th, 2015.

- Milena Pojac (2014) "Gaius, Hadzic and Occupatio of Wild Animals-Classical Roman Law in the Serbian Civil Code", Fundamina 20 (2) 2014 ISSN: Print 1021-545X, Unisa Press.

- M.Vërbani (2013) E Drejta Trashëgimore në Islam. Kaçanik.

- Mónika Csöndes & Dubravka Klasiček: The legal nature of the forced share of inheritance under the Croatian and Hungarian law.working paper, SUNICOP 11/2012.

- M.Anderson & E. Arroyo i Amayuelas (2011). The Law of Succession: Testamentary Freedom: European Perspectives. European Studies in Private Law (5). Europa Law Publishing.

- M. Fromont (2009). Sistemet e huaja më të mëdha të të drejtës, Papirus.

- M.Dragovaja (1996) Studim Krahasues i Kanunit të Shqipërisë dhe Dagestanit. Tiranë.

- Marković, dr, Slavko, Nasledno parvo, Novinska izdavaćka ustanova Službeni list SFRJ, OOUR "Knjige" Beograd 1981.

- Novak M. Krstić (2015) Violation and Legal Protection of the Right to Compulsory Portion, Doctoral Dissertation, University of Niš, Fakulty of Law.

- И.Евтимов (2016). МОГУЋНОСТ НУЖНИХ НАСЛЕДНИКА ДА ЗАХТЕВАЈУ ПРЕОБРАЖАЈ ЗАКОНСКЕ ПРЕТПОСТАВКЕ ОБЛИГАЦИОНОПРАВНЕ ПРИРОДЕ ПРАВА НА НУЖНИ ДЕО. UDK: 347.65. Двадесет година Закона о наслеђивању Републике Србије.

- Nicolas Boring (2014): Inheritance Laws in the Nineteenth and Twentieth Centuries France.The Law Library of Congress.

- N.Stojanović (2013). Efectuation and Protection of the Rights to a Forced Portion in Contemporary Serbian Law. Iustinianus Primus Law Review Vol. 4:2.

- N.Dauti (2012) Kontratat.Prishtinë.

- N. Biçoku (2011) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë.

- N. Biçoku (1997) E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë. Tiranë.

- ОКРУГЛИ СТО ДВАДЕСЕТ ГОДИНА ЗАКОНА О НАСЛЕЂИВАЊУ Правни факултет Универзитета у Нишу, 23.септембар 2016.

- О.Јовић-Прлаиновић. (2016). БРАК И СРОДСТВО У ДОМЕНУ ЗАКОНСКОГ НАСЛЕЂИВАЊА, UDK: 347.626:347.66. ОКРУГЛИ СТО ДВАДЕСЕТ ГОДИНА ЗАКОНА О НАСЛЕЂИВАЊУ Правни факултет Универзитета у Нишу, 23.септембар 2016.

- O.Tmava (2006). Dëshmitarët e Testamentit. Buletini i Instituit Gjyqësor të Kosovës (IGJK).

- Obradović Milanović. Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1919-1941) Prishtinë, 1981.

- Prof.dr.Sima Avramovic (2014). *Serbian Law Between Roman-Byzantine and Austrian Tradition*s, Journal of International Philosophy.

- Prof.dr Siniša Ognjanović & Darko S. Ognjanović (2011) "*Creation of the New Serbian Civil Code"* 2nd International Conference "Law, Economy and Management in Modern Ambience" Lemima 2011 Proceedings Vol.2 Belgrade, Serbia.

- Patterson, Nicholas J. (2001) "The Repercussions in the European Union of the Netherlands' Same-Sex Marriage Law," Chicago Journal of International Law: Vol. 2: No. 1, Article 23.

- P.Klarić, M. Vedriš, Građansko parvo [Civil Law], 9.edition, Narodne novine, Zagreb, 2006.

- R.Tonchovska & K.Kelm & R.Giovarelli (2014) "Ict in support of evidence based policy making: Land and gender in the western ballkans. Annual World Bank Conference on Land and Poverty Washington DC. 14-27 March, 2014.

- Rudolf Sohm (1892) The Institutes of Roman law. Oxford.

- S.F.Joireman.(2015)."Resigning Their Rights? Impediments to Women's Property Ownership in Kosovo".Political Science Faculty Publications. Paper 44.

- S.Omari (2012) E Drejta Familjare, Tiranë.

- Shtjefën Gjeçov O.F.M (1999) Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shtepia Botuese "Kuvendi" Tiranë.

- T.Beka (2013) Vështrim i përgjithshëm i kontratës mbi mbajtjen e përjetshme.Reviste Shkencore Juridica Viti II nr 2/2012 – 3/2013.Prishtinë.

- William L. Burdick (2004). The Principles of Roman Law and Their relation to Modern Law. The law book exchange, LTD. Clark New Jersey.

- William Tetley, Mixed Jurisdictions: Common Law v. Civil Law (Codified and Uncodified), 60 La. L. Rev. (2000).

- Zojzi R. Aspekte të Kanunit të Skenderbeut studime historike Nr.4 Tiranë.1967.

B. Legjislacion

Kushtetuta

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës. (Numri i aktit: K-09042008, Kuvendi i Republikës së Kosovës, data e publikimit 09.04.2008).

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Miratuar në vitin 1998 dhe ndryshuar më ligjet nr.9675/2007; nr.9904/2008; nr.88/2012 dhe nr.137/2015/RSH. Kuvendi- Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare, 2016).

- Constitution of Bosnia and Herzegovina. (Official Gazette of BiH. 1995 amended 2009).

- Constitution of the Republic of Croatia. (as published in the official journal of the Republic of Croatia, Narodne novine, no. 56/90, 135/97, 8/98 -consolidated text, 113/2000, 124/2000-consolidated text, 28/2001, 41/2001-consolidated text, 55/2001-correction) and the Amendments to the Constitution of the Republic of Croatia published in Narodne novine, no. 76/2010, in which the date of their entry into force is indicated).

- Constitution of the Republic of Montenegro. (Official Gazette of Montenegro 01/07 of 25 October 2007).

- Constitution of the Republic of Macedonia. (adopted on November 17, 1991, published in the Official Gazette of the Republic of Macedonia No.52/1991, with the Amendments to the Constitution from I to XXX which were published in the Official Gazette of the Republic of Macedonia, as follows: - Amendments I and II, No.1/1992; - Amendment III, No.31/1998; - Amendments from IV to XVIII, No.91/2001; - Amendment XIX, No.84/2003; - Amendments from XX to XXX, No.107/2005).

- Constitution of the Republic of Slovenia. (Official Gazette RS, Nos. 33/91-I, 42/97, 66/2000 24/03, 69/04, 68/06 and 47/13) Ustava Republike Slovenije (Uradni list RS, št. 33/91-I, 42/97, 66/2000, 24/03, 69/04, 68/06 and 47/13).

- Constitution of the Republic of Serbia. (Official Gazette of the Republic Serbia No.98/2006).

Konventa

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (miratuar më dt.1950)

- Deklarata Universale e OKB-së për të Drejtat e Njeriut (miratuar më dt.10 dhjetor 1948)

- Konventa për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (miratuar nga asambleja e përgjithshme më rezoluten e saj 34/180 dt.18 dhjetor 1979 hyrë në fuqi më dt.3 shtator 1981).

- Konventa Evropiane për statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martesë. (Strasburg 1975).

- Convention providing a uniform law on the form of an international will done at Washington D.C. on 26 October 1973

Kode

- Kodi Civil Shqiptar (Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013).

- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë (Miratuar më ligjin nr 8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar më ligjet nr. 8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë 27.5. 1999; nr. 8335, datë 18.10. 1999; nr. 8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008).

- Ligj Nr. 9062 datë 8.5.2003 Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë.

- The Civil Code of German (Federal Law Gazette [Bundesgesetzblatt] I page 42, 2909; 2003 I page 738), last amented by Article 4 par. 5 of the Act of the 1 October 2013 (Federal Law Gazette I page 3719).

- The Civil Code of Czech Republic. (Law.No. 89/2012. (Zákon č. 89/2012 Sb. občanský zákoník České Republiky).

- Code of Inheritance in Finland. (No.40/1965; amendments up to 1228/2001 included).

- The Civil Code of the Republic of Lithuania, of July 18, 2000, Law No. VIII-1864 (Last amended on April 12, 2011, No XI-1312)

- The Civil Code of Hungary. (Law, Act V of 2013).

- The Civil Code of Belgium. (Code Civil de la Belgique, 21 mars 1804 à jour au 14-06-2013).

- The Civil Code of Spain.(approved by Royal Decree of July 24, 1889, and amended up to Law No.20/2011 Of July 21,2011, Law No.42/2015 of October 5,2015).

- The Civil Code of Slovakia (Občanský zákoník - zákon č. 40/1964 Sb., Občanský zákoník 2012 v aktuálním znění k 1.1.2012.).

- The Civil Code of France.(approved in 1804 and last modified on 1 November 2017).

- The Civil Code of Austrian (Allgemeines Bürgerliches Gesetzbuch, Patent vom 1ten Junius 1811, JGS Nr. 946/1811 idF BGBl I 58/2004, 77/2004, 43/2005, 51/2005, 113/06).

- The Civil Code of Netherlands (Dutch Civil Code). 1992.

- The Civil Code of Italy (approved by Royal Decree No. 262 of March 16, 1942).

- Swedish Code of Inheritance (in Swedish: Ärvdabalken (1958:637).

- Act of 23 April 1964 Civil Code Poland.

- The Civil Code of Portugal (approved by Decree-Law No. 47344/66 of November 25, 1966, and amended up to Law No. 150/2015 of September 10, 2015).

- The Civil Code of Latvia (adopted on 24 April 1997).

- The Civil Code of Malta (approved in 1868).

- The Civil Code of Luxembourg (Code Civil Luxembourg, Décrété le 5 mars 1803. Promulguée le 15 du même mois.Version consolidée au 1 avril 2017).

- Greek Civil Code (approved in 1983).

- Kodi Civil i Mbretërisë së Shqiprisë i vitit 1928, hyrë ne fuqi më dekret ligjin e datës 01.04.1929.

- Ligj Nr.6340, datë 26.6.1981, Kodi Civil i Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë.

Ligje

- Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgimi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.03/2006).

- Ligji Nr.03/L-010 për Noterinë i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III/ Nr.42/25 Nëntor 2008).

- Ligji Nr.2004/32 për Familje i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/Prishtinë: Viti I/Nr.4/01 Shtator 2006).

- Ligji Nr.03/L-007 për Procedurën Jokontestimore i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.45/12 Janar 2009).

- Ligji Nr 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore i Republikës së Kosovës. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/Nr.57/04 Guasht 2009).

- Ligji Nr 03/L-199 për Gjykatat i Republikës së Kosovës. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti V/Nr. 79/24 Gusht 2010).

- Ligji Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore i Republikës së Kosovës. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr.16/ 26 Qershor 2015, Prishtinë).

- Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.16/19 Qershor 2012, Prishtinë).

- Ligji Nr. Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr.16/ 26 Qershor 2015, Prishtinë).

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.04/L-082 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.19/13Korrik 2012, Prishtinë)

- Ligj Nr.7829, datë 1.6.1994 Për Noterinë i Republikës së Shqipërisë. (Ndryshuar për herë të fundit më ligjin nr. 131/2013, datë 29.4.2013).

- Inheritance Act of Slovenia. (Official Gazette, No. 15/76, 23/78, Official Gazette of RS, no. 13/94 - UN, 40/94 - odl. US, 117/00 - dec. US, 67/01 , 83/01 - OZ, 73/04 - UN-C 31/13 - dec. US and 63/16). Zakon o dedovanju Slovenije (Uradni list SRS, št. 15/76, 23/78, Uradni list RS, št. 13/94 – ZN, 40/94 – odl. US, 117/00 – odl. US, 67/01, 83/01 – OZ, 73/04 – ZN-C, 31/13 – odl. US in 63/16).

- Inheritance Act of Croatia. (Official Gazette of the Republic of Croatia 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15). Zakon o nasljeđivanju Hrvatske (pročišćeni tekst zakona NN 48/03, 163/03, 35/05, 127/13, 33/15 na snazi od 01.04.2015).

- Inheritance Act of Montenegro. (Official Gazette CG, No. 74/2008 and 5.12.2008). Zakon o nasljeđivanju (Zakon je objavljen u "Službenom listu CG", br. 74/2008 od 5.12.2008. godine).

- Inheritance Act of Serbia. ("Official Gazette of RS", No. 46/95, 101/2003 - USRS Decision 6/2015). Zakon o nasljeđivanju Serbia. ("Sl. glasnik RS", br. 46/95, 101/2003 - odluka USRS i 6/2015).

- Inheritance Act of Macedonia (Official Gazette of the Republic of Macedonia, No. 47/1997, 18/2001).

- Ligji për Trashëgiminë i Bosnjës dhe Hercegovinës (Gazeta Zyrtare e Bosnjes dhe Hercegovinës Nr 2/98, 39/04 i 73/05.

- Law on out contentious proceedings of the Republic of Serbia (Official Gazette of the Socialist Republic of Serbia No 25/82 and 48/88 and Official Gazette of the Republic of Serbia No 46/95 – other law, and 18/2005 – other law).

- Law on out contentious proceedings of the Republic of Montenegro. (The Law was published in the Official Gazette of Montenegro 27/2006 dated 27 April 2006).

- Law on out contentious proceedings of the Republic of Macedonia. (Official Gazette of the Republic of Macedonia, No 9/08).

- Family Law Act of the Republic of Croatia. (Official Gazette of the Republic of Croatia No.103.15). Obiteljski Zakon Hrvatske. (Sluzbeni list Republike Hrvatske. NN 103/15 - na snazi od 01.11.2015).

- Family Law of Federation of Bosnia and Herzegovina. (Official Gazette of FBiH no. 35/05, 41/05 and 31/14). Porodicni Zakon Federacije Bosnie i Hercegovine.(„Službene novine Federacije BiH“, br 35/05, 41/05 i 31/14).

- Family Law of the Republic of Serbia. (Official Gazette of the Republic of Serbia No. 18 as of 24 February 2005).

- Family Law of the Republic of Macedonia. (Official Gazette of the Republic of Macedonia No.1992/80).

- Family Law of the Republic of Montenegro. (“Official Gazette of the Republic of Montenegro” No.1/2007 dated 9.1.2007). Porodični zakon ("Službeni list Republike Crne Gore, broj 1/2007"od 9.1.2007. god.).

- The Law on Marriage and Family Relations of the Republic of Slovenia. (Official Gazette of the Republic of Slovenia, No. 69/04 - official consolidated text, 101/07 - Rev. US, 90/11 - Rev. US, 84/12- Rev. US, 82/15 - US Department of Defense and 15/17 - DZ). Zakon o zakonski zvezi in družinskih razmerjih (Uradni list RS, št. 69/04 – uradno prečiščeno besedilo, 101/07 – odl. US, 90/11 – odl. US, 84/12 –odl.US, 82/15 – odl. US in 15/17 – DZ).

- Law on Notarial of the Republic of Slovenia. (Official Gazette of the Republic of Slovenia, No. 2/07 -official consolidated text, 33/07 - ZSReg-B, 45/08 and 91/13). Zakon o notariatu (Uradni list RS, št. 2/07 – uradno prečiščeno besedilo, 33/07 – ZSReg-B, 45/08 in 91/13).

- Law on Public Notary of the Republic of Croatia. (Official Gazette of the Republic of Croatia No.78/93, 29/94, 162/98, 16/07, 75/09, 120/16). Zakon o javnom bilježništvu (pročišćeni tekst zakona NN 78/93, 29/94, 162/98, 16/07, 75/09, 120/16).

- Law on Notaries of the Republic of Montenegro. ("Official Gazette of the Republic of Montenegro, No. 68/2005"). Zakon o notarima ("Službeni list Republike Crne Gore, broj 68/2005" od 15.11.2005).

- Law on Public Notaries of the Republic of Serbia. ("Official Gazette of the Republic of Serbia". No. 31/2011, 85/2012, 19/2013, 55/2014, 121/2014, 6/2015, 106/2015). Zakon o Javnom Beležništvu ("Sl. glasnik RS", br. 31/2011, 85/2012, 19/2013, 55/2014-dr.zakon, 121/2014, 6/2015 i 106/2015).

- Law on notaries of the Federation of BiH (Official Gazette of FBiH no.45 dated 20 shtator 2002). Zakon o Notarima Federacije Bosne i Hercegovine. (Službene novine Federacije BiH, br. 45 od 20.septembra/rujna 2002. Godine).

- Law on Notary of the Republic of Macedonia (Official Gazette of the Republic of Macedonia, No. 55/2007 and 86/2008).

- Zakon o registraciji istospolne partnerske skupnosti (ZRIPS) uradini list, št. 65/2005 z dne 8.7.2005.

- Zakon o registraciji istospolne partnerske skupnosti (ZRIPS) uradini list, št. 55/2009 z dne17.7.2009 (https://www.uradni-list.si/glasilo-uradni-list-rs/vsebina/2009-01-2715?sop=2009-01-2715 dt.13.04.2017).

- Zakon o registraciji istospolne partnerske skupnosti (Uradni list RS, št. 65/05, 55/09 – odl. US, 18/16 – odl. US, 33/16 – ZPZ in 68/16 – ZPND-A).

- Zakon o istospolnim zajednicama (Narodne novine službene list republike hrvatske Broj: 01-081-03-2597/2 Zagreb,16. srp-nja 2003).

- Zakon o životnom partnerstvu osoba istog spola (Narodne novine službene list republike hrvatske Broj: 92/14).

- Inheritance law in Bulgaria. (Prom. SG. 22/29 Jan 1949, corr. SG. 41/21 Feb 1949, amend. SG. 275/22 Nov 1950, amend. SG. 41/28 May 1985, amend. SG. 60/24 Jul 1992, amend. SG. 21/12 Mar 1996, amend. SG. 104/6 Dec 1996, suppl. SG. 117/10 Dec 1997, suppl. SG. 96/5 Nov 1999, amend. SG. 34/25 Apr 2000, amend. SG. 59/20 Jul 2007, amend. SG. 47/23 Jun 2009).

- Danish Inheritance Act (arveloven) No.515 of 06.06.2007.

- Law of Succession Act in Estonia (Passed 17.01.2008 RT I 2008, 7, 52 Entry into force 01.01.2009).

- Succession Act Ireland (Number 27 of 1965).

- Wills and Succession in Cyprus.Cap.195. 1945.

- Dekreti nr.1892, datë 05.07.1954 “Mbi trashëgiminë”

C. Praktikë ligjore

Vendimet gjyqësore

- Vendimi: T.nr.273/06 datë 27.04.2006. Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T.nr. 17/08 datë 08.02.2008. Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 167/09 datë 22.10.2009. Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 150/09 datë 11.09.2009. Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.160/08 datë 01.07.2008. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr.94/05 datë 25.04.2005. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr.183/08 datë 21.08.2009. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr.118/06 datë 11.12.2007. Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.194/04 datë 05.10.2004. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr.91/04 datë 12.05.2004. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr.101/05 datë 08.08.2005. Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.Nr.05/05 datë 27.01.2005. Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.Nr.26/06 datë 05.02.2007. Gjykata Komunale në Pejë

- Vendimi: T.Nr.78/10 datë 17.06.2010. Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T.Nr.65/11 datë 23.02.2011. Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T.Nr.90/12 datë 26.07.2012. Gjykata Komunale në Mitrovicë
- Vendimi: T.Nr.153/09 datë 08.10.2009. Gjykata Komunale në Mitrovicë
- Vendimi: T.Nr.28/10 datë 18.06.2012. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.Nr.385/10 datë 24.02.2011. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.Nr.226/10 datë 19.04.2013. Gjykata Themelore në Pejë
- Vendimi: T.Nr.14/04 datë 10.02.2004. Gjykata Komunale në Gjilan
- Vendimi: T.nr. 306/04 datë 27.12.2004 Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: CT.Nr. 34/2014 datë 17.11.2014 Gjykata Themelore në Mitrovicë
- Vendimi: T. Nr. 73/07 Datë 01.12.2008 Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T. Nr. 266/04 Datë 26.06.2007 Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T. Nr. 266/04 Datë 10.07.2008 Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T. Nr. 26/1998 Datë 24.03.1998 Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T. Nr. 26/1998 Datë 13.07.2011 Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr. 126/07 datë 16.07.2007 Gjykata Komunale në Gjilan
- Vendimi: AC.nr. 300/07 datë 06.08.07 Gjykata e Qarkut në Gjilan

- Vendimi: T.nr.139/07 datë: 28.06.2007.Gjykata Komunale në Ferizaj
- Vendimi: Ac. Nr.111/2008 i dt.27.05.2010.Gjykata e Qarkut në Prishtinë
- Vendimi: T. nr. 218/03 dt.13.10.2003. Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T. nr. 58/07 dt.07.06.2007. Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T. nr. 457/07 dt.18.10.2007. Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T. nr. 456/08 dt.23.02.2010. Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T. nr. 456/10 dt.17.10.2010. Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T. nr. 582/10 dt.19.09.2011. Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T. nr.203/03 dt.11.09.2006. Gjykata Komunale në Prishtinë
- Vendimi: T.nr. 103/06 dt.12.09.2006. Gjykata Komunale në Gjilan
- Vendimi: T.nr. 103/06 dt.28.09.2007. Gjykata Komunale në Gjilan
- Vendimi: T.nr. 29/09 dt.26.02.2009. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr. 365/09 dt.27.01.2010. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr. 174/10 dt.25.05.2010. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr. 339/10 dt.13.07.2011. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr. 343/11 dt.02.02.2012. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr. 42/12 dt.11.09.2012. Gjykata Komunale në Prizren

- Vendimi: T.nr. 431/11 dt.09.07.2012. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr. 68/04 dt.22.06.2004. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr. 228/05 dt.15.07.2005. Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr. 211/07 dt.16.01.2008 Gjykata Komunale në Prizren
- Vendimi: T.nr.62/2010 dt.13.04.2010 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.83/2010 dt.10.11.2010 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 109/2010 dt.24.06.2010 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 177/2010 dt.20.07.2010 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 234/2010 dt.30.12.2010 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 105/2011 dt.26.05.2011 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 71/2011 dt.19.04.2011 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 10/2012 dt.15.03.2012 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 131/2012 dt.25.10.2012 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 56/2005 dt.10.11.2005 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 76/2005 dt.06.03.2006 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr. 72/2006 dt.11.05.2006 Gjykata Komunale në Pejë

- Vendimi: T.nr.150/2006 dt.20.09.2006 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.07/06 dt.23.01.2006 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.27/06 dt.01.03.2006 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.33/06 dt.10.03.2006 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.224/07 dt.22.11.2007 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.23/07 dt.07.02.2007 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.37/07 dt.02.03.2007 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.51/07 dt.10.05.2007 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.142/07 dt.03.08.2007 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.3/2013 dt.16.01.2013 Gjykata Themelore në Pejë
- Vendimi: T.nr.145/2006 dt.26.09.2006 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.25/2006 dt.16.03.2006 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.32/2006 dt.03.04.2007 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.40/2007 dt.13.03.2007 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.124/2008 dt.07.07.2008 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.146/2008 dt.14.05.2009 Gjykata Komunale në Pejë

- Vendimi: T.nr.33/2008 dt.03.03.2008 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.230/2009 dt.16.12.2009 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.230/2009 dt.16.12.2009 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.206/2009 dt.08.12.2009 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: T.nr.84/2003 dt.29.04.2003 Gjykata Komunale në Pejë
- Vendimi: Ac.nr.43/2010 dt.16.03.2010 Gjykata e Qarkut në Pejë

Testamente

- Testamenti gjyqësor nr. 836/04 të dt.16.12.2004. Gjykata Komunale në Pejë
- Testamenti gjyqësor nr. 908/85 dt.30.09.1985. Gjykata Komunale në Prizren
- Testamenti gjyqësor nr. 19/96 të dt.30.01.1996. Gjykata Komunale në Prizren
- Testamenti gjyqësor nr. 286/07 të dt.31.05.2007. Gjykata Komunale në Prizren
- Testamenti gjyqësor nr.13/2000 të dt.16.06.2000. Gjykata Komunale në Pejë
- Testamenti gjyqësor nr.13/2001 i dt.19.01.2001. Gjykata Komunale në Prizren
- Testamenti gjyqësor nr.539/93 i dt.31.08.1993 dhe nr.147/95 dt.25.12.1995. Gjykata Komunale në Prizren
- Testamenti gjyqësor nr. 636/83 të dt.28.07.1983. Gjykata Komunale në Pejë
- Testamenti gjyqësor Ndr.Nr. 26/97 të datë 24.02.1997 Gjykata Komunale në Prizren

- Testamenti gjyqësor nr.39/91 të dt.15.01.1991.Gjykata Komunale në Prizren

- Testamenti gjyqësor N.nr.125/98 i datës 03.12.1998.Gjykata Komunale në Gjilan

- Procesverbal mbi shpalljen e testamentit gojor.Ndr.nr.117/07 i datës 17.05.2007.Gjykata Komunale në Ferizaj

- Testamenti gjyqësor. Nr.257/91 të dt.14.05.1991. Gjykata Komunale në Pejë

- Testamenti gjyqësor. Nr.128/92 të dt.17.03.1992. Gjykata Komunale në Prishtinë

- Testamenti gjyqësor. Nr.184/89 të dt.04.08.1989. Gjykata Komunale në Gjilan.

- Testamenti gjyqësor. Nr.532/93 të dt.27.07.1993. Gjykata Komunale në Prizren

- Testamenti gjyqësor.Nr.571/94 të dt.22.07.1994. Gjykata Komunale në Prizren

- Testamenti gjyqësor. Nr.500/93 të dt.04.08.1993. Gjykata Komunale në Prizren

- Testamenti gjyqësor. Nr.40/97 të dt.28.04.1997. Gjykata Komunale në Prizren

- Testamenti gjyqësor. Nr.244/03 të dt.09.05.2003. Gjykata Komunale në Prizren

- Testamenti gjyqësor .Nr.126/02 të dt.25.04.2002. Gjykata Komunale në Prizren

- Testamenti gjyqësor. Nr.771/93 i dt.26.11.1993. Gjykata Komunale në Prizren

Kontratat për mbajtje të përjetshme

- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.103/06 dt. 31.12.1996.Gjykata Komunale në Pejë

- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.121/05 dt.15.03.2005.Gjykata Komunale në Pejë

- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.328/94 dt.07.09.1994.Gjykata Komunale në Pejë

- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.304/06 dt.13.11.2006.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.10/97 dt.19.02.1997.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr12/00 dt.15.08.2000.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.13/03 dt. 21.02.2003.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.776/04 dt.24.11.2004.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.210/09 dt.12.01.2010.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.152/01 dt.10.10.2001.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.06/98 dt.02.02.1998.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.107/01 dt.11.07.2001.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.62/97 dt.24.09.1997.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.42/95 dt.27.11.1995.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.916/82 dt.15.04.1982.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.57/96 dt.04.09.1996. Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.11/98 dt.13.02.1998.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.316/93 dt.21.06.1993.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.644/92 dt.25.12.1992.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.584/93 dt.17.12.1993.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.358/05 dt.01.07.2005.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.136/03 dt.31.03.2003.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.129/04 dt.01.06.2006.Gjykata Komunale në Pejë

- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.77/95 dt.03.11.1995.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.476/94 dt.19.06.1995.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.386/87 dt.14.05.1987.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.529/74 dt.25.12.1974.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.10/98 dt.06.02.1998.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.340/05 dt.20.06.2005.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.50/09 dt.22.04.2009.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.50/09 dt.22.04.2009.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme Nr.64/95 dt.25.08.1995.Gjykata Komunale në Pejë
- Kontrata për mbajtjen e përjetshme dt.23.09.1997.Gjykata Komunale në Pejë

Raporte

- Agjencia e Statistikave të Kosovës (prill 2013).Regjistrimi i Popullsisë Eknomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011 Rezultatet përfundimtare.Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe venbanimit.Prishtinë.

- Tetra Tech. Raporti i programit të USAID-it për të drejtat pronësore (PDP) "Informaliteti në sektorin e tokave: Çështja e trashëgimisë së vonuar në Kosovë".Prishtinë. Prill 2016.

- Tetra Tech. Raporti i programit të USAID-it për të drejtat pronësore (PDP).Analizat për zhvillimin e strategjisë kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë e hartuar nga Ministria e Drejtësisë. Korrik 2016.

- Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë.Publikuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.Ministria e Drejtësisë Prishtinë.Shtator 2016.

- Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë.Publikuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.Ministria e Drejtësisë Prishtinë. Dhjetor 2016.

- OSBE (2010) Çështjet lidhur më rolin e bashkëpuntorëve profesional dhe inicimin e procedurave në rastet e trashëgimisë.Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete.Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik.Edicioni 9. Prishtinë.

- Agjencia e Statistikave të Kosovës. Seria 4: Statistikat Sociale. Rezulatet e anketës së përdorimit të teknologjisë informative dhe komunikimit 2017. Prishtinë.

- Agjencia e Statistikave të Kosovës (shkurt 2013). Vlerësim,Popullsia e Kosovës 2011,Prishtinë.

SHTOJCA

Shtojca Nr/1 Formulari

1. **Nr. i Lëndës _____**

2. **Procedura trashëgimore është inicuar:**
   - **a.** Sipas detyrës zyrtare;
   - **b.** Më kerkesën e trashëgimtarit mashkull;
   - **c.** Më kerkesën e trashëgimtarit femër;
   - **d.** Bashkarisht më kërkesën e femrave dhe meshkujve.

   Data: _____

3. **Trashëgimlënësi ka vdekur në vitin:**
   - **a.** Ka lënë testament
   - **b.** Nuk ka lënë testament
   - **c.** Ka lënë kontratë për mbajtje të përjetshme.

4. **Nacionaliteti i trashëgimlënësit:**

   - **a.** Shqiptar
   - **b.** Serb
   - **c.** Boshnjak
   - **d.** Rome/Ashkali/Egjyptas/
   - **e.** Turq.

5. **Numri i trashëgimtarëve të përfshirë në aktvdekje dhe cilësia e tyre?**

   _____
   _____
   _____

6. **Aktvendimi. Dt:**

   _____
   _____

7. **Sa nga trashëgimtarët e përfshire në aktvdekje kanë trashëguar?**

   _____
   _____

8. **Nr.i trashëgimtarëve femra që kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimit ?**

_____
_____

9. **Nr. i trashëgimtarëve meshkuj që kanë shfrytëzuar të drejtën e trashëgimit?**

_____
_____

10. **Nr.i trashëgimtarëve femra që kanë hequr dorë nga trashëgimia dhe në favor të kujt?**

_____
_____

11. **Nr. i trashëgimtarëve meshkuj që kanë hequr dorë nga trashëgimia dhe në favor të kujt?**

_____
_____

12. **Ndonjë detaj tjetër:**

_____
_____
_____
_____.

Shtojca Nr/2 Pyetësoret

Pyetësori për të anketuarit meshkuj

Qëllimi i këtij hulumtimi është nxjerrja e rezultateve mbi qëndrimet e burrave dhe grave lidhur më të drejtën trashëgimore të gruas në përgjithësi dhe në veqanti identifikimi i faktorëve kryesor që ndikojnë në mospërfshirjen e grave në trashëgimi. Rezulatet e këtij hulumtimi do të përdoren për qëllime akademike. Dëshiroj t'ju falënderoj për bashkëpunimin dhe pa diskutim të marr përsipër ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave!

1. **Cila është mosha juaj?**

   - ☐ 18-30 vjeç
   - ☐ 31 – 40 vjeç
   - ☐ 41 – 50 vjeç
   - ☐ 51-60 vjeç
   - ☐ Mbi 60 vjeç.

2. **Vendbanimi juaj:**

   - ☐ Qytet
   - ☐ Fshat.

   Komuna _____.

3. **Shkalla e arsimimit:**

   - ☐ Fillor
   - ☐ I Mesëm
   - ☐ Universitarë
   - ☐ Pasuniversitarë.

4. **Sa jeni të informuar për mënyrën si bëhet ndarja e pasurisë trashëgimore sipas legjislacionit kosovar?**

   - ☐ I mirëinformuar
   - ☐ Mjaftueshëm
   - ☐ Pak
   - ☐ Aspak.

5. **Si mendoni sipas legjislacionit kosovar, a konsiderohen të barabartë femrat dhe meshkujt në të drejtat pronësore?**

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

6. **A mendoni se duhet të trashëgojnë në mënyrë plotësisht të barabart femrat dhe meshkujt?**

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

7. **Në emër të kujt është e regjistruar prona në familjen tuaj?**

- ☐ Në emër të anëtarit femër të familjes
- ☐ Në emër të anëtarit mashkull të familjes.
- ☐ Në emër të përbashkët F/M.

8. **A mendoni së përkundër asaj që trashëgimia rregullohet më ligj, në praktikë sidomos kur bëhet fjalë për të drejtën e gruas në trashëgimi vazhdojn të zbatohen rregullat zakonore?**

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di.

9. **Kush e ka rolin kryesor në ngritjen e vetëdijes në kontekstin e barazisë në mes femrave dhe meshkujve në trashëgimin e pronës familjare,vlerësoni nga 1 deri 5:**

1 Shumë e rëndësishme 2. E rëndësishme 3. Pak e rëndësishme 4. E parëndësishme 5- aspak e rëndësishme

Familja	1	2	3	4	5
Shkolla	1	2	3	4	5
Shoqëria	1	2	3	4	5
Mediat	1	2	3	4	5
Institucionet shtetërore	1	2	3	4	5
Tjetër specifiko					

10. **A keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast jashtë familjes ku femra ka trashëgu në mënyrë të barabart më meshkujt?**

- ☐ Po
- ☐ Jo

11. A keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast tjetër jashtë familjes që femrës nuk iu është njohur fare e drejta në trashëgimi familjare?

- ☐ Po
- ☐ Jo

12. A dini për ndonjë rast që femra është detyruar nga anëtarët e tjerë të familjes (zakonisht anëtare meshkuj të familjes) të heqë dorë nga trashëgimia?

- ☐ Po
- ☐ Jo

13. Ju lutem zgjidhni nivelin tuaj te pajtimit me secilin pohim të dhënë në tabelën e mëposhtme:

	Pajtohem	Plotësisht Pajtohem	Nuk Pajtohem	Aspak nuk pajtohem	Neutral
Pronën duhet ta trashëgojnë vetëm trashëgimtarët meshkuj të familjes;					
Motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve;					
Edhe në rastet kur nuk kanë vëllezër motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia;					
Bashkëshortja e trashëgimlënësit kur nuk ka fëmijë nuk mund të trashëgojë pasurinë, atë duhet ta trashëgojnë prindërit apo vëllezërit e trashëgimlënësit;					
Bashkëshortja e trashëgimlënësit edhe kur ka fëmijë duhet të heqë dorë nga trashëgimia në favor të fëmijve/djemve					
Edhe nëse më ligj femrës i garantohet e drejta në trashëgimi unë prapë do të vendosë të pasuria t'u takojë djemve të familjes;					

14. Në rastet kur femrës i mohohet e drejta në trashëgimi p.sh, nga vëllezërit, sipas mendimit tuaj a duhet ajo të inicojë padi?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

15. A dini për ndonjë rast që femra ka kërku më padi realizimin e të drejtës së trashëgimisë?

- ☐ Po
- ☐ Jo

16. Në rast së një femër do kërkonte realizimin e të drejtës së trashëgimisë më padi si mendoni sa do të haste ajo në përkrahje të :

	Pak	Shumë pak	Mjafueshëm	Aspak	Nuk e di
Familjes					
Rrethit/Shoqërisë					
Institucioneve të drejtësisë/Gjykatës					
Tjetër specifiko					

17. Pse femrat në Kosovë nuk e kërkojnë trashëgiminë vlerësoni nga 1 deri 5 faktorët të cilet ndikojnë në këtë aspekt:

1. Shumë e rëndësishme 2. E rëndësishme 3. Pak e rëndësishme 4. E parëndësishme 5- aspak e rëndësishme

Mentaliteti/zakonet	1	2	3	4	5
Niveli arsimor/Mosvetëdijësimi i duhur	1	2	3	4	5
Varësi e parashikuar tek prindërit pas martesës	1	2	3	4	5
Mosbezdisja e Prindërve/ Vëllezërve	1	2	3	4	5
Mosbesim në institucionet e drejtësisë	1	2	3	4	5
Tjetër specifiko					

18. Në rast së paradhësi i juaj më testament do t'iu ndante në mënyrë të barabart pronën familjare më trashëgimtarët e tjerë femra të familjes si do vepronit?

- ☐ Do e kundërshtoje testamentin (nuk do e pranoje);
- ☐ Do e pranoje si diqka shumë normale;
- ☐ Asnjëherë nuk e pranojë këtë fakt;
- ☐ Do kërkoje nga femrat/trashëgimtarë të heqin dorë nga trashëgimia;
- ☐ Nuk e di.

19. Në rast së pas vdekjes së prindërve, motra/rat do kërkonin hise në pronën e prindërve, si do vepronit?

- ☐ Do i përkrahje ato në realizimin e të drejtës së tyre;
- ☐ Nuk do i përkrahje ;
- ☐ Kurrsesi që nuk do i përkrahje;
- ☐ Neutral ;
- ☐ Nuk e di.

20. A keni të hartuar testament?

- ☐ Po
- ☐ Jo

21. Kujt mendoni ju t'ia bartin trashëgiminë?

- Vajzave;
- Djemve ;
- Vajzave/Djemve në mënyrë të barabart;
- Do t'ia ndajë edhe vajzave një pjesë, por gjithësesi që djemtë do i favorizoj;
- Vetëm në rast që nuk do kisha djalë do ja bartja trashëgiminë vajzave;
- Nuk e di.

Pyetësori për të anketuarit femra

Qëllimi i këtij hulumtimi është nxjerrja e rezultateve mbi qëndrimet e burrave dhe grave lidhur më të drejtën trashëgimore të gruas në përgjithësi dhe në veqanti identifikimi i faktorëve kryesor që ndikojnë në mospërfshirjen e grave në trashëgimi. Rezulatet e këtij hulumtimi do të përdoren për qëllime akademike. Dëshiroj t'ju falënderoj për bashkëpunimin dhe pa diskutim të marr përsipër ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave!

1. **Cila është mosha juaj?**

- ☐ 18-30 vjeç
- ☐ 31 – 40 vjeç
- ☐ 41 – 50 vjeç
- ☐ 51-60 vjeç
- ☐ Mbi 60 vjeç.

2. **Vendbanimi juaj:**

- ☐ Qytet
- ☐ Fshat.

Komuna _____.

3. **Shkalla e arsimimit:**

- ☐ Fillor
- ☐ I Mesëm
- ☐ Universitarë
- ☐ Pasuniversitarë.

4. **Sa jeni të informuar për mënyrën si bëhet ndarja e pasurisë trashëgimore sipas legjislacionit kosovar?**

- ☐ I mirëinformuar
- ☐ Mjaftueshëm
- ☐ Pak
- ☐ Aspak.

5. **Si mendoni sipas ligjislacionit kosovar, a konsiderohen të barabartë femrat dhe meshkujt në të drejtat pronësore?**

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

6. **A mendoni se duhet të trashëgojnë në mënyrë plotësisht të barabart femrat dhe meshkujt?**

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

7. **Në emër të kujt është e regjistruar prona në familjen tuaj?**

- ☐ Në emër të anëtarit femër të familjes
- ☐ Në emër të anëtarit mashkull të familjes.
- ☐ Në emër të përbashkët F/M.

8. **A mendoni së përkundër asaj që trashëgimia rregullohet më ligj, në praktikë sidomos kur bëhet fjalë për të drejtën e gruas në trashëgimi vazhdojn të zbatohen rregullat zakonore?**

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di.

9. **Kush e ka rolin kryesor në ngritjen e vetëdijes në kontekstin e barazisë në mes femrave dhe meshkujve në trashëgimin e pronës familjare,vlerësoni nga 1 deri 5:**

1 Shumë e rëndësishme 2. E rëndësishme 3. Pak e rëndësishme 4. E parëndësishme 5- aspak e rëndësishme

Familja	1	2	3	4	5
Shkolla	1	2	3	4	5
Shoqëria	1	2	3	4	5
Mediat	1	2	3	4	5
Institucionet shtetërore	1	2	3	4	5
Tjetër specifiko					

10. **A keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast jashtë familjes ku femra ka trashëgu në mënyrë të barabart më meshkujt?**

- ☐ Po
- ☐ Jo

11. A keni pasur rast në familjen tuaj apo dini për ndonjë rast tjetër jashtë familjes që femrës nuk iu është njohur fare e drejta në trashëgimi familjare?

- ☐ Po
- ☐ Jo

12. A dini për ndonjë rast që femra është detyruar nga anëtarët e tjerë të familjes (zakonisht anëtare meshkuj të familjes) të heqë dorë nga trashëgimia?

- ☐ Po
- ☐ Jo

13. Ju lutem zgjidhni nivelin tuaj te pajtimit me secilin pohim të dhënë në tabelën e mëposhtme:

	Pajtohem	Plotësisht Pajtohem	Nuk Pajtohem	Aspak nuk pajtohem	Neutral
Pronën duhet ta trashëgojnë vetëm trashëgimtarët meshkuj të familjes;					
Motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve;					
Edhe në rastet kur nuk kanë vëllezër motrat duhet të heqin dorë nga trashëgimia;					
Bashkëshortja e trashëgimlënësit kur nuk ka fëmijë nuk mund të trashëgojë pasurinë, atë duhet ta trashëgojnë prindërit apo vëllezërit e trashëgimlënësit;					
Bashkëshortja e trashëgimlënësit edhe kur ka fëmijë duhet të heqë dorë nga trashëgimia në favor të fëmijve/djemve					
Edhe nëse më ligj femrës i garantohet e drejta në trashëgimi unë prapë do të vendosë të pasuria t'u takojë djemve të familjes;					

14. A dini për ndonjë rast që femra ka kërku më padi realizimin e të drejtës së trashëgimisë?

- ☐ Po
- ☐ Jo

15. Në rast së një femër do kërkonte realizimin e të drejtës së trashëgimisë më padi si mendoni sa do të haste ajo në përkrahje të :

	Pak	Shumë pak	Mjafueshëm	Aspak	Nuk e di
Familjes					
Rrethit/Shoqërisë					
Institucioneve të drejtësisë/Gjykatës					
Tjetër specifiko					

16. **Pse femrat në Kosovë nuk e kërkojnë trashëgiminë vlerësoni nga 1 deri 5 faktorët të cilet ndikojnë në këtë aspekt:**

1. Shumë e rëndësishme 2. E rëndësishme 3. Pak e rëndësishme 4. E parëndësishme 5- aspak e rëndësishme

Mentaliteti/zakonet	1	2	3	4	5
Niveli arsimor/Mosvetëdijësimi i duhur	1	2	3	4	5
Varësi e parashikuar tek prindërit pas martesës	1	2	3	4	5
Mosbezdisja e Prindërve/ Vëllezërve	1	2	3	4	5
Mosbesim në institucionet e drejtësisë	1	2	3	4	5
Tjetër specifiko					

17. **Në rast së do ju mohohej e drejta e trashëgimisë në pronën familjare nga anëtarët meshkuj të familjes si do vepronit?**
    - ☐ Të iniconit padi private në Gjykatë ;
    - ☐ Asnjëherë nuk do inicojë padi;
    - ☐ Të heshtin;
    - ☐ Nuk e di.

18. **Në rast së paradhësi i juaj më testament do t'iu ndante në mënyrë të barabart pronën familjare më trashëgimatrët e tjerë meshkuj të familjes a do ta pranonit trashëgiminë?**

    - ☐ Po
    - ☐ Jo
    - ☐ Nuk e di

19. **Duke e ditur që edhe sipas ligjit iu takon e drejta e barabart më meshkujt në trashëgimi a do kerkonit ju që trashëgimia te ju ndahet në mënyrë plotësisht të barabart më trashëgimtarët meshkuj të familjes?**

    - ☐ Po
    - ☐ Jo
    - ☐ Nuk e di.

20. **A keni të hartuar testament?**

    - ☐ Po
    - ☐ Jo

21. **Kujt mendoni ju t'ia bartin trashëgiminë?**

    - ☐ Vajzave;
    - ☐ Djemve ;
    - ☐ Vajzave/Djemve në mënyrë të barabart;
    - ☐ Do t'ia ndajë edhe vajzave një pjesë, por gjithësesi që djemtë do i favorizoj;
    - ☐ Vetëm në rast që nuk do kisha djalë do ja bartja trashëgiminë vajzave;
    - ☐ Nuk e di

Shtojca Nr/3: Modeli i Çertifikatës së Testamentit Ndërkombëtare

ÇERTIFIKATË

(Konventa e e 26 tetor 1973)

1. Unë_____. (emri, adresa dhe kapaciteti), një person i autorizuar për të vepruar në lidhje me testamentet ndërkombëtare.
2. Vërtetoj se në. _____ (data) në. _____ (vendi).
3. (testatori)_____ (emri, adresa, data dhe vendi i lindjes) në praninë time dhe të dëshmitarëve.
4. (a)_____ (emri, adresa, data dhe vendi i lindjes).
   (b)_____ (emri, adresa, data dhe vendi i lindjes)
   ka deklaruar se dokumenti i bashkangjitur është testamenti i tij dhe se ai e di përmbajtjen e tij.
5. Unë gjithashtu vërtetoj se:
6. (a) në praninë time dhe të dëshmitarëve.
   (1) trashëgimlënësi ka nënshkruar testamentin ose ka pranuar nënshkrimin e tij vulosur më parë.
   (2) pas një deklaratë të trashëgimlënësit duke deklaruar se ai nuk ishte në gjendje për të nënshkruar testamentin e tij për disa arsye _____
   Unë kam përmendur këtë deklaratë në testament
   Nënshkrimi është vulosur nga _____
   (emri, adresa).
7. (b) Unë dhe dëshmitarët kemi nënshkruar testamentin.
8. (c) secila faqe e testamentit është nënshkruar nga _____dhe duhet të këtë numrin rendor.
9. (d) Unë kam vërtetuar identetin e testatorit dhe të dëshmitarëve në mënyrën siç përcaktohet më sipër.
10. (e) Dëshmitarët i kanë plotësuar kushtet e nevojshme për të vepruar si të tillë sipas ligjit sipas të cilit edhe unë jam duke vepruar;
11. (f) trashëgimlënësi më ka kërkuar që të përfshijë deklaratën e mëposhtme në lidhje me mbajtjen e sigurt të testamentit të tij:
12. VENDI _____
13. DATA _____
14. NËNSHKRIMI dhe, nëse është e nevojshme vula.

Të plotësohet nëse është e përshtatshme